BIBLIOTEKA
85H-31
B 98



LIBRI I TË MALLKUARVE

Jusuf Buxhovi

Redaktor
JORGO BULO

Piktore
ALMA XHAFA

Recensues:

Ndue Zef Toma
Vladimir Thanati

Shënimi hyrës i kronistit

. . . më thanë se Perandoria, krahas mijëra e mijëra librave të rëndësishëm, ruan edhe një të vetëm, që i frikëson njësoj të mëdhenjtë e të vegjlit, të gjallët e të vdekurit. . .

. . . më thanë se ai libër është plot e përplot me ngjarje e persona që duhet t'i takojnë harresës, asaj harresës së gjatë e të shurdhur. Sepse vetëm qoftëlargu pati punë me ata shpirtëra të shqetësuar, të cilët u mallkuan aq rëndë sa të largohen përgjithmonë nga kujtesa perandorake. . .

. . . më thanë se duhet të ruhem, sepse Libri i mallkuar prore pikon helm dhe vret pamëshirshëm. . .

KULLA E HARRESËS

Në fillim të verës u hapën thashetheme se një shpirt apo një i vdekur bridhte nëpër varre. Fjala gjithë shqetësim së pari u dëgjua në Kullë pastaj shkoi në Blinishtë, e më vonë, u përhap gjithandej nga shtrihej Flamuri dhe Principata e dikurshme. Dhe, sa më larg që ato shkonin, u shtoheshin të tjera, kështu që në pjesën veriore të vendit, aty ku mbaronte Principata, që nuk ishte më dhe fillonte bota e përzier e gjuhëve të tjera, tregimi i gjasonte një përralle të çuditshme. Kur në Kullë pështpëritej, për një si hije, që shfaqej herë pas here dhe linte një lule gjashtëfletëshe në varrin e Mrikës (të bijës së Martin Tanushit, vëllamit të Flamurtarit), në Blinishtë hija bëhej njeri që herë dukej e herë nuk dukej, e në qendrën e dikurshme të Principatës, ku tashmë gjendeshin garnizonet e ushtrisë së huaj dhe zyrat e para administrative me mëkëmbësin perandorak në krye, flitej për një dragua të pashoq... Kjo krijesë e çuditshme, thuhej, po gatitej të hakmerrej kundër ushtrisë perandorake për masakrat që kishte bërë ajo në Liman. Shpirtërat e mijëra e mijëra të vrarëve në pabesi nuk prehen të qetë... Ata po bëhen gati... Do të derdhet gjaku si rrëke... Limani nuk harrohet... Limani do shpagim...

Gojë më gojë, thashethemet ranë edhe në veshin e Flamurtarit. Plaku i verbër, që moti ishte kredhur në një natë të pafundme dhe vetëm me përfytyrimet e gjata shqyente perden e rëndë të territ, në fillim nuk ua vuri veshin fjalëve. Na kanë mbetur vetëm ëndrrat, i tha djaloshit dhe vazhdoi t'u jepej mendimeve të pasosura për kështjellarët që nuk ishin më dhe për betejat e gjata nëpër të cilat kishte kaluar mbi gjashtëdhjetë vjet...

Mirëpo, nuk kaloi shumë dhe djaloshi hetoi shqetësim në mendimet e plakut. Bashkëluftëtarët po më rrallohen paksa, u ankua ai. Edhe ata që vijnë nuk janë të dikurshmit... Kanë zënë të bëhen tekanjozë. Diçka po ngjet... Sillen vërdallë dhe heshtin gjatë.... Maloja ecën pa njërën këmbë... Zeka nuk ka sy... Uka herë duket e herë nuk duket... Ca fistarë i harrojnë armët... E, ç'është më keq, po druaj se ca prej tyre kanë zënë t'i harrojnë dhe emrat... Çfarë më duhet një ushtri e tillë memece... Me të nuk mund të shkohet në luftë e lëre më të fitohet...

Shumë kohë Plaku i përsëriti si përçart të njëjtat fjalë. Djaloshi i rrinte pranë dhe i vinte keq pse ai ngrysej gjithnjë më shumë. Pas një heshtjeje të gjatë, si ta kishte lënë prapa shqetësimin e thellë, Plaku i tha djaloshit:

«Në cilin varr shihet ajo lulja që nuk është lule?»

«Në varrin e Mrikës...»

«Më në fund qenka kthyer», pëshpëriti Plaku.

Këto fjalë Plaku ia tha vetes disa herë sapo mbeti vetëm dhe iu kujtua mëngjesi i asaj vjeshtës së vonë para njëzet e gjashtë vjetësh, kur i madh e i vogël në Kështjellë iu gëzua rrebeshit të parë të shiut që e pritën aq shumë. Atëbotë, retë e dendura u shfaqën si rëndom nga deti, por sadoqë dukeshin të fryra me shi, silleshin e mbështëhu dhe zbrazeshin në bjeshkë. Ata e shinin bjeshkën e qullur dhe gjithë dëshpërim shikonin nga deti dhe uronin që shirat të vinin sa më parë. Sepse, me të filluar ato, ushtria e huaj shkrehte tendat e shumta dhe ikte dikah për t'u mbrojtur nga lagështia e papërmbajtshme, me të cilën ata nuk ishin mësuar. Rreth tyre mbeteshin vetëm pararojat që

silleshin plogështazi dhe topat e rëndë të drejtuar gjithnjë kah Kështjella. Të qullur, ata dukeshin si korba të zes. E, kështjellarët e shkallmuar nga rrethimet e gjata përpiqeshin ta merrnin veten, kush duke shëruar plagët, kush duke u marrë me ndonjë zeje të dobishme, e kush duke meremetuar të plasurat e shumta të mureve të Kështjellës, nëpër vrimat e së cilës kullonte uji...

Ditën që kështjellarët panë morinë e flamujve të huaj në të mbrapsur, dikush hapi lajmin se Kryekështjellarin e kishin zënë të huajt. Në kohën e rrebeshit të parë të shiut, kur ai doli në pjesën lindore të muranës së madhe dhe po shikonte tërheqjen e ushtrisë së huaj, befas ra në një kurth të litarëve që ata e kishin ngritur gjatë natës. Kryekështjellari nuk pati kohë të bënte gjë. Gëzimi për shiun aq të pritur u bë i hidhur ngaqë të gjithë e kishin të qartë se ç'fat e priste atë. Prandaj, me urdhërin e Princit, qysh atë pasdite me shi të imët, në varret e Kështjellës u vu një kryq i ri i cili gjatë gjithë stinës së shirave u stolis me degë të njoma të qiparisave. Por, erdhën kohë kur kryqit zunë t'i vyshken degët e qiparisave. Kur ia behu pranvera dhe sërish fusha përreth nxiu nga taborret e shumta të ushtrisë së huaj, kështjellarët zunë të dyshonin se mos vallë kryetrimi i tyre, nga torturat e jashtëzakonshme kishte thënë diçka nga ato që nuk bënte t'ia kallëzonte as natës së varrit. Dyshimi u rrit kur së pari u prenë damarët e ujit që vinin nga pjesa e bjeshkës (udhën e fshehtë të të cilëve e dinin vetëm Princi dhe Kryekështjellari), e më vonë edhe kur u mbyll dalja kryesore nga ana e lumit, nëpër të cilën bëheshin furnizimet kryesore gjatë kohës së rrethimeve të gjata. Një ditë kur uji i sterrave ishte në të sosur, Princi tha gjithë dëshpërim se të huajt e kishin në dorë fatin e tyre, ngase ua kishin prerë ujin dhe ushqimet... Ngjau diçka e jashtëzakonshme, shfreu ai me shikimin e tretur kah liqeni i cili dukej si i mjegulluar nga vapa e gushtit.

Edhe pse nuk e zuri ngoje emrin e Kryekështjellarit, që aq shumë e deshi, të gjithë e patën të qartë se Princit i qante zemra mos vallë i kishte shpëtuar ndonjë fjalë nga ato që nuk duhej t'i shpëtonin kurrë. Dyshoi apo nuk dy-

shoi ai, kahet e luftës kishin ndryshuar. Në vend të mbrojtësve të pathyeshëm, ata tash ishin kthyer në të rrethuar që pritnin mëshirën e shiut...

Ç'është e vërteta, sado që qëndruan atë verë, të gjithë e kishin të qartë se në rrethana të tilla Kështjella do të binte patjetër. Me ujin bëhej disi, pasi u hapën ca puse të thella, por si të furnizoheshin? Udha e sigurt ishte ndërprerë dhe në vend të saj duheshin bërë sulme të befasishme jashtë Kështjellës për t'u hapur udhë karvaneve të ushqimit. Kështu, shumë nga kështjellarët vriteshin ende pa kaluar mirë rrethimin, e edhe ata që hidheshin tutje, e kishin edhe më të vështirë që ushqimet t'i futnin në Kështjellë. Çdo thërrime lahej me gjak...

Flamurtarit i pat ndodhur që t'i udhëhiqte dy ekspeditat e fundit. Vetëm me pak veta, para agimit i sulmoi njësitë vëzhguese të armikut, që gjendeshin në krahun e djathtë të Kështjellës, mu aty ku fillonte këneta e gjatë e cila përfundonte në liqen. Ushtarët e huaj, të cilët nuk ishin mësuar që kështjellarët t'u vinin ashtu te goja, u zunë ngushtë. Nuk ua mori mendja se ky ishte një karrem që u hapte udhë karvaneve të ushqimeve, që vinin nga ana tjetër.

Herën tjetër çak të befasisë zgjodhi tendat ngjyrëkaltra, në të cilat rrinin çallgaxhinjtë dhe gratë e haremit. Ka vite që ato tenda i kishte zët. Edhe pse s'i shihte, syri ia zinte sapo binte nata. Atëherë ato merrnin gjallëri të paparë. Përreth tyre flakëronin drita të laryshme. liroheshin gjithfarë flakadash dhe dëgjoheshin melodité mbytëse të gërnetave, që ia rrënqethnin trupin. Gjithçka tjetër në atë mizëri ushtrie i dukej e rëndomtë. Të rëndomta, madje i dukeshin edhe masakrat e tyre të jashtëzakonshme (sidomos kur i zinin kështjellarët dhe i ngulitnin në hunj të gjatë dhe endeshin me ta duke kënduar e duke u çirrur). Ushtrisë, mendonte, i ka hije ashpërsia, gjaku, dhuna e gjithçka tjetër, pos lavireve dhe haremit. Ato e bëjnë luftën të ndyrë dhe të neveritshme, e edhe fitores, sado e madhe të jetë, ia ulin vlerën... Në fillim, mu atëherë kur pati filluar rrethimi i parë, që zgjati dymbëdhjetë vjet rresht, ditë e natë ëndërronte ditën kur do të futej midis

atyre tendave të ndyra për t'i kallur me ato që mbanin brenda. Tjetër vdekje pos flakës nuk meritojnë ato. Vetëm zjarri mund ta pastrojë edhe tokën, edhe ajrin, edhe ujin nga kundërmimi i tyre i rëndë dhe i sëmurë... Mu pse gjithçka tjetër ndërronte (taborret e shumta që shkriheshin, komandantët që vinin e shkonin, armët që shkriheshin para syve të tyre), e ato mbeteshin të njëjtat, iu pat shtuar edhe më ndjenja e tërbimit dhe e hakmarrjes. Bile, kur flitnin për fitoren, e cila duhej të vinte dikur, mendja prore i shkonte te tendat dhe gratë e haremit. Si do të bëhej me to kur të fillonte parakalimi i ushtrisë së mundur? Po t'i shihte ato duke u zvarritur pas bishtit të ushtrisë, do të kthente. Prandaj, ja pse e përfytyronte dhe e dëshironte zjarrin, një zjarr të madh, që do t'i përpinte para se të mundeshin të huajt. Por, me kalimin e kohës, sidomos kur mbrojtja e Kështjellës qe dobësuar dhe rrethimi bëhej gjithnjë më i egër, zjarri po i fikej. Jo, jo, pëshpëriste, dua t'i bëj copë e grimë. Dua t'i ngul në thika...

Dhe, kur iu dha rasti ta bënte sulmin e befasishëm, pa një pa dy vendosi t'i sulmonte tendat e kaltra, pa menduar se a do t'i hapte me tamam udhë të sigurt karvanit të ushqimeve. Ndjenja e urrejtjes, që e kishte ushqyer aq gjatë dhe aq fuqishëm ishte më e fortë se gjithçka tjetër. Tash ju kam... Nuk do të më shpëtoni... Nuk do të më shpëtoni — kërcënohej dhe ishte i lumtur se edhe po të vdisnin pak nga pak çdo ditë, së paku nuk do t'i dëgjonte të qeshurat e tyre hingirisëse dhe atë muzikën që ia gllabëronte shpirtin. Natën e sulmit, nga pirgu, një copë herë i shikoi tendat e kaltra. Dritat laryshëse po i dukeshin më të zbehta, flakadanët të errësuar, e edhe klithjet e përdalëseve i vinin të fashitura. A thua ato po e parandjenin kobin që e kishin pranë kur heshtnin ashtu, mendoi. Jehona e gërnetës, që i vinte si një vajtim, thuajse ia vërtetonte këtë. Vajto, vajto, thoshte. Gjithnjë do të vajtosh. Do të vajtosh bashkë me kokën që do të kalbet në kënetë... Koka po ia thurte një gjakderdhje makabre, shumë makabre, nga ato që i kishte dëgjuar si fëmijë. E për këtë i duhej zhurma. I duhej hareja e tendave. I duhej

hingirisja e grave të haremit në mënyrë që ta ndërpriste tmerrshëm. Ndryshe as që e merrte me mend masakrën. Sa më e madhe që të jetë zhurma, aq më e fuqishme duhet të jetë e goditura. Ndryshe nuk bën. Madje, kur po i shikonte tendat ashtu gjysmë të heshtura, i shkoi mendja që sulmin ta shtynte për ndonjë herë tjetër. Por, kjo ishte punë që nuk bëhej, ngase që me kohë qenë dhënë njoftimet për kohën dhe vendin e ardhjes së mallrave.

Megjithatë, tendat i sulmoi. Por këtë e bëri pasi u fut në anën perëndimore, shkatërroi dy tenda dhe, në të kthyer, kur prapa la hutimin e ushtrisë armike, hyri në tendat e kaltra dhe shkatërroi gjithçka që gjeti në to: çallgaxhinjtë që flinin, rojat e përgjumura si dhe gratë e lakuriqësuara... Pastaj i coptoi edhe daullet e mëdha, xhambyshat dhe veglat me tela, të cilat nga të rënat dukej se qanin. Në atë shfrim se si i shkoi mendja te gërnetat. Ku ishin ato? Shikoi përreth por nuk ia zuri syri. Gërnetat! Gërnetat i dua, zuri të çirrej! Ato do të vajtojnë prapë! Prapë! Mbase do të çirrej një copë herë, por dikush i tha se koha ishte të iknin sa më parë. Ndoshta ndjenja e mllefit të kahmotshëm, që e kishte bartur me vete prej shumë e shumë vjetësh, bëri që të kërkonte ndihmë nga flaka? Në të dalë e hodhi flakadanin poshtë dhe iku. Kur kaloi nga pjesa e lumit, prej nga karvanet tashmë po sosnin në Kështjellë, pa zjarrin e madh mbi tenda. Zjarri që po bëhej i madh e më i madh sado pak e ngushëlloi...

Të nesërmen Princi i tha se me flamurin e vet duhej të largohej nga Kështjella. Ngjitu lart në male, i tha ai mendueshëm, dhe sulmo ushtrinë e huaj ku të mundesh. Ndryshe nuk bën. Ndoshta kështu do t'ia dalim që sado pak ta forcojmë mbrojtjen e Kështjellës. Tash duhet ta ndërrojmë edhe mënyrën e luftës. Le të mendojnë se jemi shumë... Shumë... Në çdo grykë... Në çdo shkurrë... Në tokë e në qiell...

Kur u ngjatjetën me Princin, ai i tha me një zë të ulët e të marrur: po flitet e ç'mos po flitet... Një i lartë i tyre po u duket i njohur tanëve... Ç'ka s'ka...

Flamurtari e mori me mend pse qahej Princi.

Gjatë luftërave që bëri jashtë Kështjellës (e ato qenë gjithsej dyzet e tri për aq kohë derisa ra përfundimisht Kështjella), i ra të dëgjonte gjithfarë kallëzimesh të jashtëzakonshme. Jo rrallë i thoshin gjithë shqetësim: kryeoficeri i huaj na u duk si të ishte Kryekështjellari... Komandanti i tyre është si t'ia kishte këputur kryet Kryekështjellarit... Kryekomandanti i tyre është si ai... Koka i ziente nga fjalët e tilla dhe pa ia da e vriste mendja se ishte ai ndonjë përftim që po u shfaqej trimave të tij në atë gjendje të rëndë, apo fjala ishte për ndonjë mashtrim që bënin të huajt për t'i shkatërruar shpirtërisht sa më parë?

Një ditë i thanë se në disa tenda dhe mu në pjesën kryesore të taborreve, u shfaq një pëlhurë e madhe në të cilën ishin të bindur se rrinte Kryekështjellari i vizatuar. Ata që ia sollën këtë lajm i thanë se kishin të dhëna të forta se ai që i gjasonte Kryekështjellarit ishte kryekomandanti i ushtrisë së huaj. Një vëzhgues i tij ndër më të zhdërvjelltët, i cili si tebdil u përvodh disa herë mu në mes të taborreve të ushtrisë së huaj, i tha se betohej në tokë e në qiell se në atë syret të madh pesë pashë njeriu, shfaqet fytyra e Kryekështjellarit që e njihte aq mirë. Nishanave të tij, i tha ai, u falen të gjithë me radhë...

Edhe të tjerët i thanë fjalë të njëjta. Por nuk mund të pranonte se ai kishte bërë tradhti. E njihte si vetveten. Megjithatë një dyshim e mundonte pareshtur: si u bë që u gjend burimi i ujit? Si u ra në dorë shtegu i fshehur i furnizimeve? Si? Si? Kjo pyetje zuri ta brengoste aq shumë sa një ditë, ngase nuk kishte më nga t'ia mbante, e bindi veten se fjala ishte për tradhti. Prej atij çasti filloi të mendonte për një hakmarrje të madhe. Mendja i tha se ndjenja e hakmarrjes do t'u ndihmonte që shpirti të mos u molisej. A nuk kishte nevojë për një shtytje të tillë më tepër se kurrë? Të jetoje në atë kohë të vështirë pa atë ndjenjë, do të thoshte përgjumje. Prandaj, që t'i ikte asaj, koka e tij pareshtur thurte gjithfarë betejash në të cilat një ditë medoemos do të ndeshej me Kryekështjellarin, shokun e dikurshëm të pandashëm e tash komandant i ushtrisë së huaj...

Por fati i luftës deshi që të mos takoheshin ndër beteja, ngase ushtrisë së huaj i printe jo ai por ajo piktura e madhe, të cilën ushtarët e hiqnin gjithnjë para vetes. Kur merrte vesh këtë, kthente kokën kah bjeshka dhe mend pëlciste nga tërbimi. Të dua ty e jo atë djall, thoshte. Të dua ty! Ç'luftë i thonë asaj kur duhet të ndeshesh me hijen në pëlhurë? Phu! Sa herë shfrynte kështu mendja i shkonte te kështjellarët dhe te dëshpërimi i tyre i pamasë kur e shihnin pëlhurën para. Kuptoi se një natë (me siguri pa lejen e Princit) një dhjetëshe e zgjedhur i ishte sulur pikturës së madhe dhe e kishte bërë copë-copë. E kishin shkelur pamëshirshëm dhe e kishin pështyrë. Por shfrimi u kushtoi me kokë, ngase kur ata po merreshin me shkallmimin e pëlhurës, ushtria e huaj, e cila një gjë të tillë e kishte pritur qëmoti, u ra nga prapa dhe i theri një nga një. Të nesërmen kështjellarët panë një pikturë edhe më të madhe që u rrinte përpara e nën të dhjetë kështjellarët e masakruar.

Ishte mu ajo piktura e madhe e cila përfundimisht u fut në kështjellë dhe zuri vend në pikën e saj më të lartë, mu aty ku kohë më parë rrinte flamuri i tyre. Ngjau kjo aty nga mesi i rrethimit të njëzetedytë me radhë...

Flamurtari pati derdhur lot kur i thanë se piktura si një shpirt i lig, ishte futur më në fund në Kështjellë. Ai lot pati derdhur sa herë i shkonte mendja te kështjellat e tjera në të cilat thuhej se buzëqeshte e njëjta. Djalli ka njëmijë fytyra, thoshte. Djalli është i pakapshëm e i paprekshëm. Kur do ta mundim djallin tonë? Kur?

I tërhequr thellë në male, nuk e kthente kokën nga Kështjella. Dronte se shikimi mund t'ia zinte pikturën. Kokën nuk e ktheu nga Kështjella as kur i thanë se piktura nuk spikatej më... Megjithatë, me kalimin e moteve, përfytyrimi i Kryekështjellarit i bëhej më i madh se bjeshka. Ajo bjeshkë po e kërruste. Kishte frikë se një ditë do t'i shëmbej e tëra përmbi. Në atë ngushtim sec i shkrepi mendimi se mbase Kryekështjellari duhej të dënohej me harresë. Harresa është e tmerrshme. Nuk ka dënim më të madh se kur dikë e gjykon t'i takojë harresës. Tash hiq-

mu, tha, hiqmu! Të kemi përjashtuar nga kujtesa jonë... Kështu është më së miri. U takon të paqenëve...

Por ja se tjetri nuk po pajtohej që t'i takonte harresës. I futej në përfytyrime dhe i kërcënohej se nuk do ta linte të qetë. Ti je i paqenë, i thoshte Flamurtari. I tillë do të mbetesh gjithnjë. Shko në shkretëtirën e zezë... E kryekështjellari nuk jepej që nuk jepej. Dëshironte t'i thoshte diçka, por fjalët i kishte shurdhe... A sheh, i thoshte Flamurtari, për ty nuk ka shpëtim. Mund t'i kesh njëmijë fytyra, por kurrë më shpirtin tonë... Kurrë më... kurrë më... Kurrrrëëëë...

Kurrë, kurrë, plaku po ecte kur u hap dera dhe bashkë me Djaloshin hyri lagështia e mëngjesit të freskët.

E Djaloshi që ia dinte mundimet priti e tha:

«Isha ndër varre. Sapo ra terri i parë, i rashë trup Blinishtës dhe ktheva rrugën në të majtë që t'u ikja shikimeve të ushtarëve të huaj. Kur hyra në fshat, vëzhgova mirë e mirë dhe u futa në kishën gjysmë të rrënuar. Trerëve u vinte era shkrumb. Prapa më rrinte një ikonë e kallur. Më vonë zvarrë u futa në mes të varreve, mu aty ku qëndronin dy skelet e këmbanares së dikurshme. Nata ishte me yje dhe unë fillova t'i numëroja yjet sa për ta mashtruar gjumin i cili nuk e di se pse më sillej në sy. Dhe pasi numërova qindra e mijëra yje, pasi u ngatërrova shumë herë me ta, dëgjova një trok kali. Vinte shumë i lehtë sa më bëhej se mund të ishte një mashtrim. Por, ja se një çast trokun e zëvendësuan ca hapa të butë, që shpërndaheshin shkujdesshëm andej-këndej nëpër varre. Më dukej se të vdekurit ishin ngritur dhe po luanin valle. Nga frika një copë herë m'u mbyllën sytë. Kur i hapa, m'u duk se pashë një burrë të gjatë që u soll disa herë rreth një varri. Se çfarë bënte nuk e dija, por nuk shkoi shumë e veshët ma kapën një si shushurimë të lehtë, e cila shpejt humbi në qetësinë e natës. Kur po shfaqej ferku i dritës, iu afrova varrit rreth të cilit u soll hija dhe gjeta një lule të kuqe me gjashtë fletë. Lulja ishte e freskët e të freskëta ishin edhe ca gjurmë përreth varrit...

«I kujt ishte varri?», pyeti Plaku prajshëm.

«I Mrikës së Mal Tanushit».

«I Mrikës së Mal Tanushit, the?»

«I Mrikës», tha djaloshi dhe doli.

E bija e Malës së Tanush Malës, pështpëriti me vete plaku dhe ndjeu një mallëngjim aq të madh sa iu bë se iu mbushën sytë me lot. Koka e tij e vjetër tash po shpalonte një kujtim të kahmotshëm, mbase nga rrethimi i parë (Plaku e maste kohën me rrethime), kur në pirgun e lartë, ku po vëzhgonte taborret e ushtrisë së huaj që po e shkrinin një top të madh, nga më të mëdhenjtë që kishin parë ndonjëherë para Kështjellës, iu afrua Mala i Tanush Malës dhe i tha se i kishte lindur vajzë. Në atë kohë lufte, kur të gjithë u gëzoheshin djemve më tepër se bukës, Mala iu gëzua çupës me arsye, ngase kishte shtatë djem rresht. Shtëpia pa bija është e shurdhër, thoshte. Flamurtari i pati thënë se do t'i bëhej nun dhe do t'ia gjente trimin kur të rritej. Jotja është, o Flamurtar, i pati thënë Mala. U rrittë e lirë, ia pati kthyer ai. Po vajza të cilën Flamurtari e pagëzoi Mrikë, qysh fëmijë zuri ta ndiente peshën e rrethimeve të pakufishme. Dhe, pikërisht në të gjashtëmbëdhjetën, kur vajza ishte bërë selvi dhe i përdorte me shkathtësi armët, me lejen e të atit Flamurtari e fejoi me Kryekështjellarin. Kur e shpalli fejesën e dinte se po fliste me zemrat e të rinjve. Në Kështjellë i madh e i vogël u gëzuan. E bëfshim dasmën në liri, uronin. Por, liria për të cilën luftonin pareshtur, dukej se nuk ishte afër. Rrethimet nuk kishin të sosur. Bile, erdhën kohë kur edhe vajzave u binin mbi supe sakrifica të shumta. Kjo e shtyri Kryekështjellarin të merrte leje prej Kuvendit të luftës që ta formonte njësitin e vajzave, në të cilin ndër të parat u fut Mrika. Aty ajo dallohej për trimëri dhe zhdërvjelltësi të pashoqe. Në shumë luftime brenda dhe përreth Kështjellës ajo kishte lënë nam. Flamurtari u gëzohej të dyve dhe priste sa më parë të vinte pranvera që t'ua vinte në gishta unazat e martesës. Edhe pse qe vendosur që martesat të bëheshin gjatë stinës së shirave, pra kur rrethimet ndërpriteshin përkohësisht, Flamurtari luti Kuvendin që dasma të bëhej mu në pranverë, ditën e rrethimit. Do t'u

tregojmë se gëzohemi, se nuk jemi molisur, se dëshirojmë të përtërihemi pareshtur... Flamurtari përfytyronte një dasmë të madhe, të jashtëzakonshme, që do të bëhej një ditë me behar, ku së pari do të jehonin daullet e pastaj këngët e vallet e gjata. E tutje, përtej mureve, ushtria e huaj do t'i përshëndeste me predha topash e me zjarr të furishëm nga të gjitha anët... Ç'madhështi, mendonte ai: në njërën anë daullet dhe këngët e në tjetrën zjarri i luftës. Këngë, predha, gjak... Dhe në fund nusja heq duvakun para syrit të armikut. Ai do të zemërohet dhe do të hedhë predhat më të mëdha. Ndonjë mund të derdhet edhe në sofrat e mbushura me verë e me desh të pjekur, por askush nuk do t'ua vërë veshin atyre. Vera do të pihet me kupa, kënga do të jehojë, nusja e re do ta ëndërrojë vogëlushin si rritet më shpejt se behari, e armiqtë do të lagen e do të lagen në rrebeshin e shiut derisa të qullen dhe do të ikin për t'u tharë në shkretëtirat e pafund të lindjes...

Por, dasma që ai e priste nuk u bë as atë pranverë e as kurrë më. Pas rënies së Kryekështjellarit në kurth, Mrika dëshpërimin e shprehu në një mënyrë të veçantë: veshi rroba burrash dhe me lejen e Princit kaloi në njësitin e vëzhguesve, i cili ngarkohej me sulme të herpashershme jashtë Kështjellës. Një vit më vonë, kur u pre damari i ujit e kalimi i fshehtë i furnizimeve u mbyll përgjithmonë, një ditë prej ditësh Mrika nuk u pa më në Kështjellë. Nuk u duk as të nesërmen e as kurrë më... I madh e i vogël zuri të brengosej për të. Flamurtari vështronte nga pirgu i lartë fushat përreth dhe kah s'i shkonte mendja. Mos vallë edhe ajo kish shkuar pas të fejuarit? Mos kishte pasur midis tyre ndonjë lidhje të fshehtë? Mos vallë Mrika i kishte ditur të gjitha dhe iku nga frika se do të mund të zbulohej? Çnuk i thoshte mendja...

Ditën e katërt u hap një lajm (i cili më vonë u vërtetua në tërësi) se Mrika futej nëpër tendat armike dhe priste ushtarë. Hynte befas, gjithnjë aty ku nuk e pritnin dhe ikte duke lënë pas currila të shumtë të gjakut. Ushtria e huaj qe shqetësuar së tepërmi, ngase sulmet ishin aq të shpejta e aq të ashpra sa kush nuk mund ta merrte me

mend se ato i kryente një dorë e vetme. Komanda e huaj mendonte se mund të ishte ndonjë shpirt i jashtëzakonshëm, i cili nuk mund të hetohej para se ta linte prenë pas. Kështu, krahas masave të jashtëzakonshme të mbrojtjes, u vunë në lëvizje gjithfarë hafijesh e çështja u shtrua me ngut edhe në këshillin e lartë të fesë. Nga dervishët dhe nga të tjerët u kërkua që të vërtetohej se mos ishte fjala për ndonjë shpirt hakmarrës, për të cilët në Kryesheher thuhej se në këtë pjesë të botës kishte si shumë, dhe herë pas herë merrnin botën në sy. Këtë shqetësim e hetuan me të shpejtë edhe kshtjellarët. Ata, nga muret, që në agim shikonin ceremonialet e varrimit që bëheshin diku në afërsi të tendave ngjyrë vjollcë. Se po ngjiste diçka njëmend e papritur dhe e rëndë dëshmoi edhe heshtja e papritur që i përfshiu tendat e kaltra. Jeta e natës, e cila rëndom fillonte pasi binte terri i parë, u shua. Taborret e shumta pa zhurmën e haremeve dukeshin të përgjumura e të frikësuara.

Ditën e shtatë u kuptua se ishte vrarë një oficer i rëndësishëm (togu i nderit marshoi prej tendës së gjelbër e deri te tenda e praruar). Ndërsa ditën e nëntë nuk mund të dyshohej fare se ishte vrarë një oficer i lartë, në mos njëri ndër më të rëndësishmit. Këtë e treguan shenjat e zisë, që për herë të parë u dukën qysh se kishin filluar rrethimet. Kështjellarët panë flamurin e huaj në gjysmështizë dhe dëgjuan uluritjet e dervishëve gjithë sa zgjati e lumja ditë. Gjëmimi i tyre u bë edhe më i trishtueshëm kur ra nata dhe terri futi në pushtetin e vet taborret e pafund. Gjëmimi përhapej si një ogur i lig në të gjithë Krahinën... Kështjellarët atë natë nuk vunë gjumë në sy. E dinin se të nesërmen do të pasonte një sulm i jashtëzakonshëm me rrebeshe të papara deri më atëherë. Ishin mësuar që pikëllimi apo dëshpërimi i të huajve t'u derdhej pamëshirshëm. Por, për habinë e tyre të madhe, sapo gdhiu, vendin e gjëmës që nuk pushoi sa qe nata, e zuri një hare e trishtueshme. Filluan të binin çallgitë, dëgjoheshin gjithfarë çirrjesh nga ato që shpërthenin pas ndonjë suksesi ushtarak... Moria e ushtarëve luante një valle që nuk i shihej as koka e as bishti, po që hiqej gjithë vrull, prej

tendës në tendë, duke formuar një si labirinth përmasash përrallore. Ajo zallahi marramenthe vazhdoi deri sa dielli mori tatëpjetën. Atëherë, befas, labirinthi i valles u shthur dhe gjithë ata trupa të shkallmuar nga lëvizjet e shumta, iu afruan tendës së praruar. Nga ajo lartësi, kubeja e saj që vezullonte vrazhdë, kështjellarëve iu duk si një varr i madh, që nën vete ngërthente shumë viktima...

Pasi ranë daullet e komandës dhe dikush tha diçka, nga poshtë doli një e çirrur, e thënë si me një gojë, e cila mbyti hapësirën deri në liqen. Pastaj, para turmës sekush e nxori një hu të madh, në të cilin shihej një trup njeriu i ngulitur në të. Turma prapë zuri të ulurinte dhe të nxirrte gjithfarë çirrjesh të cilat dukeshin kërcënuese. Dervishët u hodhën në vallen e ziqrit mu para hurit dhe ulurinin thekshëm...

Gjithë ajo që panë më vonë, kështjellarëve ua ngjethi mishtë, ngase pas pak hetuan se në majë të atij hurit, qëndronte Mrika kaherë e vdekur.

Ceremoniali i përdhosjes zgjati deri kur perëndoi dielli. Pastaj nga turma e shfrenuar u liruan dy kalorës, të cilët, me hurin në dorë, u drejtuan nga muret e Kështjellës. Pasi bënë një vrap të lazdrueshëm, në pjesën ballore para muranës, para sheshit të kuvendit e lanë drurin me të vdekurën dhe ikën.

Pastaj ra nata, një natë e ethshme që dukej se nuk do të kishte fund kurrë. Por, Princi i urdhëroi rapsodët që të këndonin gjithë natën. Ata me të shpejtë ia morën këngës dhe zëri i tyre u dëgjua deri në agim. Zëri i tyre dukej se ikte nga kështjella, shkonte në liqen dhe prej andej i ripërtëritur nga kaltërsia e ujit, shpërndahej në gjithë Principatën si një kumt lufte që duhej ta dëgjonin të gjithë, i madh e i vogël, guri e druri...

Atë kumt Flamurtari e ndjeu thellë. Në kokë i jehonte thekshëm dhe prore ia sillte para pamjen e llahtarshme të vajzës së ngulur në hu. Por, ajo vdekje sado që qe makabre, e qetësoi. Me dëshirë, në atë gjendje do ta shihte edhe Kryekështjellarin. Në varrin e tij do të rriteshin lulet dhe

17
46577

bari në vend të dyshimit të pafund, që nuk e la të qetë asnjëherë...

Mrikë, moj Mrikë, pështpëriti plaku gjithë shqetësim. Nuk po të lenë të qetë as ty. Edhe në varr po të shqetësojnë...

Një copë herë foli si i përçartë. Dikur deshi t'i jepej harrimit, por s'qe e mundur. Së pari, në përfytyrim iu shfaq Mrika e veshur me të bardha, duke vrapuar në një kodrinë bleroshe, e më pas iu bë se po shihte Kryekështjellarin që po kërkonte vajzën. Dukej si një hije që niste diku dhe zgjatej neveritshëm. Hija po përpëlitej e po përpëlitej si të dëshëronte të shkëputej nga terri që po e mbante të kyçur. Dikur iu bë se hija ia doli të shkëputej. Tash e kishyer në një shumëhije lirisht e ndiqte Mrikën dhe ishte fare afër saj. Iu bë më në fund se hija dhe vajza u bashkuan, se u bënë një, se ecnin të njësuar... Zuri të çirrej, por hetoi se nuk kishte zë. I dëshpëruar pa se gjendej në një kjasinë ku kishte lagështirë dhe myshqe të kalbura, që kundërmonin rëndë. Myshku po rritej e po rritej dhe po bëhej gati ta fuste në botën e kalbur. Nga frika nisi të kërkonte ndihmë. Hej, Tanush! Hej, Curr! Hej, Zekë! Hej, Zog! Hej! Hehej! Ju mori mordja të gjithëve? Hehej! Një kohë të gjatë heheja e tij sillej kjasinës dhe i bëhej se i vërtitej në kokë gjithë lagështi... Dhe kur ia mori mendja se do të sharronte në atë kalburinë, iu shfaq një vegullim nga lindja. Pa se ca veta po zbrisnin prej kodrinës drejt kënetës. Ecnin si xhuxhimaxhuxha me nga një gur varri përmbi. Njohu bashkëluftëtarët e dikurshëm, të cilët, kush andej e kush këndej, ranë nëpër fushbeteja të ndryshme. Ku po shkoni, u tha? Ku po shkoni? Atje do të kalbeni përgjithmonë? Nuk e ditkeni se aty pushojnë ujërat e vdekura? Por, ata me rrasa në kokë ecnin kah këneta. Pas pak prekën ujin e trashë dhe një nga një u krodhën në të. Shihte rrasat që mbeteshin në syprinë dhe notonin lehtë. Më paskeni harruar, po thoshte, më paskeni harruar. Ç'u bë me ne kështu? Mos u dashka të bëhemi pjesë e ligatinës? Pse nuk shkoni atje ku ka thatësirë? Psepseja hapej ngado, por mbetej pa jehonë. Kjo bëri që të nisej nga këneta për t'i shpëtuar shokët, por ata tashmë kishin sharruar në kënetë. Për

habi nuk i pa më as rrasat e varrezave, të cilat notonin mbi ujë. Ktheu kokën pas dhe hetoi se aty nuk ishin as myshqet e kalbura, që pak më parë mbulonin kjasinën nga të gjitha anët.. Ndodhej në një mjegullim të thellë, i përcjellë nga një shpirt që s'e shihte, por që e ndiente se e kishte pranë. Kështjellar, o Kryekështjellar, u çirr. Pse po ma shpartallon ushtrinë? Pse?

Çierrja e nxorri nga përftimi i rëndë. Hetoi se ishte mbytur në djersë. Më pas e mbërthyen të dridhura të mëdha. Trupi i dridhej si thupra në ujë. Nuk i ndihmuan as lëkurat e mëdha të ogiçëve që i hodhi përmbi. Akullnajat e botës më kanë mbërthyer, pëshpëriti duke i cakëlluar dhëmbët, akullnajat e botës... Akullnajat...

Një copë herë zuri ngojë akullnajat dhe kur mendoi se ishte bërë pjesë e akullnajave ndjeu se kishte pranë dikë. Hoqi me të shpejtë lëkurat dhe u ul këmbëkryq.

«Erdha... më në fund erdha...», po i thoshte një zë që atij iu duk i njohur. Ishte i bindur se po i fliste Kryekështjellari. Dhe, për herë të parë pas verbimit, iu bë se po shihte atë që i fliste nga afër. Po e shihte Kryekështjellarin.

«Gjatë u more me mua... Gjatë...»

Flamurtari i fërkoi sytë. Tash ishte i bindur se ishte mu Kryekështjellari, i njëjtë si atëherë kur për herë të fundit e kishte parë në Kështjellë.

«Gjatë u more me mua», vazhdoi ai «dhe ta them të drejtën se kjo më mbajti...»

Pas një heshtjeje Plaku tha:

«Të kemi përjashtuar nga kujtesa jonë. Vendin nuk e ke më midis nesh, as si i gjallë, as si i vdekur...»

«Këtë nuk mund ta bëni. Isha dhe mbetu pjesë juaja...»

«S'e ditke se ç'pësuam?...»

Ai heshti. Plakut i bëhej se ai kërkonte t'i bishtëronte së vërtetës.

«E harrove ujin? I harrove furnizimet? E harrove masakrën e jashtëzakonshme që ngjau në Liman? Mijëra e mijëra veta i morën dhe sapo panë detin, ua futën thikat pas. Nga gjaku i tyre u përskuq edhe deti... Bën të harrohet një kasaphanë e tillë?»

Plaku po fliste me sa zë kishte. Jehona e tij përplasej mureve të dhomës dhe sërish i kthehej kokës së tij sa ajo zuri t'i digjte.

«Pse bëhesh i shurdhër?»

«Të gjitha, të gjitha i di», tha tjetri. «Nuk ka gjë që s'e di...»

«Ani?»

«Ka edhe ca gjëra që duhet t'i dini edhe ju...», tha ai. «Aq më bën për to».

«Janë të rëndësishme, madje shumë të rëndësishme...»

«Ç'kuptim ka që të merremi me gjepura. Bashkë me dokrrat tuaja je përjashtuar nga kujtesa jonë dhe mjaft».

«Do të ishte dëm i madh që ca gjëra të mos merreshin vesh. E vërteta, sado e hidhur të jetë, të ndihmon. Është koha ta njohim vetveten, me të mirat dhe me të ligat. Shi për këtë bëra rrugë të gjatë, shumë të gjatë. Kalova male, kalova fusha, kalova dete. Kapërceva muret e kohës që të merrni vesh një të vërtetë që nuk është vetëm imja, por e të gjithëve ne. Pa të kujtesa jonë do të jetë e mangët. Ata që kalojnë nëpër kobe të mëdha, do të pësojnë edhe më rëndë, po qe se nuk bëjnë përpjekje t'i mësojnë shkaqet e kobit. Sepse kobet, jo rrallë, përsëriten...»

«Mbase për kobe të tjera nuk ka më nevojë», foli Plaku gjithë dëshpërim.

«Të ka molisur disfata, por dije se Kështjella mbetet...»

«Ç'është kështjella pa kështjellarë?»

«Vijnë kohë kur ajo do të gumëzhijë prapë...»

«Nuk i duroj dot andrralla të tilla. Thuaj atë që dëshiron të thuash dhe më lë të qetë...»

«Kobi im filloi ditën e fundit të rrethimit të njëzetenjë pra, ditën kur pas një pritje të gjatë, retë sollën pikat e para të shiut dhe ne e dinim se ushtria e huaj do të mblidhte tendat për t'u kthyer sërish pas stinës së shirave...

Po ecja mendueshëm nëpër përgjimtoret e Kështjellës dhe po shikoja tendat e shumta që fillonin rrëzë mureve tona dhe mbaronin diku në afërsi të ujrave të liqenit. Pjesa më e madhe, mendova, do të shfaqen sërish pas katër muajsh. Me to do të vijnë edhe tendat e tjera dhe ne nuk do ta

kemi të vështirë t'i dallojmë të rejat. Kronistët tanë, rrethimin prej rrethimit e dallonin nga numri i tendave të reja dhe topat që derdheshin në afërsinë tonë. Kur kalova përgjimtoren anësore (andej kah lumi merrte kthesën e fundit për t'u derdhur në liqen) roja e lagur më tha: erdhi koha të shlodhemi paksa... Ato qenë fjalët e fundit që i dëgjova para se të shkëputesha nga qenia ime. Nuk e di as vetë si u futa në një mjegullim të pafund, në të cilin koka ime çuditërisht përnjëherësh përjashtoi gjithçka të veten! Një perde e akullt e harresës u hap tej për tej saj, saqë kur më futën në tendën ngjyrëvjollcë, në të cilën prarimi m'i mori sytë. m'u bë se u zgjova nga paqenësia...

— Të pritëm, më tha ai që rrinte i ulur në një shilte të madhe krye vendit. — E dinim se do të vinte dita kur do të shfaqeshe... Këtë ia tregoi Lartmadhërisë engjëlli mirëtor, që bëhet pedan gjithnjë para kthesave të jashtëzakonshme për Perandorinë...

— Të pritëm. Të pritëm — thanë edhe të tjerët.

Këto fjalë sikur po më vinin nga të gjitha anët dhe më bëhej se shumoheshin furishëm.

Zbrazëtia e shurdhër, që e ndjeva sapo u futa në tendë, po më mbushej me fjalët e atij që më foli i pari. Dikur ai më tha se duhej të pushoja paksa, ngase më priste rruga e largët.

Në dhomën e veshur me kadife të gjelbër koka po më ushtonte nga ato që dëgjova pak më parë. E ardhshmja e Perandorisë... E ardhshmja fitimtare... Njeriu i ri, që sheh vetëm para... E ardhshmja... E ardhshmja... gumëzhinin te unë tmerrësisht. Më kot bëra përpjekje t'i përjashtoja ato fjalë të shkëputura. Përkundrazi, ato sa vinin e bëheshin edhe më të forta.

Kur ra nata, më hipën në një karrocë të madhe. Ai që më foli i pari, më tha:

— Gëzohem që të përshëndeta i pari.

U përkul dhe doli. Pas la një kundërmim të fuqishëm luleshqerre.

Edhe të tjerët përshëndetnin dhe përkuleshin.

— Do të udhëtojmë gjatë, por do t'i bëjmë edhe pu-

shimet e duhura, — më tha njeri nga dy përcjellësit, që më rrinin pranë.

Kështu, lum miku, filloi vetmia ime e gjatë. Natën ecnim e ditën pushonim. Përcjellësit flisnin pak, e edhe kur bisedonin mes vete, nuk i kuptoja ato që i thoshin. Ç'është më keq, aty për herë të parë hetova se nuk kisha mundësi të mendoja sipas dëshirës. Në kokë kisha vetëm ato që m'i tha njeriu i veshur me krypsiten mavi, e ato krvesisht ishin fjali të shkëputura, si e ardhshmja... e ardhshmja e Perandorisë... njeriu i ri... Me një fjalë, isha njeri i zbrazur dhe, ç'është më keq, nuk e dija se kush isha! Më kot u mendova ta lidhja kujtesën. Mjegullimi në të cilin u gjenda befas ma humbte fare përcaktimin. Isha një fyshtë, që pranonte vetëm ato që dëgjonte...

Kur karroca përkundej hapësirave të errëta, bëja përpjekje që të njihja vetveten. Kush jam? Kush jam?... Por, nga brendia më vinte vetëm një zhurmë e shurdhër që nuk më thoshte asgjë. Ajo oshëtimë shtohej e shtohej sa më digjte koka e trupin ma mbulonin djersë të ftohta. Kush jam? Kush jam? Dhe prapë oshëtima e pafund, mjegullimi dhe heshtja e shurdhër. Dikur ndërhynin ato që i kisha dëgjuar në tendën e praruar: e ardhshmja... e ardhshmja e Perandorisë... njeriu i ri... e ardhshmja fitimtare... Nga këto pjesë ndjeja lodhje e amulli. I jepesha errësirës që të mbrohesha disi. Por, erdhi koha që as errësirën shlodhëse nuk e kisha më pranë. Karroca u ndal dhe ata që më përcollën më thanë gjithë përzemërsi: arritëm.

Kur u hap dera e karrocës para më doli një pallat i praruar. M'u bë se kubeja e përflakur, që dukej si e varur në qiell, më ftoi të futsha në të sa më parë. Dhe unë nxitova të hyja në kube. Ecja shkujdesshëm. Nuk ua vija veshin rojeve të shumta, që më përuleshin nga të gjitha anët. Vargoi i rojeve dukej si i pafund. Nisi para karrocës dhe më ndoqi nëpër kalldrëmin dredharak, që shkonte skaj disa luleve shumëngjyrëshe për të marrë fund në shkalloren e madhe, që m'u shfaq befas. Më tutje nuk kishte roje por ushtarakë me nishana, të cilët rrinin dhjetë hapa larg njëri-tjetrit, që, sapo u afrohesha më nderonin ushtarakisht.

Më vonë pashë asish që kishin nishane, shumë sish që u flakëronin në kraharor. Ai flakërim më përplasej fytyrës sa më digjnin sytë. Një çast m'u bë se nga flakërimi i nishaneve të panumërta do të humbja drejtpeshimin. Kisha frikë se do të plandosesha pa e arritur kubenë e përflakur. Një çast zura sytë me duar dhe ecja ashtu nga më shpinin këmbët, që po më dridheshin. Një copë herë eca nëpër terrin që ia krijova vetes. pa menduar fare se ashtu do të shkoja në ndonjë udhë të paudhë. Mendja ma thoshte se ngado që të ngarendja, patjetër do të sosja në kubenë e praruar. Dhe, pas ngarendjes, që m'u duk shumë e gjatë, hapa sytë. Para më doli një hapësirë e ndritshme, gjithë prarim. Nuk pashë roje e as ushtarakë me shumë nishane. Përkundrazi, aty hetova se isha vetëm, krejt vetëm, i zhytur në një prarim të butë, në të cilin nuk më gumëzhinte koka e as nuk më shkallmonte lodhja. U ula në kadifenë e purpurt dhe fjeta. Nuk e di sa kohë fjeta, por më kujtohet se kur hapa sytë, pashë se nuk isha vetëm. Në një fron të artë rrinte i veshur i tëri me të praruara që po shikonte butësisht

— Mirë se erdhe, Daut Pasha, — më tha ai gjithë përzemërsi.

Zbriti nga froni dhe më mori ngryk.

— E dinim se një ditë do të vije... Të kemi pritur siç e pret toka e uritur shiun...

— Mirë se erdhe! Mirë se erdhe! — jehoi pallati.

— Rroftë Daut Pashai! Rroftë!

Cilët ishin, vallë, ata që e thoshin atë emër dhe rrinin në gjunjë para meje? M'u bë se kishin të njëjtën fytyrë, të njëjtat rroba të shkëlqyeshme dhe të njëjtin zë.

— Je i madh ndër të mëdhenjtë, — më tha ai që më foli i pari e që tash sërish ishte kthyer në fronin e artë. — Perandoria jonë pret t'ia hapësh rrugët e përhershme...

— Rroftë Daut Pashai! Rroftë — Flisnin me një gojë ata që rrinin në gjunjë.

— Ne duhet të shkojmë në Lindje dhe në Perëndim...

— Në Lindje! Në Perëndim!

— Perandoria është Perandori vetëm kur ecën përpara, e jo kur vendnumëron. Perandoritë që nuk lëvizin plogështohen dhe sëmuren...

— Rroftë Daut Pashai! Rroftë!

— Tash e tutje ata që na dalin para do t'i hajë e zeza tokë...

— Rroftë Daut Pashai! Rroftë! — jehonte pallati.

Ai foli edhe fjalë të tjera, të cilat nga njëfarë turbullimi që m'u shfaq, nuk i mora vesh.

Dikur njëri nga ata që rrinte në gjunjë, u shkëput nga vendi dhe më vuri para një libër të gjelbër.

Ra një heshtje e jashtëzakonshme.

— Puthe, — më tha, — dhe betohu se do t'i shërbesh me mendje e me zemër Perandorisë.

Shikimi im sërish e gjeti atë që rrinte në fron. Nga qëndrimi i tij kuptova se duhej të bëja siç më tha ai që më rrinte para me librin në duar.

Ç'domethënie kishte betimi në formë të puthjes, që duhej ta bëja para atij libri të gjelbër, i cili kishte përmbi ca vija lakadredhe, që fillonin nga e majta dhe ngatërroheshin në gjithë sipërfaqen e tij? Koka ime nuk ishte në gjendje të më jepte kurrfarë përgjigje ngase e ndjeva atë oshëtimën e zhurmshme, që ma bënte me dije se për mua shumë gjëra ishin të panjohura. Si i ngrirë e putha librin ndërsa ata që rrinin në gjunjë, u përkulën sa me kokë prekën qilimat shumëngjyrësh.

Mendja ma thoshte se pas asaj puthjeje do të prehesha i qetë, por ai që rrinte në fron sërish zuri të fliste. Bënte me dorë nga perëndimi dhe ata që më rrinin para në gjunjë, preknin qilimat me kokë. Nga përkulje të tilla po më merreshin mendët. Njëfarë zjarmie po ma digjte gjoksin furishëm, sa desha të kërkoja ujë. Mbase do të klithja ujë, por nuk e di se nga më doli përpara një shpatë e artë. Shpata po më afrohej e po më afrohej sa mendja më shkoi se ajo po më kërkonte kokën. Çuditërisht vendosa ta shikoja pa u trembur nga akti i prerjes së kokës sime. Por shpata nuk eci më. U ndal diku midis meje e duarve të mia dhe pas pak, si të trembej nga shikimi im, më ra në duar.

— T'u praroftë! — tha ai që rrinte në fron.

— Amin! Amin — thanë të tjerët.

— Para saj u shkurtoftë armiku i Perandorisë!

— Amin! Amin!
— Nata t'u bëftë ditë, e dita shekull!
— Amin! Amin!

Amin-Amin u bë aq i fuqishëm, sa mbushi gjithë hapësirën e pallatit. Kokës sime po i kërcënohej një shungullimë e jashtëzakonshme që vinte nga të gjitha anët. Ajo nuk kishte të sosur...

Dikur rashë në purpurin e butë dhe ndolla harrimin. Dëshiroja të bëhesha pjesë e paqenësisë sime.

Kur u zgjova ndodhesha në fronin e praruar. Dy veta më rrinin pranë dhe më lexonin ca libra të trashë. Herë njeri e herë tjetri ata err e terr lexonin e lexonin e koka ime habitshëm i gëlltiste të gjitha. Libri i shenjtë është libër perandorak, më thoshte njeri... Ka një mijë vjet që ky libër shkruhet e shkruhet e kurrsesi s'plotësohet, më thoshte tjetri... Libri i shenjtë është i përkryer... «Toka e lashtë» është një vend i çuditshëm që tash sa shekuj e ndan botën në dy pjesë... Në të kalon kufiri i Lindjes dhe i Perëndimit... Perandoritë e mëdha pareshtur u ndeshën në atë hapësirë të ngushtë dhe ia hëngrën kokën njëra-tjetrës... Çdo pëllëmbë e saj është e larë me gjak, e megjithatë ai mbeti se mbeti asnjanjës... Ngjau kështu, ngase atje është një shejtni, së cilës i falen më shumë se besimeve të ardhura dhe shkrimeve të ndryshme që e zëvendësojnë njëri-tjetrin pa pra... Ajo shenjtni duhet të shkatërrohet njëherë e mirë... Nuk bën të lejohet që ajo të përsëritet, siç u përsërit shumë herë, në ndonjë kështjellë, në ndonjë burim... Lufta kundër asaj shejtnie është luftë e gjithanshme... Kush e mund atë shejtni do ta ketë për vete nyjën e botës, e nyjën e botës mund ta ketë vetëm perandori dhe asesi shumë sosh... Lufta e shenjtë... Lufta e shenjtë... Bota pastrohet nga mundimet mijëravjeçare... Bota pastrohet...

Më vonë zura t'i lexoja vetë librat e trashë. Vihesha mbi to dhe si i uritur që mbledh secilën thërrime nuk lija gjë pa e futur në kokë. Kështu zbrazëtinë që e kisha, jo vetëm se e plotësova, por zura t'i lidhja mendimet e mia të pavarura. Mbase asnjëherë nuk do të largohesha nga leximi po të mos më thoshin se më thërriste Lartmadhëria.

Kur dola jashtë dielli m'i dogji sytë. Sa kohë, vallë, paskam qenë i shkëputur nga të tjerët, e pyeta veten? Por, përgjigje nuk mora. Pastaj ecа drejt Pallatit të Praruar, kubeja e të cilit m'u bë se nuk shkëlqente si atë ditë kur e pashë për herë të parë sapo zbrita nga karroca. Kalova nëpër të njëjtin kalldrëm pashë të njëjtat roje që më përkuleshin dhe ngjita të njëjtat shkallë që më nxorën në hyrjen e madhe të Pallatit. Aty u ndala pak dhe ktheva shikimin pas. Nuk e di as vetë se çfarë më shtyri që ta bëja këtë, por hetova se nga ajo pikë bota dukej si e frikësuar dhe e rrasur thellë në vetvete. A thua madhështia e Pallatit e bënte të tillë?

Koridoreve të mëdha të Pallatit nuk nxitova si dikur. Ecja ngadalë dhe i kapja me sy shikimet e ushtarakëve që uleshin përdhe sapo u afrohesha. Kur dola para fronit të praruar nuk ngurrova e as që ndjeva shqetësim. Përkundrazi, më bëhej se atë pjesë dhe atë vend e njihja pëllëmbë për pëllëmbë. Mbase qëndrimi im i tillë bëri që Lartmadhëria të ngrihet nga froni i praruar dhe të më merrte ngryk ende pa iu afruar mirë shkallores së madhe në të cilën nuk shkelte njeri pos këmbës së tij.

Shikimet tona sërish u ndeshën miqësisht. Më uli pranë dhe dha shenjë me dorë që të niste ahengu. Ishte një aheng i madh, të parin që kisha parë. Nisi me valltare e përfundoi me gjithfarë palaçosh. Lartmadhëria herë pas here më shikonte butësisht dhe më thoshte ca fjalë që nga çallgitë nuk i kuptoja. Kur mbetëm vetëm dhe Pallati i Praruar prapë dukej ai që ishte, më tha:

— Ka kohë që po merresh me libra. Si e sheh të ardhmen e Perandorisë sonë?

Dhe unë, pa një pa dy, prita e thashë:

— Dielli ynë do ta nxejë botën. Rrezet e tij do të shkëlqejnë në veri, në jug, në lindje dhe në perëndim. Së pari ato do të nxejnë në veri e menjëherë në jug, e pastaj në lindje e në perëndim. Kur të bëhet kjo, e për t'u bërë do të bëhet patjetër, rruzulli tokësor do të jetë i lumtur, sepse do të flitet kudo e njëjta gjuhë, do të këndohet kudo e njëjta këngë dhe do të mësohet kudo i njëjti libër — libri i shenjtë i Perandorisë.

Për t'u bërë kjo, njëherë e mirë, duhet t'u shpallim luftë deri në vdekje të gjitha gjuhëve, pos asaj perandorakes; të gjitha mendimeve, pos atij të Perandorisë... E mbi të gjitha t'i shpallim luftë asaj që krijoi e djeshmja dhe e pardjeshmja... Dielli ynë duhet t'i djegë pamëshirshëm fosilët e padobishme. në mënyrë që kujtesa e secilit njëherë e mirë të lirohet nga ato që mund ta ngacmojnë. Në vend të atyre fosileve të padobishme e të rrezikshme për shëndetin e Perandorisë. duhet të ketë të sotme të pjesërishme, pra kalimtare dhe të nesërme të lavdishme, e cila duhet të jetë e shkëqyeshme, me lule dafine, me rreze të praruara dhe e pakufishme... Në vend të shumë shkrimeve, duhet të ketë vetëm një shkrim — ai perandorak; në vend të shumë librave të çoroditura që mund të helmojnë duhet të lexohet një i vetëm — libri i shenjtë i Perandorisë... E gjithë kjo duhet të bëhet për të mirën e Perandorisë dhe të shtetasve të saj. Barra na bie që t'ia nisim sa nuk është vonë, të bëjmë atë që duhet bërë në mënyrë që historia të nisë dhe të sosë me ne. Për këtë madhështi nuk duhet të kursehet asgjë...

— Të lumtë goja, — më tha Lartmadhëria dhe ma shtrëngoi dorën butësisht.

Mbeta si i shtangur. Ato që thashë m'u bë që i tha dikush tjetër që ishte strukur tek unë, e të cilin për herë të parë po e njihja.

Ai më përgëzoi prapë dhe më pyeti se prej nga i kish ato mësime aq të mira.

— Nga librat e shenjtë, — ia ktheva. — Ata janë plot e përplot mendime të tilla.

— Ti i lidhe. u dhe jetë, — ma ktheu ai. — Pa këtë ato do të mbeteshin të shkëputura e të heshtura.

I rrudha krahët dhe heshta. Hetova se më duhej paksa për të menduar që ta gjeja atë që duhej ta thoshe.

— Megjithatë. — zuri të fliste hamendshëm ai — ka kohë që e paramendojmë atë të diell të gjithdillshëm perandorak, por diçka e çuditshme po na heq në vend dhe nuk po na lë të ngrihemi mbi botën... Një e ligë na e ka zënë rrugën... Një e ligë...

Pashë se shikimi i butë i tij treti dhe vendin ia zuri një brengë e cila i niste në ballë dhe i lëshohej mollëzave të mufatura në drejtim të qafës plot rrudha.

— Toka e Lashtë, Toka e Lashtë na ka ngujuar... Ka kohë që mbetëm në të... Toka, ajo tokë e mallkuar...

Po fliste si i përçartë.

— Nuk di si të shkojmë më tutje? Nuk di?...

Për habi, koka ime, që gjithë kohës pranonte vetëm ato që i thuheshin nga jashtë dhe që i merrte nga librat që lexoja, për herë të parë, si të ishte rrokullisur në të diçka e jashtëzakonshme, zuri të krijonte mendimin e vet. Dhe. aty për aty më doli para një kështjellë e madhe, e rrethuar me shumë taborre. Pastaj m'u shfaq një mori kështjellarësh që mbroheshin dhe i shikonin me nënçmim rrethuesit si sorollateshin me gjithfarë armësh, të cilat s'ishin në gjendje t'i linin shenjë muranës së pathyeshme... Rrethuesit e dëshpërur bëjnë çmos për ta marrë Kështjellën, por mundi u shkon huq... Sorollatja e tyre nuk ka fund, siç nuk kanë fund as rrethimet e gjata të cilat fillojnë në të njëjtën mënyrë dhe përfundojnë në të njëjtën mënyrë... Përfytyrova flamujt e Perandorisë të grisur, të lagur nga shiu i vjeshtës, që dridheshin në duart e atyreve që i mbanin... Koka ime po krijonte një pamje tjetër nga ajo e mëparshmja: kështjella po shembej nga brenda. E hanin krimba të shumtë dhe ia rrënonin themelet, saqë ajo lëkundej dëshpërueshëm para se të shkatërrohej...

— Kështjella do të shembet, — thashë prajshëm.

Perandori luajti nga vendi. Fërkoi sytë, sikur dëshironte të më shihte më mirë dhe preku veshët, thuajse donte të dëgjonte prapë ato që thashë.

— Do të shembet? — më pyeti gjithë shqetësim.

— Do të shembet, — ia ktheva.

— Kështu flitej dikur, por koha nuk na dha të drejtë. Tash ajo po na rri mbi kokë dhe po na tall...

— Nuk do të tallë më askënd... Ajo do të shembet... Do të bëhet hi e pluhur...

— Kjo që thua po më pëlqen, por droj...

— E kuptoj drojën tuaj, por tash i erdhi fundi.

— Moti s'e kam dëgjuar këtë fjalë. Ka kohë që po e pres dhe sa më shumë e pres më bëhet se nuk do të thuhet kurrë. Në vend të saj marr habere që më rrëqethin, që janë përherë të njëjta dhe s'më bëhet t'i dëgjoj më.

— Gjësendët, — i thashë, janë si njerëzit. Një ditë shfaqen, por s'është e thënë që të mos zhduken kurrë. Vjen koha kur rrënohen...

Krahasim i bukur, por ngapak i shpërputhshëm. Përderisa njerëzit jetojnë gati njësoj dhe një ditë vdesin, gjësendët thuajse janë të amshueshëm. Kështjellat mbahen me qindra e qindra vjet. E kur këtyre u shtohen edhe meremetimet, atëherë duken si të ishin ndërtuar që të mos shemben kurrë...

Edhe kështjellat janë si njerëzit, madje bëjnë jetë njerëzish dhe ndajnë jetën e vdekjen me ta...

Ai po më shikonte sy e vesh dhe priste t'i flisja edhe më për vdekjen e kështjellave.

— Kështjella, — vazhdova, — për mua është vetë njeriu. Njeriu e bën kështjellën e jo kështjella njeriun.

— Për atë njeri, apo për atë grusht njerëzish, ne nuk do ta çanim kokën kurrë. Do t'i mbërthenim për bjeshkët e tyre me një tundje dore dhe do të talleshim me ta. Si të tillë ata nuk paraqesin kurrfarë force. Por, telashet i kemi me kështjellën. Ajo na ka zënë rrugën. Ç'djall e bëri aq të qëndrueshme?

— Njerëzit, njerëzit e saj... Duhet të ndërrojmë bindjen se ne po luftojmë me gurët. Ne po luftojmë me njerëzit. Sado që ata janë pak e ne mijëra herë më shumë, duhet të bindemi se i kemi kryqëzuar armët me ata e jo me kështjellën... Mbase këtu qëndron çelësi i disfatave tona. Prore bëhen plane si të luftohet me kështjellën e jo me njerëzit. Nënçmimi na solli në këtë gjendje...

— Po të ishe për atë grusht njerëzish, moti do të harrohej ajo tokë e mallkuar. Nuk më bind dot se ne atje bëjmë luftën si çdo luftë tjetër. Atje jemi kyçur pse luftojmë me një kështjellë muret e çuditshme të së cilës nuk po mundemi t'i kalojmë. Duhet ta shpikim një top ndër më të mëdhenjtë në botë për ta bërë shkrumb e hi atë muranë. E sa

për njerëzit e saj do të shohësh sesi do të futen birucave pastaj...

— Edhe deri më tash u shkrinë topa të tmerrshëm. Gjylet e tyre, me sa di, nuk i kursyen muret e kështjellës. Vende-vende u dëmtuan, por kështjella s'u dha që s'u dha...

— Ah, po ta kishim atë top! Vetëm atë top kërkoj. Merr mjeshtrat më të zgjuar dhe shkrije para turinjve të tyre që të shohin se çfarë po i pret.

— Këtë herë nuk do të ketë as topa as vërsulje të kota. Ato na dolën për hundësh. Do t'ia bëj ndryshe...

— Si? Si? — brofi nga vendi. — Më thuaj se plasa!

— Nuk do të luftojmë siç luftuam deri më tash...

— Se mos do të bëjmë sehir dhe të presim që të dorëzohen vetë?

— Pikërisht këtë kërkoj.

— Andrralla! Andrralla! Ata nuk dorëzohen kurrë...

— Do të dorëzohen, do të dorëzohen...

— Me lutje?

— Jo.

— Si atëherë?

— Nga etja...

— Nga etja?

— Nga etja. Do t'ua shterr ujin. Këtë do ta bëj duke ua gjetur burimet e fshehta.

Perandori një copë herë preku kokën e pastaj foli e tha:

— E harrove shiun? Aty bie shi si me shtambë.

— Bie dy muaj, por dhjetë të tjerë nuk bie. Vera atje është përcëlluese. Bën vapë e madhe sa edhe guri të pëlcasë. Puset e tyre thahen shpejt. Nuk e kanë të gjatë ujin. Duhet të ketë burime të fshehura që vijnë nga jashtë. Këto duhen gjetur për t'i prerë menjëherë.

— Nuk ma thotë mendja se kështu do t'i mundim... Nuk më bëhet të besoj...

— E qartë, i thashë. — Disfatat e shumta ta kanë humbur besimin, por ndodhi kështu pse çdo gjë u synua të arrihej me forcë. E forca nganjëherë, sado e madhe të je-

të, nuk mund të futet kudo, sepse bie ndesh me vetveten, pra pengon vetveten. Aty ku forca mund ta pengojë vetveten, nevojitet dredhia. Luftërat bëhen edhe me dredhi e sukseset janë edhe më të mëdha...

Pastaj i fola edhe për furnizimet. I thashë se, përkundër rrethit të fortë që i është vënë kështjellës, kujt nuk i ka shkuar ndërmend të shtrojë pyetjen se me çka e mbajnë shpirtin ata njerëz? Gjithsesi jo vetëm me ajër dhe me ujë, — i thashë. — Kështjella nuk është kështjellë po nuk e pati një kalim të fshehtë që lidhet me botën e nëpër të cilën hyjnë e dalin mallra të ndryshëm.

— Ne ua kemi shkatërruar të lashtat fare, tha Perandori. — Kemi bërë çmos që vendi të shkretohet, që as sorra të mos ketë çka të hajë e lëre më njeriu. A nuk mjaftoi kjo?

— Është e vërtetë se ka kohë që në ato anë nuk mbin e as nuk rritet gjë. Por kjo nuk mjafton. Njeriu e mban shpirtin disi dhe për ta mbajtur nuk zgjedh mënyrë. Tekefundit, bota është e hapët dhe shumë djallëzore...

— E qartë, e qartë, foli ai mendueshëm. — Është dashur ta vrasim mendjen edhe për këtë. Por, po s'ua gjetëm damarët e ujit dhe rrugët e fshehta të furnizimeve? A do të thotë se duhet të hiqet dorë përgjithmonë nga ajo Kështjellë? Vetëm këtë mos ma thuaj se nuk e duroj dot...

— Ajo që është, gjendet. Unë do t'i gjej edhe damarët edhe kalimet. Do t'i gjej jo më larg se gjatë fushatës së parë dhe me këtë merr fund historia e kokëfortësisë së tyre. Më vonë na hapet rruga për në Perëndim... Perandoria nuk do të ketë të ndalur.

Dhe prapë fola gjatë dhe m'u bë se ato që i thosha, i thoshte dikush tjetër që ishte futur çuditërisht tek unë dhe përcaktonte rrjedhën e mendimeve të mia.

Ndaj mesditës Perandori urdhëroi të fillonte ahengu. Shpalli gazmend të përgjithshëm triditor dhe ndau ndihma të parapara dhe fali nishane. I madh e i vogël parandjenin se do të ndodhte diçka e jashtëzakonshme.

Ditën e katërt thirri këshillin e luftës dhe u tha se vihesha në krye të tij me kompetenca të jashtëzakonshme.

Kur po hanim drekë më tha:

— Ajo puna e ujit nuk po më hiqet nga koka... Po më duket si cikërrimë...

— Jeni marrë me gjëra të mëdha dhe nuk ua keni vënë veshin cikërrimave. Por luftën e bëjnë edhe cikërrimat.

— Pastaj, — foli ai gjithë mundim, rreth ujit mund të na dalë edhe një telash.

— Ç'telash është ai?

— Ka të ngjarë që atje ujin nuk e marrin vetëm si ujë.

Desha t'i thosha se nuk po e kuptoja se ku po e qitte ashtu, por heshta. Ula kokën dhe ai e mori vesh se kërkoja sqarime të tjera. Pas pak tha:

— Thuhet se ujit i besojnë aq shumë, saqë e kanë shndërruar në shenjtëri...

— Aq më mirë për ne, e aq më keq për ta, — i thashë. — Shterja e ujit do t'i bindë se besimin e kanë pasur të kotë.

— Dikush një herë më pati thënë se atje uji rrodhi nga flijimi, nga flijimi i një gruaje që na qenkësh muruar mu në themelet e Kështjellës. Pra, ka të ngjarë se po t'i besohet kësaj legjende, ai farë burimi i ujit i ka rrënjët mu në zemrën e Kështjellës së tyre. Ne kot do ta kërkojmë përreth saj për ta prerë.

— Gjepura, — thashë, — përralla të tilla duhet të marrin fund një herë e mirë. Zatën, pikërisht përralla të tilla bënë që ushtria jonë të sorollatej si e pakotë rreth Kështjellës. Ne me armë e ata me besim... Është dashur që këtë ta kuptonim më kohë dhe të luftonim kundër besimit të tyre. Ne bëmë të kundërtën: luftuam dhe duke luftuar, edhe pse u sollëm telashe, prapëseprapë i ndihmuam besimit të tyre të forcohej. U ndihmuam të na tallnin dhe të na nënçmonin... Kur ta gjejmë damarin e ujit do ta këpusim dhe saora flashken gjepurat e tyre. Pa atë ujë legjendat dhe baladat e tyre thahen një nga një dhe bien përtokë. Uji është lëngu që u jep jetë. Atë lëng do t'ua presim në mënyrë që ata të mbesin shpejt pa besimin që kishin. Dhe ata që nuk kanë më kujt t'i besojnë janë si gjethet e vyshkura që i merr era dhe luan me to. Të tillë do

t'i shohim ne ata, të shthurur dhe të shkapërderdhur në shumë pjesë. Ata nuk do ta marrin më veten... Kur t'i mundim, e për t'i mundur do t'i mundim patjetër, krahas shembjes së miteve të tyre, legjendave dhe baladave me të cilat gjithnjë janë krenuar dhe krekosur se kanë themele të forta mijavjeçare, duhet ta krijojmë besimin e ri, besimin tonë, besimin perandorak. E këtë do ta bëjmë me anën e legjendave dhe të baladave tona, të cilat vihen në shërbim të së nesërmes sonë ngadhënjimtare. Legjenda jonë nuk do të ketë variante harbute, siç kanë ato të tyret tash, por do të jetë një legjendë e madhe perandorake, që do ta mahnisë botën...

Lartmadhëria mbeti një copë herë si i ngrirë nga ato që ia thashë. Kruante vetullat e trasha dhe thyente gishtërinjtë parreshtur. Mbase fjalët e mija po ia shembnin me themel mosbesimin e ngulitur nga disfatat e shumta që lidheshin me atë Kështjellë dhe atë vend që i thonin Tokë e Lashtë?

— Të priftë e mbara! — më tha pas një hamendje që ia shprehte gjithë trupi. — Merr çfarë të duhet, por ktheu faqebardhë!

Dhe, prej atij çasti, or Flamurtar, iu dhashë punës për nënshtrimin e Kështjellës. I bëra të gjitha përgatitjet e duhura dhe u nisa në drejtim të Tokës së Lashtë. Kur po më përcillte, Perandori më tha se duhej të kisha kujdes, ngase kisha të bëja me një vend të nemur. «Atje lamë shumë nga ato forca me të cilat patëm menduar se do t'i binim botës në fund për pak kohë...». Kur i lamë fushat dhe iu qepëm grykave të maleve, nuk e di pse më mbërtheu njëfarë shtrëngimi. Koka shpejt m'u mbush me relieve, që herë hapeshin e herë ngushtoheshin frikshëm. Më bëhej se bjeshkët e thepisura do të shembeshin mbi mua. Shpjeguesi i ëndrrave, që s'më hiqej duke u marrë me shenjat e gjumit tim të shthurur, më tha se deri te Kështjella duhej të kalonim dyzet e dy gryka, shtatë lumenj, njëmbëdhjetë qafa malesh dhe dy këneta që nuk thahen kurrë. Të gjitha këto duhet t'i kalojmë medoemos, më tha ai dhe shtoi se për të mirën time ishte që të flija ditën e të rrija

i zgjuar natën. Këtij ogursuzllëku mund t'i bësh ballë vetëm po qe se e ndërron ditën me natë. Në të kundërtën ligështohesh pa masë. Ditën do ta bëj ditë e natën do ta bëj natë, i thashë shpjeguesit të ëndrrave. Dua t'i mund unë, e jo të më mundin ata...

Kur ia thashë këto, pashë fytyrën e plakut si u ngrys vetëtimthi. Mori një pamje të përgjumur. Ishte e qartë se ato që ia thashë iu dukën pjesë e ëndrrave me të cilat merrej pareshtur. I gjori, duke përcjellë në të njëjtën rrugë dhe në të njëjtat rrethime titullarë të lartë dhe ushtarakë të cilët në nismë krekoseshin, qe mësuar t'i shoqëronte ata që ktheheshin të mundur nga fushata të tilla. Prandaj, fjalët e mëdha, që thuheshin me të filluar rrethimet, i dukeshin të rënda e madje të kobshme. Kur po zbrisnim grykës së trembëdhjetë, më tha gjithë dëshpërim:

— Kjo është hera e pesëmbëdhjetë që bëj të njëjtën rrugë. Dhashtë i madhi të jetë e fundit. Eshtrat e mia të plakura janë fanosur nga lodhja dhe klima e ashpër e këtyre maleve. Për mua tashmë ekzistojnë dy stinë: pranvera e nisjes dhe vjeshta e kthimit. Koha midis këtyre të dyjave është e tmerrshme, e tmerrshme sa s'bëhet më. Ajo përmbushet nga rënkimet dhe mallkimet e atyre që humbin dhe dinë se çfarë i pret. Më dhembsen, por unë nuk mund t'u ndihmoj më tepër se t'i ngushëlloj, duke u thënë se nuk qenë të parët e as të fundit që e pësuan ashtu. Kjo përsëritje e pareshtur droj se do të më përcjellë edhe në atë botë. Pse vallë i madhi më dënoi që gjithnjë të shoh të njëjtat gjëra? Pse unë qatipi i vogël duhet t'u rri karshi halleve të mëdha të Perandorisë në atë mënyrë që ta kuptoj gjithë rënkimin e saj? A nuk është shumë kjo për një njeri të vockël?

Plaku zuri sytë me duar dhe më bëhej se qante. Më erdhi keq për të dhe më shkoi mendja ta ngushëlloja disi. Ia thashë ca fjalë nga libri i shenjtë perandorak. Por hetova se dëshpërimi i tij nuk kishte fund, se kishte nevojë t'i thoshte ato që po e mundonin, se në atë mënyrë ndoshta lirohej paksa nga mëllëri që bartte me vete...

— Si të mos dëshpërohem kur shoh se shumë prej tyre

shqetësohen aq sa vijnë me ngut dhe më thonë: njëfarë përftimi më është qepur keqas... Hiqma se më shkallmoi... Po shoh zogj të zez... Po shoh ujë të turbullt... Po shoh merimanga sa bjeshka... Po shoh akullnaja... Dhe unë i gjori duhet t'i ndjek çapitjet e tyre deri sa të çmenden. E ç'është më keq, duhet t'i shënoj të gjitha një nga një. Pallati i ëndrrave i kërkon të gjitha, të gjitha, sidomos ndryshimet që shfaqen nga rrethimi në rrethim... Duke u marrë, me ëndrrat dhe përftimet që u shfaqen ushtarakëve tanë, e të cilat i njoh mirë e mirë, prore e takoj një kundërshtar të jashtëzakonshëm, i cili kundër nesh lufton me gjithfarë shpirtrash. Në atë vend të nëmur neve na kundërvihet ushtria e shpirtrave të tyre e jo kështjellarët, siç thonë. Na presin sapo ta kalojmë grykën e fundit dhe na sulen tmerrësisht për të na shkallmuar. Sa herë shoh se si taborret tona vendosen para Kështjellës dhe xhenierët fillojnë t'i shkrijnë topat dhe bëjnë gati armët e shumta shkatërrimtare, unë e di se ushtria e shpirtërave të tyre është në veprim. Ajo bën punën e vet, duke sulmuar ëndrrat dhe qetësinë tonë. Mendja ma thotë se ne po bëjmë një luftë të pakuptimtë dhe të kotë, e herë-herë të pabarabartë me ta. Sepse ne dalim për ledinë e u sulemi me topa dhe me ushtri që nxin tokën deri në liqen, e ata na e kthejnë në mënyrë tinzare me ushtrinë e shpirtrave, të cilën e rrjeshtojnë në të gjitha anët dhe na i sulmon ëndrrat tona. A nuk është kjo një luftë e paluftë? A nuk është koha të mendojmë edhe ne ndryshe për luftën që bëjmë dhe atë që duhet të bëjmë? Një ditë i thashë drejtuesit të Pallatit të ëndrrave se jemi futur në një luftë marrashe dhe marrashë do të mbesim në të përderisa ta kuptojmë se ai me të cilin luftojmë ka zgjedhur mënyra të tjera që të luftojë kundër nesh. Si të mendojmë ndryshe, si, më tha ai gjithë shqetësim, pa më thuaj? Unë i thashë se edhe ne duhet të bëjmë luftë shpirtrash. I krisur, ma ktheu ai, a e di se për fjalë të tilla të shkon koka? E di, i thashë, por di diçka që ju të tjerët ose nuk dëshironi ta dini, ose shtireni të tillë, ngase nuk keni guxim ta kuptoni të vërtetën. Të pranosh se ata na sulen me shpirtra, më tha ai, është një-

soj si ta pranosh mendimin se ata janë të pathyeshëm dhe të devotshëm. Libri ynë i shenjtë perandorak nuk e pranon një mendim të tillë. Ai thotë qartë se Perandorisë s'ka kush ia qet dorën para. Forca e saj është e jashtëzakonshme. .. E qartë, e qartë, i thashë, por këtu kemi të bëjmë me shpirtra që i lindi flijimi. Mbase ata shpirtra i mobilizon instikti i rrezikut, që e parandjejnë që larg, prandaj hidhen me aq ashpërsi kundër nesh... Çfarë thua ti, pra, më pyeti ai me zë të çjerrë dhe i frikësuar që të mos e dëgjojë njeri. Shpirti shkatërrohet me shpirt... Ata me shpirtra e ne me shpirtra... Ndryshe nuk bën...

Më nuk e takova drejtuesin e Pallatit të ëndrrave. Kishte frikë të fliste me mua. Por pas asaj bisede që pata me të, edhe tash unë mendoj njësoj. Them se qenia e tyre është kthyer qëllimisht në një ëndërr të pafund që hiqet zvarrë mbi kokat tona si gjarpri i zi, i cili tmerron. Ma thotë mendja se ai gjarpër të sulmon edhe ty siç i ka sulmuar të tjerët...

Kur i thashë se nuk shihja ëndrra, se koka ime i kishte përjashtuar me kohë përfytyrimet, mend plasi.

— Mos u tall me mua për perëndi, — foli gjithë hutim. — Mos. Ky është rrethimi im i fundit dhe uroj që tutje të prehem në qetësi në ndonjë vend të nxehtë për të ngrohur eshtrat e shkallmuara.

Desha t'ia sqaroja se ç'ishin ëndërrat dhe ndërlidhje e tyre me të sotmen dhe të nesërmen, por hoqa dorë, sepse ai do të shqetësohej edhe më.

— Mos më merr në qafë! Pse të më shkojë koka në pleqëri. Do të tallen me mua kur t'u them se paska edhe të tillë që nuk ëndërrojnë fare... A e dini se kështu po i shpallni luftë Pallatit të ëndrrave?

Një ditë prej ditësh e arritëm Kështjellën. Lajmëtarët bënin me dorë andej nga perëndonte dielli. Syri ma kapi një muranë që shkëputej nga bjeshka e thepisur. Nga ajo largësi më bëhej se Kështjella i kishte themelet në liqen. Shpjeguesi i ëndrrave kishte mbërthyer fytyrën imcake me të dyja duart.

— Nuk ma shohin dot sytë, nuk ma shohin dot sytë, — pëshpëriste plaku.

Më shpëtoi një buzëqeshje e lehtë. Plaku e hetoi këtë dhe tha:

— Edhe unë desha ta tall kështu kur e pashë për herë të parë po nga kjo largësi. Por, tash ajo më përqesh mua dhe gjithë Perandorinë.

— Kush qesh i fundit, qesh më ëmbël, — i thashë.

— Një jetë e tërë me rrethime. Bobo, sa shumë rrethime të gjata, sa shumë dëshpërime... Sa do të zgjasë, kjo, vallë?

Plaku fliste dhe dridhej. Për ta ngushëlluar i thashë:

— Ky do të jetë rrethimi i fundit. Nuk do të ketë më rrethime, nuk do të ketë as tallje e as disfata. Do të shkojmë më tutje, e ti do të prehesh në qetësinë që e meriton. E di se të ka molisur kjo rrugë e gjatë dhe gjithë ato luftëra të pafund, por dije se edhe atyre po u vjen fundi...

— Dashtë zoti! Dashtë zoti!

Më në fund u ndesha ballë për ballë me Kështjellën. Më kujtohet mirë kuqërremi që m'i ngacmoi sytë. Midis meje e kuqërremit gjendej murana e madhe e gurit të rrënuar por krenare. Në një pirg të lartë pashë flamurin me zog të zi në mes. Prapa meje gjendej moria e ushtrisë e mbarsur me urrejtje të madhe, që priste urdhrin për sulm. Atë çast më shkëndijoi në kokë ajo që ma tha shpjeguesi i ëndrrave për shpirtrat e panumërt që bëhen gati t'u sulen ëndrrave tona. Kështjella m'u duk si një zog përrallor që pret terrin të sulmojë gjumin tonë... Zogu i zi, mendova, do të ngrihet fuqishëm mbi taborret tona për të frikësuar të madh e të vogël. M'u bë se që atë çast filloi lufta ime me zogun e zi...

Atë natë nuk futa gjumë në sy. Vallë, ai shpirt, për të cilin më foli Plaku, po më kërcënohej? M'u bë se dikush nga jashtë po më thoshte: ta shohim pra si do të luftosh?

Kur doli agimi (ishte një ditë me diell të ndritshëm) komandantëve që po pritnin urdhërin tim për të nisur sulmin, u thashë qetë:

— Nuk do të sulmojmë.

Shikimet e tyre u derdhën mbi mua.

— Nuk do të sulmojmë, — u thashë edhe për të dytën herë. — Ushtria të rreshtohet para Kështjellës me armë në dorë dhe le të shikojë pirgjet e tyre. Kush mos ta kruajë as kokën pa dijeninë time. Tekefundit edhe të bësh sehir sot është pjesë e luftës.

Kur ushtria zuri pozicionet dhe flamujt e luftës i lëkundte era e lehët që vinte nga ana e liqenit, me shpjeguesin e ëndrrave iu sollëm Kështjellës.

— Kurrë nuk ia nisin të parët, foli Plaku. — Edhe kur komandantët tanë afrohen rrëzë mureve, ata nuk qëllojnë. Pse vallë nuk qëllojnë të parët? Shpesh herë e kam vrarë mendjen me këtë vendim. Mbase kjo lidhet me njëfarë besimi të tyre se kurrë nuk duhet qëlluar i pari?

— Tinëzarët dhe frikacakët nuk qëllojnë të parët, — ia ktheva.

— Tinëzarë mund të jenë, por frikacakë jo. Po të ishin frikacakë, atëherë nuk do të luftonin me ne. Do të dorëzoheshin siç u dorëzuan shumë e shumë të tjerë, që u tmerruan sapo na panë...

Edhe ditën e dytë dhashë urdhër që ushtria të dilte para Kështjellës dhe të bënte sehir. Të njëjtin urdhër dhashë edhe ditën e tretë, edhe të katërtën e edhe të shtatën...

Komandantët që ishin mësuar me luftëra, pa marrë parasysh humbjet e shumta dhe sorollatjet e tyre të kota rreth mureve që s'i kalonin dot, më shikonin vëngër. Njëri, gjithë dëshpërim më tha: po mpihemi. Kur do të vijë çasti ynë? Patët shumë e shumë çaste të tilla, i thashë. Paaq shumë sa as vetë nuk e dini sa shumë sosh patët... Ai heshti. Heshtën edhe të tjerët që po e humbnin durimin. Me gjasë se durimin po e humbnin edhe kështjellarët, të cilët nuk ishin mësuar t'i shihnin ushtarët tanë të rreshtuar para Kështjellës duke i shikuar qetë pirgjet e larta. Ditën e parë nuk u dukën fare. Të dytën mbretëroi një heshtje e shurdhër midis nesh. Ditën e tretë pamë aty-këtu kokat e tyre nëpër përgjimtore dhe në pirgje. Një ditë më vonë i pamë pa mburoja. E të shtatën silleshin pa ar-

më. Mendja ma thoshte se qëndrimi ynë i shqetësonte më tepër se t'i sulmonin me gjithë ushtrinë që kishim dhe me topat e rëndë, të cilët nga prapavija dukeshin si të përgjumur. E kur në të katërmbëdhjetën urdhërova që në pjesën veriore të fillonin gropimet përgjatë murit jo më shumë se pesëmbëdhjetë hapa larg tij, nuk i pamë më kështjellarët. E dinin qëllimin tonë dhe nxitonin të ruanin çdo pikë të ujit para se të bëhej vonë.

Atë natë urdhërova të binin çallgitë. Kështjellarët dëshiroja t'ua bëja me dije se qëndresës së tyre po i vinte fundi.

Po atë mëngjes, kur ushtarët tanë dukeshin të lodhur nga ahengu i natës, aty ku gërmonim, ndeshëm qen të ngordhur. Dhashë urdhër që njëzet gërmuesit që u ndodhën aty të vriteshin menjëherë dhe të futeshin në një gropë të madhe rrëzë bjeshkës. M'u kujtua shpjeguesi i ëndrrave dhe fjalët e tij për mendjen e tyre që pjell gjithfarë marifetesh kur e ka pisk. Megjithatë, sado e rëndë që m'u duk masakra e ushtarëve të shkretë, puna e qenve të ngordhur më ngushëlloi disi, ngase ishte arma e tyre e fundit. Burimi në Kështjellë, për të cilin më pat folur Perandori, nuk ekzistonte. Po ta kishin atë, nuk do të shqetësoheshin gjithaq. E dija, pra, se ndodhesha pranë suksesit të parë. Koha e triumfit të kështjellarëve, ishte në të sosur...

Edhe të nesërmen gjetëm qen të ngordhur. Sërish dhashë urdhër të vriteshin gërmuesit që punuan atë ditë. Por se e liga e tyre nuk kishte marrë fund, e mora vesh edhe ditën e katërt, pra një ditë pa e gjetur damarin e ujit, kur pararojet tona zunë pesë-gjashtë që po bëheshin gati të futeshin në prapavijën tonë. Ata kishin përgatitur një dredhi të jashtëzakonshme, e cila dështoi falë syçeltësisë sime. Pra, me t'i zënë kështjellarët, të cilët e dija se ishin sëmurë qëllimisht që të përhapnin sëmundjet në taborret tona, kryeroja erdhi gjithë gëzim dhe më tha se i kishin në dorë ca robër, të cilët do të na hynin në punë për t'u argëtuar me ta. Mend plasa nga tërbimi por u përmbajta. Nuk i thashë se ai ishte një kurth i tmerrshëm që do të na kushtonte rëndë, por urdhërova që kështjellarët aty për

aty të nxirreshin buzë liqenit dhe të vriteshin. Kryesorja, që e dinte si veprohej me ata që ziheshin robër (rëndom nxirreshin në shesh të lidhur, i endnin kah tenda e kaltër dhe pas tri-katër ditësh argëtimi, vriteshin ngadalë), deshi të kundërshtonte. Moti nuk kemi pasur të tillë, më tha por ia preva me të shpejtë. Tash e tutje me kundërshtarët nuk do të tallemi.

Fati i kështjellarëve i gjeti edhe rojet tona që patën punë me ta. Dhashë urdhër që të nxirreshin jashtë tendave dhe të vriteshin afër Kështjellës. Hafijeve u thashë të hapnin fjalë se ushtarët tanë ranë në një pritë që e kishin vënë kështjellarët...

Të nesërmen, në mesditë, kryepunëtori më solli lajmin për gjetjen e damarit të ujit. Daullet e përcollën me të shpejtë lajmin që e pritnim kaherë. Po atë pasdite prita komandantët e të gjitha njësive dhe u thashë se njëra ndër fazat më të rëndësishme për nënshtrimin e Kështjellës mori fund. Ia dolëm, u thashë, në sajë të moralit të lartë ushtarak dhe të përpjekjeve të përbashkëta. Tash që i lamë pa ujë, nuk na duhet edhe shumë që ta kuptojnë se vetëmbyllja kokëfortë merr fund me disfatë...

Atë natë mendova gjatë për hyrje-daljet e fshehta në Kështjellë. Pa to as që do të qëndronte ajo. Kështjellat e këtij lloji mbështeten në hyrje-daljet e fshehta që pakkush i di. Me ujin e patëm më lehtë, sepse hapëm hendeqe të thella, por si t'i hetonim birucat që futen nën shkëmbin dhe dalin përtej bjeshkës? Ka të ngjarë që rrugët e fshehta nisin dhe sosin në liqen. Ah, thashë, vetëm në liqen jo, vetëm aty jo, sepse nuk do t'i gjenim kurrë. Toka mund të rrëmihet edhe deri në ka të zi, por uji jo. Uji është tinëzar, siç janë tinëzare veprimet e tyre. Jo rastësisht i besojnë ujit dhe e kanë kthyer në shejtëri, sepse jetën dhe vdekjen e kanë lidhur me të. Uji, uji, flisja si përcart dhe për habi rashë në një kllapi të thellë. Kur po gdhinte në atë gjendje ankthi m'u shfaq një zjarr. Ishte një zjarr që po e përthekonte nga dikah Kështjellën. Nga ai zjarr po iknin kafshët e egra. Hynin në muranë për t'u mbrojtur disi. Ah, thashë gjithë gëzim. E gjeta. E gjeta... Zjarri

mund të më ndihmojë dhe asgjë tjetër... Zjarri... Zjarri...

Ashtu i shtrirë thirra kryekomandantin.

Ai erdhi me ngut dhe sa s'më tha se dukesha i shkallmuar. Këtë e kuptova nga shikimi i tij shqetësues.

— Rreshtoje ushtrinë sa më parë! — i thashë.

— Peqej! — ma ktheu ai i bindur se po vinte çasti kur do të bëhej lufta me të cilën ata ishin mësuar.

— Kështjellën ta futni në një rreth të madh dy mijë hapa larg saj...

Komandanti prapë hapi sytë e mëdhenj që i dukeshin si të shqyer. Deshi të më pyeste diçka, por ia preva:

— Kur të rreshtosh ushtrinë si të thashë, ndizni zjarre të mëdha që të kallet në të gur e dru përreth Kështjellës. Kur zjarri të marrë hov e të pushtojë çdo gjë, kujdesuni që egërsirat të mos kalojnë pas jush, por të marrin ikën kah Kështjella. Përgjoni se nga futen dhe shenjoni mirë të gjitha shtigjet ku ato përbirohen.

Ushtaraku u bë gur. Nuk ia kishte marrë mendja se do të vinte koha kur ai bashkë me ushtrinë e tij të madhe do të merrej me punë të tilla. Megjithatë ai e dinte se fjala ime nuk bënte të bëhej dysh. Uli kokën dhe mezi tha se i kishte kuptuar ato që duhej t'i kuptonte.

Në mesditë tymi e gjeti edhe tendën time. Kur qita kokën jashtë pashë se flaka e kishte mbërthyer Kështjellën nga të gjitha anët. E tillë m'u bë se i gjasonte një krijese të trishtuar që s'e kishte të gjatë. Tymi i zi po e përpinte edhe flamurin e tyre me zog të zi, i cili rrinte i lodhur në pirgun e lartë.

Më vonë u ngjita në njërën nga shkalloret e përgjimit (që kishin ngritur ushtarët tanë për t'i përcjellë lëvizjet e egërsirave) dhe pashë se flaka që kishte filluar dy mijë hapa larg Kështjellës, po u afrohej mureve të saj.

— Së shpejti shfaqen egërsirat, — më tha njëri nga komandantët.

Dhe, njëmend, pas pak u dukën egërsirat e para. Në fillim qenë disa lepuj, që po i drejtoheshin Kështjellës, por po atë kohë, kur egërsirat kërkonin vrimat dhe të çarat shpëtimtare, nga Kështjella u hodhën shtizat e para. Bre-

shëria e tyre nuk kishte të ndalur. Egërsirat nuk kishin nga t'ia mbanin: nga prapa i ndiqte zjarri e nga para shtizat vdekjeprurëse. Së voni, kur numri i egërsirave u shtua, ata zunë të hedhin gurë, katran dhe gjëra të tjera. Vetëm atëherë e pata të qartë se çrrebeshe të hatashme u ranë përsipër ushtarëve perandorakë sa herë provuan ta merrnin Kështjellën...

Më në fund dolën edhe dhelprat. Vraponin shpejt dhe gjithë dinakëri. Por, asnjëra nuk ia doli t'i afrohej Kështjellës. Më vonë pashë edhe ujq, derra të egër madje dhe ca rosa çalamane që kërkonin me çdo kusht t'i iknin zjarrit. E mora me mend se flaka kishte përfshirë çdo pëllëmbë e i ishte afruar edhe kënetës. Kundërmimi i rëndë i mishit sa vinte e shtohej.

— Këso hataje nuk kam parë, — më tha Shpjeguesi i ëndrrave, duke mbajtur një shami të bardhë në gojë. — Kam parë vdekje të panumërta dhe gjithfare, por djegie të tillë jo.

— Edhe kjo është pjesë e luftës, — i thashë, duke shikuar një dhelpër e cila sillej në një gjysmë rrethi me një shtizë në qafë.

— Luftën e di tjetër për tjetër dhe jo të tillë, — ma ktheu Plaku duke u kollitur.

— Luftë nuk është vetëm kur vriten njerëzit, por edhe kur vriten egërsirat, kur kallen drithërat, kur shterret uji, e edhe, si the vetë njëherë — kur vriten ëndrrat...

— Mëkat, mëkat, — tha Plaku, kur gjithçka bëhet pjesë e luftës. Po vjen koha që luftë të quhet çdo gjë, madje edhe heshtja...

— Pikërisht të tillë e dua unë luftën.

Plaku kishte ulur kokën thuase dëshironte t'i përjashtonte nga shikimi gjithë ato për të cilat mendonte që s'i kishin hije luftës.

— Të gjorët, — bëra me dorë nga kështjellarët, — u morën si shumë me egërsirat e mëdha e i harruan të voglat. I harruan ato më të rëndësishmet që mund të na shpien deri te kalimi i fshehtë. Shihet se janë të hutuar së tepërmi.

— Si mund të shihen buklat nga ajo lartësi? — më tha?

— Lufta ka edhe bukla, ka edhe minj, ka edhe urithë, ka edhe skrranja. E fiton ai që i mbikëqyr të gjitha, të gjitha...

Plaku nuk foli më. Shamia ia kishte mbuluar fytyrën imcake, sa nuk ia shihja as sytë.

— Këtë pjesë ta përgjoni me vëmëndje të madhe dhe ta shenjoni, i thashë përcjellësit.

Një kohë të gjatë shikuam buklat dhe gjarpërinjtë si i afroheshin anës së rrëpishme dhe futeshin nëpër një të çarë të shkëmbit mu afër ujit. Fërshëllima e gjarpërinjve më vinte në kokë gjithë trishtim.

— Të ikim që këtej, për perëndinë, se plasa! — m'u ankua Plaku.

Qesha lehtë dhe shkuam nga ana tjetër e Kështjellës. Edhe aty dëgjuam fërshëllima gjarpërinjsh dhe pamë shumë egërsira që vërtiteshin afër mureve të Kështjellës. Kundërmimi i rëndë desh ma zuri frymën. Plaku më dha një shami dhe më tha:

— Të ikim prej kësaj skëterre sa nuk është vonë.

Sërish buzëqesha. Fytyra e tij m'u duk si një merimangë e madhe. M'u bë se ajo merimangë tash ziente nga shqetësimet e panumërta të shumë e shumë armatave, që u mbërthyen kotnasikoti në atë hapësirë të vogël, por të ngatërruar pa masë. Merimanga ishte plot ëndrra trishtuese, ankthe e gjithfarë përfytyrimesh, që ishin lidhur nyjë në secilën pjesë të saj. Po të hapej ajo merimangë, mendova, një pjesë e Perandorisë do të mbulohej me sëmundjen e disfatës së pashmangshme...

Te tendat Plaku foli e më tha:

— Kur do të ndalet ky zjarr i mallkuar?

— Sonte, — ia ktheva.

— Tash e kam të qartë këtë hata...

— Erdha të bëj luftë tjetërfare nga ato që i bënë ata para meje.

— U dashka të kallen medoemos bashkarisht njerëzit dhe egërsirat?

— Mbase po.

— Gjë makabre, — tha dhe fshiu sytë me shami.

— Megjithatë këtë luftë do ta fitojmë pa viktima. A nuk po të ngushëllon kjo?

— Kush e thotë?

— Unë. Unë, ngase e gjetëm kalimin e fshehtë të furnizimeve. E gjeta atë që më duhej. Ajo lidhje nëntokësore qe lidhja e tyre më e fortë me botën dhe bëri që t'u bëjnë ballë rrethimeve tona. Pa atë kalim nuk do të jenë ata që ishin dikur. Tash janë mbërthyer për muri dhe nesër a pasnesër do të na dorëzohen, ngase nuk kanë si t'ia bëjnë ndryshe. Ne do të presim dhe do të shohim si do të molisen nga dita në ditë...

— Mos do të thotë se lufta mori fund?

— Lufta e bezdisshme këtu mori fund. Çështje kohe është kur në atë pirg të lartë do të shohim flamurin tonë. Zogu i tyre i zi nuk do të na i vrasë më sytë.

Plaku murmuriti një copë herë. Fytyra imcake po i dukej e shqetësuar.

— Nuk ma thotë mendja se gjithçka mori fund... Nuk më bind njeri se këtejpari nuk do të ketë më luftë... Luftërat këtu kanë nisur mu atëherë kur dukej se janë në të sosur... Vend i çuditshëm është ky... S'bën dot pa një luftë apo pa ndonjë ngatërresë të madhe.

— Të kanë bezdisur rrethimet e fundit, — i thashë, — kështu që çdo gjë të duket si nyjë e lidhur që s'ka të zgjidhet. Mbase nuk ke faj?

— Shumë luftëra, shumë rrethime, shumë sorollatje, shumë vdekje tonat pashë...

— Tash e tutje nuk do të ketë vdekje tonat. Do të ketë vetëm një vdekje — vdekja e tyre. Do të jetë një vdekje kolektive që do t'i shpaguajë vdekjet tona dhe gjithë vdekjet e tjera që u bënë këtu.

— Ç'luftë është ajo kur vdes vetëm njëra palë? — foli Plaku me një zë të matur.

— Unë dua t'ia ndërroj kuptimin luftës. Për mua luftë mund të jetë edhe ajo që nuk bëhet sheshazi, pra në log të betejës, dhe fitore mund të jetë edhe ajo që fitohet me mjete joluftarake. Pra, plako, për mua luftë i thonë edhe asaj që

luftë nuk është, por kokat bien pa ia ndarë. Një luftë të tillë e dua unë...

— Tash m'i ngatërrove të gjitha.

— E qartë, e qartë. Nuk je mësuar me luftën që bëj unë. Ti ke parë luftëra të tjera, të njëjta, qoftë përnga sulmet, qoftë përnga disfatat. Ato i kanë ngjarë njëra-tjetrës sa ty të është bërë se po sillesh në një rreth të njëjtë ku gjithçka sillet njësoj. Tash do ta shohësh që një luftë për ty nuk është luftë, meqë nuk do të hidhen topa e as nuk do të bëhen sulme të furishme. Ushtria do të presë qetë-qetë në këtë anë, e ata në Kështjellë. Ne do ta shikojmë flamurin e tyre në pirgun e lartë duke u molisur nga thatësira, e ata do të përpiqen t'i bëjnë ballë etjes dhe mungesës së ushqimeve. Koha do të punojë për ne, e jo për ta. Të shkëputur nga bota, ata ose do të vdesin të gjithë një nga një, ose do të dorëzohen. Rrugë tjetër për ta nuk ka. Ç'është e vërteta, e kanë edhe një tjetër, që nuk ma merr mendja se e zgjidhin. Fjala është për të na sulmuar. Këtë do ta dëshiroja, ngase ushtarakët tanë do të argëtoheshin paksa me ta.

— E po qe se nuk e zgjedhin as njërën e as tjetrën?

— Kjo është e pamundur.

— Pse e pamundur?

— Sepse do t'u shterret uji. Do t'u sosen ushqimet. Sepse nuk mund të jetojnë vetëm prej ajrit dhe prej gurëve që i kanë me bollëk. Pa ujë e pa bukë nuk bën as lufta, as paqja.

— Por, do të bjerë shi. A po harron se këtu katër muaj bie shi. Pastaj, duhet ditur se mendja e tyre kur zihet ngushtë pjell gjithfarë mrekullirash.

Zura të qesh. M'u qep një e qeshur e fortë që nuk m'u hoq një copë herë.

— Kam parë edhe të tjerë që qeshnin po kështu. Kam parë shumë e shumë që krekoseshin kur niseshin dhe në fund vinin te unë të kërkonin ndihmë. Nuk do të dëshiroja që kjo të përsëritet. Një gjë nuk duhet harruar — se me rrethime janë mësuar. Thuajse janë rritur me to. Shekuj e shekuj jetojnë në këtë mënyrë dhe po të mos kishin jetuar kështu ne as që do të kishim telashe me ta. Kanë pasur

punë me shumë perandori e me po aqë ushtri të huaja. Jo rastësisht në këtë Kështjellë arriti kufiri i të dy botërave. Shpjegimi im për këtë është ky: ky kufi mbeti këtu, ku gjendemi edhe ne tash, dhe asesi të bëjmë ndonjë hap më tepër kah bota tjetër, ngase edhe Lindja e edhe Perëndimi, nuk bënë dot me të. Dhe kur nuk ia dolën, deshën s'deshën u pajtuan që Kështjella të mbetet asnjanëse, sepse vetëm si e tillë mbante atë baraspeshën e botës. Ne tash sa kohë dëshirojmë ta rrënojmë atë baraspeshë në mënyrë që të pushtojmë gjithë botën. Por a nuk e sheh sesi u kyçëm. Unë them se kjo Kështjellë doli këtu që të mbesë si nyjë e të dy botërave...

— Të gjitha këto i di, plak i mirë. Të gjitha i di. Kam lexuar aq shumë gjëra për këtë vend sa do ta zgjidh atë nyjë njëherë e përgjithmonë që të mos jetë më nyjë, as asgjë. Unë do t'u tregoj të gjithëve se puna e Kështjellës ishte një hiçgjë. Asnjanësia e saj, për të cilën flet ti, e ngjashëm flasin edhe të tjerë, është vetëm një mashtrim. Nuk ishte Kështjella ajo që dëshiroi të mbetet e tillë se ishte e fuqishme, por se këtë e dëshiruan perandoritë. Perandoritë u pajtuan që kjo hapësirë të mbetet asnjanëse e jo ata. Herë njëra e herë tjetra tërthorazi i kanë ndihmuar që të mos i jepej palës tjetër, ngase e kanë ditur se më vonë vjen ndeshja midis të mëdhenjve. Për t'i ikur kësaj, secili e ka ndihmuar kur e ka parë të udhës këtë gjë. Prandaj, prapa tyre dhe në emër të tyre është zhvilluar dueli i heshtur i të mëdhenjve, duel ky të cilin, si po shihet, tash duhet ta fitojmë ne, në mënyrë që të shkojmë më tutje...

— Ndoshta, ndoshta! — murmuriti plaku gjithë shqetësim dhe u nis nga tenda.

Kur po largohej më tha:

— Sonte patjetër ëndërro diçka...

Të nesërmen u zgjova herët. Bloza e zezë i kishte mbuluar tendat tona. Dukej se kishte rënë një push i zi, i cili u kishte dhënë ngjyrën e territ taborreve tona. Atë çast m'u bë se para kisha një terr të pafund, i cili niste te tendat dhe përfundonte tutje në Kështjellë dhe në male.

Një copë herë përgjova Kështjellën dhe sa më shumë që e shikoja, më humbte nga shikimi. Një çast m'u bë se fluturoi bashkë me zogun e zi që i rrinte në pirg.

Sapo ra dielli në liqen, urdhërova të fillonin gërmimet e thella. Ushtarakët sërish më shikuan vëngër. E dija se secili prej tyre heshtazi i thoshte vetes: Ç'luftë që bëjmë? U shndërruam në argatë. Ç'na duhen armët kur nuk kemi mundësi t'i përdorim fare?

Pasdite bashkë me Shpjeguesin e ëndërrave u ktheva te pjesa veriore, ku bëheshin gërmimet e para. Hendeku i gjatë m'u bë si një gjarpër që rrëshqiste ngadalë për ta mbërthyer gjithë Kështjellën. Dikush më kishte thënë se dikur e kishin pasur shenjtni gjarprin. E mbanin në shtëpi ngase mendonin se i ruante nga e keqja që mund t'u vinte nga jashtë. Tash ai gjarpër do t'i shtrëngojë derisa t'ua zërë frymën. Mbase kështu, mendova, heqin dorë nga besimi i moçëm? Në këtë mënyrë duhet t'u shembet çdo pjesë e besimit të tyre, në mënyrë që të mos kenë më ku të mbështeten. Dikur syri ma zuri zogun e zi në flamur. Nga tymi e bloza mezi dukej.

— Ai shpend, — i thashë Plakut, duke bërë me dorë kah pirgu i lartë, — sa s'ka rënë përdhe. Shpejt do të bjerë...

Ai heshti. Shikimi i tij nga lart ra poshtë, në istikamet prej të cilave lirohej një tis i hollë avulli. Mori një grusht dhe të lagësht dhe zuri ta shprishte me gishtërinjtë e thatë.

— I helmuar si shumë me gjakun tonë, — tha.

E shikova me dhembsuri. Ishte e kotë ta shtyje të mendonte ndryshe. Koha e kishte bërë të vetën dhe ai vështirë se do të lirohej nga ankthi i disfatave, me të cilat ishte mësuar gjatë e gjatë...

— Obobo, sa shumë gjak u derdh këndej! Sa shumë!... Pse, vallë, u desh të bëhej kështu?

— Nuk do të derdhet më, fola me mjaft ashpërsi. — Kush thotë se gjithnjë duhet të bëhet kështu?

Plaku la dheun dhe shikimin e derdhi në liqen, mu në atë pikë ku mjegulla e lehtë dukej se mbytej në ujë. Dikur tha:

— Sa do të jetë i gjatë ky hendek?

— Nuk dihet, i thashë. — Do të shkojmë nga përrocka e vogël për t'u kthyer te shkëmbi i lartë, mu nën muranë. Pastaj shohim. Tash për tash kjo është pika më e dyshimtë. Puna e gërmimeve do të na sjellë telashe të shumta. Do të kemi punë me nëntokën. Do të ndeshemi me terrin e tyre. Pale se ç'del prej tij?

— Sa po shoh, do të hapet ndonjë tunel?

— Gjithsesi. Do të futemi thellë e më thellë për t'i ndjekur kalimet e fshehta.

— E po qe se gërmuesit do të bredhin kot së koti nëpër tokë? Çfarë do të ndërmarrësh tjetër?

— Edhe bredhja është pjesë e luftës... Edhe sjelljet kotnasikoti i takojnë luftës... Edhe sorollatjet tona janë pjesë e saj.. E, pjesë e luftës janë edhe këto që po flasim unë e ti këtu...

Nuk foli më. Me gjasë, ato që thashë, i shqiptova me intonacion të tillë sa ai e mori si qortim që të mos mbyllte shtigje në të gjitha anët.

Te përroska anësore shumë gjarpërinj dhe bukla nxitonin kah një e çarë në pjesën e rrëpijshme të gurit. Në shkëmbin e madh syri më zuri shumë gjurmë gjaku. Nuk e di pse ato gjurmë gjaku ma tërhoqën vërejtjen. Po i shikoja dhe sa më shumë i shikoja më bëhej se egërsirat rrethoheshin dhe dëshironin të më thoshin diçka. Por nuk vonoi dhe një gjëmë që erdhi nga ana e djathtë më trishtoi.

— Na vranë! Na vranë! — po çirrej njëri që vinte me të shpejtë nga ne.

Shpjeguesi i ëndrrave më zuri për krahu dhe hetova gjithë peshën e trupit të tij mbi mua.

— Pse çirresh ashtu? — i thanë ushtarakët që më shoqëronin.

Ai u ndal pak dhe, pasi u përkul thellë, tha:

— Punët po na shkonin mirë, kur pa një pa dy, një breshëri shigjetash na u derdh përsipër. Aty për aty vdiq kryeinxhinieri me dy ndihmësit...

Nxituam te vendi i fatkeqësisë. Rojet që më shkonin para e prapa (për arsye sigurie) nuk më lanë ta shihja mirë gjithë atë që kishte ndodhur. Megjithatë pashë letrat e

tyre më plot vija lakadredhe që nga gjaku dukeshin të kuqe.

Në të kthyer Shpjeguesi i ëndrrave më tha gjithë ngashërim:

— Nuk ia ndjeva kot aromën gjakut tonë... Nuk ia ndjeva kot... E dija se do të ndodhte diçka e tillë... e dija... Ky dhe nuk bën pa gjak të njomë... Nuk i rrihet pa të...

Isha i tronditur për të gjetur ndonjë përgjigje që do ta qetësonte Plakun e shqetësuar së tepërmi.

— Është lehtë të bëhesh analitik zyrash dhe të vësh gjithfarë vijash nëpër letra e harta, — vazhdoi Plaku. — Raportet mund të shkruhen edhe pa qenë afër luftës. Ka kalemxhinj të mirë që gjërat i teleisin aq bukur sa ta merr mendja se rrota sillet me një të prekur. Por, është vështirë t'ia dalësh këtu. U mësova me gjithfarë premtimesh e fjalësh të mëdha... U mësova, po ashtu, edhe me rënkime e me disfata. Prandaj, biro, mos ma shih për të madhe pse shoh mjegullim... Mos ma shih për të madhe...

— Kështjellarët bënë një gabim fatal. Bënë një gabim që do t'u kushtojë me kokë. Ky është çmim tepër i vogël kur krahasohet me ato që do të fitojmë ne e do të humbin ata, — i thashë. — Duke i qëlluar inxhinierët tanë, ata pranuan se gjendemi mu aty ku dhemb, pra, fare afër vendit nga shkon kalimi i fshehtë. Po të mos vritnin patjetër se nuk do të na bënin me dije se kemi rënë në gjurmë të asaj që kërkojmë. Duket se e kanë humbur durimin kur bëjnë gabime të tilla.

Plaku po qante.

Po atë mbrëmje xhenierët i varrosën atje ku gjaku i tyre preku tokën. Urdhërova që bri varreve të ndizeshin shumë qirinj sa të ngrihej një flakë që të dukej nga larg. Flaka duhej t'ua kujtonte kobin e pashmangshëm që e kishin fare afër.

Kur po kthehesha nga varrimi pashë Shpjeguesin e ëndrrave që ecte si i thyer. Një tis i zi rreth syve ia bënte edhe më të mugët fytyrën. Më erdhi keq që po e shihja në atë gjendje. E zura për krahu dhe hamendesha sesi do ta ngushëlloja, më parë duke i folur për disfatat, apo për

ndonjë përfytyrim. I thashë se varre do të ketë, se do të ketë edhe vdekje, se do të derdhet ende gjak në të gjitha anët, se ai gjak nuk do të shkojë kotnasikoti...

Zuri të më shikonte pak më ngrohtësisht.

— Këto varre, që u hapën sonte, — vazhdova, — do të mbesin në kujtesën perandorake. Për to do të flitet aq shumë saqë do ta zvetnojnë legjendën e tyre të murimit. Kështjellarët e ardhshëm do të këndojnë dhe do të flasin për tri varret e të tre mjeshtërve që ia gjetën sëmundjen Kështjellës.. Do të thuret një legjendë e gjatë për sakrificën e pashembullt kundër zogut të zi, i cili ka kohë që rri lart dhe na nënçmon me qëndrim mospërfillës. Legjenda jonë perandorake nuk do të jetë si e tyrja, që mund të bëjë jetë vetëm midis këtyre shkrepave të egër. Përkundrazi, ajo do të përhapet në tri kontinente: nga veriu në jug e nga lindja në perëndim. Prej madhështisë së saj do të mahniten jo një grusht njerëzish, por i gjithë njerëzimi. Studiuesit e shumtë do të vërshojnë ditë e natë te këto varre për të parë vendin ku buruan ato. Anembanë Perandorisë pastaj do të flitet për këtë vend jo si tash, që na qet telashe, por si qendër të shenjtërisë perandorake. Toka e Lashtë nuk do të zihet ngoje si vend i një Kështjelle harbute, por si vend i martirëve tanë, që ranë për të mirën e botës së re. Këto varre do t'i ngremë lart e më lart për ta bërë sa më të madh rrënimin e tyre shpirtëror, i cili vjen pas çdo rrënimi fizik. Këngët dhe legjendat e tyre duhet të mundën nga legjendat tona, nga ato perandorake, të cilat duhet t'i krijojë mendja e organizuar mirë e jo çoroditja spontane. Po s'u bë kjo, ngjet që nesër e pasnesër rrënojat e tyre të ngrejnë krye kundër nesh me gjithfarë shpirtrash të mallkuar...

— Pra, — tha Plaku, — tash u binde se me ta duhet të bëjmë luftë shpirtrash?

— Po çfarë bëj unë? A kot po merrem me ujin? Kot po merrem me kalimet e fshehta? Po të mendoja ndryshe do t'i sulmoja siç bënë të tjerët pareshtur. Unë dëshiroj që ata ta humbin besimin në vetvete dhe po ngjau kjo (e për të ngjarë do të ngjasë patjetër), atëherë nuk duhet

pasur droje më nga ai shpirt për të cilin më fole pa pra si për një shenjtëri që përsëritet e rilindur pas çdo rrethimi...

Pastaj i fola gjatë për projektet që do t'i propozoja Perandorisë sapo të kthehesha në Kryesheher. I thashë se si do të dukej marshimi ynë drejt Perëndimit, e i fola edhe për të tjerat që do të bëjnë pjesë në luftën tonë. Kronikat tona të reja do të fillojnë nga kjo Kështjellë...

Plaku më dëgjoi me aso kureshtje sa m'u duk se, duke luajtur kokën poshtë-lart, i ngjante një qiriu që shkrihej.

— The se kronikat tona do të fillojnë nga varret dhe Kështjella? — më pyeti.

— Nuk bën të fillojnë gjekundi kur dihet se për çfarë nyje është fjala si dhe për sakrificat tona të mëdha që i dhamë tash për tash sa kohë.

— Obobo! Obobo!

Një copë herë foli kështu dhe u largua. Edhe pse shkoi, m'u duk se hija i mbeti në tendë dhe pse ajo hije dridhej si të kërkonte diçka...

Për habi, atë pjesë të natës Shpjeguesi i ëndrrave nuk m'u hoq nga përfytyrimi. Më bëhej se më pyeste për tri varret dhe legjendat e reja. Sa madhështi, sa madhështi është të hysh në legjendë thoshte... Sytë plot kureshtje befas i mjegulloheshin, por shpejt liroheshin nga tisi i errët. E atëherë prapë më pyeste. Më thoshte se a do të dukej gjithë nur vendi i varreve. Po, i thosha. Do të shndërrisë botën... E gjithë bota do ta shohë atë nur... A do të dalin përreth lule të kuqe? më thoshte. Do të reshin lule të kuqe. Si të mos jenë të kuqe kur aty ka vetëm gjak? E me shkretëtirat çfarë do të [illegible]. Larg, larg, prej këtu do të mbesin, i [illegible]. O zot, gëzohej, shkretëtirat mbajini larg, sa më [illegible] se më mjegullohen sytë prej tyre... Dikur m'u bë se Plaku meri krah dhe fluturoi... Humbi në një kaltëri të pafund...

Në mëngjes më thanë se Shpjeguesi i ëndrrave kishte vdekur.

— E gjetëm skaj varreve të reja. Një shtizë e hollë tejpërtej kishte çarë kraharorin e tij të thatë. Në duar mbante një qiri, i cili nuk ishte ftohur ende. Gjurmë të

tjera nuk pamë, pos një curili të hollë gjaku, që i kishte rrethuar tri varret dhe soste mu aty ku Plaku mbeti pa frymë.

Komandanti foli edhe diçka tjetër që nuk ia vura veshin dhe doli. E mua serish m'u shfaq Plaku. Si ta pritja, hyri lehtë-lehtë. Ishte veshur me të bardha. Mjekra e gjatë ia prekte tokën. «Dua të bëhem pjesë e legjendës... A nuk më takon mua ky nder? Kush u ndesh më shumë se unë me hallin e Perandorisë? Kush jetoi më shumë se unë me brengat e saj? A nuk e meritoj këtë?... Dëshiroj të prehem m'u aty ku pareshtur do të bien ndesh dy botërat... Mbase mund t'i ndihmoj Perandorisë sonë që ta shohë më mirë sëmundjen e vet... Mbi varrin tim do të dalin lule të zeza sa herë të bëhet gati ndonjë kob i papritur. Lulet e zeza do t'ju mbrojnë nga kobet e papritura... Mos lejo që është rat e mi të prehen gjetiu... Mos! Se, edhe pse thua se nuk ëndërron, të sulmoj bashkë me morinë e ëndrrave të Pallatit dhe vaj halli për ty...»

Jo nga kërcënimet e tij, por nga respekti urdhërova që Shpjeguesin e ëndrrave ta varrosnin te varret e reja. Gjatë rrugës deri në tendë më dukej se e kisha pranë dhe më flisnë me gjysmë zëri për vdekjet që do të vinin patjetër... Lufta mund të humbet pa viktima, por të fitohet pa to është e pamundur... Vdekjet nuk do të kenë të ndalur... Vdekjet... Vdekjet...

Dhe njëmend, nuk vonoi, e ne u ballafaquam edhe me shumë vdekje të tjera, që na shqetësuan. Shtatë ditë pas vdekjes së Shpjeguesit të ëndrrave ia behu komandanti dhe gjithë shqetësim më njoftoi se tuneli kishte zënë mbi dyqind veta, të cilët kishin mbetur nën tokë përgjithmonë.

— Hata! Hata! — po fliste ai përçart. — Vdekje më të tmerrshme nuk kam parë.

Kur dola jashtë hetova shikimin e ftohtë të ushtarakëve. M'u bë se një akullnajë e furishme më kishte mbërthyer të tërin dhe po më merrte me vete. Zura të dridhesha si thupra në ujë. E dija se për ata që ishin mësuar të vdisnin dosido duke sulmuar, një vdekje e tillë, pa marrë parasysh se ishte e mundimshme në ato rrethana, ishte nën-

çmuese. Ai mendim për herë të parë m'u sul furishëm dhe më kërcënoi të më mposhtte. Por, duke ecur, mblodha forcë që t'u ikja shikimeve të tyre. Rrugës po më hapej një tunel në kokë, i cili ishte gati të shembej nga të gjitha anët. Çuditërisht atë shembje e pritja dhe e dija se do të ndodhte patjetër, ngase ishte paga e domosdoshme që do t'ia paguaja triumfit përfundimtar mbi Kështjellën. E dija se Kështjellasit do ta shembnin dhenë mbi gërmuesit sapo ata të gjenin kalimin e vërtetë, por në të njëjtën kohë me ato vdekje tonat do të shkëputen nga bota dhe do të mbesin në mëshirën e pamëshirë. A nuk ishte ky çmim tepër i vogël për një fitore historike, të cilën Perandoria e priste me vjet të tëra?

Atë pasdite thirra komandantët dhe u thashë:

— Punën time e kreva... Viktimat që i bëmë nuk qenë të kota... Rruga drejt Perëndimit u hap...

Dhe, sapo ra terri, me sa përcjellës mora rrugën e Kryeshehrit. Zgjodha natën, se dëshiroja një gjumë të thellë e të gjatë sa vetë rruga. Por gjumi nuk më mori që nuk më mori. U përpoqa t'i jepesha plogështisë, po as ajo nuk më ndihmoi që t'i hiqja nga mendja gjërat e tepërta. Përkundrazi, sa më shumë kalonte koha (edhe pse më bëhej se kisha sharruar në një kotësi), heshtja shurdhe nuk më linte të qetë. Koka më zionte nga një lëmsh i papërcaktuar dhe më digjte si të kisha zjarr në të. Dikur m'u bë se ai zjarr po më pushtonte të tërin bashkë me karrocën dhe ata që më përcillnin. Seç m'u tek të çirrem me sa forcë kisha, por hetova se nuk kisha zë! Në gojë e në fyt më sillej njëfarë shurdhime, e cila s'më hiqej se s'më hiqej. Dikur m'u bë se dëgjova një zë që si jehonë e thellë vinte nga një largësi e madhe dhe përplasej në karrocën që digjej. Ai zë sikur afrohej e afrohej dhe qartësohej, saqë një çast e njoha. Ishte i Shpjeguesit të ëndrrave. Ai po më thërriste. E dija se po më vinte fundi.

— Të prita! Të prita, po thoshte zëri. — Ka kohë që të kam pritur...

M'u bë se Plakun e kisha pranë, fare pranë. Bile, isha

i bindur se e kisha përpara dhe se më vështronte në atë mënyrë si ta kishte harruar një pjesë të shikimit gjetiu.

— Ç'u bë me Kullën e harresës? — po më thoshte. — Ç'u bë?

Rrudha krahët.

— Pse shtiresh sikur nuk kupton?

Prapë rrudha krahët.

— Është koha t'i kuptosh më në fund disa gjëra. E di se do të dëshpërohesh, por ç'e do që pate fat të tillë...

Pas një heshtjeje të shkurtër, që m'u duk shumë e gjatë, ai më tha:

— Ti ka kohë që nuk ekziston. Te ti ka folur një qenie tjetër, qenia e Kullës së harresës, qenia e njeriut të ri perandorak, i cili nuk duhet të ketë as të djeshme e as të pardjeshme, pos të sotmes kalimtare dhe të nesërmes...

Desha t'i thosha se kishte zgjedhur një mënyrë jo të hijshme të hakmerrej për veprimet e mia rreth Kështjellës, me të cilat ai nuk pajtohej, por nga goja ime nuk doli tjetër pos një shushërime shurdhe.

Si ta kuptonte atë që s'ma qiti goja, më tha:

— Kulla e harresës të zhveshi nga vetvetja çastin që të mori në dorë dhe ti ia nise nga fillimi sipas urdhrave të saj të përpikta. Kalove kohë e kohë nëpër zyrat e Kullës për të cilat di vetëm Perandori. Në ato bodrume ka kohë që zhvillohen eksperimente kundër kujtesës individuale ose kolektive dhe programohet njeriu i ri perandorak, që si i përlarë nga vetvetja, t'u shërbejë verbërisht qëllimeve të saj të larta. Kështu, nga kështjellar që ishe, u ktheve në një urrejtës të pashoq të vetvetes. Të bënë të tillë që të luftosh me mish e me shpirt kundër Kështjellës. Në këtë mënyrë, falë teje, Perandoria ia doli ta fitonte një luftë në të cilën pati jo më pak se njëzet e tri disfata rresht...

Megjithatë s'qe e mundur që gjithçka të dalë ashtu siç qe matur. Ngjanë ca gabime të vogla të cilat ia ngatërruan përpak hesapet Kullës së harresës, e ti mbete i mallkuar përgjithmonë... A kuptove: i mallkuar... Megjithatë, Perandoria ruan librin sekret në të cilin ti do ta kuptosh

tjetërsimin tënd, vdekjen tënde dhe mallkimin që t'u bë...

M'i tha këto fjalë Plaku dhe treti. Hetova se isha fillikat vetëm në një hapësirë të errët me një libër në dorë, nga i cili nuk u ndava kurrë...

(Jeta dhe vdekja e Daut Pashait, hartuar nga Kulla e harresës dhe e përcjellë me shënimet plotësuese tepër sekrete)

1.

Daut Pashai u kthye fitimtar ditën e parë të vjeshtës së hershme. Para Pallatit të praruar gjethet dukeshin të molisura nga vapa e gjatë e verës.

Kur doli nga karroca, dukej i përgjumur. Një copë herë shikimi i tij brodhi nga kaltërsia e detit dhe ndoqi fluturimin e ca pulëbardhave që u larguan me të shpejtë nga perëndimi. Vetëm atëherë Pashai hetoi se para kishte shumë veta që po e përshëndetnin, se po i përkuleshin thellësisht, se dikush nxitoi t'i jepte lule të freskëta dhe se ai duhej të ndiqte shtrirjen e qilimit të kuq, i cili shkonte drejt brendisë së Pallatit të praruar. Kuqërremi i bëri aso përshtypjeje saqë eci kokulur pa ia hequr sytë qilimit, i cili së pari e solli para shkallores së madhe e pastaj mu para fronit të praruar në të cilin rrinte vetë Lartmadhëria. Vetëm atëherë kur qilimi sosi para fronit të madh, ai ngriti kokën, si të kërkonte diçka dhe e vërejti Perandorin që po e priste në këmbë. Nderoi sipas rregullit dhe deshi të ulej sa më parë ngase ndjente njëfarë lodhjeje. Por, pas jehonës së fanfareve, Perandori zuri të fliste diçka për fitoren e madhe. Pashai rrinte si i ngrirë dhe dukej që s'e kishte mendjen aty. Së fundi, Perandori e mori ngrykë, i vuri në gjoks një dekoratë të artë dhe e ftoi të ulej pranë tij.

Daut Pashai mezi priti të ulej. Nga ajo lartësi *dukej krenar*[1]). Nga sytë i buronte një mister i jashtëzakonshëm që mund t'u ketë hije vetëm njerëzve të krijuar për frone

të mëdha e për vepra të lavdishme, të denja për kronika të mëdha. Pashai nuk bëri vër më gojë as kur e pranoi dekoratën, as kur mori vesh fermanin e lartë me të cilin ai emërohej kryevezir i Perandorisë. I ngrirë dukej edhe kur iu përkulën ministrat dhe i parakaluan një nga një ushtarakët e lartë, ulemaja, muderrizët dhe këshilltarët e panumërt.

— Ç'kështjellë e mallkuar që ishte, — po i thoshte Perandori. Qemë kyçur aty si të marrë dhe asesi nuk bënim ndonjë hap përpara... Ku do të ishim tash po të mos na e zinte rrugën ajo?

(Shënimi plotësues i Kullës)

1) *dukej krenar.* — Kulla e harresës është dashur ta ketë parasysh dukjen e tij tepër krenare. Seksioni i qëndrimeve nuk e ka kryer punën si duhet, ngase Pashai me atë farë qëndrimi dukej aq krenar sa ia kalonte edhe Perandorit. Ky është një lëshim që nuk bën të përsëritet më në raste të ngjashme. Nga kjo mund të na dalin telashe të papritura...

2.

Vezirët pritnin me padurim Kryevezirin e ri. Ca prej tyre thyenin gishtërinjtë e të tjerë rrinin të rrasur nëpër kolltuqe. Të gjithë e dinin se fjala ishte për një njeri të jashtëzakonshëm, i cili kishte bërë atë që s'e bënë shumë e shumë të tjerë. Prandaj e kishin të qartë se kishin të bënin me një njeri të plotëfuqishëm, fjalën e të cilit nuk e bënte dysh as Perandori.

Daut Pasha hyri me ca letra në dorë. Përshëndeti ftohtas dhe u ul në kolltukun ballor sipër të cilit qëndronte stema perandorake.

Një copë herë i mati me shikim ministrat e pastaj foli e tha:

— Kështjellën e morëm, por lufta jonë atje ende nuk

ka marrë fund. Bile, sipas të dhënave të fundit, atje gjendja është e nderë dhe me shumë *rreziqe për Perandorinë.*[1]) Prandaj, deshëm a nuk deshëm, në atë krahinë rebele duhet të shpallim shtetrrethimin dhe gjendjen e jashtëzakonshme. Tekefundit ata u morën si gjatë me atë vend dhe kanë të drejtë që ca gjëra t'i rregullojnë që të mos shrregullohen më...

Kaq tha Kryeveziri dhe mbylli mbledhjen. Me shikimin e tij të akullt përcolli vezirët që dukeshin të verdhë në fytyrë.

(Shënimi plotësues i Kullës)

1) ...*rreziqe për Perandorinë:* Në takimin e parë me Lartmadhërinë, që pasoi menjëherë pas mbledhjes me vezirët, Daut Pashai shtroi planet e hollësishme se çfarë do të bëhej në Tokën e Lashtë pas shpalljes së shtetërrethimit dhe të gjëndjes së jashtëzakonshme. Ai kërkonte:
a) mobilizimin e dhunshëm të popullsisë aktive,
b) dërgimin e saj në frontin e perëndimit, pra në vijën e parë prej nga shumë prej tyre nuk do të ktheheshin kurrë,
c) zhvendosjen e popullsisë nëpër krahinat e largëta të Perandorisë dhe
d) pasi të bëhej kjo në të gjithë krahinën të ndizej një terror i jashtëzakonshëm represiv, me pretekst se kërkoheshin armiqtë e Perandorisë, të cilët kohë e kohë i kishin zhytur duart në gjakun e shenjtë të ushtrisë perandorake. Ata na kanë shumë hak, i tha Daut Pashai Perandorit. Na kanë aq shumë sa edhe t'i zhbinim nga faqja e dheut bashkë me gurët dhe drunjtë, nuk na i shpaguajnë dot borxhet. Mënyra si u sollën gjatë njëzet e pesë vjetëve të fundit na jep të dreitë që të përdorim çdo metodë kundër tyre... Lartmadhëria u pajtua me fjalët e Pashait dhe i uroi punë të mbarë. Kush nuk ta qet dorën që të bëhet ajo që ti mendon se bëhet për të mirën e Perandorisë. Është kohë e përshtatshme

për ne, tha Kryeveziri, që ta shfrytëzojmë mjegullimin e krijuar për t'i qëruar hesapet njëherë e mirë me ta. Tash ose kurrë, tash ose kurrë tha Pashai gjithë gëzim... Takimi zgjati tri orë. Filloi në iqindinë e ditës së katërt të muajit të njëmbëdhjetë të vitit të madh perandorak.

Lartmadhëria i dha kohë tre muaj Kryevezirit, Daut Pashait, që t'i kryente gjithë ato që duhet t'i kryente në mënyrë që plani më i rëndësishëm perandorak për nënshtrimin përfundimtar të Tokës së Lashtë të zbatohej në tërësi. Gëzohem, tha Lartmadhëria, që më pas Perandoria nuk do ta zërë më në gojë as për të mirë e as për të keq atë vend të mallkuar...

3.

Veziri i madh thirri komandantët e armatës perëndimore perandorake dhe u tha:

— Po nisemi në një fushatë historike, që ka për qëllim forcimin e Perandorisë sonë të lavdishme. Nga kjo varet e ardhmja jonë. Gabimi më i vogël mund të na kushtojë shtrenjt. Prandaj, prej këtij çasti jeni nën betimin e shenjtë.

Kryeveziri foli edhe për ca gjëra të tjera që kishin të bënin me shtetrrethimin dhe me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Së fundi, *priti një ushtarak*[1]) me të cilin bisedoi plot shtatë orë.

(Shënimi plotësues i Kullës)

1) ...priti një ushtarak: Ushtaraku trupshkurtër, me sy të mufatur e me mjekër të dalë, edhe për vetë Kullën mbeti i panjohur! Të kota qenë përpjekjet tona ta dinim se cili ishte ai njeri, të cilit Kryeveziri i tha:
— Merr një njësi, vesh rrobat e harbutëve dhe sulmoi në disa pjesë batalionet tona. Mos ki kurrfarë mëshire...
Ushtaraku u zu ngushtë. Fërkoi mjekrën e dalë dhe belbëzoi një copë herë pa krijuar asnjë fjalë të qartë.

— Nuk ke pse shqetësohesh. Do t'i sulmosh garnizonet tona dhe pikë. Këtë urdhër po ta jap unë dhe nuk e di kush tjetër. Pastaj, do t'u futësh zjarrin ca objekteve që do t'i gjesh në plikon që e ke përpara... Plikon do ta hapësh kur të shkosh atje dhe ruaju se le gjë pa përmbushur nga ato që shënohen aty.
— Pasha, — tha ai gjithë shqetësim, — mbase nuk po më dëgjojnë veshët mirë?
— Të shkretët i ke në rregull, por t'i nuk po i dëgjon ata. Pra, do ta sulmosh ushtrinë tonë. Kjo është detyrë e shenjtë dhe vaj halli po qe se tregon farë mëdyshjesh gjatë sulmeve.
—Peqe, peqe, — foli ai prapë duke belbëzuar, — por bëra kaq vjet shërbim dhe nuk më ka rënë të dëgjoj se dikush që e sulmon vetveten lëvdohet. Pashai qeshi. Qeshi aq sa ushtaraku gati u shemb për tokë.
— Perandoria nuk do të ishte Perandori po të mos sillej edhe ashtu që në të parë duket e pabesueshme... Ca gjëra bëhen me sakrifica, me mashtrime dhe me veprime që s't'i merr mendja. Njeriut të rëndomtë, e aq më tepër ushtarakut besnik, këto gjëra nuk ia merr mendja... Prandaj, dije se po futesh në një lojë jashtëzakonisht të rrezikshme, por me rëndësi të madhe për synimet e Perandorisë. Kjo të detyron që çështjen ta shikosh drejt dhe me përgjegjësi të madhe. Ke të bësh me fshehtësi të rendit të parë, e cila do mbrojtur me çdo kusht, qoftë dhe me rrezikimin e kokës. Bashkë me njerëzit e tu atje je armik i ushtrisë sonë. Je armik i përbetuar dhe vrasës. Je kështjellar dhe nuk duhet të çash kokën për gjeneralët tanë. Cilindo që ta kapësh, këputja kokën pa mëshirë. Kështu do të veprosh derisa të mos marrësh urdhër tjetër. Pra, mos harro se prej tashit je armik. Fjalën armik Kryeveziri e theksoi si shumë, sa ushtaraku u zbeh.
— Unë, armik?
— Armik që ç'ke me të.
— Këtë nuk do ta thosha kurrë. Obobo, armik i Perandorisë! E di se çfarë do të thotë kjo...

Pashai sërish qeshi. Ia hodhi dorën krahaqafë dhe i tha:

— Në të vërtetë ti je njeriu më i besueshëm i Perandorisë. Ti je hero i njëmendët i Perandorisë. Ti nuk je i vetëdijshëm se ç'hero je bashkë me ata që do të kesh në shërbim. Me këtë bindje duhet të shkosh atje dhe të veprosh. Këtë bindje duhet t'ua futësh trimave të tu, të cilët ngjet që atje vdesin kotnasikoti, por që në fakt vdekja e tyre është e madhe... Ju jeni të vetmit që edhe si vrasës, e edhe si të vrarë bëheni heronj... Këtë privilegj e ka rrallëkush...

— O zot, tha ushtaraku, — nuk po ma kap kjo e shkreta rradake sesi mund të jetë vrasësi i vetvetes hero? Kjo nuk po më hyn në kokë fare!

— Nisu! — i tha Kryeveziri dhe ia dha fermanin e fshehtë në të cilin i kishte të shkruara ato që duhej të bënte...

4.

Veziri i madh po i shfletonte me kurreshtje letrat që kishte para. Vezirët ia shihnin në fytyrë brengën, atë brengë të thellë që iu shfaq sapo u hapën lajmet gjysmëzyrtare se në Tokën e Lashtë, në kohën kur bëheshin përgatitjet e fundit për të filluar fushata e shenjtë kah perëndimi, ushtria sulmohej nga rebelët që u shfaqën befas. Brenga bëhej edhe më e madhe kur në Kryesheher flitej me krenari se ai vend ishte shtruar njëherë e përgjithmonë.

Pasi i rrotulloi disa herë letrat dhe pasi i bëri në to disa vija, Kryeveziri nisi e tha:

— Punët *nuk i kemi mirë*[1]). Ka kohë që në atë vend të mallkuar, në të cilin derdhëm aq shumë gjak e aq shumë mund për ta shtruar, sërish po ngre kokë armiku ynë. Kur na thoshte mendja se nuk do të kishim të bënim më me të (sidomos pas rënies së kështjellës së fundit), ai prapë qiti krye. Dhe ç'është më keq, nëse dikur armikun e kishin kry-

esisht në Kështjellë dhe e mbanim të rrethuar, tash është thuajse i padukshëm dhe gjendet kudo. Shfaqet nëpër male, shfaqet nëpër gryka, shfaqet nëpër shkurre, e shfaqet nëpër kodra. Na e sulmon tinëzisht ushtrinë dhe zhduket pa gjurmë. Këtë e bën natën, këtë e bën ditën, këtë e bën nëpër borë, këtë e bën nëpër shi... Me një fjalë na sulet aty ku më së paku e presim... Kjo bëri që fushata kah përëndimi të ngecë, por po ashtu mëkëmbësit perandorakë të kenë telashe me ripërtëritjen e pushtetit, të cilin ata nuk dëshirojnë ta pranojnë fare.

Prandaj, vazhdoi Kryeveziri, armiku që e njohim aq gjatë është kthyer në një hije që po na sillet pareshtur duke na qëlluar tmerrësisht. Droj se ajo hije na është futur brenda-përbrenda. Çka nuk sjell mendja e tyre.

Pas një pushimi të shkurtër, Kryeveziri mori në dorë një dosje nga ato që i kishte pranë dhe tha:

— Këtu i kam shënimet e fshehta *për dëmet*[2]) që na u shkaktuan gjatë dy muajve të fundit. Mbase ca nga ato ka patur mundësi t'i dinit, por shpresoja se të pabërat e tyre qenë ndonjë rastisje, e cila shpejt merr fund. Të dhënat flasin për të kundërtën...

Së fundi Kryeveziri tha:

— Rreziku është i madh, e armiku në veprim e sipër. Nga ju kërkoj që të marr përsipër autorizimet e plotfuqishme të ministrit të luftës dhe të atij të brendshëm, në mënyrë që (siç tha vetë Lartmadhëria) e gjithë barra e fushatës së re dhe e pastrimit të asaj krahine nga armiqtë të më bjerë mua. Lufta e shenjtë nuk mund të bëhet si duhet po s'e patëm shpinën të mbrojtur. Siguria e vendit e do që ajo hapësirë, e cila na qiti dhe po na qet ende telashe, të pastrohet një herë e mirë, që më vonë të mos drojmë për asgjë. Përëndimi, kundër të cilit tash ne do të luftojmë gjithnjë, i ka përdorur ata kundër nesh. E dimë fare mirë se si i ndihmoi gjatë njëzet e pesë vjetëve të fundit. Tash që e kanë të qartë se do t'i ndeshin armët me ne patjetër kërkojnë që përmes tyre të na ligësojnë sado pak. Prandaj, kryeneçësia e tyre nuk është pa lidhje me Përëndimin. Merreni me mend se ç'telashe na dalin po qe se ata në vlugun

e fushatës sonë na e kthejnë dorën, siç kanë zënë të bëjnë tash?

(Shënimi plotësues i Kullës)

1) *nuk i kemi punët mirë:* Kohëve të fundit Kryeveziri shpesh e më shpesh thoshte se Perandoria nuk i kishte punët mirë në atë pjesë të saj. Ato fjalë i thoshte edhe kur shtroheshin çështje që nuk kishin të bënin fare me sigurinë e Perandorisë. Shërbimi ynë shënoi se një ditë më parë, në një mbledhje, ku shqyrtohej çështja e ujërave, Kryeveziri disa herë qe ngatërruar me ato fjalë ngojë. Veziri i ngarkuar me punët e ekonomisë së ujërave kërkoi sqarime rreth atyre që u thanë, ngase kishte frikë që një përcaktim i tillë do t'i kushtonte shtrenjt. E Kryeveziri gjithë zemërim i kishte thënë se do të vinte koha kur do t'i kuptonte të gjitha... Prandaj, ja pse vezirët e kishin pritur me interesim të madh sqarimin që lidhej me shfaqjen e armikut aty ku mendonin se çështjet, së paku për një kohë, merreshin si të zgjidhura. Tekefundit, a nuk flitnin në dobi të kësaj zijafetet e shumta dhe dekoratat e panumërta që u ndanë dhe ndahen pa pushim me rastin e marrjes së Kështjellës...

2) *...për dëmet:* Si të dhëna tepër sekrete për veprimtarinë e armikut gjatë dy muajve të fundit Kryeveziri solli këto të dhëna:

— njëzet e një sulme natën,
— trembëdhjetë sulme gjatë mjegullës,
— shtatë sulme ditën dhe
— tridhjetë e një zjarre.

Me rastin e këtyre sulmeve u shkaktuan këto humbje:

— 112 ushtarë të vrarë,
— 999 ushtarë të plagosur,
— 99 ushtarë të humbur.

Nga zjarret u dëmtuan këto objekte:

— dy postkomanda të mëdha,
— shtatë karakolle,
— tri karroca dhe
— katër depo armësh.
Po ashtu, ku më pak e ku më shumë, u dëmtuan:
— katër ura,
— një kalim tepër strategjik dhe
— një ujësjellës i rëndësishëm.
Kryeveziri përsëriti se armiku është i organizuar mirë, se është i lëvizshëm, se di t'u përshtatet rrethanave të reja dhe, ç'është më shqetësuese, ai mbase po futet me sukses edhe në radhët tona...
— Po bëhen hetime të posaçme rreth asaj se në ç'masë është futur ideja e armiqësisë edhe në qarqet e besueshme ushtarake dhe shtetërore.
Fjalët e fundit i tha me një intonim kumbues, saqë vezirët zunë ta shikojnë njëri-tjetrin me frikë. E Kryeveziri, sapo hetoi shqetësimin e tyre, tha:
— Kjo tregon se çështja është serioze dhe duhet të vlerësohet si e tillë përderisa të veprojë armiku qoftë edhe me ndonjë aksion të vogël. Çfarëdo veprimi duhet të merret si veprim kundër shkatërrimit të Perandorisë. Prandaj, edhe masat që duhet të ndërmerren, duhet t'i përshtaten natyrës së rrezikut...
Në fund Kryeveziri tha edhe këto:
— Për ne ky problem është i dorës së parë. Asnjë tjetër nuk e ka peshën e tij.
Në fund, shënuam një pyetje që iu bë Kryevezirit nga Veziri i së brendshmes i cili tashmë nuk kishte post:
— Sa do të zgjasë gjendja e jashtëzakonshme dhe shtetrrethimi në atë pjesë?
— Kjo varet prej zhvillimit të situatës.

5.

Ditën e parë të muajit të dytë Daut Pashai u nis me shumë ushtri kah Perëndimi. Pas dymbëdhjetë ditë udhe

arriti aty ku dikur taborret e tij qenë ndalur para Kështjellës. Por këtë herë nuk u ndal para saj e as që i hapi tendat në rrafshirën skaj liqenit, ku rëndom vendoseshin taborret dhe pritnin për të bërë luftën e gjatë kundër Kështjellës. Përkundrazi, ai hyri në Kështjellë dhe iu përkul flamurit perandorak, i cili valonte krenar. Seç iu kujtua flamuri i kështjellarëve, të cilin nuk ia zinte dot syri kur arrinte në atë vend. Iu bë se ndjeu krrokamën e zogut të zi që nuk ishte më. Shikoi përreth, por zogu i zi nuk ishte kund. Një copë herë syri i tij kërkonte zogun e zi nëpër qiellin gjysmë gri. Më vonë syri i zuri sheshin e vogël me shkalloren në mes, që ngushtohej si shpejt kah pjesa fundore e saj; pa dhe stemën perandorake, e cila rrinte në atë vend ku kohë më parë rrinte ajo e Principatës që nuk ishte më. Gjithçka në atë hapësirë iu bë e ngushtë dhe tepër e vogël për kallëzimet që kishte dëgjuar, e për të cilat dinte gjithë Perandoria e madje edhe bota. A ishte e mundur që një Kështjellë kaq e vogël t'i ketë qitur aq telashe të mëdha Perandorisë? A ishte e mundur që mu aty të ishin ndeshur aq tmerrësisht synimet e një Perandorie të madhe dhe shpresat e të tjerëve për jetë a vdekje? Këtë pyetje ia shtroi vetes disa herë.

Po atë pasdite Kryeveziri shpalli *shtetrrethimin*[1]). Ishte kjo një ditë me shi të imët, e cila Pashait iu duk tepër e gjatë, aq e gjatë sa mendoi se ishte zhytur në një kohë të pafund e plot bezdi. E, kur më në fund pa se nata po binte mbi Kështjellë dhe tisi i errësirës e kishte mbështjellë sipërfaqen e lëmuar të liqenit, thirri komandantët. Dhe, ata dymbëdhjetë sa ishin, me nishanë të shumtë në kraharor, nxituan në dhomën e Pashait. Kryevezirit iu bë se ata që erdhën, kush më pak e kush më shumë, sollën nga një pjesë të asaj dite të pafund, të cilën as vetë nuk dinte pse e mori zët. I frikësuar se mos vallë brenda do t'i përsëritej diçka e mbetur e asaj dite të përgjumur, urdhëroi të mbylleshin dritaret me çepenxhet e rënda prej druri që përdoreshin kur mbi Kështjellë lëshohej ndonjë stuhi e fortë nga ato që shfaqeshin diku nga fundi i dhjetorit. Urdhëroi madje që të ndizeshin qirinjtë.

— Dua terr e dritë, — tha Pashai me një zë të çjerrë, sa komandantët u frikësuan. — E dua një terr që do t'i japë fund dritës së rreme, dritës që nuk është as ditë, as natë...

— Terrin tashmë e kemi jashtë, — i tha Kadiasqeri i hollë e i gjatë. — Ndërsa, brenda, do ta bëjmë nur perëndie, tha ai, që me nxitim doli dhe po ashtu me nxitim u kthye me një grumbull qirinjsh, të cilët i ndezi me të shpejtë.

Komandantët po i shikonin flakët e qirinjve si dridheshin duke nxjerrë një tym të hollë që shpejt tretej dhe pas linte flakërimin. Dukej se ai flakërim në sytë e Kryevezirit kthehej në një të atillë zjarr që atyre u ngjallte dyshim dhe frikë. Komandantët, pas shpalljes së dekretit të shtetrrethimit, hamendeshin se mbase Pashai i kishte thirrur t'u fliste për çështjet që lidheshin ngushtë me luftën e re aq të pritur. Zymtia, që e hetuan sapo hynë brenda në dhomë, fjalët që i tha aq çuditshëm për terrin e dritën si dhe heshtja që pllakosi dhomën më pas, ua shtuan dyshimin se Pashai jo vetëm që nuk do t'u thoshte gjë prej gjëje për luftën e re që ata e pritnin me padurim, por edhe se lufta me Perëndimin sërish do të shtyhej gjer në harrim, siç ngjau me rastin e rrethimit të Kështjellës. E kjo për ta do të thoshte se do të kyçeshin prapë jo vetëm para Kështjellës (si gjatë shumë e shumë rrethimeve të pafund që gjithsej qenë njëzet e shtatë), por tash në një hapësirë edhe më të gjerë për të filluar një luftë tjetër të bezdisshme, ku në vend të logut të betejës (atij logut të madh me shumë taborre të ushtrive perëndimore përballë), do të hidheshin në ndjekje të pakuptimta pas atyre që nuk kishin as taborre, e as kurrfarë formacionesh të organizuara, e as komandantë të njohur që luftës i prinin me emblema dhe me flamuj e stema të nduarduarta. Në kësi sorollatjesh të mërzitshme ata mund të humbnin shumë (shpesh edhe kokën) e të mos fitonin asgjë. Jo rrallë binin në prita e mezi dilnin prej tyre. Dhe, ç'është më nënçmuese, nuk e dinin me kë luftonin... Kësaj lufte ia kishin frikën komandantët me Xhavid Again në krye.

E Pashai, si ta kuptonte sikletin e tyre, ndoqi një copë herë me shikim flakën e qirinjve. Pastaj shikimi i kaloi në-

për fytyrat e komandantëve, sikur të kërkonte në to diçka të strukur e të rrezikshme. Së fundi, u ndal te Xhavid Agai (sa Agait iu rrëzua shikimi) dhe, i bindur se megjithatë pa atë që e kërkonte, tha:

— Ka kohë që jemi nisur drejt Perëndimit dhe nuk po mundim të shkojmë fare në atë pjesë të botës ku duhet të shkojmë patjetër. Pse nuk jemi atje, shkakun të gjithë e dini, andaj s'e shoh të udhës të bëj ndonjë përsëritje, ngase sa më shumë që flasim për to, aq më e madhe na bëhet brenga dhe aq më i madh na shfaqet ligështimi. Megjithatë, para nesh gjendet Perëndimi, kurrë më i afërt dhe kurrë më i shastisur. Por, si po shihni, kemi *edhe ca për të bërë*[2]) para se të nisemi në marshimin tonë të pandalshëm. Shtetrrethimin nuk e shpallëm sa për sy e faqe. Edhe këtë, ma thotë mendja, e dini mirë e mirë. Sepse, kur të vijë dita e nisjes kah Perëndimi (ditë kjo *që nuk është larg*[3]), vendi duhet *të jetë i pastruar*[4]) doemos...

Sot më tepër se kurrë e kuptoj shqetësimin tuaj. E marr me mend se sa të padurueshëm jeni. Tekefundit dihet se ushtarakun e lodhin sorollatjet e kota, sepse ai kërkon beteja dhe luftëra që t'i rregullojnë qarkullimin e gjakut dhe oreksin. Shumë nga ju që jeni sjellë aq gjatë në këtë vend dhe keni përjetuar shumë e shumë disfata, kërkoni lavd dhe ai mund të gjendet në luftë me taborre të organizuara e të forta, të cilave pos tjerash u prijnë ushtarakë të fuqishëm. Në betejat ku përdoren armët më të mira dhe provohen taktikat më të përkryera ushtarake mund të fitohet fama e dëshiruar. Atje edhe humbja duket më e durueshme, e edhe vdekja më e madhërishme. E di se ju kërkoni luftëra të tilla. Ato do t'i gjeni nesër e pasnesër patjetër...

Fjalët e fundit i theksoi me një ngjyrë tjetërfare të zërit sa komandantët e patën të qartë se njëherë për njëherë lufta e shenjtë kah Perëndimi shtyhej. Në vend të saj, ata sërish do të merreshin me harbutët, se do të hiqeshin zvarrë kënetave dhe moçaleve të pafund për të bërë një luftë monotone dhe fare të pakuptimtë në të cilën asgjë nuk mund të fitohej, pos të humbej... Fjalët nesër a pasnesër shumicës u kujtuan tri rrethimet e fundit kur ushtria më së paku luftoi,

e megjithatë për të vdekur vdiqën si shumë (herë duke ndezur zjarre rreth Kështjellës, herë duke u hapur istikame të thella, herë duke u futur nëpër tunele e herë duke u marrë me gjëra fare të pakuptimta që nuk kishin të bënin me luftën). Atë kohë vdekja njëmend u bë nënçmuese dhe e pavlefshme të përmendej, sa komandantët në letrat e tyre që u dërgonin familjeve të të vdekurve zunë të mos e shënonin fjalinë e domosdoshme «u vra heroikisht për atdhe»... Bile, vetë Xhavid Agai (i cili në ekspeditën e fundit udhëhoqi njësitë vëzhguese) urdhëroi që kjo fjali të mos shkruhej më, edhe pse e dinte se po rrezikonte si shumë. Kështu ai protestoi kundër mënyrës së re të luftës të cilën e futi Daut Pashai sapo mori në dorë gjithë pushtetin e vendit e me të cilën u ndrydh përfundimisht krenaria e ushtarakut. Sapo ra Kështjella (kur kjo pritej më së paku), e Daut Pashai u emërua Kryevezir dhe mori përsipër gjithë komandën e armatës perëndimore, Xhavid Agai shpresonte se më në fund do ta fitonte lavdinë e madhe që e kishte pritur aq shumë. Shumë herë kishte menduar se ç'përpjetëzë do të merrte po qe se nuk do t'i shfaqej para ajo muranë e mallkuar që u hëngri kokat sa e sa ushtarakëve të lavdishme e po aq të tjerëve u fiku shpresat që në nismë. Mendja ia thoshte se ajo qe vetë kobi, ngase e la pa nishanet që i kishte ëndërruar aq shumë dhe pa lumturinë jetësore. Edhe pse shumë e shumë vjet i humbi duke u sorollatur rreth saj (pa mëdyshje vitet më të mira të jetës) prapëseprapë lajmi për marrjen e Kështjellës e gëzoi pa masë sa iu bë se gjithë bota befas iu shfaq në shuplakë të dorës. I pati ardhur keq që Shpjeguesi i ëndrrave nuk ishte më për t'i thënë se ai farë mjegullimi për të cilin ai fliste parreshtur sa herë merrej me ëndrrat e tij, tash ishte shthurur dhe ai, më në fund, mund ta fitonte atë që e kishte gjakuar gjatë. Një çast i tha vetes si me dëshpërim: mëkat që nuk je më i ri, sepse kushedi se sa larg do të shkoje, kushedi se ç'nishane do të bartje, kushedi se sa luftëra do të fitoje... Por, ja se gjithë ai gëzim s'qe thënë ta mbante gjatë. Përfytyrimet e ëmbla iu tretën sapo i dëgjoi ato që i tha Kryeveziri për pritjen e domosdoshme. Qenka shkruar, tha, t'i lë eshtrat në këtë vend ugurzi... Qenka shkruar kështu...

Si t'ia shihte dëshpërimin e thellë, Kryeveziri zuri të fliste për ca aksione ushtarake të rendit të parë, në të cilat do të përdorej një strategji e re... Foli e foli e shikimin nuk e ndau nga Xhavid Agai.

Megjithatë koka e Xhavid Agait shkarazi po i pranonte ato që i thoshte Kryeveziri, ngase ishte zhytur në një pikëllim të thellë sa mezi i përmbante lotët. Po të ishte vetëm, patjetër do të qante. Do të qante si fëmija që ngashërehet pas gjërave të humbura...

(Shënimi plotësues i Kullës)

1) *shtetrrethimi:* përfshinte hapësirën e dikurshme të Principatës me gjithë Tokën e Lashtë. Territori shpallej i rezikshëm dhe i mbyllur për të gjithë. Ushtarakët vunë pushtet të plotë mbi gjithçka. Shtabet e tyre i mbikëqyrte drejtpërsëdrejti Kryeveziri, i cili në të njëjtën kohë e kishte marrë në dorë gjithë komandimin. Me këtë rast pushoi pushteti i sanxhakbeut dhe i valive; Ata viheshin në shërbim të ushtarakëve dhe ishin të detyruar t'u nënshtroheshin me gjithë qatipat dhe administratën që kishin.

2) *...edhe ca për të bërë:* rreth kësaj Kryeveziri fjalë për fjalë u tha kështu ushtarakëve:

— Këto që po u them janë tepër sekrete, sa nuk bën t'ia përsëritni as vetes... Po u tërheq vërejtjen me kohë se besimi i Perandorisë njëmend është i madh, por edhe rreziku nga ai është po ashtu i madh. Prandaj (kollitje e gjatë) duhet t'ia fillojmë menjëherë të propagandojmë me të madhe rrezikun që i kërcënohet krahinës nga Perëndimi. Populllit duhet t'i thuhet err e terr se ç'e zezë u vjen nga bota armike (fjalën e kam te ajo perëndimorja), e cila është e degjeneruar dhe në shkatërrim e sipër... Duhet t'u themi se të mallkuarit (pra perëndimorët) kaherë kanë bërë plane që t'ua shkatërrojnë tempujt, t'ua prishin artin e t'ua çorodisin edhe gjuhën... Nëpër sheshe, tubime dhe kudo njerëzit tanë duhet të hapin fjalë se një kuçedër e ma-

dhe është nisur për të ardhur dhe sapo të vijë do të shterrë ujin, do të sulmojë fshatrat dhe gjithçka tjetër që krijuam me mund të madh... Për këtë të ligë duhet t'u flasim pareshtur si për një të keqe të jashtëzakonshme të madhe. E, kur të mbjellim psikozën e frikës e të urrejtjes, duhet të nisim të regjistrojmë vullnetarët që dëshirojnë të luftojnë kundër Perëndimit. Vullnetarëve duhet t'u japim shpërblime të mira. Së pari, duhet t'ia nisim, pra, me vullnetarë. Po nuk piu ujë kjo, atëhere shpallim mobilizimin e detyrueshëm, ku do të përfshihen ata që janë të aftë për luftë. Një gjë nuk duhet të harrohet: krahas fushatës për të ashtuquajturën kuçedër perëndimore, duhet të zëmë ngojë edhe ata që po na sulen kazermave tona. Ata duhet t'i cilësojmë si agjentë të Perëndimit, të cilët kanë për qëllim që të mbjellin urrejtje dhe të godasin nga brenda Perandorinë tonë të lavdishme. Me veprime të tilla, t'i thuhet popullit, perëndimi dëshiron që ky vend të mos ketë kurrë paqe...

3) ... *që nuk është larg:* Kryeveziri mendonte se vullnetarët dhe të mobilizuarit duhet të niseshin kah Perëndimi pas dy javësh... jepet rasti prapë, do të na pengojë pa ngurruar fare. Pra, fjala është për një armik të lindur, i cili edhe kur duket se struket, apo dorëzohet, e madje edhe kur punon për ne, e ka me sherr. Këta njerëz e kanë të ngulitur në shpirt urrejtjen kundër nesh... Tash kemi rast të jashtëzakonshëm që me një të rënë t'i bëjmë dy të vrame. Prandaj, trimo, hyr kudo dhe kërko armikun. Kërko të pabesin, kërko të dyshimtin, dhe mos ki mëshirë. Armik dhe i dyshimtë për ne këtu është edhe fëmija në djep, edhe i rrituri, edhe gruaja, edhe plaku, edhe kafsha e tyre shtëpiake. Me një fjalë: armik është edhe i gjalli edhe i vdekuri...

— Pra, Pasha, secili është armik?

— Secili. Secili.

— Pa dallim?

— Pa dallim.

— Vlen kjo edhe për hafijet tona?
— Edhe për ato.
— Nuk më duhen sqarime të tjera, — tha Xhavid Agai i kënaqur.
— Pusho dy javë deri sa të kryhet mobilizimi i përgjithshëm e pastaj filloja. Ke tre muaj kohë që ta bësh atë që të ka besuar Perandoria vetëm ty. Më vonë nisemi kah Perëndimi...
Xhavid Agai u përkul, i puthi dorën Pashait dhe kërkoi leje të largohej.
— Mbaj ditar. Shëno të bërat dhe të pabërat. Perandoria kërkon dëshmi të shkruara për të gjitha. Ditarin duhet ta shoh vetëm unë...

6.

Nga Pirgu Pashai po shikonte hapësirën e liqenit e cila thyhej nga ca maja malesh që dukeshin si të zhytura në ujë. Tisi i hollë i mjegullës që kreshpërohej nëpër sipërfaqe ia bënte pamjen edhe më të ashpër. Shikimi i brodhi gjatë andej, e mendimet zunë t'i fluturonin prapa. Mbasë për herë të parë koka, që rëndom i merrej me të tashmen dhe i jepej vetëm së ardhmes, po i kthehej edhe së kaluarës. Sado padashtas, gjithnjë më shumë i kujtohej çasti që hyri në Pallatin e praruar kur Lartmadhëria e quajti Daut Pasha. Pastaj, zuri t'i kujtohej koha e rrethimit të Kështjellës dhe planet që bënte për ta gjunjëzuar atë sa më parë,pa luftë... Dhe sa herë që koka ia kapte gjërat e së kaluarës,të cilave me dëshirë nuk do t'u kthehej kurrë (nuk e dinte pse dhe nga i vinte kjo ndjenjë), shihte Shpjeguesin e ëndrrave. I shfaqej si gjysmëhije dhe i fliste diçka për shpirtin dhe ëndrrat vetjake, të cilat një ditë patjetër e gjejnë vetveten... Ëndrra është e çuditshme, i thoshte ai. Ngjet që bredh e bredh e shkëputur nëpër mote, e papërcaktuar dhe e mjegulluar, por një ditë i kthehet kokës së vet... Ëndrra e gjen të zonë... Ëndrra nuk plaket... Ëndrra edhe kur bredh e papërcaktuar, i kthehet dikur burimit të vet... Një çast iu duk se Plaku po i fliste për

njëfarë zbrazëtie, po i thoshte se njeriu pa ëndrra ishte i zbrazët... Madje iu bë se ai i tha «nuk ke qenë i zbrazët... nuk ke qenë i tillë.. Ëndrrat të kanë ikur por një ditë ato të gjejnë dhe ti do të shohësh se nuk je i zbrazët...»

Mend plasi nga ato fjalë që nuk po i ndaheshin. Po i vinin të shkëputura si zukamë e mundimshme. Një copë herë zukama e ndoqi dhe i solli aso sikleti, saqë deshi të dilte jashtë për të bredhur paksa pa ndonjë cak... Por trokiti dera dhe ai pa këshilltarin e lartë ushtarak, i cili çdo ditë, në të njëjtën kohë i sillte raportet e reja që i dërgonin komandantët që merreshin me mobilizimin. Ai këtë herë nuk solli raporte. Kryeveziri i pa duart që po i dridheshin. Rrinte i shtangur dhe dukej si i pagojë.

— Ç'kemi, — i tha për t'ia hequr shqetësimin që ia shfaqte gjithë trupi?

— Madhëri... Madhëri — po belbëzonte, — Madhëri...

— Fol, de! Pse murmurit ashtu?

— Madhëri... komandantët... Komandantët më thanë t'u bëj me dije se punët... punët nuk po shkojnë mirë...

Kryeveziri, të cilit ende po i ushtonte koka nga përftimet e pakmëparshme, brofi në këmbë dhe lëshoi një çirrje të çuditshme nga e cila Këshilltari desh ra përdhe.

— Madhëri... unë... Madhëri...

— Zgjidhe njëherë atë të shkretë dhe thuaje atë që duhet ta thuash.

— ... po ikin... po ikin...

— Kush ikën!

— Thonë se ikin vendësit... Ata që i mobilizuam... ata ikin...

— Brr!— shfreu Kryeveziri. —Mund të jetë ky ndonjë hutim!

— Nuk e di, Madhëri, nuk e di... Kështu më thanë të them... tjetër nuk di...

Kryeveziri shfreu edhe për të dytën herë dhe zuri të sillej gjithë shqetësim nëpër dhomë. Shkoi te dritarja dhe, pasi shikoi një copë herë liqenin, tha:

— Le të vijë me ngut Shemsi Agai.

— Peqej, Pasha, — tha Këshilltari dhe doli me nxitim.

— Po ikin, po ikin, — shfreu prapë Kryeveziri kur

mbeti vetëm. — Po ikin. E kanë në gjak armiqësinë kundër Perandorisë. Këtë e dija. Por këtë duhet ta paguajnë me kokë... I madh e i vogël duhet ta ngulisin në mend njëherë e mirë...

Kryevezirit nuk iu hoq zemërimi një kohë të gjatë. Tash trillimi i vet për agjentët e perëndisë, iu duk i vërtetë. I bëhej se vendi ishte mbushur me ta, siç mbushet çemeri me minj. Minjtë shumoheshin e shumoheshin sa kërkonin t'i futeshin edhe në dhomë... Po ikin, po ikin, foli prapë përçart...Po e ditkan? Ky mendim i solli të dridhura. Po si e kuptuan atë që askush nuk duhej ta kuptonte? Një kohë të gjatë u rropat me këtë hamendje e pastaj mendja i tha se ndonjëri nga komandantët mund të kishte folur pahiri ndonjë fjalë për qëllimet e mobilizimit dhe pastaj fjala kishte marrë dhenë dhe kishte rënë në veshin e tyre. Po të kishte ndodhur kjo, atëherë të gjitha përgatitjet e bëra me aq kujdes dhe përkushtim do t'i vinin në djall. Bile, pasojat e dështimit do të ishin afatgjata, sepse vendësit nuk do t'i besonin, më kurrën e kurrës Perandorisë për asgjë. Ky mendim e trishtoi. E bëri që të shembej përtokë dhe të mbytej në djersë. A thua qenka shkruar që edhe unë të pësoj fatin e të tjerëve, po fliste si përçart. A thua qenka e thënë që ky vend i mallkuar gjithnjë të jetë i njëjtë?... Dëshpërueshëm mbylli sytë dhe kërkoi t'i jepej harrimit. Por, nuk vonoi dhe iu shfaq prapë Shpjeguesi i ëndrrave. «A të kujtohet kur të thosha se na kundërvihen me ëndrrat e tyre dhe me lloj-lloj përfytyrimesh të tmerrshme?», po i thoshte. A të kujtohet kur të thosha se mendja e tyre gjithnjë pjell diçka të pabesueshme?... A të kujtohet se si më shikoje gjithë nënçmim kur të thosha se nuk do ta kemi të lehtë me ta?... Mendoje se me një curil uji dhe me një tunel merr fund e tëra... Unë e dija se telashet tona me ta do të bëhen edhe më të mëdha kur nuk do t'i kemi më të mbërthyer në Kështjellë... Jashtë saj ata bëhen edhe më të rrezikshëm... Shpërndahen në shumë anë dhe bëhen si pleshtat të pakapshëm... Janë si sëmundja e pashërueshme, e cila kur të rrok nuk të ndahet më... S'po të kujtohen këto? Ë?

Ajo ëëë po i vinte si thekamë e rëndë. Po më dhëmb koka, po më ndahet përgjysmë, tha. Diçka e çuditshme po më zihet në të. Po më oshëtin...po më oshëtin... Ndihmomni! Ndihmomni!

Shemsi Agai e gjeti të bërë dyll. Ushtaraku nuk e dinte të rrinte apo të largohej sa më parë. Një copë herë u mat si t'ia bënte, por për çudi Pashai shpejt e mori veten. U ul këmbëkryq. Piu shurupin dhe i fërkoi sytë sikur dëshironte ta hiqte sa më parë mjegullimin që i ishte qepur pak më parë.

Ushtaraku e përshëndeti dhe i tha se vinte me urdhërin e tij. Pashai piu prapë shurup dhe përpak u mor me vetveten. Bënte përpjekje që ta tejkalonte sa më parë ligështimin që iu shfaq sapo këshilltari ushtarak e lajmëroi për ikjen e vullnetarëve dhe të të mobilizuarve.

— Çështja është shumë serioze, —foli Pashai. —Kërkoj shpjegime të ngutshme dhe të hollësishme rreth asaj që po ngjet poshtë. Edhe imtësia më e vogël mund të ketë rëndësi shumë të madhe.

Ushtaraku, pasi u kollit disa herë, tha:

— Madhëri, ka një javë që po merrem me kryerjen e urdhrave tuaja. Siç e dini, për një kohë të shkurtër mobilizova mbi njëmbëdhjetë mijë veta, të gjithë të moshës së re. U flitnim për kuçedrën e Perëndimit dhe të ligat që mund t'u sillte ajo, e ata vinin grumbuj-grumbuj. Për të luftuar, thoshin, nuk përtojmë. Neve na molis paqja e rreme. Lufta na i rrit flokët. Mendja ma thoshte se shumë prej tyre kërkonin sa më parë atë luftën për të cilën ne u thoshim se do të jetë një luftë e madhe, e pashoqe dhe me gjithfarë armësh. E mbi të gjitha do të jetë një luftë nga e cila ato do të mbroheshin kundër një rreziku që e kishin fare pranë dhe priste që t'u hidhej në qafë sapo të gjente rastin më të përshtatshëm. Së shpejti do të nisemi, u thoshim. Askush nuk do të mbetet jashtë luftës së madhe në të cilën do të luftojnë për vdekje lindja me perëndimin... Por, ç'e do Madhëri, kur e keqja e ka folenë te ta

dhe pareshtur i ngre dallash. Dje dhe pardje, këshilltarët më thanë se të vullnetarët vërejtën njëfarë shqetësimi. Urdhërova që të bëhen hetime të ngutshme. Nga hafijet më të besueshme kërkova t'i kuptonin të gjitha. Nuk vonoi dhe mësova se dikush ishte futur midis tyre dhe u kishte thënë se ne nuk kishim qëllime të mira. Do t'i dërgonim diku për t'i lënë kokat kotnasikoti... U kishin thënë se Perandoria e kishte imagjinuar armikun dhe atë farë Perëndimi vetëm e vetëm për t'i qëruar hesapet me ta njëherë e mirë... Ikni, ikni, u kishin thënë. Ikni sa më parë dhe hapni fjalë që të mos i besojë më kush Perandorisë, sepse ajo do t'i therë një nga një, të madh e të vogël, deri në një... Për të qenë edhe më keq, Madhëri, lajmi ishte përhapur si mortja, kështu që shumë prej tyre morën arratinë. U nisëm me të shpejtë pas tyre në fshatrat më anësorë. Kudo gjenim shtëpi të mbyllura. Gratë na shikonin me njëfarë urrejtjeje që lehtë u shihej në sy, si të kishin punë me vetë djallin. Afër një lumi takuam një plak dhe e pyetëm se për ç'shkak iknin nga ne, e ai na e ktheu troç se i madh e i vogël e kishte të qartë se mobilizimi ishte vetëm një kurdisje që e kishte bërë Perandoria për të na marrë kokat. I xhindosur pa masë, ia ngjita plakut për fyti dhe i thashë se ato ishin gënjeshtra të turpshme, të cilat i kishin përhapur pikërisht ata që punonin kundër Perandorisë. I thashë pastaj se me veprime të tilla jo vetëm që i bënin dëm Perandorisë, por edhe vetes, ngase Perëndimi do të bënte çmos që, kur t'i jepej rasti, t'ua dredhte zullumin... njëmijë herë pas qafe... Ngado që shkuam përsëritëm të njëjtat fjalë. E ata na shikonin me dyshim dhe iknin. Duket se vështirë mund t'i fusim në grusht siç i patëm.

— Kush janë ata që ua turbulluan ashtu mendjet? — pyeti Kryeveziri prajshëm.

— Vendës, Madhëri, vendës. Kështjellarë...

— Kështjellarë?

— I zumë me pelë për dore...

— Do të thotë, nuk e paskemi ndarë egjrën prej thekrës? Do të thotë se nuk keni punuar si duhet... S'keni bërë asgjë...

Ushtaraku zu të djersitej. Bënte përpjekje t'i ikte disi shikimit të rreptë të Kryevezirit.

— Madhëri, —foli ai pas një mundimi të theksuar, —i bëmë ato që duhej të bëheshin. Ndër vullnetarë futëm mjaft hafije, por kujt i shkonte mendja se ata dinin ato që nuk duhet t'i dijë kush. Megjithatë ne u ramë në gjurmë vetëtimthi gojëkqijve dhe sapo i zumë i dërguam në hetuesi dhe vepruam si dimë në raste të tilla. Qenë tre veta, të një dukjeje dhe rrite, që nuk bënë gëk me gojë. Hetuesi gati ia mora kokën kur më tha se janë si mumje. Po tallesh me mua? i thashë. Kush guxon të heshtë para nesh? Kush? Shkova me nxitim në hetuesi dhe u binda se ata ishin të shkallmuar sa s'u dilte më as fryma nga goja e lëre më ndonjë fjalë. Urdhërova që të ndërpriteshin mundimet deri sa ta merrnin prapë veten. Droja se do të vdisnin pa kuptuar gjë prej tyre...

— Mjaft! Mjaft! — shfreu Kryeveziri. — Flet thuajse ne kemi aq shumë kohë sa t'i lusim armiqtë tanë të flasin kur t'u teket. Po harron se gjendemi para një sprove të jashtëzakonshme me interes të madh për Perandorinë. Është dashur po atë çast që i zutë të mësoni se prej nga i kishin ato mendime të mbrapshta. Kjo më duhej. Kjo!

— Madhëri,— foli Shemsi Agai me një ndjenjë të thellë faji — mbase u tregova paksa i butë, por ta dini se kjo ndodhi nga frika se nuk do të kuptonim gjë prej gjëje po qe se ata të tre na mbesin në dorë. Përulësisht i pranoj të gjitha. Por, po deshët tash mund t'ua nxjerr fjalët bashkë me gjuhët.

Kryeveziri u qetësua paksa. Një copë herë shikimi iu tret në liqen dhe i zuri njëfarë tisi të mjegullës, që po i bëhej gjithnjë më i madh. Nga ai tis iu duk se po shihte të dilnin tre vetë që kishin tri koka të njëjta e një trup. Trupi me tri koka po i afrohej e po i afrohej, sa dikur iu bë se ato fytyra disi po i njihte. Çuditërisht nga shikimet e tyre po i digjte koka aq sa i bëhej se diçka e fuqishme do të shembej në të. Kjo e mbushi gjithë siklet dhe me të shpejtë iku nga dritarja dhe ndeshi ushtarakun që po rrinte si i ngrirë.

— Ata të tre nuk do të flasin më,— foli Pashai si të

ishte zgjuar nga ndonjë gjumë i thellë. — Kjo është më se e qartë, por, po qe se nuk do të na thonë gjë prej gjëje, t'i bëjmë që të mos flasin kurrë.

— Fjala juaj, Madhëri.

— T'ua shkurtoni gjuhët...

— Do t'ua shkurtojmë deri në rrënjë.

— E mandej, mandej... — zuri të fliste Kryeveziri sikur t'i kishte mbetur diku ajo që duhej të thoshte, — mandej t'i verboni...

— Do t'i verbojmë që të zhyten përgjithmonë në botën e territ... A mos patët edhe ndonjë dëshirë tjetër?

— Më vonë i lironi. Le të shkojnë nga të duan.

— Peqej, Madhëri!

— Dënimin t'ua bëni në shesh, para grumbullit të vullnetarëve. Të thoni me gjithë zërin se ishin agjentë të huaj, pra të Perëndimit, që punuan ditë e natë kundër interesave të Perandorisë. Kaq.

Ushtaraku u përkul dhe u bë gati të largohej.

—Para perëndimit të diellit le të vijë Xhavid Agai,— tha Kryeveziri.

Në sheshin e Kështjellës vullnetarët vinin grumbuj-grumbuj dhe zinin vend para shkallores së madhe. Hapësira rrëzë pirgut të lartë, aty ku valonte flamuri perandorak, ishte mbërthyer prej tyre.

Kryeveziri po shikonte nga dritarja mizërinë e pafund të të mobilizuarve e megjithatë sheshi që qe mbushur me ta, po i dukej i gjerë, aq i gjerë sa do të mjaftonte të përpinte gjithë ushtrinë e botës. Sado që të mobilizuarit vinin dhe rraseshin pranë njëri-tjetrit sa edhe pikat e shiut të imët që binin pareshtur nuk e gjenin tokën, i dukej se gjithë ajo që kishte bërë Shefqet Agai ishte pak, shumë pak. Jashtë radhëve i bëhej se kishin mbetur shumë e shumë veta, të cilët, herdo-kurdo, do të çonin krye kundër Perandorisë. Duke shikuar ata që lageshin në shesh dhe pritnin të hutuar se çfarë do të ndodhte, po merrej me një mendim çoroditës: sa armiq më tepër do të kishte Perandoria pas ndonjë dhjetëvjetëshi po qe se të mobilizuarit që rrinin aty tok do të shkonin nga kishin ardhur? Para i dolën shifra të mëdha,

shumë të mëdha, ku secila ishte armë e kthyer kundër tyre. Janë. Janë si minjtë mendoi. Shumohen shpejt, shumë shpejt...Ju kujtua se si dikush i kishte thënë se rrita e tyre është e rrezikshme, aq e rrezikshme sa një ditë mund t'i kërcënohet Perandorisë. Ju bë se tash që i kishte përpara, që të gjithë po i kërkonin kokën. Kokën po ia kërkonin edhe ata të cilët kishin ikur dhe ishin shpërndarë nëpër mal. Të gjithë, të gjithë po e kërkonin. Kjo e ligështoi sa deshi të strukej diku për t'u mbrojtur disi. Por, shpejt e mori veten. Një buzëqeshje e thartë i kaloi fytyrës. Më ndje, perëndi, tha, më ndje për këtë dobësim që nganjëherë në mënyrë të pavetëdijshme e gjen shpirtin për ta mashtruar. Por lutja nuk i ndihmoi gjithaq. Mendja prapë i shkoi te tytat që po i kërkonin kokën. Iu bë se i gjithë sheshi ishte kthyer në një armë shumëtytëshe që i ishte drejtuar atij dhe Perandorisë. Zuri sytë me duar dhe oshëtiu dëshpërueshëm. Për herë të parë ia pranoi vetes se sa më shumë që kalonte koha, ndihej i shkallmuar dhe i shqetësuar së tepërmi. Ndjeu se në kulmin e atij shqetësimi prapë hetoi Shpjeguesin e ëndrrave që po i fliste për njëfarë Kulle të harresës dhe qenien e zbrazët, e cila mëton të plotësohet pareshtur me ato që i përkasin, e nga të cilat pavetëdijshëm është zbrazur... «Pjesa jote nuk të lë të qetë... Pjesa jote nuk të lë të qetë», po i fliste Plaku...«Kujtesa është e çuditshme...Jo rrallë shfaqet në pjesën e pavetëdijshme për t'u lidhur me vetëdijen... Gjë e çuditshme, për besë... Nuk të lë të qetë..., Shfaqet si shungullimë dhe shqetësim i përhershëm... Shqetësime të tilla janë të tmerrshme... Janë të tmerrshme...»

Fjalët e Shpjeguesit të ëndrrave e shqetësuan edhe më shumë. Nuk e dinte pse plaku si i vdekur po e ndiqte me ato fjalë që i shfaqeshin si përftime. A nuk po i qitnin telashe të mjaftueshme të gjallët që të merrej edhe me të vdekurit? Një copë herë deshi të gjente shkakun e kësaj, por sa më shumë që mendonte, i bëhej se ishte i paaftë ta zgjidhte atë nyje, e cila hove-hove e shtrëngonte me gjithë forcë. I pazoti që të zgjidhte atë nyjë, iu afrua dritares dhe pasi i shikoi një copë herë vullnetarët që lage-

shin në shi, seç i përftoi një dëshirë që ai vend të lahej në gjak. Dëshiroi një gjak si përrua, i cili do të zbriste nga mali dhe do të futej në Kështjellë, e pasi t'i bënte muret e saj all, të shkonte tutje-tëhu në liqen, në mënyrë që edhe liqeni të dukej i kuq. Përfytyrimi i gjakut iu ngulit aq shumë, saqë gjithçka që pa nga dritarja qe vetëm gjak, një gjak i freskët që vinte nga të gjitha anët dhe e pushtonte hapësirën që kishte para: së pari sheshin, pastaj shkalloren e madhe, faltoren derisa nisi t'u ngjitej mureve të kullave dhe vetë pirgut të lartë në të cilin valonte flamuri perandorak. Iu bë se gjaku po i futej brenda, se po ia pushtonte furishëm dhomën, se gjaku po e merrte me vete drejt një deti të gjerë ku kishte vetëm gjak, gjak dhe furtuna gjaku... Asaj rrugës së pakthim, gjaku trashej, bëhej gjithnjë më i trashë sa mbeti i shtanguar në të. Nga frika se do të mbetej përgjithmonë në atë humbëtirë gjaku, zuri të kërkonte ndihmë. Ndihmë po kërkonte nga Shpjeguesi i ëndrrave. Ishte i bindur se Plakun e kishte pranë dhe ai ishte i vetmi që mund t'i ndihmonte në ato çaste të vështira. Por, Shpjeguesi i ëndrrave po i largohej e po i largohej. I fliste diçka që ky nuk e kuptonte fare... Po mbytem, po mbytem, foli një copë herë...

Kur u lirua nga ai ankth i rëndë, si në mjegull pa se para po i rrinte Xhavid Agai i përkulur.

Kryevezirit i erdhi rëndë që ushtaraku e gjeti në atë gjendje. Edhe më rëndë i erdhi kur i shkoi mendja se i zhytur në ankth kishte folur ndonjë fjalë që nuk duhej ta fliste.

— Sapo erdha, Madhëri, Gëzohem që ju shoh mirë...

Kryeveziri e vodhi me shikim disa herë dhe deshi ta pyeste për diçka që as vetë nuk e kishte të qartë se çfarë ishte ajo që duhej të dinte. Pasi fshiu djersët që i kishin kapluar ballin, gjeti fjalët që duhej t'i thoshte:

— Çfarë thanë vullnetarët për ata që *u shkurtuat gjuhët*[1]).

Si të kishte pritur mu atë pyetje, ushtaraku iu përgjigj shpejt e shpejt:

— Dukeshin si të ngrirë. Askush nuk bëri vër me gojë...

— Do të thotë se vetëm shikuan?

— Qenë kthyer në mumje.

— Ç'u bë me ata të tre? Nga shkuan?

— Kuptova se shkuan drejt pjesës së rrëpishme të Kështjellës dhe u bënë pjesë e natës.

Kryevezirin thuajse nuk e kënaqën ato që i tha ushtaraku. Një copë herë theu gishtërinjtë hamendshëm, eci poshtë lart nëpër dhomë, e dikur tha:

— Sonte duhet t'ia fillosh... Merr taborret ndëshkimore dhe nisja...

— Peqej, Madhëri. Më gëzove.

— Tash i di të gjitha?

— Të gjitha, të gjitha i di...

— Mos harro ditarin... Shënoi të gjitha. Dije se shënimet janë tepër sekrete. Më përkasin vetëm mua dhe Lartmadhërisë...

— Fjala juaj, Madhëri. Do t'i ruaj si sytë.

Ushtaraku u përkul dhe u nis kah dera. Në të dalë Kryeveziri i tha:

— Vullnetarët dhe të mobilizuarit të rreshtohen sa më parë dhe të nisen kah deti. Pas tyre nisem edhe unë...

(Shënimet plotësuese të Kullës)

1) ...*ua shkurtuan gjuhët:* Së pari u shkurtuan gjuhët e pastaj u verbuan sytë... Para se t'u futnin gjilpërat në sy u thanë: shikojeni botën për të fundmen herë. Hapni mirë, që territ tuaj të amshueshëm t'i mbetet në kujtesë moria e vullnetarëve... Më vonë do të bëheni pjesë e skëterrës...

Ata të tre nuk u shqetësuan. Shikuan vullnetarët dhe iu dhanë pushtetit të errësirës. Qëndrimi i tyre e tmerroi xhelatin, e tmerroi edhe hosodobashin që u mbante duart të lidhura. I tmerruar mbeti edhe Shefqet Agai, i cili kërkonte që dënimi të kryhej sipas ceremonialit të paparë. Agai, që rrinte kundruall tyre në pjesën e sipërme të të faltores, mu afër tempullit të thyer, mend plasi kur ata nuk pranuan të pendoheshin e lëre më të

kërkonin mëshirë. Edhe pse e dinte se edhe pendimi më i sinqertë nuk do t'u ndihmonte fare, pendimin e tyre sado të tërthortë do ta dëshironte mbi botën. Por ata nuk bënë vër me gojë, as kur ka diasqeri u kumtoi se çi priste, as kur panë gjilpërat si u afroheshin kah sytë... Përkundrazi, heshtnin. Heshtnin mospërfillshëm sa Shefqet Agai zu të dridhej si thupra në ujë dhe, po të mos ndodhej në atë vend me detyrë, patjetër do të plandosej për tokë si i paqenë... Më vonë, kur shkoi në dhomën e vet u fut në të m'u atëherë kur terri kishte zënë t'ua fshihte konturat gjërave të njohura), dëshiroi që nga kujtesa ta shlyente sa më parë atë që pa në shesh. Por iu bë se ata të tre, me qëndrimin e tyre mospërfillës, po e ndiqnin dhe i kishte brenda bashkë me atë heshtjen nënçmuese. Çfarë dëshironi nga unë, deshi t'u thoshte. Unë nuk jam ai që ju dënova... Gjeni ata me të cilët patët punë, e jo mua që qeshë i detyruar t'ju shikoj...

Një kohë Agai foli si përçart. Nuk u kam hak, nuk u kam hak, thoshte dhe zinte fytyrën me duar, duke kërkuar shpëtim nga terri, i cili edhe ashtu ishte i mjaftueshëm që të humbje në të. Por, Shefqet Agai kërkonte në terr sketerrë, që do të zhytej në të bashkë me mendimet e liga...

Më vonë, kur hyri Këshilltari i Kryevezirit që t'i kumtonte urdhrin nga lart, po fliste përçart: «ata të tre... të tre... ata...»

— Shkuan dhe tash janë në atë botë... Shpirtrat e tyre gjenden në atë ferr që e kërkuan vetë, — i tha Këshilltari i Kryevezirit, i cili nuk e pati të vështirë ta kuptonte gjendjen e tij të rëndë.

— E pse në ferr? — tha Agai, i tëri i mbytur në djersë.

— Atje e kishin vendin. Atje ku gjenden kundërshtarët e përbetuar të Perandorisë... Kush s'u tha të shkonin por këmbët e tyre i bartën drejt pjesës së rrëpirët të kështjellës, mu në greminën e pafund... Aty sharruan përgjithmonë... — Do të thotë, — foli Agai gjithë shqetësim, — nuk do t'i shoh më?

— Kurrë më, kurrë më! — tha Këshilltari me një zë të matur.
— S'i takon dot njeri...
— Po me qëndrimin e tyre çfarë do të bëhet.
Këshilltari u shtir kinse nuk i dëgjoi ato që tha ai, por Shevqet Agai sërish shtroi të njëjtën pyetje. Bile, me një zë shumë të lartë. E Këshilltari ia ktheu:
— Ata nuk patën qëndrim. Nuk e kanë pasur kurrnjëherë. Njerëz të tillë nuk kanë qëndrim. Ishin harbutë dhe të tillë do të mbesin edhe në atë botë... Soji i tyre janë hiçër fodullë. Kush nuk i njeh për të tjerë...
— Këtë nuk do ta thosha, — foli Shevqet Agai. — Këtë nuk do ta thosha... Ai që s'e përfill vdekjen në atë mënyrë nuk është fodull apo hiç, si po thua. Me këtë nuk pajtohem... Këshilltari nuk e çoi më gjatë. Ishte i bindur se Agai nuk i kishte punët mirë. Për këtë sa më parë duhej të lajmëronte Kryevezirin.
Në të dalë i tha:
— Madhëria e tij, Kryeveziri, urdhëron që në mesnatë të nisesh me vullnetarët dhe të mobilizuarit. Pas dy orësh duhet të paraqiteni edhe një herë te ai... Shevqet Agai u vesh dhe u mbath me nxitim. Disa herë u soll nëpër dhomë dhe nuk dinte se çfarë kërkonte me tamam. I shqetësuar ai ishte, doli jashtë dhe brodhi shkujdesshëm andej nga e çonin këmbët. Ata që e panë në atë gjendje, hetuan diç jo të rëndomtë në sjelljet e tij. Roja anësore, kur e thirrëm të dëshmojë, tha se i kishte thënë se po e ndiqnin shikimet e tre vetave që u masakruan në shesh dhe se duhej patjetër t'i takonte. «Bëri me dorë kah pjesa e rrëpirët e Kështjellës dhe pas pak dëgjova një jehonë të thekshme që shpejt e përpiu nata», tha roja.

7.

Kryeveziri dha porosi që ta zgjonin para ferkut të dritës dhe ndolli një gjumë të thellë. Por gjumi nuk e mori që nuk e mori. Më kot u mundua që nga koka t'i largonte

ato që ia bënë ditën pafund. Së pari iu shfaq ai deti i kuq i gjakut, e pastaj iu qepën ata të tre që u prenë gjuhët dhe i verbuan. Edhe pse nuk i pa kur i sollën para vullnetarëve dhe i masakruan botërisht, po i bëheshin të njohur, shumë të njohur, thuajse kishte qenë gjatë me ta. Dhe ata të tre për të cilët këshilltari i kishte thënë se dukeshin të ngjashëm si të ishin një njeri i vetëm shumëzuar në tresh, po i shfaqeshin tamam si krijesë që kishte tri kokë të njëjta. Më vonë nga i njëjti trup u bënë tre sish, por që kishin një kokë dhe kështu me radhë, herë një krijesë me tri koka, e herë një kokë me tre trupa... Ata të tre zunë t'i afroheshin. I erdhën aq afër sa ua pa mollëzat e dala e sytë e kaltërt. Ata po i thoshin diçka, por ai nuk i kuptonte fare gjërat që ata i përsëritnin pareshtur me një gojë. Dikur, nga moria e atyre fjalëve të shkëputura, që ai nuk mund t'i lidhte fare si duhej, po i ushtonte koka. Hetoi se diçka po thyhej në të furishëm. Këtë thyerje e ndiente si mundim të të kuptuarit, ngase i bëhej se ca gjëra përftueshëm i kapte paksa, por që ashtu vetëtimthi i iknin... Kjo e shqetësoi edhe më shumë, sepse dëshironte të kuptonte se ç'ishin ato që i vinin si shkreptima dhe po ashtu i largoheshin. Në atë mezokohë çasti, i dukej se, sado shkurt, ndihej ndryshe. Madje lirohej nga ankthi që e kishte mbërthyer kushedi se kur.

Një kohë të gjatë u mor me ata të tre. Dikur iu bë se ata humbën në një mjegullim të dendur, nga i cili pas pak hetoi se po shfaqeshin gjarpërinj. Ishin shumë sish të cilët fërshëllenin dhe rrëshqitnin drejt një humnere. Po i ikim zjarrit që na dogji, po i thoshin gjarpërinjtë. Atje nuk ka zjarr. Ka vetëm errësirë dhe akullnaja... Aty do të mbesim të ngrirë përgjithmonë... A të ngushëllon kjo? O zot, klithi Kryeveziri, pse nuk po gjej qetësi kund? Pse? Pse?

Kur i kaloi ankthi pa këshilltarin si po ia fshinte djersët, por para i kishte edhe ushtarakët, që po e pritnin pa bërë zë.

— Nuk jam mirë, — foli Kryeveziri gjithë mundim. — Nuk jam mirë tha edhe për të dytën herë, dhe nuk ishte i sigurt se ato që i tha qenë njëmend fjalët e tij, apo

të një tjetri që fliste me gojën e tij? Mendja ia tha se ai përbëhej prej pjesës që e thoshte dhe asaj që s'e thoshte, por që gjithnjë e më shpesh i shfaqej si ushtimë. Frikësohej se brenda për brenda vetvetes kishte edhe diçka që s'e kuptonte fare, e që, së voni, herë pas here, bënte përpjekje që të shpërthente disi... Këtë deshi t'ua shpjegonte ushtarakëve, por me të shpejtë hoqi dorë kur i ra ndërmend se ata jo vetëm që nuk do ta kuptonin, por do ta merrnin për të krisur.

— Të gjithë jemi ligështuar, Madhëri, foli Këshilltari. — Mbase fajet i ka ndërrimi i stinëve? Këtu thonë se në këtë kohë ajri bëhet i rëndë sa ta merr gjumi dhe ta shton sikletin...

Kryeveziri heshti. Shikoi me radhë ushtarakët dhe prapë gjeti Këshilltarin, i cili tha se duhej t'ia bënte me dije, se koha ishte të nisej kah deti, ngase kohë më parë vullnetarët dhe të mobilizuarit (mbi njëmbëdhjetë bijë sa ishin) qenë nisur. Pas dy ditë rruge, foli ai, do të arrijë në Liman në mënyrë që nga aty të futen në atë luftën të cilën ne duhet ta fitojmë patjetër. Pas kësaj bota është jona...

Por Pashai duket se nuk ua vuri veshin atyre që i tha Këshilltari. Rrinte si i ngrirë. Nuk e dinte as vetë pse kërkonte me sy diçka të panjohur në flamurin perandorak, që hapej kundruall tij në pjesën ballore. Pas një heshtjeje foli e tha:

— Prej tashit do të vrasim gjarpërinj... Do t'i vrasim gjithë gjarpërinjtë e botës... Perandoria i ka zët gjarpërinjtë...

I tha këto dhe heshti.

Ushtarakët, që kishin pritur urdhra të rëndësishëm, mbetën pa gojë. Secili mundohej të kuptonte se çfarë fshihej pas atyre që tha Kryeveziri për gjarpërinjtë.

Megjithatë heshtjen e ndërpreu Këshilltari ushtarak i cili ia tha Kryevezirit ato që ia pati thënë pak më parë rreth nisjes së vullnetarëve kah deti. Si të ishte shkëputur nga ndonjë ëndërr e ligë, Kryeveziri brofi në këmbë dhe tha:

— Erdhi koha të ecim rrugës së pafund...

Fjalën e fundit e tha me gjysmë zëri dhe si të lënë për-

gjysmë. Vetëm pasi i vuri nishanet dhe rregulloi shpatën e praruar, atë fjalë e tha disa herë. E përsëritur dhe e shkëputur ajo u shkapërderdh, ushtarakëve u vinte në kokë herë si «fund» e herë si «unë... unë... unëëëëëë. . . .»

I tha këto dhe doli. Ushtarakët, gjithë sa ishin, panë një pelerinë të madhe që u kaloi pranë nxitueshëm...

Kur hyri në karrocë dhe pa ferkun e dritës që po i vijëzonte majat e bjeshkëve, Këshilltari i tha se ishte dita e njëzetekatërt e muajit të tretë, apo dita e katërt e pranverës. Më tutje i tha se detin e kishin larg dy ditë rrugë e edhe një tjetër duhej ta bënin deri te kufiri i Perëndimit. Këshilltari i foli pastaj edhe diçka për ato që lidheshin me formacionet ushtarake që ishin në Liman si dhe qëndrimin e vullnetarëve atje... Por Kryeveziri nuk ia vuri veshin Këshilltarit. I bëri përshtypje e dhëna se ishte dita e katërt e pranverës, e cila mund të quhej edhe dita e njëzetekatërt e muajit të tretë, pra muajit në të cilin thyheshin dy stinët kundërthënëse të vitit: dimri dhe pranvera. Muaj gjysmë-gjysmë tha vetëmeveti... Mezokohë e çuditshme... Shpjeguesi i ëndrrave i kishte thënë se muajt gjysma-gjysma nuk sjellin fat asnjëherë. Bile, po të kishte mundësi, ata do t'i hiqte nga kalendari. Janë të ngatërruar, — i tha Plaku. Janë të ngatërruar keqas sa nuk u dihet kurrë se cila pjesë e tyre është e fatshme dhe cila e pafatshme. Gjithnjë ngjet që diçka e të fatshmes përzihet me të pafatshmen dhe anasjelltas. I erdhi keq që kjo nuk i qe kujtuar kohë më parë për ta shtyrë fushatën ca ditë para apo ca ditë prapa... E, kur drita përfundimisht mundi terrin, Kryeveziri e pyeti Këshilltarin për numrin e të mobilizuarve të sëmurë, të cilët nuk u nisën me eshallonet e rregullta.

— Qenë rreth tetëqind veta, — i tha Këshilltari.

— Ç'ilete kishin?

— Kush nga ethet, kush nga eshtrat, kush nga veremi, e kush nga sëmundjet që s'u dihen as emrat...

— Paskan qenë si shumë?

— Pati edhe më shumë, por kush çau kokën për ata që heqeshin disi. Po t'i shikonim si duhej, gjysma do të na fironte.

Kryeveziri përpak zuri fytyrën me duar. Si të ishte zgjuar nga ndonjë gjumë i rëndë, tha:

— Tetëqind... tetëqind më pak... tetëqind, — po fliste Kryeveziri vetmevete. — Tetëqind...

Pastaj heshti. Heshti edhe Këshilltari, të cilit gjysmëdrita që po mundte errësirën, zuri t'ia cyste mendimet për Perëndimin, apo për atë pikën ku do të fillonte lufta e shenjtë, ajo lufta kaherë e pritur. Kur të fillojë ajo luftë, kishte dëgjuar të flitej sa e sa herë nëpër mbledhje të rëndësishme, do të dridhet toka... Do të dridhet deri në ka të zi... Do të ngrihen re të zeza e do të fluturojnë zogj të zinj... Çfarë nuk kishte dëgjuar. Nga gjithë ato ai krijoi medoemos parafytyrimin e vet për botën e cila një ditë do të mundej. Perëndimi për të ishte një terr i përhershëm, një terr i thellë i vendosur kushedi se kur, në të cilin edhe dielli mashtrohej për të perënduar. Po të mos ishte ajo botë ugurzezë, edhe dielli, i cili ngrihej në lindje, pra në botën e pastër së cilës i takonte, do të rrinte përherë në qiell dhe nuk do të kishte natë. Prandaj, a nuk meritonte urrejtje një botë e tillë e cila rrafsh gjysmën e kohës e mbante diellin peng?... Fjalët e kahmotshme «se lindja do ta mundë atë errësim», i kuptoi si domosdoshmëri që të lahej njëherë e mirë e padrejta ndaj botës, në mënyrë që ajo të ketë vetëm lindje dhe kurrfarë perëndimi. Kjo do të thoshte se nuk do të kishte natë, nuk do të kishte terr, nuk do të kishte pastaj ëndrra gjithfare, të cilat i mundojnë njerëzit vetëm e vetëm pse ekziston e pamira e tillë. Nga ato që dëgjoi vite e vite u bind se Perandoria do të shkojë kah Perëndimi. Ai çast do të vijë patjetër. E paqartë po i bëhej se çfarë do të bëhej me natën. Ku do të mbetej vallë ajo? Mbase edhe ajo do të zhdukej me perëndimin, mendonte dhe ishte e drejtë që edhe ajo të merrte fund me të, nga se Perëndimi ishte pjesë e natës. Po me diellin? Çfarë do bëhej me të? A do të pushonte ai ndonjëherë dhe po qe se njëmend vendoste që ndonjëherë të pushonte, si do të quhej ai vend: Perëndim apo ndryshe? Si shumë herë më parë, iu bë se u kurthua. I shkoi mendja ta pyeste Kryevezirin, për të gjitha, sidomos për atë se a do të shfaqej më vonë ndonjë

Perëndim tjetër për të cilin sërish do të flisnin me aq mllef dhe, a ishte e domosdoshme pastaj që para secilit Perëndim të shfaqej një rrip toke kryeneçe siç ishte Toka e Lashtë? Dhe po qe se do të dilte ndonjë Perëndim tjetër, që mund të quhej edhe ndryshe, a ishte e domosdoshme të vendnumëronin me vite të tëra në atë tokën pararoje, që luftës së shenjtë t'i lejohej gjithçka, që ajo të jetë njëmend e shenjtë? Deshi ta pyeste dhe për ca gjëra të tjera që aq gjatë i ishin sjellë nëpër kokë në formë të një mjegullimi të madh, por pa se tashmë ishte zbardhur dhe një rreze dielli, që herë-herë gjente rrugën deri te fytyra e kryevezirit, i jepte asaj një ashpërsi të frikshme. Një çast ai iu bë aq i mëvrejtur dhe i egër sa kishte bindje se para kishte një të mundur, i cili u gjasonte të tjerëve që nuk ia dolën. Mos, o zot, pëshpëriti Këshilltari, të shoh edhe një disfatë! Vetëm këtë mos ta shoh. Dhe, nëpër kokë i kaluan me shpejtësi të madhe gjithë ato takime të pafundme me kryevezirët (qenë tre para të tanishmit), me ushtarakët e lartë dhe me gjithfarë titullarësh të tjerë, të cilët nuk bisedonin për tjetër pos për Perëndimin dhe për Tokën e Lashtë, që kishte dalë përpara si bjeshkë. Kur do të marrin fund këto biseda, i thoshte vetes. Kur do të fillojë më në fund ajo fushatë . Kur? Kur? Por ajo kurkur nuk kishte të sosur. E përsëritur, i gjasonte një krrokame të thekshme. Përsëritej çdo herë e më shumë bashkë me të njëjtat fjalë, me të njëjtat ankime, me të njëjtat dështime... Dhe në të gjitha ato duhej të përzihej medoemos ajo Toka e Lashtë që nuk jepej. Këshilltari ushtarak pas gjithë atyre bisedave dhe disfatave, të cilat shpesh emërtoheshin «si ngecje të përkohëshme» filloi të mendonte se ai vend ugurzi mbase qe krijuar të jetë vetë kobi i Perandorisë dhe i tij. Mendja ia tha se ai dhe Perandoria kishin thuajse të njëjtin fat: ai i mbyllur në atë rreth të çuditshëm të pritjes së bezdisshme (ku gjithçka ishte e njëjtë) dhe Perandoria e kyçur para Kështjellës së mallkuar. Kur erdhi kryeveziri i ri u hapën fjalë se vendnumërimit të gjatë po i vinte fundi, por ai, as që donte ta çante kokën me ato që për të ishin të pabesueshme. Mbi tridhjetë vjet pritje qenë të bollshme t'ia bënin me dije se gjithçka në këtë botë, në

një fazë të zhvillimit, bëhet e pandryshueshme. I erdhi keq vetëm pse ajo fazë e pandryshueshmërisë erdhi atëherë kur ai priste të ngjante diçka. Por e ngushëlloi mendimi se ca gjëra nuk mund t'i ndryshonin edhe më të fortët; prandaj pse ai robi i vocërr të çante kokën me gjërat e pabesueshme siç ishin ato që thuheshin për Daut Pashën se do ta çonte luftën më tej? Madje, kur pas një kohe dëgjoi lajmin, të cilin mendja ia thoshte se nuk do ta dëgjonte kurrë (se Kështjella e mallkuar qe marrë me përvojën e jashtëzakonshme të Daut Pashait e jo me armë), i shkoi mendja se qe hapur ndonjë lajm i rremë, me të cilin dëshirohej të shkundej letargjia e gjatë që e kishte kapluar prej kohësh Perandorinë e ngujuar. Apo bënte që ishte gjetur ndonjë rrugë tjetër për të shkuar drejt Perëndimit, duke e lënë manash tokën ugurzezë që ajo ta hante veten (ngase sekush kishte thënë se vende të tilla bien vetëm atëherë kur s'ua vë kush veshin!) Megjithatë, kur po bëhej gati fushata e shenjtë dhe kryeveziri i ri i kishte thënë se do ta merrte me vete për të parë mrekullinë e mrekullive (ngase një gëzim të tillë e meritonte), qe shtanguar. Fytyrës së tij të bardhë i kaloi një zjarrmi që provoi t'ia kthente gjallërinë e dikurshme, por hetoi se ishte plakur e forca e kishte lënë më tepër se duhej. Perëndi, ofshami, po ç'jetë boshe që paskam bërë! Fshani edhe për të dytën herë dhe një errësim ia kaploi sytë kur ia pranoi vetes atë që prej shumë kohësh e dinte se duke u marrë me mendimet e huaja e duke ua përgatitur ato të mëdhenjve, kishte kaluar një jetë shterpë, pa lënë as më të voglën gjurmë... Vonë është, vonë është, tha... Edhe njëqind fushata të shenjta nuk ma ngrohin më zemrën... Vonë është... Edhe njëqind fitore nuk më bëjnë të gëzohem... Vonë është... vonë, tha dhe vërejti se po e mashtronte gjumi. Ndoshta do të flinte, por kur po bëhej gati t'i jepej gjumit që po i sillej në sy, e tronditi një çjerrje e thekshme. Shikoi nga Kryeveziri dhe e pa atë të mbytur në djersë.

— Ndihmë! Ndihmë! Ndihmëëëëë, — po thoshte ai.

Çirrej e çirrej dhe shtrëngonte fytin me të dyja duart. Pa menduar fare kapi bucelën e ujit dhe ia përplasi.

E zuri me të dyja duart dhe po e trumbazte si të dëshironte t'ia largonte sa më parë të ligën që i kishte hyrë në trup. Nuk vonoi e Kryeveziri u qetësua. Ato duar, që pak më parë mbërthenin qafën, tash dukeshin të lodhura. Edhe unazat e shumta në to nuk e kishin më shkëlqimin e pakmëparshëm.

Pas pak Kryeveziri tha:

— *Çfarë ngjau me mua, vallë?*[1])

Këshilltari mbeti i shtangur. Nuk e kishte të qartë se kujt ia shtronte atë pyetje Kryeveziri. U mat t'i thoshte se po ecnin në karrocë që nga mesnata dhe se kishte fjetur i qetë prej çastit kur ferku i dritës ishte dukur në majat e maleve, e vetë ishte marrë me disa përsiatje të kota, sa për të kaluar kohën disi... Deshi t'ia tregonte të gjitha për të cilat kishte vrarë mendjen dhe t'ia bënte me dije se ajo që thuhej për fushatën kah Perëndimi ishte vetëm një mashtrim dhe hiçgjë tjetër. Por, si gjithnjë, nuk pati forcë që për ato që mendonte në heshtje të thellë të fliste sheshazi. Kjo lidhej me atë që ai tashmë e quante mënyrë të jetës së tij, të dëgjonte çka thoshin të tjerët pa pasur mundësi që ta thoshte haptas mendimin e vet...

Sikur t'ia kuptonte dilemat, Kryeveziri e shikoi butësisht, u mbështet shkujdesshëm në pjesën e prapme të karrocës dhe i tha ta zgjonte kur të binte terri.

(Shënimi plotësues i Kullës)

1) *Çfarë ngjau me mua vallë:* Këtë pyetje ia shtroi Kryeveziri vetes pas një mundimi të madh që në të vërtetë ai nuk e dinte se fjala ishte për ndeshjen e rreptë midis dy qenieve brenda për brenda tij... Ç'është e vërteta, pas pesëmbëdhjetë vjetësh shërbimi të besueshëm në fronin më të lartë të Perandorisë, kur në sajë të tij jo vetëm që u hap rruga kah Perëndimi, por u përsosën ca nga metodat për nënshtrimin e plangprishësve nëpër vendet ugurzeza siç ishte Toka e Lashtë, qenia e tij e r i f o r m u a r dhe p r o g r a m u a r nga shërbimet tona, zuri të shqetësohej. Ishte

më se e qartë se e ashtuquajtura v e t ë d i j e e v j e t ë r apo ajo e m i r ë f i l l t a prej kështjellarit, po i kthehej, në fillim në formë të një shqetësimi ngërthyes e më vonë si kacafytje e drejtpërdrejtë dhe e fuqishme, gjë që zuri t'i vinte në dyshim bindjet e Kullës për epërsinë e padiskutueshme të qenies së re, pra të asaj të programuarës ndaj qenies së dikurshme, për të cilën ne tashmë mendonim se kur shlyhet një herë, nuk mund të përsëritet më. Bile, jo vetëm që nuk përsëritet, por ai që jeton me qenësinë e r i p r o g r a m u a r kthehet në urrejtës të jashtëzakonshëm të vetvetes.

Atë natë kur po bëheshin hapat e fundit dhe vendimtarët drejt sendërtimit të plotë të programit të Kryevezirit për p a s t r i m i n e plotë të Tokës së Lashtë (në mënyrë që lufta e shenjtë kah Perëndimi të bëhej pa kurrfarë telashesh dhe pa drojë se do të pengohej nga ndonjë kryeneçësi e papritur), e kur vullnetarët ishin në rrugë kah deti, vetëdija e vjetër (ajo e dikurshmja, e shlyer rrënjësisht nga shërbimet tona) zuri ta shqetësonte V e t ë d i j e n e r e...

E gjithë kjo ngjau kështu:

Kryeveziri (siç e përcollën nga fillimi e deri në mbarim pasi ishte krijesë jona), pati shqetësime të herpashershme. Megjithatë, ne nuk dyshonim në pjellën tonë, por mendonim se fjala ishte për ndonjë lodhje të vogël, e cila duhet të jetë pjesë përbërëse edhe e qenieve të programuara. Por, ne nuk pritnim se pas shumë e shumë rezultatesh tejet të mira, siç dha eksperimenti i quajtur Daut Pashai, do të kërcënohej në atë masë sa një çast të shembej në tërësi.

Atë natë, pasi i masakruan ata tre veta (që u zunë duke folur kundër mobilizimit ushtarak dhe shkuarjes së vullnetarëve kah deti), koka e tij u turbullua dukshëm. Së pari qenë tri hije të gjata që u sollën në shesh, që më vonë iu sulën atij dhe çuditërisht po i qartësoheshin si të njohura... Ky pra ishte filli i fillimit të lidhjes së fillit kah filli i fillimit apo çastet e

para të shpërthimit në syprinë të vetëdijes së mirëfilltë, për të cilën ne ishim të bindur se nuk mund të rilidhej, ngase pesëmbëdhjetë vjetëve të shkuara nuk ishte manifestuar me çfarëdo shenje. Përkundrazi, kështjellari i dikurshëm e pashai i mëvonshëm, që u bë edhe Kryevezir, dha njëmijë e një dëshmi se është kundër rrënjës e trungut të vet të mirëfilltë. Ai bëri aso masakrash mbi sojin e vet sa edhe urrejtësit më të mëdhenj nuk do të bënin ato që bëri ai... Por ç'e do që si eksperiment nuk qe i përkryer. Me një fjalë kështjellari i dikurshëm hetoi tre kështjellarët dhe ky hetim u bë shkallë shkallë: së pari pa tre veta duke u sorollatur në shesh (që në të vërtetë atij po i shfaqej si sheshi i kuvendit të Kështjellës):... Në sjelljet e tyre hetoi një lojë që po e njihte prej dikah por që nga mjegullimi i vetëdijes së mirëfilltë me atë të renë, pra me anën, nuk ia mundësonte që t'i rikujtonte ato që i qenë shlyer me dhunë. Hove-hove i bëhej se përpara kishte njerëz të njohur, por që shpejt i bëheshin të panjohur. Kështu, një kohë të gjatë procesi i shndërrimit nga njera gjendje në tjetrën ia nxirrte përpara gjërat, sendet dhe njerëzit me një kundërthënshmëri të çuditshme. Komisioni mendon se ndryshimi më qenësor ngjau kur ai zuri të dëgjonte ca fjalë të një gjuhe që pak nga pak po i dukej e njohur. Në të vërtetë, ne hetuam se koka ia kapte ca tingujt apo ca fjalë që i bëhej se i thoshin ata të tre që i masakruan në shesh. Ajo tingëllimë vetëtimthi merrte një kuptim të njëmendët e po ashtu vetëtimthi i tretej. Gjendja, ku gjërat çuditërisht i vinin herë ashtu e herë kështu, pra një çast i urrente dhe po atë çast i ndjente të afërta, kur diçka aty për aty e ngashërente dhe po aq shpejt e neveriste, e shthuri dukshëm. Kapërcimet prej një gjendjeje në një tjetër (dashuri-urrejtje, urrejtje-dashuri) e çorientuan fare sa ai në një çast hutie e zhgënjimi tha:

«Çfarë po ngjet me mua kështu vallë?»

P.S.

Për ne ky ishte çast zhgënjimi dhe dëshpërimi të thellë ngase e patëm të qartë se eksperimenti ynë i parë i këtij lloj i cili ishte në udhë të mirë dhe që u hapte udhën të tjerëve, dështoi... Ç'është më keq, dështimi erdhi në çastin kur ne pritnim që të kryhej në tërësi programi dhe kështu të fillonim fazën tjetër, atë të programimeve masive. Nuk na kishte mbetur edhe shumë që ta shpallnim punën tonë shumëvjeçare të kryer dhe të suksesshme. Na ndante vetëm një hap deri te kjo. Ah, vetëm një hap, pra, ta kalonim edhe Limanin dhe gjithçka do të ishte e përkryer. Çdo gjë, medet?

— Po shoh një botë tjetër... Po shoh diçka tjetër, — foli Kryeveziri gjithë shqetësim.

Këshilltari nuk e dinte me tamam se në ç'gjendje po i fliste ato Kryeveziri, ngase ai rrinte i shtrirë dhe me sy të mbyllur. Megjithatë, hetoi se ishte koha ta zgjonte dhe t'i thoshte se duhej që ta shihte detin dhe atë pikën kaherë të ëndërruar që ndante Lindjen me Perëndimin.

Kryeveziri përsëriti të njëjtat fjalë për atë botën tjetër edhe kur Këshilltari e preku lehtë-lehtë dhe i tha se detin e kishin përpara.

— Ajo botë... ah, ajo botë... — thoshte Pashai pa ia ndarë dhe i fërkonte sytë sikur të dëshironte që ta hiqte perden që i rrinte në mes asaj që e shihte dhe tjetrës që e kishte përpara.

— Po çfarë bote na qenka ajo, Madhëri? — e pyeti Këshilltari përulësisht më shumë për t'ia larguar terslläkun, sesa për të kuptuar se ç'ishin ato që shihte ai. Tekefundit ai nuk kishte kurrfarë të drejte që të dinte çkadoqoftë nga bota e të mëdhenjve.

Kryeveziri dukej se matej t'i thoshte diçka Këshilltarit, por shpejt e kuptoi se as vetë nuk i kishte të qarta gjithë ato që po e mundonin. A mjaftonte t'i thoshte që po e përcillnin ca klithje që herë i bëhej se i kuptonte e herë i bëhej se nuk i kuptonte fare? Pas një rropatjeje, tha mundimshëm:

— Njëfarë errësire s'po më hiqet...

— Paj, terr u bë. Kaherë ka perënduar. Ka kohë që terri ka pushtuar gjithçka. Në Liman tash janë ndezur dritat... Pastaj, Madhëri, mos harroni se para kemi botën e territ, atë botë që pret ta zbardhëllojmë... Ju i shihni gjërat ndryshe, më thellë dhe më larg... Është e natyrshme që juve ju mundojnë ato që ne të tjerët as që mund t'i vërejmë... Prandaj, mendja juaj e ndritur me të drejtë ngushtohet, por ajo gjithçkahes i jep udhë, në ndryshim prej tonës që mbetet në të...

Kryeveziri pastaj një copë herë përcolli drejtimin e dorës së Këshilltarit dhe dëgjoi fjalët për Limanin që do të shihnin.

— Atje kanë arritur vullnetarët dhe të mobilizuarit, po i thoshte Kështjellari, me një zë aq të butë që atij po i dukej si vajtim. Atje janë rreshtuar që të gjithë dhe presin që të fillojë ajo lufta e shenjtë... Ah, ç'luftë që do të jetë! Do të jetë e jashtëzakonshme, e jashtëzakonshme...

Këshilltari i tha edhe diçka për luftën e shenjtë dhe për vullnetarët në Liman, por Kryevezirit sërish iu shfaq ai farë mjegullimi dhe kështjellarët në të. Tashmë i bëhej se i kishte pranë, fare pranë. Të tre mbanin kokat në duar dhe ia tregonin të prera. Kokat, megjithatë, kishin jetë. Ato lëviznin sytë dhe qitnin gjuhët jashtë. E shikonin vëngër dhe dukej se i thoshin diçka. Dhe sa më shumë që thoshin, kokat i shumoheshin. Një çast, ato iu bënë shumë, shumë sosh që rreshtoheshin dhe shkonin duke u rrokullisur kah deti. Iu bë se kokat e morën me vete. Rrokullisej me to tatëpjetë kodrinës për në Liman. Dhe sapo arritën në Liman mbi kokat u vërsulën mijëra e mijëra shpata. Nga të gjitha anët shpata dhe thika që nguliteshin mbi kokat, të cilat nuk bënin vër më gojë... Shpatat dhe thikat vinin edhe nga Kështjella, edhe nga sheshi, edhe nga kodrina edhe nga deti... Ngado shihte gjak dhe ngado dëgjonte fjalët: «Lufta e shenjtë! Lufta e shenjtë! Filloi lufta e shenjtë!»... Kokat nuk po rrokulliseshin më. Të gjitha kishin nga një shpatë të ngulitur dhe kullonin gjak, që ai e shihte të zi. Gjaku i zi shkonte kah deti... Kur ngriti kokën pa se edhe kështjella ishte e mbytur në gjak, e gjithë gjak ishte edhe sheshi i vo-

gël që soste në det... Hetoi se po zhytej në atë gjak. Një kokë, nga ato mijëra e mijëra të prerat, po i thoshte:

«Kjo është vdekja jote... a, nuk e pate të qartë se po i shërbeje vdekjes sate?... kjo është vdekja jote...»

Kur u lirua nga ankthi, Kryeveziri klithi me sa zë kishte:

— Po i shoh kështjellarët në Liman! Dikush po na vret! Dikush po na vret! Dikush po na vret!...

Ende po çirrej me fjalët «dikush po na vret, dikush po na vret», kur në karrocë u futën dy vetë, që iu dukën pikërisht se ishin nga ata që bënë masakër në Liman. U pa të njëjtat shpata që u nguleshin kokave. Bile iu bë se në to kishte gjak, gjak të freskët, nga ai që shkonte rrëke deri në det. I erdhi mirë që shpatat po i afroheshin. Çuditërisht dëshironte sa më parë që edhe koka e tij t'u bashkohej kokave të tjera në Liman. Dhe kur më në fund shpatat ia çanë kraharorin tejpërtej dhe gjaku i shkoi çurg, ndjeu se u lirua përfundimisht nga mjegullimi i gjatë që e kishte zhveshur nga vetvetja. Po lirohej nga ajo qenia tjetër, e huaja...

Mendimi i fundit që i përftoi në kokë qe ai se jetën mund ta bëje të huaj, por vdekjen jo...

Këshilltari u tmerrua kur pa sesi ai që po vdiste tash me shpatë në krahëror nuk ishte Kryeveziri, por një tjetër. Bile, iu bë se para kishte njërin nga ata tre kështjellarët që ua prenë gjuhët dhe i verbuan para se të niseshin drejt Perëndimit...

Deshi të thoshte diçka për ta mundur habinë, por edhe atij një shpatë, që i erdhi nga prapa, si ajo që pak më parë gjeti kraharorin e Kryevezirit, iu ngul pamëshirshëm. Ia la në gjysmë ato që po bëhej gati t'i thoshte...

Ja kështu, o Flamurtar, kur i rashë në fund librit të Kullës së harresës, Shpjeguesi i ëndrrave më tha:

«Nuk është kjo e tëra...»

A thua mund të kishte diçka tjetër më të rëndë? Heshta dhe fare nuk munda ta merrja veten. E Plaku po më thoshte:

«Ndodhën gjëra të jashtëzakonshme...»

«Asgjë nuk më kujtohet. Asgjë.»

«As Xhavit Agai?»

«As ai».

«E pate dorë të djathtë».

«Mbase»?

«Ai e bëri masakrën në Liman. E bëri me urdhërin tënd, e së fundi u çmend... E zuri lumi i gjakut që rrodhi nga Limani... I pate thënë që të mbante ditar sekret. Këtë e bëri si duhet...»

Unë prapë heshta! Koka më digjte nga ato që dëgjoja, e Shpjeguesi i ëndrrave qeshte thartë. Pa ia da më thoshte se Xhavit Agai ishte pjellë imja, siç isha unë pjellë e Kullës së harresës, M'i tha këto dhe iku duke ma lënë në dorë një fletore të lidhur me një fjong të zi me të cilin u mora shumë e shumë kohë...

(Ditari sekret i Xhavit Agait, mbi patrimin e Tokës së lashtë nga armiqtë e perandorisë, i shkruar nga mesi i muajit të dytë deri në mesin e muajit të pestë të vitit që duhet të ishte vendimtar).

Faqe 1

Dita e parë e aksionit:
Diku në front... Koha me vranësira... Ende ka borë...
Rrebelët i kemi rrethuar nga veriu dhe jug-lindja. Sipas të dhënave që na sollën hafijet tona, të cilat ka kohë që i kemi futur në të gjitha anët, janë mbi dy mijë veta të armatosur mirë. U mblodhën me të dëgjuar urdhrin se ushtria u nis drejt rrafshnaltës dhe u shpall gjendja e jashtëzakonshme bashkë me shtetrrethimin.
Pa mëdyshje, të gjithë janë agjentë të Perëndimit.
Në mesditë filloi lufta. Rrebelët u tërhoqën me të shpejtë. Ne i ndoqëm hap pas hapi. Kur u err, ikën kah bjeshka. Në rrafshnaltë dëgjonim të lehurat e qenëve dhe ndonjë zog të zi, nga ata që këndej ka shumë dhe bredhin natën.
Humbjet tona: dy të vrarë e tridhjetë e dy të plagosur.

Humbjet e armikut: katërmbëdhjetë të vrarë e njëzet e tre të plagosur.
Xhavit Agai, d.v.
P.s.
1. Oficerët kërkonin që të vendoseshin nëpër kullat e tyre dhe aty ta shtronin ahengun. Kjo duhet bërë edhe për një arsye, më thanë, — që t'i fyejmë dhe t'i nënçmojmë... Sado që kjo më pëlqeu, nuk lejova që të shpërndaheshin nëpër kullat e tyre nga droja se mund të na i kthenin armët papritmas. Uji fle e hasmi nuk fle...
2. Urdhërova që të ndezej një zjarr i madh. Oficerëve u thashë që ushtarët të këndojnë e të argëtohen...

Faqe 2

Dita e dytë e aksionit
Diku në front... gjurmëve të rrebeleve të ikur.
Ushtrinë e shpërndava kështu: dy brigada pas rrebelëve, një nëpër fshatrat malore dhe një brigadë në zonën e pastrimit, Njësitë e posaçme, ato elite dhe të ushtruara mirë për sulme të jashtëzakonshme mbetën në prapavijë.
Dy brigadat sulmuese zhvilluan luftime të rrepta me rrebelët, por u detyruan të tërhiqeshin pasi terreni ishte i papërshtatshëm dhe fare i panjohur për ne. Urdhërova që ca nga hafijet të depërtonin gjithsesi në hapësirën në të cilën rrebelët e ndjenin veten mirë. U thashë të merrnin shënime për numrin e vërtetë të tyre, pasi gjykuar sipas qëndresës që na bënë, ata duhet të jenë shumë, shumë më shumë se ç'mendojmë.
Brigada e zonës së pastrimit filloi të veprojë në dhjetë fshatra. U bënë bastisje të përgjithshme. (Në çdo shtëpi hynë me forcë. Pushkatuan dymbëdhjetë veta (pati edhe fëmijë dhe tri gra që nuk iu nënshtruan urdhërit ushtarak). U gjetën të vrarë edhe katër veta... Edhe në prapavijë njësitë e posaçme, pra elitet, vepruan sipas urdhrit të marrë. Kërkuan me lista armiqtë e kahershëm të Perandorisë, të cilët kishin vepruar gjatë kundër interesave tona. Me emra dhe mbiemra i thirrën të dorëzoheshin ata që në çfarëdo mënyre kishin

pasë lidhje me kryengritësit dhe me Kështjellën. Ua dogjën gjashtë shtëpi armiqve më të njohur, pesë veta i vranë dhe një mbeti i plagosur në mal.
Komandantët i përgëzova për efikasitet.
Humbjet e armikut: mbi gjashtëdhjetë të vrarë.
Humbjet tona: një i vrarë e një i plagosur lehtë.
Xhavit Agai, d.v.

P.S.

Natën e dytë hapëm tendat. Do të presim edhe pak u thashë oficerëve që t'u futemi nëpër kulla dhe t'i poshtrojmë deri në pikë të fundit. Urdhërova që të bien çallgitë. Në disa vende ndezëm zjarre të mëdha dhe vumë në hell pesë viça që i morëm në një shtëpi të djegur... Megjithatë, pas mesnatës, kur ushtarët tanë të ushqyer mirë i mashtroi gjumi, në pjesën veriore, rrebelët na i sulmuan dy tendat dhe na i vranë dymbëdhjetë ushtarë... E gjithë kjo u bë thuajse pa ditur kush gjë. Në mëngjes, kur dhashë urdhër që ushtria të nisej në aksion, oficeri i sigurimit erdhi i zverdhur dhe më tha gjithë shqetësim:
— Ka ndodhur një hata!
— Ç'hata?
— Ushtarët tanë të therur në fyt...
Pastaj më tregoi me lot në sy sesi në dy tendat e skajshme u futën rrebelët dhe i therën në fyt një nga një ata që i gjetën aty dhe ua morën kokat. Nxitova dhe mend plasa nga zemërimi. Tendat ishin plot gjak. O, zot, thashë, ç'hata e madhe do të bjerë mbi këtë vend tash e tutje. Dhe, aty për aty urdhërova katër brigadat të niseshin për një aksion ndëshkimor.
— Mos kurseni as burrë, as plak, as fëmijë, e as grua, — u thashë.

Faqe 3

Dita e katër e aksionit:
Diku në front... Bën të ftohtë. Veprimi: dy brigada pas rre-

belëve, një nëpër fshatrat malorë, një në zonën e pastrimit dhe, si rëndom, njësitë e posaçme në prapavijë.
Ditën e filluam me nderimin që u bëmë dymbëdhjetë martirëve tanë që na i vranë rrebelët në pabesi. Urdhërova hetime të posaçme, e po ashtu urdhërova që të merrej vesh se mos vallë rrebelët kishin me vete farë njësish diversante të futura nga jashtë. Të gjitha njësive u thashë që të mos kenë mëshirë fare. Ushtarët tanë duhen paguar njëqindfish.
Sërish filloi të bjerë borë. Rrebelët shfaqeshin në grupe të vogla dhe bënin sulme të befasishme, gjë që nuk qiti telashe të shumta. Kah mesdita urdhërova që frontin ta zgjeronim sa më tepër dhe si i tillë të mbahej në drejtim të bjeshkëve. Mendja ma thoshte se ata nuk kanë nga t'ia mbajnë tjetër pos të kërkojnë strehim në bjeshkë. Aty do t'i fusim në një kurth të madh prej nga nuk do të dalin dot. Oficerëve u thashë që me njësitë e tyre të përgjojnë në çdo kasolle, në çdo gur, në çdo dru, në çdo shpellë... U thashë se rrebelët i kemi në grusht. Tash ose kurrë...
Humbjet e armikut: katër të vrarë e tre të plagosur.
Humbjet tona: gjashtëmbëdhjetë të vrare.
Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Në mbrëmje thirra oficerët që udhëhiqnin katër brigadat. U fola rreptë. Dje, u thashë, lamë shumë të vrarë, sot po ashtu, gjashtëmbëdhjetë. Humbjet tona po na rriten e të atyre po pakësohen. Si është e mundur kjo?
Ata më shikuan me sy përdhe dhe më thanë se ata patjetër kishin përkrahës të huaj, që i mësonin si të vepronin. Është e pabesueshme, më tha oficeri i njësitit të posaçëm, që ngado të futemi ne e gjejmë shkretë. Shtëpitë janë të braktisura, stallat e zbrazëta, hambarët e boshatisur! Këtë nuk po e kuptoj. Ku flenë ata? Ku strehohen? Këtë duhet ta dimë në mënyrë që të veprojmë me kohë dhe si duhet...
Edhe komandanti i njësitit ndëshkimor më tha thuajse të njëjtat fjalë. M'u ankua se në të gjithë zonën e paraparë për ndëshkim takoi vetëm një plak të verbër dhe ca gomarë të shkallmuar që nuk ishin për asgjë. Kur e pyeta plakun se ku ishin të tjerët, ai më tha mospërfillshëm: unë nuk shoh...

a s'e shihni që nuk shoh? Por, dëgjova se ka rënë mordja... Thonin se kush ka këmbë e sy duhet të ikë sa më parë... Ç'farë mordje, ore i thashë? Mordje nuk ka as këtu e as gjëkundi. E ai sërish më tha se po qe se vendi është shkretëruar, e këtë e hetonte edhe ai që nuk kishte sy, atëherë u duhej besuar fjalëve për mordjen. Dhe ti beson se njëmend ka mordje, e pyeta plakun? Po, më tha ai. Besoj se ka mordje. Si t'ia bëja me atë kukuban që fliste ashtu pos ta vrisja? Tek e fundit ç'ditë është ajo këtu në të cilën njeriu nuk vret gjë

Urdhërova që brigada e ndëshkimeve dhe ajo specialja të zgjeronin zonat e operimit, nga veriu e nga jugu, dhe secila të shkonte në drejtimin e kundër sa më thellë. Prej tashit, u thashë komandantëve, duhet të veproni si të pavarur. Lidhjet do t'i mbajmë të rregullta me anën e korrierëve. Bashkë me shtabin operativ të komandës, vendosa të mbetem me brigadat ndjekëse, që kishin të bënin me rebelët, të cilët shkonin kah bjeshka.

Faqe 4

Dita e shtatë e aksionit.

Pozicioni ynë: pika 33 në bjeshkë. Bën të ftohtë. Një fërfëllizë po na përcjell pareshtur. Bora sa vjen e shtohet ndërsa edhe ngrica është gjithnjë më e madhe.

Rrebelët vazhdojnë të na sulmojnë nga e djathta dhe nga e majta, gjithnjë pabesisht. Gjatë dy ditëve të fundit humbjet i patëm të vogla, por nuk zumë e as nuk vramë asnjë rrebel. Nga terreni njoftimet janë diçka më të mira; brigada ndëshkuese thuajse e pastroi zonën e vet. Shifrat inkurajojnë: njëqind e njëzet të vrarë. Humbjet tona tejet të vogla: dy të vrarë, një i plagosur dhe një i zhdukur. Njësia speciale po ka telashe, por as rezultatet e saj nuk duhet të nënçmohen: 76 të vrarë, 12 të plagosur e 143 të arrestuar, të cilët shpejt do të dënohen me vdekje. Njësia speciale po përdor metodat e njohura të thyerjes së eshtrave, të prerjes së gjinjve, në mënyrë që edhe ato që shpëtojnë të mbesin shterpa...

Xhavit Agai, d.v.

P.S.
Mbrëmë nuk e di pse mendova për urrejtjen...

Faqe 5

Dita e dhjetë e aksionit.
Pozicioni ynë: pika 43. Bora nuk ka të ndalur. Fërfëlliza është tërbuar. Nga tenda ime shoh një bardhësi të pafund. Oficerët më thonë se më tutje nuk bën të shkohet. Do të ngrihemi me çka kemi. Duhet parë se çfarë mund të fitojmë e çfarë mund të humbim?
U thashë se do të ecim e do të ecim përpara përderisa të mallkuarit t'i zëmë. Po qe se ne ngrihemi një herë, armiqtë tanë do të ngrihen dhjetë herë... Njëri prej tyre më tha se nuk duhet harruar se rrebelët janë fodullë. Janë mësuar me këtë mot. Njeriu i gazepit nuk jepet lehtë. Edhe ne duhet të mësohemi me të gjitha, i thashë. Nuk na thotë kot Perandori. Tash, që i kemi në grusht dhe i kemi zënë pisk, duhet të shkojmë deri në fund. Tash ose kurrë... Tash ose kurrë.. Të presim pranverën, më thanë oficerët. Kur të vijë ajo mund t'i ndjekim këmba këmbës? Një zot e di se a mund të dalin fare në pranverë po i mbajtëm të mbërthyer në këtë borë pa ushqime... Këtyre nuk u besoj. Vetëm dimri, ky dimër kijamet, mund të na ndihmojë t'i asgjesojmë. Po dolën në pranverë, bëhen të pathyeshëm. Këtë dimër nuk duhet ta kalojnë, thashë.
Nga terreni ka ditë që nuk marr lajme. Por, siç hetuan vëzhguesit nga pikat 23, 27 dhe 33 në zonën e ndëshkimit u vërejtën zjarre të shumta
Ai tym ma nxehu shpirtin.
Humbjet tona gjatë katër ditëve të fundit: dy të vrarë në një pusi të largët dhe një i mërdhirë.
Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Pa urrejtje njeriu nuk është njeri e shteti nuk është shtet. Po shtazët a e kanë të zhvilluar një instikt të tillë?

Faqe 6

Dita e pesëmbëdhjetë e aksionit.

Pozicioni ynë kuota 51. Para nesh bjeshka dhe bora. Drunjtë janë të rrallë. Gjithçka është e zbrazur dhe e zhveshur. Rrebelëve nuk po u shihen gjurmët. Thuajse i ka lëshuar toka. Oficerët parreshtur hamenden dhe thonë se është e pamundur që t'i kemi para. E unë i them se i kemi para, se për këtë nuk bën të mëdyshemi fare. Por, si t'i besojmë kësaj kur ata janë bërë të paqenë? Si? A ka të ngjarë që janë kthyer në njerëz të borës?

Edhe mua kanë zënë të më mundojnë dilema të tilla. Por nuk dua t'ia pranoj as vetes se mund të jetë ndryshe. Sapo zë të luhatem ngrihet urrejtja ime dhe më thotë: behari do t'i gjejë kufomat...

Nga zona operative mora lajme të mira: njësia speciale e kishte pastruar hapësirën e paraparë dhe kaloi në pjesën jugore...

Brigada e ndëshkimeve po ecën pak më ngadalë. Edhe pse ka humbje detyrat po i kryen sipas planit. Duhet pritur që edhe ajo brenda tri ditësh ta pastrojë zonën e vet dhe të niset kah lindja, në mënyrë që të bashkohet me brigadën plotësuese në sektorin qendror... Lajmëtari më tha se aty-këtu kanë zënë të shfaqen njësi të vogla të rrebelëve që po i sulmojnë brigadat që gjenden në terren. Sulmojnë natën dhe në pabesi. Gjithçka e tyre është tinëzare...

Xhavit Agai, d.v.

P.S.

A mund të shuhet ndonjëherë urrejtja?

Faqe 7

Dita e njëzet e aksionit.

Pozicioni ynë kuota 52. Më lutje nuk mund të shkohet. Bora është gjithnjë më e madhe. Acari i padurueshëm. Gjatë tri ditëve të fundit nuk bëmë asnjë hap para. Me zemër të thyer dhashë urdhër që të presim mot më të mirë. Edhe vëzhguesit e kanë pisk. Sorollaten afër tendave dhe ngujohen në borë. Oficerët gjithë dëshpërim kërkojnë që ta shtyjmë rrethimin. Nuk ka kthim prapa, u thashë... Atë natë ra një borë edhe më e madhe dhe na ngujoi me çka kishim.

Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Për herë të parë zura të mendoj për ngujimin. Paska gjëra edhe më të forta se Perandoria, mendova dhe më erdhi keq që, diku-diku, pushtcti i njeriut është fare i vogël, apo fare i pavërejtshëm... Kjo më dëshpëroi aq shumë sa gjithë natën mbi mendimet e mia reshi borë...

Faqe 8

Dita e njëzet e shtatë e aksionit.
Pozicioni i njëjtë. Bora nuk ka të ndalur. Jemi shkëputur nga bota. Megjithatë, mbrëmë na ngjau një e papritur e madhe. Rrebelët iu afruan tendave anësore dhe tri sosh na i shkatërruan. Vranë 17 veta dhe dy i plagosën rëndë. Kur u zgjuam nuk i pamë më tendat. Menduam se i kishte rrafshuar bora, por shpejt kuptuam të ligën që nuk do të na e merrte mendja kurrën e kurrës. Me të shpejtë mblodha shtabin për ta shoshitur mirë e mirë si ndodhi masakra e tmerrshme kur as zog e as njeri në këtë hapësirë nuk ka mundësi të bëjë një hap të vetëm? Vëzhguesit erdhën te përfundimi se rrebelët këtë e kishin pritur dhe se kishin shfrytëzuar ca thupra në formë rrethi të thurura që i mbanin në këmbë. Me to ecin lehtë dhe pa lënë gjurmë. Këtë nuk e kemi ditur. Ka gjasa se ata tash e tutje do të na sulmojnë pareshtur. Prandaj, urdhërova forcimin e rojeve dhe dyfishimin e tyre në disa pika. Gjatë bisedave hetova se oficerët ishin të dëshpëruar. Nuk thanë se duhej të ktheheshin pas, por nga qëndrimi i tyre hetohej frika se shumë prej nesh do të mbeteshin përgjithmonë në këtë humbëtirë. Për herë të parë u fola për misionin tonë tejet të rëndësishëm, që mund të ketë jehonë të madhe për strategjinë ushtarake të Perandorisë. Ata më dëgjonin të heshtur dhe e dinin që ato që i thosha nuk ishin gjë tjetër pos fjalë me të cilat i ngushëlloja ata dhe veten...
Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Robi i Allahut nuk bën të dëshpërohet kurrë.;. Robi i Alla-

hut duhet të shpresojë gjithnjë... Nuk bën të jepet edhe kur e ka ngushtë... Nuk bën të jepet kurrnjëherë... Por, si të përballohet ndjenja e frikës në rrethana të tilla? Si? Si?...

Faqe 9

Dita e tridhjetë e aksionit.
Bora pushoi, por ende bën të ftohtë. Dielli zuri të duket kah Lindja. Pranvera po vjen, por në këtë lartësi ajo arrin më vonë se gjetiu. E shikova gjatë majën e bjeshkës dhe sërish po mendoja si ta rrethoj atë majë për t'i zënë një nga një ata që na qitën aq shumë telashe. Shikimi im kërkoi diçka nëpër atë bardhësi, por mbeti i ngrirë. Dikur vërejta se një tufë zogjsh shkuan kah maja. Ishte kjo shenjë e mirë se acari, i cili më poshtë moti ishte thyer, tash edhe këtu po jepej... Më në fund, pas shumë e shumë ditësh, nga zona e operimit morëm lajmet e pritura. Lajmëtari, që u kthye pas shumë e shumë mundimesh më tha se poshtë të gjithë ishin brengosur për ne. Mendonin se ngrimë. Kuptova se brigada e ndëshkimeve ka telashe të mëdha. Rebelët gjenden kudo. Të shpërndarë në grupe të vogla sulmojnë pareshtur. Fshatrat janë të zbrazët.
Mendova e çmendova dhe korrierit që nisa për në zonat e operimit, ia dhashë me vete një shkresë-urdhërese për të gjitha njësitë tona që të fillojnë fushatën e madhe të pastrimit, ngase isha i bindur se kryeneçësia e tyre ishte shndërruar në një rebelim të përgjithshëm. Po s'e shuam këtë kryengritje, fushata e shenjtë kah Perëndimi do të dështojë...
Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Po s'e pushtove majën, maja bie mbi ty...

Faqe 10

Dita e tridhjetë e vestë e aksionit.
Në të njëjtën pikë. Moti po zbutet. Bora po shkrihet. Nga lartësia jonë shihen shenjat e beharit në Rrafsh.

Oficerëve u thashë të gatiteshin pasi po afrohej çasti i sulmit përfundimtar. Rebelët, u thashë, do të bëjnë çmos ta çajnë rrethimin ngase e dinë se çfarë i pret. Oficerët nuk u ngazëllyen nga fjalët e mia. Shumë nga ata e kanë humbur shpresën se nga ngarendja jonë do të dalë gjë. Bora dhe ngrica me të cilën shumë prej tyre nuk ishin mësuar, i kishte bërë të pashpresë. Te disa një ngujim i tillë kishte ngjallur aso dëshpërimi sa kishin humbur dëshirën edhe për të folur... Këtyre njerëzve, mendova, u duhet gjak, shumë gjak që të ringjallen. Vetëm gjaku shëron nga dëshpërimi dhe ndjenja e inferioritetit dhe zymtia shpirtërore... Nga zonat e operimit mora lajme se gjendja nuk është gjithaq e kënaqshme, siç është pritur. Brigada ndëshkuese dhe ajo e njësive specifike sillen kotnasikoti, sepse fshatrat janë të zbrazët. Hafijet bëjnë të ditur se rrebelët do të organizohen sa më mirë që pranverën ta shfrytëzojnë për të na sulmuar dhe për të na mbajtur të ngujuar. Urdhërova që vëzhguesit të shkojnë kah maja.
Xhavit Agai, d.v.
Ç'është disfata, vallë?

Faqe 11

Dita e gjashtëdhjetë e aksionit.
Pika e njëjtë. Bora ka sharruar. Së shpejti do të nisemi kah maja. Urdhërova të bëhen të gjitha përgatitjet e duhura që në çastin vendimtar të mos na dalin telashe të papritura. Vumë kurthe të shumta.. Megjithatë, humbëm shumë kohë duke u përgatitur. Ushtria e mërdhirë kërkonte të lëvizte e ta shkundte njëherë e mirë ngricën që i ishte futur në palcë. Këtë mund ta bënte vetëm kur të futej në luftë. Luftën tash e dëshironte më tepër se çdo gjë. Por, si ta bënim atë luftë kur ata me të cilët duhej të ndesheshim, nuk i kishim? Na iknin dhe na sulmonin tinëzisht. A thua këtë herë do t'ia dalin që të na mashtrojnë?
Ky mendim më frikësoi. Për herë të parë hetova praninë e diçkahes që mund të jetë e kobshme jo vetëm për mua, por edhe për mbarë Perandorinë. M'u bë se po më tingëllonin

kërcënueshëm fjalët e Kryevezirit: tash ose kurrë. tash ose kurrë...
Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Nuk më mori gjumi. Zura të mendoj shtruar për fushatën e shenjtë kah Perëndimi. A ka të ngjarë që Perëndimi të jetë futur me njerëzit e vet në këtë anë në mënyrë që të na detyrojë që ne të ngujohemi siç u ngujuam aq gjatë rreth Kështjellës? Po të jetë kjo, mendova, vaj halli për ne...

Faqe 12

Dita e gjashtëdhjetë e pestë e aksionit.
Më në fund u nisëm përpjetë. Sulmin e filluam me daulle. Gjatë nuk i kishim dëgjuar të binin Tamtamet e tyre m'u dukën të ftohta. Jehona e tyre thyhej shpejt dhe më bëhej se ngrihej shpejt. Tërë ditën kontrolluam shpella, kalime, tisa të thyer dhe çmos, por askund gjurmë njeriu. Në mbrëmje pashë oficerët edhe më të dëshpëruar se kur ishim ngujuar. Shpresa se do ta gjenim armikun të ngrirë po fikej. Edhe dy-tri ditë, edhe dy-tri ditë durim...
Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Mendimet ndjellakeqe janë si mordja: përhapen shpejt dhe rrënojnë ato që u dalin para...

Faqe 13

Dita e shtatëdhjetë e aksionit.
Gjendemi në pikën më të lartë, shumë afër majës. Askund gjurmë njeriu. Bora shkrihet vrullshëm, por me të na shkrihen edhe shpresat tona. Ku mbetën mbi dy mijë veta? Ku? Mos i lëshoi toka? Mos kanë fluturuar?
Mblodha shtabin dhe kërkova mendimin e të gjithëve. Ata heshtin si mumje. Thoni diçka, u thashë, thoni! Lufta është jona, e të gjithë neve, e gjithë Perandorisë... Ata prapë heshtën. Dikur njeri foli gjithë dëshpërim: moti e kam pasur të qartë se ata na kanë qitur një karrem para dhe ne

ramë në të. U futëm kah deshën ata dhe pos që na ngujuan shumë kohë, tash po na tallin... Jo, jo, i thashë. Këtë nuk dua ta dëgjoj. Nuk dua të më shkojë mendja se ata më kanë mashtruar. Jo, jo. Nuk na kanë mashtruar. I ndoqëm. I patëm para dhe bëmë atë që duhej të bënim. Vepruam siç veprojnë ushtarakët e rryer, që nuk ndalen në gjysmë të rrugës... Ne do ta bëjmë tonën, u thashë. Do të ngjitemi në majë, e pastaj shohim... Brigadës ndëshkuese në Rrafsh i dhashë urdhër, që, po nuk gjeti njeri, atëherë t'u sulen shtëpive, pemëve, fushave e maleve të tyre. Të gjitha duhet t'ua shkatërrojmë, u thashë, të gjitha, që të mos ketë më jetë në këtë vend të mallkuar...
Xhavit Agai, d.v.
P.S.
Bisedova shtruar me oficerin që më foli për karremin. Ai më tha se në një kronikë kishte lexuar se këta rrebelë, po e patën pisk, bëhen edhe të padukshëm.
E di se për këtë të shkon koka, i thashë?
E di, më tha ai, por këto nuk janë shpifje. I ka shkruar Hivzi Pashai, njëri ndër ushtarakët tanë të fuqishëm, i cili mori pjesë në dymbëdhjetë rrethimet e para të Kështjellës. E ka pasur nga zhgënjimi i thashë. — Ne nuk kemi nevojë të mendojmë ashtu, sepse ua kemi marrë të gjitha. I kemi futur në birë të miut. I kemi në grusht...
Ai shkoi i heshtur, ndërsa mua më la një shqetësim që nuk m'u hoq. Një mend, pashai e kishte shtruar atë dilemë dhe për të gati i pati shkuar koka.. Dashtë i madhi e mos u marrsha me gjëra të tilla!

Faqe 14

Dita e tetëdhjetë e pestë e aksionit.
Majën e kemi afër. Nesër do ta pushtojmë. Para nesh shtrihet një hapësirë e shkretë, në të cilën ka borë. Aty-këtu ka ndonjë shkëmb që avullon në rrezet e diellit pranveror. Nga të gjitha anët më vijnë fjalët: «thatë, thatë... nuk ka gjë... nuk shohim gjë... nuk ka gjurmë jete... nuk ka...» Këto fjalë ma hanë shpirtin. Ç'u bë me ata të dymijët? Ç'u

bë? A mos i lëshoi toka? Koka më vlon nga dilema të shumta. E sa më shumë që merrem me to, aq më shumë ligështohem... A thua kalova një dimër të tmerrshëm kotnasikoti? Jo, jo, nuk më kanë mashtruar... Do t'i gjej... Do t'i kap... Do t'i ndëshkoj me dorën time... Hakmarrja do të jetë e tmerrshme! E tmerrshme!

Xhavit Agai, d.v

P.S.

Mendja më shkon te Hivzi Pashai. A thua ai pati të drejtë? Jo. Jo. Nuk pati të drejtë. Ai ishte i sëmurë. Ishte një qyqar. Mendja e tij polli mendimin e lig, disfatist, se rrebelët mund të bëheshin edhe të padukshëm.. Këtë nuk e pranon Perandoria, e as që duhet ta pranojë ndonjëherë...

Dikur, në njëfarë ankthi, m'u bë se po e shihje Hivzi Pashain. Ishte i veshur në të zeza. Dukej si korb. Ik, ik, po i thosha. Ik! Pse erdhe te unë? Nuk u besoj mendimeve tuaja ugurzeze. Nuk u besoj dot. E ai, më shikoi gjatë dhe më tha; besove a nuk besove kjo është një, e vërteta është tjetër... Patëm të njëjtin fat... të njëjtin fat... Jo, jo, thashë, kurrë... kurrë...

Faqe 15

Dita e fundit...

U ngjitëm në majë, në atë majë që tetëdhjetë e dy ditë m'i mori sytë. Nuk gjetëm gjë! Oficerët ulën kokën dhe heshtën. Nga ajo lartësi shikova poshtë dhe çdo gjë m'u duk e mjegulluar dhe e ftohtë. Megjithatë nuk më jepej që ta pranoja mashtrimin. Por, ta pranoje mashtrimin është më lehtë se të besohet se ata janë të padukshëm? Jo, jo, ata nuk janë të padukshëm. Bëmë ndonjë gabim të vogël dhe ata na e hodhën.

Shpjegim tjetër nuk mund të ketë. Nuk ka marrë fund e tëra... Jo, jo unë nuk jam Hivzi Pashai. Nuk jam ai korb i zi... Nuk çmendem unë. Më parë e kall gjithë botën se të çmendem...

Dhe, atë çast zura të mendoj për hakmarrjen, për një hakmarrje të tmerrshme, për një hakmarrje madhështore e cila

do të na ngushëllojë mua dhe ushtrinë time. Ajo hakmarrje duhet të na kthejë besimin e luhatur.

Aty për aty mendja më shkoi te vullnetarët dhe të të mobilizuarit që duhet të jenë nisur drejt detit për të vdekur në atë luftën që duhet të bëhet me Perëndimin. Ata për të vdekur do të vdesin gjithsesi, thashë, por a s'është më mirë që të vdesin nga dora ime? Pse të mos i vrasim ne? Më mirë ne se ushtritë e Perëndimit. Jo, jo, ne duhet t'i vrasim, sepse ka rrezik që ata të Perëndimit t'i bëjnë për vete dhe t'i ndërsejnë kah ne. Jo, jo, ne do t'i vrasim. Unë do t'i vras... Të gjithë, të gjithë do t'i vras... Vullnetarët do të ma paguajnë këtë pësim... Vullnetarët do të ma lajnë nënçmimin që më bënë rrebelët... E pastaj, do t'i hedhim në det që të mos kenë as varre e as gjurmë...A nuk është kjo hakmarrje e denjë? Në mëngjes mblodha oficerët dhe u thashë se duhet të niseshim me të shpejtë kah deti. Dita e pasnesërme, u thashë, duhet të na çelë në Liman. Fjalën Liman e përsërita disa herë me plot gojën.

Xhavit Agai, d.v.

P.S.

Në Liman, në Liman do të bëhet hataja...»

Dhe kështu, o Flamurtar, kur i rashë në fund fletores me fjong të zi që ma dha Shpjeguesi i ëndrrave, ajo më iku prej dorës. Një stuhi që erdhi nga lindja ma mori dhe unë pashë fletët e saj të shpërndara që fluturonin si zogj të frikësuar...

«Nuk do t'i zësh kurrë, më tha Shpjeguesi i ëndrrave. — Nuk do t'i zësh. A s'e sheh se u kthyen në zogj të zez?

Por, unë nuk u dhashë. Zura të vrapoja pas fletëve-zogj. Vrapoja dhe sa më shumë vrapoja merrja në thua, shalakatesha dhe së fundi u rrëzova. U shemba përdhe. Hetova se rashë në një errësirë të thellë në të cilën m'u ngri kujtesa. Prapë u bëra i paqenë, i zbrazur dhe shurdhër... Nuk e di sa kohë kalova në atë paqenësi, por në një çast m'u bë se po zgjohesha. Një zë po më thërriste.

Ishe ti dhe zëri yt që bëri të dal nga ajo harresë e pakufijshme. A s'është kështu, o Flamurtar?

— Unë nuk të kam thirrur, por brendia ime, foli Flamurtari pas një heshtjeje të gjatë. — Desha të të harroja, desha të të përjashtoja nga kujtesa. Por, ç'e do, thirrja e shpirtit qenka më e fuqishme se gjithçka tjetër... Po e shembka edhe Kullën e harresës...

Në mëngjes Djaloshi e gjeti Plakun të ngrirë. Në fytyrë i kishte mbetur një buzëqeshje e ëmbël. Në dorën e djathtë mbante lulen gjashtërrembëshe, mu si atë që e kishte gjetur në varrin e Mrikës...

SËMUNDJA E TERRIT

Fushën e gjerë, që lahej në rrezet e diellit pranveror dhe dukej si një det i gjelbër, të parët e panë pararojat. Ata nxituan ta çonin lajmin te roja e parë, e ata të rojës së parë ua kumtuan truprojave. Nuk vonoi kryeroja, pasi fshiu pluhurin nga uniforma dhe fërkoi sytë që të mos i dalloheshin shenjat e lodhjes, u nis me të shpejtë kah tenda mavi. Gjatë rrugës që bëri, u hamend se me çfarë fjale do ta thoshte lajmin e pritur: para e kemi vilajetin e skajshëm, apo-në dukje vendlindjen e Madhërisë? Megjithatë në ato çaste i ndihmoi hutimi, sepse kur pa kadiasqerin të ngrysur iu ngatërruan keqas ato që duhej t'i thoshte, kështu që, pas një mundimi që ia shfaqi fytyra, më në fund, nga goja i rrodhi e shkëputur vetëm fjala «erdhëm». Kadiasqerit i mjaftoi edhe ajo e thënë me aq mundim të kuptonte se para kishte vendin kryeneç... Një buzëqeshje e lehtë kaloi vetëtimthi nëpër fytyrën e tij sa dukej se e çeli paksa atë. Më në fund erdhi çasti im, tha vetmevete dhe i shkoi mendja te nishanet që do të mund t'i merrte kur të përfundonte fushata. Nuk do të sorollatem më udhëve të tilla të paudha, tha kur po bëhej gati të hynte në tendën mavi. Por para saj e ndali veqili që i tha se Madhëria kishte dhënë urdhër të mos e trazonin derisa dielli të mos i afrohej majës së bjeshkës që kishin para. Kadiasqeri u mat t'i thoshte

veqilit se fjala ishte për një lajm të rëndësishëm, që Madhëria e kishte pritur aq shumë, por shpejt hoqi dorë nga ngulmimi, ngase e dinte se urdhri i të madhit ishte urdhër dhe nuk bënte të bëhej dysh.

Kadiasqeri shikoi diellin që gjendej mu në zenit dhe i erdhi keq që ai ishte aq lart. Rrezet e forta i erdhën fuqishëm në sy sa ata i dogjën dhe iu errësuan. Një kohë të gjatë gjësendët iu shfaqen si hije të përziera me njëfarë mjegullimi të dendur. Bile një çast, mendoi se ishte zhytur në një kllapi të thellë ku gjithçka dukej si një përfytyrim i përsëritshëm e ku kishte shumë hije që zgjateshin tutje kah një thellësi që nuk e shihte, por mendja ia thoshte se duhej të ishte shumë e madhe... Më vonë hetoi se dikush e preku, se e trumhazi madje aq sa iu bë se gjithë mjegullimi iu përplas furishëm në kokë. Kur hapi sytë, pa veqilin që po i thoshte se koha ishte të paraqitej para Madhërisë. Tash, vendin e kllapisë së pakmëparshme ia zuri hutimi i papërmbajtshëm. Zuri të vriste mendjen se me ç'fjalë do t'ia niste të tregonte se para kishin vendin kah i cili u nisën para dy javësh dhe udhëtuan ditë e natë për ta arritur sa më parë? A mjaftonte vetëm një «erdhëm», apo asaj i duheshin shtuar edhe shumë e shumë asosh të tjera, para e pas, në mënyrë që lajmi ta kishte peshën sa më solemne. Mendja ia thoshte se ai lajm, që nuk ishte si çdo lajm tjetër, meritonte një ngjyrë të posaçme të zërit, por nuk ishte i sigurt me tamam se kur ta thoshte duhej të shprehte shqetësim apo mburrje? Hutimi iu bë edhe më i madh në çastin kur hyri në tendën e madhe dhe befas u gjend para Madhërisë, i cili rrinte këmbëkryq, shtruar mbi sexhadenë e purpurt. Kushedi sa kohë do të rrinte ashtu i shtangur po të mos dëgjonte një zë të butë që po i thoshte t'i fliste ato që do t'i thoshte.

— Erdhëm... Erdhëm... — tha ai, dhe, përkundër dëshirës që të mbahej disi, së paku sa të merrte izën, u shemb poshtë. Veqili me dy të tjerë, që ishte mësuar me raste të tilla, e kapi përkrahësh dhe e qiti jashtë...

Lajmin e arritjes Kryeviziri Hasan Pashë Ohri e priti me njëfarë shqetësimi të çuditshëm. Ca të dridhura ia ka-

pluan gjithë trupin sa iu bë se ndjeu ligështim. Në kushtë të tjera do ta thërriste mjekun dhe do t'i tregonte një nga një ato që ndjeu, por këtë herë hoqi dorë nga ankesa. Por, përkundër kësaj, shqetësimi nuk po i hiqej. Një herë e mbërtheu një siklet i furishëm e pastaj iu shfaqën ca djersë të lehta, të cilat sa vinin e shtoheshin sa një herë mendoi se ra në ujë, në një ujë të nxehtë, i cili po e përpinte të tërin. Allah, tha dhe u ngrit në këmbë për ta shmangur ligështimin që ndjeu aq furishëm. Një copë herë preku kokën, si të kërkonte në të diçka që do ta forconte e pastaj doli nga tenda. Jashtë rrezet e dobëta të diellit që ishte në të perënduar, ia ledhatuan fytyrën e bërë qull nga djersët. Nuk vonoi e ato rreze të buta u fikën e ai pa fushën e gjerë që shtrihej tutje-tëhu si e përgjumur. E gatshme që t'i jepej muzgut të parë, ajo dukej si e praruar, ndryshe nga ç'e kishte përfytyruar kohëve të fundit. Mbase kjo mund të lidhej edhe me atë se ai gjatë, shumë gjatë, e kishte ushqyer kujtesën me një përfytyrim të zbehtë të vendlindjes që e kishte bartur që nga fëmijëria. Atëbotë ishte gjashtëvjeçar kur bashkë me prindërit u nis për në Kryesheher. I ati, që ishte një qatip i postës, i pati thënë se po shkonin në një vend të praruar. Megjithatë vendlindjen nuk duhet ta harronte kurrë. Ilijalli i saj është si nuri i xhehnetit... Shi për këtë disa ditë e pati endur nëpër të gjitha pjesët e shehrit. Shihe këtë, i thoshte. Shihe atë... Kjo është Kështjella... Kjo është xhamia e kuqe... Kjo është Kodra e madhe... kjo është kulla e gurit... kjo është Çarshia e madhe... kjo është fusha e Sahatit.. ky është pusi i pafund... Çmos i thoshte sikur të kërkonte me çdo kusht që kokës së tij të vogël t'ia nguliste patjetër ca gjëra që ajo të mos i harronte asnjëherë... Atij i bëhej se i ati i fliste me njëfarë shpejtësie thuajse gjësendet do të ndërronin vend aty për aty. Por koha ishte më e fortë se kujtesa e tij. Kështu, nuk vonoi shumë dhe larg vendlindjes, zunë t'i mjegullohen një nga një konturet e gjërave të njohura, që i mori me vete me aq ngut. Nga gjithë ato rrugica, xhami të larta, shtëpi e kroje, pas disa vjetësh i mbetën vetëm ca pamje të shkëputura e të zbehta të cilat edhe kur i

kujtoheshin i përziheshin me të tjera, kështu që nuk e dinte me tamam se çka ishte kujtim i mirëfilltë nga vendlindja. Mbase një ditë ai fill i kujtesës do t'i treste e do t'i mbetej sa një pikë e mjegulluar, po qe se para pak kohësh Lartmadhëria nuk do t'ia zinte ngojë vendlindjen. Atje, i tha ai, po ndodhin gjëra të jashtëzakonshme, të jashtëzakonshme... Ia tha këto dhe i shikoi ngultas sikur të kërkonte që në shikimin e tij të gjente shkaktarin e asaj të jashtëzakonshmes për të cilën i foli me aq brengosje. Ai nuk mundi ta duronte atë shikim dhe i pati ulur sytë sikur ta pranonte fajin që nuk e kishte bërë. Ç'ishte vallë ajo e jashtëzakonshmja, që ia tha me aq shqetësim? Sikur ta kishte kuptuar mëdyshjen e tij, Lartmadhëria e këputi fjalën mu aty dhe mori shurupin e ftohtë për t'u freskuar. Rrufatjet e ngadalshme i erdhën gjithë ngacmim sa zuri të ndjehej keq. Por, ishte i bindur se duhej të priste i heshtur për të parë se ç'kahe do të merrte biseda. «Pra, — vazhdoi Larmadhëria, — atje po ndodhin gjëra të jashtëzakonshme, tejet të jashtëzakonshme... «Fjalën e dytë e theksoi aq shumë sa iu bë se ajo po i kërcënohej haptas. Mbase për t'u mbrojtur nga ai kërcënim, që ende nuk e dinte se çfarë ishte në të vërtetë, Kryeviziri bëri përpjekje që të mbrohej me pjesët e vendlindjes. Por hetoi me dëshpërim se mozaiku i saj tashmë ishte pa shumë pjesë. I shkëputur, i mangët dhe i zbehtë, nga ajo tërësi e shthurur fare nuk mund të krijonte një përfytyrim të qartë. Bile, edhe ato që po i vijëzoheshin, nuk ishte i sigurt se qenë të gjitha pjesë të vendlindjes apo me përzierje të huaja. Fjalët e Lartmadhërisë për të jashtëzakonshmen, e cila gjithsesi ashtu si thuhej nga goja e tij paralajmëronte diçka të keqe, po ia ngatërronin edhe më tepër ato që duhej t'i shihte të qarta. Kështu që, nga gjithë ajo që përpiqej të rikujtonte, i shfaqej vetëm një mjegullim i madh, në të cilin herë pas here spikatnin vetëm ca shtëpi të vogla dhe një lumë, që nuk e dinte me tamam se a ishte i madh apo i vogël. Pak më vonë, nga mjegullimi, si e qartësuar, i doli edhe një shtëpi e vogël, një derë e rezbitur në të cilën varej një hallkë që shërbente si do rezë për të trokitur dhe ca gozhdë të ndry-

shkura në të... Ishte kjo shtëpia e tij. Por, a nuk kishte të tjera? A thua vetëm ajo kishte mbetur? Më vonë iu shfaqën edhe pjesët e një minareje, por nuk ishte i bindur se formësimi i saj të ishte i njëmendët, ngase dronte se shumëçka e saj përzihej me të tjerat që kishte parë pareshtur ngjeti... Tjetër nuk pa. I erdhi keq që vendlindja i kishte sharruar në mjegull. «Në atë vend, — i tha Lartmadhëria pas një pushimi që iu duk i gjatë — njerëzit kanë zënë të bëhen të padukshëm...» U shtang. Iu bë se një akullnajë e madhe po i ngrinte përgjithmonë. «Ka kohë që njerëzit tanë më të besueshëm kanë hetuar se atje po ngjet diçka e jashtëzakonshme. — vazhdoi ai. — Me ferman të fshehtë formova komisionin e shtetit për ta shqyrtuar gjendjen. Angazhova njerëzit më të besueshëm të shërbimeve tona, të cilët po qe nevoja edhe gurit mund t'ia nxjerrin ujin. Dhe pas gjashtëmbëdhjetë ditë hetimesh ma sollën raportin e besueshëm... Ç'e do që lajmet që në fillim m'u bënë si thashetheme, ishin të vërteta... «Sapo ia tha këto, i qiti para një tubë letrash të lidhura me fjongun e verdhë që u vihej fshehtësive shtetërore të rendit të parë. Një copë herë i shikoi ato letra dhe iu bë se sa më shumë që ua picërronte sytë, mbushej me shqetësim edhe më të madh. «Lexoi, — i tha Lartmadhëria. — Pastaj bisedojmë...»

Kur i mori letrat iu duk se në dorë kishte gjithë shqetësimin e papritur të Perandorisë. A thua, tha vetmevete, po vjen koha kur qoftëlargu mund të vërë pushtet të tillë të fortë mbi njerëzit sa t'i bëjë të padukshëm? Dhe, po qe se një gjë e tillë duhet të ngjajë medoemos, atëherë pse kjo të ndodhte në vendlindjen e tij të cilën nuk e kishte parë rrafsh pesëdhjetë vjet? A do të bisedonte me të Lartmadhëria në këtë mënyrë, po qe se e jashtëzakonshmja apo e liga e tmerrshme do të shfaqej në ndonjë pjesë tjetër të Perandorisë? Me dilema të tilla do të merrej edhe më, por e pati të qartë se ato nuk kishin fund. I mbetej që t'i lexonte sa më parë ato që kishte para dhe të bëhej gati të dëgjonte ato të tjerat, të cilat Llartmadhëria i kishte të gatshme. Një copë herë shikoi dyllin e verdhë përmbi me vulën e Perandorisë, që e njihte aq mirë. Vula sa vinte e i

rritej dhe po i kthehej në një thikë. Shpejt e shpejt hapi faqen e parë dhe lexoi:

«Lartmadhërisë personalisht,
raport nga komisioni i shtetit, i themeluar me urdhrin e Lartmadhërisë, të Sulltan Osmanit të Dytë, i kryer në fillim të dimrit të vitit 1614.»

Në faqen tjetër raporti niste kështu:

«Unë, Idriz Allajbeu, bashkë me katër nënpunës të lartë të Shërbimit të fshehtë të mbrojtjes së shtetit, me urdhrin e prerë të Lartmadhërisë, u nisëm për në Shehrin e vogël, diku në Tokën e Lashtë, për t'i vërtetuar aty për aty thashethemet që po hapeshin se në atë vend njerëzit po bëheshin të padukshëm!

Rrugën e morëm të përgatitur mirë dhe të bindur se syrit tonë nuk do t'i shpëtojë asgjë që është në interes të ndriçimit të këtij rasti të çuditshëm. Kështu, misioni ynë filloi dhe mbaroi në rrethana të fshehta, ashtu siç u kërkua nga ne dhe siç punohet në raste të tilla të veçanta.

Pas rrugës së gjatë arritëm në Shehrin e vogël e të mbërthyer pranë bjeshkëve. Fusha që i rrinte para na dukej se rritej para shikimit tonë. Kajmekamit i thamë se ishim hulumtues të ujërave. Ia dorëzuam dëshmitë e duhura. Ai na priti mirë, dhe, siç shkruante në letrën përcjellëse, na doli në ndihmë. U tregua aq i vëmendshëm sa mori përsipër edhe cikërrimat që nuk i përkitnin fare. Mendja ma thoshte se këtë e bënte ngase dëshironte të mbeteshim sa më larg thashethemeve që qarkullonin andejpari për të jashtëzakonshmen. Këtë e hetuam edhe nga përcjellja e vazhdueshme që na bëhej nga ca persona të tij të besueshëm. Ne, megjithatë, tregoheshim të vëmendshëm. Hapnim hartat tona plot e përplot me vija dhe shtireshim sikur nuk na interesonte gjë prej gjëje pos ujërave tekanjoze, të cilat aty ishin të shumta. Mbase sjelljet tona nuk lanë kurrfarë shkasi për çfarëdo dyshimi. Kështuqë kajmekamit dhe të tjerëve përreth tij iu mbush mendja se ne njëmend

ishim njerëz të ujërave që nuk çanim kokën për gjërat e tjera. Dhe, siç u morëm vesh gjatë përgatitjeve të bëra në Kryesheher, punës ia nisëm nga ujërat. Duhej çdo gjë ta nisnim me respekt, sepse në këtë vend të merresh me ujin do të thotë të kesh punë me shenjtërinë e tyre. Ne kishim njoftime të bollshme se si askund tjetër aty mbizotëronte një bindje se uji ishte i pacenueshëm. Mitologjia dhe legjendat e tyre janë plot e përplot me flijime për ujin. Pra, uji për ta është një pjesë e shpirtit të tyre të devotshëm me të cilin lidhet ngushtë qenia e tyre. Kjo bindje e tyre hetohet me sovranitetin e ujit, që shprehet me vijat e shumta, të cilat fillojnë diku nga kreu i lumit dhe vazhdojnë të degëzohen nëpër të gjitha anët në formë të një merimange, herë duke hyrë e herë duke dalë lirisht nga secila shtëpi dhe nga secili oborr. U binda se pikërisht ishin vijat e ujit ato që kishin përcaktuar kahën e shtëpive, të rrugëve dhe në përgjithësi shtrirjen e Shehrit. Me një fjalë, ngritja dhe zhvillimi i Shehrit ishte bërë siç kishte dëshiruar uji. Prandaj ishte edhe e arsyeshme pse edhe presa më e vogël apo çfarëdo lajthitje nga kushdo, do të thoshte për këtë vend shqetësim kolektiv ose kob. Nisur nga kjo, ne e patëm të qartë se i madh e i vogël në Sheher duhej ta dinte se ne nuk kishim për qëllim të ndryshonim asgjë nga ajo që lidhej me besimin e tyre për ujin, pos që interesoheshin për masën dhe cilësinë e ujit. Madje, hapëm fjalë se shtrirja e ujit na interesonte që nesër a pasnesër Perandoria edhe gjetiu të vepronte me ujin siç veprohet këtu. Njërit nga bashkëpunëtorët e mi i dhashë për detyrë t'i shënonte këngët, legjendat dhe baladat e tyre për ujin. I thashë t'i shënonte të gjitha kallëzimet popullore dhe ato t'i përsëriste nëpër vende publike. Bashkëpunëtori bëri siç i thashë dhe pas pak zuri të fliste për ujin siç flisnin edhe vendësit. Kjo bëri që të na shikojnë për të mirë. Nxitonin dhe na sillnin gjithfarë vargjesh, të cilat bashkëpunëtori im që e dinte gjuhën e tyre, m'i përkthente dhe m'i përfliste me kujdes të madh. Për të krijuar afërsi sa më të madhe me ta, mësova ca vargje të atyre këngëve, edhe pse me mjaft mundim, dhe ua thosha sa herë takohesha me ta. Ata m'i

hapnin zemrat dhe unë nuk e kisha të vështirë që t'i kuptoja ato që më duheshin.

Çfarë pyetnim ne?

Së pari interesoheshim për vjetërsinë e shtëpive, pastaj për vijat e ujit, për pemët dhe për frutet që merrnin... Nëse ditët dhe datat e shtëpive ndryshonin, e ndryshonin edhe ditëlindjet e njerëzve vijat e ujit ishin njësoj të vjetra. Secili thoshte: kjo vijë ka qenë gjithnjë e tillë... Gjithnjë ka ecur në këtë drejtim... Nuk e ka ndryshuar kurrë sasinë e ujit as dimër as verë... Hyn e del lirisht... Kush s'ia qet presën... Nuk është ngrirë kurrë... Nuk është turbulluar kurrë...

Edhe bashkëpunëtori im që merrej me çështjet e folklorit m'i vërtetonte ato që dëgjoja preshtur. Nëpër legjendat e tyre nuk takohen shenjat e shterjes apo të ngrirjes — më thoshte ai. Po ngjau kjo, atëherë fjala është për tronditje të jashtëzakonshme, të cilat mund të përfundojnë me kobe të mëdha. Uji, pra, më tha ai është sovran.

Kështu, pak nga pak, po u afroheshim çështjeve për të cilat kishim ardhur. Pra, po e hartonim listën e përpiktë të banorëve të secilës shtëpi veç e veç dhe të Shehrit në përgjithësi. Në lista tashmë kishim emrat, ditëlindjet, mbiemrat, gjinitë dhe marrëdhëniet familjare e farefisnore. I dinim lidhjet e familjeve me familje, i dinim çështjet e martesave, të pronësive dhe të ngatërresave të hershme dhe të atyre aktuale. Ca familjeve ua shënuam emrat e pesë gjashtë koreve dhe vërtetuam atë që thuhet se këtu njerëzit shumë herë i kanë ndërruar besimet, duke marrë rëndom besimin e atij që ka vënë pushtet mbi ta. Diku-diku, brendapërbrenda një shtëpie apo vëllazërie hasëm dy përkatësi të ndryshme fetare! Hasëm emra besimesh të ndryshme të cilët bashkëjetonin çuditërisht brenda një kulmi të njëjtë si të ishte puna për cikërrima të zakonshme e jo për shprehje të përkatësive të bindjeve të ndryshme tejet kundërthënëse. Na ra në sy edhe dukuria e përsëdytjes apo e përsëtretjes së shumtë të emrave në secilën familje. Baba rëndom ia linte fëmijës emrin e të atit dhe kështu me radhë...

Me një fjalë, ditë për ditë po futeshim thellë e më thellë

në strukturën e tyre shpirtërore. edhe pse gjendeshim ende larg që të kuptonim atë që na duhej mbi të gjitha.

Gjatë regjistrimit të parë nuk hetuam asgjë të jashtëzakonshme. Çdo gjë na dukej e rëndomtë dhe e natyrshme. E të njëjta na u dukën edhe me rastin e regjistrimit të dytë. përveç se në atë mezokohë prej dhjetë ditësh. numri i banorëve të Shehrit u shtua për dymbëdhjetë veta. Në të vërtetë lindën pesëmbëdhjetë fëmijë (prej tyre tetë djem e shtatë vajza), por vdiqën tre veta (një grua e moshuar, një mezoburrë dhe një i ri). Të lindurit qenë katër fëmijë të parë, tre të dytë. një i tretë. dy të katërt. një i pestë. një i shtatë dhe dy të nëntë... Midis dy regjistrimeve u bënë tri martesa, dy fejesa dhe u lidhën tri kumbari...

Në regjistrimin e tretë (që e bëmë gjashtë ditë pas të dytit) hetuam se në lagjen e skajshme një plakë mungonte. Kot u sollëm dy ditë poshtë e lart nëpër oborr, rreth shtëpisë dhe në rrugë. Plaka nuk ishte. Bashkëpunëtorët e mi bënë sytë katër, por plaka nuk po dukej se nuk po dukej, edhe pse dera e shtëpisë së saj rrinte e hapur pareshtur. Bile, ajo hapej me të shpejtë edhe kur njerëzit e mi e mbyllnin. Çuditërisht. ditën e tretë e pamë plakën. Rrinte si të kishte qenë gjithnjë aty. Ajo nuk na vuri veshin dhe vazhdoi të lëmurte lesh dhe të përpushte zjarrin me lagraçën e madhe. (Duhet shtuar se zjarri pa ia da ishte i ndezur edhe kur nuk e shihnim Plakën...) Kur e pyetëm Plakën si ishte e mundur që zjarri në vatrën e saj nuk fikej kurrë, pra edhe kur ajo nuk ishte aty, ajo pa ngurrim na tha se vatrën nuk e linte vetëm kurrë... (Ka dyzet vjet që zjarri nuk është shuar kurrë në vatrën time dhe nuk do të shuhet kurrë edhe po qe se nuk do të jem unë... Shpirti im e mban të ndezur...)

Kështu filloi interesimi ynë për Plakën. Mësuam se ajo quhej Shahe Krraba, se i kishte kaluar moti të nëntëdhjetat, se ishte nënë e gjashtë fëmijëve (e një vajze dhe pesë djemve), se djemtë i kishin vdekur moti (një nga një brenda gjashtë javësh nga një sëmundje e rrallë), ndërsa vajzën e hasretit e kishte martuar në një bajrak të largët shtatë ditë udhë kah Veriu në një vend që plaka qëllimisht ia ki-

shte harruar emrin. (Ç'më duhet mua emri i atij vendi dhe i atij fisi të mallkuar? Erdhën dhe ma morën me natë. Me natë edhe u larguan... Të mos u shoh më u thashë krushqve, sepse qysh kur i mbulova me dhe sokolat, jam e paqenë... Nuk më shihet njeri... Jetoj me terrin... Nga ai s'ka kush më nxjerr më...)

Isha i bindur se plaka qëllimisht nuk dëshironte ta zinte ngojë emrin e së bijës se frikësohej se po t'ia thoshte emrin atë do ta gjente ndonjë e ligë, siç ia kishte gjetur të bijtë. Kjo lidhet me besimin e tyre të përhershëm se mortit të madh duhet t'i fshihen emrat medoemos. (Prej ditës që më shkuan sokolat jam hije.) Ndërsa ata që kishin pasur rastin ta shihnin ndonjëherë, e të tillë janë të pakët, na thanë: Plaka jeton vetëm me ujë... Pi nga një filxhan në ditë sa për ta mbajtur shpirtin... Goja e saj prej vdekjes së të bijve nuk ka provuar tjetërgjë...)

Vetmia e plakës është njëmend e cuditshme. Neve na u hapën shumë mëdyshje, sidomos kur dëgjuam për punën e ushqimit që s'hante dhe për raportet e saj me njerëzit... M'u bë se kaherë m'u ka ngatërruar kufiri midis të qenës dhe të paqenës... Nuk e di me tamam se kur shoh dikë a kam përpara ndonjë kufomë apo ndonjë hije?... Unë bisedoj vetëm me të vdekur.... Kaherë gjithçka ka vdekur... Bota e të vdekurëve është e pafund... Po ju shoh të vdekur... Që të gjithë për mua janë të vdekur... Krejt njësoj: të vdekurit që janë gjallë dhe të gjallët që janë të vdekur...)

Si Shahe Krrabën hasëm edhe një plakë tjetër, në pjesën lindore të Shehrit, mu aty ku vijat kryesore të ujit ndahen prej lumit dhe derdhen hareshëm nëpër të gjitha pjesët e tij. Ç'është e vërteta atë e gjetëm në sajë të grindjeve të fëmijëve. (U bëfsh i paqenë si Nuria, i tha njëri tjetrit. Tjetri qeshi dhe iku...) Ne që po vëzhgonim me kureshtje të madhe çdo fjalë dhe secilën imtësi, e pyetëm fëmijën se pse ajo grua po u bëka e paqenë? Fëmija si fëmijë, rrudhi krahët dhe u skuq. E morëm me të mirë dhe i thamë se nuk kishte pse të frikësohej, ngase nuk kishte thënë ndonjë fjalë që nuk duhej ta thoshte. (Nuk e di se ç'domethënie

ka ajo fjalë, — na tha ai, — por ne kështu i themi atij që nuk dëshirojmë ta shohim më... Në Sheher këtë fjalë mund ta dëgjoni sa herë të doni...)

Plakës Nurie Futa, që i thoshin Nurë, shpejt i ramë në gjurmë. Jetonte në një shtëpi të madhe, e vetmuar prej shumë e shumë vjetësh. (Nuk jam e vetme, na tha. Jetoj me ujin... A nuk keni parë të tjerët që jetojnë me ujin? Keq. Ju qenkët të marrë kur nuk e ditkeni se uji është shoku më i mirë... Ai të përkund... Të vë në gjumë si djepi fëmijën... Të ruan ditë e natë... Cili njeri të rri pranë si uji? Cili mik është i kujdesshëm si uji? Mjerë ai që guxon të flasë keq për ujin se ia shkurtoj gjuhën...)

Plaka Nurë i kishte kaluar të njëqindëtat. Vetmia e saj kishte filluar moti, para shtatëdhjetë e ca vjetësh, kur burrin ia vranë në një pritë. Me të kishte kaluar vetëm shtatë net. Nga ai çast u vesh me të zeza dhe nuk e kaloi më pragun e derës. Të gjithë në Sheher thonë se ajo flet vetmevete dhe krye çdo dhjetëvjetëshi i ndërron emrat e atyre që i zë ngojë pareshtur. Kështu vepron edhe me emrin e të shoqit, të cilin herë e thërret Zekë, herë Shpend, herë Cenë e herë Malë. Së fundi e quan Merr. Nga kjo përzierje e emrave tash nuk ia di emrin e njëmendët të të shoqit, e mbase as ajo nuk e di më. Mendohet se emri i fundit Merr lidhet me lutjet e saj të pareshtura që vdekja ta marrë nga kjo botë. Për dallim nga Shahe Krraba, plaka Nurë, thonë se nuk ha fare. As ujin nuk e fut në gojë, ngase thonë se e do mbi gjithë botën. (Ushqehet me terrin, tha njëri. — Netëve të verës dëgjohet mbllaçitja e nofullave të saj që i gjason një gjëme... Ai që ha terrin, nuk vdes kurrë...)

Plaka Nurë, edhe si e padukshme hetohet. Ne dëgjuam plot kureshtje zërin e saj si sillej nëpër shtëpi. Ai zë lëvizte, i tregonte dikujt diçka për një bimë të zezë e cila kishte qitur befas lule të kuqe (... e ke parë lulen e zezë?... Nuk e ke parë?... Sa keq... Të kuptoj, moj e shkretë, të kuptoj.. Kahere ka mbetur pa sy... Po ti, çfarë thua për këtë?... Asgjë.... T'i ka pirë sorra trutë.., Të tillët s'i mban as varri.. Janë të ligj... Kush thotë se nuk thahet?.., Kush? Auu!)

Pastaj dëgjuam një këngë që i gjasonte një vajtimi të thellë. Dhoma mbushej me tinguj të thekshëm që përplaseshin nga njëra anë në anën tjetër të mureve dhe gjatë asaj përplasje bëheshin edhe më të thekshëm. Një copë herë plaka Nurë vajtoi apo këndoi, e dikur zu të bisedonte me dikë: Ç'thua, moj, Koko Terri:... Pse nuk erdhe më parë?... E dija se do të m'i thuash këto fjalë... E dija... Ti nuk flet ndryshe.. Ka njëmijë vjet që flet të njëjtat fjalë.. Edhe para treqind vjetësh më the të njëjtat... Si gjithnjë... Mendon se kam harruar? Jo, jo... Nuk janë dyqind vjet por katërqind... Rrafsh katërqind vjet... As më shumë e as më pak... Po ti moj Verore, pse je katandisur kështu?... Ke ngrënë yje?... E di... E di.. : Do të na lësh pa ta... Mbase e ha edhe hënën?... Po, po.... Edhe hënës i bën dëm... Nuk shfaqet ajo herë ashtu e herë kështu... Po, po.... Ta di hujin.. E ti, moj Bjeshkë, pse rri e brengosur?... Për çupëzën?... Me të drejtë,.. Me të drejtë... Por, ajo do të vijë... Do të vijë gjithsesi... Nuk ka nga ia mban... The se kaluan nëntëqind vjet që s'e ke parë?... Qe besa shumë... Por thanë se pas nëntëqind vjetësh e qet dheu sipër... Mos u brengos... Sonte e ke para vetes... Sonte... Mos i ha të gjitha rrasat e varreve...)

Ne vërejtëm një ngatërrim emrash. Plaka prore i përziente ata. (... Ç'u bë me Gjergjin?... Ka shkuar?... Do ta marrë Mrikën? Këtë prisja... Po Guri?... E ka shkurtuar gjuhën?... Në djall të vejë!... Asnjëherë nuk iu ka dashur... Thirreni Veroren... Mbylljani yjt në liqe... Shkaben mos e harroni... Shkaben... Ajo ka tre sy...)

Foli një copë herë, pastaj sërish iu kthye vajtimit të thekshëm. Më vonë prapë ia nisi me ata emrat e ngatërruar nga të cilët po na pëlciste koka. Së voni e pamë si hyri brenda me një kërrutë të madhe. (Nuk kam çupëz për të martuar, na tha... Nuk kam... Ndoshta do ta kem një pas dyqind vjetësh.. Dëshiroj ta kem një, por ende është herët... Eni pas treqind vjetësh... Atëherë do t'ua jap me gjithë zemër... Ju qenkshit krushq të durueshëm... Të tillë i dua njerëzit e jo nga ata që ecin hundabuzash... Pale, pale.. Edhe atllarët i paskëshit të mirë.... Patjetër se vini nga larg?.... Ani-

mirë... Eni, pra, pas dyqind vjetësh... Nuk ju kthej duarthatë. . Jo, jo... Nuk e bëj këtë kurrën e kurrës...)

Pra na merrte për krushq dhe kur po bëheshim gati t'i thoshim se nuk ishim krushq dhe as që erdhëm t'i kërkonim të bijën që nuk e kishte, na harroi fare. Thuajse nuk i rrinim para. (A të thashë, Koko, se bota nuk është e pafundme?... A të thashë se mali me mal nuk takohet... E ti Shkruman, pse po sorollatesh nëpër varret e huaja?... Pse dërdëllisesh dhe nxjerr zjarr nga goja?... E di, e di... Por, kujdes... Zjarri megjithatë është zjarr... Mos u anko pastaj... E ti, Uko, pse e mban ashtu atë kryq?... Pse e tërheq zvarrë?... Nga të parët?... Të kuptoj... Të kuptoj... Ka njëqind vjet që mendoj për të njëjtën gjë dhe nuk arrij fare ta zgjidh... S'është e thënë të ngutem... Kam kohë... Apo jo?... Aq më bën. : : Le të dalë ku të dalë..)

Gjatë u morëm me Nurie Futën dhe sa herë që e dëgjonim nuk e dinim me tamam se a fliste njëmend ajo apo ndonjë shpirt i huaj në të? Njëherë më shkoi mendja se te ajo kërcunë ishin puqur çuditërisht disa qenie, të cilat ngatërroheshin keqas me njëra-tjetrën...

Raste të tjera të ngjashme nuk gjetëm. Bëmë edhe tri regjistrime të njëpasnjëshme e u futëm në të gjitha skutat (gjithnjë me arsyetim se hulumtonim ujin dhe lidhjet e njerëzve me të). Në lagjen afër shatërvanit të madh, na thanë se ishte një djalë që ecte pas pehrrive. Tri ditë e tri netë e përcollëm çdo veprim të tij dhe vërtetuam sa vijon:

Djali që i thonin Shejnur, prej babës Hysniut dhe nënës Nerxhivane, ishte fëmijë i tretë. Ai çohej në pikë të gjumit nga shtrati, symbylltas hapte dritaren, dilte në çardak dhe pasi sillej tri herë nëpër të, kalonte nëpër murin ballor (të gjatë pesë metra e dyzet e një centimetër) dhe ngjitej në kulm. Sillej katër herë prej njërës anë në tjetrën e pastaj ulej mu në cep të tij dhe një copë herë mbante sytë kah qielli me hënë. Me duar të ngritura përpjetë (si të lutej) bënte edhe një kalim nëpër kulm, kthehej murit ballor, ulej pak në çardak dhe hynte në dhomë. Futej në shtrat dhe vazhdonte gjumin e rehatshëm Në mëngjes dukej i freskët dhe nuk jepte kurrfarë shenjash të ndonjë lodhjeje apo

ankthi. (Bëra gjumë të mirë, i thoshte s'ëmës, e cila e dinte fare mirë se ç'kishte ndodhur gjatë natës). Ne i shikuam të gjitha ato bredhje dhe e patëm të qartë se ai nuk ishte nga ata që bëheshin të padukshëm. Përkundrazi, ai ecte nëpër çati në të njëjtën kohë dhe bënte të njëjtat vepr me, pa u shtuar dhe pa u munguar gjë. Bile, me të matur kohën, vërtetuam se bredhja e tij në çati zgjaste gjithnjë shtatë minuta. As më pak e as më shumë.

(Ka kohë që Shejnuri ynë vepron kështu, na thanë prindërit e tij kur i pyetëm se a kishin njohuri për veprimet e djaloshit nëpër kulm. — Në fillim u tmerruam... Si është e mundur që fëmija të dalë nga shtrati dhe symbylltas të ngjitet në çati për të bredhur nëpër të. Hoxha i Vogël na tha se Shejnuri ynë do ta bëjë këtë deri sa të hyjë në bylyk. Emira e së mirës, na tha ai, është që të mos e bëjmë punën të madhe. Shtiruni kinëse nuk shihni e as nuk dini gjë... Ai sheh ato që nuk i shohim ne... Na dha një hajmali dhe na bindi se me kohë ai do të bjerë në vete... Ne po presim që Shejnuri ynë së shpejti ta ndërpresë këtë bredhje të rrezikshme... Ka shenja që po i afrohet bylykut... E pastaj le të bëhet si do i madhi... Vetëm të mos mbetet me ilet...)

Bredhjet e Shejnurit nuk e shqetësuan askend në Sheher. Për të flitej si për një fëmijë që ishte shumë më afër qiellit se të tjerët. (Është i mbërrimë... E kanë në dorë pehrritë, prandaj ai sheh më shumë se të tjerët... Lumë ai që ka mundësi ta plotësojë boshllëkun e kësaj bote... Shejnuri qysh tash e di se sa mashtrimtare është kjo botë, andaj dëshiron që sa më parë t'i takojë asaj të amshuemes...)

Krye muajit të dytë i mblodhëm çaklat dhe shkuam te Kajmekami. I thamë se matjet e hulumtimet tona morën fund. Ia bëmë me dije se në Kryesheher po ktheheshim të kënaqur si me hulumtimet tona si me ndihmën që na kishte dhënë ai. Mësuam shumë gjëra, i thashë dhe po e lypi puna mund të vijmë prapë. Ardhshi për të mirë, ma ktheu ai. I keni dyert të hapura. Për mikun e mirë oxhaku gjithnjë rri i ndezur. Na tha se ishim komisioni i parë i rangut

të tillë të lartë që kishte punuar pa bërë kurrfarë telashesh. (Ata që dinë gjuhën e ujërave, patjetër, se njerëzve ua njohin shpirtin si duhet — tha kur na përcolli).

Përfundim

Unë, Idriz Allajbeu, hetues i lartë i zyrës sekrete perandorake pas qëndrimit dy muajsh në Shehrin e vogël të vilajetit të shkajshëm apo të Tokës së Lashtë, në cilësinë e nënpunësit të lartë deklaroj sa vijon:

1. Është e vërtetë se në atë Sheher ka raste që njerëzit bëhen të padukshëm.

2. Si të padukshëm na u shfaqën këta persona:

a) Shahe Krraba, plakë mbi nëntëdhjetëvjeçare dhe

b) Nurie Futa, e cila sipas të gjitha dyshimeve moti i kishte kaluar të njëqindtat.

Se këto dy plaka bëhen herë pas here të padukshme, këtë e di gjithë Shehri që moti. Bazuar në thashethemet, përgojimet dhe intrigat e tjera, të cilat në këtë vend janë si shumë të përhapura, askush nuk mendon se fjala është për ndonjë kob, që mund të paralajmërohet përmes shenjave të tilla. Përkundrazi, në Sheher shumëkush mendon se Shahe Krraba dhe Nurie Futa janë krijesa të harruara, të ngatërruara dhe pikërisht pse nuk kanë vdekur (kohën e kanë pasur kaherë, por mbase vdekja i ka harruar), shpirtërisht nuk janë më midis të të gjallëve. Prandaj sorrollatjet e tyre janë të parëndësishme dhe nuk ua vë kush veshin... (Ato që i harron mortja, — na thanë, — nuk janë gjë tjetër pos kufoma të gjalla që sillen andej-këndej për t'u kujtuar njerëzve të vërtetën se vdekjen e kemi hak dhe se është mirë kur ai hak lahet me kohë. Në të kundërtën bëhesh i paqenë si edhe plakat e hallakatura, që ngatërrojnë ditën me natën, terrin me dritën, të gjallët me të vdekurit...)

Në Sheher dëgjuam edhe këso mendimesh për to:

— as që kanë jetuar ndonjëherë...

mund të jenë shpirtra të mallkuar...

— nuk i do as ajo botë...

Njëri, që nuk ia mësuam dot emrin, na tha:

— Nuk janë të marra. Përkundrazi, ato janë të vetmet krijesa në këtë Sheher dhe më gjërë që shohin shumë më larg, shumë më thellë dhe shumë më tepër se gjithë të tjerët së bashku... Diçka do të ndodhë me ne patjetër... Nuk duhet të bëhemi të shurdhër dhe të marrë...

Megjithatë, Lartmadhëri, punët nuk i pashë aq të thjeshta, siç mendojnë shumica në Sheher. Përkundrazi, kur gjërat shikohen mirë e mirë dhe më thellë, del se fjala është për çështje të ndërlikuara që mund të kenë pasoja të rënda për Perandorinë. Ma thotë mendja se fjala është për shenjat e një shqetësimi tejet të madh, mbase kolektiv, që lidhet me kundërshtimin e drejtpërdrejtë të botës sonë. Unë, që aq me zell hulumtoj shpirtin dhe vetëdijen shekullore të njerëzve të Tokës së Lashtë dhe gjithë asaj pjese që lidh kufirin e dikurshëm (e fatkeqësisht edhe të tanishëm) të botës së re dhe asaj të së vjetrës (e cila patjetër se do të mundet nga madhështia jonë), kam hasur në përpjekje të vazhdueshme të kryeneçësisë së tyre shpirtërore dhe pikërisht premisat e saj tash kanë ngrehur krye në këtë mënyrë...

Dikujt mund t'i duken këto dokrra (një plakë e rrokatur flet me të vdekurit dhe herë shihet e herë nuk shihet, fodullëk hesapi), por mua jo. Mendimet e tyre heretike, tash e njëqind vjet (edhe pse marrin fenë tonë thuajse me dëshirë) sillen e sillen dhe kërkojnë që të gjejnë të çara për veprim, në mënyrë që t'i zhvleftësojnë mësimet tona, e edhe t'i tallin madje... Qendra e besimit tonë të shenjtë (që një ditë do të bëhet i të gjithëve) mbështetet në amshueshmërinë e shpirtit dhe rruga deri te kjo çon në dy drejtime: përmes xhehnetit dhe xhehnemit. Kjo është kulla jonë pa të cilën ne nuk kemi as të tashme e as të ardhshme. Gjithçka në këtë botë edhe në atë botë lidhet mbi këto parime. Prandaj, Lartmadhëri, të provosh të dëshmosh se bën edhe ndryshe, kjo nuk është vetëm herezi, por edhe kundërvënie mendimit tonë. Sipas besimit të tyre të moçëm, që i ka bazat në paganizëm të përlarë, kufiri midis jetës dhe vdekjes shpesh na del i ngatërruar dhe pa farë përcaktimi kohor. Kjo dogmë,

sado e pashkruar, ka mbijetuar gjatë, shumë gjatë në vetëdijen e tyre e jeton ende (edhe përkundër faktit se qenë ndër të parët që e morën krishtërimin dhe mbi dhjetë shekuj qenë të zhytur në të).

Në çastin kur i pashë plakat Shane Krraba dhe Nurie Futa si nunërisnin me të vdekurit ngojë, filloi të më forcohej dyshimi se fjala është për herezinë e tyre shpirtërore. Prandaj,ditë e natë u dhashë pas gjetjeve të dëshmive që do të vërtetojnë në tërësi mendimin tim se fjala është për kryeneçësi të jashtëzakonshme shpirtërore, e cila ka për qëllim që në këtë mënyrë t'u bjerë ndesh mësimeve të shenjta të Allahut (falë i qofshim). Kjo kryeneçësi, ku më pak e ku më shumë, jeton edhe ushqehet në vetëdijen e tyre pareshtur, ani pse dëshirojnë që të na bindin për të kundërtën. Sa për ilustrim po sjell ca shembuj që mund të hasen në leksikun e tyre të përditshëm, ku ata thuajse vazhdimisht bien ndesh me mësimet tona të shenjta, e që ne mund t'i dënojmë rreptësisht:

Jeta e vdekja ecin në të njëjtin kalë...

Shpirti shkon e shpirti kthehet...
Ecën si kufomë e gjallë...
Vdiq pak, e vdiq shumë...
Trupi në varr e hija në tokë...
Sa shihet, sa nuk shihet...
Rri si i vdekur...

Mund të sjell edhe shumë e shumë shembuj të tjerë, ku jetojnë në formë të pjesëzave, herezitë e besimit të tyre të vjetër (apo antibesimi), i cili na i kundërshton mësimet tona të shenjta e me këtë edhe perandorinë tonë. Dhe, ç'është më keq, sot e gjithë ditën në atë vend, edhe pas njëqind e sa vjetësh të depërtimit të fesë së re, ata nuk heqin dorë nga përzierja e të pafeve me të fesë sonë. Në atë botë shkojnë truq, duke e zhveshur njeriun nga besimi, i cili është i domosdoshëm që t'i caktohet vendi që e meriton. Mjafton për këtë të zihet ngojë e dhëna kur Nurie Futa bisedon njësoj me të vdekurit që kanë emrat tanë (pra të besimit të

ri) dhe me ata që kanë kundëremra (pra të besimit të vjetër).

Prandaj, bindjet se jeta ngatërrohet me vdekjen (ecin në të njëjtin kalë jeta dhe vdekja...); se vdekja mund të jetë e pjesërishme (vdiq pak apo shumë...); se nuk ekziston xhehneti dhe xhehnemi (gjithçka duket sheshazi në këtë botë...) si dhe bindja se ata pa dallim gjenden bashkë edhe si të vdekur (siç gjenden edhe si të gjallë), tregojnë fare qartë se në këtë Sheher ka zënë të shfaqet vetëdijësimi i tyre armiqësor kundër mësimeve tona të shenjta dhe në përgjithësi kundër nesh.

Çështjen e këtij vetëdijësimi e lidh drejtpërsëdrejti me të ashtuquajturën dukuri të padukshmërisë, pra të rasteve kur dikush nganjëherë mund të bëhet i padukshëm e pastaj të bëhet edhe i dukshëm (siç është rasti i Shahe Krrabës dhe i Nurie Futës). Në të vërtetë, fenomeni i padukshmërisë mund të merret si shenjë e parë e manifestimit të të ashtuquajturit vetëdijësim individual, që shpie doemos kah vetëdijësimi i mëvonshëm kolektiv?

Pra, këtu nuk është fjala për dukuri të jashtëzakonshme apo shrregullime mendore, por për zgjim të ngadalshëm të asaj që ka ekzistuar dhe që si e tillë (si e shkëputur) jeton dhe mëton të lidhet. Në këtë mënyrë, qenia që dëshiron të kalojë nga një gjendje amullie kah ajo e formuar, shfaqet në forma të tilla ekscesive, të cilat janë shumë tinëzare dhe të rrezikshme po s'u shikuan si duhet dhe po s'u zbërthyen me tërë kompleksitetin. Do të ishte verbësi e pafalshme që në këto veprime, të cilat në të parë duken fodullëqe, të mos shikohet kryeneçësia e tyre shpirtërore. Në këtë mënyrë ata luftojnë me të madhe që qenësia e tyre të mos pranojë asgjë nga ne. Dëshirojnë, pra të mbesin jashtë strukturës sonë historike, dëshirojnë t'i bëjnë bisht integritetit të ri perandorak... Heretizmi i tyre bëhet edhe më i madh, kur dihet se mësimeve tona perandorake po u binden me përulësinë më të madhe.

Andaj, nga ato që thashë më sipër, propozoj:

a) Që çështja e fenomenit të padukshmërisë së tyre të mos merret si rastisje apo farë shrregullimi personal, por si shprehje e kryenaçësisë së tyre shpirtërore, që ka për

qëllim t'u bëjë ballë mësimeve tona të shenjta dhe vetë forcës së Perandorisë së madhe;

b) Këto raste duhet të na bëjnë me dije se mësimet heretike, sado të padukshme qofshin ato, nuk bën të nënçmohen apo të lihen anash si të parrezikshme;

c) Që nesër a pasnesër të jemi të qetë dhe të sigurt se ajo që po ndërtojmë nuk do të rrezikohet nga çastet më të liga, jam i mendimit se Perandoria duhet të formojë shërbime të fshehta për të përcjellë pareshtur shpirtin e tyre. Ky shërbim duhet të merret ditë e natë me vetëdijen e tyre dhe të shënojë çdo lëvizje të saj. Madje të merret edhe me ëndrrat e tyre, ngase në to shpesh herë gjenden paralajmërimet e së keqes së tyre; dhe

d) T'u shkatërrohen sa më parë e pa humbur kohë ato që mendohet se e ushqejnë mendimin e tyre heretik. E mbi të gjitha t'u shemben shenjtëritë. Është dëshmuar kaherë se ata që u kthehen shejtërive të veta nuk çajnë kokën për ato që u ofrohen nga jashtë. Krahas rrënimit të shenjtërive të tyre, duhet bërë çmos që t'i lidhin për shejtëritë tona duhet ta dinë mirë e mirë se për çfarë shejtërish është fjala».

I përuluri juaj,
Idriz Allajbeu,
nënpunës i lartë i shërbimeve sekrete
të Perandorisë.

Kur i lexoi rreshtat e fundit gati se u ngri. Këtë po ia tregonin buzët fytyra dhe sytë që iu bënë akull.

«A po sheh, i tha Lartmadhëria, — pse ne u ngatërruam si shumë në ato anë. Humbëm shumë kohë pa pikë nevoje. E ç'është më keq, po në atë vend mund të fillojë ndonjë e keqe edhe më e madhe që mund t'i qesë Perandorisë telashe të jashtëzakonshme...»

Ai heshti. Më kot mundohej ta gjente fjalën më të përshtatshme për ta thënë. Ndjeu se e gjithë qenia i ishte zbrazur sa mund ta bartte edhe puhiza më e lehtë. Mbase edhe Lartmadhërisë, që ia hetoi shqetësimin, i erdhi keq që ai u shqetësua aq shumë. Megjithatë, i tha ai, — ne jemi Perandori e madhe dhe e fuqishme. Nuk u bëmë kot të tillë

dhe nuk na marrin për të fortë pa arsye. Kemi mundësi që secilës të ligë t'ia shkurtojmë rrënjët në kohë. Këtë do ta bëjmë! Nuk kemi rrugëdalje tjetër... Perandoria mund të jetë Perandori vetëm po qe se më kohë i heton rreziqet dhe më kohë merr masa kundër tyre...

Atë natë nuk futi gjumë në sy. E mbërtheu një ankth i rëndë që s'ju hoq gjatë. Herë djersitej, herë e kapnin ethet, e herë ngushtohej aq shumë sa i vinte t'ia hiqte vetes që të lirohej përfundimisht nga lëmshi në të cilin ishte ngatërruar keq. Edhe konturat e mjegulluara të Shehrit të vet iu tretën. Më kot u mundua ta përfytyronte vendlindjen. Më kot po mundohej ta rikrijonte njëfarë imazhi të saj. I shfaqej vetëm një si shkretëtirë e pafund në të cilën nuk kishte gjë prej gjëje. Pastaj, iu kujtuan fjalët e Idriz Allajbeut (për të cilin ishte i bindur se i kishte shkuar koka bashkë me të tjerët, sapo Lartmadhëria e kishte lexuar raportin e fshehtë). Plakat janë të rrezikshme... Shumë të rrezikshme... I bëhej se ai ia përsëriste ato fjalë pareshtur. A mos kishte shpifur ai kundër tij dhe kundër të tjerëve përreth tij? Mos ishte ky ndonjë komplot ndjellazi? Raporti po i sillej para dhe po i kërcënohej çuditërisht. Ç'ishin ato fjalë për herezinë e pashembullt? A është e mundur që një vend të shpallet menjëherë i rrezikshëm sipas ca thashethemeve? Pse s'u vërtetuan? A nuk kishte mundësi që e gjithë puna të shikohej mirë e mirë? Psehet po i shtoheshin e ai bëhej gjithnjë më i paaftë që t'u jepte përgjigje. Bile, i dukej se nuk kishte fuqi as të mendonte...

Edhe të nesërmen nuk fjeti, e gjumë në sy nuk futi as shumë netë të tjera. Nuk e ngushëlloi as mendimi se Lartmadhëria kishte të drejtë. Nuk i solli qetësi as pajtimi pikë për pikë me fjalët e heluesit të shkretë. Madje, nuk e ndjeu veten mirë as atëherë kur ia pranoi vetes njëfarë ndjenjeje të fajësisë, e as atëherë kur u pajtua me Lartmadhërinë që për hir të interesit të Perandorisë të merrnin sa më ngutshëm të gjitha masat e duhura... Kot... Edhe si urrejtës, edhe si fajtor, edhe si asnjanjës nuk po lirohej nga gjendja e rëndë. Dhe ishte në prak të një krize të thellë, kur e thirri prapë Lartmadhëria. Në atë çast ia preu mendja se mbase

do të qetësohej po të jepte dorëheqje nga posti i Kryevezirit. Bile, duke ecur sixhadeve të trasha, mendja ia thoshte se ishte njeri i lirë që nuk kishte pse e çante më kokën me hallet e dynjasë. Por, si t'ia kishte hetuar mendimet, Lartmadhëria i tha: «Të gjitha i kam të qarta... S'ke pse shqetësohesh... Trupi që sëmuret duhet të shërohet... Ilaçe mund të ketë edhe për sëmundjet trashëguese...»

Fjala «sëmundje trashëguese» iu duk e rëndë, aq e rëndë sa ndjeu se sërish iu kthye ankthi i atyre netëve të rënda, të cilat mendoi se i la pas. Në kokë zunë t'i vërtiten gjithfarë mendimesh të cunguara që e mbushën me të dridhura. Gjendjen e tij të rëndë e vërejtën të gjithë, madje edhe vetë Lartmadhëria. «Je bërë lima, i tha ai. — Për t'u shqetësuar duhet të shqetësohemi që të gjithë, por për t'u ligështuar nuk duhet të ligështohemi... Ka edhe më keq... Ka edhe më keq...».

Pastaj, i ofroi gotën e çajit e i foli për disa gjëra që i kishte treguar Shpjeguesi i ëndrrave lidhur me ca telashe që ishin shfaqur në disa krahina të Lindjes. Ato që po i dëgjonte, po i vinin në kokë të shkëputura, fare të shkëputura, si kallëzime pa ndonjë domethënie. Vetëm kur e zbrazi gotën e dytë iu bë se gjërat po i qartësoheshin paksa dhe ato që dëgjonte ishin fjalë të buta, madje pajtuese... «Allahu na e fali brengën, — po i thoshte ai, — që të jemi më të përbajtshëm dhe të gatshëm t'i kuptojmë gjërat më thellë dhe më mirë... Pa brengën si brengë nuk do të ishim këta që jemi... Do t'u gjasonim kafshëve... Vetëm ato nuk brengosen...»

Kur piu çajin e tretë dhe ndjeu shtrëngimin e zakonshëm në lukth (që i vinte nga ulçera), u kthjellua i tëri. Në atë çast Lartmadhëria i lëshoi para tri pliko ngjyrë hiri, të lidhura me dyll. Nuk e pati të qartë pse dylli në pliko, i ndrydhur me vulën e madhe të Perandorisë (që e njihte aq mirë), ia mori sytë sa iu bë se i qenë ngrirë në atë pikë.

«Këto tri pliko, — i tha ai, — do t'i marrësh me vete që nesër dhe do të nisesh... Të gjitha përgatitjet janë bërë si duhet. Plikot do t'i hapësh një nga një. Të parën do ta hapësh ditën që do t'i afrohesh Shehrit. Lexoje me vëme-

ndje dhe vepro pikë për pikë sipas udhëzimeve që do t'i gjesh në të. Kur të përmbushen të gjitha pikat e së parës, digje dhe hap të dytën. Ato që do të lexosh janë vetëm për ty... Nuk bën t'i dinë as bashkëpunëtorët e tu më të ngushtë. Misioni yt përfundon kur ta kallësh edhe plikon e tretë. Kaq».

Të tjerat nuk i dëgjoi. Sytë i qenë ndalur te plikot e mendja i qe ngrirë. Plikot me dyllin e verdhë dhe me vulën perandorake në mes, herë i rriteshin e i rriteshin e i bëheshin sa bjeshka, e herë i zvogëloheshin e i zvogëloheshin sa bëheshin si thngela... Iu bë se ato zunë të dridheshin, zunë të shungullonin, se po vegullonin. Gjithë shqetësim ato iu dukën edhe kur u largua nga Pallati i praruar, edhe kur hyri në Pallatin blu, e të tilla iu dukën edhe kur hyri në dhomën e madhe dhe u mbyll në të... Atë shqetësim ato po e shprehnin edhe nën jastëkun e butë, në të cilin ai gjithë natën nuk mundi t'i mbyllte sytë. Nën jastëk plikot po e ngacmonin edhe më. I bëhej se dikur zunë t'ia bartin kokën dikah në një lartësi që t'ia shihte e gjithë bota. Dhe bota habitej si fluturonte koka pa trup... I bëhej se poshtë po e tallnin. Dikush thoshte diçka e të tjerët bënin me gisht nga ai dhe qeshin... Të qeshurat nuk kishin fund dhe ai kërkonte që të shkonte larg e më larg ku nuk do ta shihnin, e prej nga nuk do t'i dëgjonte ato të qeshura... Dëshiroi të bëhej i padukshëm. Një mendim që i rrodhi nga një pjesë e tij e fshehur po i thoshte: padukshmëria të ndihmon... Padukshmëria të shpëton... Padukshmëria...

Në atë çast brofi në këmbë trembshëm. Më ndje, o perëndi, tha, më ndje!! M'i largo mendimet plangprishëse... Ma largo ndjenjën heretike që më pushtoi padashtas... Padukshmëria është pjellë e djallit... Ajo është antiperandorake... Më ndje... Hiqmi mendimet e liga!

Por, mendimet e liga nuk po i hiqeshin. Qe mpleksur si shumë me to dhe kush e di se çfarë mundi do t'i duhej të shpleksej prej tyre. I dëshpëruar, thirri klarinistin plak dhe i tha t'ia merrte një melodi nga ato që dinte. Zëri i klarinetit shpejt e mbushi dhomën me ngrohtësi. Por atij nuk po i hiqej sikleti. Bjeri! Bjeri! zuri të çirrej. E plaku i shkre-

të frynte me sa fuqi kishte. Dikur po i sosej fryma, kështu që melodia e klarinetës i vinte si gjëmë. Urdhëroi t'i sillnin edhe një klarinetist tjetër. Por edhe ai iu duk pak. Thirri gjithë orkestrën. Dhe, së fundi, në atë kohë të natës kërkoi valltarët. Pallati blu po shungullonte, e atij i dukej se gjithë ato çallgi dhe valle ishin hiçgjë. Nuk ishin në gjendje t'ia hiqnin boshllëkun që u kishte bërë mulla. Një çast iu bë se valltaret gjysmë të zhveshura me veloret e bardha në kokë po i shfaqeshin herë të dukshme e herë të padukshme. Kryepsitena e bardhë i kthehej në një tis mjegulle ne të cilin i zhyteshin valltaret herë pas here. Kjo e tmerroi. U çorr me sa zë kishte. Urdhëroi që ta linin vetëm. Çfarë po ngjet kështu?, tha. Çfarë?... Çfarë?... Herë po shoh e herë nuk po shoh... Mos jam sëmurë, tha duke e zënë kokën me duar, që ta hiqte nga ajo çfarëdo të ligë që do të mund t'i shfaqej pa dijeninë e tij. Më ndihmo, më ndihmo, Perëndi, tha dhe u përplas në sexhaden e purpurtë...

I shtrirë po fliste përçart dhe po lutej. Një copë herë mbeti i shtrirë dhe do të rrinte edhe më po të mos kishte trokitur dera.

U ngrit gjithë shkallmim dhe pa kryerojën që i tha se po e kërkonte Lartmadhëria.

Rruga deri te Pallati i praruar iu duk e mundimshme. Nuk i ndihmoi as fresku i natës së pahënë e as kundërmimi i jargovanëve që e donte aq shumë. Edhe jashtë koka po i shungullonte dhe ajo sa vinte e i shtohej. Te shatërvani i beharit lagu ballin dhe qafën. Ndoshta do ta fuste kokën në ujë po të mos e kishte truprojen pas. Për herë të parë i erdhi keq që nuk mundi të qante, të qeshte, të shante, të shfrynte e të shfrynte sipas dëshirës. I erdhi keq që duhej të mendonte për veprimet e tij më shumë se për vetveten. Gjithë dëshpërim e shikoi Pallatin e praruar dhe iu bë se ai po i largohej e po i largohej. Sa çel e mbyll sytë hetoi se Pallati nuk ishte aty. Iu bë se në vend të tij flakëronte një dritë verbuese. Përkoi sytë habitshëm, por pa se megjithatë Pallati ishte aty. Bile, më i madh dhe më krenar sesa kishte parë herave të tjera. Nuk vonoi e po ajo muranë e bardhë iu duk se po lëvizte. Ajo lëvizte herë djathtas e herë maj-

tas sa u rrëzua. Përpak sa s'u ça. Por, nuk pati nevojë ngase pas pak hetoi se Pallati as nuk lëkundej, as nuk shembej. Ishte aty ku rrinte gjithnjë. Gati plasi nga ai mashtrim. I erdhi të çirrej prapë. Madje, deshi ta bënte këtë, por hetoi se i ishte afruar si shumë dhe nuk kishte kthim prapa. Duhej të ecte kah Pallati, qe apo nuk qe ai aty. Gati symbyllтas nxitoi para dhe u ndal vetëm atëherë kur hetoi se para kishte rojet e shumta, të cilat po i përkuleshin dhe po i hapnin rrugën që të ngjitej shkallëve, në të cilat qilimi i kuq iu duk si gjarpër i pafundët...

«Sonte kemi festë, i tha Lartmadhëria. — Duhet ta marrësh uratën para se të nisesh në misionin e shenjtë... Së shpejti do të agojë dita më e rëndësishme, jo vetëm për ty, por për gjithë Perandorinë... Me fat!»

Deshi t'ia merrte temenanë, por nuk e bëri, ngase të djathtën e kishte të zënë me tri plikot që i shtrëngonte me sa forcë kishte. Lartmadhëria fliste e buzëqeshte, ndërsa ai sharroi padashtas në një mjegullim të dendur ku dallonte herë pas here shtatet e gërmuçura të ca luleve të zeza... Më vonë pa një fushë që i gjasonte një humbëtire, ku gjithçka ishte e papërcaktuar dhe e ftohtë... Nga ajo gjendje e trishtueshme e nxorën rrezet e para të diellit pranveror, të cilat së pari prekën mermerin dhe shtyllat e praruara me ar, e andej, të kthyera iu përplasën furishëm, sa i dogjën sytë. Vetëm atëherë u kthye aty ku ishte, në mizërinë e Pallatit. Vendin e shungullimave ia zuri një qetësi shurdhe, e cila i dukej se kishte pushtuar jo vetëm Pallatin e praruar, por gjithçka tjetër përreth, e madje tërë Perandorinë. Në atë gjendje e priti edhe ceremonialin e madh të përcjelljes. I ulur në krahun e djathtë të Lartmadhërisë, para pa vezirët që i rrinin në pjesën ballore dhe e shikonin si të kërkonin nga ai diçka të fshehtë. Iu bë se edhe ushtarakët e shumtë, kadiasqerët, kanditë, ulemaja e edhe muderrizët me të tjerët kërkonin nga ai po atë që nuk e dinte se çka ishte... Anash pa flamujt e luftës dhe stemat e llojllojshme të sanxhaqeve dhe të vilajeteve të panumërta të Perandorisë. Shumë prej atyre flamujve dhe stemave gjithfarëshe, që stoliseshin me rruza e me pupla, nuk i kishte

parë kurrë. Hajmalitë dhe eshtrat në to ia morën sytë sa iu shfaq një marramendje. Stemat dhe flamujt e panumërt iu pështjelluan aq shumë mes vetes sa tash iu bë se para po i shfaqej një grixhë e tërë kafshësh të egërsuara, të cilat me padurim pritnin të vërsuleshin dikah. Një kohë të gjatë u mor me kafshët që gjendeshin në emblema e me stema. Ato davariteshin dhe kërkonin që të liroheshin nga hapësirat në të cilat i kishin mbërthyer. Kur do të dalin nga ato korniza? po i thoshte vetes gjithë frikë. Ato një ditë do të dalin... Do të dalin... S'ka gjë që i pret... Do t'i sulen gjithë botës e së fundit edhe Pallatit të praruar... Do të dalin... Do të dalin, po i thoshte një zë tjetër për të cilin nuk ishte i sigurt se a ia thoshte frika e vet apo po i vinte nga jashtë. Do të dalin... Do të dalin... Botën do ta rrafshojnë... Kthetrat e tyre janë të pamëshirshme... Vaj halli për ata që s'e dinë këtë... Iu bë se kafshët e çartura po i këputnin vargojt, se po i bënin copë-copë parzmoret që i mbërthenin për emblema... Nga frika që kishte nga kafshimi i tyre tmerrues po zvogëlohej e po zvogëlohej sa u kthye në një thnegël që nuk shihej... Si fëmijë i kishte rënë të dëgjonte se thneglat e urata dhe punëtore nuk bëjnë tjetër pos që jetën e kalojnë duke lëvizur në mënyrë marramendëse e të shthurur pikërisht nga ndjenja e frikës. Ato bëjnë një jetikje. Jetikja ishte jeta e tyre... Më vonë qe bindur se instikti i frikës i kthyer në një jetikje ishte i njëmendët. Një thnegël që pat nxënë, e lëshoi në një çarçaf të madh të bardhë dhe ajo e gjora gjithë kohën u soll e u mbështoll nëpër hapësirën e bardhë duke ikur. Ikte dhe kërkonte të bënte diçka në atë vetikje. Thnegla nuk ishte në gjendje ta gjente ndonjë shteg për të dalë nga ajo hapësirë e bardhë kufizuese. Madje, edhe kur i afrohej cepit të skajshëm dhe mund të largohej nga hapësira kufizuese. ajo nuk e bënte këtë. Kthehej marramenthi dhe bënte të njëjtën bredhje të mundimshme. Vërtitej frikshëm... I tillë iu duk vetja atë çast midis mizërisë së jashtëzakonshme të flamujve, stemave e emblemave... Duhej të nisej dikah pa ditur sa do të qëndronte dhe nga do të sillej. E vetmja gjë që dinte ishte se nisej për në vendlindje, në krye të

një fushate. Të tjerat gjendeshin në ato tri plikotë në formë të urdhrave. A nuk gjëndej në një çarçaf të bardhë? A nuk ishte ai një mend një thnegël që do të bënte një jetikje të frikshme? Shikimi i kaloi prej njërës pjesë në tjetrën, prej njërës anë në tjetrën, prej njërës fytyrë në tjetrën dhe po shihte vetëm thnegla, thnegla të panumërta, që ngarendnin sipas instiktit të frikës dhe të përuljes... Nëpër çarçafin e madh mund të sorollateshin amshueshëm por tutje tij jo... Aty bënin atë jetën e dëgjueshme jetikëse... Ky mendim e turbulloi aq shumë sa gati volli. Ata që po i rrinin pranë (ishin vezirët) dhe të tjerët manash (ushtarakët e lartë), po i shihte vetëm si thnegla. O perëndi, murmuriti, pse u bënë thnegla?

Nga mendimet e liga e nxori zhurma që bënin ushtarët në parakalim. Përpara pa njësitë e shumta që ecnin me hap të rëndë dhe përshëndetnin. Me vete kishin flamujt e luftës bashkë me stemat dhe emblemat gjithfare. Iu bë se kafshët në to nuk ishin të shqetësuara. Të mbërthyera në hapësirat e stemave dhe të emblemave, i dukeshin të mundura. Një kohë të gjatë u pa bishtat e ulur dhe shenjat e ndryshme që i bartnin me vete, si stoli që s'u kishin hije... Kah mesdita parakalimi ushtarak mori fund. Vendin e tyre e zunë ulematë, dervishët, shehlerët dhe sektet e ndryshme fetare të viseve lindore të Perandorisë. Ata kërkonin, çirreshin dhe luteshin... Kërkonin fat dhe fitore të shpejtë. Kur i pa ato fytyra të gërvishura, nëpër të cilat currilët e gjakut rridhnin rrëke, e pati të qartë se po nisej në një fushatë luftarake të rendit të parë. Çjerrja dhe gërvishtja gjakosëse bëhej vetëm atëherë kur Perandoria nisej për të ndëshkuar ndonjë krahinë apo ata që ia kthenin fjalën... Perëndi, tha, pse më bëre thnegël? Pse?

Tjetër nuk tha më. U ndry në ngrirjen e vet dhe bëri përpjekje që gjërat t'i merrte ashtu si ishin, pa dëshiruar as t'u shtonte e as t'u pakësonte gjë. Bile, gjakftohtësinë e ruajti edhe kur erdhi çasti të nisej. Uratës së Lartmadhërisë (dalsh faqebardhë!) as që iu përgjigj. Buzët e tij të ftohta mezi e puthën dorën që i rrinte përmbi...

I ftohtë mbeti edhe gjatë gjithë pjesës më të madhe të

rrugës. I shtrirë në karrocën e kaltër ngushëllohej me heshtjen e vet. Nuk i ndjente as shalakatjet e pafundme të taboreve të panumërta që zvarriteshin nëpër rrugën gjarpërore, nuk i ndjente as trokëllimat e kalorësisë, e nuk ua vinte veshin as telasheve të atyre të njësive të xhenios që u dilnin me topat shumë të rëndë të cilët i hiqnin mundimshëm. Veshin nuk ua vinte as dërdëllisjeve të vashave të haremit të cilat i shkonin pas me shumë shërbime të tjera gjithfare, që ia bënin me dije dimensionin e gjerë dhe të gjatë të fushatës. Ftohtas i priste edhe raportet e përditshme që ia lexonte veqili, të hartuara në pika të shkurtra nga moria e informatave që i vinin nga ushtarakët e shumtë dhe nga shërbimet e tjera përcjellëse. Mbase qëndrimi i tij i akullt bëri që atmosfera entuziaste e fushatës, që filloi me ceremonialin madhështor në Kryesheher, të binte pak nga pak. Bile, ata që i rrinin pranë dhe e shihnin të ngrysur sado që s'e thonin, e merrnin për shenjë të keqe. Kishin frikë se mos po fillonte koha e fushatave të pafund, të cilat dikur nisnin në pranverë, po me të njëjtin ceremonial, dhe përfundonin me disfata me të filluar shirat e para të vjeshtës.

Brenga e të tjerëve e gjeti edhe atë, sado padashtas. Dhe, ajo po i shtohej sa më shumë që i afrohej vendlindjes. Thneglat kanë të njëjtin fat, tha si përçart. Nga ky mendim u frikësua aq shumë sa u ngrit me të shpejtë dhe hodhi para plikot që mbante nën jastëk. Një copë herë i shikoi si të kërkonte prej tyre diçka që do t'ia hiqte frikën. Por, ato i sollën ftohtësi edhe më të madhe. Numrat në to (një, dy e tre) po i ktheheshin në shpata. Iu bë se numrat-shpata po i rrinin në pritë që një çast ta sulmonin patjetër. Çështja ishte se kur do ta bënin këtë për t'ia marrë medoemos kokën. Kokën, pastaj, do t'ua merrnin edhe ushtarakëve, shërbimeve përcjellëse dhe të gjithëve. E kokat do t'ua merrnin edhe grave të haremit... Kjo e trishtoi dhe ia mori qetësinë. Aty për aty iu qepën mendimet të cilave u frikësohej aq shumë e që me mjaft mund u kishte bishtëruar gjatë pjesës më të madhe të rrugës. Këto kishin të bënin me ato që shkruante në plikot e mbyllura. E dinte se një ditë duhej

medoemos t'ia shtronte atë pyetje vetes. Deshi apo s'deshi duhej ta vriste mendjen me ato shkrime. Por, tash iu bë e qartë se ato shkrime ishin vetëm urdhra, urdhra të prerë që i përcaktonin sjelljet, veprimet dhe të menduarit. Atyre duhej t'u përmbahej deri në fund. A nuk ia bënte me dije këtë edhe vetë radhitja prej një deri në tre? Se ishin urdhra lufte, këtë e kishte të qartë edhe për faktin se me vete kishte taborre të panumërta të ushtrisë e me vete kishte topat më të mëdhenj që ishin përdorur deri atëherë. Por nuk e kishte të qartë çfarë i duheshin një fushate të tillë hetuesit e shumtë, kadiasqerët, kaditë, hulumtuesit e ndryshëm? Po të qe puna për shtruarjen e një Shehri (ah, Shehri i vogël që i ishte zvetënuar kaherë nga kujtimet), do të mjaftonte një grusht ushtarësh. Madje këtë do të mund ta bënin ata që gjendeshin atje, pa pasur nevojë t'u vinin në ndihmë njësitë më të mira të Perandorisë. Po të qe puna për dy tri plaka të padukshme, atëherë çfarë kërkonte ushtria me to? A ishin ato, vallë, aq të fuqishme që me to të luftonte Perandoria e tërë? Me sa i kishte rënë të kuptonte nga ato që i shkruante Allajbeu, plakat merreshin me të vdekurit dhe nuk u bënin gjë të gjallëve. Ç'duhej, pra, gjithë ajo hata ushtrie? Hata ushtria është për hata... Ky mendim e trishtoi. Hata, hata ushtri, hata... Hata luftë, por edhe hata dështime... A thua po përsëriteshin kohët kur vitet kujtoheshin me disfatat dhe me kokat e prera të vezirëve të ekspozuara në kamarën e turpit? Iu bë se kokën ia priste i njëjti fat. Dita dhe muaji i prerjes gjendej në njërën ndër ato tri pliko...

Kur do të vijë ajo kohë? — tha dëshpërueshëm.

Por koha nuk po ecte. Në të vërtetë atij i dukej se sillej në një labirinth të pafund bashkë me ata që i shkonin pas. Në atë labirinth vërtitej e vërtitej, herë andej e herë këndej, pa parë ndonjë shteg. Në vend të shtigjeve shihte pliko. Shihte shumë sosh, jo tri, por tridhjetë e tri, treqind e tridhjetë e tri... Shihte tresha të pafund që lidheshin varg mes vetes. Vargoi po e përthekonte fuqishëm nga të gjitha anët. Mbase nga ai mbërthim nuk do të lirohej kurrë, po të mos

e kishte parë kadiasqerin që po i rrinte para dhe po bëhej gati t'i thoshte diçka.

I erdhi mirë që do ta dëgjonte lajmin për arritjen. Ai lajm do ta lironte nga ankthet e shumta dhe nga plogështia shpirtërore. Nga ai çast do të futej në kohën e urdhrave...

Koha e urdhrave... Koha e plikove... Koha e pakohë...

Nga këto mendime doli sapo hetoi se tashmë terri kishte pushtuar fushën e gjerë në thellësinë e së cilës strukej Shehri i vendlindjes. Ktheu kokën pas dhe mezi dalloi tendat e panumërta që shtriheshin jo fort larg tij. Ushtria e lodhur nga udha e gjatë shlodhej. Gjithçka ishte zhytur në heshtjen e natës. Vetëm mendja e tij rrinte zgjuar dhe kërkonte plikot. Erdhi koha e tyre, pështpëriti. Erdhi koha e plikove... Koha e urdhrave...

Me përtesë u kthye në tendë. Sytë i zunë plikot. Iu dukën pa atë peshën që kishin pasur deri pak më parë. Vetëm dylli i verdhë në mes dhe vula e madhe e Perandorisë ia bënin me dije se fjala ishte për gjëra të rëndësishme... Një copë herë plikot deshi t'i shihte të zhveshura nga rëndësia e porosive që bartnin. Por nuk vonoi e ato prapë po i ktheheshin në shpata. Bile, ajo me numrin një po i kërcënohej. Nga frika që ajo shpatë do t'i sulej, hapi plikon me numër një dhe i bindur se po luftonte me dikë që dëshironte ta mposhtte, e shqeu. Ndjeu plasaritjen e dyllit dhe shkëputjen e fjongos që lëshuan një krismë të thatë...

Para vetes pa një letër të bardhë bashkë me një pliko tjetër të vogël në të cilën shkruhej: «T'i dorëzohet Kryehetuesit sapo të lexohet letra bazë.»

O zot, tha, ç'poshtërim!

Ra poshtë si i vdekur. Një copë herë mbeti i ngrirë. Ju bë se gjendej në një çarçaf të bardhë duke kërkuar një shteg. Ishte kthyer në një thnegël të vogël e cila zvarritej gjith plogështi nëpër hapësirën e bardhë që nuk kishte fund. Më vonë, pak nga pak u këndell. Trupit të shkallmuar po i kthehej forca e nevojshme për të mbajtur drejtpeshimin. Dhe kur bëri të ngrihej, prapë i doli letra e vogël para me porosinë për Kryehetuesin. Ishte e thjeshtë. Po të mos ishte shkrimi i Lartmadhërisë në të, as që do ta vërente. Ishte i

bindur se ajo letër e vogël përmbante porosi të mëdha. Por ç'gjëra ishin, vallë, ato që ai nuk duhej t'i dinte, por një tjetër, i cili i nënshtrohej urdhrit të tij? Një copë herë e mundoi ky mendim dhe sa më shumë që vriste mendjen, gjërat më shumë i mjegulloheshin. Një çast, mbase sa për ta ngushëlluar veten, mendoi se mund të ishte ndonjë porosi që nuk çonte peshë, me të cilën nuk dëshironte Lartmadhëria ta lodhte, ngase kishte punë shumë më të mençura. Ishte gati të pajtohej me atë mendim, por as kjo nuk e qetësoi. Fakti se ajo porosi gjendej në ato pliko dhe kushtëzohej me fjalët «... t'i dorëzohet Kryehetuesit sapo të lexohet letra bazë», ia bënte me dije se fjala ishte për ndonjë dredhi të madhe e cila po kurdisej kundër tij...

Nga ky mendim u drodh. Të dridhurat i nisën nga gishtat e këmbëve dhe i shkuan vetëtimthi deri në kokë. Po i dridhej edhe letra, që mezi ia mbanin duart, por që ishte koha ta lexonte. Nga ato të dridhura iu bë se do t'i shpëtonte letra. E shtrëngoi me sa forcë kishte dhe e hapi me dorën tjetër. Pra i doli fjala «Urdhërese» e shkruar me shkronja të mëdha, të cilat po ashtu po i dridheshin dhe po i shkonin herë majtas e herë djathtas. Dikur iu bë se shkronjat u qetësuan dhe ai lexoi:

1. Ushtria të ndahet një orë larg Shehrit.
2. Të shlodhet katër ditë,
3. Pas iqindisë së ditës së pestë të shpallet s h t e t - r r e t h i m i.
4. Po atë pasdite të rrethohet Shehri dhe të shkëputet nga bota.
5. Në mbrëmje të thirren këta persona: Komandanti i operativës ushtarake kryeinxhinieri Harun Oglu, Kadiasqeri, Milaim Agai, Serasqeri Hamdi Beu, Shpjeguesi i ëndrrave, Kronisti dhe përgjegjësja e haremit Hyrije Hanmi.
6. Të gjithëve t'u thuhet se duhet të kryejnë detyrat e veta. Për këtë kanë tridhjetë ditë afat. Pas tridhjetë ditësh në të njëjtën kohë, secili të raportojë për kryerjen e detyrave të marra nga ky ferman. Po qe se punët ngecin, koha e shtetrrethimit zgjatet edhe për tridhjetë ditë të tjera. E nëse ngjet që edhe pas tridhjetë ditëshit të dytë

diçka do të çalojë, atëherë shpallet shtetrrethimi i pakufishëm, i cili zgjat përderi sa të vijë fermani tjetër që zhvleftëson këtë masë.

7. Plikoja e dytë të hapet pas tridhjetë ditësh, pas gjashtëdhjetë ditësh, apo vetëm atëherë kur të përmbushen të gjitha nga plikoja e parë. Kështu duhet të veprohet edhe me plikon e tretë.

8. Plikoja të kallet sapo të hapet dhe

9. Plikoja e vogël t'i jepet Kryehetuesit sapo të marrë fund puna.

Në fund pa nënshkrimin e Lartmadhërisë që e njihte mirë. Por tash ai nënshkrim iu duk i ngatërruar, si merimangë që end rrjetën e vet në të gjitha anët dhe vë prita për prenë e vet... A nuk ishte i kurthuar ai në atë pjesë? Kjo ndjenjë e ligështoi aq shumë sa ishte gati të shpërthente në vaj, por iu kujtuan fjalët e fundit të urdhëresës dhe plikoja e vogël në të, që duhej t'i dorëzohej menjëherë Kryehetuesit. Ishte i bindur se Kryehetuesi priste tashmë atë thirrje. Madje, mendja ia tha se ai po bëhej gati të hynte në tendë me mospërfillje. Për t'i ikur nënçmimit tjetër edhe më të madh, siç e ndjeu kur e lexoi urdhëresën, vendosi që atë t'ia jepte veqilit që ai t'ia dorëzonte Kryehetuesit, edhe pse e dinte se bënte shkelje për të cilën herët a vonë do të jepte llogari... Edhe miza e zënë në rrjetën e merimangës ka të drejtë të kundërshtojë, i tha vetes, apo jo? Këtë «apo jo» i tha vetes disa herë dhe një buzëqeshje e ftohtë që i kaloi fytyrës, ia ktheu asaj përpak gjallërinë që e kishte humbur kaherë. Bile, kur erdhi komandanti me katër ushtarakët e lartë, dukej i hareshëm, sa ata, të mësuar me ngrysjen e tij, u befasuan.

— Gëzohemi që të shohim plot gjallëri, Madhëri, — i thanë dhe iu përkulën.

U dha izë dhe i shikoi të katërt me njëfarë dhembsurie. Dhe, nuk e diti as vetë pse ata iu bënë se ishin pjesë e tij, se ishin ai, se ishin një shumësi e tij e përsëritur, e cila bashkërisht nuk vlente sa Kryehetuesi...

— Bëmë një udhëtim të gjatë e të mundimshëm. Por, ç'e do kur e kemi detyrë.

— Ashtu është, — thanë ata si me një gojë.
— Ushtria e ka hak një shlodhje.
Ushtarakët pohuan me kokë.
— Të themi nja tri? Katër?
— Si të thoni ju.
— Pra, katër?
— Fjala juaj.
— Tash për tash kaq, e pastaj shohim e bëjmë...

Ushtarakët u ngritën. Përshëndetën sipas zakonit dhe dolën. Ishin të kënaqur që pas udhës së gjatë do të pushonin sadopak. I kënaqur mbeti edhe Pashai për shtrirjen rreth ditëve të pushimit të ushtrisë. Por ajo ndjenjë shpejt i iku. Në kokë iu qep pika e tretë e urdhëresës në të cilën bëhej fjalë për shpalljen e shtetrrethimit dhe mbylljen e Shehrit. Tash e kishte të qartë pse po i printe një ushtrie kaq të madhe, e të qarta i kishte edhe ato që kishin të bënin «me kryerjen e detyrave të secilit veç e veç» për të cilat bëhej fjalë në urdhëresë. Do të bëhet një hata, përshpëriti, do të bëhet kasaphanë e paparë... Gjaku do të shkojë rrëke dhe do të bëhet lumë. Iu bë se atë lumë po e shihte, se ai lumë po fryhej, se e kishte formuar shtratin e vet... ai lumë po e merrte edhe atë bashkë me Shehrin dhe gjithë krahinën... A thua e gjithë kjo bëhej vetëm për ato dy plaka që i kishte harruar vdekja, apo gjithçka lidhej me porositë e letrës së Idriz Allajbeut «që Perandoria t'ia priste hovin një herë e mirë herezisë e cila mund të përhapej prej këndej si murtajë e pandalshme...» Iu duk se po shihte Idriz Allajbeun duke dhënë gjithfarë porosish për t'u mbrojtur «nga rreziku i jashtëzakonshëm». Ai kërkonte fushatë të shenjtë. Fliste pa ia ndarë për një të ligë që s'e kishte shoqen. Perandoria, Perandoria, çirrej ai, është në rrezik... Ju nuk e dini se ç'shpirt heretik kanë ata... Nuk e dini se ç'dëme mund t'u bëhen mësimeve tona nga ata plangprishës, që nuk përfillin normat e shenjta... Këta njerëz e kanë në shpirt urrejtjen kundër nesh... Të tillë lindin dhe të tillë vdesin... Kot humbim kohë t'i bëjmë për vete... Kot... Kot merremi me ta... Gjithçka e tyre është e rre-

zikshme dhe armiqësore... Gjithçka... Armiqësore... Armiqësi...

Fjalët e Allajbeut dikur i pa të kthyera në shpata. Shpatat po shumoheshin e po shumoheshin dhe suleshin si një breshëri e madhe. Ajo breshëri po e rrethonte dhe po ia kërkonte kokën... Frikshëm iu kujtuan plakat, të cilat mund të bëheshin të padukshme. Ato s'ka gjë që i zë, i tha mendja. Herë shihen, e herë nuk shihen. Kur nuk shihen bëhen të padukshme dhe t'i lënë këmbët e harushës. Kur u bind se si i padukshëm mund t'u ikte shpatave vdekjeprurëse, hetoi se shpatat nuk i kishte pranë. Nuk po e vërente as Idriz Allajbeun. Ishte vetëm, fillikat vetëm, i bërë një nga djersët që po i shkonin trupit. Më ndje, o perëndi, më ndje, tha. Më ndje për mendimin heretik që nuk po më ndahet. Preku ballin disa herë si të dëshironte që nga koka t'i çrrënjoste mendimet e liga... Më ndje, o i madh, dhe m'i fal mëkatet. Unë, robi yt, jam vetëm një urdhërkryes i thjeshtë... Ma kthe, së paku, qetësinë dhe gjumin...

Por, qetësia e gjumi nuk iu kthye as atë natë, as netëve të tjera, as kurrë më. Mendimet e liga e gjenin edhe atëherë kur ia pranonte vetes nënçmimin më të madh, se ishte një hiç hiçi, se nuk meritonte fat më të mirë. A nuk ishte ky shpjegim i mjaftueshëm për të gjetur njëfarë qetësie të rreme? Por, sa më tepër që pranonte hiçësinë, shqetësimi i bëhej edhe më i madh. Ia thoshte mendja se do të duhej të ishte e kundërta. Por ja se gjërat i ishin ngatërruar si shumë dhe ai nuk dinte me tamam se çfarë ishte e mirë dhe çfarë ishte e ligë, çfarë vlente dhe çfarë nuk vlente. Në atë pështjellim të ankthshëm, i bëhej se dikush i lexonte pjesët e urdhëresës, e herë i bëhej se atë punë e bënin mbase vetë plakat e padukshme. Nganjëherë mendja i thoshte se ato i rrinin pranë në tendë dhe kërkonin t'i thoshin diçka... Për t'i ikur trishtimit thirri çallgaxhinjtë dhe valltaret. Tri ditë e tri net tenda e tij gumëzhiu nga çallgitë. Ai rrinte si i ngrirë në minder. Të gjithë e dinin se ai nuk ishte aheng por një shqetësim i thellë në të cilin kishte rënë. Ushtarakët kërkonin të dinin se ç'siklet ishte ai që e mundonte dhe e shtynte t'i mbante çallgitë në mënyrë aq të panatyrshme.

Dikush tha se brenga e tij kishte të bënte me faktin se gjendej në vendlindje dhe, deshi e nuk deshi kundër saj do ta përdorte ushtrinë... Ahengu pushoi natën e kaltërt, kur në tendën e kaltër hyri Kryehetuesi. Pashai, që ia mbante mend emrin prej plikos së vogël, pa i thënë që veqili, e pati të qartë se ishte Kryehetuesi. Po vinte tamam në kohën që e kishte paraparë se do të shfaqej. Çështja ishte vetëm se çfarë lajmesh do të sillte. Madje, edhe për një gjë ishte i sigurt: se ato që do t'i thoshte ai njeri me fytyrë dinake e sy të egër lidheshin patjetër me pikën e tretë të urdhëresës, pra me shpalljen e shtetrrethimit dhe shkëputjen e Shehrit nga bota. E ai, si ta hetonte mendimin e Pashait, pasi u përkul dhe kërkoi leje të fliste, tha:

— Masakër, Madhëri!

Pashai u shtang. Iu mor goja dhe vetëm pasi preku disa herë ballin e fytyrën gjeti forcë të fliste ashtu sa nuk e njohu as zërin e vet:

— Për çfarë masakre po flet? A mos je në gjumë?

— Na i masakruan ushtarët, — foli ai ftohtas, si të kumtonte ndonjë lajm të rëndomtë.

Kryeveziri mend plasi nga qëndrimi i tij mospërfillës. Pa shpatën që e kishte pranë dhe i shkoi mendja ta ndante përgjysmë, edhe pse e dinte se gjithçka më vonë do të ngatërrohej keqas e mbase do t'i shkonte edhe koka. Një copë herë e çoi mendjen gjetkë dhe vetëm pasi u qetësua paksa e pyeti:

— Kush i masakroi ushtarët?

Kryehetuesi ngrehu kokën më lart sesa duhej ta mbante në raste të tilla dhe tha:

— Vendësit, Madhëri, vendësit... Kush tjetër do ta bënte?

Prapë foli në mënyrë mospërfillëse sa Pashai u shtang nga zemërimi që po i sillej furishëm trupit. Sytë prapë i zunë shpatën. I mbylli që të mos e shihte më as shpatën e as Kryehetuesin që po i rrinte pranë dhe po i fliste për masakrën si për diçka të rëndomtë: «...ushtarët tanë po pinin ujë... u thanë se uji është i shenjtë... nuk duron ta përdhosin të huajt... uji... përdhosja... pastaj, thikat pra-

pa... thikat e shumta dhe gjaku i ushtarëve tanë që skuqi ujin...»

— Mjaft! Mjaft! shfryu. — Koka po më pëlcet! Të gjitha i kam të qarta!

Kryehetuesi u ngrit ngadalë dhe po bëhej gati të largohej.

Pashai nuk e shihte dot me sy. Zuri kokën me duar që të mos ia shihte fytyrën dinake. Dronte se në atë gjendje të rëndë mund të thoshte diçka që nuk duhej ta thoshte...

— Madhëri, — foli Kryehetuesi me një zë të prajshëm, — kjo është për Ju. Të gjitha hollësitë e nevojshme i keni në të...

— Mirë, — foli Pashai, pa e prekur me dorë letrën që la ai. — Detyrën tënde e kreve. Detyrën tënde...

Deshi të thoshte edhe diçka, por e la përgjysmë.

Kur doli Kryehetuesi iu bë se tenda po i skuqej e po i skuqej e po i mbushej me gjak. Gjaku po i rridhte në formë të currilave të shumtë, të cilët vinin nga të gjitha anët. I bëhej se prapa secilit curril gjaku, shihte hijen e gjatë të Kryehetuesit. Ajo hije i përzihej dhe i bëhej një me gjakun, me atë gjak të vetin që vinte nga të gjitha anët, e në të cilin po sharronte. Nuk e kishte të qartë se a e zuri gjakun ngojë, por kur hapi sytë pa ushtarakët që po i rrinin para si të ngrirë.

— Duhet ta dini se u derdh gjak, — tha si i shkallmuar, — se u bë një masakër e temrrshme... Thika të shumta vezulluan dhe u lyen me gjak... Shumë thika... Shumë gjak... Një det gjak. Një det gjak rrodhi e thikat nuk u panë... Thikat... Gjaku... Çfarë po ngjet me ne...

Ushtarakët që tashmë e dinin punën e masakrës, e shikuan gjatë Kryevezirin që fliste përçart për thikat dhe gjakun. Goja e tij i sillte dhe i pështillte ato fjalë pa ndonjë rend, sa ata zunë të brengoseshin për gjendjen e tij. Vetëm atëherë kur ferku i parë i mëngjesit gjeti tendën, ushtarakët panë se Pashai u rrethua disi dhe ua tha troç ato që i kishte thënë Kryehetuesi. Ushtarakët shënuan diçka ndërsa ai dha urdhër që edhe të tjerët të vinin me ngut. Kur veqili kërkoi të dinte se cilët ishin ata të tjerët që duhej

të vinin, Pashai u zu ngushtë. Emrat që kishte lexuar në urdhëresë tashmë i kishin dalë mendsh. Nuk dëshironte që para ushtarakëve të lartë ta shfletonte sërish letrën, të cilën duhej ta mbante pa e parë kush derisa t'i vinte çasti i zhvleftësimit (pra të kallej) dhe të hapej plikoja tjetër. Murmuriti disa herë dhe me përpjekje të mëdha ia doli t'i thoshte emrat e atyre që gjendeshin në urdhëresë. Veqili, që kishte dëgjuar me aq kujdes ato që i tha Pashai, në mënyrë që të mos i shpëtonte asgjë, përmendjen e emrit të përgjegjëses së haremit deshi ta merrte si gabim apo ngatërrim emrash. Bile, si të dëshironte ta zhbënte atë fjalë para ushtarakëve, i përsëriti emrat e atyre që duhej t'i thërriste dhe qëllimisht e la pa përmendur atë të përgjegjëses së haremit. Pashai, që atë çast nuk fliste me vullnetin e vet por sipas urdhëresës, i bëri me dije se duhej ta thërriste edhe Hyrije Hanmin.

Nuk vonoi dhe në tendë, një nga një, hynë të ftuarit. E fundit erdhi Hyrije Hanmi, e veshur me një fustan të zi me ca rruza të bardha që i shkëlqenin. Askush nuk e kishte të qartë se çfarë kërkonte ajo grua në atë mbledhje aq të rëndësishme. Për ta bërë hutimin e tyre edhe më të madh, Hyrije Hanmi mezi përshëndeti Pashain, e të tjerëve u lëshoi një shikim mospërfillës.

Ai përcolli me sy një copë herë gruan që e njihte aq mirë, e më pas shikimi i tij i lodhur i kapi edhe ata që i kishte pranë dhe rrinin si të shtangur. Si do t'ia fillonte, vallë? Nga çasti që e kishte lexuar urdhëresën dhe i mori vesh gjithë ato që ishin në të, e pati të qartë se ai ishte vënë në një lojë që nuk i shihej fundi. Kishte rolin e mbikëqyrësit pa ditur se çfarë bënin të tjerët në prapaskenë. Duhej të nënshkruante, duhej të rrinte në tendë dhe nga ai vend të përcillte ato që do të ngjanin tutje në Sheher pa pasur të drejtë të pyeste e të dinte se çfarë njëmend po ngjiste. Duhej të priste tridhjetë ditë, të priste pastaj edhe tridhjetë të tjera dhe, së fundit, të jepte njëfarë mendimi për shtetrrethimin, që nuk ishte e thënë se mund të përfillej. Dhe, ç'është më keq, ai duhej të shtirej se i dinte të gjitha... Kjo ia turbulloi kokën në atë masë sa ata që kishte pranë

po i dukeshin si hije. Hijet kreshpëroheshin dhe të ngatërruara përhapeshin frikshëm në të gjitha anët... Një copë herë u mor me hijet dhe ndoshta do të dilte jashtë për të kërkuar shpëtim nga ankthi që i frikësohej po të mos kishte ndeshur shikimin e ëmbël të Hyrije Hanmit, që e nxori çuditërisht nga moria e hijeve. Mbase vetëm ajo është e sinqertë në mesin e atyreve që kishte përpara. Të tjerët, kush më shumë e kush më pak, kanë detyra për të punuar kundër tij, mendoi... Mbase, mbase, tha dhe u kollit disa herë për të thyer qetësinë e akullt që hetoi në atë vend prej nga duhej të fliste gjithsesi.

— Tashmë të gjithë e dinë lajmin e zi, — zuri të fliste me një zë të çjerrë sa as vetë nuk ishte i bindur se ato që thoshte gjenin veshin e të tjerëve. — Masakra u bë... Ushtarët na u therën si qengjat... Ky është provokim i rëndë dhe nuk është i rastit... U përgatit kohë e kohë... E përgatiti ai që dëshironte gjak dhe përçarje...

Një copë herë foli për masakrën dhe sa më shumë që fliste, i bëhej se mbllaçiste diçka që i kapej për goje dhe nuk shkëputej nga ajo për të dalë si e formësuar dhe e qartësuar. Për t'i ikur ndonjë hutimi më të madh, shpejt e shpejt iu kthye çështjes së urdhëresës. Duhej të thoshte ato që ishin për t'u thënë. Me urdhëresat gjithnjë ishte më lehtë. Ai që rrinte më lart i merrte përsipër të gjitha. Por këtë herë porositë-urdhra të urdhëresës ai nuk duhej t'i thoshte si të thata. Atë duhej ta jepte në atë mënyrë që të dukej si urdhër i tij, i hartuar aty për aty, nga gjendja e krijuar. Një e qeshur e thartë i kaloi fytyrës kur i ra ndërmend improvizimi i rremë. Pse vallë duhej ta luante një lojë të tillë? Ç'fron i lartë është ai që të poshtëron pareshtur?... Për t'i ikur turbullimit që i shfaqej sa herë merrej me mendime të tilla, tha:

— Siç ndodh në raste të tilla, kur Perandoria rrezikohet e i prishet rendi e siguria jam i detyruar që, bazuar në rrethanat e reja tepër të vështirësuara, të shpall fermanin e posaçëm...

Me të dëgjuar fjalën ferman të gjithë u ngritën në këmbë dhe morën qëndrim gatitu. U ngrit edhe vetë Pashai të cilit zuri t'i dridhej letra në dorë.

Pasi i shikoi të gjithë, tha:

— Pas masakrës së përgjakshme, ku na u vranë njëzet e shtatë ushtarë, për t'i penguar shrregullimet e mëtutjeshme, që mund të rrezikojnë gjithë Perandorinë, bazuar në kompetencat e plotfuqishme, të cilat gjithnjë i bart nga Lartmadhëria, e shpall këtë ferman të plotfuqishëm.

Fjalët e fundit i theksoi aq shumë, sa ato tingëllonin si ndonjë kërcënim i hapët.

Pastaj nisi të lexonte ato që kishte në letër:

1. Shtetrrethimi e përfshin Shehrin dhe rrethinën e tij me gjithë luginën e gjerë që nga bjeshka në perëndim dhe deri në lumë nga lindja.

Territori shpallet si i mbyllur.

2. Taborret tona duhet ta rrethojnë menjëherë territorin e përmendur.

3. Administrata ushtarake merr përsipër qeverisjen e vendit dhe mbikëqyr të gjitha segmentet e jetës shoqërore dhe ato private.

4. Pushteti i deritanishëm i nënshtrohet plotësisht administrimit ushtarak dhe vihet në dispozicion të tij.

5. Ngrihen gjyqet e jashtëzakonshme. Ato duhet të punojnë shpejt e shpejt dhe mirë. Mëshirë nuk duhet të ketë për armiqtë e Perandorisë.

6. Ndaj atyre që në çfarëdo mënyre nuk u përmbahen urdhrave të këtij fermani duhet të merren masat më të rrepta në pajtim me ato që parasheh fermani.

7. Shtetrrethimi tash për tash zgjat tridhjetë ditë dhe mund të vazhdohet edhe për tridhjetë të tjera, po qe se vërtetohet se ekzistojnë kushtet për një gjë të tillë. Nëse edhe pas gjashtëdhjetë ditësh vlerësohet se asgjë nuk ka ndryshuar e rreziku ekziston, atëherë shtetrrethimi vazhdohet me afat të pacaktuar.

8. Ky ferman mund të zhvleftësohet vetëm me fermanin e lartë të Perandorisë.

Kaq pata, — tha Pashai. — Mbase e dini se çfarë do të thotë të jetosh dhe të veprosh në rrethanat e shtetrrethimit dhe të administrimit ushtarak?

Ushtarakët, me të përfunduar leximi i fermanit, pasi

kërkuan lejë, u ngritën dhe dolën. Në të dalë Pashai u tha se i pritnin detyra të mëdha dhe me përgjegjësi të jashtëzakonshme.

Të tjerët po pritnin se a do t'u thoshte Pashai edhe ndonjë fjalë para se të ndaheshin secili në punë të vet. E ai i shikoi një copë herë dhe sërish po i shihte si hije. Nga frika e ankthit u dha shenjë që të shkonin sa më parë. Dëshironte të rrinte vetëm, fillikat vetëm, që askush mos t'ia shihte ligështimin që e parandjente se do ta përfshinte së shpejti.

Tenda u zbraz shpejt dhe kur iu bë se mbeti vetëm, ndjeu zërin e butë të Hyrije Hanmit që po i thoshte:

— Është koha më në fund të më vizitosh... Ka ca gjëra që nuk bën të harrohen... Tekefundit i duhemi njëri-tjetrit... Nuk kemi nga t'ia mbajmë... Këtë e dimë që të dy... Apo jo?

E pa fytyrën e saj të hareshme që i ishte afruar dhe iu duk se në të pa një ngashërim që s'e kishte hetuar më parë.

— Njëmend, njëmend, murmuriti, — disa gjëra nuk bën të harrohen... Vlejnë më shumë se punët e botës...

Aty për aty i shkoi mendja se duhej të shkonte në tendën ngjyrë vjollcë te Hyrije Hanmi, se këtë ishte dashur ta bënte më shpesh, e mbase gjithë rrugën ta kalonte në të...

Hyrije Hanmi, që ia vërejti në fytyrë flakërimin e ndjenjave, të cilat ia njihte mirë, duke e zënë për dore i tha:

— E dija se ca gjëra i kupton si duhet... E dija...

Ai e mbërtheu dorën e saj për të vetën. E shtrëngoi fuqishëm dhe do të shkonte po atë çast me të, po të mos i kujtohej se së shpejti duhej t'u bënte nderimin ushtarëve të masakruar.

— Në djall, — fshau, — në djall! Në djall të venë të gjallët dhe të vdekurit... Në djall të venë të gjithë...

Dielli pranveror po shkëlqente hareshëm kur u shfaqën qerret me të masakruarit. Numëroi njëzet e shtatë tabute të mbuluara me çevre jeshile. Anash u shkonin hoxhallarët dhe dervishët e shumtë, duke kënduar dua. Allah

katilat! Allah katilat! çirreshin. Vdekje katilave! Vdekje! Zërin e kishin plot shfrime ogurzeza.

— Allah katilat! Vdekje katilave!

Koka po i zjente nga ato klithje. Me dëshirë do të largohej, por nuk kishte si. Puna e donte të rrinte aty dhe t'i nderonte shehitët e Perandoris*...

Shikoi diellin dhe pa se ai po i afrohej zenitit. Megjithatë rrezet i kishte mikluese. Edhe pak, mendoi, kur dita do të marrë tatëpjetën, do të shpallet shtetrrethimi. Ushtria do të rrethojë Shehrin dhe do të fillojë koha e mbylljes së përgjithshme. Do të fillojë koha e vetmisë së tij të madhe. Do të fillojë koha e ethshme, koha me zjarrmi, koha me frikë, koha me gjyqe të atypëratyshme. E mbi të gjitha, do të fillojë koha me ushtrinë mbi kokë... Pushteti i ushtarakëve do të jetë i pakufishëm... Tridhjetë ditë? Mbase gjashtëdhjetë ditë? Apo gjatë, shumë gjatë të rrethuar e të mbyllur? Kujtesa e tyre duhet të tkurret nën peshën e presionit që sjell shtetrrethimi e gjendja e jashtëzakonshme... Duhet të bëhet e paqenë... Duhet t'i përjashtojë gjërat e rrezikshme... Duhet të leqë dorë nga vetvetja... Allah, psherëtiu, Allah ndihmoju! Gjëma funebre që vinte nga të dy anët tash po i dukej edhe më e tmerrshme. Rituali ndjellakeq kërkon vdekje. Kërkohej një vdekje e përgjithshme. Një vdekje që do të përsëritej pareshtur për ta bërë jetën të paqenë mu në nismën e saj... Kërkohej një vdekje që nuk do të ishte si çdo vdekje tjetër... Kërkohej një vdekje e cila do t'i përjashtonte përfundimisht nga kjo botë bashkë me mendimet e tyre, bashkë me ëndrrat e tyre, bashkë me varret e tyre... Kërkohej, pra, një vdekje që do t'i bënte përgjithmonë të vdekshëm!

O zot, psherëtiu prapë, shpëtova nga vdekja e tillë! Dhe, seç ia zuri syri Kryehetuesin që rrinte i akullt dhe shikonte funeralin. Pranë i rrinin serasqerët dhe hetuesit e tjerë, të cilët gjithashtu dukeshin si mumje. Ashtu të heshtur dhe të ngrirë po i shihte si kufoma. Madje Kryehetuesi ishte skelet i zi që ecte pas tabuteve dhe kërkonte vdekjen në sytë e të gjallëve. Kërkonte që të gjallët t'i kthente në skelete. T'i kthente në morinë e skeleteve për

t'i marrë me vete... Ai kërkonte t'i printe ushtrisë së skeletëve. Kjo e tmerroi. Një ushtri skeletesh. Ushtri e madhe skeletesh... Iu bë se po i parakalonin skeletet e panumërta, që po u printe Kryehetuesi... Trembshëm i fërkoi sytë dhe pa se diellì po vazhdonte rrugën kah bjeshka. Pse nuk ndalesh sado pak? deshi t'i thotë diellit. Pse nuk pret aty ku je? Pse? Por hetoi se diellì nuk po e dëgjonte. Ai po e bënte rrugën e tij të përhershme dhe nuk e çante kokën as për të e as për të tjerët. Hetoi se po afrohej iqindia.

Koha e shtetrrethimit ishte në prag...

— Allah, katilat! Allah, katilat! Kërkojmë shpagim! Shpagim për armiqtë e Perandorisë...

— Allah katilat! Allah!

— Shpagim! Shpagim!

— Allah! Allah!

Shtetrrethimi filloi. Tridhjetë ditë? Gjashtëdhjetë ditë? Apo ditë të pakufishme? Këto fjalë po i silleshin në kokë dhe po e qëllonin me sa forcë kishin. Tridhjetë ditë... Gjashtëdhjetë ditë. Deri në amshim? Koha e vdekjes... Koha e vdekjeve të panumërta... Koha e Kryehetuesit. Medet. Ai do të futet në Sheher pas ushtrisë dhe bashkë me shtabin e tij tinzar do të bëjë ato që duhet të bëjë (pa i dhënë atij llogari). Kryehetuesi do t'i dërgojë raporte të drejtpërdrejta Zyrës së fshehtë të Perandorisë (që e mbikëqyrte vetëm Lartmadhëria), e ai do të rrijë në atë rrafshnaltë dhe do të presë shënimet e ushtarakëve që nuk e kanë peshën e atyre të Kryehetuesit dhe do të bëjë sehir për të pritur kohën e plikos tjetër, asaj me numër dy, e cila doemos do të jetë me urdhra të tjerë, siç ishte edhe e para. Në ndërkohë ai mund të zhgërryhet në tendën e Hyrije Hanmit... Mund t'i shfryjë epshet dhe mund t'i dëgjojë çallgaxhinjtë. E tutje, vetëm një orë larg, vendlindja e tij e rrethuar në duart e ushtarakëve dhe nën mbikëqyrjen djallëzore të Kryehetuesit dhe të hetuesve të panumërt...

Si duket, vallë, jeta në kohën e shtetrrethimit, pyeti veten si të ishte i huaj? Ç'domethënie ka jeta kur secili mund që ta marrë nëpër këmbë? Mendja i tha se gjithçka në të është nënçmuese dhe fyese. Është jetë qençe...

Njeriu bëhet i pavlerë dhe zhvleftësohet tmerrësisht... Në atë hapësirë sillet Kryehetuesi me pushtet të jashtëzakonshëm. Hetuesit e tij të panumërt bëjnë çfarë t'u teket. Futen nëpër shtëpi. Burgosin të madh e të vogël. I fusin nëpër burgje. I mbajnë sa të duan. Ua thyejnë eshtrat dhe së fundi tallen me ta. I hedhin si mbeturina dhe i fyejnë edhe për së vdekuri! Ah, Kryehetues, ofshau. Kush të bëri të gjithfuqishëm? Kush? Allahu?

Megjithatë, ai e dinte se Kryehetuesi ishte pjellë e Lartmadhërisë... Pushteti i tij i pakufishëm buronte nga ai dhe prej askujt tjetër... Ai mund t'ia bënte varrin edhe atij që ishte Kryevezir dhe qëndronte mbi fronin e lartë të pushtetit perandorak... Ah, farë e djallit, ofshau dhe iu kujtua çasti i asaj nate kur ai hyri si hije në tendë dhe i solli lajmin e trishtueshëm për masakrën... Nga ai çast ajo fytyrë dinake i qe qepur dhe ia mori qetësinë... Do t'i hakmerrem, i tha vetes disa herë dhe deshi të merrej me formën e hakmarrjes, por e kthjelloi zëri i hoxhallarëve që po e këndonin ezanin e iqindisë. Iu duk se ishte zëri i Kryehetuesit, se po këndonin shumë Kryehetues, që po i bënin me dije se mu ai duhej të jepte shenjë për fushatën e përgjakshme, e cila do të niste mu atë çast dhe nuk dihej sa kohë do të zgjaste. Ai zë po i vinte thekshëm...

Koha e shtetrrethimit, tha dëshpërueshëm, erdhi... Buzët iu drodhën një copë herë. Pa ushtarakët që po e pritnin shenjën e nisjes. Kryekomandanti kishte dalë para tyre dhe me shpatën të ngritur para fytyrës ia bënte me dije se ushtria ishte e gatshme të nisej për vendosjen e shtetrrethimit...

Një copë herë s'ia hoqi sytë shpatës së mprehtë që rrinte midis tij dhe ushtarakut të lartë. Një rreze drite thyhej në të dhe ia vriste sytë. Rrezja e përthyer në shpatë nuk po e linte të qetë. Po i kërcënohej dhe ai ndjeu t'i digjnin sytë. Po i digjnin aq shumë sa iu bë se një shumësi shpatash të vogla do ta verbonin. I tmerruar ngriti dorën dhe dha shenjë që të fillonte shtetrrethimi. Dora që po i dridhej, një copë herë i mbeti si e ngrirë përpjetë, pa pasur mundësi që ta ulte.

Dhe, prej atij çasti, iu bë se lëvizi diçka e madhe, se u trondit toka, se po shembeshin malet që kishte përpara, se zogjtë e tmerruar po iknin dikah... Si në mjegull, së pari pa duakënduesit që u nisën me dua e lutje të thekshme në gojë, e më pas hetoi sesi u shkëput këmbësoria e cila la pas një re të lehtë pluhuri. Ajo re e pluhurit i bëri si të paqena taborret e shumta, të cilave ai ua dëgjonte gjëmimin. Megjithatë mbi atë re të pluhurit ai po i shihte stemat, emblemat dhe flamujt e llojllojshëm, bashkë me kafshët e egra që i mbërthenin në kornizat e tyre të forta. Dikur iu bë se mbi atë katrahurë ngrihej një flamur i vetëm, ai i Perandorisë, i cili jo vetëm që i mbulonte taboret e pafund, por po e bënte edhe diellin të paparë... Zuri svtë me duar që t'i ikte disi mjegullimit që kishte përpara. Dëshironte që nga kujtesa ta përjashtonte atë çast të rëndë. Mbase ia doli që gjithë asaj t'ia vinte përqark një perde të lehtë, por pikërisht kur mendoi se ishte shkëputur nga të gjitha, veshi i kapi çirrjet e thekshme të të allxhinjve:

«Shtetrrethimi!»

«Shtetrrethimi!»

«Pushtetin e morën ushtarakët!»

«Hasan Pashë Ohri...»

«Shtetrrethimi!»

«Gjendja e jashtëzakonshme»

«Hasan Pashë Ohri!»

Për herë të parë u frikësua nga emri i vet. Zuri të dridhej. Emri i tij hapej furishëm bashkë me terrin që po bëhej gjithnjë më i dendur. Emri i tij përzihej me shtetrrethimin dhe hapej si ogur i lig në gjithë vendlindjen... Të dridhurat e kapluan edhe më, sa ishte gati të shembej poshtë. Bile do të binte përdhe po të mos e kishte kapur për krahu Hyrije Hanmi.

— Eja, xhan, eja! A nuk të thashë se i duhemi njëri-tjetrit?... Pse çan kokën për punët e botës? Pse?

Ai edhe më tej po dridhej. E, u dridh edhe kur Hyrije Hanmi e zuri për krahu dhe e mori me vete në tendë. I shkallmuar si kurrë më parë rrinte i mbështetur në kra-

hun e saj dhe kërkonte të mbrohej nga çirrjet e tellallxhinjve të cilat e gjenin edhe aty...

Miklimet e ëmbla po e zbraznin prej mendimeve të ngatërruara. Ajo i kishte ndihmuar që përpak të lirohej nga ankthi i rrëmbimshëm që e kaploi kur u nis ushtria kah Shehri për të vënë shtetrrethimin. Sapo hyri në tend ajo i tha «e di unë se ç'ilaçe të duhen ty...» Dhe nuk vonoi e ndjeu një kundërmim të këndshëm luleshqerre që iu fut me të shpejtë në kraharor. Nga gjendja e një të shkallmuari, u fut në një qetësi të shurdhër. Kundërmimi i këndshëm po ia nxirrte shqetësimin e bërë nyjë prej kohësh. Kështu, në vend të ankthit të rëndë, ndjeu shfrim të qetë. I bëhej se po notonte në një hapësirë të pafund ku kishte gjelbrim, ku kishte gjithfarë lulesh e ku kishte zogj të shumtë që fluturonin prajshëm... Aty hetoi një lumë, ndjeu gurgullimën e një përrocke dhe më tutje ia mori mendja se gjendej një det i madh, në të cilin kishte shumë anije me vela të bardha që po pritnin ta merrnin për ta dërguar dikah ku nuk do të shihte gjë pos kaltërsisë së pafund dhe qiellit të praruar nga rrezet e një dielli të amshueshëm... Më vonë iu bë se u fut në atë det, se pranë e kishte Hyrije Hanmin që po ia ngjeshte trupin... Më tutje nuk iu kujtua gjë...

Në mëngjes gdhiu i qetë. Hyrije Hanmi edhe një copë herë e mikloi dhe i pështëriti fjalë të ëmbla. Por kur ajo deshi të largohej ndjeu se po i kthehej ankthi i mëparshëm. Në kokë zunë t'i pështilleshin flamujt e luftës bashkë me stemat e emblemat. Kafshët në to ishin tërbuar. Po bëheshin gati t'i suleshin. Më kot mundohej të strehohej dikund. Gjendej në një shkretëtirë ku kishte vetëm thorra dhe lule të zeza kaherë të vyshkura...

Hyrije Hanmi e gjeti të zverdhur dhe të mbytur në djersë të ftohta.

— Pse çan kokën me hallet e botës? — i tha ajo. Pse? A s'u binde akoma se jemi të pafuqishëm t'i ndërrojmë ca gjëra? Harroi ato që s'i ke në dorë... Harroi... Vetëm harrimi na shpëton... Vetëm harrimi...

E ai, si i frikësuari që dëshiron t'i rrijë sa më larg

përfytyrimit trishtues, vuri kokën mbi prehrin e saj dhe mbylli sytë. Po e kërkonte atë cazën me shumë lule dhe anijen me vela në atë detin e qetë...

— Ty të shpëton harrimi... Të shpëton harrimi, — po i thoshte përgjegjësja e haremit.

Dhe ai, me gjithë qenien, iu dha harrimit, atij harrimit që i thoshte ajo. I bëhej se herë fluturonte në një hapësirë të kaltër, ku cicëronin zogjtë, herë udhëtonte në atë anijen me vela të bardha bashkë me Hyrije Hanmin... Kundërmimi i luleshqerrës e mjegullonte dhe e shkëputste nga bota. E largonte nga bota së cilës tash i frikësohej aq shumë...

Por botës që i frikësohej dhe e mundonte nuk kishte mundësi t'i ikte përgjithmonë. Me të ishte mpleksur si shumë, thuajse aq sa s'dilte gjë ta shplekste nga ajo. Nuk vonoi dhe veqili i tha se e pritnin raportet e para ushtarake, të cilat duhej t'i lexonte dhe pastaj t'ia jepte kronistit që ai t'i rendiste për kronikat e përgjithshme të Pallatit. Ka shumë sosh, Madhëri, i tha veqili. Ai dëshironte t'i bënte me dije se ishin ca punë që nuk mund të shtyheshin fare.

Jashtë po binte një shi i imët, i cili ia kishte shtuar edhe më kundërmimin e këndshëm pranveror barit të njomë dhe beharit mugullues. Një tis i hollë i mjegullës që mezi mbahej, ia kishte vënë një perde të tejdukshme hapësirës që shtrihej tutje. Një copë herë e shikoi atë pamje që i pëlqeu pa masë dhe iu bë se tutje fshihej pjesa e tij e dikurshme, ajo pjesë pa shqetësime, pa ankthe, pa përfytyrime të liga dhe pa urdhëresa të tmerrshme... Atje ishte qenia e tij e njëmendtë, nga e cila kishte ikur kahmot për t'u futur në një tjetër, e cila jo vetëm që nuk ishte e tija, por bënte që ta luftonte tmerrësisht atë të vërtetën...

Mbase do të rrinte gjatë në atë shi të imët duke e shikuar mjegullimin e lehtë po të mos e kishin penguar truprojat, që po i silleshin pranë me çadra. Çadrat iu dukën si varre të mëdha në të cilat po futej bashkë me ata që i rrinin pranë. Nxitoi të kthehej në tendë sa më parë që t'u largohej çadrave-varre që iu shfaqën si në ankthe. Në

tendë ndjeu një copë herë pikëllimin e lehtë të shiut dhe sërish po e parafytyronte hapësirën tutje perdes së tejdukshme... Atje ishte i lirë... Ishte i pabrenga... Ishte larg pushtetit të urdhëresave... Ishte larg hetuesve... Ishte larg ushtarakëve... Ishte vetëm dhe vraponte pas një fluture të gëzueshme, e cila kërcente nga lulja në lule, nga druri në dru... Kushedi sa kohë do të bridhte pas asaj fluture laroshe po të mos kishte dëgjuar hapat e veqilit që i la diçka para dhe shkoi. Përtueshëm i hapi sytë dhe pa raportet që duhej t'i lexonte medoemos...

— Perëndi, — oshëtiu, — pse njeriu nuk paska qetësi askund?

Gjatë, shumë gjatë, ndoqi jehonën e dëshpërimit të vet. Iu bë se ajo u soll e u soll nëpër tendë dhe sërish iu kthye si ngulmim edhe më i madh, kështu që i tëri u ngri prej peshës së saj. I ngrirë mbeti një copë herë derisa dikur sytë ia zunë letrat e shumta të ushtarakëve Ato iu dukën të ftohta, si akullnaja të pafund që sjellin vetëm ngricë, vetëm ngricë. .

(Raporti numër një)

«...dielli po i afrohej majës së bjeshkës kur pamë Shehrin. Tellallët shqyenin qiellin, sa i gjithë vendi mbushej me çirrjet e thekshme për shtetrrethimin.

— Shtetrrethimi!

— Shtetrrethimi!

— Masakra!

— Gjendja e jashtëzakonshme!

Një kohë më oshëtiu koka dhe nga këto çirrje të cilat nuk i kisha dëgjuar kaherë. Duhet ta them se më kishte marrë malli për to.

Pararojet na e bënë me dije se terreni ishte i lirë dhe ne mund t'i zinim pozicionet e parapara përreth Shehrit. Kështu edhe u bë. Hapëm istikamet. Ngritëm karakollet. Qitëm telat. Shpërndamë përgjuesit... Të gjitha i bëmë me shpejtësi marramendëse. Terri i parë e zuri Shehrin të mbërthyer në rrethimin tonë të pakapërcyeshëm...

Po në Sheher si do të hymë? Do të na i fusin thikat pas shpinës? Do të na vrasin ku të munden? Ne ishim të gatshëm për të gjitha dhe e dinim se po i shërbenim Perandorisë. Jeta e vdekja jonë i takonte asaj. Megjithatë, atë natë nuk na trazoi njeri as jetën e as vdekjen. Me terrin e parë u futën në Sheher dhe punët na shkuan shumë e shumë më mirë se sa kishim pritur.

Hafijet tona, të cilat prej kohësh gjendeshin në Sheher dhe kishin bërë ato që duhej t'i bënin, na thanë se nuk pritej kurrfarë shrregullimi. Përkundrazi, lajmi i masakrës i kishte frikësuar të gjithë. Me të dëgjuar atë, i madh e i vogël ishin mbyllur n' për shtëpi dhe përgjonin se çfarë do të ngjante...

Se ishte kështu u bindëm me të shpejtë. Rrugët i pamë të zbrazëta, dyert të mbyllura. Mendja ma thoshte se ata pritnin të shihnin ato që kishim ndërmend ne në mënyrë që të na kundërpërgjigjeshin më vonë... Ne vendosëm postkomandën, hapëm përgjuesit, vumë rojet e para pranë zyrave të shtabit dhe ngritëm tendën blu, në të cilën do të vendosej qendra e pushtetit ushtarak.

Nga gjuma e natës ngritëm flamurin perandorak dhe kënduam himnin tonë me sa zë kishim.

(Raporti numër dy)

...Shehri gdhiu i shkretë...

Rojat tona dukeshin kudo. Ecnin kujdesshëm dhe të matura. Në shesh tenda blu dukej madhështore. Përballë saj ***gjithçka*** *tjetër në atë hapësirë gërmuqej keqas. Prapa hapëm dy ashqihane. Ashqitë tanë të shkathët qitën para kazanët e mëdhenj me pilaf, hallvë dhe kaçamak. Aroma e ushqimeve u përhap me të shpejtë, por nuk u shfaq kush. Një kohë të gjatë pritëm që vendësit të merrnin ushqimet, që ua jepnim falas... Tellallët edhe më tutje njoftonin për shtetrrethimin. Askush nuk do të ketë telashe me ushtrinë, thoshin ata... Ushtria do t'ju mbrojë nga e liga... Vetëm armiqtë e Perandorisë do të kenë punë me ushtrinë.. Armiqtë e Perandorisë e kanë zët ushtrinë... Vetëm armiqtë...* ***Ata do të marrin dënimin e merituar...***

Megjithatë, kush nuk doli në rrugë. Kazanët tanë avullonin. Frika, — na thanë hafijet tona, — u kishte hyrë në palcë. Dronin se as tatlitë e dynjasë nuk do t'i nxirrnin jashtë, edhe pse ne as të nesërmen e as të pasnesërmen nuk bëmë bastisje as nuk burgosëm njeri. Ditën e katërt, kur mendonim se mbase rrugët gjatë do të mbeteshin të shkreta, pamë njërin që po zbriste pazarit me një cjap që e mbante të lidhur për dore. Cjapi kishte zile dhe zilja lëshonte një tingëllimë të ndryshkur. Cjapi i kuqërremtë rrinte dëgjueshëm për lakun e të zot dhe shkonte para tij. Ne e përcollëm një copë herë ngarendjen e njeriut me cjap në dorë. Sa më shumë që e shikonim na bëhej se kishim punë me një të marrë, i cili i bartur nga instikti i nuhatjes, kërkonte të gjente kazanin e kaçamakut. Askujt nuk i shkonte mendja se ai sillej ashtu që të paralajmëronte ndonjë ogur të ligë. Dikur kur e gjeti sheshin dhe ne po prisnim më në fund ta shihnim të fuste turinjtë në kazan për t'u ngopur me kaçamak, ai shkoi gjatë, mori frymë thellë (sikur të thithte gjithë aromën e gjellërave që kishte para) dhe e lëshoi cjapin. Bërr! Bërr! — tha dhe cjapi u nis vetëm. Pas pak kafsha bëri dy-tri kërcime të lazdrueshme dhe kur na e mori mendja se do t'u afrohej kazanëve, u ndal. Shikoi anash. Prapë u nis dhe iu soll dy herë rreth Tendës blu. Shikonim me kujdes se çfarë kishte ndërmend ai cjap, i cili tash po na vinte paksa në dyshime, sidomos me atë qëndrimin e tij mospërfillës. Rojet tona deshën ta vrisnin, por ne u dhamë shenjë ta linin të qetë, ngase ishim të bindur se dicka fshihej në veprimet e cjapit.

Cjapi u soll edhe tri herë të tjera rreth Tendës blu. Cingërima e ziles po e mbushte sheshin me një ftohtësi edhe më të madhe. Dridhërimat e asaj cingërime po i ndjenim ne, mbase edhe gjithë a'a që përgjonin nga të gjitha anët. Më pastaj cjapi iu drejtua Tendës blu. Pamë një kafshë krenare, me brirë të gjatë që po vinte kujdesshëm kah ne, thuajse dëshironte të na thoshte dicka. A thua këtu njerëzit porositë e rëndësishme ua japin qëllimisht kafshëve, thashë, dhe mendja më shkoi te ca kallëzime të çuditshme që kisha dëgjuar në ca krahina të zhveshura të Perandorisë, ku

disa popuj, që tashmë kishin harruar të flisnin si duhej, gjërat që ata nuk mund t'i thoshin apo që kujtesa e tyre e mjegulluar nuk ua dëftonte qartë, këto i bënin kafshët e tyre... Mbase një ngjashmëri e tillë ishte e mundshme. Kishte të ngjarë që edhe këtu gjërat kishin arritur deri në atë shkallë që porositë e njerëzve duhej t'i thoshin kafshët? Kjo më gëzoi. Për pak urdhërova që çjapit t'i bëheshin ndërime të mëdha. Por u përmbajta paksa, ngase më shkoi mendja te ato që kisha dëgjuar për këtë vend, se këtu edhe gurët flisnin mbarë e mbrapsht e lëre më njerëzit. Tekefundit, po të mos ishte kështu, pse do të vihej shtetrrethimi. Po të kishin ardhur në atë gjendje nuk do të merrej kush me ta...

Ballafaqimi ynë me çjapin zgjati një copë herë. Sillej lazdrueshëm dhe luante kokën gjithë kreni. Çfarë kishte ndërmend kafsha? Këtë pyetje ia shtronim vetes ne dhe e gjithë ushtria jonë. Si ta kuptonte kërshërinë tonë, çjapi më në fund u afrua te dera e Tendës blu dhe lëshoi një mori kakërdhish. Një kundërmim i rëndë na e zuri frymën. Aty për aty një breshëri hanxharësh iu ngulitën çjapit. Gjaku i tij spërkati Tendën blu. Bashkë me atë gjak m'u bë se u përhap edhe një blegërimë e hekurt. Për habi, çjapi edhe me hanxharët e shumta në trup nuk u dha. Iku si të kishte fituar fuqi të re. Ikte i përgjakur, ndërsa zilja i lëshonte një cingërimë të thekshme. Ne pamë një curril gjaku që nisi nga Tenda blu dhe vazhdoi përmes Shehrit deri te lumi i tyre. Ushtarët tanë e ndoqën çjapin derisa kafsha e mallkuar u humbi sysh. (U fut në lumë dhe nuk doli më, thanë ata gjithë shqetësim). Urdhërova që të bëheshin hetime të hollësishme për të parë se çfarë domethënie kishte puna e çjapit të përgjakur, i cili humbi pa gjurmë bashkë me të zonë. Dhashë urdhra të shoshiteshin që të gjitha rrethanat që këtë rast e bënin njëmend të çuditshëm.

Kajmekani që i dinte ca gjëra të këtushme, një kohë të gjatë qe bërë dyllë në fytyrë. Iu qep një kollë e hollë sapo pa gjakun. Nuk është shenjë e mirë, tha. Nuk është shenjë e mirë... Mendja ma thotë se punët nuk do të na shkojnë mirë... Koka e tyre pjell gjithfarë gjërash... Ju nuk e dini se me kë keni punë...

(Raporti numër tre)

...Ditën e katërt mblodhëm parinë dhe u thamë se duhej t'ua bënim me dije qytetarëve se shtetrrethimi dhe ushtria nuk janë këtu për të keqen e tyre. Përkundrazi, Perandoria mendoi dhe mendon mirë për shtetasit e vet. Armiqtë e Perandorisë duhet t'i marrin për armiq të vet. Armiqtë e Perandorisë janë armiq të të gjithëve... U thamë se duhet t'u ndihmojnë autoriteteve ushtarake për t'i gjetur sa më parë ata që bënë masakrën. Pa i gjetur ata nuk do të kemi qetësi. Këta armiq do të bëjnë masakra të tjera, andaj ushtria njëherë e mirë duhet t'i qërojë hesapet me ta. Ata nuk do të prajnë pa marrë grushtin që meritojnë... U folëm për lojalitetin që është barrë e çdo shtetasi të Perandorisë. Juve, u thashë, ju bie barrë edhe më e madhe që ta mbroni dhe ta doni Perandorinë, ngase Madhëria e tij, Kryeveziri, jo vetëm qe është vendës juaji, por ai e udhëheq fushatën e shtetrrethimit. Me nënshkrimin e tij u vendos shtetrrethimi bashkë me gjendjen e jashtëzakonshme. Po të ishte kjo gjë e keqe, ai nuk do ta bënte këtë kurrën e kurrës. Përkundrazi, me shtetrrethimin ai dëshiron t'ju mbrojë së pari ju e pastaj gjithë Perandorinë. Madhëria, u thashë, nuk është larg jush. Ditë e natë mendon për ju dhe pret çastin që të krijohen rrethanat e përshtatshme t'ju vizitojë...

Ata heshtën. Rrinin si të ngrirë dhe dukeshin se me heshtjen e akullt dëshironin t'i përjashtonin ato që u thosha unë. Heshtën edhe kur i pyetëm se mos kishin gjë të paqartë, e heshtën edhe kur u thamë se mos i mundonte gjë. Ata shikonin stemën e madhe perandorake. E mua m'u bë se midis atyre shikimeve pashë edhe atë të çjapit të përgjakur.

(Raporti numër katër)

...Çarshia më në fund u hap. Ditën e pestë papritmas rrugët dhe rrugicat e saj vërshuan nga lumi i njerëzve. Para na dolën shumë fëmijë, të rinj dhe pleq... Nuk na ka rënë të shohim aq shumë fëmijë dhe të rinj. Prej nga gjithë këta

përnjëherësh? Mos po na mashtronin sytë? Mbase edhe kjo mund të ishte pjesë e asaj së ligës për të cilën erdhëm këtu? Jo, jo, nuk po na mashtronin sytë. Ata ishin në rrugë, në sheshe dhe kudo. Flitnin, qeshnin, çirreshin, thuajse nuk kishte ndodhur gjë. Kjo na shqetësoi... Mos ishte ky ndonjë tjetër ogur i lig? Një gjë, megjithatë e kishim të qartë: ata i udhëhiqte një forcë e brendshme që ne nuk ishim në gjendje ta hetonim. A nuk mjaftonte kjo për një shqetësim të përmasave të tilla?

E shikova gjatë turmën dhe bëja sehir. Sa armiq të Perandorisë gjenden midis tyre? Mbase të gjithë? Të gjithë janë armiq. Të gjithë i kanë përlyer duart me gjakun e ushtrisë sonë? A thua edhe tash mendojnë si të na i fusin thikat prapa?

(Raporti numër pesë)

...Filluan burgimet. Kryehetuesi na dorëzoi një listë të gjatë prej dyzet e shtatë emrash. Kini kujdes, na tha, janë shumë të rrezikshëm. Armët i fshehin edhe në gojë. Po qe se tash na dalin telashe, më vonë do të humbim në ndonjë pyll të cilit nuk i shihet fundi...

U morëm vesh që burgimet dhe bastisjet të fillojnë pas gjysmës së natës për t'i përfunduar kah mëngjesi. Gjithçka duhej të bëhej pa zhurmë.

Në fillim punët na shkuan mirë. Pa ndonjë telash burgosëm njëzet veta, kryesisht të rinj të moshës pesëmbëdhjetë-njëzetvjeçare. Por, sapo afrohej ferku i mëngjesit ata po na iknin. Kot i rrethonim. Dhashë urdhër për bastisje të përgjithshme. Edhe ato nuk na i hoqën brengat. Nga bastisja ia dolëm të burgosnim vetëm dy veta. Shtatëmbëdhjetë të tjerët na ikën. Ca nga ata çuan dorë. Shtatë veta na u plagosën. Njëri na vdiq rrugës. Më thanë se i gjori, kur po ndërronte jetë, kishte folur si përçart për një lulishte të madhe që po shihte. Të gjithë, të gjithë, kishte thënë, do të shkojmë në atë jeshillëk...

Ballafaqimi ynë i parë me ta na dëshpëroi. Më doli ajo që pandehja për lidhjen e mirë që kishin me njëri-tjetrin. Para

kishim një rrjetë merimange, që ishte në gjendje edhe dridhërimën më të vogël ta barte shpejt e shpejt nga njëri kënd në tjetrin.
Këtë merimangë, u thashë ushtarakëve, duhet ta shkatërrojmë patjetër. Por duhet pasur kujdes që të mos ngatërrohemi në të...

(Raporti numër gjashtë)

...E mblodha me ngut parinë. U fola ashpër për gjakun që po derdhet ende. Masakra nuk ka të ndalur, u thashë. Armiku i Perandorisë nuk do të jepet lehtë. Na ka shpallur luftë të hapur dhe ne nuk kemi si t'i bishtërojmë kësaj.
Ata prapë heshtën. Rrinin të ngrirë dhe nuk bënin vër me gojë. Heshtja e tyre po më brengos sa edhe vetë armiku. Në fund u thashë, ose do të vë rregull, ose të vemi të gjithë në djall. Rrugë tjetër nuk ka. Gjaku paguhet me gjak. Gjithë vendin do ta zhys në të...
Ata prapë heshtën.
Pasdite varrosën ushtarin e vrarë. Dervishët dhe shehlerët pareshtur bënë dua. Bën ziqër. Vendësit i shikonin si të ngrirë dervishët dhe shehlerët si i futnin hanxharët në gojë e në fyt. Tabutin e tij e mbuluan me flamujt e luftës dhe me stemën e madhe perandorake. Funerali u soll dy herë nëpër Sheher dhe së fundi u ndal në kopshtin e shatërvanit. Ziqri i shehlerëve vazhdoi edhe kur trupi i tij preku tokën e zezë... Urdhërova që sheshi i tyre kryesor të pagëzohej: «Sheshi i heroit të perandorisë». Edhe si i vdekur nuk do t'u largohet kurrë nga fjalori i tyre...
P.S.
Shehri vlon nga thashethemet. Hafijet tona i mbledhin pa ndarë ato... Herën tjetër ua dërgojmë edhe ato...

Qenka derdhur gjak, tha Pashai. Së pari gjaku i një cjapi e pastaj i ushtarit tonë. Do të ketë gjak, shumë gjak... Gjaku do gjak... Gjak... Gjak... Gjak...

iu bë se gjaku po gufonte e po gufonte dhe po i hynte në tendë. I frikësuar doli jashtë. Ajri i freskët e kthjelloi paksa, por i bëhej se gjaku po e ndiqte pas. Sytë i zunë

retë e ulëta që po ndrydhnin horizontin e gjerë. Ato re po ndrydhnin edhe pirgun e vrojtimit, i cili rrinte si i pikëlluar. Seç i shkrepi një dëshirë e çuditshme të ngjitej në atë majë të pirgut dhe prej andej të shikonte luginën e përgjumur. Me hapa të shpejtë u nis drejt pirgut. Truprojet i shkonin pas dhe nuk e dinin se nga po ia mbante dhe çfarë synonte ashtu befas. Oficeri i pirgut e priti me nderime të mëdha, por edhe i befasuar ngase kurrë nuk ia kishte marrë mendja se ai vend do t'i zgjonte kërshërinë Madhërisë për t'iu afruar me aq ngut. I habitur dhe si i zënë pisk, zuri t'i fliste sesi ditë e natë nga ai vend syri i rojeve kap çdo gjë, madje edhe ato që shihen me vështirësi. Gjendemi midis armiqve, i tha oficeri, andaj syçeltësia luan një rol të madh për t'i hetuar më kohë edhe lëvizjet, që në të parë duken të rëndomta, por që mund të fshehin gjithfarë rreziqesh... Uji fle, e hasmi jo... Këtë fjali ia tha disa herë. Mbase kjo ishte e vetmja gjë që mund ta thoshte pa drojë, ngase qindra e mijëra herë e kishte dëgjuar të përsëritur prej më të madhit e deri te më i vogli. Por Pashai nuk ia vuri veshin. U nis drejt shkallëve dhe pas pak po u ngjitej atyre me nxitim. Druri i lagur lëkundej nën peshën e tij dhe të rojave që i shkonin pas. Në pikën më të lartë rojet rrinin të ngrira. E përshëndetën të hutuara. Nuk ishin mësuar që në folenë e tyre të ngjiteshin as oficerët e rëndomtë, e lëre më Kryeveziri i Perandorisë së fuqishme. Ai shikoi butësisht dhe s'u tha gjë. I lëshoi një sy luginës dhe, për habinë e të gjithëve, urdhëroi që ta linin vetëm. Oficeri i pirgut, bashkë me të tjerët nuk po u besonte veshëve. Një copë herë u shtir si të mos dëgjonte gjë, por kur Pashai prapë ia tha të njëjtat gjëra, zbriti gjithë frikë. Dronte nga më e keqja...

Pashai nuk po shihte gjë nga ajo pikë e lartë. Retë kishin sharruar edhe më poshtë dhe thuajse gjithçka e kishin mbuluar qëllimisht. Megjithatë, nga ajo pikë mendimet i gjetën vendlindjen. Sado që kujtimi i ishte zbehur (e qartësuar i kishte mbetur vetëm shtëpia e madhe dhe lumi që s'e dinte më se a ishte lumë apo përroskë) përpara po i shfaqej një vend i vogël me rrugica dredhake, me shtëpi

përdhese me çardaqe përpara që u rrinin si sy... Po i shfaqej një shatërvan me një çarshi si të pafund, ku ngatërroheshin rrugicat dhe derdheshin të gjitha kalimet... Nëpër ato rrugica kishte plot njerëz, që i njihte dhe e njihnin. Ata po i thoshin: sa mirë që erdhe... Të kemi pritur... Sa mirë... sa miiiirëëë... sa miiiii...

Një copë herë fjala e fundit po i vinte e shkëputur dhe e thekshme. Nga kjo thekamë i iku përfytyrimi. Por, ajo miiii... miiii po i sillej furishëm sa ndjeu marramendje. Marramendja po i shtohej ngulshëm saqë i bëhej se gjendej mbi një katrahurë në të cilën patjetër do të zhytej. Madje iu bë se qe shumë afër asaj katrahure, por një dorë që po e mbante nuk e la të futej në të... Ishte kryeroja që po i thoshte gjithë shqetësim: lartësia është marramendëse dhe e rrezikshme... e rrezikshme...

Kur preku tokën, i erdhi të villte. Lermëni u tha rojave! Mundem edhe vetë. Kryesorja deshi t'i bënte me dije se nuk i kishte punët mirë me shëndetin, por urdhri ishte urdhër. U kthye te pirgu dhe e shikonte me habi si ecte çaprapikas drejt tendës së Hyrije Hanmit.

— I duhemi njëri-tjetrit... I duhemi njëri-tjetrit, — i tha ajo sapo e pa në atë gjendje të rëndë.

I ndihmoi t'i hiqte rrobat e mbushura me lagështi dhe e dërgoi në shtrat.

— Shpejt të kalon, xhan, shpejt... Hyrije Hanmi i di të gjitha ... të gjitha...

— Jam një hiç hiçi, po fliste përçart, — një hiç hiçi... hiç-hiçi...

Një kohë të gjatë përsëriti të njëjtat fjalë. Hyrije Hanmi e përkëdhelte dhe mundohej t'ia hiqte sikletin. Solli barishtet e shumta, të cilat atij i ndihmuan të harronte se kush ishte dhe ku ishte...

Shiu i imët që ra disa ditë i lëshoi vendin një dielli të ngrohtë, i cili po i jepte hov të ri gjelbërimit. Ai shikonte mugullimin dhe i bëhej se po zhytej në të, po zhytej në një det të madh gjelbërimi, ku gjithçka ishte e mahnitshme... Por hareja i treste sapo kthehej në tendë dhe shihte raportet e ushtarakëve që i vinin nga zona e shtetrrethimit. Në

to gjithnjë më shpesh lexonte për burgimet e shumta, merrte vesh për bastisjet dhe për telashet që përsëriteshin thuajse në të njëjtën mënyrë. Ç'është më keq, aty derdhej gjak. Në njërin nga raportet e fundit lexoi se ishte vrarë një fëmijë tetëvjeçar. Ne hapëm fjalë, i shkruante ushtaraku, se fëmijën e vranë armiqtë e Perandorisë për të kompromet uar sjelljet tona... Në një raport tjetër ushtarakët ia bënin me dije se «punët» jo vetëm që nuk po ndreqeshin, por kishte shenja të shumta që tregonin për thellimin e krizës dhe për shfaqjen e ndonjë rebelimi përmasash të mëdha «Paria nuk po na ndihmon... Janë bërë heshtakë... Vijnë e shkojnë si të ngrirë... Nuk bëjnë vër me gojë... Të gjithë janë bërë heshtakë... Heshtakë... Ngado ndeshim heshtakë... Vetëm heshtakë... Kemi të bëjmë me heshtakë, të cilët një zot e di se çfarë të keqe bluajnë në kokat e tyre kundër nesh. Kot po mundohemi t'ua nxjerrim gjuhën... Kot... Nuk bëjnë gëk me gojë... Mos janë mumje?»

Më tutje ushtarakët i shkruanin: «...i madh e i vogël po na shikojnë me sy të keq... Kur na ndeshin e rrëzojnë shikimin përdhe... Bëjnë çmos ta kthejnë rrugën kur ndeshemi... Kudo ftohtësi... Kudo armiqësi... kudo mospërfillje...»

Edhe raporti i parë që i erdhi nga Kryehetuesi ishte plot e përplot me ankime dhe mosbesim ndaj gjithçkahes. Raportin e tij e kishte pritur shumë më herët, edhe pse ishte i bindur se ai do t'i shkruante sa për sy e faqe, ndërsa shënimet kryesore do t'ia dërgonte drejtpërsëdrejti Lartmadhërisë, sapo të kthehej në Kryesheher. «...secilën krijesë Allahu e krijoi me kokë, me mendje, me trup dhe me ndjenjat e tij, të cilat zhvillohen sipas ca rrethanave. «po i shkruante në fillim Kryehetuesi. «Ma thotë mendja se prej kësaj rregulle nuk bën të largohemi dhe kjo duhet të na shërbejë si pikënisje për të gjitha veprimet dhe hetimet tona». Pikërisht kështu ia nisa edhe unë. Por ca gjëra siç nuk përcjellin rrjedhën normale të logjikës, po ashtu dalin nga kjo logjika. Këtë po e has në këtë vend. Siç e dini edhe nga raportet e ushtarakëve, deri më tash burgosëm shumë veta. Bëmë bastisje dhe ndërmorëm thuajse të

gjitha masat që Shehri të mbetej i shkëputur nga bota, për ta pasur më lehtë të bënim hetimet e duhura e në të njëjtën kohë të izolonin gjithë kryeneçësinë e tyre kundër nesh, e cila nga këtu pastaj mund të përhapej edhe më tutje. E gjithë kjo është në rregull. Hiq eksceset e ndryshme, të cilat janë të rëndomta gjatë operacioneve të tilla të mëdha dhe të thella (një ushtar i vrarë e shtatë të plagosur në anën tonë dhe një fëmijë i vrarë e tridhjetë e dy të plagosur tek ata), nuk mund të themi se nuk po i realizojmë parashikimet tona. Por mendja ma thotë se armikun nuk po e gjejmë. Edhe kur mendojmë se e kemi afër, na ikën çuditërisht. Burgosëm mbi treqind e tridhjetë veta. Po aq të tjerë i morëm në pyetje, e shumë e shumë sish po i mbajmë nën mbikëqyrje të përhershme. Por kokën nuk po e gjejmë. E, dihet se armiku ka kokë, se duhet ta ketë patjetër.

Letrën nuk e lexoi deri në fund. Iu duk e tmerrshme. Kryehetuesi kërkon që shtetrrethimi të shtyhet, mendoi. Kërkon që të mbahet një gjendje e tendosjes së përhershme, ku ai do të ketë mundësi t'i fusë duart gjithnjë në emër të mbrojtjes së interesave të Perandorisë. Në të vërtetë ai kërkon koka. Kërkon shumë koka. Kërkon që Shehri të mbetet pa kokë. Kërkon që Shehri të sillet në aso gjendjeje të rëndë, saqë një ditë të heqë dorë nga koka e vet. Të heqë dorë nga qenia e vet vetëm e vetëm të jetojë i qetë!... Pjellë e ligë, shfreu Pashai dhe iu bë se po i shihte sytë dinakë që i lëviznin herë andej e herë këndej duke kërkuar koka, aso kokash që kishin vlerë dhe jo çfarëdo kokash të zbrazëta. Ai kërkonte koka që dinin të mendonin. Ato dëshironin t'i ketë për t'i prerë njëherë e mirë...

Iu kujtuan ato që pati lexuar në shënimet e fshehta të Idriz Allajbeut. Allajbeu «të ligën» dhe «të rrezikshmen për Perandorinë» e shihte te shpirti, te ai shpirt i cili edhe në mënyrë të pavetëdijshme mund t'i kthehet pjesës së vetëdijshme për të kërkuar vetëdijësimin, si mjet mbrojtës kundër Perandorisë... A s'e thotë këtë, por tash në një mënyrë tjetër, fare praktike edhe Kryehetuesi? Të pohosh pa ia ndarë se «të gjithë heshtin», «janë bërë si mumje», «kush

nuk bën vër me gojë», «na shikojnë me mospërfillje», e pastaj të thuash pareshtur «se nuk po ua gjejmë kokën, se ajo na duhet patjetër», është njësoj si të thuash: «kanë lindur dhe duhet të vdesin si armiq të Perandorisë...» Kryehetuesi këtë dëshiron të thotë. Ai është i bindur se këta njerëz e kanë të lindur urrejtjen kundër Perandorisë. Secili prej tyre e ka të ngulitur mu në qënie këtë urrejtje, që herët a vonë, por medoemos, shfaqet... Prandaj nuk duhet t'u besojmë për asgjë. Për ne secili është i dyshimtë dhe armik i Perandorisë... Pra, me të tillë nuk ka muhabet. Duhet t'ua marrim kokat. T'i mbajmë të rrethuar e t'i mbajmë prore në shënjestër. Të mos u lëmë paqe mbi kokë, e mbi të gjitha kujtesës së tyre t'i vëmë mur, një mur të madh e të përhershëm derisa të mjegullohen përfundimisht... Ai mur duhet të jetë varri i tyre... Rroftë lufta e shenjtë!

Lufta e shenjtë... Lufta e shenjtë... Këto fjalë ia tha dëshpërueshëm vetes dhe sytë i zunë dy plikot, atë me numër dy dhe atë me numër tre. Kur do t'u hap? Kur? — po u thoshte plikove. Mbase kurrë? Ajo kurrë i erdhi si krrokamë sa ndjeu frikë prej vetvetes dhe prej tyre. I mori në dorë dhe po i rrotullonte sikur t'i luste që të hapeshin patjetër... Mbase e dini se është një Kryehetues, po u thoshte plikove, shumë i fuqishëm... Ai njeri futet ngado dhe hedh mjegullim... Mjegullimi pastaj bëhet i madh saqë shumëkujt i humbin gjurmët në të... Kryehetuesi është i fuqishëm... Shumë i fuqishëm... Mund t'ua marrë kokat kujt të dojë... Madje, edhe timen... Koka ime e shkretë, megjithatë, nuk vlen nuk vlen gjithaq... Mund ta marrë me një fjalë goje, siç mund t'i marrë edhe të ushtarakëve torrollakë, që sorollaten nëpër Sheher dhe mendojnë se do ta gjejnë armikun për të cilin u flet pa ia ndarë Kryehetuesi... Ai i mban në ethe të gjorët... Ai është dinak... Dinak i pashoq... Mbase edhe ju e dini se është skile e madhe?... Skile... Skile... Ha, ha, ha... Ha, ha, ha...

Një copë herë qeshi me të madhe sa iu bë se u shkul së qeshuri. Pastaj zuri të dridhej. E kapluan djersë të ftohta. Ra në gjunjë dhe hetoi se po i rrotullohej tenda, se ba-

shkë me të po rrotullohej e gjithë bota. Vetëm plikot rrinin të forta dhe po i thoshin: «së pari të kryhen të gjitha detyrat... të gjitha...»

Por, ç'e do që detyrat nuk po kryheshin. Ushtarakët i raportonin për burgime të shumta. I shkruanin për bastisje dhe kryeneçësi që nuk kishin fund. Kryehetuesi i fliste për njëfarë gjendjeje të përhershme të shtetrrethimit derisa të binin të gjitha kokat. Ndërsa nuk e dinte fare se çfarë mendonin ata që nuk i kishin raportuar ende. Edhe pak kohë do të bëhen tridhjetë ditë. Përpara do t'i shfaqen një nga një të gjithë ata me të cilët u pa kohë më parë. Do t'i flasin secili në mënyrën e vet dhe atij do t'i mbetet të vendosë e të çmojë se a janë krijuar kushtet për heqjen e shtetrrethimit apo do ta vazhdojë edhe për tridhjetë të tjera? Mendja i thoshte se si shkonin punët, shtetrrethimi do të vazhdohej patjetër. Por, çfarë do të bënte po qe se edhe pas tridhjetë ditëshit të dytë do të dëgjonte të njëjtat fjalë? Për këtë nuk kishte menduar shtruar, por ishte i bindur se do të vinte ajo ditë kur ushtarakët do t'i thoshin: armikun nuk e kemi mundur... shfaqet gjithnjë më i fuqishëm... Kryehetuesi do të flasë gjithë hipokrizi për kokën që s'e kishin gjetur... Kadiasqeri do t'i shpjegojë edhe një herë ato që dinte për të burgosurit, për të dënuarit dhe për izolimet e shumta që bëhen në çdo kohë në emër të sigurisë së Perandorisë... Me një fjalë, të gjithë do t'i thonë të njëjtën gjë: vazhdon armiqësia... Vazhdon heshtja... Kokat askund... Këndojnë këngë armiqësore... Nuk na shikojnë me sy të mirë... Edhe Hyrije Hanmi do t'i thotë të njëjtat fjalë... Të gjithë, të gjithë do të më përsërisin të njëjtat gjëra e unë nuk di se çfarë ngjet atje... Unë nuk di gjë, — oshëtiu, — Shtirem si i marrë dhe bëhem se të gjitha i di! Medet, të gjitha bëhen me nënshkrimin tim. Të gjitha... Të gjitha me nënshkrimin tim... Të gjitha... Ushtarakët burgosin dhe vrasin me nënshkrimin tim; Kryehetuesi merr gjithfarë masash të tmerrshme me nënshkrimin tim; hetuesit masakrojnë të pafajshmit me nënshkrimin tim... Një zot e di se çfarë bëjnë ata të xhenios dhe njësitë e tjera speciale me nënshkrimin tim. Të gjithë, të

gjithë, të gjithë veprojnë me emrin tim e unë sorollatem këtu e bëj sehir... Medet! Medet!

Këto ia tha vetes për herë të parë dhe u shemb poshtë. Në sexhadenë e butë ndjeu veten jashtë asaj fyerjeje të pashembëllt që nuk po e lente të qetë. Deshi t'i jepej harrimit. I shtrirë, iu bë se po shihte cjapin e përgjakur. Cjapi kishte brirë të mëdhenj, shumë të mëdhenj, aq të mëdhenj sa humbnin në të dy anët e degëzuar. Brirët i hetoi afër, fare afër, sa u frikësua. Por cjapi po e shikonte butësisht. Sikur dëshironte t'i thoshte diçka. A thua kafsha njëmend sillte ndonjë porosi që njerëzit nuk guxonin ta thoshin?... Dikur cjapi u tret, por i bëhej se një tjetër që nuk e shihte, e kishte pranë. Mendja i shkoi te plakat e padukshme. Një çast mendoi se ishin pikërisht ato që po i rrinin pranë dhe po i thoshin diçka për njëfarë uji që duhej ta pinte patjetër... Fjala ujë po i vinte si shushurimë e, herë-herë, si vërshimë që ia mbushte tendën. Iu bë se tenda po mbushej me ujë, me një ujë të turbullt, i cili vinte nga të gjitha anët. Pati frikë se do të sharronte i tëri në atë ujë, andaj me të shpejtë u ngrit në këmbë dhe zuri të çirrej për ujin. Uji. Uji më erdhi deri në fyt, po thoshte. Uji deri në fyt! Mbase do të largohej nga tenda, por iu bë se ndjeu një zë që i tha «mos ki frikë nga uji, por nga vetvetja... Nga vetvetja».

Po dridhej. Zuri sytë me duar dhe i mbylli të mos shihte gjë. Kishte frikë nga ato që iu bë se dëgjoi dhe një copë herë iu përplasën në kokë. Ato vinin si ogur i lig. Kishte frikë t'i hapte sytë, e frikë kishte të rrinte edhe me perden e territ që i vuri vetes. Dhe në atë gjendje nuk e dinte se çfarë duhej të bënte: t'i hapte sytë, apo të rrinte në atë errësirë të tmerrshme? Megjithatë, mendja i thoshte se më mirë ishte të rrinte në terr. T'i jepej botës së territ në vend që të ballafaqohej me dështimin e frikshëm të cilin kurrë s'e kishte pasur më afër. Në atë gjendje të rëndë, seç i përftoi një mendim se duhej të lutej, duhej të lutej pa pra. Të ligën do ta mashtronte vetëm me ndihmën e mësimeve të shenjta... Por për habi, nuk po i kujtohej asgjë nga lutjet e shumta që dinte. Një plogështi e papërshkrueshme ia

kishte kurthuar kujtesën. Perëndi, tha, shpëtomë nga qoftëlargu! Shpëtomë! Shpëtomë!

Shpëtomë! Shpëtomë! — tha edhe kur në tendë hyri veqili me trup rojat...

Atë natë foli përçart dhe nuk e mori vesh kush se ç'ishte ajo që e frikësonte aq shumë. Dikur Hyrije Hanmi e mori në tendën e saj dhe pravulliti me avullin e luleshqerrës, dhe me barishtet e tjera që i ruante vetëm për të. Megjithatë, ai plot dy ditë nuk erdhi në vete. Murmuriste diçka për njëfarë uji të turbullt. E zinte ngojë një cjap të përgjakur dhe brirët e tij të mëdhenj në të cilët mbante botën... E, edhe kur i kaloi ankthi, rrinte si i ngrirë dhe nuk e ndihmonin as përkëdheljet e Hyrije Hanmit, të cilat rëndom i ndihmonin që t'i kthehej hareja e herëpashershme e trupit, ai afshi i cili kur shpërthente bëhej i papërmbajtshëm. E brengosur për shqetësimin e tij të madh, Hyrije Hanmi i foli për mjekët që duhej ta vizitonin medoemos. Por ai, me të dëgjuar për ta, tha se i duhej harrimi, një harrim në të cilin do të zhytej i tëri... Duhet të bëhem i paqenë, i tha Hyrije Hanmit, në mënyrë që të shpëtoj nga mundimet që s'i ka kush...

I ngrirë Pashai u duk edhe ditëve të tjera, e thuajse në gjendje të tillë e priti edhe të tridhjetën, ditën që duhej të vendoste të hiqej apo të mos hiqej shtetrrethimi. Mirëpo çastin që pa ushtarakët, Kryehetuesin, kadiasqerin, kryeinxhinierin, serasqerin, shpjeguesin e ëndrrave, kronistin dhe Hyrije Hanmin që hynë në tendë dhe zunë vendet e veta (në njërën anë ushtarakët e në tjetrën të tjerët), befas iu hoq ngrirja. Ndjeu se doli nga të mërdhiturit dhe shiriti i mendimeve sërish po i sillej, bile më shpejt se përpara. Kështu, saora solli ndërmend thuajse të gjitha raportet e ushtarakëve, atë të Kryehetuesit dhe ca letra të tjera që i kishte marrë nga myderrizët dhe ulemaja. Këta të fundit i shkruanin për çështjet që lidheshin me moralin dhe me shpirtin, me theks të veçantë të fenomenet e theshethemeve dhe te paraqitja e herëpashershme e njëfarë cjapi, i cili në atë mes luante një rol të çuditshëm... Ndryshe nga raportet e ushtarakëve, ku për cjapin flitej si për

«një variant taktik të armikut që fuste në përdorim kafshët për të arritur qëllimet e errëta», myderrizët shtronin dilema që kishin të bënin me ngatërrimin dhe ndërlidhjen e instikteve njerëzore te shtazët dhe atyre të shtazëve te njerëzit në masën sa e para bëhej mbizotëruese te të dytët dhe e dyta mbizotëruese te të parët... «Po qe se njerëzit gjejnë gjuhë të përbashkët me kafshët dhe përmes tyre dërgojnë porosi, atëherë të arsyeshme janë masat, sado të egra qofshin, që kanë për qëllim ta shporrin shtazaraken nga njerëzorja dhe njerëzoren ta largojnë nga shtazarakja... Me një fjalë, sipas myderrizëve, shtetrrethimi duhet ta bëjë këtë pastrim dhe çdo gjë duhet të shkojë kësaj rrjedhe e të zgjasë përderisa të vërtetohet se shtazarakja është larguar nga njerëzorja... Por, edhe po qe se konstatohet se te njeriu është bërë njësimi midis shtazarakes dhe njerëzores, ku shtazarakja përdoret për qëllime të caktuara, atëherë edhe me këtë rast shtetrrethimi e arsyeton veten...»

Një copë herë u muar me këto mendime dhe herë pas here ua lëshonte sytë atyre që rrinin pranë dhe prisnin që t'u jepte leje të flisnin. Iu bë se ata dukeshin të shqetësuar dhe kjo i pëlqeu. Andaj po i përcillte me shikim sikur ta hetonte sa më mirë këtë ndjenjë. Pastaj kapi letrat që kishte pranë dhe po i shikonte me mospërfillje, herë njërën e herë tjetrën, pa u thelluar në to. Dëshironte që ata të ndjeheshin sa më të shqetësuar dhe sa më të padurueshëm. Dikur, shikimi i zuri fytyrën dinake të Kryehetuesit. Ai po dridhej nga nervoziteti. I erdhi mirë që ia kishte dalë sadopak t'i shqetësonte të tjerët sidomos ata të cilët i bënin intriga, secili në mënyrën e vet duke i dërguar raporte të fshehta Lartmadhërisë. Këta janë gënjeshtarë, i tha vetes. Janë urithë të neveritshëm. Të gjithë janë gënjeshtarë... Të gjithë mendojnë se koka ime duhet të mbetet e mallkuar mu ku lindi... Nën gishtat e tij letrat kërcitnin gjithë vrazhdësi. Ajo vrazhdësi i pëlqente, ndërsa të tjerët i shqetësonte. Duke i luajtur letrat me mospërfillje, mendja ia thoshte se ua kthente sadopak një pjesë të nënçmimit që ata ia bënin çdo ditë... A thua mjaftonte kjo?

Gjatë, shumë gjatë i solli letrat nëpër duar dhe vetëm

kur hetoi shenjat e njëfarë mjegullimi, që ia paralajmëronte ankthet e rënda, u kollit dhe tha:

— Thuajini ato që duhet t'i thoni.

Fjalët e ftohta dhe aq mospërfillëse shkaktuan huti edhe më të madhe sesa pritja e gjatë. Ndoshta që të gjithë kishin pritur ndonjë fjalë përshëndetëse, apo ndonjë fjalim mirënjohës, në të cilin do të bëhej fjalë për përpjekjet, sakrificat dhe angazhimin e pashoq të secilit veç e veç që ata bënin ditë e natë për të mirën e Perandorisë... Ushtarakët patjetër se kishin pritur fjalë miradie për mundin e tyre të madh, e mbi të gjitha për gjakun e ushtarëve që u derdh dhe mund të derdhej në çdo çast për të mirën e vatanit në ato rrethana të jashtëzakonshme. Bile edhe Kryehetuesi dinak, që tashmë e kishte të qartë mosbesimin që hetonte ndaj veprimeve të tij, së paku sa për sy e faqe, priste t'ia thoshte ndonjë fjalë për punën e palodhshme të hetuesve të shumtë, të cilët s'e bënin gjumin gjumë duke bërë gjithfarë hetimesh dhe duke dhënë urdhra të njëpasnjëshëm për burgime, për bastisje, për përcjellje dhe për mbikëqyrje të bezdisshme... Të njëjtën gjë e kishin pritur edhe kadiasqerët, të cilët bënin punë të madhe për organizimin e proceseve të njëpasnjëshme, thuajse nuk kalonte ditë pa u dënuar me dhjetëra vetë me burgime të gjata... Ata sa s'po i thoshin: ne kemi punë me fëmijë... Dënojmë të tillë që u qet buza tëmbël... Kjo është detyra më e vështirë që bëjmë...

I kënaqur që më në fund paksa po u hamerrej, për të dytën herë përsëriti fjalën «nisjani» dhe shikimin e drejtoi kah ushtarakët. Të zënë ngushtë, ushtarakët e dinin se duhej t'ia nisnin disi dhe ai që duhej t'ia niste ishte komandanti i zonës së rrethimit. Pra, ai që ia shkruante raportet nga Shehri. Ai u ngrit në këmbë gjithë përtesë dhe pasi përshëndeti, zuri të fliste për mënyrën e rrethimit, për shpërndarjen e postkomandave e deri te gatishmëria për të kryer çdo urdhër për burgosje apo për bastisje të menjëhershme. Ne, tha ai, vepruam me përpikmëri dhe me maturi të madhe siç e lyp nderi ynë prej ushtaraku. I përballuam të gjitha vështirësitë, madje edhe ato më të rënda

(zuri ngojë masakrën dhe vrasjen e ushtarit), vetëm e vetëm që të jemi ballëhapur para Perandorisë...

Fjalimin e tij të thatë e me shumë përsëritje e mbylli me zotimin «se ushtria nuk do të tregojë kurrfarë shenjash të lodhjes apo të shqetësimit, edhe po qe se i thuhet se duhet të rrijë gjatë apo shumë gjatë këtu. Për ne ruajtja e lirisë është detyrë e shenjtë dhe nuk kursejmë gjë që këtë ta kryejmë si duhet dhe kur duhet...»

Ushtarakut ia dha izën të ulej. Shikimi sërish zuri t'i bridhte nga njëra fytyrë në tjetrën, si të kërkonte diçka të fshehtë që duhej ta gjente medoemos. Tash ato fytyra po i dukeshin më të qeta dhe më pak misterioze. Pas një bredhjeje, shikimi iu ndal te Kryehetuesi. Sytë e tij të thellë dhe dinakë iu dukën edhe më të mjegulluar.

— Po ti, — iu drejtua Kryehetuesit, — çfarë ke për të thënë?

Kryehetuesi u zu ngushtë. Nuk kishte pritur se dikush (qoftë ai edhe Kryeveziri) do t'i drejtohej me aq mospërfillje. Këtë hutim ia tregoi fytyra thatake (që iu bë si e pajetë) dhe duart e vogla, të cilat i dridheshin çuditërisht. I sigurt se nuk kishte nga t'ia mbante (ngase kishte pritur se do të fliste i fundit për t'i dhënë kapak bisedës), u ngrit në këmbë dhe tha:

— Puna ime dhe e shokëve të mi nuk filloi çastin kur u shpall shtetrrethimi... Ajo zuri fill qysh në Kryesheher...

Këtu i mbeti fjala në gjysmë. U përbi disa herë si të kërkonte ta tërhiqte pas atë që e tha pa e ditur se kishte thënë diçka që nuk duhej ta thoshte fare. Pashai hetoi se ai ishte zënë në kurth dhe tash po bëhej gati ta ndreqte atë që e kishte prishur nga zëmërimi i pashoq.

— ... Pra, — zuri të belbëzonte, — pra, këtëëëë punëëë tejet të rëndësishme ne e morëm me shumë seriozitet, si edhe të gjitha të tjerat; sepse e dinim se çfarë do të thotë për Perandorinë shrregullimi i rrethave në një pikë tejet të rëndësishme siç është kjo këtu, ku shekuj e shekuj kaloi kufiri i dy botërave, i dy besimeve dhe i lakmisë së të gjithëve... Pra, çastin kur u shpall shtetrrethimi, ne ishim të gatshëm t'i jepnim çdo gjë, madje edhe shpirtin... Këtë

gatishmëri e kemi edhe tash dhe do ta kemi përgjithmonë. Por gatishmëria dhe vullneti ynë, është një, e tjetër është gatishmëria dhe vullneti i armikut që të ecë me të vetën...

Fjalët «armiku» dhe «të ecë me të vetën», Kryehetuesi i tha me një zë të tillë sa Pashait iu bë se po ia drejtonte atij. Ishte e qartë se dëshironte të hakmerrej aty për aty për atë që i tha pak më parë.

— ... Armiku, — vazhdoi Kryehetuesi, — siç thashë dhe si e dini edhe ju (e për këtë keni pasur rast të bindeni mirë e mirë), — ka vullnet të madh. Ditë e natë vazhdon punën e vet, pra veprimtarinë armiqësore... Një proverb i tyre thotë: uji fle, e armiku nuk fle... Kujtoj se kjo u përshtatet rrethanave tona... Ai po i përdor të gjitha mjetet e mundshme kundër nesh, me qëllim që të dëshmojë se është i fortë e i pathyeshëm. Sepse, si mund të shpjegohet ndryshe e dhëna se edhe përkundër masave të marra (shkarazi përmendi burgimet dhe dënimet e shumta), gjendja nuk po përmirësohet? Armiku po vepron kudo dhe ngado, duke shfrytëzuar një mijë e një mënyra që ta shqetësojë Perandorinë, Perandorinë tonë të madhe, e cila deri më tash nuk ka çarë kokën për askënd... E kur kësaj i shtohet edhe heshtja e përgjithshme e tyre (nuk çel kush gojë edhe po t'ia heqësh gjuhën), atëherë është e qartë pse gjendja duhet të vlerësohet si serioze, e rëndë, me ekcese, me armiqësi të haptë dhe së fundit, si shumë të rrezikshme për Perandorinë. Ç'është më keq ajo si e tillë do të jetë jo vetëm nesër e pasnesër, por edhe shumë kohë... Mendja ma thotë se fjala është për një sëmundje të gjatë, e cila ka zënë vend në kokat dhe në mendjet e tyre. U duhet, pra, shumë kohë që të shërohen... Na pëlqeu apo nuk na pëlqeu, e tillë është gjendja. Çfarëdo vlerësimi tjetër do të na mashtronte jo vetëm ne, por edhe Perandorinë. E, për mashtrime nuk kemi nevojë. Mjaft jetuam me to. Ato na sollën në këtë gjendje. Po shihet se nuk është dashur ta heqim shtetrrenë dorë kështjallat e tyre, është dashur t'i mbajmë të rrethuar dhe nën mbikëqyrje të shtuar. Po të vepronim kështu, në vend që të rrinim të brengosur dhe të vraponim

ditë e natë pas armikut, do të merreshim me çështje të tjera më të rëndësishme...

Ndoshta e zgjata pak, por njerëz jemi, nga mishi e gjaku dhe na ka hije dhe dëshpërimi. E, ky dëshpërim nuk bën të na thyejë. Përkundrazi duhet të na japë forcë të ecim më tutje dhe t'i korrigjojmë gabimet e djeshme, në mënyrë që të nesërmen ta kemi më të lumtur e më të qetë.

Kaq pata. Allahu na ndihmoftë që të kthehemi faqebardhë!

Pashai që më pak e kishte dëgjuar e më shumë ia kishte shikuar sytë që i lëviznin herë djathtas e herë majtas, nuk i dha izë të ulej.

E shikoi një copë herë pa përfillje, sikur t'i bënte me dije se nga ai kërkonte ato që ai i ruante për të tjerët.

— Kërkoj të dhëna të tjera që do të më bindin se gjendja është njëmend si po thua...

Kryehetuesit iu ndërrua çehreja. Sytë që deri pak më parë i lëviznin si në ujë, iu ngrinë dhe fytyra, që nxirrte buzëqeshje të tharta, iu bë dyllë. Nuk kishte pritur se në atë vend do t'i shtroheshin pyetje të tilla dhe do t'i kërkoheshin hollësi, të cilat mund të thuhen vetëm në katër sy. Njëfarë tërbimi po i sillej hovshëm, por bënte përpjekje të përmbahej, pa marrë parasysh besimin e madh të Perandorisë dhe autorizimet e mëdha që i sillte prej andej. Kryeveziri ishte mbi të dhe këtë duhej ta kishte parasysh. Për herë të parë i shkoi mendja se autorizimet që kishte, sado të fuqishme qofshin, nuk duhej t'i jepnin shkas Pashait që të dyshonte në të. Përkundrazi, ato duhej t'i përdorte në atë mënyrë që t'ia gërryente dheun nën këmbë pa marrë vesh gjë. Ç'është e vërteta, në nismë kishte menduar se mund t'i dilnin telashe me Pashain për faktin se ai vinte nga ky Sheher dhe, sado që ai interesin e Perandorisë e vinte mbi gjithçka, nuk do të pajtohej me prapaskenën e fushatës. Mënyra sesi po i fliste ai tash, ia bënte me dije se Pashai jo vetëm që nuk ishte shkëputur nga ndjeshmëria për vendlindjen e vet, por kërkonte ta mbronte me çdo kusht, edhe pse me këtë rast ai duhej ta sulmonte i pari... Këto deshi t'ia thoshte Pashait, por u përmbajt.

Ai ishte nën urdhrin e tij dhe fjala e tij nuk duhej të kundërshtohej. Në rrethana të tilla edhe dyshimi më i vogël mund t'i kushtonte me kokë. Ato që e mundonin duhej t'i ndrydhte, t'i shoshiste me vetveten dhe t'ia thoshte personalisht Lartmadhërisë, po qe se ai kërkonte mendim prej tij. Ndryshe do ta pësonte. Kjo ndjenjë frike për herë të parë i solli të dridhura në trup dhe i bëri me dije se Kryeveziri është Kryevezir pa marrë parasysh pozitën e tij. Andaj nxitoi që të përgjigjej sa më parë, me përulje dhe gjithë respekt.

— Ma thotë mendja, Madhëri, — tha me një zë të matur, — se pa hyrë në hollësi, që do t'ju bezdisnin, i thashë ato që duhej t'i thosha. Kisha parasysh se çdo cikërrimë nuk është gjë për Madhërinë tuaj. Por pasi Madhëria juaj ka dëshirë t'i dëgjojë edhe ato që unë mendoj se mund t'ju lodhin pa nevojë, po ua them të gjitha një nga një. Unë e kam për detyrë që t'ua sjell në çdo kohë ato që kërkoni ju dhe mendoni se ju duhen. Jemi në shërbimin tuaj, Madhëri...

Kryehetuesi nxori ca letra dhe zuri t'i lexonte. Në to kishte plot e përplot të dhëna për të burgosurit, për të dënuarit, për ata që merreshin në pyetje pareshtur, për ata që përcilleshin në çdo hap dhe për të izoluarit... Zuri ngoje gjithfarë emrash dhe pas secilit syresh bënte një pushim të shkurtër dhe vidhte me sy veprimet e Pashait. Thuajse kështu kërkonte ta hetonte çastin më të përshtatshëm kur duhej të ndalej. Por Pashai vazhdonte ta shikonte si i ngrirë dhe ai nuk ishte më i sigurt se po i interesonin apo nuk i interesonin ato që thoshte. Lexoi e lexoi e dikur u ndal. Fshiu djersët në ballë mori frymë thellë dhe po priste se çfarë do t'i thoshte Pashai.

— Këto i di, — i tha Pashai. — Të gjitha janë raportet e mëparshme. Më duhen edhe të tjerat...

Ai u shtang. Pashai kërkonte ta mbërthente për mur. Dëshironte t'i dinte edhe ato që ai, sipas urdhrave të mara në Kryesheher, guxonte t'ia thoshte vetëm Lartmadhërisë në katër sy. Vetëtimthi mendja i shkoi te betimi i dhënë në Kryesheher. Kjo e trimëroi paksa. Por, megjithatë,

diçka duhej të thoshte. Duhej të thoshte në atë mënyrë që mishi të piqej e helli të mos digjej. Tekefundit nuk e mbante kot një post aq të rëndësishëm. Atë duhej ta arsyetonte edhe në rastet më të vështira. Tekefundit a s'i mësonte ai hetuesit se njeriu i këtij profesioni mund t'i ndërronte saora një mijë fytyra, por atë të vërtetën nuk bënte ta tregonte kurrë? Dhe, aty për aty iu kujtua fletorja e Poetit të masakruar ditë më parë në kështjellë. A nuk ishte ajo e fuqishme për t'u përdorur si argument i fundit?

Kryehetuesit iu kujtua çasti kur i thanë se gjatë bastisjeve të njëpasnjëshme që u bënin të njohurve të Shehrit (veçmas atyre që merreshin me krijimtari), hetuesit kishin gjetur një fletore, në të cilën Poeti kishte hartuar njëfarë ditari që e kishte quajtur «Jeta në kohën e shtetrrethimit». Kuptohet se Poeti nuk kishte dëshiruar që ditarin t'ua jepte hetuesve. U kishte thënë se «meditimi ishte çështje e tij personale dhe «gjendjen e krijuar kishte të drejtë ta shikonte sipas objektivit të vet...» Hetuesit megjithatë e kishin bërë të vetën. Ia morën ditarin me dhunë e ai u kishte thënë: «Pse po më shqetësoni ditë e natë? Pse? Pse nuk më lejoni të marr frymë lirisht? Unë shikoj punët e mia dhe bëj si dua... Pse po ua zë rrugën kaq shumë?... I futni hundët në punët e mia... Më shqetësoni ditë e natë... Ç'faj kam bërë?.. Kush ju jep të drejtë të silleni me ne si me gjësende të pavlera?...» Hetuesit nuk kishin çarë kokën për ankesat e tij dhe për «krijimtarinë si të drejtë të patjetërsueshme...» E ai, i tërbuar nga zemërimi, u kishte folur gjithfarë fjalësh. U kishte thënë se ishin xhelatë, varrtarë, bisha që kërkojnë vetëm koka dhe çkamos. Hetuesit, që atë gjë kishin pritur, e arrestuan. Ishte gjysma e natës kur e thirrën me ngut në kështjellë. E kemi një të madh në dorë, i thanë. Ishin të bindur se Poeti ishte njëri nga ata të cilët mund t'i takonin kokës, asaj kohe që e kërkonin kudo ditë e natë me ngulm. Qe veshur e mbathur me përtesë, sepse e dinte fare mirë se Poeti ishte i mjerë si gjithë poetët e tjerë, të cilët ai i quante tuafë dhe kalemxhinj djerrakohës, që nuk meritonin vëmendje. Bile, ai kishte një mendim edhe më fyes për poetët por që nuk guxonte ta

thoshte haptas, ngase kishte udhëzime që këta të merreshin si armiqtë kryesorë. Në shërbim gjithnjë i thoshin: poetët, poetët t'i keni në shënjestër. Ata duhet të shkallmohen. Duhet bërë që të mos flasin kurrë dhe të mos shkruajnë dot... Fjalët i kanë helm... S'është mahi me ta, ndonse duken torollakë... Intimisht me këtë mendim nuk ishte pajtuar asnjëherë, edhe pse sa herë që i kishin rënë në dorë, kishte vepruar sipas urdhrave...

Kur hyri në shkalloren e errët të bodrumit të kështjellës, era e pishës dhe tymi i zunë frymën. Në pjesën e fundme pa një të lidhur që ishte masakruar. Currilat e gjakut në shpinë i qenë ngrirë. A këtë e merrni për të rrezikshëm? u pat thënë hetuesve gjithë nënçmim. Ata, të djersitur si ishin, mend plasën nga dëshpërimi. I thanë se ishte poet, se ishte poeti më i rëndësishëm i Shehrit dhe se kishin bërë mjaft mund deri sa e kishin hequr për gjuhe që t'u jepte shkas ta fusnin në dorë... Ky nuk është i rrezikshëm e as i gjallë, u tha. Nuk do të shkruajë më shkarravina... Ata e shikuan me habi dhe i thanë se ai, deri pak më parë, përkundër mundimeve të mëdha që ia bënë, fliste. Na fyente zi e më zi, i thanë Kryehetuesit. Na thoshte se ne dhe Perandoria jemi gjaksorë. Andaj, si të vepronim me të ndryshe? Ishte kokëfortë sa edhe lidhur ia doli një çast të na e merrte fletoren dhe ta puthte. Kjo mund të dëshmohet edhe me gjurmët e gjakut që mbetën në të...

Ndoshta u ngutët? U desh të më prisnit. Me të do të bisedoja ndryshe. Me ndonjë shaka apo thashetheme do ta qitja nga lëkura dhe ai do t'i thoshte ato që do të na mjaftonin për ta paditur rëndë e më rëndë. Me të tillë nuk është vështirë. Flasin çmos. Nuk mbajnë gjë të fshehtë. Kështu si vepruam, i nxorëm telashe vetes. Ai do të bëhet i pavdekshëm, e neve do të na shikojnë me sy edhe më të keq. Për atë tuaf njeri do të thuren edhe këngë. Kujtesa e tyre do ta ngrejë në piedestal, edhe pse ai si i gjallë nuk vlente pesë para...

Hetuesit heshtën. Nuk e dinim se është kaq i lig, — i thanë. Nuk e dinim se nuk do ta preknim me dorë. Ndaj tij nuk ndërmorëm as gjysmën e asaj që ua bëjmë të tjerëve...

E qartë, e qartë, u tha hetuesve të cilët dukeshin të dëshpëruar pa masë, — ju e menduat mirë, por duhet bërë disi që puna të mos kuptohet. Hapni fjalë se Poeti iku nga rrethimi. Thoni se Poeti ka kohë që punon kundër Perandorisë. Shpalleni një shpërblim për atë që mund të sjellë ndonjë të dhënë për të. Mbase kështu do t'ia humbim gjurmët. Poetin Varroseni qysh sonte në kështjellë. Varri i tij le të rrafshohet me tokën...

Kur po largohej, hetuesit i dhanë fletoren e Poetit. U mundua të mos i prekte gjurmët e gjakut në të. Dikur ua lëshoi një sy shkarazi faqeve të para dhe e futi në xhep, aty ku ruante materialet e tjera tepër sekrete që do t'i dorëzonte me dorë të vetë në Kryesheher. Nuk qenka shkruar që Poetit t'i shkojë zëri aq larg, tha vetmevete, kur e nxori fletoren dhe ia lëshoi para Pashait.

— Kujtoj, Madhëri, — tha prajshëm, — se këtu ka mjaft të dhëna që flasin për armiqësinë e tyre shpirtërore. Sado që është fjala për një shkarravitës, si shumë të tjerë që ka në këtë vend, prapëseprapë ata qëllimet i kanë të përbashkëta: që ta rrënojnë Perandorinë. Me anën e shkrimeve të tyre dëshirojnë t'i bien ndesh frymës sonë perandorake. Ngjet që ky njeri e ka kaluar rrethimin për t'i përhapur mendimet heretike në gjithë Tokën e Lashtë. Por ne do ta kërkojmë pareshtur. Do ta kërkojmë ditë e natë në Sheher dhe kudo.

Pashai e mori fletoren dhe pasi ia lëshoi përpak sytë, e la mbi plikot që mbante para. Një copë herë shikimi i tij kaloi nga Kryehetuesi te fletorja e Poetit. Gjurmët e gjakut në të thuajse ia bënin me dije fatin tragjik të Poetit. Kryehetuesi uli shikimin poshtë nga frika se ai do ta tradhtonte.

— Do të flasim prapë, — tha Pashai si të ishte liruar nga ndonjë kllapi. — Por mos harro se i di të gjitha... Të gjitha i di...

Kur e mori izën, Kryehetuesi u shemb poshtë si t'i kishte hedhur kush ndonjë barrë të madhe. Kryevezirit i erdhi mirë që po e shihte në atë gjendje, por saora i shkoi mendja se mos vallë e kishte tepruar. Ky mendim nuk iu

hoq një copë herë. Kështu që, atyre që folën pas tij (kryeinxhinierit, kadiasqerit, serasqerit) nuk ua vuri veshin fare. Herë pas here i vështronte shkarazi dhe instiktivisht ua bënte me dorë që të uleshin. Vetëm Shpjeguesin e ëndrrave e dëgjoi me vëmendje. Mbase kjo lidhej me bindjen se ai ishte i vetmi ndër ata që i rrinin përpara, që nuk i dërgonte raporte të fshehta Kryeshehrit.

— Unë, Kahraman Ogllu, Shpjegues i ëndrrave i kategorisë së parë, — filloi ai, — i ngarkuar me detyrën tepër të rëndësishme që të përcjell ëndrrat e shtetasve tanë në këtë pjesë të botës, gjatë punës së mundimshme dhe të pandërprerë në pjesën e rrethuar mora në shqyrtim një mijë ëndrra dhe gati aq përfytyrime. I vetëdijshëm se fjala është për një punë shumë me interes për të sotmen dhe të ardhmen e Perandorisë sonë të fuqishme, i shënova të gjitha me kujdes, një nga një. Edhe pse këto ëndrra do të shoshiten veç e veç kur t'u vijë koha që të gjenden në Pallatin e ëndrrave bashkë me shumë e shumë të tjera që vijnë nga të gjitha anët e Perandorisë dhe për to do të jepen vlerësime të merituara e do të bëhen shkoqitje të hollësishme, bazuar në këto që pata në shqyrtim, mund të nxjerr një përfundim që mund të na hyjë në punë. Pra, gjithnjë duke u mbështetur në ëndrrat dhe në parafytyrimet e nxjerra, mund të thuhet se shtetasit tanë në këtë pjesë të Perandorisë, janë psikikisht stabilë dhe kanë një botë shpirtërore të fuqishme, me plot kreativitet. Bile, mund të thuhet se te këta njerëz hetova shenjat e një prirjeje të vazhdueshme krijuese që shkon mbi mesataren e pjesëve të tjera të vendit tonë të madh. Ma thotë mendja se këtu, kush më shumë e kush më pak, është krijues i njëmendtë. Edhe pse shumë prej tyre nuk e dinë se kanë dhunti të tilla fisnike tejet të çuditshme...

Në ëndrrat e tyre hetova shumë pak zogj të zez. Pastaj, nuk hasa asnjë deve dhe kurrnjë shkretëtirë. Kjo është e pabesueshme, Madhëri. Kot pyeta për devetë dhe për shkretëtirat. Shumë prej tyre nuk dinin se ç'është deveja dhe nuk kishin dëgjuar se mund të ketë botë të tharë, në të cilën ka vetëm rërë dhe therra. Më shikonin me habi dhe

më thoshin se diçka të tillë as që mund ta paramendonin. Ne kemi dëgjuar se gjendet edhe një botë e tillë, e shkretë dhe e thatë, më tha njëri, por gjithnjë mendojmë se kjo është pjellë e mendimeve të stërkequra... Bota e thatë nuk duhet të ekzistojë. Po të jetë e tillë, atëherë njerëzit janë fajtorë që ajo është e thatë. Nuk duhet lejuar që thatësia ta pushtojë njeriun, por të bëhet e kundërta. Njeriu që s'e shtrydh edhe gurin, kur e do puna, nuk është njeri. Andaj, ne nuk i kuptojmë këto që ju i flitni për shkretëtirat. Të shkretit e pranojnë shkretëtirën... Edhe për devenë, si kafshë e gërmuqur, më folën ngjashëm. Si është e mundur që njeriu gjen mbështetje në një kafshë të gërmuqur? A nuk është nënçmim për të?

Pallati i ëndrrave këtyre çështjeve duhet t'u kushtojë rëndësi dhe të nxjerrë përfundime të nevojshme. Mendja ma thotë se fjala është për një homogjenitet të madh shpirtëror, i cili mbase u bë i tillë nga rrethanat e jashtme, tashmë të njohura për ne. Por, nëse nuk hasa elemente të përbashkëta me ato të ëndrrave perandorake (zogun e zi, deven dhe shkretëtirën), këtu hetova elemente të tjera, që gjetiu shfaqen rrallë apo shumë rrallë. Fjala është për ujin dhe erën. Thuajse secili ëndërronte ujë dhe erëra. Çuditërisht një ujë i qetë, i kaltër dhe i prajshëm rrjedh te secili. Pastaj shfaqen erërat e lehta në të cilat ata jo rrallë marrin krahë dhe fluturojnë. Ato erëra gjithnjë fryjnë nga Perëndimi dhe shkojnë tutje tëhu kah ca bjeshkë të larta. Prej asaj bjeshke thuajse nuk shkon gjë prej gjëje. Gjithçka mbetet aty, sikurse tutje saj të mos ekzistonte bota. Kur njërin e pyeta se a dinin se përtej asaj bjeshke shtrihej pjesa tjetër e botës, ajo më e madhja, më e bukura, në të cilën zgjerohet Perandoria e madhe, ai më tha: tutje saj nuk ka botë... Atje fle errësira. Flenë shpirtërat e huaj. Pse t'i pranojmë katrahura të tilla?... Ne i takojmë Perëndimit...

Midis këtij uji dhe erërave, në të cilat fluturojnë shpesh, ka kuaj të bardhë dhe të kuq, që bredhin fushave e maleve hareshëm. Kuajt lavdrojnë dhe je rrallë i ndërrojnë ngjyrat. Herë bëhen të bardhë e herë të kuq. Nuk më ka rënë

të takoj ndonjë kalë të zi. Për ta ngjyra e zezë në ëndrra nuk ekziston. Bile edhe kur ndonjëherë u përzihet ndonjë zog, atë e shohin me ngjyra të tjera, por jo me të zezën, edhe pse në të vërtetë zogun e zi e kanë shenjtëri dhe s'e heqin nga emblemat dhe flamujt...

Me një fjalë, sipas shenjave që vijnë nga shpirti i tyre nëpërmes ëndrrave, unë nuk shoh zi. Përkundrazi, po qe se bazohemi në porositë e yjve, këtu nuk paralajmërohet kurrfarë e lige e madhe apo mbrapështie. Për mua, e ardhshmja në këtë vend është e qetë.

Sa për stabilitetin shpirtëror dhe për fuqinë e pashembëllt krijuese, që hetohet shumë shpejt, mbetet të bëhen studime të hollësishme për t'u parë pse bota e tyre shpirtërore mbeti e paprekur nga ndikimet e jashtme në këtë masë? Vlerësimet e mia mund të duken pak si të parëndomta për gjendjen në të cilën ndodhemi. Por, duhet ta dini se unë bëj vetëm regjistrimin e shenjave të yjve. Këtë e kam për detyrë. Do të bëja mëkat të madh e të pafalshëm madje, po qe se nuk do ta tregoja atë që e shoh. Mbase ka fusha ku gjërat mund të pispillosen ashtu ose kështu, sipas dëshirës. Por, me ëndrrat puna qëndron ndryshe. Ato duhet të shpjegohen drejt, edhe po qe se në to nuk shfaqet ajo që ne e kërkojmë me çdo kusht. Me ëndrrat është ndryshe: e përditshmja thuajse nuk luan kurrfarë roli.

Fjalët e fundit Shpjeguesi i ëndrrave i tha me një zë të butë, thuajse dëshironte të kërkonte falje për ato që tha dhe duhej të thoshte pa marrë parasysh rrethanat.

Pashai e shikoi një copë herë plakun e thinjur dhe i tha miqësisht se mund të ulej?

— Vrojtimet e tua janë me shumë interes.

Plaku, i befasuar, shikoi disa herë andej-këndej dhe vetëm pasi u bind se Pashai dukej i qetë, u ul.

Një copë herë mendoi për vlerësimet e Shpjeguesit të ëndrrave. Edhe pse ato iu dukën të thella dhe i pëlqyen, ato nuk mjaftonin për ta hequr shtetrrethimin. Ato mund t'i shërbenin për meditime, por jo për të dëshmuar se shtetrrethimi mund të pezullohej. Të tjerët, kush më pak e kush më shumë, ishin të pakënaqur me gjendjen. Andaj, nuk i

mbetej tjetër pos që ta vazhdonte shtetrrethimin edhe tridhjetë ditë. Megjithatë këtë fjalë që duhej ta thoshte medoemos, nuk po ia qitte goja. Disa herë u mat ta thoshte atë fjalë të vetme, në mënyrë që t'i largonte nga tenda që të gjithë. Por ajo po i sillej si një lëmsh i madh që i kishte mbetur në fyt. Një kohë të gjatë u mundua me atë lëmsh, që sa më lart që i ngjitej, aq më shumë e digjte. Një copë herë u mundua, sa i dolën djersët, por fjala nuk po i dilte që s'po i dilte. Dikur zuri fytyrën me dorë. U fut në një terr të dendur në të cilin iu bë se po rrokullisej një tatëpjete të pafund. Nga tmerri ndjeu se ai lëmshi që i kishte mbetur në fyt, i doli. Fjalët e kyçura «të vazhdohet shtetrrethimi...» i shpërthyen si shungullimë.

Shungullima e nxori nga terrimi. Pa fytyrat e atyre që po i rrinin përpara dhe iu bë se ato ishin të kënaqura. Gati plasi nga vështrimet e tyre, por u përmbajt. Fërkoi mjekrën që iu duk shumë e rëndë dhe tha:

— Megjithatë, tash fillon koha e riprovimit... Këtë duhet ta dini... Koha e riprovimit...

Fjalët e fundit i tha kërcënueshëm. Një copë e asaj jehone iu bë se, e shkëputur, po i sillej nëpër gojë, duke lënë pas një fishkëllimë. Pastaj nuk e diti pse atë fjalë ia tha edhe vetes disa herë. Sa më shumë që e dëgjonte, ajo i dukej një urdhër i huaj...

Tenda u zbraz shpejt dhe ai mbeti vetëm, por edhe pse fillikat i vetëm, i bëhej se pranë i kishte ata që dolën. Tash po bëheshin gati t'i thoshin ato që nuk ia kishin thënë. Megjithatë ata i vinin të mjegulluar, herë si hije e herë si qenie të dala nga vetvetja, të kthyera në konture të lëvizshme. Të tillë e pa Kryehetuesin me hetuesin që i rrinin pranë dhe i flitnin diçka në vesh. Kryehetuesi i kthyer në kontur të luhatshme mbante një thikë në dorë. Thika kishin edhe hetuesit e tjerë. Thikat u vezullonin dhe nga majat u kullonin pika të kuqe gjaku, të cilat binin në një pellg që po i krijohej pranë... Më kot u mundua t'i largohej pellgut. Ai rritej e rritej... Dikur iu bë se pa cjapin me brirët e tij të mprehtë, në të cilët mbante një pjesë të botës në ta... Cjapi mekëronte, mekëronte dhe nga ajo mekërimë

liroheshin ca fjalë të gjata që i thyheshin furishëm kokës... Më vonë iu bë se po i shihte plakat e padukshme duke fluturuar, ndërsa Poeti endtte një rrjetë merimangash me anën e fjalëve dhe të vargjeve, të cilat nuk kishin fund...

— Ndihmo zot! tha dhe ra për tokë.

KOHA E SHTETRRETHIMIT

(E shkruar nga thashethemet gjithfare në një kohë të çuditshme në të cilën edhe shelgu mund të bëhej rrush, edhe plaka mund të bëhej nuse, edhe nusja mund të bëhej plakë, sikundër që miza mund të bëhej buall dhe bualli mund të bëhej mizë...

Autori i këtyre shkarravinave herë-herë mori guximin që thashethemeve, të cilat i regjistroi me përpikëri, t'ua shtonte edhe ndonjë fjalë të vetën ose ndonjë gjykim, të cilin ju mund të mos e përfillni fare...

1. Thashethemet në kohën e shtetrrethimit

Rremë Batarja tha:

— Ushtria e mbretit po kërkon kuçedrën...

Kuçedra është shfaqur dhe është kërcënuar se shpejt do t'ia ndalë ujin gjithë Perandorisë, po qe se ne e zëmë ngojë borën...

Baba mbret e di se kuçedra mundet vetëm atëherë kur mbarë ushtria ia pështurr nga një herë në ditë folenë... Andaj, mos shihni kusure. Ushtria do të na pështurrë çdo ditë dhe duke na pështurrur do të na ndihmojë neve dhe do ta shpëtojë Perandorinë...

Rroftë shurra e ushtrisë shpëtimtare!

Mos e përmendni borën!

Ukë Curranı tha: e

— Delja e Balos polli dy thi... Njëri është i zi e tjetri i kuq!

I kam parë me këta dy sy.

Ky është paralajmërim i kobit.

Vajhalli për ata që heshtin kur delja u pjell thi. Një dele e tillë duhet prerë menjëherë. Edhe bariu i saj meriton ndonjë çytek.

Loni Keqi tha:

— Shahe Kërrabës do t'i kthehet vajza pas nëntëqind vjetësh. Po ia sjellin nëntëqind krushq të padukshëm, të cilët i bartin kokat nën sqetulla e ëndrrat i kanë të shpërndara në gjumin e huaj.

Të lajmërohen gjithë ata që s'i merr gjumi.

Të lajmërohen ata që ëndërrojnë.

Të lajmërohen ata që koka u rëndon shpatullat.

Sa më parë...

Lytë Ziu tha:

— Myzhde!

Deti do të bëhet kos...

Deti do të bëhet kos...

Gratë do të veshin krypsiten të kuq...

I madh e i vogël do t'i lyejë buzët me mjaltë...

Lumë ne!

Baba mbret është hidhëruar paksa. Pse të bëheni vetëm ju të dashurit e perëndisë?

Komandanti i ushtrisë thotë se të mirat duhet t'i ndajmë edhe me të tjerët.

Mos u frikësoni!

Të mirat tona do të jenë të pafund, kështu që as ushtria e gjithë botës nuk mund të na i marrë!

Gëzohuni, pra, o njerëz, gëzohuni!

Dan Pelimi tha:

— Gjithë bota po na sheh në ëndërr.

Çudi!
Bien e zgjohen me ne në kokë. Nuk na heqin koke fare. Ç'është ky farë sikleti që na zuri me ta, thonë ca mbretër? Pse nuk po na lënë të qetë?... Nuk u kemi gjë borxh. Çfarë kërkojnë që na i shqetësojnë ëndrrat?... Ç'djaj janë që s'na hiqen qafe?

Çudi për besë. Thonë se në ëndrrat e tyre jemi të tjerë!

Shfaqemi si të guximshëm... të patrembur... të pathyeshëm... të jashtëzakonshëm...

Çudi!

Na shohin duke ngrënë hekur me dhëmbë!

Na shohin me sy të përflakur!

Na shohin me hënë e yll në ballë!

Çudi!

Shtatë mbretëritë na i dinë përmendësh emrat e mahallëve.

Na i dinë emrat e krojeve!

Na i dinë emrat e përroskave!

Na i dinë emrat dhe mbiemrat!

Na i dinë edhe nofkat!

Çudi!

Na i dinë dhëmbët në gojë!

Na i dinë edhe zorrët në bark!

Çudi!

Megjithatë, mua ma thotë mendja se të gjitha këto janë gënjeshtra, ngase ne jemi hiça...

Cen Karremi tha:

— Një e një bëjnë tre...

Njerëzit e shikuan për të marrë.

Të nesërmen sërish tha:

një e një bëjnë katër...

Njerëzit u shqyen së qeshuri.

Pas dy ditësh tha:

një dhe një bëjnë pesë...

Njerëzit e zunë për gushe dhe deshën ta vrisnin. Ç'është ky pështjellim në kokën tënde i thanë?

E ai u tha:

do të bindeni...

Të nesërmen Cen Karremi ra pazarit vetë i pestë. Dy foshnje i mbante ai dhe tri e shoqja...

Ec e merre ti për të marrë Cen Karremin?

Gogo Gecit i shpëtuan edhe këto fjalë:

— Shoh çfarë po ngjet përtej shtatë bjeshkëve dhe dëgjoj se çfarë thuhet përtej shtatë krajlive.

Kur e pyetën të thoshte ato që fliteshin për ushtrinë e mbretit dhe për shtetrrethimin, tha:

— S'e ha Goga më...

E veja e Tushit tha:

— Edhe plakat janë me barrë!

2. I marri Sylo dhe cjapi i tij në kohën e shtetrrethimit

I marri Sylë kishte një cjap me brirë e me zile në qafë, me të cilin fliste si me njeri. Cjapi e dëgjonte të zonë dhe bënte ato që i thoshte ai. Por, ama, edhe Sylo, thonë, nuk ia prishte qejfin cjapit.

Të gjithë e dinin se Sylo dhe cjapi jetonin në një kasolle përtej Çabratit. Kush mund t'i ketë parë pa njëri-tjetrin.

Sylo mori vesh nga cjapi për njëfarë kobi të madh që do të shpërthente së shpejti. Vrapoi t'u thoshte njerëzve ato që i tha cjapi, por ata, si rëndom, qeshën me të...

— Të kanë rrokur ethet, or torollak, i thanë...

Sylo edhe përkundër përbuzjes ua përsëriti ato që i tha cjapi. Foli e foli deri sa u lodh. Njerëzit e panë cjapin duke i lëpirë djersët të zot.

Atë natë dukej se zëri i Sylos dhe mekërima e cjapit brodhën nga rrugica në rrugicë si një ogur i ligë. (Unë e dija, tha Dan Pelimi më vonë, se fjala ishte për një të ligë të madhe që po na afrohej. E ne si ne, gjërat i morëm me të qeshura. Mbase ishin mjegulluar si shumë? Prandaj edhe paralajmërimi i kobit na dukej shaka).

Të nesërmen erdhi ushtria dhe shpalli shtetrrethimin. Thonë se Sylo derdhi lotë të kuq. Të kuq ia panë lotët edhe cjapit të tij...

Çastin që ushtria e huaj ngriti flamurin e vet, Sylo bashkë me cjapin ia kishte marrë një kënge të gjatë... Në mbrëmje cjapi ishte ngjitur në majë të manit të vjetër dhe kishte mekëruar gjatë. Sylo nxitoi të tregonte se cjapi kishte biseduar me hënën. Ajo i kishte thënë se qyteza do të mbushej me minj e urithë, që do të flasin, e pastaj mund të fryjë një erë e thatë, e cila do të hapë një kundërmim kërmash kah merr syri dhe kah shkon zëri...

Sylo kishte shqyer gërmazin duke thënë se minjtë dhe urithët do të flasin. Urithët flasin! Minjtë flasin! Urithët! Minjtë! Kujdes! Ç'kohë e ligë!

Vetëm e veja e Tushit u besoi fjalëve të Sylos dhe thanë se brenga i qepi kapakët e syve. (Nuk më bëhet të shoh më, tha vejusha e bukur. Nuk dua ta shoh botën e çoroditur...)

Dy ditë askush nuk doli në rrugë. I madh e i vogël fshehtas shikonin sorollatjet e ushtrisë dhe dëgjonin telallët për shpalljen e shtetrrethimit. Burrat i fshehnin sytë nga fëmijët, e plakat i shkundnin furkat e thara. Ndezën krande dhe nxituan që gacat e flashkta t'i hedhnin para dyrve të oborreve. Pllakosi një heshtje e shurdhër e cila prishej herë pas here nga kënga e Sylos dhe nga cjapi i tij...

Sylo i kishte thënë cjapit të ngjitej edhe një herë në majë të manit dhe të pyeste hënën se çfarë mund të ndodhte tjetër? Cjapi ishte ngjitur pa përtesë në majë të manit dhe kishte pritur më kot të shihte hënën. Njëfarë mjegulle e kishte përthekuar qiellin sa nuk shihej yll as hënë...

Edhe të nesërmen cjapi i Sylos gjithë natën mbeti me sy kah qielli. Hëna nuk po i shfaqej e nuk po i shfaqej. Thuajse mjegulla qëllimisht kishte zënë vend mbi atë copë qiell? Cjapi ishte dëshpëruar pa masë dhe po të mos i dhembsej i zoti (pra Sylo), do të fluturonte larg-larg... (Të ikim nga kjo botë, të ikim, i kishte thënë cjapi të zot. Të ikim sa më parë. A nuk e sheh se sa kiamet është kur dikush ta mban hënën të mbërthyer para mjegullës? Ç'jetë është

ajo kur gjithçka të mjegullohet? Sylo, megjithatë, kishte kundërshtuar ca. Herët është të largohemi... Për t'u larguar nga kjo botë patjetër se do të largohemi, por të presim sa të vijë ajo ditë...)

Nuk vonoi e Sylo mori vesh nga biseda që cjapi kishte bërë me një dru shelgu se në Tendën Blu, që ishte ngritur midis sheshit, rrinte mbreti më i madh i botës, që sapo erdhi me ushtrinë e vet. Shelgu i kishte thënë cjapit, e cjapi Sylos, se ai mbret i mbretërve, siç e quante veten me kreni, kishte tre sy (dy në ballë dhe një prapa) dhe me ta shihte mbi tokë e nën tokë, se shihte njësoj në dritë dhe në terr-skëterrë...

Sylo ishte gëzuar pa masë dhe këtë gëzim e kishte shprehur me një të qeshur të thekshme nga e cila ishin thyer qelqet e xhamisë së kuqe...

Moti, moti kam pritur më të madhin e më të mëdhenjve që ta përdhos haptas, tha Sylo. Ata që i shkojnë pas do të shohin sesa i lig është i forti, e sa i fortë ai që duket i pafuqishëm. Mbreti i mbretërve i ka hak ca kakërdhi të freskëta...

Po atë pasdite, Sylo dhe cjapi i tij u panë të zbrisnin nga Çabrati. Ecnin gjithë kreni. Sylo shkonte pas cjapit e cjapi ecte para të zotit. Dikur Sylo u ndal e cjapi vazhdoi të ecte rrugës së shkretë në të cilën kishte vetëm ushtarë që ecnin gjithë frikë. Kur hyri në shesh, cjapi u ndal një copë herë dhe lazdrueshëm ngriti këmbët e para. Pastaj u nis kah Tenda Blu dhe u soll gjithë hare katër herë rreth tij. Kazanët me gjithfarë gjellësh të nxehta përpak që s'ia morën mendët cjapit. I shkoi mendja te lezeti i të zot që ai kishte për tatlitë. Më në fund, iu afrua derës, ktheu prapanicën nga ajo dhe lëshoi një grumbull kakërdhish. Kakërdhitë lëshonin avull dhe po atë çast një breshëri thikash dhe shpatash gjeti trupin e cjapit nga i cili rrodhi gjak, një gjak i kuq, currilat e të cilit e spërkatën Tendën Blu.

Por cjapi i Sylos nuk u dha. Priti deri sa të gjakosej Tenda Blu dhe kur hetoi se kishte lënë mjaft gjak në të, ia mori një vrapi mespërmes sheshit dhe tërfilloi drejt Çabratit. Ushtarët iu vunë pas dhe çirreshin me sa zë kishin:

— Kapeni! Kapeni kafshën e djallit! Kapeni!

Por si të kapej cjapi që fluturonte?

Ushtarët e kërkuan gjatë cjapin e përgjakur që përdhosi mbretin e mbretërve. E gjithë bota u vu pas tij.

Cjapi i Sylos megjithatë nuk u pa se nuk u pa... Nuk u pa as të nesërmen, as kurrë më. Dhe sa më shumë që kalonte koha, nëpër thashetheme, cjapi i Sylos herë merrte krahë, herë bëhej i padukshëm, herë ngjitej në hënë, herë futej shtatë pashë thellë në tokë, herë luftonte me gjithë botën, e herë gjuante kakërdhi të freskëta mbi mbretërinë!

(Unë e dija se ai cjap ishte isharet perëndie, tha Shahini i Taliqëve. E dija këtë dhe isha i bindur se një ditë do të merret vesh se prapa tij fshihet një shpirt i mirë. Mjerë ne që u tallëm aq shumë me të zonë e tij...)

(Cjapi nuk ishte kafshë, por insan shkuar insanit... Ai ishte kthyer në kafshë sa për të na mashtruar dhe për t'i parë mëkatet tona sa më mirë. Obobo, po i lig është ai që i nënshtrohet shkurtpamësisë, tha Njaziu i Qerimit)

(Ma thoshte mendja se ai nuk rrinte kot me Sylon, që ne e merrnim për të marrë... Ç'mëkate kemi bërë! E kemi hak ndonjë të ligë edhe më të madhe se këtë, — foli një plak para hamamit të Hyrës.)

(Cjapi është kthyer në trajtën e vet të njëmendtë, pra, të insanit kur e pa të udhës se këtë duhej ta bënte patjetër. Ishte koha që të merrnim mend. Qepni buzët dhe mos folni çka t'u vijë në gjuhë, se muri ka vesh e gardhi sy...)

(E dija se kjo që ngjau do të ngjante një ditë, — foli Uka i Cenukës. — U desh që cjapi që s'ishte cjap, të na hiqte mjegullimin që na ka vu perde syve.

A nuk është koha të mendojmë me kokën tonë?)

(Cjapi sheh çdo gjë...)

(Cjapi përgjon... Kujdes!)

(Është koha t'i harrojmë hasmëritë!)

(Lërini thashethemet!)

Krahas cjapit flitej edhe për Sylon. Ai tashmë nuk ishte i marrë e as i përbuzur si më parë. Përkundrazi, u hapën fjalë se ai dhe cjapi i tij u gjendën pranë njëri-tjetrit, ngase fjala ishte për dy qenie të jashtëzakonshme, që dinin dhe

shihnin më shumë se të tjerët. Fakti se Sylo pas masakrës së cjapit nuk shihej më, por i dëgjohej zëri me plot porosi të dobishme (herë në namazxha, herë në fushë të sahatit e herë në Çarshi të Madhe) i shtynte njerëzit të mendonin se fjala ishte për ndonjë profet. Ato që i tha publikisht pak para se të vinte ushtria e huaj, bënë që i madh e i vogël ta ndërronte mendjen për të...

(Vaj për ne të marrët që nuk e ditëm se ç'njeri patëm midis nesh. Mund të na gjejë edhe ndonjë hata më e madhe se kjo, tha Cyme Shelnja.)

(Sylo shtirej si i marrë. Në të vërtetë ai neve na merrte për të marrë. Si nuk e dinim se njeriu që rri me kafshën dhe flet me të si me të tjerët mund të jetë i mbërrimë? Si?)

(Unë e dija se ai nuk ishte i marrë, — tha Lytë Bardhi. — Isha i bindur se ai shtirej i tillë. Në të vërtetë ai gjithë kohën na përgjonte dhe shprehte keqardhje për mjerimin tonë...)

(Patëm harruar se do ushqyer edhe koka... Patëm harruar se ka edhe diçka më të rëndësishme nga barku... U bëmë mendjefjetur. Merreshim me thashetheme dhe kënaqeshim kur fqiut i cofte lopa... Nuk shihnin tutje thembrave... Mbase tash do ta shohim atë që Sylo e pa që moti, — tha Lam Metahysa).

(Sylo ishte profet).

(Sylo ishte mendjendritur).

(Të paçim Sylo!)

Për Sylon u thanë edhe këto mendime:

— Sylo ishte kthyer në një shpirt të padukshëm për t'u ndihmuar të tjerëve që ta njohin veten;

— Sylo fluturonte (bashkë me cjapin) natë e ditë mbi qytezë dhe shikonte se kush lidhej me ushtarët e huaj;

— Sylo po merrej vesh me Shane Krrabën dhe Nurie Futën për ta futur në luftë armatën e krushqve të vdekur;

— Sylo tash po u sulej ëndrrave të mbretit. Ai ose do të çmendet ose do të largohet.

3. Thashethemet e tjera në kohën e shtetrrethimit

a) *Selami Dacit* iu shfaq në ëndërr një vjershë, të cilën tash sa ditë po e thotë gjithkund... Ditë e natë e thotë dhe qan. Kur e pyesin se prej nga i ke këto mendime të ngatërruara bashë me atë siklet që e derdh përmes lotëve, ai thotë:

— nuk e di, vëllezër, çfarë më gjeti. Nuk e di... Dikush po flet në mua. Një tjetër është futur në kokën time dhe i flet këto që po i flas... Nuk e di?

Po a nuk mund t'i bësh zap disi, i thonë?

— jo qebesa, jo... Nuk mund t'i ndal... Më vijnë në gojë dhe burojnë si të ishin ndonjë krua... Unë nuk kam si t'ia bëj... Po ç'hall i madh më zuri, o vëllezër... Më ndihmoni sa nuk bëhet vonë...

b) Ca veta bredhin natën të veshur me veladonë të zinj... Nuk dihet me tamam se a janë njerëz apo hije. Thonë se Shahin Lala, që gjithnjë është marrë me mbledhjen e veve të kumrive, herë pas here shihet me veladon të zi...

(Nuk e keni rrenë, tha një rrapatus që gjithnjë pështurr nën Urën e Taliqit dhe luan me pata, Shahinin e pashë me këta dy sy kur i nxori nga gjiri hijet dhe i lëshoi të ecnin... Desha t'i them se çfarë po bënte ashtu, por m'u mor goja. Pasha bablokun e Pashtrikut u bëra gur. Një kohë të gjatë nuk bëra vër me gojë. Kur erdha në vete nuk e pashë më as Shahinin e as ato hijet që i lëshoi...)

(Ata që bredhin me veladona të zinj janë vjedhës dhe asgjë tjetër, — tha Meta i Lamametës. — Një natë i pashë dhe desha t'i kapja, por qenë më të shpejtë. E them me kokë se ata janë hajna shkuar hajnash).

(Janë vetë e liga, — tha një grua e tmerruar. — M'u shfaqën kur po kthehesha nga pazari. Ishin qenie të llahtarshme. Më shpëtoi mpirja që të mos çmendem. Tash nuk bëj gjumë të qetë. Më dalin përpara dhe unë mbyll sytë me orë të tëra...)

(Shahin Lalen duhet vrarë! Po i nxjerr hijet nga vetë e kumrive...)

(Ata që bredhin me veladona të zinj janë pjesë e shtet-

rrethimit. Kanë për detyrë që të na tmerrojnë në mënyrë që ne të humbim besimin në vetvete, — tha Hil Bryma).

c) *Rremë Batares* po i kruhen veshët si shumë. Shkulmi! Shkulmi i thotë Lamit. Por, kroma nuk po i hiqet që s'po i hiqet.

— Çfarë të gjeti, Rremo, — i thonë njerëzit më shumë duke u tallur se nga kurreshtja?

— Nuk di... Nuk di... Nuk paska siklet më të madh nga kroma e veshëve.

— I ke të mëdhenj, — i thonë, — andaj të kruhen.

— Ndoshta. Ndoshta. Por, po ua jap fjalën e nderit po qe se edhe dy ditë më mundojnë kështu, do t'i pres me brisk rroje para syve të botës. Ç'më duhen të tillë?

d) *Një hamall* midis Çarshisë së Madhe i hëngri trembëdhjetë zymbyla me samuna të nxehtë. Piu një fuçi me ujë dhe tha se do t'i hante edhe dy tepsi bakllava me sherbet.

(Ka ditë që po vërej pangopësinë. Njerëzit hanë e hanë dhe thuajse nuk ngopen dot, — tha plaka Neriman. — Bile, edhe kërthitë po ua shkulin gjinjtë, nënave. Nuk del gjë që t'ua futë gjuhën brenda. Droj se po vjen koha që do të hamë njëri-tjetrin! zot, ruajna nga e keqja!)

(Jo vetëm njerëzit, por edhe kafshët po bëhen të pangopshme. Bagëtia hanë shumë e qesin pak. Ndërsa zogjtë fluturojnë aq shkujdesësh sa ka rrezik që një ditë të na nxjerrin edhe sytë, — tha Bec Shkurti).

(Ç'është më keq, foli njëri, — ka të tillë që po hanë dhe. Në mëhallë të Kusarit pashë dy veta të gërryenin muret e shtëpive. Hanin qerpiç si të ishin ata samuna të furrës së Talipit...)

4. Thashethemet për Shahe Kërraben dhe Nurie Futën në kohën e shtetrrethimit

Për plakat tona më të moçme, Shahe Kërrabën dhe Nurie Futën, të cilat një zot e di se kur janë parë në rrugë, tash flitet më tepër se kurrë. Duket se ardhja e ushtrisë së huaj i tronditi aq shumë sa ato, tash, herë pas here, shfaqen

si të padukshme në pjesë të ndryshme të qytezës. Megjithatë, zëri i Shahe Kërrabës shfaqet më tepër rreth Tendës Blu. Ushtarët tmerrohen kur hetojnë se u flet dikush që s'e shohin, por e ndjejnë shumë afër. I zgurdullojnë sytë dhe marrin ikën. E zënë ngojë shejtanin dhe ia mbathin të lemeritur.

Të njëjtat fjalë i thonë edhe para eprorëve, të cilët bëjnë përpjekje t'ua heqin frikën. Pse i mbushnin tëlintat? u thonë. Si s'keni turp? Por të gjorët bëjnë me dorë nga sheshi dhe zënë ngojë shejtanin.

Kur eprorët u thonë se po i mashtrojnë veshët, ushtarët sërish ikin. Ja ku e keni, ja ku e keni, thonë ata duke bërë me dorë nga sheshi. E liga sillet vërdallë mu në mes të Shehrit...

Për ta ruajtur moralin, gjyqi dënoi me vdekje tre veta. Një pas dite me shi i pamë trupat e ushtarëve që pehateshin në litarë. Tri ditë mbetën varur. Kur i hoqën mbetën të thatë trekëmbëshat, të cilët u bënin me dije të tjerëve se çfarë i priste, po qe se edhe më tutje do të hapnin frikë e disfatizëm. Por, as kërcënimet e eprorëve e as trekëmbëshat në shesh nuk patën forcë t'ua kthenin guximin ushtarëve të shkretë. Së voni shfaqeshin grumbuj-grumbuj dhe i mbanin veshët përpjetë. Për të ikur nuk iknin, por ne e dinim se kur rraseshin për njeri-tjetrin dhe shikonin çakërdisshëm, kishin pranë zërin e Shahe Kërrabës që i tmerronte.

Selami Koka, i cili sillet rreth kazanëve të ushtrisë dhe fshehtas fut ndonjë duç hallvë në gojë, hapi fjalë se ushtria po çmendej. Pasha ploncat e Taphaneve, — tha ai, — me sy të mi pashë dy veta të lidhur si i çonin në një drejtim të panjohur. Magjupi që u rrinte pranë dhe u fshinte shkumën nga goja më tha se ka edhe të tjerë. Shumë prej tyre, po të kenë mundësi, janë të gatshëm t'ia shkrepin vetes në kokë... Ata të Tendës Blu thonë se nga Kryesheheri janë nisur për këtu gjithfarë magjistarësh, të cilët do t'i zënë shpirtërat e mallkuar...

Sabri Hamalli tha se baba mbret kishte urdhëruar që të gjendej një ilaç, i cili jo vetëm që do ta shporrte frikën,

por do të shkaktonte gas. Kush e pi atë bar, tha hamalli, bëhet i gëzueshëm. Do të pështurremi së qeshuri. Lum ne!

Ngjashëm folën edhe ca të tjerë që kishin të bënin me ushtrinë e huaj (kryesisht hamenj, karrocierë, dhe varrtarë).

Fakti që në shesh herë pas here në litarë pehat: trupat e të dënuarve dhe të dezertorëve, fliste se Shahe Kërraba po e bënte të vetën. Mbase ajo e ka pritur ditën që t'i shtinte brirët në ushtrinë e mbretit për t'i treguar asaj se është më e fortë se e gjithë mbretëria?

Nurie Futa sillej ndryshe. Zëri i saj nuk shfaqej shesheve dhe rrugëve, por thuhej se ajo po mblidhte një ushtri të madhe të të vdekurve... Ushtria ime, thotë ajo, do ta rrafshojë dynjanë... Edhe mbreti do ta kërkojë birën e miut...

(Nuk është rrenë qe besa, — thanë tre veta, — me sytë tanë pamë Plakën duke u sjellë rreth pjergullës së madhe si fliste: ... gati! Bëhuni gati!... Kapni armët... Ngrini përpjetë... Gishtin në çark! Mirë fort... Ashtu duhet.. Mirë... Të vrarët në luftën e fundit këndej... Të masakruarit në kryqëzata — shkoni djathtas.. Ju të përtej detit — në mes... Njësia e të verbërve te Ura e Qabesë — majtas... Të vrarit tradhëtisht në Malin e Shenjtë — në prapavijë... Gatituni, pra!... Do të sulmojmë me turr... Herë nga e djathta e herë nga e majta... Gishtin në çark!... Bëhuni gati!.. Gati!... Gati...)

(Nurie Futa nuk po mahitet. Sekush po fut armë në shtëpinë e saj...)

5. Ca thashetheme të tjera në kohën e shtetrrethimit

Po hanë pulat baskia...
po flasin gomarët...
shelgu po bën rrush...
polli kusia e Hilit...
Sefos i dolën brirët...
lë qen, e merr këlysh...

peshqit në det e fëlterja në zjarr...
kush thumbit e kush patkonit...
hyp se të vrava, zhdryp se të vrava...
ço një kashtë, nxjerr njëzet e gjashtë...
bira e miut treqind qese...
e të tjera, e të tjera...

6. Thashethemet për njeriun që e shihte botën së mbrapshti

Sakip Brini u kthye në vendlindje pas dyzet vjet bredhjesh nëpër botë. Si e kaloi shtetrrethimin nuk dihet, por ai u duk një ditë me diell të fortë. Me vete kishte një biçikletë të rrezbitur dhe një mori rraqesh në të, të cilat shquheshin për ngjyrat e ndryshme.

Një copë herë, njeriu trupshkurtër i veshur çuditërisht, lëvizi poshtë e përpjetë dhe askush nuk hetoi se ishte njeri yni, që si fëmijë e kishte marrë botën në sy bashkë me t'et, Kel Brinin. Në të vërtetë Kel Brina pat shkuar nga qyteza pse pati vënë bast se do ta gjente fundin e botës. Këtë gjë do ta bëj patjetër, tha mu në mes të sheshit...

(Mbaj mend çastin kur Kel Brini doli para njerëzve dhe zuri të fliste për pikën e cila shënon fundin e botës, — tha Lytë Sherri. — Isha ende i ri dhe më pëlqente kur ai thoshte se rrafsh tridhjet e tri vjet; kishte menduar për këtë punë. Tash s'ka kush që ma thotë të kundërtën, thosh.te Keli. Atë pikë do ta gjej patjetër dhe nga ajo do ta përnap të vërtetën për të në gjithë botën.

Më kujtohet, tha më tutje Lytë Sherri, — harta e madhe, të cilën e bartte me vete kudo dhe e hapte. Prekte ca kryqe dhe ca vija, të cilat ua tregonte të tjerëve gjithnjë, duke thënë se zbulimi i tij do të jetë i jashtëzakonshëm. Sado që nuk kuptoja gjë nga ato që thoshte, ia kisha lakmi për aftësinë e madhe që të njëjtat gjëra t'i përsëriste pareshtur. E megjithatë, kush nuk ia vinte veshin. I krisur është, thonin. Mua më vinte rëndë kur dëgjoja ato që thoshin për

të. Për mua ai dinte më tepër se gjithë bota, andaj s'i ndahesha.

I dëshpëruar pse kush nuk ia vinte veshin, një ditë prej ditësh mblodhi hartat dhe cikërrimat e tjera që i përdorte gjatë shpjegimit dhe u bë gati për rrugën e gjatë. Sapo po nisej, tha: unë po shkoj nga ky vend i marrë, por dijeni se çastin që do ta prek pikën e fundit të botës, do t'ju gjejë të gjithëve një e keqe e madhe. Kjo e ligë do të vazhdojë për aq sa të marrët nuk do të binden se bota nuk është si tepsi, por disi si top i mbërthyer në pikën e lartë dhe pikën e fundit.

Ata që i dëgjuan ato që tha ai, qeshën dhe i thanë se do të mbetet në ndonjë këmetë... Një i marrë më pak...)

(E dija se i panjohuri i çuditshëm, që erdhi me biçikletë, ishte biri i Kel Brinit, Sakipi, — tha Kurt Mprehti. Çastin që Keli po ikte nga qyteza te Ura e Shenjtë, më tha:

— Do t'ju bjerë në mend për mua kur t'ju gjejë e liga e pashembullt dhe kur do të shihni sërish një tjetër që do t'ju vijë mbi dy rrota të mëdha. Ai do të jetë im bir.

— Pse po e merr fëmijën në qafë, i thashë?

E ai ma ktheu:

— Përkundrazi. Do ta merrja në qafë po qe se ai do të puqej me ju që jeni torollakë. Im bir do ta shohë botën dhe do të mësojë se ajo e ka pikën e vet të fundit. Ky do të niset nga ajo pikë për të shkuar pastaj në anën e kundërt të saj, në kulmin e botës... Bota është si kungull. Pjesën e poshtme të këtij kungulli do ta prek unë, e të epërmen im bir.

— Do të thotë, i thashë unë, atje ku shkon ti ecet me këmbë përpjetë e me krye teposhtë?

— Torollakëve si ti u duket kështu, më tha dhe iku...)

Sylë Brini nuk pati nevojë të fliste si dikur i ati. Njerëzit e dinin se, pasi dardha pik nën dardhë, edhe i biri ishte si i ati.

Ata që mendonin se shtetrrethimi lidhej me gjetjen e pikës së fundme të botës, dëshironin që Sakip Brini të nisej sa më shpejt përpjetë, për ta gjetur kulmin e botës, në mënyrë që qytezës t'i hiqej e liga që e gjet.

Sakipi dukej se ishte nisur për atë rrugë kaherë. Ato që demostronte (hapi ca harta të vjetra, lidhi ca litarë gjithë nyje, vuri disa tela të hollë në biçikletë dhe i ngrehu përpjetë) dëshmonin se ia kishte shkuar tet.

Tri ditë Sakipi u soll e u mbështoll rreth cikërrimave të veta. Të katërtën vuri syzet e zeza (që ia mbulonin thuajse gjithë fytyrën), hapi ca pasqyra me korniza të metalta dhe ngriti një tel përpjetë, në formë të kunjit. Midis pasqyrave dhe telit si kunj vuri dy bilurë të mëdhenj që rrinin në pozitë të lakuar. Të gjitha këto i ktheu nga dielli dhe për habinë e të pranishmëve, zuri t'u binte shuplakave e të sillej marramendshëm. Pas pak, në hapësirën midis bilurit të parë dhe të dytë shpërtheu një flakë, e cila liroi tym të zi. Flaka shpejt u fik, por më tutje, në ca teneqe të shpërndara njëzet hapa tutje zik-zak, u bënë ca shpërthime që frikësuan të madh e të vogël.

Disa herë Sakipi e përsëriti flakën që çuditërisht vinte nga bilurët si dhe shpërthimet në teneqe, të cilat bëheshin gjithnjë më të fuqishme. Më vonë, për të treguar se mund të bënte çfarë të dëshironte, bilurët i ktheu kah sahatkulla, i afroi pasqyrat me fytyrë kah bilurët dhe pasi bëri po ato lëvizje marramendëse, foli diçka që askush nuk e kuptoi. Foli e foli si i përgjumur dhe një çast bëri me dorë kah sahatkulla dhe, shih mrekullinë, zuri të digjej foleja e lejlekut, e cila gjendej në majë të shtizës ku valonte flamuri perandorak. Flaka u bë e madhe dhe Sakipi vazhdonte të sillej marramendshëm. Pas pak nga maja e sahatkullës iu një blozë dhe shtiza mbeti pa folenë e lejlekut...

Pas kësaj mrekullie Sakipi mblodhi çaklat dhe pa bërë zë, u largua nga qyteza. Kujt nuk i tha gjë se nga shkonte. Vetëm ata që i mbanin mend fjalët e t'et, Kelit, ishin të bindur se ai shkonte për ta gjetur kulmin e botës, apo siç thoshte Keli, për të hipur në majën e kungullit.

Mrekullia e Sakipit shpejt mori dhenë. Për flakën në kullën e sahatit si dhe për shpërthimet e fuqishme me teneqe u thurën gjithfarë thashethemesh.

Fakti se ai nuk foli por veproi dhe fundja ia doli që t'i linte gojëhapur që të gjithë (dogji çerdhen e lejlekut në majë

të shtizës), mund të ishin dëshmi të bollshme se mënxyrës së përgjithshme mund t'i vinte fundi. Mbetej, pra, të besohej se bota kishte pikën e saj të fundit, (që e kishte zbuluar Kel Brini) dhe kishte pikën e saj të epërme (që do ta prekte Sakipi). Tevona, të ligat do të shkonin ashtu si kishin ardhur...

Edhe përkundër dëshmive bindëse (shpërthimeve të teneqeve dhe kalljes së folesë së lejlekut në majën e shtizës së flamurit), për Sakip Brinin, të birin e Kel Brinit, u thanë edhe këto gjëra:

— Me syzet e tij të zeza e shihte botën së prapshti...

(Pasha tokë e qiell, — bëri be Nikë Zogu, — i vura ato syza të djallit dhe pashë Dile Patarricën të vogël sa një lajthi, e Riza Probën sa një bjeshkë... Rremë Bataren e pashë të hollë si skrranjë e Lytë Sherrin e pashë të trashë si buall...

Kur i thashë Sakipit se ato janë vegla të qoftëlargut, ai qeshi me të madhe dhe më tha:

— Vetëm i marri i sheh gjërat ashtu si janë... Për ta njohur si duhet botën, duhet parë së mbrapshti...

Ik or, i thashë, ç'marifet është ky t'i shohësh gjërat dallash?)

— Të gjallët i shihte si të vdekur dhe të vdekurit si të gjallë...

(Sapo i vura ato syza, — tha Ifran Dibra, — bota m'u bë me lule. Pashë lulepjeshka, jargavanë, luleftoi e gjithfarë zambakësh... Desha të them diçka, por Sakipi më tha:

— Është parajsa.... A nuk ke dëgjuar për të? Ah, kujt po i flas. Ju nuk e dini se ekziston jeta tjetër, ku të vdekurit bëhen të gjallë e të gjallët mund të bëhen të vdekur...

Dikur, pasi shikoi qiellin, si të kërkonte diçka më tha:

— Kë nga të gjallët dëshiron ta shohësh si të vdekur? e kë nga të vdekurit dëshiron ta shohësh si të gjallë?

U tmerrova.

— Pse tallesh me mua, i thashë? Si mund të bëhet i vdekuri i gjallë e i gjalli i vdekur?

Ai qeshi me të madhe e unë ika. Ia mbatha me të katrat dhe herë pas here ktheja kokën pas të shihja se mos më ndiqte ndonjë shpirt i lig...);

— Shihte çfarë fshehnin njerëzit në shpirt:

— (S'e keni rrenë, foli Emrush Bryma, një copë herë më mati me syzet e errëta dhe më tha:

— E di se dëshiron t'i cofë lopa fqiut tënd...)

Së fundit, për Sakip Brinin u thanë edhe këto:

— Ishte palaço,

— Ishte mashtrues,

— Ishte hafije e ushtrisë së huaj...

7. Dashuria në kohën e shtetrrethimit

Një mëngjes të kthellët pranveror, në bujtinën e Mon Sefasë u duk një zonjë e rëndë. Ishte e veshur me të bardha dhe buzëqeshi ëmbël sapo shkeli pragun e derës së vjetër...

Mon Sefaja hapi fjalë se ishte e bukura e dheut që ishte nisur dikah, por që rastësisht ishte ndalur ngase kundërmimi i jashtëzakonshëm i jargovanëve ia kishte kthyer rrugën. Nuk ka më jargovanë, tanë, thoshte Moni. Edhe të vdekurin e nxjerrin jashtë...

Zonja e rëndë, apo e bukura e dheut, siç e quante Moni, po atë ditë doli në shesh dhe shëtiti paksa. Pas la aromën e luleshqerrës, që u përhap deri te rrugicat më të largëta. Ajo u duk në shesh edhe të nesërmen, por tash e veshur me një fustan lulepjeshke, që ia shpalonte fët e fët puhiza e mëngjesit. Eci krenare dhe sërish u kthye në bujtinë.

Se nga u shfaq një djalosh që e shikoi gjatë gruan e veshur me fustan lulepjeshke dhe mbeti i ngrirë. Nuk u besonte syve. Dronte se po e mashtronin keq. A ishte e mundur që midis asaj zymtie (ku kishte vetëm ushtarë të panumërt), të shfaqej një bukuri e tillë? Mos ishte ky ndonjë përftim i lig që i mashtron ata që mashtrohen lehtë...

Para perëndimit të diellit (ah, ai diell që nuk zbriste fare nga kupa e qiellit), ajo u duk prapë. Këtë herë doli në dritare. Shikoi djathtas e majtas dhe së fundi ia nguliti sytë kalimthi djaloshit të shtanguar. Djaloshit iu duk se ajo ia bëri me dorë.

Ai gati sa s'u rrëzua për tokë. Ishte njëmend dora e saj

që lëvizi ashtu lehtë, apo e mashtruan sytë e lodhur? Jo, jo, ajo e përshëndeti. Ishte i bindur se ajo e përshëndeti. Koka iu turbullua e trupit iu ngjit një shqetësim i paparë.

Ra edhe terri. Erdhi nata me yje. Pastaj doli një hënë e hareshme dhe, yjet bashkë me hënën, e panë djaloshin të rrinte po në atë vend. E më atë vend e la edhe mugëtira e natës (bashkë me vesën e lehtë). Aty pastaj e gjeti edhe ferku i dritës dhe rrezet e para të diellit...

Kur u bë ditë dhe dielli sërish u ngrit në kupë të qiellit, ajo u duk prapë në dritare, e djaloshit iu bë se tash kishte përpara pranverën më të bukur, të mbushur me gjithfarë lulesh... Ajo sërish ia bëri me dorë dhe u largua. Djaloshi ishte i bindur se nuk po e mashtronin sytë... Një çast deshi të hynte në bujtinë. Madje qe bërë gati të nisej, por u ndal. Një mendim po i thoshte: po të presë dikë tjetër? Koka po i vlonte nga hamendjet... Rrinte ashtu i shtanguar dhe nuk i pengonte as dielli që i binte nga të gjitha anët, as ata që kalonin dhe e shikonin gjithë habi, e as zhurma që bënin ushtarët... Dukej se pjesa tjetër e botës për të ishte bërë e paqenë...

Ndaj buzëmbrëmjes ajo doli në shesh. E veshur me të bardha, po e pengonte natën që të vendoste pushtetin e territ. Bardhësia po i afrohej. Vinte drejt tij dhe sa më afër që e kishte ndjehej si i mpirë. Ato që kishte menduar t'ia thoshte tash nuk po i kujtoheshin. A thua bukuria e saj ishte aq magjepse sa ia kishte ndrydhur pamëshirë edhe kujtesën?

Më në fund ajo iu afrua dhe ia dhuroi një lule. I buzëqeshi ëmbël dhe shkoi.

Djaloshi nuk ishte i sigurt se çfarë pa: qenie të jashtëzakonshme apo vesë? Nuk dihet pse, por djaloshi, sapo hetoi se atë nuk e kishte më pranë, mori ikën. Vrapoi si i çmendur...

U kthye apo s'u kthye më, këtë askush nuk e diti. Ca thoshin se ai ishte parë me një buqetë lulesh të ngarendëte shthurshëm kah bujtina... Dikush tha se ai fare nuk kishte shkuar në bujtinë, pos që lulet i kishte lënë diku në shesh... E dikush tha se kishte të ngjarë se ata të dy, të përqafuar, kishin ikur pa gjurmë...

Megjithatë, nga moria e thashethemeve, vetëm një doli e vërtetë: se djaloshi u gjend i vdekur përtej lumit, ndërsa e bukura e dheut nuk u pa më...

(Thashethemet për dashurinë e kobshme në kohën e shtetrrethimit)

— U tha se ajo ishte një dashuri e rëndomtë, si çdo dashuri tjetër, që mund të lindte aty për aty. Qe, pra, vetëm një lidhje e thjeshtë dashurie...

(Gruaja erdhi në qytezë e nxitur nga kundërmimi i luleshqerrës, bëri be Mon Sefaja kur e pyetën të tregonte se çfarë dinte për atë dashuri tragjike.

— Djaloshi u dashurua në të sapo e pa, — tha ai. — Ka të ngjarë që edhe ajo ishte dashuruar në djaloshin..

I zoti i bujtinës këtë e shpjegoi me lulen e verdhë që ajo i kishte dhënë atij, e që për të ishte shenjë e dashurisë së njëmendtë. Ai, pastaj, solli një buqetë lulesh që ajo e mori dhe, si shpërblim për to ajo i kishte dhuruar një të puthur. E frikësuar nga shikimi i jashtëzakonshëm i djaloshit dhe ndjenja se ajo dashuri pa filluar mirë do të përfundonte me kob, ajo ishte larguar po atë natë, ndërsa ai, kur mori vesh, vdiq nga pikëllimi...

— Shenjat e kobit i mora vesh herët, tha Moni. — Qysh atëherë kur ajo kërkoi që t'ia gjente lulet e verdha. Ajo kishte një shikim të akullt, të tejdukshëm dhe të frikshëm... Nuk më tha se lulen e kishte për djaloshin. Por këtë e mora me mend, ngase ajo rrinte përballë dhe e shikonte pa ia ndarë... Kur ia dhashë lulen që e kërkoi me ngut, gjithë shqetësim më tha: e kam harruar edhe emrin tim. Mbase edhe djaloshi e kishte harruar veten kur rrinte si i ngrirë në shesh?)

— U tha se ajo kishte ardhur qëllimisht te ne për dashuri dhe ishte nga ato të përdala, të cilat shkojnë ngado dhe, aty ku hynë, lënë ngatërresa të jashtëzakonshme, madje edhe gjaqe. Andaj, sherri i saj zuri edhe të shkretin djalë...

(Unë e dija se ajo ishte e përdalë, tha Loni Guri. — E dija se është e tillë edhe për faktin se ato shfaqen befas dhe ikin befas, gjithnjë në kohë të turbullta. Ajo erdhi e pispillosur, e pudrosur dhe gjithë gënjeshtra kur tha se e ndoqi kundërmimi i luleshqerrës...

Unë them, — tha Leci i Lamalecit, — dhe këtë mund ta dëshmoj me kokën time, se ajo e mashtroi djaloshin deri sa e futi në dhomë dhe atje, pas dashurisë që bënë, hynë ata që gjithnjë i shkojnë pas, ia morën ato që kishte dhe pastaj, pas grindjes që ngjau, aty e mbytën djaloshin. Të vdekur e futën në thes dhe e hodhën pranë lumit...

Mbase punët qëndrojnë paksa ndryshe, — tha Hilë Lehta. — Ajo njëmend ishte e përdalë, por nuk pati ndërmend t'i bënte ndonjë të keqe djaloshit. Ç'është e vërteta ajo çoi dashuri me të. Pse jo. Por, kur ai i tha se nuk do të dëshironte të ndahej prej saj, ajo buzëqeshi dhe tha se ishte e lirë... Unë jam si zogu, mund t'i ketë thënë, që kërcen nga dega në degë... Më pëlqejnë pranverat dhe luleshqerrat... Prandaj, dëshiroj ta ndjekë këtë kundërmim pa më penguar kush.. Dua të shkoj nga folea në fole... e të tjera, e të tjera... Këto fjalë mund ta kenë hidhëruar aq shumë të gjorin djalë, saqë, i paprishur siç ishte dhe i padjallëzuar siç qëlloi, ia shkrepi vetes?).

— U tha se ajo ishte shtojzavalle dhe ai pati fat të lig që ra në dashuri me të. Largimi i saj pa gjurmë flet më së miri se ajo nuk ishte tjetër pos shtojzavalle. Tekefundit a nuk shfaqen ato në kohën e ëndërrimeve të përgjithshme?

(Unë e dija, tha e veja Zymrije, — se shtojzavallja do të vinte te ne, sepse ka kohë që më kruheshin vetullat dhe gjumin e bëja copë-copë. Kur zgjohesha në mëngjes hetoja njolla të zeza trupit, thuajse dikush më kishte shtrënguar me sa fuqi kishte. Zot ruajna! kisha frikë se do të mbetesha me barrë! Atë natë që ajo iku, iku edhe ai që më hipte përmbi...

— Edhe mua më ngacmonte diçka e ëmbël në gjumë, — tha njëra që nuk dëshironte t'i zihej emri në gojë. Kur zgjohesha më dukej vetja e shkallmuar, thuajse bëja dashuri me shtatë burra të fortë. Ky siklet, që do ta dëshiroja më

shpesh, m'u hoq sapo u hap lajmi se ajo kishte ikur.

Ah, pse nuk qëndroi edhe një çikë? Sa mirë e kisha...)

— U tha se ajo nuk ishte as e përdalë e as shtojzovalle, por pjesë e luftës. Pra, i takonte së keqes. e cila u shfaq me ardhjen e ushtarëve të huaj, për t'i përmbushur disa detyra të rëndësishme...

(Unë e dija se ajo ishte pjesë e shtetrrethimit, — tha Shahe Kërraba. — E pispillosur si pehrri, nuk ishte tjetër pos strofkë me sëmundje të tmerrshme që meshkujt i marrin çastin që bëjnë dashuri me to... Zyrat speciale, që i takojnë luftës dhe punojnë pareshtur kundër nesh, e kanë paraparë edhe mikrobin e tmerrshëm si mjet shkatërrues. Pse jo, kur ai futet pa ndonjë mund të madh dhe djallëzisht... Këtë ia thashë djaloshit sapo doli nga dhoma e asaj nepërke. Ai mbeti i shtanguar kur i thashë për mikrobet e liga ,që tashmë i kishte në trup... Jo, jo, më tha ai sypërlotur. Ajo nuk ishte e tillë... Nuk ma thotë mendja se dashurinë e kishte me sherr? Si mund të ketë dashuri djallëzore?...

I ri, i ri je, i thashë, djalo. Ca gjëra do t'i kuptosh më vonë. Ai që bie në dashuri të tillë, të sinqertë, nuk sheh më larg. Gjithçka i duket e pastër dhe e madhërishme... E çfarë të bëj tash? më tha gjithë shqetësim.

Po ua deshe të mirën të tjerëve, shko në bjeshkë dhe jeto i vetmuar përgjithmonë, i thashë. Mbaj, pra, kujtimin e kësaj nate dhe mos u ndaj kurrë prej tij. Mbase do ta kesh më lehtë ta përballosh dhembjen dhe mënxyrën. Nganjëherë, një jetë e tërë nuk vlen më tepër se një kujtim i bukur... Jo, jo, më tha ai gjithë dëshpërim. Nuk dua të jetoj me kurrfarë kujtimesh... Nuk jam aq i fortë që gjithçka të sakrifikoj... Nuk jam i fortë...

M'i tha këto fjalë me gjysmë zëri dhe e dija se i shkreti djalë do të bënte vetëvrasje pa kaluar njëqind hapa...

Kështu edhe ngjau...

Dikur hyra në dhomën e saj dhe ia thashë troç se ia dinim qëllimet. Prej tashit, i thashë, askush më nuk do të bjerë në kurthën tënde. Shko në ndonjë vend tjetër dhe kryeje punën tënde, po munde, se këtu të gjithë e dinë se

çfarë je dhe kujt i shërben. Ajo e lemëritur doli dhe iku me të shpejtë...)

U tha se ajo nuk ishte as shtojzovalle, as e përdalë, e as pjesë e shtetrrethimit. Ishte një mashkull, i veshur me rroba femrash, që kishte ardhë të merrte hak..,

(Sapo e pashë të sillej ashtu e pispillosur dhe shikonte diellin pa ia ndarë, e dija se ajo nuk ishte femër, por mashkull që kërkonte ndonjë hak apo diç të ngjashme, — tha Hysë Arapi — Kur e shikova më shtruar, hetova se edhe ecjen nuk e kishte si të femrës. Qëllimisht ecte ngadalë, që të mos e shfaqte burrërinë. Këtë e bëri deri sa e futi në kurth atë që duhej ta fuste.

Çfarë s'u bie njerëzve në mend?)

(Qëndrimi i kronistit ndaj kobit të djaloshit dhe dashurisë së pafat në kohën e shtetrrethimit)

1. Ma thotë mendja se fjala ishte për një dashuri të rëndomtë, por fakti se ngjau në kohën e luftës dhe përfundoi me kob, jep mundësi për thashetheme të ndryshme.

Unë mendoj se ata njiheshin që më parë. Shtetrrethimi i pengoi që të takoheshin si rëndom. Kjo vlente sidomos për djaloshin, i cili, si të gjithë të tjerët, mbeti i mbyllur në qytezë. Ajo gjeti mënyrën si të futej në pjesën e rrethuar dhe ato që i tha të zotit të bujtinës «se kishte ardhur pse ia kishte thyer rrugën kundërmimi i jashtëzakonshëm i jargovanëve», ishin vetëm lojë fjalësh për t'ia fshehur dashurisë gjurmët. Dashnorët, më në fund ishin takuar. Pas gjithë atij aktrimi dhe atyre shtirjesh nuk kishin mundur t'i bënin ballë ndarjes, e cila duhej të pasonte pas një nate plot epshe të zjarrta. Kujtoj se dashnorët ishin të bindur se dashuria e tyre ishte e paperspektivë (kur kihet parasysh lufta dhe shtetrrethimi me kohëzgjatjen e pakufishme). Andaj vendosën që me aq të merrnin fund vuajtjet e tyre. Ajo mund t'i ketë thënë: nuk jetoj më pa ty. Edhe ai do t'ia ketë kthyer: as unë nuk jetoj pa ty... Kështu, ai bëri vetvrasje

në zonën e shtetrrethimit, e ajo bëri të njëjtën gjë sapo u largua nga pjesa e mbyllur. E tillë mund të ketë qenë marrëveshja e dashnorëve të pafat. Ka të ngjarë që në këtë mënyrë e ngritën zërin kundër së ligës së pashembullt që na ra mbi kokë pa dëshirën tonë. Ata mund të merren për martirët e parë që vullnetarisht vdiqën kundër shtetrrethimit të pakuptimtë?

2. Ka të ngjarë se ky ishte kob i dashurisë së pafat, të cilin të pafat e bëri mu shtetrrethimi?

Në të vërtetë, fjala ishte për një marrëveshje të kahmotshme të dashnorëve që të takoheshin ditën e pranverës (pra ditën kur ajo u pa në shesh, pa marrë parasysh rrethanat që do të krijoheshin). Por, shtetrrethimi që kishte prishur çdo gjë, e ngatërroi edhe këtë takim, saqë as dashuria nuk i shpëtoi ngatërrimit të përgjithshëm.

Kështu ngjau që dy të rinjtë të takoheshin, por në të njëjtën kohë të dëshpëroheshin, sepse djali nuk e takoi vashën që e priste, e as vasha nuk e takoi djalin që e priste! E gjithë kjo ngjau spontanisht, sapo ra terri i parë dhe të rinjtë po i afroheshin njëri-tjetrit, vasha gjithë dridhërimë e shqiptoi një emër që djaloshit iu duk i huaj, e po ashtu edhe djaloshi e shqiptoi një emër, që vashës iu duk i huaj...

Kur u panë së afërmi, vasha pa se ai nuk ishte dashnori i saj, e edhe djaloshi pa se vasha nuk ishte dashnorja e tij. Shpejt e kuptuan të vërtetën e hidhur, e cila në rrethana të tilla lidhet medoemos me kobin. Dashnori i vashës ishte vrarë me rastin e burgimeve të para që u bënë sapo u vu shtetrrethimi, e po ashtu e dashuria e djaloshit, që ishte po nga ai vend i vashës, kishte bërë vetvrasje sapo kishte kuptuar se në qytezën e rrethuar që të gjithë të rinjtë qenë vrarë...

Për hir të dashurisë së madhe, që s'e kishin më kurrnjëri, dashnorët fatkëqinj, u përqafuan, qajtën fatin e zi dhe vendosën të bënin vetëvrasje...

3. Dhe në fund, si kronist që jam, nuk mund të kaloj lehtë para atyre që thuhet se i tha Shahe Kërraba (se ajo ishte pjellë e shtetrrethimit).

Tash për tash nuk mund të jap ndonjë vlerësim të plotë

se a ishte ajo në të vërtetë pjellë e luftës dhe në shërbim të saj?

Mbase, edhe jeta, edhe vdekja në kohë të tilla prore ngatërrohen kcqas dhe marrin shpjegime të kundërta e të ndryshme?

Thashethemet e tjera në kohën e shtetrrethimit:

— Lit Cenës i dolën brirët,
— Nokën së Balës i doli samari,
— Zelihasë së Rudit i dolën dhëmbët e tretë,
— Lonit të Nikollës i doli syri i tretë,
— Cenës së Zylfisë i doli bishti,
e të tjera, e të tjera...

Martesa në kohën e shtetrrethimit

Një ditë prej ditësh u hap lajmi se Riza Probja martohej me Dile Gëzofziun.

Të premten e madhe. i madh e i vogël panë së bashku çiftin e jashtëzakonshëm: Riza Proben — dypëllëmbësh dhe Dile Gëzofziun — vajzën më të gjatë të qytezës.

Dilja kishte lesh fytyrës dhe zë mashkulli.

Rizaja ecte shpejt dhe i hidhte hapat njërin pas tjetrit, ndërsa, Dila, ashtu si plep, mezi lëvizte. Dora e tij e vogël kishte sharruar në atë të Dilës, e cila ecte e gërmuçur.

Megjithatë, dukej se shpërputhja qesharake nuk u pengonte që të ecnin hareshëm. Riza buzëqeshte dhe bënte me dorë, ndërsa Dilja gjithë gëzimin e shprehte me anën e një zgërdhirjeje të ashpër nga e cila shiheshin dhëmbët e mëdhenj të verdhë si dylli.

Çiftin e ri e përcillnin dy xhuxhët: Goni dhe Moni. Goni mbante skajin e vellos së nuses, ndërsa Moni unazat që do t'i ndërronin para syve të botës.

Në shesh i priste Xim Llastra me një def të vogël në dorë. Ai këndonte dhe kërcente si i marrë. Herë pas here prekte syrin e mbyllur, që s'i thahej kurrë dhe fshinte jargët që i shkonin çurg. Defi lëshonte një tingëllimë të çudit-

shme, si të qe krrokamë sorre, ndërsa zëri i tij e mbushte hapësirën me njëfarë gërvishtje monotone...

Çastin kur çifti i ri arriti në shesh, Xim Llastra e la defin mënjanë, fshiu jargët, fërkoi syrin e mbyllur dhe pasi u përkul (si të ishte në ndonjë skenë të teatrit), vrapoi kah ata dhe u ra në gjunj. Se çfarë tha ashtu me kokë teposhtë, nuk u mor vesh. Por, pas pak, u ngrit, mori qëndrim gatitu, dhe, pasi shikoi përreth, tha:

Po bie shi... Po merr mot i lig... Po fryn... A nuk po shihni se ç'heqamë që po bëhet gati të vijë?

Ha, ha, ha...

Po bie shi... Po fryn... Askush nuk po e sheh se ç'heqamë do të vijë?

Ha, ha, ha...

Ata që kanë sy nuk shohin...

Ha, ha, ha...

Ata që kanë veshë nuk dëgjojnë...

Ha, ha, ha...

Ata që kanë kokë fshihen...

Ha, ha, ha...

Çile gur gojën...

Ha, ha, ha...

Kush nuk sheh,

Kush nuk dëgjon,

Kush nuk bën vër me gojë...

Ha, ha, ha...

Kujt nuk i kërcasin eshtrat nga reumatizma, edhe pse bën të ftohtë dhe merr mot i lig!

Ha, ha, ha,...

Të gjithë të verbër,

Të gjithë të shurdhër;

Të gjithë memecë;

Ha, ha, ha...

Rroftë Riza Probja!

Rroftë Dile Gëzofziu!

Rroftë çifti i ri!

Rrofshin trashëgimtarët që do të vijnë nesër a pasnesër!

Rrofshin ata që nuk do të jenë më as të verbër, as të shurdhër e as memecë!

Rrofshin!

Pastaj Xim Llastra mori defin e i ra. Sërish sheshi jehonte prej tingëllimave të çuditshme. Dikur, pasi fërkoi syrin e mbyllur, pastroi jargët që iu zgjatën gjatë fjalimit, nga xhuxhët mori unazat dhe ua futi në duar Rizës e Diles.

Rroftë çifti i ri!, tha.

Disa herë tha rroftë çifti i ri dhe, si ta kishte ngacmuar kush keqas, bashkë me defin iku me të shpejtë. Nuk vonoi e edhe Dilja, pasi e kapi ngrykë Riza Proben dhe e përqafoi botërisht (pa mëdyshje se ky ishte përqafimi i parë publikisht në qytezën tonë qëkur mbahet mend), u nis me të shpejtë pas Ximit. Nga hapat e saj të rëndë dukej se dridheshin shtëpitë.

Goni e Moni i shkonin prapa dhe këndonin gjithë gëzim:

«Nusja jonë si pehrri»

Lum e lum, o dhënrri i ri....

«Nusja jonë si pehrri...»

Thuhet se kënga e tyre u dëgjua atë natë edhe dy net të tjera te Ura e Taliqit...

Thashethemet e tjera në kohën e shtetrrethimit:

— Cjapi i Sylos sërish u pa në kodrinë. Këtë herë nuk mekëroi, por foli si njeri!

(Me këta veshë e dëgjova kur tha: mbretit do t'ia marr shpirtin me këta brirë... Mbretërit i kam zët.. .

Këtyre dëshmive të Rremë Batares iu shtuan edhe shumë të ngjashme si:

... e pati puna e tij,

... e gjithë bota do të tallet me mbretin...

... mos çani kokën... koha po punon për ne: : :

... ruajeni gjakftohtësinë...

... uji e di rrugën e vet...

... qeni leh kur i bien dhëmbët...

e të tjera e të tjera, të cilat cjapi i Sylos na i kishte thënë para të tjerëve!)

— Ushtarët po e kërkojnë edhe më tutje kuçedrën në Blinishtë.

(Pasha kryet e nënës, — tha Riza Probja, — si i vogël që jam, një ditë u katrrisa për leshin e një ogiçi dhe dola jashtë rrethimit pa u hetuar fare. Në Blinishtë pashë njerëz me rroba të hekurta, si hapnin ca puse të mëdha. Futeshin në ta dhe nuk dilnin prej tyre me orë të tëra. Me vete kishin ca hekura të gjata... Ata që rrinin lart pa ia ndarë u thoshin:

E gjetët?

Kur do ta gjeni atë të shkretë?

Ç'damar i mallkuar që është?

Po zgjati kështu, na mori e liga...

Po deshët, mund t'ua tregoj vendin ku ata punonin);

— Nurie Futa po bëhet gati për luftë. I duhen edhe dy veta për ta rrumbullakosur numrin prej nëntëqind vetash...

(Ka kohë që dëgjoj zërin e saj nëpër oborr, thotë një fqinj i saj. — Atë nuk e shoh, por e dëgjoj zërin e saj si flet: Gatitu! Gatitu!... Një dy, një dy dy... Një dy.. Para... Prapa... Para... Djathtas... Majtas.... Pararoja majtas.. : Njëdy, një dy.... Më shpejt!... Togu i parë këndej ... Togu i dytë andej... Togu i tretë prapa: : : Pushoni ca... Shpejt u lodhët... Shihet se ka njëqind vjet që nuk keni vrapuar... Mos i harroni rrasat e varreve... Duhet t'i keni pranë... Mos i harroni mburojat... Pa rrasa të varreve nuk fillohet lufta... Lufta është e gjatë... Këtë mos e harroni...

Kështu nga mëngjesi deri në mbrëmje dëgjoj zërin e saj. Ndonjëherë edhe natën dëgjoj të njëjtat fjalë... Lufta nuk bëhet vetëm ditën, thotë ajo... Lufta bëhet edhe natën... Lufta bëhet edhe nën tokë edhe në qiell... Lufta bëhet me armë dhe lufta bëhet edhe pa armë... Ajo bëhet gjithnjë, edhe kur flemë, edhe kur heshtim, edhe kur flasim, edhe kur ëndërrojmë... Luftë i thonë kësaj...)

— Në burgun e kështjellës një fëmijë preu në fyt katër ushtarë, e pastaj u bë i padukshëm!

(Ishta një fëmijë sypishë. Ndryshe nga të tjerët që ato ditë i sillnin në burgun e kështjellës, — tregoi Xajë Sherri,

i cili qëlloi në burg për një vjedhje nga ato që ai i bënte si shpesh. — Me sytë e mi e pashë sesi e munduan të shkretin fëmijë për vdekje. E rrahën dhe e rrahën por ai nuk bënte vër me gojë. E qëllonin pa mëshirë, e ai rrinte si i ngrirë. Me gjasë kjo i tërboi edhe më shumë hetuesit. Na thuaj, o i gjorë, sa veta ishin te ju atë natë? Na thuaj, o ta morëm shpirtin. E ai heshtte. I duronte të gjitha ato mundime nga të cilat do të rrëzohej edhe bualli njëmijokësh... Fëmija nuk bëzënte. Mua gati më ra të fikët kur e shihja të gjorin si duronte dhe heshtte. Dikur fëmija u lodh. U shtri poshtë. Mendova se e lëshoi shpirti. Hetuesit e lagën me ujë dhe e shkundnin. Nuk bën të vdesë pa folur, i thoshin njëri-tjetrit. Nuk bën të vdesë si heshtak. Do t'ia presim gjuhën. Pashë se ata nuk po mahiteshin. E morën thikën dhe ia nxorën gjuhën. Kur po bëheshin gati t'ia shkurtonin, për habi, fëmija u ngrit befas. Lëshoi një ulërimë të madhe, nga e cila më ushtuan veshët dhe iu sul hetuesve. Ua mori thikën dhe sa çel e mbyll sytë që të treve ua preu kokat.

A thua mos po më mashtronin sytë? I fërkova një copë herë, por ata nuk po më mashtronin. Para këmbëve të mia gjendeshin tri koka të prera, prej të cilave ende rridhte gjak i freskët. U tmerrova. Volla. Fëmijën sypishë nuk e pashë më...

Kur më detyruan t'ua tregoja fije e për pe ato që pashë, ata më dhanë pesëdhjetë kamxhikë shpinës dhe më thanë se po nxora ndonjë fjalë rreth kësaj, ta shkurtojmë gjuhën. Por, ç'e do që mua s'më mban gjë...)

Lindja e parë në kohën e shtetrrethimit

Fjala mori dhenë se vejushës plakë, Shazijes, së cilës burri i kishte vdekur para njëzet e sa vjetësh me zhig të madh që nuk po linte pas trashëgimtar, i lindi djalë.

Një natë pa hënë, kur në qytezë po bëheshin bastisje të mëdha dhe nuk dihej se kujt do t'i shkonte koka më parë, thuhet se vejusha plakë ndjeu dhembje të mëdha në bark. Dhembjet i pati aq të forta, sa uluriu në kupë të qiellit.

(Kur shkuam ta shohim se ç'kishte, — thanë plakat Nurije dhe Litë, — Shazija po gërrithte tokën me thonj. Shtrëngonte barkun dhe thoshte se diçka e tmerrshme po i këpuste zorrët. Ndihmomni, ndihmomni, thoshte e shkreta grua. Dhe kur ia hoqëm ushkurin, pamë se barkun e kishte të fryrë. U bindëm se ato ishin dhembje fëmije dhe asgjë tjetër.

Ti qenke me barrë, i thamë.

Ajo, si ta kishim prerë me ndonjë hanxhar, kërceu dhe përpak sa s'na i verboi sytë.

Ç'thoni, moj të marra? Ç'thoni kështu? Çfarë barre? A s'e dini ju se ka njëzet vjet që rri kërcu me hijallin e tim shoq që më la si qyqe në më të mirën kohë?

Çfarë t'i thoshim tjetër ajo u skuq në fytyrë dhe dukej si gacë.

Po ky ç'është? i thamë duke ia prekur barkun e fryrë. A nuk po e sheh si t'u ka bërë?

Korba unë, tha ajo pasi e preku barkun dhe u bind se njëmend e kishte të fryrë, korba unë. Vetë djalli qenka futur në të! Mos qofsha!

Prapë zuri të ulërinte. Filloi t'i mëshonte barkut me grushta dhe të shqelmonte si e çmendur. Mbase ai tërbim bëri që vejusha plakë të lirohej më shpejt prej barrës që thoshte se nuk e kishte vërejtur...

Kështu i lindi djalë.

E lidhëm e ia vumë pranë. Kishim frikë se do t'ia merrte shpirtin, por për habinë tonë, ajo u qetësua dhe, si të mos ishte ajo e pak mëparshmja, zuri ta ledhatonte.

Lumja unë! Lumja unë! i thoshte. Lumja unë! Si s'e dija? Si?...

Ne ikëm si të ngrira...

Thashethemet për fëmijën e vejushës plakë në kohën e shtetrrethimit

— Vejusha plakë qëllimisht e kishte mbajtur fëmijën në bark mbi njëzet vjet, ngase ishte betuar se do t'i hak-

merrej të shoq për disa të pamira që i kishte bërë. Andaj fëmija kishte dalë i burrëruar: me mustaqe, me flokë të gjatë e mjekër të thinjur...

(E di fort mirë se ajo vetëm një natë e pati burrin në shtrat, — tha plaka Nurie. — Kurrë më nuk hyri në dhomën e saj. Nuk e di pse? Shazija priti e priti dhe u ndry në vete. Ditë e natë mendoi si do t'i hakmerrej atij. Njëherë më pati thënë se do ta turpëronte kur ai nuk do ta priste këtë...);

— Vejusha lindi lugat...

(Njëzet vjet nuk doli jashtë, — tha Shahe magjupja. — Rrinte brenda dhe ushqehej me farë të terura e me urithë. Prej meje kërkonte t'i sillja çdo javë nga një urith dhe këtë do të ma paguante me flori. E di fare mirë se ajo çonte dashuri me një të vdekur, që i vinte në dhomë si shpirt. Po, qebesa, nuk e keni rrenë, vejusha shfrynte epshet e veta ditë e natë në dhomë të errët me të vdekurin dhe pastaj thithte gjakun e urithëve... Shëmtimi u desh të dilte në këtë botë për t'i dëshmuar mëkatet e saj. Ruajna zot!);

— Vejusha plakë as që ka lindur fëmijë. Vejusha plakë as që ka pasur dhembje, e Nura e Lita as që i kanë ndihmuar e as që kanë pasur punë me të... Ato e kanë kurdisur punën që të fshehin një kopil të një zonje të madhe të qytezës, gjoja se ka lindur vejusha... Ato e dinin se vejusha plakë që moti është kthyer në hije...

(Shumë trokita në derën e saj, — tha Meremja e Golës, — por nuk mora përgjigje. Nuk dihet se kush e ndez qiriun në atë shtëpi...);

— Vejusha plakë ka kohë që ka vdekur...

(Vejusha plakë ka vdekur çastin që mbeti vetëm, — tha Xilja e Zekës. — Këtë e di fare mirë. Ngjau kjo para njëzet e sa vjetësh.

Në atë shtëpi rri qoftëlargu, që herë-herë vajton si fëmijë!)

I marri Sylo bëhet i rrezikshëm në kohën e shtetrrethimit

Njëmend kohë e çuditshme. Kur i madh e i vogël janë futur brenda dhe kërkojnë birën e miut, i marri Sylo thonë se është bërë i padukshëm! Qysh se ia gjakosën cjapin, zëri i dëgjohet i shpërndarë në të gjitha anët e qytezës. Bile, për dallim prej herëve të tjera (pra kur shihej me cjapin dhe më shumë mekëronte se thoshte diç të kuptueshme), Sylo tash mban edhe fjalime!

Ditën e pazarit, në Çarshi të Madhe zëri iu dëgjua gjithë ditën. Fjalët e tij brodhën nga sokaku në sokak dhe u përhapën marramendshëm.

Ja ca nga mendimet e Sylos, që i ndjeva të shkapërderdhura nëpër qytezë:

«Kohë e pakohë kjo e jona. Gjërat ndryshojnë marramendshëm: sa i mirë, sa i keq... herë ashtu, herë kështu...

Ha, ha, ha...
Dje mik, e sot armik...
Ha, ha, ha...
Dje armik, e sot mik...
Ha, ha, ha...
Dje i besueshëm, e sot i pabesueshëm...
Ha, ha, ha...
Dje i madh, e sot i vogël...
Ha, ha, ha...
Dje burrë e sot shurrë...
Ha, ha, ha...
Ec bjeri në fije!
Në Lamën e druve Sylo tha edhe këto:
Qengji e ha ujkun...
Peshku i vogël e ha peshkun e madh...

Çfarë tha njëri për thashethemet e Sylos në kohën e shtetrrethimit?

Sylo ka filluar të mbledhë një ushtri të madhe vullnetarësh, që do të luftojnë deri në pikë të fundit. Armata e

tij e padukshme përbëhet prej të gjitha llojeve të kafshëve dhe shpezëve. Në Kodër të Çabratit ka filluar t'i stërvisë njësitë vullnetare që përbëhen prej këtyre formacioneve:

dhjetëshja e gomarëve,
dhjetëshja e lopëve,
dhjetëshja e maceve,
dhjetëshja e deleve,
dhjetëshja e pulave,
dhjetëshja e lepujve,
dhjetëshja e patave,
dhjetëshja e rosave,
dhjetëshja e krimbave dhe
dhjetëshja e urithëve.

Komandant i përgjithshëm është cjapi i përgjakur, i cili rri në majë të manit dhe flet me hënën:

— Syloja do të niset me ushtrinë e tij të tmerrshme çastin që do të hetojë se i madh e i vogël në qytezë i kanë mbushur tëlinat...

Të nesërmen, po ai njeri, i rrotulloi fjalët dhe, për Sylon tha edhe këto që gjenden më poshtë:

a) Sylo as që ka folur ndonjëherë. Ai nuk e ka kuptuar gjuhën e njerëzve. Ishte një kafshë që rastësisht doli me dukje njeriu. Në të vërtetë kafshë ishte dhe kafshë mbeti...

b) Ato që thonë se i flet Sylo, i flet dikush tjetër, nga ata të padukshmit që shtohen dita-ditës... Kryehetuesi dhe hetuesit e tjerë dëshirojnë që këto t'ia veshin Sylos në mënyrë që e gjithë çështja të zhvleftësohet sa më tepër...

c) Ato që dëgjohen nëpër rrugë si dhe pamfletet e shkruara, për të cilat thuhet se janë vepër e Sylos, në të vërtetë janë të shtabeve të shtetrrethimit... Hetuesit i trillojnë të gjitha për t'i arsyetuar pastaj bastisjet, burgimet dhe represaljet, e së fundi, edhe kohëzgjatjen e pafund të shtetrrethimit. Me një fjalë, Kryehetuesi duhet të ketë «dëshmi» të bollshme se «armiku po vepron...». Andaj, është më se e qartë, kundër tij duhen marrë masat e nevojshme e të domosdoshme...

d) se ato që shkruhen dhe thuhen njëmend i flet ndonjë nga tanët, por që ai në të vërtetë paguhet nga Kryehetuesi dhe njerëzit e tij. Pra kryen urdhrat e tyre.

P.S.

Si mos t'i luajë njeriut mendja nga ky panair mendimesh dhe gjykimesh ndër më të çuditshmet?... Si?

Thashetheme të tjera në kohën e shtetrrethimit

— Sali Therra zuri qeshkun njëqind okësh në livadh!

(Me sytë e mi e pashë, bëri be Himë Qafziu. — E kishte lidhur për bisht të gomarit dhe e tërhiqte zvarrë përpjetëzës së Rrypës. Pas i shkonin një mori zogjsh, që ai i trembte me anën e një filikaqe...

Shtatë ditë e shtatë net me disa të Mëhallës së Sefës bëri kokrrën e safasë nën Urën e Taliqit..);

— Dile Gëzofziu vuri xhyzlykë të diellit (ndoshta ata që i solli Sakip Brini) dhe tash sheh botën me lule...

Qyshse është martuar me Riza Proben, çdo të hënë del ne namazxhah dhe thotë:

Bota qenka sheqer...

Një garë e çuditshme publike në kohën e shtetrrethimit

Se nga erdhi një njeri i trashë dhe i shkurtër, nuk dihet. Por ai tërhoqi vërejtjen për çehren e zymtë dhe një kamxhik që e mbante në dorë me të cilin pa ia ndarë u binte çizmeve të tij të gjata, të cilat gjithnjë i shkëlqenin. Trashaleci shkurtalec, apo siç do të quhet, Trashalecshkurtaleci, u soll e u mbështoll pa folur me kë. Të tretën e panë me tre veta duke hapur një çadër midis Fushës së sahatit. Punoi pa ua vënë veshin kurreshtarëve të shumtë, të cilët i kishin bërë sytë katër dhe shikonin nga të gjitha anët. Buzëmbrëmjes çadra u formësua. Ngrihej e rrumbullakët dhe e lidhur nga të gjitha anët me litarë të fortë dhe të gjatë, që nisnin në tokë dhe shkonin përpjetë deri në majën e majës. Po të mos ishte Loni Keqi e të thoshte se çadra e përhime ishte vend cirku, kushedi sa fjalë do të harxhoheshin kot së koti për t'ia qëlluar së vërtetës.

— Çadër cirku është, — tha ai disa herë, — Nuk e keni rrenë. E pate parë njëherë mu këtë në ëndërr... Cirqet janë pjesë e qyteteve të mëdha. A nuk flet kjo për atë se edhe ne po bëhemi pjesë e botës?

Kur dikush e pyeti se çfarë ngjet në atë farë çadre, Loni Keqi tha:

— Çkamos... Për shembull, njeriun mund ta shihni herë me kokë e herë pa kokë...

— Auuuu!

— Pastaj, tha Loni Keqi, i kënaqur që të vetmen herë dikush po ua vinte veshin atyre që thoshte ai, — pastaj, aty zogu mund të bëhet njeri, e njeriu të bëhet zog...

— Auuuu!

— Pastaj, sheh edhe ai që nuk mund të shohë...

— Auuuu!

— A nuk ju thashë se jemi fatlumë?

Loni Keqi do të fliste edhe më për marifetllëqet që mund të shihen aty, por në shesh u shfaq njeri nga ndihmësit e Trashalecshkurtalecit, i cili me sa zë kishte zuri të fliste për një garë që do të mbahej të nesërmen në cirk.

Ai tha se në atë garë mund të merrnin pjesë që të gjithë, i madh e i vogël.

Atë natë cirku zuri vend në mendimet e të gjithëve. Për herë të parë pas shpalljes së shtetrrethimit, i madh e i vogël i përjashtuan nga koka ushtarët, bastisjet, burgimet dhe gjithë ato të liga që u ranë mbi kokë.

Ç'garë ishte, vallë, ajo?

Çfarë do të ngjiste brenda asaj çadre të çuditshme?

A thua po vijnë kohë kur gjërat kryesore do të zëvendësohen me ato periferike, siç është cirku?

Çmos u mendua atë natë...

Dita e garës nuk ishte si çdo ditë tjetër. Njëfarë heshtjeje e shurdhër që vërehej në të gjitha anët dukej se edhe njerëzit i kishte bërë si të paqenë. Ata nuk po dukeshin as në rrugë, as në sheshe e as gjëkundi.

A mos i kishte lëshuar toka?

Kjo po e shqetësonte edhe Trashalecshkurtalecin, i cili kishte dalë para çadrës dhe ecte gjithë shqetësim. Iu binte

çizmeve me kamxhikun e hollë dhe shikonte djathtas-majtas. Pa mëdyshje se ai ishte i brengosur pse qytezën e kishte pllakosur një heshtje e tillë, të cilën ai nuk e kuptonte.

Megjithatë, shqetësimin ia hoqi Loni Keqi, i cili u pa të ecte drejt çadrës me dy të tjerë, që i shkonin disa hapa pas dhe ecnin si t'i kishin këmbët të tepërta.

Pronari i cirkut i shikoi një copë herë si afroheshin dhe uroi që ata të kenë këmbë të mbarë. Përvoja e gjatë ia bënte me dije se kudo në çadrën e tij vizitorët hynin me përtesë, por me përtesë largoheshin nga ajo. Dronte se ky vend kishte diçka të veçantë. E këtë veçanti ai po e vërtetonte në ecjen e atyre dhe në hamendjet që ua shfaqnin lëvizjet e tyre sa më tepër që i afroheshin çadrës.

Loni Keqi, edhe pse i pari tha se çadra ishte cirk dhe cirqe të tilla gjetiu kishte sa të duash, edhe vetë hamendej. Këtë ia tregonte shalakatja e duarve dhe e këmbëve, të cilat i shkonin para e prapa sikur t'i qenë shkëputur kaherë nga pushteti i tij. Bile, ai linte përshtypjen e atij që e kishte humbur kontrollin mbi vetveten. Kjo i bëri përshtypje edhe Trashalecshkurtalecit dhe e shtyri të hamendej se mos do të kishte punë me ndonjë të marrë, të cilin qëllimisht e kishin shtyrë të merrte rrugën drejt cirkut për ta tallur.

Por, a mund të kishte garë të tillë ku edhe të marrët nuk do ta thoshin fjalën e tyre?

Këtë Trashalecshkurtaleci e dinte, por nuk dëshironte që këtë herë që në nismë të kishte të bënte me të tillë.

Loni Keqi më në fund u fut në cirk. Zgjatja e hamendjeve të tij dhe çfarë përjetoi ai kur u ballafaqua me Trashalecshkurtalecin nuk i ka interesuar kronistit. E rëndësishme është se ai, pas gjithë asaj shalakatjeje hyri brenda dhe rrugës së tij, kush më herët, kush më vonë, shkuan edhe shumë të tjerë. Po ashtu meriton të thuhet se gjurmëve të tij shkoi së pari Rremë Batarja, pastaj Ukë Currani, e si i tretë Lytë Ziu...

Më tutje nuk u pa se kush e para kujt futej në cirk. Por, është e vërtetë se në hapësirën e përbashkët në çadër u gjendën: Dun Pelimi, Cenë Karremi, Gogo Geci, Dan Ziu, Shahini i Taliqëve, Njaziu i Qerimit, Ukë Canauka, Cyme

Shelnja, Lytë Bardhziu, Lam Metahasi, Selami Daci, Shahin Lyta, Selami Koka, Sabri Hamalli, Shahin Lala, Nikë Zogjani, Nikollë Kryqi, Ifran Dibra, Loni Guri, Hilë Lehta, Mon Sefaja, Leci i Lamalecit, e veja e Hyrrit, Zymrija, Liti i Cenit, Riza Probja, Dile Gëzofziu, Gon Xhuxhi, Mon Xhuxhi, Cen Zhuga, Hilmi Gaxha, Xim Llastrja, Gani Pasuli, vejusha Nerimane, Sali Therra, Himë Qafgjati e edhe ca të tjerë...

I kënaqur që në arenë kishte shumë veta, Trashalecshkurtaleci hipi në tribunën ballore dhe pasi i shikoi të gjithë një nga një, tha:

— Gara është e thjeshtë. Unë flas diçka dhe ai që nuk mund të përmbahet, e lëshon garën... Fiton ai që hesht më së shumti... Heshtja, pra, është më e rëndësishmja. Heshtja shpërblehet.

Të pranishmit zunë ta shikonin njëri-tjetrin me habi. Shumëkush po e vriste mendjen se ç'garë ishte ajo vallë në të cilën fitonte heshtja? Mbase kjo lidhej me bindjen e tyre se heshtja është më e lehta. Të flasësh, megjithatë, është më vështirë...

Kronisti, (pra autori i këtyre rreshtave) shikonte si i ngrirë dhe priste me padurim se ç'fjalë ishin ato që do t'i sprovonin të pranishmit?

Pas pak Trashalecshkurtaleci dha shenjë se gara mund të fillonte.

Hapësira e ngushtë e çadrës u bë edhe më e ngushtë nga jehona e daulles. Kur pushoi daullja Trashalecshkurtaleci tha:

— Bora është e zezë...

Heshtje.

— Bora është e zezë, tha prapë.

Loni Keqi sa s'tha se bora ishte e bardhë, por kur i shkoi mendja se duhej të heshtte dhe kusht për të fituar ishte heshtja, u përmbajt. Koka e tij, e cila nuk ishte mësuar me mendime të thella, u shqetësua dukshëm, ngase për herë të parë duhej të mendonte paksa. Kjo iu duk e pamundshme dhe po të mos e kishte kafshuar gjuhën, doemos do të fliste.

Edhe të tjerët heshtën. E Trashalecshkurtaleci, që i mati mirë veprimet e të gjithëve, sërish përsëriti të njëjtat fjalë.

Prapë heshtje. Prapë jehona e tamtameve të daulles që plotësonte thekshëm hapësirën e kohës midis fjalëve të pronarit të cirkut dhe sprovës së garistëve.

— Bora është e zezë!

— Bora e zezë!

— Bora është e zezë!

Herë fjalët e trashalecshkurtalecit, herë tamtamet e daulles u binin garuesve furishëm në kokë.

— Bora është e zezë!

— Bora e zezëëëëë!

Nuk vonoi dhe nga turma shpërtheu një zë gjithë pezëm:

— Bora nuk është e zezë, por e bardhë!

Ishte Loni Keqi, i cili si t'i kishte rënë mohit, mbylli gojën dhe u shtri sikur të mos qe ai që kishte folur.

Trashalecshkurtaleci ua bëri me dorë rojeve. Si t'u thoshte se për të gara mbaroi.

Dhe ata iu afruan Loni Keqit dhe e kapën për krahësh. I zënë ngushtë, nuk ishte i sigurt se a duhej të kundërshtonte apo të ecte nga e shpinin ata të dy. Por, sapo u nis, tha:

— Mendon se jemi të marrë, — iu drejtua pronarit të cirkut? — Mendon se ne nuk e dimë se bora është e bardhë...? Të gjitha i dimë... Të gjitha...

Loni Keqi do të fliste edhe më, por ata që e kapën prej krahësh, e hodhën jashtë.

Në çadër mbeti për pak jehona e fjalëve të tij e shkapërderdhur, por qenë tamtamet e daulleve që atë e bënë të paqenë.

— Uji shkon përpjetë, — tha Trashalecshkurtaleci.

Heshtje.

— Uji shkon përpjetë, — tha edhe për të dytën herë. E të njëjtën gjë e përsëriti edhe shumë herë.

Prapë heshtje.

Prapë jehuan daullet, të cilat binin gjithnjë e më fuqishëm.

— Uji shkon përpjetë!

— Ha, ha, ha! u dëgjua një e qeshur e cila me të shpej-

të u përhap në të gjitha anët e cirkut. Hahaja zgjati një copë herë.

Ai që po qeshte, ishte Ukë Currani. Qeshte dhe brinjët i mbante nga të qeshurit.

— Kjo nuk është garë por njëfarë gënjeshtre, — tha, pasi hoqi dorë nga e qeshura... Kjo është më se e qartë... Gënjeshtra duhet të përdoret për të dalë lëkure...

Trashalecshkurtaleci nuk u dha kurrfarë shenje ndihmësve. Ata iu afruan Ukës dhe deshën ta zinin për krâhësh.

— Dal vetë, — tha Uka prajshëm. — Por, mos mendo se më munde. Mashtrohesh.

— Loja mbaroi, — tha pronari i cirkut. — Ti e humbe garën...

— Nuk e humba, — foli Uka prapë. — Nuk e humba. Unë dola nga një garë e tillë që ta kem ndërgjegjen të pastër. Ta pranosh një lojë të tillë do të thotë të pajtohesh me gënjeshtrën. Këtë s'e dëshiroj. Mirëmbetëshit!

Trashalecshkurtaleci ftohtas e përcolli largimin e Ukë Curranit. Sapo doli ai, tha:

— Hëna në bisht, e dielli në gisht...

Ende pa e mbaruar mendimin, dikush priti e tha:

— ... gishti në bisht e bishti në gisht...

Ishte Lytë Ziu, i cili po fliste gjithë zemërim:

— Pse e dallashon mendimin? Pse s'e thua si duhet? Këtë e dinë i madh e i vogël...

— Edhe për të gara përfundoi...

— Unë as që fola, — tha Lytë Ziu. — Përsërita atë që ti e the dallash.

Pronari i cirkut heshti. Shtirej se nuk e shihte.

— Lehtë është ta kapësh njeriun për gjuhe dhe ta heqësh pastaj zvarrë, — tha Lyta kur po largohej. — Në këtë mënyrë secilin do ta hedhja në gjunjë...

Lyta tha edhe diçka, por tamtamet e daulleve ranë fuqishëm...

— Qengji e ha ujkun, — tha Trashalecshkurtaleci.

Qengji e ha ujkun!

Qengji e ha ujkun!

Heshtje e thellë.

— Qengji e ha ujkun!

Prapë ranë daullet.

— Qengji e ha ujkun!

— Qengji e ha ujkun!

— Qengji e ha ujkun! Qengji e ha ujkun!

Arena po shungullonte. Të përziera me tamtamet e daulleve, ato bëheshin edhe më të thekshme.

Të pranishmit po i mbyllnin veshët. Zhurma ishte gllabëruese.

— Qengji e ha ujkun!... Qengjiiiiiiii... iiiiii...

— Mjaft se u çmendëm, — folën disa veta si njëzëshëm. — Mjaft! Edhe i marri e di se qengji nuk mund ta hajë ujkun, por ujku e ha qengjin.

Ata që kundërshtuan ishin katër veta: Dan Pelivani, Cen Karremi, Gogo Geci dhe Shahini i Taliqëve. Ndër ta më i zëshmi ishte Gogo Geci. Ishte skuqur e bërë all. Sa më shumë që fliste fjalët i bëheshin të pakuptimta. Nga goja i shpërthenin jargët dhe një pështymë që hapej gjithë stërpikë.

— Si s'ke turp të thuash kështu! Çirresh me të njëjtat fjalë pareshtur...

Pronari i cirkut nuk ua vuri veshin atyre që po i thoshte Gogoja në të dalë. Po i fshinte djersët. Dukej se ishte lodhur. Puna e qengjit dhe ujkut i kishte qitur bukur shumë telashe. Pas një pushimi të shkurtër tha:

— Pleshti sa një buall!

— Gënjeshtër, ndërhyri Njaziu i Qerimit. — Ku ka plesht sa një buall? Pse na hip në qafë me këso gjërash?

Ende pa dalë mirë Njaziu i Qerimit, ai tha:

— Bualli sa një plesht!

— Prapë po gënjen, — tha Ukë Cenauka. — Ku ka buall sa një plesht? Sa kohë durohen muhalife të tilla, bre vëlla? A jemi ne taravola?

Trashalecshkurtaleci vuri buzën në gaz, i kënaqur që më në fund ia kishte dalë që ata t'i bënte të papërmbajtshëm.

— Nuk kam parë, bre vëlla, si ti. Flet rrena klloçe dhe nuk skuqesh fare... Nuk kam parë të tillë. Unë duhet të skuqem për ato që thua ti, — foli Uka në të dalë.

— Lepuri ka dy këmbë...

— Jo, por pesëdhjetë, — foli Lytë Bardhi gjithë pezëm.
— Patjetër se mund t'i ketë pesëdhjetë po qe se i ka dy...

— Lepuri ka dy këmbë...

— Punë djajsh i thonë kësaj, — tha Lyta gjithë dëshpërim, — kur njeriu duhet të heshtë para gënjeshtrave... Çfarë mund të fitohet nëse heshtet? Gënjeshtra vazhdon. Kaq...

— Fluturon, fluturon... peshku. — Trashalecshkurtaleci.

— Fluturon jotamë, — ia ktheu Lam Metahasi. — A more vesh: jotamë!

Pronari i cirkut, si ta kishte pritur këtë shfrim, zuri të qeshte me nënçmim.

— Edhe ju të tjerët jeni të marrë që e dëgjoni këtë gënjeshtër, — tha Lami kur po largohej. — Të gjithë... të gjithë. Ç'kohë është kjo kur njeriu duhet të bëhet i shurdhër?

Një nga një, arenën e lëshuan shumë veta. Pronari i cirkut ishte gjithnjë e më i kënaqur, ngase, sapo fliste, ata e kundërshtonin. Bënte me dorë kah rojet dhe vazhdonte të thoshte ato që kishte bërë gati që më parë.

Dikur në arenë mbetën tre veta: Dile Gëzofziu, Riza Probja dhe Xajë Llastra.

E shikonin njëri-tjetrin dhe heshtnin. Nuk ia vinin fare veshin pronarit të cirkut dhe atyre që thoshte ai.

Kjo po e shqetësonte Trashalecshkurtalecin. Fliste. Çirrej. Kërkonte që daullja të binte më thekshëm. Kërkonte zhurmë të meçdokushtme.

Por Dile Gëzofziu, Riza Probja e Xajë Llastra, nuk jepeshin fare. I kishin futur veshët në lesh dhe s'çanin kokën për ato që thoshte Trashalecshkurtaleci.

— Jeni të shurdhër, — po u thoshte pronari i cirkut.
— Patjetër se jeni të shurdhër. Ndryshe do të thoshit ndonjë gjë...

Ata heshtnin.

— Mbase jeni të marrë? Vetëm i marri s'ua vë veshin atyre që thuhen... Vetëm i marri rri si i ngrirë... Të tillë jeni ju...

Një copë herë i zoti i cirkut i fyu. U tha çmos. Por Dilja, Rizaja e Xaja shikonin njëri-tjetrin dhe nuk ia varnin fare Trashalecshkurtalecit.

Dikur i zoti i cirkut urdhëroi që të mos binin daullet më. Në vend të çirrjes, zuri t'u fliste me zë të qetë.

— Mbase gabova paksa? Gabova. Ju nuk jeni të marrë. Harrova se ju jeni në garë. Këtë nuk mund t'ia fal vetes. Bëra një gabim të madh. Po shoh se ju jeni të dëgjueshëm... Unë e di se ju po i përcillni ato që po them dhe pajtoheni me fjalët e mia, por jeni edhe me mua... Gënjen ai që thotë se ju nuk keni veshë e sy. Gënjen ai që thotë se ju nuk keni gojë... Mendja më thotë se ju jeni tepër të dëgjueshëm... Jeni shumë të dëgjueshëm... të tillë ishit dhe do të mbeteni .. E di unë këtë... e di...

Pas pak zbriti në arenë dhe po u thoshte:

— Ju jeni të mitë... Ju jeni me mua?... Ju jeni të mitë... Pa ju nuk di si do t'ia bëja?... Juve ju kam në dorë të djathtë...

— Gënjeshtar! Pse flet gënjeshtra! — thanë ata të tretë njëzërit. — Asnjëherë nuk kemi qenë me ty e as me të tutë, si po thua! Gënjeshtar! Pse dëshiron të na njollosësh?

Dile Gëzofziu e zuri për fyti dhe po të mos ishin ndihmësit, t'ia heqnin me të shpejtë nga duart, do t'ia nxirrte frymën.

— Pse po na fyen, or derr debederri? Pse flet kështu kur nuk të kemi borxh?

— Ha, ha, ha, — zuri të qeshte pronari i cirkut. — Ha, ha, ha!

Hahaja e mbërtheu gjithë cirkun.

— A s'e keni të qartë se humbët? Kush ju ka faj se jeni të marrë? Kush ju ka faj që s'e dalloni fjalën e mirë nga ajo me bisht? Kush ju ka faj?

— Ti! Ti na e nxore gjuhën! — tha Riza Probja. — Ti përdore dredhinë e jo ne...

— Ha, ha, ha... Kush ju ka faj që nuk dini të përmbaheni? Kush?

— Lajkatar, — shfreu prapë Riza Probja me zërin e tij të hollë si të sorrës. — Lajkatar!

Xim Llastra po qante. Lot e jargë i shkonin poshtë dhe i vareshin deri te këmbët.

— Tash më nuk ka heshtakë, — tha Trashalecshkurtaleci, — U thanë ato që u desh të thuheshin. Unë e bëj edhe gurin të flasë...

Por, çastin që po bënte me dorë nga arena e zbrazët, mbase për ta vërtetuar atë që e tha me aq kreni i zoti i cirkut pa se në të gjendej dikush. Fërkoi sytë dhe si të kishte parë ndonjë krijesë të jashtëzakonshme nxitoi kah arena.

— Po ndodhin gjëra të jashtëzakonshme... Gjëra të jashtëzakonshme, — po fliste. — Qenë tre dhe që të tre u mundën... Ky është ndonjë mashtrim.

Një copë herë foli ashtu dhe si të kërkonte përkrahje nga publiku doli në arenë.

— A s'ishin ata tre të fundit?

Publiku, që po bëhej gati ta lëshonte cirkun hetoi se poshtë rrinte plaka Shahe Kërraba si e gozhduar.

— Kjo plakë e mallkuar nuk ishte këtu. Nga doli ajo tash?

Pastaj, iu drejtua ndihmësve:

— Kush e solli?

Ata heshtnin dhe dridheshin.

— Pse më shikoni si të marrë?

— Dyert qenë të mbyllura, — thanë ata. — Të gjitha qenë të mbyllura...

— A mos piku nga qielli?

Ata rrudhën krahët.

Ai shikoi sërish publikun. Por askush nuk tha gjë. Të gjithë pritnin se çfarë do të ndodhte.

— Mirë pra, — foli pronari i cirkut gjithë pezëm. — Do të kem të bëj me një plakë kërcunë, e cila çdo çast mund të japë shpirt. Mbase ajo dëshiron që këtë ta bëj para syve të botës?

U kthye në vendin e vet dhe pasi urdhëroi që të binin tamtamet me sa forcë kishin, zuri të fliste:

— Bora është e zezë!

— Uji shkon përpjetë!

— Qengji e ha ujkun!

— Lepuri ka dy këmbë!

— Miza buall!

— Bualli mizë!

Plaka as që ua vinte veshin atyreve që thoshte ai. Rrinte në mes të arenës dhe shikonte në një pikë të artë, aty ku bashkoheshin litarët. Dukej se flinte.

— Zhurmë! Sa më shumë zhurmë dua! — thoshte i zoti i cirkut.

Arena shungullonte nga zhurma e fuqishme.

— Zhurmë! Sa më shumë zhurmë! A po kuptoni sa më shumë zhurmë! Zhurmëëëëëëë!

Zhurma u bë aq e madhe sa disa nga publiku nuk po mund ta duronin. Kërkonin që ajo të ndërpritej. Por Trashalecshkurtaleci nuk prante. Çirrej dhe kërkonte zhurmë. Djersët i shkonin çurg.

— Ose do të flasë shtriga, ose do të çmendeni të gjithë! Ndryshe nuk bën!

Të pranishmit po i mbyllnin veshët me duar.

— Nuk ka mëshirë! Nuk heq dorë nga kjo kurrë. Mua nuk më ka mundur kush. A e keni të qartë, askush nuk më ka mundur asnjëherë...

E plaka dukej se njëmend kishte fjetur. Katrahura e kishte bërë më të durueshme dhe mospërfillëse...

Nga mospërfillja e saj pronari i cirkut po çmendej. Kërkoi edhe daulle të tjera. Por s'kishte më. Që të gjitha kishte kohë që binin.

— Më shumë! Më shumë! Bjeruni më shumë!

Por daullet zunë të pëlcisnin. Një nga një pëlcitën sa pushuan fare.

— Ah, — shfreu Trashalecshkurtaleci, — këtë nuk e prisja... Këtë nuk e prisja...

I tha këto dhe u shemb nga vendi në të cilin rrinte. I shkallmuar kërkonte derën.

— Do të kthehem... Do të kthehem... Mendoni se do ta harroj këtë? — po fliste në të dalë.

Në arenë mbretëroi një qetësi e shurdhër. Shahe Kërraba edhe ca mbeti si e ngrirë. Dikur, si të zgjohej nga ndonjë gjumë i thellë, fërkoi sytë dhe tha:

— Ah, kjo qetësia...

Çfarë tha pastaj Shahe Kërraba botërisht pas asaj gare të çuditshme?

Kur e kaloi fushën e Sahatit dhe doli në shesh, Shahe Kërraba dukej si korb. Të paktë ishin ata që e mbanin mend kur e kishte kaluar ajo për herë të fundit pragun e derës së shtëpisë. Megjithatë, ajo ecte me mospërfillje. Një copë herë shkoi andej-këndej e së fundi u ndal te shatrivani i vogël. Saora para saj u formua një gjysmërreth. Secili dëshironte ta shihte sa më mirë plakën për të cilën flitej aq shumë kohëve të fundit. Si ta hetonte kërshërinë e tyre, Shahe Kërraba, preku currilat e ujit, lagu ballin e u kthye nga ata. Të pranishmit panë një qenie e cila dukej si të kishte dalë nga ndonjë akullnajë.

Dhe, shih mrekullinë, plaka pa pritur e pa kujtuar, ia mori një kënge. Këndonte ndër hundë. Ata që i rrinin pranë nuk kuptuan gjë prej gjëje nga ato që thoshte. Mandej, askush nuk ishte i sigurt se a këndonte apo vajtonte?

(— E ka harruar gjuhën e njerëzve, — tha njëri.

— Si të mos e harroj kur jeton me të vdekur, — ia priti tjetri.

— Betohem në tokë e në qiell se tash ajo flet me të vdekur, — shtoi një i tretë.

— Nuk mund të thuhet me tamam se cilës botë i takon kjo plakë; sonës apo asaj tjetrës?

— Po jetojmë në kohë të turbullt, — tha një tjetër...)

Pasi e la këndimin apo vajtimin, Plaka zuri të sillej në vend me mospërfillje. I ngrinte duart përpjetë dhe bënte me to kah dielli, i cili ishte gjithnjë më i fuqishëm. Shumëkush mendonte se ajo do të rrëzohej nga marramendja. Por Plaka mbahej.

Kur dielli kishte marrë rrugën drejt bjeshkëve, Plaka foli e tha:

«Mirë se erdhët...»

Bënte si të merrte ngrykë dikënd.

«Mirë se erdhët...»

«... ju pastë nëna...»

(A të thashë se moti ka vdekur, — tha ai që foli pak më parë. — Kjo ka vdekur... Sillet si kufomë...

— Diçka e jashtëzakonshme po ngjet... Të vdekurit janë bërë të gjallë e të gjallët të vdekur? Po ndodhin gjëra që nuk t'i bluan truri...)

«Bëtë mirë që erdhët, — tha Plaka. — Koha ishte të vinit... Njëmijë vjet janë si shumë që të presin kotnasikoti... Njëmijë vjet... Ah, të shkretat...

«E more Xim, sa shpejt kaluan treqind vjet... Shkuan si uji...»

«... Po ty Xërxo, sa t'u bënë?... Pesëqind?... Auu... Pesëqind dhe të duken shumë?»

«... Sa qenke rritur, Xyth?... Si mund të rritet njeriu gjashtëqind vjet pa ia ndarë?...»

«... e ti Xen, i mbushe të shtatëqindat?... Kush do të thoshte se do të mbeteshe xhuxhimaxhuxh?...»

«... Shihe shihe Xelin... Sa t'u paskan rritur mustaqet! Thua se për to t'u deshën treqind vjet?... Auuuu!...»

«...Xuma sot i mbushi të njëqindat... A mos po të duken pak, biro?... Nuk bën të skuqesh më, të pastë nëna!... Fija e flokut t'u paska dredhur... Tash më nuk je fëmije...»

«... Po Xixa, nuk do të vijë?... Ti Sugar nuk e mbajte fjalën... Më thoshe se do ta sjellësh së paku një herë në njëqind vjet? A e harrove këtë premtim?... Thua se do ta sjellësh?... Po kur? Kur të bëhen nëntëqind... Mos është shumë?...»

Plaka sërish iu kthye ritualit të pakmëparshëm. Zuri të sillej më shpejt. Në atë rrotullim marramendës dukej si një pirg i zi, që herë ngrihej, e herë sharronte dikund. Kur dielli preku majën e bjeshkës, Plaka sërish foli.

(Kronisti i shënoi pikë për pikë ato që i thoshte ajo, qoftë si pyetje, qoftë si përgjigje. U përpoq që të mos linte gjë pa e kapur nga ato që atij ia zinte veshin.)

«...Zhurma... Ka zhurmë... Nuk po ka të ndalë...»

(Pushim i shkurtër. Plaka ngriti duart përpjetë)

...Thoni: ku jemi ne? A?

— Paj, ku ishim gjithnjë... Nuk kemi se nga t'ia mbajmë...

...Thoni: a duhet të bëjmë diçka?
— Mbase më mirë është kështu?
...Thoni: a mund të zgjasë shumë zhurma?
— Do të zgjasë. Do të zgjasë. Këtë e dimë fare mirë...
...Thoni se ajo nuk do të ketë të ndalë?
— Patjetër se një ditë do të prajë.
...Thoni se mund të zgjasë shumë? Shumë?
— Edhe këtë e dimë.
...Thoni: si do t'ia bëjmë pra?
— Paj, do të qeshim.
...Thoni: pse do të qeshim?
— Pse është më mirë të qeshësh me dikë që çirret si i marrë. Kjo e çmend edhe më shumë.
...Thoni se ne do të na marrin për të marrë?
— Jo. Jo. Ai që bën zhurmë e çirret, ai ka ndonjë hall të madh.
...Thoni: cili na qenka halli i tyre?
— Mbase thahen?
— Mbase vyshken?
— Mbase u kanë rënë dhëmbët?
— Mbase e dinë se e kanë mashtruar veten?
— Mbase e dinë se po stërkeqen?
Andaj,
çirren, bëjnë zhurmë, nuk shohin gjë të bardhë, ua shpalosin njerëzve ëndrrat njëmijë vjet prapa, ua shoshisin ato që i kanë thënë ndonjëherë përçart, ua mbledhin fjalët e shkapërderdhura nëpër mjegull, ua masin hijet, ua tjerrin mendimet, ua numërojnë pa ia ndarë të gjallët...
Kështu që, nuk e dinë as kur është tepër e as kur është pak; nuk dinë kur është mirë e kur është keq; nuk e dinë ku presin e ku ngjesin; nuk e dinë se kur duhet folur e kur duhet heshtur...
Ngase,
kanë shpresuar të jenë vetëm ata... që bota të nisë e sosë me ta...
Ky mund të jetë, pra, halli i tyre...
...Thoni: a do të qeshni edhe më me ta?

— Do të qeshim. Do të shqyhemi së qeshuri. Ky është ilaçi më i mirë kundër katrahurës së tyre.

...Thoni se ka rrezik se mund të stërkeqemi, ngase i harrojmë gjërat e rëndësishme?

— Kjo është e vërtetë, por do t'ia bëjmë disi që të mos merremi gjithnjë me puse.

...Thoni: a keni edhe puse?

— Kemi. Të tillë kemi.

...Thoni: a mund të biem në puset tona?

— Po. Po, pusi yt është më tinëzari... Këtë e dimë... Pusi yt është më i rrezikshmi...

Plaka një copë herë i përsëriti fjalët «pusi yt... pusi yt më i rrezikshmi...»

Ushtarët, që gjithë kohës rrinin pranë Tendës Blu, po e humbnin durimin. Një thatak, i veshur me të zeza, më në fund, tha:

— Kapeni gërxhulën!

Të pranishmit u stepën. Çfarë do të ngjante tash, vallë?

Shahe Kërraba nuk ua vuri veshin fjalëve të tij as ushtarëve. Pareshtur i thoshte fjalët «puset tona... puset tona... puset tona... kundër vetvetes...»

— Kapeni, — u çor prapë ushtaraku!

Por ushtarët, që bënë vetëm disa hapa drejt saj, u ndalën.

Ushtaraku gati plasi nga tërbimi. Ushtarët mbetën si të ngrirë para saj.

— Do t'ua tregoj unë juve!, — tha ushtaraku. — Do të vareni në litar.

Megjithatë, ushtarët nuk e çonin fare urdhrin në vend. Një copë herë shikuan herë majtas e herë djathtas e morën ikën.

— Në litar! Në litar frikacakët! Ushtari i perandorisë nuk bën të frikësohet!

Ushtaraku e dha urdhrin dhe u nis nga Plaka. Pas dy-tre hapave, zuri të shalakatej. I gjithë sheshi u bë sy e vesh. Armët po bëheshin gati. Të pranishmit prisnin se çfarë do të bënte Plaka kur t'i afrohej ushtaraku? A thua do të bëhej e padukshme? Ah, të bëhet e padukshme, uronin shumica. Të bëhet e tillë sa të pëlcasë ushtaraku.

Dhe njëmend, Plaka Shahe Kërraba, sapo ushtaraku iu afrua tre hapa, u bë e padukshme.

Aty, ku pak më parë fliste dhe këndonte, mbeti një zbrazëti e shurdhër.

Ushtaraku u rrëzua nga shqetësimi.

— A ju thashë se ajo është frikacake? A ju thashë se ajo është frikacake, — po thoshte Ushtaraku gjithë gëzim. — Nuk ia mban me ne!

Ushtaraku pastaj u ngrit. Shkoi mu aty ku kohë më parë rrinte Plaka dhe zuri ta shqelmonte tokën.

— A ju thashë se s'është gjë puna e saj? Këtë e dija...

Zuri të qeshte.

Por pa një pa dy, përpara iu shfaq Plaka. Ajo u bë e dukshme.

Ushtaraku u shemb përdhe si i vdekur.

Një uuuuuuu erdhi nga të gjitha anët e sheshit. U bë një pështjellim i paparë.

— Mos i kurseni armët e Perandorisë! — tha dikush. — Bjeruni nga të gjitha anët!

Më tutje nuk e di se cfarë ndodhi... Nata erdhi shpejt... Terri i mbuloi kufomat dhe gjurmët e gjakut...

Duke menduar, më bëhej se fjalët e Plakës Shahe Kërraba po i thoshin shumë veta. Mbase i gjithë vendi? Në atë shumëzëshmëri e njoha edhe zërin tim, të përzier dhe të ngjizur me të tjerët...

Dikur zuri të trokiste dera. Po i mëshonin me sa fuqi kishin...

Tash do ta thyejnë, thashë dhe...»

Një rreze drite hyri në tendë kur Pashai u ra në fund shënimeve të Poetit. Dhe ajo rreze çuditërisht po ia ndriçonte mendjen, saqë gjithë ato fjalë, gjithë ato ngjarje, gjithë ato veprime e mbi të gjitha personat po i dukeshin të njohur, thuajse gjithmonë kishte qenë midis tyre! Iu bë se edhe ai gjendej pranë tyre dhe ndoshta do t'u bashkohej po mos ta kishte parë, apo përfytyruar (kjo është një), një perde të tejdukshme që po i ndante ata prej tij si me thikë. Ajo perde, madje, nuk po linte që zëri të kalonte nga njëra anë në tjetrën. I erdhi keq që ajo perde qëndronte midis tyre

dhe i ndante. Dikur iu bë se përtej perdes pa Poetin të gjakosur me fletoren në dorë. Ishte mu ajo fletorja që e lexoi pak më parë. I dalloi edhe gjurmët e gjakut në të. Ai bëri disa hapa drejt tij dhe u ndal mu aty ku ai e merrte me mend se gjendej perdja e tejdukshme e ndarjes. Ndonëse dukej i shkallmuar, sytë i kishte të kaltër dhe gjithë jetë. Ai po i thoshte diçka. Fliste e fliste pa ndërprerë. Dikur zuri të bënte me duar, me kokë dhe ta lëvizte trupin djathtas e majtas... Më vonë Poeti e hapi fletoren dhe po kërkonte diçka në të. Në shikim fletorja po i rritej e po i rritej. Në një çast fletorja u bë sa vetë Poeti. Poeti bënte me gisht kah fjalët e shkëputura, që lidheshin me pika të shumta... Por pikat tash po i bëheshin shumë të mëdha, si puse të thella. Mendja ia tha se Poeti kërkonte që hapësira me pika të mëdha, që atij i dukej si hapësirë pusesh, duhej të mbushej me shkronja të tjera, ose me fjalë të tjera, në mënyrë që puset të mos dukeshin më... Madje, iu bë se Poeti po i thoshte ngulmishëm:... pikat, pikat (apo puset) duhet plotësuar sa më parë... Pikat do plotësuar... Kjo është e domosdoshme... Mendimet duhet të mbindërtohen... Pa mbindërtim të tekstit nuk ka rikuptim.. Nuk ka kuptime të thella...

C'ishin vallë ato kuptime të thella, për të cilat iu bë se foli Poeti? Asnjëherë nuk ishte marrë me mbindërtime të teksteve të lexuara. Ai kishte lexuar fermane dhe urdhëresa të qarta dhe kishte nënshkruar gjithfarë vendimesh, që ia kishin shkruar të tjerët. Shpesh nuk i kishte lexuar ato që kishte nënshkruar... Për herë të parë dikush po kërkonte që ai të merrej me rileximë, me ato që futen midis rreshtave apo me ato që mund të merren me mend, por që pikat apo presjet përpak i mënjanojnë qëllimisht që gjërat të mos thuhen troç. Kuptimi më i thellë... Kuptimi i dytë?... Rileximi?... Kuptimi i dytë... Shumëkuptimësia?...

Koka po i digjte nga këto fjalë që s'i ndaheshin. Dikur iu bë se të njëjtat fjalë po ia thoshte edhe Shahe Kërraba, e cila po i bridhte nëpër mendime... kuptimet e reja... kuptimet e reja janë të domosdoshme, po i thoshte ajo...

Iu bë se ato që po i thoshte Shahe Kërraba po e qëllonin nga të gjitha anët.

— Kuptimet e dyta... Kuptimet e dyta...

Një copë herë i tha këto fjalë dhe mbase do t'i përsëriste pareshtur po të mos hetonte truprojën që i solli kafjallin. Ai i tha përulshëm se ishte koha të hante diçka.

Por kafjallin nuk e futi në gojë. Fjalët e Shahe Kërrabës bashkë me sinkopat e shumta nuk po i shqiteshin nga mendja. Ato po i vërsuleshin edhe më me ngulm sa ndjeu t'i digjte koka. Vetëm kur mori sërish fletoren e Poetit, aty për aty ndjeu njëfarë heshtjeje të shurdhër. Çfarë po ngjet kështu, e pyeti veten? Dikush është futur në mua...

Për t'i ikur shqetësimit, që i frikësohej aq shumë, hapi prapë fletoren dhe zuri ta lexonte. Tash iu bë se përpara kishte një tjetër, të mbushur plot e përplot sinkopa dhe shkëputje të tjera. Sytë po i digjnin nga pikat të cilat i lëviznin andej-këndej sikur të dëshironin të iknin nga hapësira e fletores. Edhe fjalët iu bënë lozonjare. I shfaqeshin herë të rrumbullakosura, e herë të gjymtuara, që herë kuptimësoheshin, e herë dukeshin të ngatërruara... Bile, edhe ato kuptime që mund t'i lidhte, tevona i dilnin të çoroditura, kështu që nuk ishte i sigurt se çfarë kishte përpara: një rrëfim që pak më parë e lexoi me shumë interes, apo një tjetër merimangë që nuk ia hetonte kund fillin? Më e keqja ishte se edhe personazhet po i shfaqeshin të ngatërruar fund e krye. Që të gjithë ishin gjysmënjerëz gjysmëhije... I dëshpëruar, mbylli fletoren dhe u shtri. Deshi të shkëputej nga ato që po e mundonin e t'i ikte personazheve që po e ndiqnin. Megjithatë, personazhet i rrinin pranë dhe po i kërcënoheshin. Lyt Ziu mbante shumë koka në dorë... Himë Keqja dredhte ca litarë... Shahini i Taliqëve pastronte thikat që kullonin gjak... Dile Gëzofziu i fliste për disa vrasje tinëzare të bëra përtej Urës së Tabakut... Riza Probja i thoshte se kishte parë disa varre të mëdha në Shkuzë... Iu bë se po e shihte edhe Sylon bashkë me Cjapin... Cjapi po i thoshte se pas kishte ushtrinë më të madhe të kafshëve, e cila do ta shkatërronte një ditë perandorinë... Syloja po i tregonte ca vendime për masakra, në të cilat ai pa emrin e

vet... Nënshkrimi yt, nënshkrimi yt qëndron këtu... Masakrat u bënë me nënshkrimin tënd... Nënshkrimi yt... nënshkrimi yt... po i thoshin si njëzërit personazhet e Poetit... Nënshkrimi yt na bëri të tillë... Ti... Ti.. Tiiiii... Personazhet po e ndiqnin. Ata po e futnin në mes dhe po i kërcënoheshin. Në atë pështjellim dalloi një kalë të bardhë që hingëllonte dhe bridhte majave. As vetë nuk e kuptoi pse i pëlqeu kali i bardhë, zuri të çirrej dhe ta kërkonte kalin e bardhë...

Kalin e bardhë e kërkoi edhe kur pa veqilin që po ia fshinte djersët e ftohta në ballë.

— E dua kalin e bardhë! Kalin e bardhë... Sillmani! — urdhëroi.

Veqili mbeti si i ngrirë. Nuk e dinte si të vepronte. Por Pashai i tha edhe për të dytën herë se e kërkonte atë kalë.

— E dua kalin e bardhë! Kalin e bardhë...

Veqili doli me ngut. Ishte i bindur se ato që po i thoshte Pashai ishin pjesë e ndonjë përfytyrimi të ngatërruar. Megjithatë, atij nuk i takonte të bënte pyetje. Duhej t'i pranonte urdhërat dhe t'i zbatonte me përpikmëri.

Kur ia solli kalin e bardhë deshi t'i thoshte se ishte vonë, se kishte kaluar kaherë mesnata, se jashtë ishte nata pa hënë. Por pashai, si ta ndiqte dikush, u ngrit me të shpejtë. Qiti veladonin e purpurtë krahëve dhe doli jashtë.

— Pikërisht ky kalë më duhej, — tha. — Ky kalë më shpëtoi...

Veqili dukej i zverdhur. Nuk mund ta merrte veten fare.

— Pasha, Pasha, — ia nisi, por qe vonë. Ai tashmë ishte nisur...

Plaku një copë herë dëgjoi trokun e kalit dhe trokun e kuajve të truprojeve që me të shpejtë iu vunë pas Pashait...

. . .

Seç iu kujtua se dikur kishte dëgjuar një këngë në të cilën thuhej se «jeta e vdekja ecnin në një kalë...» Mbase ajo kishte qenë një këngë e pikëllueshme, që bënte fjalë për një të gjallë dhe një të vdekur që kushedi si u gjendën së bashku në të njëjtin kalë dhe kaluronin fushave, kaluro-

nin maleve, kaluronin dimrit e kaluronin vjeshtës... Vdekja kërkonte jetën e jeta kërkonte vdekjen... Në atë kalurim vdekja heshtte, e heshtte edhe jeta... Jeta mendonte se ishte vetë vdekja, e vdekja mendonte se ishte vetë jeta... Iu bë se gjendej mu në atë kalë. Mu në atë kalë dhe ishte edhe jetë, ishte edhe vdekje, se ishte edhe i gjallë, se ishte edhe i vdekur, se sillej në një hapësirë ku jeta ishte vdekje e vdekja ishte jetë... Në atë përzierje kufiri midis jetës e vdekjes ishte ngatërruar aq shumë sa mbizotëronte një amulli e paparë, ku as jeta nuk ishte e njëmendtë e as vdekja nuk ishte e njëmendtë...

Në një çast iu bë se vdekja foli e tha:

«Ç'u ngatërruam keqas...»

Jeta heshtte. Dëgjohej vetëm troku i kalit, i mbytur në atë natën e zezë, pise.

«Ç'u ngatërruam keqas», — tha prapë vdekja.

Pas një heshtjeje jeta tha:

«Kaherë jemi ngatërruar...»

Vdekja heshti.

«Kaherë jemi ngatërruar dhe ma thotë mendja se nuk do të ndahemi dot...»

Prapë heshtje. Troku i kalit bëhej gjithnjë më i fortë. Dikur jeta dhe vdekja folën si me një gojë:

«Do të kalurojmë bashkë... Do të ecim në këtë kalë të bardhë... Do të bredhim nëpër errësirë...»

Troku i kalit u bë edhe më i fortë. Ai ishte i bindur se po sharronte thellë e më thellë në një errësirë të pafund. Dikur iu bë se po dëgjonte sesi po bisedonin jeta me vdekjen:

Jeta: çuç...
Vdekja: truç...
Jeta: çuç, çuç...
Vdekja: truç... truç...
Jeta: çuç, çuç, çuç...
Vdekja: truç, truç, truç...
Jeta — Vdekja, bashkarisht: çuç e truç...
Jeta: nuk ishim...
Vdekja: ishim...
Jeta: nuk ishim... nuk ishim...

Vdekja: ishim... ishim...
Jeta: nuk ishim, nuk ishim, nuk ishim...
Vdekja: ishim, ishim, ishim...
Jeta: andej...
Vdekja: këndej...
— Jeta-vdekja: andej, këndej... këndej, andej...
Jeta: poshtë...
Vdekja: lart...
Jeta-vdekja: poshtë, lart... lart, poshtë...
Jeta: bardhë...
Vdekja: zi...
— Jeta-vdekja: bardhë, zi... bardhë, zi...
Jeta: vetëm...
Vdekja: së bashku...
Jeta-vdekja: vetëm, bashkë... bashkë, vetëm...
Jeta: hip...
Vdekja: zbrit...
Jeta-vdekja: hip, zbrit... zbrit, hip... hipzbrit, zbrithip...
Vdekja: ngricë...
Jeta-vdekja: vapë, ngricë... ngricë, vapë... vapëngricë, ngricëvapë...
Jeta: ec...
Vdekja: ndal...
Jeta-vdekja: ec, ndal... ndal, ec, ecendal, ndaleec...
Jeta: si?
Vdekja: nuk di...
Jeta: e dija...
Vdekja: se do të bredhim
Jeta-Vdekja: bredhje, bredhje, bredhje...
Dikur s'u dëgjua gjë. Edhe troku i kalit kishte mbetur në erë. Ishte i bindur se gjendej në paqenësinë së cilës i kishte takuar gjithmonë...

Kur e hetuan, rojet, nata ishte në të sosur. Ç'kishte ndodhur vallë që ai vinte ashtu në atë kohë të paparalajmëruar?

Ai kaloi pranë tyre sikur të mos shihte njeri. Ata që

e panë ishin të bindur se ai kotej dhe ndiqte ndonjë përfytyrim të mjegulluar.

Kur hyri në shesh, la kalin e bardhë mënjanë dhe një copë herë ndoqi yllin e mëngjesit, i cili po shuhej. Kur s'e pa më, u soll marramendshëm disa herë rreth shatërvanit të vogël dhe pasi bëri dhjetë hapa në të majtë e po aq në të djathtë, u nis drejt shtëpisë së vogël, dera e së cilës mezi dallohej në atë gjysmëzbardhëllim...

— Të prisnim...

— Gjatë të kemi pritur...

— E dinim se një ditë megjithatë do të ktheheshe...

— Si nuk paske ndryshuar?

— Para treqind vjetësh të kemi parë të tillë...

— Atëherë dukeshe paksa më i ri, ama ky se ky ishe...

— Nuk po ju kuptoj, — foli ai, — Mbase është bërë ndonjë gabim... Unë... unë...

— Jo, jo, nuk është bërë kurrfarë gabimi...

— Megjithatë...

— Nuk flasim kuturu...

— ...por?

— Mos u shqetëso... Si shumë ke bredhur jashtë vetvetes. Andaj, nuk të kujtohen gjërat kryesore...

Deshi të fliste edhe diçka, por ndjeu se po i merrej goja...

— Sa shumë kohë humbe kot së koti...

— Dhe nuk pate nga t'ia mbashë...

— ...mirë që e kuptove më në fund të vërtetën...

— ...sado që është e hidhur...

— Por, por, — zuri të fliste sërish, — unë, unë, nuk po marr vesh gjë prej gjëje... Më flitni për treqind vjet... Patjetër se fjala është për ndonjë hutim?

— Edhe atëherë flisje kështu...

— Ah, asgjë nuk po kuptojë... asgjë...

— I hutuar dukeshe edhe atëherë, para treqind vjetësh...

— Para treqind vjetësh?

— Para treqind e më shumë vjetësh...

Ai heshti. Zuri ta shtrëngonte fytin sikur të kërkonte

që të ndrynte në thellësinë e vet ato që tashmë i thoshte e nuk dinte se çfarë ishin.

— A nuk të kujtohet?

— Njëmend. nuk të kujtohet gjë?

— Asgjë nuk më kujtohet, — tha ai gjithë shqetësim.

— Nuk të kujtohet as thika?

— Çfarë thike?

Shpërtheu një e qeshur e fortë që atij i erdhi si gjëmë e papërmbajtur.

— Kishe një thikë të gjatë, shumë të gjatë...

— Thikë të tillë nuk kishim parë...

— Vezullonte në diell...

— Nuk kishte shoqe...

— Thikat i kisha zët gjithmonë, — tha ai.

E qeshura u ngjall sërish. I bëhej se ajo në të vërtetë as që kishte pushuar, por herë ishte më e lehtë e herë më e fortë.

— ...kishe një thikë të gjatë. Thika shkëlqente. E lëvizje në erë. Ne e dinim se atë thikë e kishte për Princin dhe një ditë ajo do ta gjente zemrën e tij... Do ta gjente patjetër, sepse ti e lëvizje kah kështjella dhe pa pra e matje kokën e tij... Dhe ajo ditë erdhi. Qe ditë me shi, me një shi të imët. Në atë shi që nuk dinte të ndalej, thika jote u gjakos. Dhe ai shi u bë edhe më i mërzitshëm. Ra shtatë ditë e shtatë net... A nuk të kujtohet si mugulloi bari dhe u shfaqën urithët e bardhë nëpër fushat e pangopura me ujë? Nuk të kujtohet as kjo? Ngjet që nuk të kujtohet, por shi ra edhe më vonë. Ra aq shumë shi sa dukej se gjithçka do të kalbej, e do të kalbeshin edhe eshtrat e Princit që ranë në tokën e lagur... Shiu zgjati dyzet ditë dhe për habi më pas frynë do erëra të thata e të nxehta, që nuk pushonin ditë e natë... A të kujtohet se ç'erëra të flakta që ishin? A nuk të kujtohet pastaj ç'vapë e çuditshme ia behu? Toka zuri të çahej. Urithët gjendeshin të ngordhur pranë vijave të thara të ujit e kërmat e tyre kutërbonin rëndë, shumë rëndë... O, se ç'kutërbim i tmerrshëm qe ai... Ti urdhërove që të mbylleshin edhe frengjitë e kështjellave. Urdhërove që të mbylleshin portat. Urdhërove që të mbyteshin edhe

bretkocat e shumta që kërkonin shpëtim ne pusat e kështjellës, uji i të cilëve po shterrej dita-ditës... Urdhërove që i madh e i vogël t'u dilte ndesh minjve të kuq, sa troha, të cilët vinin nga bjeshka dhe futeshin në kështjellë. A nuk të kujtohet se sa dronim se ata minj të neveritshëm do të na hanin? Natyrisht se as ethet e minjve nuk të kujtohen të cilave u droje aq shumë... Në atë thatësirë të paparë, ku edhe guri pëlciste, vetëm thika jote nuk thahej... Gjaku në të prore dukej i freskët... A nuk të kujtohet kjo?

— Betohem se ju i keni ngatërruar gjërat... Çfarë thikash? Çfarë princi?

— Ha, ha, ha!

— Nuk po të kujtohet asgjë?

— Ha, ha ha!

— Njëmend nuk po të kujtohet gjë? Nuk po të kujtohet gjaku në thika? E ke me gjithë mend? Apo, je mjegulluar i tëri?

— Asgjë, asgjë nuk po më kujtohet...

— ...Princi duhej të vdiste patjetër... Ashtu kishte vendosur Perandori i Perandorisë së fuqishme. Ti vetëm ia fute thikën, atë thikë që patjetër u desh ta gjente zemrën e tij, atë zemër tuajën (edhe tënden) e cila duhej të pushonte përgjithmonë. A nuk të kujtohet as kjo? Megjithatë, më e tmerrshmja ishte ajo që ngjau pas vrasjes së tij...

Ai heshtte. Djersët po i shkonin çurg.

— ...vjedhja e pergameneve... A nuk po të kujtohet? Nejse. Por dije se prej atij çasti të mori lumi ty dhe gjithë vendin. Ngase ua hape dyert komisioneve dhe hetuesve të shumtë të Perandorisë, që vinin valë-valë... A nuk të kujtohet se ç'mori komisionesh dhe hetuesish erdhën nga Kryeqyteti? Vinin e shkonin pa ia ndarë e ti bartje arkat e vulosura me dyllë, që pastaj të mbushura i nisnit me ngut në Kryeqytet. A nuk të kujtohet se sa të rënda ishin ato? Njëmend asgjë nuk dije?

— Asgjë nuk dija, asgjë nuk dija, — tha ai duke dënesur. — Asgjë nuk dija...

— Mund të supozohet se nuk e dije se ç'vlerë kishin vleftat tuaja, por të tjerët këtë e dinin fare mirë. Hetuesit

dhe komisionet e larta, të cilat ua kishin zënë frymën, nuk erdhën për gjë tjetër pos t'i mblidhnin shkrimet tuaja, erdhën t'i merrnin pergamenet tuaja, erdhën t'i mblidhnin stemat tuaja, erdhën t'i mblidhnin emblemat tuaja, erdhën t'i merrnin kronikat tuaja, erdhën t'i merrnin të gjitha kartat që bënin fjalë për ju... Me një fjalë, ata kërkonin çdo gjurmë tuajën, qoftë ajo si shkrim i juaji apo i huaj, apo gjësend tjetër që tregon qenësinë tuaj...

Prapa fushatës për gjoja pastrimin e tokës nga shpirtërat e ligj që, sipas tyre, na ishin hapur ngado dhe rrezikonin Perandorinë e madhe, fshihej lufta kundër shpirtit tuaj...

A nuk të kujtohet sesi futeshin nëpër kisha, sesi futeshin nëpër kështjella, sesi futeshin nëpër kulla, sesi futeshin nëpër të gjitha skutat dhe pareshtur kërkonin diçka që ti nuk e dije se çfarë ishte? Dhe ato që gjenin i futnin nepër arka dhe me ngut i nisnin krah Kryeqyteti. Ty të merrnin me të mirë dhe për mes zhurmës së paparë që bënin të qitnin pluhur syve. E, e gjithë fushata bëhej me nënshkrimin tënd. Ti e nënshkrove dekretin e ftesës së hetuesve dhe të kryehetuesve. Ti e shpalle vendin të helmuar me të ligën. A nuk të kujtohet se çka nënshkrove?

— Asgjë nuk nënshkrova... Asgjë...

— Ti nënshkruaje, por nuk e dije se nënshkrimi yt vlente kundër teje, pra kundër vetvetes...

Si të dije se çfarë po ngjiste në të vërtetë, kur ti kënaqeshe duke shikuar thikën e përgjakur dhe duke prekur nishanet e shumta që ta kishin rënduar kraharorin...

A nuk të kujtohet dekorata me urdhrin e parë që ta dha Perandori?

A nuk të kujtohet kryqi i artë që ta dha Sinodi i madh?

A nuk të kujtohet se me ç'kreni e bartje luanin e shndritshëm të mbretëreshës?

A nuk të kujtohet se me ç'përulësi i pritje të dërguarit e Perandorit? A nuk të kujtohet se si ta pushtuan kështjellën pelivanët, palaçot dhe gjithfarë sharlatanësh që vinin nga Kryeqyteti? A nuk të kujtohet se si urdhërove që t'ia ndërroje pamjen kështjellës dhe për këtë thirre mjeshtrit e huaj? A nuk të kujtohet si të kundërshtoi kryemjeshtri yt

rreth shndërrimit të kështjellës me petkun e ri pa pikë nevoje? A nuk të kujtohet se kryemjeshtrit ia shkurtove kokën kur të tha se kështjella nuk kishte nevojë për çoroditje? A nuk të kujtohet si i ndërrove edhe rrobat dhe veshe ca të qëndisura, si të grave? U hutove duke i shikuar gajtanët e tyre të praruar. Nuk shihje se mbete vetëm, fillikat vetëm, i rrethuar me hetuesit, mbihetuesit, kryehetuesit si dhe nga komisionet e panumërta, të cilat hynin e dilnin në kështjellë si në shtëpi të vet... Dhe ti nuk e hetoje nënçmimin, nuk e kishe të qartë se po të tallnin... Obobo, si të merrnin nëpër këmbë! Si të zhveshën nga krenaria e fisit tënd?

Dhe, atë çast që fillove të dyshoje se ca gjëra kishin marrë nënudhën, të gjet ajo që patjetër të priste...

Kështu hyre në atë natë të pafund, si hije dhe mbete në të, i mjegulluar dhe i harruar...

A nuk të kujtohet as kjo?

— Jo, jo.

— Si i përlarë nuk e ndjeje më zërin e vetvetes...

— Ha, ha, ha! I përlari s'e ndjen zërin e vet!

— Ha, ha, ha!

— I përlari nuk ndjen gjë!

— Ha, ha, ha!

— Mos më mundoni, — po lutej ai. — Mos më mundoni se plasa!

— Ha, ha, ha! Si mund të pëlcasë ai që është i zbrazët? Ha, ha, ha, si mund të pëlcasë fyshta?

— Mosni! Mosni! Mosni!...

Pas pak iu bë se po e ndjente dënesjen e vet. Hahaja kishte pushuar. Madje as plakat nuk i kishte pranë. A mos po e mashtronin sytë? Ishte vetëm, fill vetëm. Heshtja po e brente. Megjithatë në kokë i kishte mbetur ende jehona e atyre që dëgjoi pak më parë. Fjalët po i silleshin vrullshëm. Koka po i digjte. E zuri me dorë si të dëshironte të hiqte prej saj gjithë atë pështjellim. Por, sapo e zuri me duar, ndjeu një thekamë, e cila po i vinte nga të gjitha anët. Thekama ishte aq e fortë, sa ra në gjunjë. Po mundohej të mbrohej disi nga vërtitjet e saj.

— Nuk ke se nga ia mban, — po i thoshte një zë që shpejt u bë i shumëzëshëm. — Nuk ke nga ia mban...

Kur hapi sytë, pa plakat që po e rrethonin. Rrethi i futës po e mbërthente nga të gjitha anët.

Ato po e shikonin. Sytë i kishin të errësuar si puse të thellë, në të cilat edhe drita më e fortë shuhej. Iu bë se rrethi i futës po e përbinte. U ngrit me të shpejtë dhe u rras në këndin e çardakut, ku si fëmijë qe trishtuar pa masë kur pa pjesën e jashtme të botës...

Atëbotë, nga ajo pikë, kur e shikoi rrugën, pa vetëm koka, pa koka të cilat i bëhej se notonin në ajër. Ishte i bindur se ato koka ishin të këputura dhe kushedi se si bridhnin në botë. Tet i pati thënë gjithë frikë se po shihte vetëm koka. Por, ai i pat thënë si me shaka, se nga ajo larësi, xhami nuk e lente që njerëzit t'i shihte të tërë. I tha se koka ishte pjesë e trupit dhe nuk ndodhte që koka të ecte pa trup apo trupi pa kokë... Jo, jo, i pati kundërshtuar tet. Po i shoh kokat të fluturojnë. Me këta sy po i shoh si shkojnë në ajër. Shumë prej tyre janë të përgjakura... Të njëjtat fjalë ia pati thënë edhe një kushërire plakë, e cila, gjithë shqetësim i tha: «pa më thuaj, a turbullohesh?». Nga pak, i pati thënë ai. «Pa më thuaj, a vjell kur sheh shumë koka?» Ngapak i tha, më vjen të vjell. «Pa më thuaj, a neveritesh?» Ngapak, i pati thënë. Njerëzit kanë zënë të më bëhen të neveritshëm. Nganjëherë s'i shoh dot me sy...

Iu kujtua pastaj sesi kushërira plakë i tha tet gjithë shqetësim: «droj se çuni vuan nga sëmundja e territ?» Qoftë larg! Qoftë larg, i pati thënë ai dhe qe zverdhur si t'ia kishte marrë dikush aty për aty gjakun. «Mos i trego kujt gjë se na mori lumi...»

Kushërira plakë nuk erdhi më, por iu kujtua sesi i ati atë natë dhe të nesërmen, mbase edhe ditë të tjera, e pati pytur pa ia ndarë: A po turbullohesh? A po të mundojnë njerëzit?... Jo, jo këtë mos e thuaj... Mos thuaj se s'i sheh me sy me sy... Këtë mos e thuaj...

Një ditë i ati solli një xham tjetër, të lyer me sedefe që shkëlqenin. Ngjyrat ishin të buta dhe të ngrohta. Por, atij nuk po i pëlqenin, ngase edhe ashtu i shihte kokat të lë-

viznin në ajër. Dua terr, thoshte. Dua terr... Një ditë, dritaren ia lyen me ngjyrë ca më të mbyllët, e më vonë ia vunë një perde të errët. Megjithatë, kokat e shkëputura i shihte të notonin në ajër. Ato s'i shqiteshin nga përfytyrimi. I bëhej se edhe po t'ia mbyllnin sytë përgjithmonë, njerëzit do t'i shihte pa koka. Këtë ia tha t'et dhe ai nuk vonoi e i solli dy plaka kërruta, të cilat një kohë të gjatë ia prekën shputat e duarve e të këmbëve, pastaj ia prenë thonjtë e ia futën në një facoletë, ia fërkuan qerpikët dhe së fundit ia nxorën dy dhëmballë... Tri ditë i dhanë njëfarë uji pa shije. Gjatë gjithë kohës kërcunat i rrinin para dhe i luanin duart para fytyrës së tij. Gishtat e tyre gjithë nyje i afroheshin e i afroheshin sa mendonte se do t'ia nxirrnin sytë. Së fundit, pasi i lyenin me pështymë, i kërcitnin. Kërcitja e gishtave ia ngjeshte mishin dhe e bëntë të ikte, por nuk kishte nga t'ia mbante, ngase te dera i rrinte i ati, mbase edhe të tjerët, duke pritur me padurim se çfarë do të thoshin plakat. Kur ato ikën, dy ditë fjeti i qetë. Kur u zgjua, e pa t'et të gëzuar si thoshte: e dija, se shtriga e pati me sherr... E dija... Falë të madhit që nuk doli fjala e saj...

Tash, pas shumë e shumë vjetësh, dritarja prapë iu bë e ngjyrosur. Në sytë e tij çuditërisht po luante një ylber që s'i kishte rënë ta shihte dot. Ylberi i ndërronte ngjyrat dhe ai përherë të parë zuri të mendonte për atë shumësi ngjyrash. Shumësia po e ngashërente në atë mënyrë sa ndjeu njëfarë qetësie shlodhëse. I erdhi të flinte. Mbase do t'i mbyllte sytë po të mos e kishte dëgjuar një thekamë, nga e cila u trondit. Thekama ia mori ylberin. I erdhi keq kur hetoi se nuk e kishte më ylberin para. Kot u mundua ta shihte xhamin e ngjyrosur. Kush e kishte hequr vallë? Në vend të tij ishte një i thjeshtë, prapa të cilit ferku i dritës vijëzonte çepengjet e vjetra.

Një copë herë priti ylberin, por në vend të tij pa rrethin e plakave, që po i afroheshin. Rrethi ishte mbyllur dhe po sillej. Plakat po luanin një valle të zezë dhe çirreshin. Asgjë nuk kuptonte nga ato fjalë të shkëputura, që i dukej se buronin nga një gojë... Nga vallja po i shtohej marramendja. Dronte se do të kthente, mu si në fëmijëri, kur nje-

rëzit i shihte pa koka, e kokat të shkëputura nga trupi. Që t'i ikte disi asaj gjendjeje, mbylli sytë. Nuk dëshironte ta shihte vallen mekabre të plakave. Sado që vallen nuk e shihte, po e ndjente. Në një çast, vallja e plakave e përfshiu të tërin dhe po e barte furishëm në një hapësirë të paanë ku kishte zogj të zez me krahë të gjatë, të cilët, po ashtu, fluturonin shthurshëm, si ta kishin humbur baraspeshën...

Një kohë të gjatë bëri përpjekje që të shkëputej nga vallja makabre. Zogjtë e zez po ia kërkonin sytë... Sytë po ia kërkonin edhe plakat... Sytë po ia kërkonte e gjithë bota... Sytë! Sytë! — u çirr dhe hetoi se gjendej i rrëzuar në dysheme, i tëri i mbytur në djersë. I erdhi mirë që ishte ashtu i shtrirë dhe kundërmonte aromën e dërrasave të zhbiruara nga tenja.

Qëndroi gjatë ashtu i shtrirë duke bërë përpjekje që nga kujtesa të përjashtonte ato që s'i duheshin. Por nuk e dinte më se ç'ishte ajo që i duhej dhe që s'i duhej. Kufiri i tyre ishte i ngatërruar keqas... As këndej, as andej, tha dëshpërueshëm... As këndej, as andej... Medet...

Disa herë i shpëtuan nga goja ato fjalë të gjymtuara dhe, sa më shumë që i thoshte, i bëhej se ato ia thoshte dikush tjetër që gjendej i struktur diku në brendinë e tij. Çfarë po ngjet me mua, vallë, deshi të thoshte me gjithë zërin, por ndjeu prapë hahanë e thekshme, e cila ia la në gjysmë mendimet.

Kur ktheu kokën dhe u ngrit në gjunjë, sërish pa plakat që po e shikonin qortueshëm. Sytë nuk i kishin të errët, si më parë. Në to thyheshin ca drita që shkëndijonin furishëm.

— Nuk po e njeh veten, — i tha njëra?
— Ke mbetur në mjegull, — i tha tjetra?
— Një mijë vjet i harruar...
— Gjithnjë në anën e kundërt...
— Kjo nuk është mahi...
— Kush do të thoshte se do të zgjaste kaq shumë?
— Varret e shëmbura...
— Varrmihësit e maskuar...
— Tempujt e humbur...

— Lojtarët me një mijë fytyra...
— Thikat në kujtesë...
— Kokat që lulojnë...
— Një mijë vjet...
— Kush do të thoshte se zgjat kaq shumë?
— Një mijë vjet...
— Një mijë...
— Rrethi i mbyllur...
— Një mijë vjet...
— Një mijë...
— Rrethi...

Fjalën rreth po e thoshin të gjitha me një gojë dhe ai rreth po i afrohej e po i afrohej, duke ia ngushtuar hapësirën. Iu bë se rrethi i futës po ia ngushtonte frymëmarrjen. Madje, ndjeu se po i sosej edhe ajri. Nuk e kuptoi sesi nga goja i rrodhi fjala «ndihmë» që e tha me një zë të butë, si të mos shprehte frikë dhe shqetësim të thellë.

Për hapi vallja u ndal. Rrethi i futës u tërhoq paksa prapa. Pa një fytyrë shumëfytyrëshe, të përsëritshme dhe të njëtrajtshme që po e shikonte dhe po heshtte. Ajo heshtje iu duk e rëndë, tepër e rëndë, madje më e rëndë se valla e territ...

Dikur, nga rrethi i territ u shkëput njëra. Tash, ajo u bë tjetër. Shikimin e kishte të butë. Në sytë e saj po shihte një afërsi të jashtëzakonshme. Iu duk si e ëma. Fërkoi sytë për të parë më mirë, dhe, njëmend, u bind se ishte ajo. Gati plasi nga gëzimi. Deshi të klithte me sa zë kishte: nënë! nënëzo! Por shikimi i saj i butë saora ia lëshoi vendin një brengosjeje. Ajo po e shikonte gjithë brengë sa ai uli kokën. Kur e ngriti, iu bë se ajo po matej t'i thoshte diçka. Bile, ia pa buzët t'i lëviznin. Folë, folë, deshi t'i thoshte. Qortomë... Më thuaj çfarë të duash... Sa kohë po e pres fjalën tënde.,. Por ajo e shikonte dhe heshtte.

Pas një mundimi të madh, ai i tha:

— Sa kohë që nuk të kam parë, nënëzo... Sa shumë kohë që nuk të kam parë... E megjithatë paske mbetur po ajo...

Ajo prapë heshtte. Dukej se fjalët e tij e ngrysën edhe më.

— Çudi, varrin e ke shumë ditë rrugë nga këtu... Si s'të paska molisur udha e gjatë?...

Prapë heshtje. I shkoi mendja se fjalët i kishte të shurdhra, se ato që po thoshte, i thoshte kotnasikoti, ngase ato buronin nga zbrazëtia e tij dhe të zbrazëta mbeteshin? Kjo e dëshpëroi më shumë se heshtja e së ëmës.

— Medet, oshëtiu, medet, edhe fjala m'u paska bërë e paqenë. Medet...

— Sëmundja e territ nuk t'u paska hequr... Është koha ta kuptosh këtë...

Ajo foli me një zë si të akullt dhe u bë pjesë e rrethit të futës.

Ai kot po e kërkonte me shikim. Plakat ishin të njëjta, të ftohta dhe mospërfillëse. Të gjitha po thoshin me një gojë:

— Sëmundja e territ... Sëmundja e territ...

— Nuk po kuptoj gjë, nënëzo, nuk po kuptoj gjë...

— Hijen e ke shtatë pashë thellë në tokë, — i tha një zë që s'e diti as vetë prej nga i erdhi. — Hijen e ke shtatë pashë thellë në tokë... Hija po të kërkon...

Në atë çast pa se rrethi i futës po e mbërthente fuqishëm dhe ai po sharronte në një skëterrë të pafund...

VARIANTE

Po kaluronte në njëfarë rrethi të ngushtë, i zhytur në një kllapi të thellë, kur një zë i tha:

— Dikush po gjëmon...

Nuk ua vuri veshin fjalëve që iu dukën si të qenë pjesë e asaj përsëritjeje marramendëse.

— Diçka e çuditshme po ngjet, e ti sillesh kot...

Prapë heshti. Errësira e pafund po i ndjellte një gjumë të thellë, në të cilin dëshironte të zhytej sa më parë.

— A nuk po e dëgjon heqamën?

— Po më vjen të vjell, — tha. — Nuk di pse një lëmsh ma ka zënë fytin?

— Si të mos turbullohesh kur sillesh kështu?

— Unë, — tha ai, — nuk po gjëmoj... Unë, nuk po dëgjoj kurrfarë heqame... Këtu mbretëron heshtja e shurdhër... Pse nuk më lini të qetë? Pse?

— Sepse, koha është të zgjohesh... Koha është të kuptosh...

— Po më zë gjumi... Po më zë gjumi... asgjë nuk po ndjej...

— Shiko përreth...

— Po më zë gjumi... gjumi... gjumi...

— Hapi sytë njëherë...

— Po më zë gjumi...

— Heqama po afrohet...

— Gjumi... gjumi

— Heqama...

— Nuk e dua heqamën...

— Atë e ke afër... A nuk po e heton?

— Pse po ma zë ngojë heqamën?

— Ajo të ka rrethuar...

— Dua të fle... E dua gjumin... Gjumin...

— Po si do të flesh kur bën heqamë? Mos pandeh se do të bësh gjumë të rehatshëm kur fryn heqama...

— Bah! Dua gjumë...

— Si s'u ngope me gjumë... Sa gjatë po fle...

— Terri e do gjumin... Nata e do gjumin...

— Unë të flas për heqamën e ti më flet për gjumin... Çfarë po ngjet me ty kështu?

— Asgjë. Po flej... Do të flej...

— Do të mpihesh...

— Pse të merrem me heqamën? Në rrethin tim nuk fryn. Unë bëj gjumë të rehatshëm...

— Këtë herë nuk do të bësh...

— Ha, ha, ha...

— Kot bëhesh i shurdhër dhe memec. Kot. Këtë herë as ti nuk do t'i shpëtosh heqamës. A nuk po e dëgjon fishkëllimën e saj? A nuk po e heton akullnajën që po të afrohet?

— Po më merr gjumi...

— **Zgjohu!**

— Nuk zgjohem...
— Bëhu me të tjerët...
— Kush janë të tjerët?
— Ata që dëshirojnë ta ndalin heqamën...
— Uh, paska të tillë? Sa të marrë që janë...
— Nuk janë të marrë...
— Po kush e ndal heqamën? Si mund të bëhet kjo?
— T'i dalësh para... T'ia vësh gjoksin...
— Dhe çfarë bëhet pastaj?
— Mund të rrëzohesh...
— Të rrëzohem?
— Po.
— A nuk është kjo punë huqe?
— Nuk është huqe...
— Si nuk është huqe kur rrëzohesh?
— Por ti bën përpjekje të ngihesh... Bën përpjekje t'ia vësh prapë gjoksin...
— Dhe prapë të rrëzohem?
— Prapë.
— Prapë për tokë?
— Prapë për tokë.
— A nuk është marrëzi kjo?
— Nuk është.
— Si nuk është?
— Sepse heqama egërsohet.
— E pastaj?
— Ajo bëhet edhe më e egër...
— E pastaj?
— Ajo tërbohet...
— E pastaj?
—Ajo verbohet... Nuk di se ç'bën...
— E pastaj?
— Ajo shthuret.
— E pastaj?
— Pastaj, ajo shkallomhet... Ashpërsia e shkallmon... Mundet...
— Mua po më zë gjumi...
— A s'u ngope me gjumë?

— Po më mbyllen sytë...
— Zgjohu!
— Gjumi... Gjumi... Gjumi...
— Zgjohu!
— Gjumë... unë... gjumi... unë...

Fjalët unë, unë po i thyheshin shthurshëm. Dikur ndjeu të ftohtë. Goja po i dridhej. Po dridhej i tëri. Dikur ndjeu se nuk ishte më në kalë. Këmbët po i shkelnin në njëfarë akullnaje dhe po i sharronin në të... Heqama dhe katrahura po e bartnin dikah...

Raporti i fundit i kryehetuesit

I gjithndritshmi dhe i gjithfuqishmi ynë.

Me urdhërin Tuaj dhe me këshillat Tuaja të shtrenjta e të ndritshme u nisa nga Kryeshehri për në Tokën e Lashtë me detyra të rëndësishme. Gjithnjë i pata parasysh fjalët Tuaja: nuk është kjo fushatë si çdo fushatë tjetër... Prej saj varet e ardhmja e Perandorisë... Ose fitojmë përfundimisht, ose hiqemi nga pika e ndieshme...

Shi për këtë i bëra të gjitha përgatitjet e duhura që të dalim faqebardhë. Por ç'e do që krimbi na ishte futur dhe po na brente dalëngadalë. Këto po i them me zemër të plasur dhe po nuk qe kështu, unë i përuluri Juaj, jam në gjendje dhe i gatshëm kurdoherë ta paguaj me kokë gabimin tim... Vezirit të madh nuk ia kam pasur besën asnjëherë. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me kodeksin profesionist se të dyshosh në secilin është detyrë e parë dhe e përhershme e çdo hetuesi, por me njëfarë parandjenje të çuditshme që m'u shfaq sapo i pashë heshtjen e akullt në sy. Përvoja e deritanishme prej hetuesi të lartë, të dhënë këmbë e krye pas ideve perandorake, më ka mësuar se të tillët gjithnjë bluajnë diçka të rrezikshme në kokë, diçka tinëzake... Andaj, pa u nisur në fushatën e shenjtë, lexova dosjen e fshehtë të familjes së tij dhe nga ato që hasa aty, më së shumti më bëri përshtypje një fakt që fliste për njëfarë sëmundjeje të çuditshme që

ai e kishte pasur në fëmijëri, e nga e cila, me gjasë, nuk u shërua kurrë.

Pra, sipas të dhënave, Kryeveziri si fëmijë njerëzit i shihte të shkëputur nga trupi. Pra. pa kokë. Kur i shihte ndryshe, villte. Në vendlindjen e tij kësaj i thonë s ë m u n d j a e t e r r i t. Është kjo një sëmundje shumë e rrallë dhe shumë e rrezikshme po aq sa edhe e rrallë. Rreth kësaj sëmundjeje bisedova me shumë mjekë tanët, por kush nuk dinte gjë. I rrudhnin krahët dhe më thoshin se për të nuk kishin dëgjuar. Ka popuj që edhe ëndrrat i marrin për sëmundje, më tha një mjek yni i njohur. Ngjet që kjo lidhet me ndonjë besim të tyre të çoroditur, më tha ai...

Pas shumë e shumë bisedash dhe hetimesh të pandërprera gjeta njërin që vinte nga ato anë. Ai më thase «sëmundja e territ» merrej si sëmundje shumë e rrallë. e cila shkakton aso shrregullimesh sa të sëmurit, së pari i bëhen armiq të vetët (prindërit dhe kushërinjtë), e më vonë të afërmit. pastaj farefisi i gjerë, dikur i gjithë fisi dhe në fund e gjithë bota...

Pra, sëmundja e urrejtjes fillon nga familja dhe shkon më tutje. Kjo sëmundje, e cila nuk shërohet kurrë, por që shfaqet hove-hove, duket së pari në fëmijëri. pastaj në moshë të pjekur e së fundit në pleqëri. Në fëmijëri, i sëmuri turbullohet, vjell dhe i sheh njerëzit të deformuar, pra kokat ua sheh të shkëputura nga trupi dhe kur i sheh të tërë. ndjen neveri të jashtëzakonshme... Në fazën e pjekurisë, të sëmurin e qetëson vetëm gjaku... Së pari kërkon gjakun e të vetëve, e më vonë të të tjerëve. Ndërsa, në pleqëri ngushëllohet vetëm me rikujtimin e viktimave... Se fjala është për një sëmundje të çuditshme dhe të rrallë, fare të rrallë, madje të pashërueshme në vende të tjera dhe te popuj të tjerë, u binda kur erdha në Sheher. Kur e përmendja sëmundjen, preknin tokën. Tokës i raftë, thoshin.

Të sëmurë të tillë në fëmijëri nuk janë të rrezikshëm. Madje, vështirë që merren vesh se vuajnë nga «sëmundja e territ», ngase për të vjellë fëmijët vjellin gjithnjë e për çkado. Vetëm kur rriten dhe moshohen, befas iu shfaqet një gjendje neurotike e paparë. Të sëmurin e qetëson vetëm gjaku

i të vetëve, që e merr me dorë të vet. Nga hetimet e mia mësova se i sëmuri nuk kënaqet vetëm me pak gjak, ose me një viktimë. Jo. Jo. Ai kërkon vazhdimisht gjak, shumë e më shumë.

Për t'iu ikur gjakderdhjeve të tmerrshme, që s'ka kush i ndal, sipas një ligji te pashkruar, prindërit që hetojnë shenjat e kësaj sëmundjeje te fëmijët, duhet t'i vrasin ata sa më parë. Kjo bëhet sipas një rituali të përbashkët, në të cilin duhet të marrin pjesë që të gjithë, i madh e i vogël, në mënyrë që të bëhet pastrimi kolektiv nga fara e së keqes, e cila çuditërisht te ata përsëritet herë pas here dhe nuk i lë të qetë kurrë.

Ja sesi zhvillohet rituali:

Së pari, hapet fjala përmes kumtit të veçantë, pra kumtit të zi. Sapo dëgjohet kumti i zi, të gjithë e dinë se fjala është për sëmundjen e jashtëzakonshme dhe po atë natë secila shtëpi pren nga një kurban (qengj apo viç). Me gjakun e tij stërpikin themelet e shtëpisë dhe dyert e jashtme. Mishin e kurbanit e ziejnë gjithë natën dhe të nesërmen, pra ditën e therrorit kolektiv, e hanë. Duhet ta hanë secilën thelë, në mënyrë që asgjë e tij të mos mbetet. Kjo lidhet me besimin se të keqen e vet e kanë ngrënë dhe mendohet se ajo për një kohë të gjatë është e mundur, por jo përfundimisht. Si e tillë ajo gjendet në ta dhe patjetër se dikur përsëritet.

Në mëngjes, pra kur hahet mishi, meshkujt, nga një për shtëpi hapin gropën e thellë në majë të kodrinës. Pastaj e sjellin fëmijën të stolisur me gjithfarë lulesh (po të jetë verë). Fëmijës i përkulen të gjithë me radhë. Ia puthin dorën dhe qajnë para tij si para një shejtnie. Ky ritual zgjat deri pak para perëndimit të diellit. Atëherë fëmijën e fusin në gropën e thellë. I qesin përmbi të gjitha lulet. Prapë qajnë. Prindërit të parët hedhin dhè mbi të, pastaj dhè qesin të gjithë sa janë derisa gropa rrafshohet. Së fundi, mbi të mbjellin një dru...

Për prindërit pasojnë edhe masa të tjera: së pari, u ndalohet të lindin fëmijë të tjerë. Së dyti, edhe po patën fëmijë, askush prej tyre nuk mund të martohet më. I dërgojnë në një kullë që gjendet e vetmuar majë një bjeshke për të kaluar

pjesën e jetës larg botës. Me një fjalë, aty ku shfaqet sëmundja, ajo shtëpi shuhet përgjithmonë. Për ata që nuk e paraqesin të sëmurin, e, herëdokurdo, merret vesh kjo, a'ëherë pason një ndëshkim i madh. I madh e i vogël i asnj familjeje digjen publikisht në një turrë drush.
Megjithatë, sa më ra të marr vesh, në pesëqind vjetët e fundit nuk ishte bërë ndonjë shkelje e tillë, edhe pse sëmundja u paraqit katër herë. Së fundi, para njëqind vjetësh...
Pra, Lartmadhëri, ky njeri duhej të vdiste që moti, si fëmijë. Prindërit e tij bënë një shkelje të rëndë. Nuk do mend se ata nxituan të vinin në Kryesheher për t'ia humbur gjurmët sëmundjes. Dëshironin ta mashtronin vdekjen dhe nuk është për t'u habitur pse ai fëmijë tregoi energji të jashtëzakonshme dhe aq vrullshëm u ngrit deri në fronin e Kryevezirit. Në të vërtetë, ai ishte i tjetërsuar kahmot dhe kjo i ndihmoi që të përballojë çdo vështirësi. Me padijen e tij ai u mundua që shtytjen e sëmundjes, që të ngopet me gjakun e të vetëve, ta ndërronte me ngritjen e vazhdueshme përpara deri në lartësitë më të mëdha. Shtytja e tij nuk do të përfundonte pa e pushtuar edhe fronin Tuaj...
Edhe pse ndjenja e derdhjes së gjakut të vet iu zëvendësua me ecjen e furishme përpara, ai nuk u shërua plotësisht. Ç'është më e rëndësishme, edhe pse jetoi shumë larg vendit të vet (dhe sipas bestytnisë së tyre pas shtatë bjeshkësh dhe pas shtatë lumenjsh edhe gjaku bëhet tjetër edhe njeriu bëhet tjetër), ai prapësepranë të vetëve ua kishte borxh vdekjen, atë vdekje që u desh të bëhej para shumë e shumë vjetësh, sipas ritualit të tyre të moçëm...
Ma thotë mendja se pikërisht ajo vdekje që u desh të bëhej patjetër, solli një shqetësim kolektiv, sa shpirtërat e tyre u vunë në kërkim të atij shpirti që duhej të mbetej aty, i ndryrë në atë gropë të thellë në kujtesën e brezave. Andaj edhe thashethemet për shfaqjen e plakave që herë duken e herë nuk duken, e të cilat gjoja se prej kohësh po mbledhin një ushtri të paparë të të vdekurve, duhet lidhur me domosdonë e vdekjes së tij...
Plakat u bënë të padukshme dhe do të mbeten të tilla derisa të takohen me shpirtin e tij...

Por t'i kthehem edhe një herë asaj nate të kobshme.
Ai erdhi i paparalajmëruar, hipur në kalë të bardhë. Pasi i shkonin truprojet që nuk e dinin se po ndiqnin një shpirt të tjetërsuar, i cili duhej t'i nënshtrohej ritualit të vdekjes, asaj vdekjeje fizike së cilës i kishte bishtëruar aq gjatë. Nuk e dinin, pra, se po i shkonin pas atij që kërkonte vdekjen e vet...
Në shtëpinë e lindjes ai e dinte se po e pritnin plakat e padukshme, ato që duhej t'ia kumtonin dënimin dhe ta varrosnin shtatë pashë në dhè, si të dënuar që nuk do të ketë më të drejtë as të përzihet me të tjerët, as ta riprodhojë veten. Jam i bindur se kështu u bë. Sado që shtëpia ishte e kyçur dhe nën mbikqyrjen e rreptë të hetuesve të mi, ai i takoi ato aty dhe, më në fund e kuptoi atë që duhej ta kuptonte patjetër. Falë allahut që u bë ashtu, sepse droj se do ta pushtonte dhe fronin e gjithfuqishëm dhe ne do të shndërroheshim në një perandori vetëngrënëse. Mbase e liga e tyre, që asnjëherë nuk ka prajtur që të na kundërvihej, ka menduar që sëmundjen e vet ta drejtojë kundër nesh? Po të mbetej i pazbuluar, droj se sëmundja do të na futej neve dhe do të na çrrënjosej prej tyre... Sa më përket mua, veprova më së miri dhe më së drejti. E rrethova shtëpinë. Prita tri ditë e tri net, por ai nuk doli. Se nuk do të dilte, këtë e dija. E lutja të madhin që, megjithatë, të mos dilte. Pastaj, dhashë urdhër që truproja kryesore të futej brenda. Ai më shikoi vëngër dhe ma kujtoi urdhrin e tij të prerë që askush të mos e shqetësonte derisa të rrinte brenda. Ai urdhër, i thashë truprojës, nuk vlen më. Truproja hyri, por nuk doli më. Edhe këtë e prisja. Ai kishte rënë viktimë e lemerisë së papritur. Kur hyra brenda, truprojen e mbështolla me çevren jeshile dhe prita deri sa ra terri. Atëherë hapa fjalë se Madhëria e tij Kryeveziri, kishte vdekur nga pika nga shqetësimi kur pas aq shumë e shumë vjetësh ishte takuar me folenë e fëmijërisë.
Urdhërova që tabuti të mbyllej me një arkë të madhe dhe askush të mos e hapte deri në Kryesheher. I mora të gjitha masat të mos shfaqej as më i vogli dyshim se i vdekuri në tabut nuk ishte Kryeveziri, por një tjetër. Letrën e nisa me

postën ushtarake në mënyrë që Ju ta dini të vërtetën pa arritur tabuti në Kryesheher...
Ma thotë mendja, Lartmadhëri, se kjo ishte rruga më e mirë dhe më e drejtë që t'u priteshin të gjitha burimet e mundshme thashethemeve të tmerrshme, po qe se do të mësohej e vërteta për vdekjen e Kryevezirit. Ne mund të bëjmë gjithfarë gabimesh, mund të pranojmë gjithfarë lëshimesh, por nuk bën fare të pranojmë mësimin heretik që bie ndesh me thelbin e mendimit perandorak...»

Diku në Tokën e lashtë

në verën e vitit 1614.

(Në vend të mbylljes)

Shtatë ditë e shtatë net tabuti i përcjellë prej katërqind kalorësve të zgjedhur, të cilëve u printe Kryehetuesi, udhëtoi kah Perandoria. Kaloi nëpër krahinat e ndryshme dhe ngado që u shfaq, u shpall zi shtetërore. Në mëngjesin e ditës së katërmbëdhjetë, kur kalorësit po i afroheshin detit, tabutin e mori në dorëzim garda e posaçme perandorake. Kalorësve të lodhur me Kryehetuesin në krye, u thanë se duhej të pushonin. U shtruan drekë solemne dhe të gjithë mbetën me koka në tryezë... Fshehtas i varrosën në një varr të përbashkët dhe askush nuk mori vesh për fatin e tyre të zi...

Në Kryesheher zia zgjati dyzet ditë. Myezinët këndonin dhe luteshin për shpirtin e Vezirit të Madh Hasan Pashës. Varrimi qe madhështor dhe askush, pos Lartmadhërisë së tij, Sulltan Osmanit të Dytë, nuk e dinte se në atë tabut gjendej trupi i rojës së thjeshtë...

NJËQIND VJET PUSHTET

Ditën e xhumasë së madhe, nga Saraji i praruar, doli lajmi se Niman Pashai u emërua vezir i madh. Lartmadhëria e tij, sulltan Mustafai i Dytë, bashkë me dekretin e jashtëzakonshëm shpalli edhe një varg emërimesh të rëndësishme dhe paralajmëroi amnistinë më të madhe në historinë e perandorisë. Kremtja e madhe, që do të bëhej pas dyzet ditësh, bëhej edhe më e madhe për faktin se atë ditë Niman Pashai martohej me të bijën e Sulltanit, Xhylsymen e bukur, që nuk kishte shoqe në gjithë perandorinë e pafund.

Lajmi për emërimin e kryevezirit nga derë e Qyprillinjve saora fashiti thashethemet që u përhapën pas vdekjes së Hysni Pashës se gjoja sulltani e kishte pritur me padurim këtë rast që, më në fund, të ndërpriste pushtetin njëqindvjeçar të beratasve në postin më të lartë të Portës. E vërteta se njëri nga Qyprillinjtë sërish zinte vendin e Vezirit të madh, tash edhe më i fuqishëm madje (ngase martohej me të bijën e sulltanit), i dëshpëroi pa masë ata që shpresonin se më në fund perandoria nuk do të kishte në krye «një trup të huaj», i cili, përkundër përpjekjeve të pareshtura që bëri për të mirën e saj, nuk shikohej me sy të mirë prej tyre.

«Trup i huaj» në trungun e perandorisë Qyprillinjtë zunë të quhen moti, mbase në kohën e kryevizirit të dytë

me radhë, Ahmetit, kur u shfaqën ca trazira në pjesën lindore të vendit. Veziri i madh nuk pranoi kërkesën e shtruar të mexhilisit që atje të dërgoheshin menjëherë repartet ndëshkimore. Të hetohet njëherë puna mirë e mirë e pastaj të merren masat e duhura, tha. Kjo shkaktoi huti të madhe, sidomos te pjesa e fetarëve fanatikë, të cilët atëbotë kërkonin masa represive ndaj çfarëdo lëvizjeje, pa marrë parasysh se çfarë ishin ato. Ahmet Pashai, edhe pse i rrethuar nga fanatikë të tërbuar, nuk ngurroi të thoshte se «për hir të shëndetit të perandorisë nevojitet të bëhet një shqyrtim i gjithanshëm i revoltës njerëzore, kudoqoftë ajo...» Pashai foli gjatë për arsyen dhe për mirëkuptimin si baza të demokracisë që duhej t'i shërbenin shtetit para çdo veprimi. «Ku do të na çonte një përvojë e tillë që për çdo gjë të kapnim armët dhe t'u suleshim njerëzve tanë pse thonë ndonjë fjalë apo shprehin ndonjë mendim qoftë edhe përmes ndonjë revolte? Te masa duhet të mbështetemi prore dhe t'ua bëjmë me dije se pushteti është i tyre... Në çastin kur ata pushtetin do ta shikojnë si pjesë të vetën, jo vetëm se nuk do të veprojnë kundër tij, por do ta mbrojnë me gjithë qenien... Këtë kërkoj unë», tha Pashai dhe krye në vete dërgoi dy komisione të pavarura në pjesët e rebeluara. «Ju do të punoni pa ndikimin e faktorëve të jashtëm. Vendimet tuaja janë të pavarura. I dua edhe mendimet e palës tjetër. Bëni përpjekje që fjalët e tyre t'i shënoni sa më besnikërisht», u tha komisioneve.

Dhe prej atij çasti Qyprillinjtë nuk u shikuan me sy të mirë nga dorëfortët dhe nga ata që mendonin se Perandoria mund të shkonte përpara vetëm me shpatë dhe me lutje.

Por, sa më shumë që shtohej urrejtja ndaj tyre, Qyprillinjtë çuditërisht, me njëfarë energjie të pashoqe dhe me forcë shpirtërore që e gjenin në vetvete, ia dolën që të futnin rrënjë të thella në fronin e lartë të perandorisë sa dikur dukeshin si të pazëvendësueshëm. Sulltanët, që e dinin se çfarë mendonin fanatikët dhe të tjerët për beratasit, nuk hiqnin dorë nga Qyprillinjtë. Me ngulm kërkonin që ata ta udhëhiqnin pushtetin më të lartë të Portës, sepse me ta

ndjeheshin më të sigurt dhe më të fortë. Prandaj, jo pa arsye Sulltan Selimi i Parë me një rast tha botërisht se «Qyprillinjve u ka hije pushteti...» Sulltani e tha këtë pas fitores së madhe që arriti Mustafa Pashë Qyprilliu ndaj austriakëve në Shkup, në Prishtinë dhe në Nish dhe bëri që themelet e perandorisë të forcoheshin së tepërmi...

Të gjendur prore në shënjestrën e atyre që nuk i donin dhe të sulltanëve që nuk bënin pa ta, Qyprillinjtë kujdeseshin me mish e me shpirt që të mos bënin as me të voglin gabim. Bile, mund të thuhet se kjo u kaloi në njëfarë arti të posaçëm të gjeturisë, saqë dikur u bindën edhe kundërshtarët e tyre më të rreptë se Qyprillinjtë do të largoheshin nga froni i lartë vetëm atëherë kur do të ngopeshin me pushtet. Mehmeti plak, i pari ndër Qyprillinjtë që qe ulur në fronin e lartë, pak me shpoti e pak si përnjëmend, tha: «ne nga ky vend mund të na zbresë vetëm molisja jonë...»

Dhe njëmend, pas Mehmetit, erdhën hiç më pak se gjashtë të tjerë dhe, çështë me interes të thuhet, kush më shumë e kush më pak, asnjëri nuk u ndërrua nga posti i kryevezirit para kohës. Përkundrazi, nga aty largoheshin ose kur vdisnin, ose kur vriteshin nëpër fushata të mëdha.

Por ngopjes me pushtet dhe molisjes, për të cilën pati folur Mehmeti plak para njëqind vjetësh, po i shihej fundi me vdekjen e hershme dhe të papritur të Hysni Pashait. Çështë e vërteta, Pashai dinak, i cili merrej si më i zgjuari ndër Qyprillinjtë, si ta kishte parandier se së shpejti do të vdiste, u mundua me mish e me shpirt që të birin e vetëm, Nimanin, ta afronte rreth vetes, në mënyrë që t'ia shtinte në huj pushtetin. Por djaloshi nuk tregonte kurrfarë kurreshtjeje për zejen e Qyprillinjve. Përkundrazi, sa më shumë që rritej, mbyllej në vete dhe i rrinte larg t'et. Ditë të tëra futej në dhomë dhe lexonte. Kryevezirit një ditë i thanë se i biri ishte dashuruar thellësisht në libra dhe tregonte shenjat e mendimtarit dhe të poetit. Pashai, që ishte mësuar të dëgjonte se ndër Qyprillinjtë gjithnjë ishte zhvilluar një garë e fshehtë për pushtet dhe kjo garë shpesh kishte marrë fund me kurthe, intriga dhe vrasje mizore, gati plasi nga

tërbimi. Thirri të birin me ngut dhe kërkoi që ai t'ia thoshte aty për aty se çfarë kishte pushteti që atij nuk po i pëlqente. Djaloshi heshti. Heshti edhe atëherë kur Pashai për të dytën herë i shtroi të njëjtën pyetje me një zë kërcënues. Mendjen e kishte gjetiu, te ca vargje që po e mundonin ditë e natë, e që pikërisht kishin të bënin me moralin e lirisë. Mbase mënyra sesi i foli i ati ia shtoi edhe më tepër bindjen se «njerëzit shpesh bëhen robër të një prirjeje të vazhdueshme, që shfaqet si shtytje e përsëritshme kah pushteti...» Madje, para t'et deshi t'i recitonte vargjet, të cilat atë çast iu duk se i lidhi si duhej me fjalët që i mungonin. Vargjet do t'i recitonte po të mos e kishte parë të atin të vrenjtur si kurrë më parë. Pashai e shikoi një copë herë të birin, dhe, vetëm pasi dalloi në sytë e tij njëfarë tisi që iu duk si mjegullim, oshëtiu dëshpërueshëm dhe i dha leje të largohej. Kur po e kapërcente derën e sallonit të praruar, i tha me një zë thuajse lutës: «dije se fati dhe fatkeqësia jonë është nga froni i lartë...»

Ato fjalë Nimanit iu ngulitën në kokë si heshta të helmuara. Nga ai çast zuri të mendojë pareshtur se përse vallë fati dhe fatkeqësia e tyre ishin nga froni? Ç'ishte ajo që e lidhte aq ngushtë familjen e tij me pushtetin e lartë prej aq shumë kohësh? A ishte e thënë se duhej medoemos të mbeteshin në atë majë?... Dhe, sa më shumë që mendonte për këto çështje, ndjehej gjithnjë më i pafuqishëm. Para i shfaqej një labirinth i pafund, në të cilin humbte. Dhe kjo e dëshpëronte pa masë. Pse, vallë, duhet të ulem patjetër në atë fron? — i thoshte vetes. Pse? Pse? A ishte e domosdoshme që edhe ai, si gjysh e stërgjysh, të merrej vetëm me çështjet e pushtetit më të lartë? A thua Qyprillinjtë nuk kishin shteg tjetër pos atij që shpinte fronin më të lartë?... Kurreshtja rreth fronit iu shtua aq shumë nga çasti kur i ati foli në atë mënyrë për të, sa vendosi të hynte në dhomën e kronikave për të parë se mos e gjente nyjen e mpleksjes së Qyprillinjve me pushtetin...

Kur Pashai e mori vesh se i biri, më në fund u fut në Dhomën e kronikave, mendoi se atij i ishte kthyer mendja. Qe i bindur se te Nimani ishte shfaqur befas ajo shtytja për

pushtet, pa të cilën Qyprillinjtë as që mund të merreshin me mend.

Por heshtja e thellë që e kishte pllakosur dhomën me mure kadifeje të kaltër e frikësoi djaloshin sa ai ndjeu të dridhura. Të ftohta iu dukën edhe shikimet që i erdhën nga shtatë portretet e mëdha, të renditura në pjesën ballore të murit. Njëherë iu bë se portretet e mbërthyera në korniza të rënda e të stolisura me fjongo të praruara, po e vështronin vëngër, aq vëngër thuajse i kërcënoheshin. Djaloshi përpak nuk iku. Ndoshta do të ikte po të mos i kujtohej aty për aty se erdhi të merrej me kohën e atyre që tashmë rrinin në atë vend si portrete. Por, kur i shkoi mendja se një ditë dhe portreti i tij mund të gjendej afër tyre, sërish e mbërthyen të dridhurat. O zot, tha, a ka dënim më të rëndë se të futesh përgjithmonë në këtë hapësirë të akullt! Psherëtiu dhe u ul në kolltukun e madh përbri tryezës së drunjtë, në të cilën rrinin ca fletë të bardha dhe një bishtpenë. E zuri kokën me dorë që t'u ikte përpak shikimeve të akullta. Por, edhe pse nuk i shikonte dhe rrinte symbyllur, portretet, tash si konture të deformuara, po i shihte të pështjelluara. Ato po i njësoheshin. Nga shtatëshja po i formohej një portret i madh, me shumë vija të shqetësuara, i cili po afrohej duke ia zënë të gjitha anët e dhomës. E ai provonte të mbrohej nga portreti i gjithëportretshëm. Shumëportretëshi i shthurur po ia ngushtonte hapësirën, sa në një çast hetoi se ishte mbërthyer për mur dhe nuk kishte nga t'ia mbante më. Shumëportretin e deformuar tash e kishte aq afër, sa përpara po i shfaqeshin gjithfarë vijash që lëviznin, thyheshin dhe ngatërroheshin mes vetes marramendshëm. Nga ato vija po i vijëzohej një qenie e mjegulluar, e cila po çirrej dhe po i kërcënohej. Dikur iu bë se në atë shumëportret po veçoheshin portretet që pa në fillim. Por ato ishin edhe më tutje të gjymtuara. Po i shihte herë pa sy, herë pa hundë, herë pa gojë, e po i shihte edhe pa njërën pjesë të kokës... Pamjet e tyre e trishtuan aq shumë sa klithi. Klithja shkoi nga muri në mur dhe prapë iu kthye në kokë si një përplasje, e cila e shembi mbi tryezën e drunjtë...

Kur u kthjellua, pa Kronistin plak, që la diçka dhe u

largua duke u përkulur. Në shikimin e tij thuajse dalloi këshillën që ai nuk ia tha, por që e kuptoi: «fajet i ka madhështia e kryevezirëve.. Ajo të bën të vockël... Ajo ta merr krenarinë... Fajet i ka madhështia e kryevezirëve...»

Përse duhet t'i takoj kësaj madhështie, — tha vetmevete? Përse? Nuk bën ndryshe?...

Iu duk se pyetjes, që ia shtroi vetes me aq dëshpërim, tash po i përgjigjeshin si me një gojë portretet e varura në mur:

«... nuk ke nga ia mban... nuk ke nga ia mban... kot e ke... kot.. fati dhe fatkeqësia jonë... fati dhe fatkeqësia...»

Fjalët që i kishte thënë dikur i ati, tash po i kumbonin thekshëm. I vinin si kërcënime. Shikoi anash, por portretet rrinin të ftohta në vendet e tyre. Për herë të parë i shkoi mendja se mbase ato fjalë ia thoshte dikush tjetër që e kishte brenda? Mbase ia thoshte ajo pjesa e vet, zërin e së cilës nuk e kishte dëgjuar, ngase e kishte ndrydhur pamëshirshëm kur zuri të merrej me krijimtari?...

Edhe herave të tjera në atë dhomë ndeshte shikimet e ftohta të portreteve në mur. Një ditë iu bë se portretet morën jetë. Shqetësimi filloi me ca lëvizje, të cilat në fillim iu dukën të lehta. Nuk vonoi dhe një nga një ata u liruan nga kornizat e rënda. U shkundën, si ta hiqnin pjesën e heshtjes që u rrinte sipër dhe pjesën e vdekshme që e bartnin me vete, u ulën pranë tij... Para kishte shtatë burra të një dukjeje dhe të një qëndrimi. Nuk kishin nishana as armë të cilat i mbanin gjithnjë në mur. Pa armë dhe pa nishana, iu dukën pak më të afërt. Madje, nuk po e ndjente më ftohtësinë e shikimit të tyre. Hetoi se ata që i kishin folur aq ashpër për fatin dhe fatkeqësinë e frontit e shikonin miqësisht dhe mbanin nga një libër në dorë. Pa se ata libra bënin pjesë në kronikën e familjes. Një copë herë mes tij dhe atyre heshtja mbeti e shurdhër. Dhe, kur iu bë se ata nuk do të flisnin fare, por do të ktheheshin prej nga erdhën, i pari nga e majta foli e tha:

«Unë jam Mehmeti...

... Ky libër që s'e heq nga dora kurrë, peshon rëndë, shumë rëndë. Mbase aq rëndë sa vetë themelet e perandori-

së... Çfarë do të bënim ne pa këtë libër? Ah, do të dukeshim si të paqenë... Megjithatë në këtë libër nuk është e tëra... Shumëçka jona kreshpërohet nëpër fletë të huaja. Këtë duhet ta dish... Kjo kronikë duhet të plotësohet... Patjetër duhet të plotësohet... Fletët e saj janë të shpërndara.

Por, nejse...

Kur dhashë urdhër që kronika jonë të shkruhet, nga ato që dihen dhe nuk dihen, e pata parasysh se një ditë, herët a vonë, do të takoheshim së bashku, siç gjendemi tash në këtë dhomë. E dija se do ta shikojmë në sy njëri-tjetrin... E kjo duhet bërë që ta plotësojmë kronikën. Askush nuk mund ta bëjë këtë më mirë se ne... Erdhi koha t'i hapim zemrat dhe t'i themi edhe ato që nuk ia thamë kurrë as vetvetes... Megjithatë, them se gjithçka duhet të mbetet këtu midis nesh... Vetëm midis nesh... Ky nuk është egoizëm, por vetëmbrojtje, vetëmbrojtje nga ajo që na përgjon dhe na kërcënon të na shkatërrojë... Mbase një kujdes i tillë na ndihmon të mbesim ata që ishim?»

Plaku përpak heshti. Nimanit iu bë se ato që po i thoshte ai, po buronin nga ndonjë sfingë, e cila ishte ringjallur për t'i thënë ato që patjetër një ditë duhet të thuhen.

«Qytetin tim të praruar me mijëra dritare që shikonin nga lumi, nuk do ta ndërroja me tërë botën. Por, ç'e do kur në kokë befas m'u qep një mendim shqetësues që më thoshte: duhet të shkosh pas yllit tënd... Duhet të shkosh pas tij larg e më larg... Ylli të pret.: : Ylli të pret: : : Nisu pas tij... Nisu dhe mos u ndal.. : Ylli të pret: : : Të pret ylli i gjithfuqishëm... Mos u dëshpëro dhe mos u ligështo asnjëherë... Ylli yt: : : Ylli i fuqishëm: : :

Kështu më thoshte ajo thirrje dhe unë më kot përpiqesha t'i kundërshtoja me mallin e madh që kisha për qytetin tim me njëmijë e një dritare, me kaltërsinë e lumit tonë që nuk kishte shoq, me bjeshkët e thepisme që na rrinin pas dhe na mbronin nga stuhitë e egra.. Kot. .. Kot... Thirrja që më vinte ishte shumë e fuqishme dhe shqetësuese... Ajo pareshtur më thoshte të njëjtat gjëra. Dikur m'u bë se atë thirrje ma thoshin edhe gjësendet, ma thoshte edhe heshtja, ma dëftonin edhe ëndrrat... Ylli, ylli yt... shko pas tij... ylli: : :

Thirrja u bë aq e fortë, sa më rrëmbeu edhe përkundër dashurisë së pashoqe që ndjeja për qytetin tim me njëmijë e një dritare. Dhe kështu një ditë prej ditësh, sapo i mbusha të tetëmbëdhjetat, ndjeva një ngashërim të çuditshëm. Nuk e dija se në ç'gjendje isha: i fjetur, i zgjuar, apo i zhytur në ndonjë ankth të thellë? Gjatë qëndrova ashtu dhe një çast pashë një yll që m'i mori sytë. Pa një pa dy iu qepa yllit dhe zura ta ndiqja andej nga më çonte ai... Nuk e di se nga shkova, Ç'rrugë kalova, ç'shtigje lashë pas, ç'lumenj trupova, por më në fund u ndala para një qyteti të praruar. Këtu e ke vendin, më tha ylli im... Këtu dhe askund tjetër... Në këtë vend do të bëhesh një me mua...

Dhe, sapo i hapa sytë mirë e mirë, pashë saraje të bardha. Pashë prarim të jashtëzakonshëm. Pashë çmos sa u mahnita. Vallë, po më mashtronin sytë? Mos ishte ky ndonjë vegim që shfaqet pas bredhjeve të pafund e të kota?

Në atë majë të praruar do të ulesh medoemos, më tha ylli im...

Por rruga deri te sarajet, që më dukeshin aq afër sa mund t'i prekja edhe me dorë, qe e gjatë, shumë e gjatë, sa nganjëherë më bëhej se ajo thirrja e brendshme që më shtynte para, nuk ishte gjë tjetër pos përsëritje e ndonjë ëndrre të huaj, e cila m'u kishte qepur gabimisht që të më shqetësonte dhe të më bënte fatkeq për gjithë jetën... Dhe, kur dëshpërohesha, sërish më shfaqej ylli. Mos u ndal, më thoshte, mos u ndal... Nuk ka kthim prapa: : : Nuk ka: : : Të gjitha duhet t'i përballosh... Të gjitha duhet t'i përballosh...

Falë kësaj shtytjeje, zura t'i kapërceja të gjitha vështirësitë. Një ditë hetova se po ngjitesha përpjetë. Se po u afrohesha sarajeve të praruara. Se më duhej edhe një hap i vetëm që të futesha në to. Megjithatë, m'u desh shumë kohë që ta bëja atë hap. Dhe, kur më në fund e bëra, ylli që më përcolli aq gjatë foli e tha: erdhe ku u desh të vije. : . Tash e tutje përpiqu të mbetesh aty ku duhet të mbetesh... Do të bindesh se është më lehtë të fitosh diçka se ta mbash...

Lum djaloshi, ajo që erdhi më pas ishte vetëm pushtet, pushtet i paanshëm. Njëzet e tetë vjet pushtet mbi perandorinë e madhe. Njëzet e tetë vjet pushtet mbi popujt e pa-

numërt. Njëzet e tetë vjet pushtet mbi gjuhët e panumërta... Pushtet mbi lumenjtë, pushtet mbi detet, pushtet mbi stepat, pushtet mbi fushat e malet, pushtet mbi shkretëtirat...

Dikur vërejta se ylli im po zvetënohej. Kuptova se ishte koha të shkoja... Ylli im po perëndonte. Por nuk po më vinte keq për këtë, ngase po lindte ylli i ri, ylli i tim bir, Ahmetit. Në të vërtetë ai ishte i njëjti yll që më përcolli mua, por që kthehej saora prej perëndimit kah lindja për të bërë prapë udhën e vet të pafund... A nuk ishte kështu?»

«Unë nuk pashë kurrfarë ylli, — foli i dyti, që mbante librin e vet në dorë dhe e shfletonte kujdesshëm herë nga e majta, e herë nga e djathta. — Nuk e dija se froni trashëgohet. Bile, as më kishte shkuar mendja për të e lëre më se do të ulesha aty ku aq gjatë ishte im atë. U habita pa masë kur më thanë se të pret froni... Desha t'u them se ai vend kishte marrë fund për mua me vdekjen e plakut, por ata as që më lanë të flisja. Pushteti nuk bën të mbetet thatë, më thanë dhe m'u përkulën thellësisht...»

«Ashtu është, ndërhyri i pari. — Tim biri nuk i fola për pushtetin, e as që i thashë se do të ulej në të. Por, e mbajta afër, shumë afër, saqë mendja ma thoshte se ai ishte mishëruar më të. E kur dikush i rri pranë pushtetit, atëherë medoemos se lidhet me të. Po t'i thosha tim biri se duhej të mësonte dhe të bëhej gati për fron, mbase do të shqetësohej? Mbase do të frikësohej nga ai? Isha i bindur se ca gjëra duhet të bëhen pa shtytje. A nuk është kështu, biro?»

«Me tamam. Por duhet pranuar se nuk isha i gatshëm për pushtet... Mendja nuk më kishte shkuar se një ditë do të ulesha në të...»

Plaku qeshi. Nimani ndjeu një shungullimë që u lirua furishëm prej gojës së tij dhe u përplas nëpër dhomë si të ishte furtunë.

«Gjendesha në Krime, — vazhdoi Ahmeti, — kur më thirrën me ngut. — Çfarë paska ndodhur? Kah s'më shkoi mendja. Rrugën e gjatë e bëra i menduar dhe i heshtur, e i heshtur rrinte skaj meje edhe lajmëtari që erdhi të më merrte. Më shkoi mendja te nëna plakë e cila u bë helm pas

vdekjes së tim eti. Mos kishte vdekur e shkreta nga pikëllimi i madh? Desha ta pyesja lajmëtarin se a sillte kob apo fat udhëtimi i tij aq i ngutshëm, por nuk më la sedra ime ta bëja këtë. Tekefundit, një guvernatori të lartë nuk i kishte hije të pyeste një nëpunës të thjeshtë të shtetit se ç'lajme sillte. Për një gjë isha i sigurt: i burgosur nuk isha. Po të jepej një urdhër i tillë, atëherë do të m'i lidhnin duart dhe do të më përcillnin me roje të dyfishuara. Megjithatë, diçka kishte ndodhur. Thirrja me ngut lidhej me ndonjë të papritur. Sa më shumë që i afrohesha Kryeshehrit, më bëhej se po zhytesha në një kllapi të çuditshme. Kisha dëshirë të arrinim natën, ngase mendja ma thoshte se kobi i takonte natës. Dritat e Gjylsarajit dhe të Aja Sofisë i hetova sapo ra terri i parë. M'u duk se po shihja një prarim të jashtëzakonshëm që rrinte as në tokë e as në qiell. Ai rreth i dritës po shfaqej ashtu i shkëputur në errësirë që të më mashtronte... Atë ndjenjë e pata edhe kur pashë rojet e shumta që më përkuleshin, edhe kur hetova përcjellësit që më uronin mirëseardhje, edhe kur vërejta protokollarët e lartë që më prinë kah brendia e Gjylsarajit të praruar...

Hutimi m'u tret atë çast që dola para Lartmadhërisë, kur ai ma kumtoi vendimin se më kishte emëruar Kryevezir. Sapo iu përkula dhe ia putha dorën ai më tha:

«Babanë e pate të fuqishëm. Dardha pikë nën dardhë...»

Ata që ishin pranë (e ishin të gjithë vezirët, ushtarakët e shumtë dhe diplomatët), u përkulën dhe thanë si me një gojë: Amin!

Lartmadhëria pastaj më uroi shëndet dhe ngriti gotën e shurupit për hatrin tim.

— U bëfshim edhe më të fuqishëm, tha!

— Amin, bënë të tjerët.

Radha ishte të flisja unë. Por çfarë të thosha? Isha fare i papërgatitur për atë fjalim. Rrugës mendoja për kobin që kemi pranë dhe na përcjell pareshtur në çdo anë dhe në çdo hap. Si ta përballoja atë gjendje plot shqetësim? Më dukej se të gjithë pritnin me padurim ato që do t'ua thosha. Ishin mësuar me tim atë që fliste pak e bënte shumë. Mendja ma thoshte se këtë e kërkonte Lartmadhëria, e këtë e kërkonte

e gjithë perandoria, në fronin e së cilës u gjenda befas. Si të flisja kur më qe kyçur goja dhe më ishin ngrirë mendimet? Hetova se koka ime ishte e pazonja t'i lidhte dy fjalë e lëre më ndonjë mendim i cili do t'i takonte historisë. Një kohë të gjatë bëra përpjekje të them së paku një fjalë të vetme, apo ndonjë mendim fare të thjeshtë që do të shprehte falënderim. Shtangia më kishte mbërthyer dhe nuk po më hiqej se nuk po më hiqej. Më kapluan djersë të ftohta dhe zura të dridhesha. Kisha frikë se do të plandosesha përpara Lartmadhërisë dhe përpara gjithë atyre që më shikonin me kureshtje.

I bindur se isha i shqetësuar së tepërmi, Lartmadhëria më ftoi pranë. M'i rrahu krahët miqësisht dhe gjithë butësi më tha:

— Të presin shumë të papritura, biro. Froni të do të fortë. Por ta kuptoj shqetësimin... Fillimet janë të tilla... Përgjegjësia e madhe nganjëherë të ligështon... Këtë unë e marr si shenjë të mirë, ngase pa përgjegjësi të tillë nuk mund të bëhet gjë... Ai që mendon se është i fuqishëm shpesh mashtrohet... Njeriu duhet të veprojë si i fuqishëm dhe jo të mendojë se është i tillë...

Ç'është e vërteta të papriturat nuk m'u hoqën qafe asnjëherë. Për shumë vjet, sa isha në fronin më të lartë, m'u desh t'i shuaja disa kryengritje të mëdha (një në Rumeli, një në Egjipt, dy në Vllahi dhe një në Ballkan). Çfarë po ngjiste, vallë? Kryengritje, rebelime të njëpasnjëshme... Dëshira për mëvetësime... E në anën tjetër forca, ajo forca e pamëshirshme, e cila nuk pyeste për asgjë... Perandoria dëshironte të forcohej e të forcohej pa çarë kokën pse të tjerët dëshironin mvetësim... Në fund rridhte gjaku... Derdhej gjak... Shumë gjak. Toka nuk ngopej kurrë me të... Unë sillesha pareshtur në një rreth të mbyllur ku ndeshesin dëshirat për mëvetësim dhe forcimi i Perandorisë.. Gjendesha në atë vorbull dhe gjakosesha më tepër seç gjakosej toka e tharë... Medet.

Por, si t'ia bëja? Si?

Rrugëdalje nuk kishte...

Shihja koka të prera. Shihja shumë sosh që shkonin kotnasikoti... Ato ishin të pafundëta. Shtoheshin më tepër se

bari në pranverë dhe gjethet e thara të vjeshtës. Prej nga ato koka që shkonin ashtu kot? A thua gjithçka jona i nënshtrohej sprovës së tmerrshme të vetëshkatërrimit? A thua po vinin kohë kur duhet të hanim njëri-tjetrin, ngase nuk ishim në gjendje të mendonim si duhej pa e prekur armën e ftohtë, e cila nuk thahej nga gjaku i njomë? A thua përfundimisht e kishim bjerrë arsyen? Pse duhej të jepeshin sprova të besnikërisë me numrin e kokave të hequra?...

Edhe tash po merrem me këto gjëra dhe shumëçka më është ngatërruar... Megjithatë, mendja ma thotë se i takova një kohe të ligë dhe të mbrapshtë...»

Shpërtheu një e qeshur. Nimani mendoi se ishte plaku me shungullimën e pakmëparshme. Por jo. Ajo ishte një e qeshur e hollë, që djaloshit iu duk e thekshme.

«Gjithnjë ke qenë i tillë... Gjithnjë... i tha i treti, pra, ai që qeshi pak më parë e që nga grimasat e të qeshurës ende nuk i ishte liruar e folmja. — Ndaj kundërshtarëve nuk ka mëshirë. Perandoria pati kundërshtarë dhe është më se e drejtë që ajo përdori dhe përdor sot e gjithditën mjetet e ligjshme për t'u mbrojtur. Tekefundit për të qëndruar duhet të përdorësh forcën. Po nuk pate forcë, të marrin nëpër këmbë. Pallavra janë ato për gjoja mençurinë, fjalën e urtë dhe bindjet... Pallavra! Kur t'i shohin dhëmbët brisk, të lënë të qetë. Ndryshe nuk bën.

Me kundërshtarët duhet vepruar siç e kërkojnë ata? Apo jo?»

«Ata nuk i patëm kundërshtarë», — foli Ahmeti.

«Mos i patëm miq?», — pyeti i treti, që tashmë ishte liruar nga e qeshura e thekshme.

«As armiq nuk patëm. Në Krime nuk hasa shenja armiqësie. Ishin njerëz të ndershëm dhe fisnikë...»

«Me të vetmin përjashtim se na kthyen armën... A nuk ishte kështu?»

«Nuk na e kthyen armën...»

«Po kush na vrau, pra?»

«Kërkuan të mbrohen... Kërkuan ta mbrojnë dinjitetin e vet... Kjo është e tëra... Perandoria i mashtroi ata e jo

ata perandorinë. Ata e pranuan perandorinë që të mos e humbnin mëvetësimin...»

I treti sërish shpërtheu në gaz.

«Po çfarë mëvetësimi, tha ai... Ata kërkuan ta shkatërrojnë perandorinë. Kërkuan që t'ia futnin krimbin, i cili do ta brente pastaj nga të gjitha anët... Kërkuan që të na futnin thikën pas shpinës...»

«Për perëndi, — zuri të fliste me një zë të butë Ahmeti, — ata nuk e kishin me të keq. Përkundrazi, ia donin të mirën perandorisë. Kur erdhën te unë, lanë armët jashtë dhe më thanë: e duam perandorinë... Ju e dini madhëri këtë më së miri, ngase një kohë të gjatë e kaluat me ne... Tash kërkojnë që ne të heqim dorë nga zakonet tona, kërkojnë të heqim dorë nga mendimet tona... Thonë se po e rrezikuakemi perandorinë! Shpirtin na e kanë shpallur të rrezikshëm bashkë me atë që e krijoi ai gjatë qindra e mijëra vjetëve... Çfarë bëhet me pemën së cilës dikush ngadalë ia këput degët? Patjetër se thahet... A nuk është kështu, Madhëri? më thanë. Dikush kërkon që ne të mbesim pa degë e pa rrënjë... Këtë e kërkojnë në emër të forcimit të perandorisë... Këtë nuk po mund ta kuptojmë... Si mund të forcohet perandoria duke na dobësuar ne? Si mund ta duam atë perandori e cila na i mohon të drejtat, të cilat u zotua se do t'i respektojë kur e pranuam kurorën e saj? Po qe se na lejohet qenësia jonë, perandoria nuk ka pse të frikësohet. Përkundrazi, ajo do të jetë edhe më e fortë. Bëhemi themeli i saj, siç ishim deri dje...

Këto më thanë dhe shkuan... Çfarë t'u thosha? E dija se ata kishin të drejtë... E dija se dikush kishte filluar të ngatërrohej me ëndrrat e tyre. Pastaj ato ëndrra ia paraqitnin Lartmadhërisë si të rrezikshme, e ai fitonte bindjen se ata njerëz janë të rrezikshëm...»

«Mendon se nuk ishin të rrezikshëm? Po pse ia kthenin armën perandorisë? Për t'u argëtuar?»

«Mos m'i zë fjalët në gjuhë. Ata patën të drejtë. Perandoria ua kishte borxh mëvetësimin në kuadër të saj, ngase me kushte të tilla u bashkuan me të. Por ç'e do që dikujt nuk i pëlqente perandoria me pjesë të mëvetësuara. Ata

hapën gjithfarë intrigash në Kryesheher se fjala është për armiq të rrezikshëm, të cilët kërkonin shkëputje. Të gjitha ato ishin dokrra. Ato i duheshin dikujt për të arsyetuar raprezaliet që u bëheshin pareshtur. Këtë e kuptova shpejt por nuk pata si t'ia bëja. Edhe komisionet e hetimit m'i shpallën të pavlefshme...»

«Po pse s'u vure në anën e tyre, pra? Mbase do të bëheshe hero i tyre? Për ty do të këndonin këngë të gjata. Ha, ha, ha! Këngë të gjata. Do të bëheshe i pavdekshëm...»

«Mbase u desh të bëja diçka që të fitonte arsyeja dhe e drejta...? Mbase u desh që të tregohesha më i vendosur?... Por, ç'e do që njeriu brendapërbrenda vetes paska dy pjesë: një që vepron sipas arsyes dhe bindjes dhe një tjetër që vepron sipas urdhrave të jashtëm. Gjatë, shumë gjatë te unë këto pjesë u grindën. Herë njëra e herë tjetra merrnin krye. Kjo ma mori qetësinë, e qetësi nuk kam as tash, nuk do të kem kurrë. Pjesa e njëmendët, pra ajo e bindjes dhe e arsyes, shpesh herë lëshoi pe para së dytës. Pra, para asaj që vepronte nga urdhrat e jashtëm. Kjo më dëshpëroi. U dëshpërova aq shumë, sa pareshtur e ndjeja veten fajtor... Nuk mund t'ia fal vetes disa gjëra... Nuk mund t'ia fal.... Vështirë qenka kur njeriu ka telashe me ndërgjegjen e vet... Vështirë... Po më bren ndërgjegjja...»

«Ha, ha, ha,... Çfarë mëkati? Çfarë faji? Ha, ha, ha... Si nuk u lirova njëherë nga hamendje të tilla?... Ma thoshte mendja se një ditë do të përmirësohen, por po shoh se edhe në këtë botë po të mundojnë gjëra të tilla...»

«Unë jam mëkatar! — zuri të çirrej Ahmeti. — Unë jam mëkatar! Këtë duhet ta dijë Djaloshi! Mëkatet e mia janë të mëdha! Lejova që përkundër dëshirës sime të bëhen masakra! Unë jam mëkatar... Me nënshkrimin tim u vu shtetrrethimi në atë pjesë dhe po ashtu me nënshkrimin tim u bë hataja për shumë kohë... A nuk është mëkat ky? A mund t'i ik unë ndjenjës së fajit me arsyetimin bosh se patëm punë me armiq dhe i tillë ishte interesi i perandorisë? Jo. Jo. Bëra atë që nuk duhej të bëja... Djaloshi duhet ta dijë, e edhe ju duhet ta dini këtë, se unë vdiqa si mëkatar... Mbase do të më ndihmojë pendimi? Mbase shpirtit tim të përvuajtur

do t'i ndihmojë kjo ndjenjë... Vëllezër, pendohuni dhe mendoni pareshtur se çfarë ngjet kur njeriu nuk guxon t'i kundërshtojë së ligës që është aq e dukshme... E kemi për detyrë, që në këtë hapësirë të ngrirë, në të cilën gjendemi, dhe nga e cila nuk do të dalim kurrë, ta pastrojmë shpirtin... Shpirti do pastruar... Nuk na mbrojnë as parimet që kanë të bëjnë me betimin e fronit e as stema perandorake... Mos mendoni se ato na ndihmojnë... Jo. Jo... Njeriu duhet ta ndjejë peshën e fajit dhe përulësisht të pendohet... Unë do të ec gjithnjë kokulur...»

I treti qeshi edhe një copë herë, e pastaj i katërti foli e tha: Gjërat do sqaruar deri në fund dhe si duhet. Bile, do sqaruar sa më mirë e sa më drejt për hir të vetvetes dhe për hir të Djaloshit, pa marrë parasysh se ai do t'i lexojë kronikat tona dhe do të formojë mendimin e vet. Ma thotë mendja se bindja dhe arsyeja, apo çështja e të dy pjesëve brendapërbrenda një personi, për të cilat foli xha Ahmeti dhe me atë kundërthënie që ai merret pareshtur, do shikuar thellë e më thellë.

Edhe njëra, edhe tjetra kushtëzohen dhe nuk mund të merren si të ndara. Çdo bindje që bëhet me arsye, në të njëjtën kohë është e arsyeshme dhe e bindshme. Dhe, çdo arsye që shfaqet si rezultat i bindjes është e drejtë... Dua të them se kur ishte në pyetje rruga e perandorisë, unë e zbatova atë me bindje dhe me arsye të plotë. Këtë e bëra pa kurrfarë hamendjeje, ngase isha i bindur se kisha të drejtë. Kur më emëruan kryevezir, Lartmadhëria më tha: çfarë mendon, Fadil pasha, rreth lëvizjeve për mëvetësim që kanë zënë të shfaqen aty-këtu?

Unë heshta një copë herë e pastaj kërkova njëzet e katër orë kohë të mendoja. Lartmadhëria ma dha izën dhe mbase i erdhi mirë që unë kisha nevojë të mendoja shtruar.

Një ditë e një natë mendova pareshtur rreth pyetjes që m'u shtua. E dija se nga përgjigjja ime më varej e ardhmja. Por, këtë s'e kuptoja vetëm si të ardhmen time. E merrja si çështje të orientimit të mëtutjeshëm perandorak. Ngase nuk pata kohë për të shfletuar libra, iu dhashë mendimit të thellë me dëshirë që të gjykoja sa më mirë dhe sa më drejt,

pa e çuar mendjen te froni dhe kurrfarë shtytjesh... Herë vihesha në anën e atyre që kërkonin mëvetësim, e herë në anën e perandorisë që kërkonte integritet të pacënueshëm. Pastaj zura të merresha me rrethana të tjera, me ato të jashtmet. Këtu m'u shfaqën moskuptimet e para. Mendova shtruar për mëvetësimet, kundërmëvetësimet dhe gjithnjë në mesin e mesit më shfaqeshin armiqtë e perandorisë. Bëja përpjekje t'i kuptoja që të gjithë, edhe ata që kërkonin mëvetësim e edhe ata që ishin kundër mëvetësimit, pra që të ardhmen e shihnin vetëm në forcimin e mëtutjeshëm të perandorisë. Njëra palë thoshte se mëvetësimi nuk e dëmton perandorinë, pos që e forcon unitetin e saj përmes veçantive të secilit e tjetra më thoshte se pikërisht mëvetësimi ia bën varrin asaj... Njëra palë thoshte kështu, e tjetra ashtu... Këtë kacafytje më bëhej se e përgjonin me vëmendje ata që rrinin anash dhe pritnin që të dobësohej perandoria... Ata ishin shumë. Ata shikonin pareshtur zënkat tona dhe bënin plane kundër nesh... Përpara më krijohej një lëmsh i madh që në shikimin tim e mjegullonte perandorinë. Ata që përgjonin, bënin sehir që ajo të shkatërrohej sa më shpejt...

Dhe, çfarë do të ngjiste po qe se njëmend do të rrënohej perandoria? A do ta fitonin mëvetësimin ata që e kërkonin atë? Assesi. Ata do të kalonin nga perandoria në perandori dhe gjithçka do të fillonte nga e para. Prapë «bashkim me vullnetet»... Prapë vrull fillestar... Prapë skena e prapaskena... Prapë qërime hesapesh të vjetra... Prapë kurdisje dhe lojëra të pafund... Prapë dëshira për mëvetësime... Prapë rebelime... Prapë shtetrrethime... Prapë armiq të perandorisë dhe asish që e duan perandorinë... Prapë burgime... Prapë koka të prera kotnasikoti... Prapë gjithfarë fermanesh... Prapë luftë me ndërgjegjen... Prapë... Prapë...

Mendja më tha se bota pa perandori nuk mund të frymojë. Perandoritë janë fati dhe fatkeqësia e saj. Andaj, perandoritë mund ta hanë njëra tjetrën, por assesi të shkatërrohen. Shkon njëra e vjen tjetra, me të njëjtat huqe dhe me të njëjtat preokupime... Të vegjëlit do të mbesin ose në kuadrin e tyre ose përreth tyre. Rrugë tjetër për ta nuk ka.

Prandaj. konstatova se kërkesat e quajtura mvehtësime apo dosido ndryshe, në të vërtetë janë intriga të një perandorie kundër perandorisë tjetër...

Të nesërmen Lartmadhërisë i thashë me bindje të plotë se lëvizjet për mëvehtësim ishin të rrezikshme për perandorinë tonë. Ato duhet të ndërpriten sa më parë...

— Aferim! Aferim, — më tha ai, të tillë të dua...

I putha dorën dhe mora bekimin e tij.

— Gjakosi pamëshirë ata që mendojnë keq për perandorinë. Mos ki mëshirë!

Nga ai çast zura të mendoja dhe të veproja si perandoria. Nuk bëra kurrfarë mëkati. Apo jo, gjysh?»

«Ne ishim vetë perandoria dhe duhej të luftonin për të mirën e saj. Ndryshe nuk bënte. Sapo të njësohesh me të, atëherë bëhesh pjesë e mekanizmit të saj», tha Plaku me një zë të butë.

«E qartë, e qartë, — tha Ahmeti. — Edhe unë e bëra atë që u desh ta bëja, por e bëra kundër dëshirës sime... Këtë desha të thoja...»

«As unë nuk luftova kundër ndërgjegjes sime, — tha Fadili. Pata një bindje të tillë, që e mbroj dhe do ta mbroj gjithnjë...»

«Pate fat që bindja jote përkonte me atë të perandorisë, — ndërhyri Ahmeti si me shpoti. — Tekefundit ne po bisedojmë jo për të ndryshuar gjë, ngase nuk ka se çfarë ndryshohet, por që Djaloshi t'i kuptojë ato që s'i di askush. Sado që linim përshtypjen se ishim të vendosur dhe tejet besnik ndaj perandorisë (e që në të vërtetë ishim të tillë), prapësepraprë ne kishim mendimet tona... Kjo duhet të dihet... Po ashtu duhet të dihet se kishim shumë e shumë dilema. Pra, nuk ishim uniformë dhe të pandjenja, siç thuhet aty-këtu për ne. Këto duhet t'i dijë Djaloshi...»

«Lëri ato. Djaloshi do të ngatërrohet po qe se zë të merret me gjërat që nuk do t'i hyjnë në punë... Tekefundit ne i takuam fronit e udhëhoqëm, kush më shumë e kush më pak, por gjithnjë me sukses. Këtë nuk ka kush të na e mohojë. Për ne do të flitet kurdoherë me respekt...» — tha Fadili.

Është e vërtetë se ishim të fortë. Se kishim plot vullnet të qeverisnim, por nuk mund të mos pajtohem me ato që tha im gjysh, Fadili, — foli i katërti, i cili kishte një shikim të butë.

Njëmend se pushteti mund të jetë i njëtrajtshëm, i ngurtë dhe si i tillë vetëm i përsëritshëm. Por në këtë njëtrajtshmëri mund të gjenden hapësira për individualitet. Kjo varet prej vullnetit dhe dëshirës së atij që rri në fron. Megjithatë, është njëfarë hapësire, që mund të cilësohet si hapësirë e veprimit të lirë, që qeveritarin mund ta bëjë ca si të pavarur, pa e lënduar normën e aprovuar perandorake. Edhe pse nuk pata shëndet dhe jetë të gjatë, luftova me ngulm që ta zgjeroj sa më shumë atë hapësirë. Kur dergjesha në shtrat dhe dihej se ditët i kisha të numëruara, Lartmadhëria më tha:

— Dije, or Sami Pasha, se vdekja është kapak i artë... E pata të qartë pse më foli kështu».

«E pse t'i tha ato fjalë», e pyeti Fadili?

«Paj ma bëri me dije se po i gëzohej vdekjes sime. Më mirë që exheli po ma merrte shpirtin se ta bënte ai këtë punë. Ishte e qartë se ai nuk do të më duronte më... Ja pse e zuri ngojë vdekjen si kapak të artë...»

«Këtë nuk ma thotë mendja, — foli Fadili gjithë shqetësim, — nuk do të ma thotë mendja kurrë. Lartmadhëria të tha ashtu nga dëshpërimi. Ai kishte dhembje për mundimin tënd. E shihte se dergjën e ke të rëndë. Lartmadhëria ka pushtet mbi njerëzit, mbi malet, mbi fushat dhe mbi gjithë perandorinë e pafund, por nuk mund të përzihet në punët e të madhit...»

«Gjithë ke qenë i prirur që t'i besosh vetëm Lartmadhërisë dhe fjalëve të tij. Por, herët a vonë, do t'i kuptosh ca nga veprimet e mia. Më vjen keq vetëm që nuk pata jetë te qëndroj edhe ca në pushtet. Vetëm për këtë më vjen keq. Mbase disa gjëra do të merrnin rrjedhë tjetër?...»

«Asgjë, asgjë nuk do të ndryshonte, — ndërhyri Fadili... — Do të shkonte koka si qenit në rrush dhe me këtë do të merrte fund gjithë mundi i Qyprillinjve. Të tjerë nuk do të kishte më në fronin më të lartë. E, edhe neve që qemë

para teje dhe bëmë shumëçka për perandorinë do të na i shembnin varret. Vetëm këtë do ta arrije. Ti e di se sa e pamëshirshme është perandoria ndaj të padëgjueshmëve. Ajo për një plesht ta djeg jorganin. Jo rrallë në kamarën e turpit dolën emrat e atyre që kaherë i kishte ngrënë toka e zezë. Mbase këtë e dije?»

Samiu deshi të thotë edhe diçka, por ndërhyri i pesti, që zuri të fiste me një zë të fortë:

«E di, or Mustafë Pashai, se shpatën e ke të fortë dhe të pamëshirshme, — më tha Lartmadhëria kur më uroi fronin. — I tillë i duhesh sot perandorisë, të cilën po e kërcënojnë nga Lindja e nga Perëndimi. Nuk është kohë e besimeve, por e veprimeve. Andaj filloja! Filloja? Ke pushtet të pakufijshëm... E pata të qartë se kërkohej ngulmim i madh e jo pispillosje mendimesh, aso pispillosjeje, e cila do t'ua bënte të mundur armiqve tanë me të cilët gjendeshim në luftë, që të na gjunjëzonin. Iu sula me rrëmbim dhe bëra që perandoria prapë të bëhet ajo që ishte dikur, e fortë, e madhe dhe e fuqishme. Nga Kaukazi kalova në Evropë dhe ua drodha kokën mirë e mirë pashallarve që kishin filluar që ta merrnin nëpër këmbë fronin e lartë perandorak. A nuk e merituan këtë? Pa bërë këtë nuk ishte e mundur që t'ia qëroja hesapet me austriakët dhe të tjerët që ishin bashkuar me ta në Tokën e Lashtë. Gjenerali i Vjenës na ishte futur thellë dhe ia thoshte mendja se kishte ardhur koha që të na e shkëputste Ballkanin. Nga Shkupi, nëpër Prishtinë e Nish e ndoqa këmba këmbës dhe ai iku si qen i zgjebosur. Dal, o dal, or gjeneral i thosha. Dal njëherë, se t'i gjakos nishanet unë... Por, ç'e do që s'e futa në dorë që ta tallja njëherë. Ajo sëmundja ishte më e fuqishme se unë. Më vjen keq që s'më ra në dorë t'i thosha se kishte bërë hesap pa hanxhiun kur erdhi në Tokën e Lashtë dhe foli për shuarjen e gjysmëhënës sonë dhe për lindjen e shqiponjës danubiane. Më erdhi keq për ata të gjorët që i kishte mashtruar. Por nuk pata si t'ia bëja ndryshe. Ata, kur e panë se gjenerali i Vjenës i la në baltë, u turrën, me çka kishin, pas oficerëve të tij për në veri. Të kota qenë përpjekjet e mia që t'i ndalja. Dërgova lajmëtar që t'ua bënin me dije se nuk do

t'i ndëshkoja. Por ata nuk kishin të ndalur. Shumë prej tyre i mori ai dimër i fortë dhe vetëm një numër i vogël doli në tokën e gjeneralit. Ç'e do që kur ha kumbulla të tharta, të mpihen dhëmbët patjetër...»

«E drejtë, e drejtë, — tha Fadili. — Veprova sipas betimit. Edhe unë do të veproja ashtu».

«Njëmend, punët qenë të ngatërruara, por a u desh që në vendlindjen tonë të përdorësh topat më të rinj»? — tha Ahmeti.

«E si t'ia bëja, — tha Mustafë Pashai me një zë të fortë? — Si t'ia bëja? Pa më thuaj? Aty ishte gjenerali i Vjenës me ushtrinë e vet. Me vete kishte shumë njerëz tanët. Unë e dija se duhet të luftoja kundër njerëzve tanë. Por ajo ishte luftë që zhvillohej midis dy perandorive, ku njëra patjetër se do të fitonte e tjetra do të mundej. Gjenerali i Vjenës i kishte bërë për vete disa mijëra veta dhe u kishte premtuar se do t'u jepte njfarë mëvetësimi. Në të vërtetë ai i mashtronte, sepse mëvetësim nuk do t'u jepte, siç nuk u jep as të tjerëve që i mban deri në Baltik. Ai dëshironte që kaurrët t'i bënte për vete në mënyrë që vëllezërit e një gjaku të ndaheshin më dysh. Këtë edhe e bëri. Disa mbronin gjeneralin e Vjenës e disa gjysmëhënën perandorake. Mua më çahej zemra, por nuk kisha rrugë tjetër. Bëra përpjekje t'ua kthenja mendjen dhe disa i ktheva në rrugë të drejtë, por disa qenë kokëfortë. Nuk shihnin gjë pos kryqit të Vjenës dhe kryqit të Moskës. Mendonin se kryqi do t'i shpëtonte. Nuk e dinin të gjorët se kryqi i Vjenës apo kryqi i Moskës do t'i gëlltiste pa mëshirë, siç i gëlltiti gjithmonë...»

«Ti bëre atë që u desh ta bëje», — tha Fadili.

«Topat... Topat po më gjëmojnë... Topat po i shoh mbi fisin tonë... Ata po bëjnë nam të zi... Topat... Pse u desh që të zbrazen në kështjellat tona?», — fliste Ahmeti si i përçartë.

«Ishte kryeneçësi e përgijthshme. Ti e di fort mirë se çfarë do të thotë kryeneçësi. Kryeneçësinë nuk e bëra unë por ata të Vjenës. Ata i morën në qafë njerëzit tanë. Po të mos luftoja, atëherë prapë do të kthehej kryqi. Prapë do të kthehej era e temjanit dhe shkronjat lakadredhe çirilike.

Prapë do të ktheheshin ikonat e ngrira dhe djallëzitë e tyre. Çfarë do të bëhej me kështjellën tonë? Ajo do të kthehej në një kishë bizantine. Në të do të rrihnin këmbanat e Moskës...»

«Topat... topat po gjëmojnë... ishte hata...»

«Ç'e do që këtë kësmet pati», tha Fadili

«Kësmeti? Kësmeti? — foli Mahmuti. — Atë kështjellë, me vetëdije ose pa të, e mbanim në kujtesën tonë. Jetonte e madhe në shpirtin tonë. Në të gjenin prehje mendimet tona kur na rëndonin dertet e perandorisë. Vetëm atje ndjeheshim të qetë dhe shlodheshim pak... Vetëm atje...»

«Ky qe një kob që nuk patëm si t'i ikim, — foli Mustafa Pasha me një zë të prajshëm, si të kërkonte falje, — Fisi ynë mbronte në të njëjtën kohë dy perandoritë. Disa ishin në anën time e disa në atë të gjeneralit të Vjenës. Ata vriteshin mes veti dhe nuk e kishin të qartë pse vriteshin. Por, si t'ua bëja me dije këtë? Si? Ishte tepër vonë. Kjo më dhemb edhe mua...

E, sa për kështjellën, edhe ajo më dhembset. U desh të gjuhej me topa. Si të mos gjuhej kur në të gjendeshin shtabet e gjeneralit të Vjenës? Kur i binin gjylet, më bëhej se ato qëllonin trupin tim. Më dukej se eshtrat e mia fluturonin lart dhe përhapeshin në të dy perandoritë... Aty pashë se djalli është futur te ne dhe nuk na lë të qetë...»

«Kështjella më dhembset... Kështjella... Njerëzit e gjorë që u bënë pre e topave... Ata që nuk do të kthehen më kurrë... Mashtrimi pas kryqit...», fliste Mehmeti si përçart.

«Mustafa Pasha nuk pati rrugëdalje tjetër, — foli prapë Fadili. — A mos u desh t'i thoshte gjeneralit të Vjenës bëj çfarë të duash? A mos u desh t'u thoshte murgjve të Moskës bëni çfarë të dëshironi me kryqin tuaj? Ajo ishte një luftë e shenjtë. Ishte një luftë mbrojtëse. Ishte një luftë që do ta bëja me dëshirë dhe duhej ta bënim që të gjithë, jo vetëm për të mbrojtur perandorinë, që e kemi për detyrë, por për të mbrojtur rrënjën tonë nga djallëzia e kryqit. Kryqi ishte futur si thellë dhe dëshironte të na i shpalonte rrënjët për të na i tharë... Këtë e dëshironin Vjena me Moskën. Vetëm këtë... Djallëzisë së tyre u desh t'ia prisnim kokën me kohë...»

«Mbase ishte dhe kjo, por nuk duhet harruar se Mustafa Pashai ishte bir i Sami Pashës, i atij që kërkonte individualitet në fronin perandorak. Lartmadhëria dhe e gjithë perandoria dëshironte me çdo kusht dëshmi bindëse se ajo që ngjau gjatë kohës së Sami Pashës ishte vetëm pasojë e sëmundjes së tij. Pra, një shrregullim personal pa kurrfarë prapavije që do të lidhej me çfarëdo dyshimi se Qyprillinjtë mendonin ndryshe nga perandoria. Andaj ishte koha që e gjithë kjo të dëshmohej njëherë e mirë. Dhe, ku ka dëshmi më të mirë sesa t'i sulesh vatanit. Lufta me Austrinë dhe kryeneçësia në Tokën e Lashtë qenë të mirëseardhura për dëshmi të tilla. Çuditërisht gjithçka u lidh mirë që të sqarohej një gjë: ishin apo nuk ishin Qyprillinjtë luajalë? Kjo luftë qe shumë e përshtatshme për të hequr dilema të tilla njëherë e përgjithmonë.

S'do mend se Lartmadhërisë kjo i shkoi për shtat që t'ua mbyllte gojën atyre që me smirë e shikonin pashkëputshmërinë tonë në fronin e lashtë të perandorisë. Lartmadhëria, pas fitores së shkëlqyeshme të Mustafa Pashës në Ballkan foli me plot gojën: ja se kush janë Qyprillinjtë... — tha Mehmeti».

«Ndoshta sëmundja ime ishte sëmundje e shpirtit tonë, — tha Samiu pas një pushimi. — Mbase ajo sëmundje m'u shfaq si vërejtje që të mendonim dhe të vepronim ndryshe. Pareshtur u mora me këtë dilemë, e edhe tash merrem me të, por nuk ia gjej dot fillin lëmshit. Ngatërrohem në një rreth të mbyllur, i cili m'i zë këmbët dhe ma ngrin kokën... Aty bëhem i paqenë... Megjithatë mendja ma thotë se do ta gjej atë fill të lëmshit... Do ta gjej patjetër...

Por tash një gjë e kam të qartë, se nga mendja jonë perandoria kishte frikë.. Ajo na e donte mendjen tonë të kthyer vetëm në forcë qeverisëse. Mendja jonë nuk duhej të merrej me meditim vetjak...

Mbase brendapërbrenda shpirtit tonë gjendej një barazues i brendshëm, që i mbikëqyrte të gjitha. Kështu, sa herë që kërcënohej rreziku që të ktheheshim në një mekanizëm shkatërrues që vepronte sipas urdhrave të njëtratshëm, atëherë shfaqej arsyeja, e cila kërkonte të bënte të vetën. E

frenonte veprimin dhe mund të thuhet se fillonte koha e stabilizimit, që nuk mund të zgjaste shumë... Kujtoj se falë këtij proçesi që po përsëritet pareshtur, ne po mbahemi në fronin më të lartë. Si të tillë i duhemi perandorisë. Atë çast që barazpesha e përmendur do të prishej, pa marrë parasysh se në dëm të kujt apo në dobi të kujt, familja jonë bie, e edhe perandoria nuk do t'i ketë punët mirë. Perandoria do t'i gjasojë pastaj anijes e cila lundron nëpër det të hapët pa timon të fortë dhe pa timonier të shkathët...»

«Im gjysh ka qenë gjithnjë i thellë, — tha Mahmuti, duke ia lëshuar sytë Nimanit, sa ai nuk mundi t'i bënte ballë shikimit të tij të fortë. — Sapo u ula në fron, vazhdoi ai, — më shkoi mendja se a do të mund të ndryshoja gjë? Njëtrajtshmërinë e tij e njihja dhe kjo më shtyri të mendoja shtruar a kishte mundësi që pushteti të kishte një frymëmarrje tjetër nga kjo që e kishte? Mendova e çmendova, por sa më shumë që meditoja mendja ma thoshte se një pushtet i tillë ishte kthyer në një mekanizëm të njëtrajtshëm, që përsëritej pareshtur dhe pikërisht ajo përsëritje e kishte varfëruar shpirtin tonë. Në vorbullin e këtyre përsëritjeve gjithçka ishte njësuar në atë masë, saqë individualiteti kishte humbur fare. Njeriu duhej t'i ngjante njeriut me përulësinë për t'i zbatuar ato që thuhen. Urdhëdhënësi, pra, pushteti, vazhdonte ta ndiqte fillin e njëjtë, pa luajtur asnjë qime floku andej apo këndej... Kjo bëri që mendimi vetjak të përjashtohet në atë masë sa ai nuk ekzistonte më! Njeriu pra, në të vërtetë mendonte siç i urdhërohej...

Ky fakt më qiti në shtrat dhe, falë Perëndisë, sëmundja më shpëtoi të mos mundohem me një pushtet të tillë... U mbërtheva në shtratin e vdekjes dhe kërkoja t'i gjeja edhe më rrënjët e fatkeqësisë, nga e cila nuk ka shpëtim i gjorë njeri...»

«Dhe ia gjete?» — pyeti Fadili?

Tjetri heshti pak. Nimanit iu bë se ai kishte kyçur gojën qëllimisht për të mos folur më. Ndoshta mendonte se kishte thënë edhe ato që nuk duhej të thuheshin?

«E di se ke mbetur në mjegull. Rropatje të tilla ta marrin qetësinë e t'i mbyllin shtigjet...» — foli prapë Fadili.

«Në mjegull kam qenë gjithmonë... Më bëhet se linda dhe vdiqa në mjegull... E keqja është se mjegulla nuk do të hiqet kurrë...» — foli Samiu.

«Kësaj i droj edhe unë. Por, po s'i ndihmove vetes, askush nuk të ndihmon...»

«Këtë them edhe unë, foli Mahmuti. — Në mjegullim futet vetëm ai që dëshiron të shohë diçka më larg se hunda... Kjo është më se e vërtetë... Ai që dëshiron të ngarkohet me këtë barrë do të jetë gjithnjë i shqetësuar, i mbërthyer në vete dhe fatkeq. Por, fatkeqsia dhe një mundim i tillë e ushqejnë shpirtin. E mbrojnë nga rrënimi dhe tjetërsimi. Kush ecën nëpër mjegull, shpirtërisht është më i pasur dhe prore më afër amshimit... Mjegullimi është më i mirë nga tejdukshmëria e zbrazët, që merret si shihet, pa i shtuar dhe pa i munguar gjë... Për perëndi nuk ka gjë më të llahtarshme sesa kjo tejdukshmëri... Nga ajo gjithnjë më ka ardhur të vjell. E po më vjen të vjell edhe tash që po mendoj për të...»

Fadili zuri të qeshte. E qeshura e tij e thekshme pushtoi hapësirën e dhomës, sa Nimanit iu bë se diçka e fuqishme po i përplasej në kokë.

«Hiqu ëndrrave, o babaxhan, hiqu! Ç'dobi ke nga ato? Ç'mjegullim është ai i cili po e shëruaka shpirtin? Shërohu njëherë e mirë...»

«Jo, jo, — tha tjetri. — Nuk kërkoj shërim të tillë... Pushteti më ka sëmurë dhe mund të shërohem kur ai të zhduket përgjithmonë...»

Fadili prapë qeshi. E qeshura e tij një copë herë u soll nëpër dhomë.

«Ëndërrimtar! Po si mund të jetohet pa pushtet? Do ta hanim vetveten atë çast që nuk do ta kishim atë mbi kokë...»

«Nuk është kështu... nuk është...»

«Po kush e krijoi pushtetin? Mos piku nga qielli? Pushtetin e krijoi njeriu që të bënte zap veten e që të vinte në pranga herezinë që e ka në shpirt. Një herezi e tillë, herë më shumë e herë më pak, ngre krye dhe kërcënohet.

Vetëm pushteti është në gjendje që prapti të tilla t'i frenojë...»

Pushtetin njëmend e lindi dhe e rriti pjesa e instikteve të liga, — tha Mahmuti, — por nuk është e thënë që ato gjithnjë të mbesin të njëjta... Njeriu është njeri vetëm pse ka mundësi t'i përballojë ato dhe t'i drejtojë si duhet... Ta mbash pushtetin të fortë, do të thotë të mos kesh besim në vetvete, të mos kesh besim në atë që është e madhërishme dhe e gatshme ta mundë të ligën... Ata që frikësohen nga herezia e vet, pra nga pjesa e ligë, e kërkojnë pushtetin e fortë. Kërkojnë mbrojtje nga institucioni i tij. Por ky është një mashtrim, një mashtrim i madh i përsëritshëm, i cili mbjell shterpësinë shpirtërore dhe ndrydh pamëshirshëm ndërgjegjen...»

«I tillë do të mbetesh gjithmonë. I tillë do të mbetesh... Nuk ke shpëtim... Tekefundit vetë e zgjodhe këtë udhë dhe sillu nëpër të... Pushtetin duhet ta bësh për vete. Vetëm ashtu mund të arrish diçka. Duke e luftuar, do ta thyhesh kokën tënde...»

Biseda po shndërrohej në grindje, por ndërhyri Mehmeti:

«Mjaft! Folëm mjaft! Ka njëqind vjet që rropatemi me biseda të tilla... Njëqind vjet që i themi njëri-tjetrit të njëjtat fjalë...»

Ra një heshtje e shurdhër. Nimani zuri kokën me duar. Fjalët «njëqind vjet...» po i silleshin marramenthi. Tash, ato po i kumbonin të forta e të ngjizura me një jeh të thellë që shkëputej si të vinte nga ndonjë lashtësi. Një copë herë fjalët iu sollën nëpër kokë dhe sa më shumë që i silleshin, aq më e dendur i shfaqej një mjegull. Dikur iu bë se i tëri humbi në atë mjegull: Ecte pa parë shteg as dritë. Mendoi se u verbua. Mendoi se iu dha pushtetit të errësirës së devotshme për të mbetur në të amshueshëm... Ju bë se po shoqëronte njërin prej stërgjyshërve, ai që i foli për mjegullimin e amshueshëm në të cilin bëhet ai pastrimi i domosdoshëm shpirtëror, në mënyrë që më tutje, soji i tyre dhe njeriu në përgjithësi ta rrënojë pushtetin që i kishte ngritur vetes vetëm e vetëm pse dëgjoi urdhrin e së ligës...

Mbase do të mbetej aty përgjithmonë, po të mos kishte hetuar dorën e dikujt që po e prekte lehtë-lehtë në sup. Kur hapi sytë, pa Kronistin plak me shandan në dorë. Flaka e qirinjve ia ndante fytyrën në shumë pjesë, kështu që iu bë se po shihte një njeri të shumëzuar, që kishte shumë fytyra të njëjta, të cilat përdridheshin sikur të dëshironin të shkëputeshin.

— Madhëri, — i tha Plaku me një zë të butë, — erdhi koha e darkës...

Nimani fërkoi sytë edhe për të dytën herë dhe shikoi përreth me frikë. Në murin ballor portretet rrinin të varura si gjithnjë me shikimet e tyre të akullta...

Atë natë mendoi gjatë për poezinë dhe për filozofinë. I bëhej, herë-herë, se ato që kishte shkruar ia recitonin të tjerët pa ndonjë përkushtim... kështu vargjet nuk kishin kurrfarë domethënie. Përkundrazi i bëhej se prej tyre lirohej një fishkëllimë e thekshme, e cila i sulej nga të gjitha anët... Çfarë po ngjet me mua, vallë, tha dhe deshi të hapte dritaren, por disa trokitje të lehta në derë e ndanë nga gjendja e rëndë. Ishte lajmëtari që i tha se e kërkonte Kryeveziri me ngut.

Në shikimin e lajmëtarit hetoi shqetësim, e shqetësim hetoi edhe para dhomës së madhe, ku ushtarakë, vezirë dhe titullarë të lartë rrinin kokulur dhe thyenin gishtat.

Në dhomë i ati rrinte shtrirë e i zverdhur dyll. Kur i puthi dorën, i shpëtuan lotët. Ai si të kishte fituar fuqi nga prekja e dorë së të birit, hapi sytë, në të cilët Nimani pa qartë perëndimin e jetës dhe tha:

— Mos e harro amanetin...

Gjatë kohës së ceremonialit të varrimit të t'et, i ndodhi diçka e jashtëzakonshme, që do ta mbajë mend gjithmonë. Pra, kur po ecte pas turmës së xhematit, që nuk kishte fund, në duart e së cilës i vdekuri dukej se fluturonte, mendja i treti në një hapësirë të paanë, ku nuk kishte gjë prej gjëje pos poezisë. Fjalët e shumta, pastaj vargjet, strofat shenjat dhe rimat e panumërta ndërthureshin mes veti dhe plotësonin gjithçka. Kështu që edhe bimët ishin vargje, edhe drunjtë i dukeshin vargje, edhe lulet i shfaqeshin si

vargje, e edhe lumenjtë i takonin poezisë... Madje edhe shtëpitë ishin strofa madhësish të ndryshme...

Një puhizë që frynte herë nga veriu e herë nga jugu bënte që nga fjalët të shkëputeshin ca rrokje të cilat pastaj, duke i ndërruar vendet, lëshonin tinguj të shumtë, që më vonë krijonin melodi magjike... Melodia magjike e joshi aq shumë sa për herë të parë e ndjeu thellë shijen e poezisë...

Do të rrinte kohë e mot aty ku gjithçka i nënshtrohej pushtetit të poezisë, po të mos ndiente një shi të imtë, që i ishte futur në trup. Befas pa se përpara kishte një varr të madh që po bëheshin gati ta mbulonin me dhe të zi. Në majë të atij dheu të zi rrinte pema e poezisë. Deshi të lutej për drurin e poezisë, që ta mos varrosnin. Deshi të çirrej për poezinë, por dikush i dha një grusht dhè dhe i tha se dheun duhej ta hidhte në varr... Ai që ia dha dheun i tha se duhej ta hidhte patjetër në varr, ngase trupi i prindit pushon më i qetë në atë botë... Ai megjithatë mendjen e kishte te druri i poezisë që i bëhej se do ta varrosnin. Dheun e lëshoi në varr dhe po atë çast që dheu ra poshtë nuk e pa më drurin e poezisë... Poezia, varri, poezia, varri... Një copë herë ia përsëriti vetes këto fjalë... Mos, vallë, këtu fshehet kuptimi i përsëritjes së amshueshme të gjërave që gjithmonë mbesin të pakryera?

Deshi të ndiqte atë mendim, por hoqi dorë, ngase nuk e diti as vetë sesi iu shfaq një fron perandorak, i cili ndrydhte pamëshirshëm strofat dhe vargjet e shumta... Tutje atij froni të zbrazët iu bë se po rrinte i ati gjysmë i mbuluar me dhe të lagësht. Anash, si në mjegullim, shihte Qyprillinjtë e tjerë, ata që i kishte takuar në Dhomën e kronikave që rrinin me kornizat e forta përmbi. Ata po bëheshin gati ta ndiqnin. I lemeritur, mbylli sytë që të mos shihte asgjë dhe pështëriti gjithë shqetësim... Lërmëni të qetë... lërmëni të qetë...

Por nga ai çast të qetë nuk e lanë as të gjallët e as të vdekurit... I bëhej se të gjallët që i shihte, dëshironin t'ia zinin ngojë fronin që e priste, ndërsa të vdekurit i thoshin se amaneti i t'et duhej të çohej në vend patjetër...

Në një gjendje të tillë nuk i ndihmonte më as poezia. Më kot kërkonte që vargjet dhe rimat ta shpinin në botën e thellë të përsiatjeve, kur rëndom gjente prehje. I dëshpëruar, kthente në Dhomën e kronikës dhe dëgjonte bisedat e Qyprillinjve të vdekur, të cilët sapo hynte ai aty, zbritnin nga kornizat dhe shtroheshin në biseda të gjata... Ia fillonin qetë-qetë dhe gjithnjë i jepnin fund me ndonjë grindje të madhe. Kjo e ngushëllonte disi dhe zuri t'i pëlqente.

Dikur në ato biseda ndërhynte edhe i ati (edhe pse portretin nuk ia kishin sjellë në atë dhomë). Ai kërkonte nga të tjerët që t'ia detyronin të birin, të vetmin nga Qyprillinjtë, që të ulej në fron... Do të na marrë në qafë poezia, thoshte gjithë dëshpërim... Do t'ia shohim sherrin përgjithmonë meditimit të thellë... Qyprillinjtë nuk lindën të mendonin me vargje, por të udhëhiqnin fronin e lartë... Qyprillinjve nuk u ka hije pispillosja e mendimeve... Qyprillinjve u kanë hije froni dhe shpata... Ndihmoni që të mos zbresim nga skena e historisë si palaço, me të cilët qesh bota... Ne ishim të madhërishëm...

Nganjëherë thoshte në formë të lutjes: «Aman, mos lejoni që im bir të vdesë rrugëve si i marrë!... Mos lejoni që të bëhet gazi i botës... Mos lejoni që t'u takojë të krisurve...»

Kështu, midis tyre fillonin grindjet e gjata të cilat sa dukej se fashiteshin, prapë merrnin hov... Ahmet Pashai me Mahmut Pashain e kundërshtonin tim atë. Samiu i sëmurë fliste për një shpirt, i cili dëshironte t'i ikte dërgjës së gjatë, ndërsa Fadili me Mustafë Pashën kërkonin që me çdo kusht froni të kishte edhe një Qyprillinjas, qoftë ai nga derë e tyre më e largët... Mehmeti Plak mundohej t'i qetësonte me fjalët se Qyprillinjtë kanë yllin e vet që i përcjell dhe nga froni do të zbresin kur ylli i tyre të shuhet... Mbase erdhi ajo kohë? thoshte ai. Mbase ylli ynë perëndoi?...

Më vonë, në këto biseda zunë të shfaqeshin edhe të tjerë, të gjithë kushërinj të afërm dhe të largët që patën pasur poste të nduarduarta në hierarkinë e lartë ushtarake dhe administrative të perandorisë. Mësoi se shumë prej tyre qenë ushtarakë të rangjeve të ndrydhshme dhe morën pjesë

në shumë beteja, ku, kush më shumë e kush më pak, i ndihmuan çështjes perandorake. Kishte ndër ta titullarë, diplomatë, myderrizë dhe ulema të zëshëm... Moria e tyre vinte e shtohej sa një çast iu bë se përpara kishte një armatë të tërë, nga ata që nuk kishin nishane e deri te ata që kishin nishane të panumërt. Ca prej tyre nuk ngurronin t'i tregonin këmbët e gjymtuara, duart e këputura, sytë e nxjerrë apo veshët e prerë...

Një natë prej netësh ngjau një përshtjellim i madh, në të cilin morën pjesë shumë e shumë nga ata të famshmit. E gjithë kjo ngjau kështu: kur para masës u shfaq Mustafë Pashai, ca nga oficerët që kishin shumë nishane e që gjithnjë shkonin bashkë, filluan ta ngrinim zërin kundër kryevezirit, për të cilin dihej se ishte njëri ndër ushtarakët më të fuqishëm të perandorisë në qindvjetëshin e fundit. Oficerët çirreshin dhe kërkonin nga Mehmeti plak që Mustafë Pashai të mos u afrohej më, ngase nuk dëshironin të kishin punë me të. Na bëre kurban në Kaukaz, thoshin oficerët me plot gojën... Nuk na deshe për së gjalli e as për së vdekuri... Kryeveziri Mustafë Pashai megjithatë mori qëndrim gatitu (si dikur) dhe zuri të fliste... ju duhet të kuptoni njëherë e mirë se ç'është strategjia... Këtë patjetër duhet ta kuptoni... Strategjia është mbi të gjitha...

Oficerët po kundërshtonin. S'çajmë kokën për strategjinë tënde që na bëri kurbanë. Deri kur do të na i thuash ato fjalë?...

Kryeveziri Mustafë Pashai nuk hiqte dorë nga dëshira që të thoshte ato që i kishte bërë gati t'i thoshte para botës. Mbase nuk do t'ia dilte ta kryente mendimin, por i ndihmoi një adjutant i lartë, i cili doli përpara oficerëve dhe u tha se ishte e udhës që njëherë, të vetmen herë, së paku si të vdekur, kur nuk kishin më se çfarë të humbnin e çfarë të fitonin, ta dëgjonin me vëmendje njëri-tjetrin... Ka njëqind vjet që grindemi mes veti dhe nuk arrijmë fare të gjejmë gjuhë të përbashkët... Si të gjallë na kishin hije grindjet, por si të vdekur kjo nuk na ka hije...

Adjutanti foli e foli në atë mënyrë sa masa e shqetësuar pranoi që Kryeveziri të thoshte ato që ai mendonte se ishin

të rëndësishme të thuheshin.

«Prapë duhet t'ia nis nga strategjia, ia filloi Mustafë Pashai... Ishte pikërisht strategjia që në atë betejë më detyroi të urdhëroja që njësia e trembëdhjetë sulmuese të nisej nga ana e djathtë për ta zënë pusinë e domosdoshme. Kjo kishte rëndësi të jashtëzakonshme për fatin e luftës... Armiku duhej të futej në kurth, në mënyrë që forca e tij kryesore të zhvendosej andej nga ne e parapamë se mund të shkapërderdhej më lehtë. Dhe pikërisht njësia e trembëdhjetë, si më luftarakja, si më e guximshmja, si më e forta, pra njësia elite e perandorisë, duhej të merrte përsipër pusinë, në mënyrë që beteja të ishte shumë e përgjakshme, aq e përgjakshme sa armiku të mos kishte as më të voglin dyshim se e gjithë kjo ishte vetëm një kurban yni i vetëdijshëm për ta vënë në grackë forcën e tij kryesore... Për këtë grackë duheshin trimat, më trimat e armatës sonë. Ata që do të vdisnin pa u trembur fare. Andaj ju zgjodha juve. Trimëria qe kobi juaj... Më vjen keq që u desh të vriteshit ashtu deri në një, por mos harroni se vdekja juaj na solli fitoren. Solli fitoren më të rëndësishme në historinë e perandorisë... Nuk është kjo për t'u krenuar? A nuk u dekoruat që të gjithë me urdhrin më të lartë? A nuk përmenden emrat tuaj me adhurim të posaçëm... A ka libër shkollor ku nuk gjenden emrat tuaj?... Ju edhe ashtu do të vdisnit... Ishit luftëtarë dhe, luftëtari i takon luftës, asaj lufte në të cilën vdekja është pjesë e saj... Unë bëra që vdekja juaj të ishte madhështore, një vdekje që do të mbahet mend... Vdekja juaj nuk ishte si çdo vdekja tjetër... Përkundrazi, ajo ishte vdekje e pavdekshme...

«Na bëre kurban pse kështu të detyruan... Vdekjen tonë e shfrytëzove për interesat tuaja, e jo për fatin e luftës... Këtë e dimë fare mirë... Ajo t'u desh të mbetesh në fronin më të lartë... flisnin oficerët gjithë shqetësim.

«E dija se do t'i thoshit këto fjalë.. E dija... Sa kohë u duhet ta kuptoni se vdekja e juaj ishte vdekje e madhe?...»

«Jo, jo. Nuk ishte ajo vdekje e madhe, siç po thua ti, por një pusi që na e vunë gjeneralët e tu me Maliq Pashën në krye nga se ai me të tjerët kishin frikë prej nesh se

nesër a pasnesër do t'ua merrnim anën... Ata dridheshin nga hija jonë... Kishin frikë nga qëndrimi dhe fuqia jonë... Ata qëllimisht na bënë kurbanë dhe ti pranove një sakrificë të tillë... Ne e dinim se ata do të na futnin në ndonjë kurth. Këtë na e tregonin shikimet e tyre tinëzare, që ishin plot dredhi... Ne ishim të dyshimtë për ta, sado që vdisnim në të gjitha betejat më të rëndësishme të perandorisë...»

«Nuk ishte dredhi kjo, por strategji... Rrufeja nuk i vret hithat por lisat...»

«Mjaft! Mjaft! këtë e deshi Maliq Pashai... Maliq Pashai na vrau me urdhrin tënd...»

Kryeveziri nuk foli më. Pas tij fjalën e mori adjutanti i tij i cili zuri të thoshte edhe diçka rreth asaj lufte, por oficerët nuk e lanë të fliste. Iu sulën dhe u bë një rrëmujë e madhe. Mbase rrëmuja do të bëhej edhe më e madhe po të mos shfaqej Mehmeti plak, i cili me sa zë kishte, mori mundimin e tha:

«Pushoni! Deri kur do të grindeni kështu? Deri kur?...»

Fjalët e plakut askush s'i bëri dysh. U shpërndanë me të shpejt Mu aty ku pak më parë ngjau pështjellimi, Nimani pa një plak të tinjur, me një mjekër të gjatë që i shkonte deri ndaj belit. Ishte i ngarkuar me ca libra të trasha, që i kishte lidhur me një litar gjithë nyje.

«Më thonë Selajdin, Selajdin Kronisti, — tha Plaku i mbushur me frymë. — Ka kohë që në shpinë bart historinë tuaj, e cila ende nuk është e plotësuar... Ka kohë që merrem me punët tuaja... Shfletoj letra, lexoj pergamene, gjej dokumente që u ka rënë pluhuri i harresës... Futem nëpër të gjitha stukat e errëta, por gjithnjë më hapen ca të çara që më qesin telashe... Fare nuk mund ta hartoj historinë tuaj... Fare...»

Plaku heshti pak. Kishte vështirësi me frymëmarrjen, e cila herë pas here i zihej. E ai me njërën dorë prekte fytin si ta gjente çepin nëpër të cilin do të kalonte pjesa e nevojshme e ajrit për t'ia kthyer fuqinë e duhur.

«Megjithatë, Selajdini nuk jepet... Një ditë do të plotësoj kronikën tuaj... Patjetër se do ta plotësoj... Ia dhashë

fjalën Ahmet Pashait të ndritur se në këtë botë dhe në atë botë do të merrem me ju...»

Më pas Plaku gjithë mundim u ngrit. Lidhi barrën që mbante para dhe, kur po nisej, tha:

«Një ditë do të takohemi... Do të flasim për ca gjëra tejet të rëndësishme...»

Nimani deshi ta pyeste Plakun diçka për librat që mbante në shpinë, por aty ku pak më parë rrinte ai, iu shfaq një mjegullirë. Mjegulla u bë re e reja shkoi dikah. Një kohë të gjatë e kërkoi renë. Në atë kundrim të çuditshëm iu bë se i ati po i thoshte ato që i tha çastin që po vdiste: mas e harro amanetin...

«Mos e harro amanetin», i tha edhe Lartmadhëria kur e thirri për herë të parë në Sarajin e praruar. Ishte ajo një ditë e bukur pranverore e mbushur me diell të shndritshëm dhe me kundërmim jargovanësh. Shkëlqimi i asaj dite ishte aq i madh, sa iu bë se ishte futur qëllimisht që ta bënte edhe më madhështor Sarajin e praruar... Një kohë të gjatë iu bë se mbeti i tëri i zhytur në atë madhështi...

Por, nuk vonoi e pranvera iu bë dimër, ndërsa shkëlqimi mahnitës iu kthye në një re mjegulle... Kur po e shikonte një degë të jargovanit të harlisur, Lartmadhëria i tha: «është punë fort e mirë që perandoria, e cila gjendet para fitoreve të reja, do ta ketë në krye të pushtetit të saj një poet e mendimtar... Do t'i pajtojmë dhe do t'i afrojmë dy gjëra që deri më tash nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët, pushtetin me artin... Kam besim të plotë se pas dyzet ditësh do t'ia nisësh mbarë dhe ne do të shpallim një festë të madhe, ndër më të mëdhatë që patëm deri më tash...»

Nga ato që dëgjoi, iu këput dega e jargovanit. Jargovani rrinte i shtirë përtokë dhe tashmë i vyshkur. Ktheu shikimin kah Lartmadhëria dhe iu bë se para kishte një tjetër njeri, që po e shikonte gjithë ashpërsi... Ajo ashpërsi po e rrethonte nga të gjitha anët. Deshi t'i ikte disi asaj ashpërsie, por hetoi se ajo e kishte mbërthyer të tërin...

Si t'ia kishte kuptuar hutimin, Lartmadhëria i tha:

«Xhylsymja nuk të do të trishtuar... Hareja e burrit

e përtërin gruan siç e përtërin filizën e njomë vesa e pranverës... Ah, ç'dasmë që do të bëjmë!... Dasmë të tillë nuk ka parë bota...»

Iu bë se po sharronte në një akullnajë të pafund. Gjithçka që kishte krijuar dhe ëndërruar po i ngrihej në acar të paparë... Aty po i shihte vargjet të ngrira, po i shihte mendimet të ngrira, po i shihte metaforat të tëkurrura nga ngrica... Akullnaja ishte e pamëshirshme... Po e përbinte bashkë me botën e tij që mendonte se ishte e pafund dhe e paprekshme... Ajo botë i ishte ngrirë... Qëndronte përpara tij e ftohtë...

Tmerr! Tmerr! — pëshpëriti dhe deshi ta merrte ikën. Por, ndjeu se nuk kishte nga t'ia mbante. Akullnaja e kishte mbërthyer të tërin.

I dëshpëruar, ofshani: perëndi, pse robi yt është aq i vocërr e aq i pafuqishëm? Pse?... Një kohë të gjatë pseu iu soll nëpër kokë dhe nga gjithë ai mundim i shkëndijuan vetëm ca vargje të dashura të Jahja Dukagjin Zadës:

...yllin tënd s'ka që e fik...
vrapo, vrapo pas tij,
me muaj, me vjet, me shekuj,
ylli yt deri në amshim...

Si ta ndjek? Si? Si ta ndjek yllin që është i ngrirë?.. Ai nuk po shihet... Dikur hetoi se iu ngrinë edhe mendimet. Madje, edhe fjalët që ia tha Lartmadhëria «se ke dyzet ditë kohë...» i erdhën si të ngrira...

Jeta iu nda në dy pjesë të pabarabarta: në njëzet e tre vjetët e shkuar dhe në dyzet ditët që i kishin mbetur... Dyzet ditëshi ishte njëfarë mesokohe, që duhej t'i shërbente së ardhmes, pra kohës së re, e cila duhej të vazhdonte pa ato njëzet e tri vjetët e shkuar. E shkuara, pra ato të njëzetetri vjetët, bëheshin kohë-harresë dhe ia lëshonin vendin tjetrës, së resë, në të cilën qenia e tij do të përcaktohej nga të tjerët, nga ata të cilët mund të hynin e mund të dilnin në hapësirën e tij të zbrazët, për të marrë e për të lënë çfarë të donin në të... Nga ai çast ai duhej ta ha-

rronte vetveten... Kjo i solli të dridhura. Iu kujtua Dhoma e kronikës. Pra iu shfaqën shikimet e ftohta të gjyshërve dhe të stërgjyshërve. Po të mos ishte nga soji i tyre askush nuk do t'i thoshte: i ke dyzet ditë kohë për t'u ulur në fronin më të lartë... Mbase ishte pikërisht parandjenja e hershme e refuzimit të pushtetit që e kishte shtyrë të merrej me poezinë dhe me meditimin, që të ndrydhte me çdo kusht shtytjet që kishin të bënin me instiktet e pushtetit, të cilat me vetëdije apo pavetëdije struken te njeriu dhe zhvillohen pastaj gjithnjë të varura nga rrethanat. Sado që rrethanat i pati fatkëqija (ngase ishte biri i kryevezirit që tetë vjet me radhë që vinte nga dera e Qyprillinjve), shpresonte se nuk do ta lidhnin me pushtetin, jo vetëm se nuk tregonte interesim për të, por edhe për faktin se merrej me poezi dhe me filozofi. Perandoria asnjëherë nuk i kishte përfillur gjithaq poetët e filozofët, andaj pse për të bënte përjashtim? Bile, ishte i lumtur që po vinte dita kur Qyprillinjtë, pas pushtetit njëqindvjeçar, njëherë e mirë t'u ktheheshin çështjeve të shpirtit, pra t'i ktheheshin vetvetes. Sepse mendonte se familja e tij kishte humbur shumë energji të panevojshme rreth fronit të njëtrajtshëm (edhe pse i kishte ndihmuar së tepërmi mirëqënies dhe forcimit të perandorisë) pa u marrë me vetveten... Çfarë do të ngjiste thoshte kur dehej nga frymëzimi poetik, po qe se gjyshërit dhe stërgjyshërit e mi do të merreshin me muzikë, me poezi, me pikturë, me arkitekturë apo me filozofi. Para i shfaqeshin shumë libra, shumë piktura, shumë vepra të tjera artistike dhe filozofike...

Sa kohë dhe sa forcë humbën kot? tha. A nuk është koha që shpirti ynë të shprehë madhështinë që e ka ngacmuar prore? Fuqia jonë duhet të shpenzohet për vepra të amshueshme e jo të përdoret për ngurtësinë e fronit... Shpirti është i fuqishëm... Shpirti është i thellë... Thellësive të tilla duhet të ecet...

Megjithatë, meditimi ishte një e realiteti tjetër...

Për herë të parë i erdhi keq që nuk kishte menduar më shtruar për këto çështje, në mënyrë që t'u bënte ballë sa më mirë të papriturave për të cilat nuk e kishte çarë ko-

kën asnjëherë. Duke iu dhënë poezisë dhe filozofisë, kishte harruar se gjendej në një botë e cila kishte ligjësitë e saj të ashpëra, të pamëshirshme dhe të njëtrajtshme. Në kokë i kishin valëzuar gjërat pa shtrembërime dhe pa prapaskena dhe asnjëherë nuk e kishte hetuar atë njëmendësinë jetësore, ku shpesh mjafton vetëm një rastisje e vogël që gjërat të marrin kahe tjetër, krejtësisht tjetër nga ato që parashikohen... A nuk e vërtetonte këtë e dhëna se vetëm pse ishte nga soji i Qyprillinjve duhej t'i nënshtrohej pushtetit dhe ta linte manash poezinë dhe artin që e donte aq shumë?

Pa dëshirë zuri të mendonte shtruar se ç'kahe do të kishte jeta e tij po të mos ishte Qyprillinjas? Aty për aty iu shfaq një fushë e gjerë plot luleshqerra. Në atë fushë mund të bridhte e mund të bridhte duke ndjekur ligjërimin e zogjve të shumtë. Aty mund të shkrryhej, mund të çirrej e mund të shkruante edhe vargje dhe të mendonte shtruar për të gjitha gjërat... Hyri në atë fushë dhe nisi të merrte frymë lirisht. I bëhej se ishte njeriu më i lumtur në botë. Por, ç'e do që edhe aty, pas pak, dikush po ia këputste luleshqerrat. Ato shtriheshin të vyshkura e të ndrydhura. Kush ishte ai që po ia shkatërronte botën që mezi e gjeti?

Më vonë u kthye kah mendimet e pakmëparshme, kah ato që kishin të bënin me rastisjen. Po çfarë do të ngjante, mendoi, po qe se i ati do të jetonte gjatë, shumë gjatë? Apo, të ishte e mundur që ai të mos vdiste fare? Mendime të tilla e dëshpëruan edhe më shumë. Asgjë nuk më ndihmon tha dhe deshi ta harronte kohën që e kishte lënë pas. Dyzet ditë... Dyzet ditë... A mjaftojnë vetëm aq sosh që të plotësohet një jetë e tërë? Dyzet ditë... dyzet ditë... Pak apo shumë? Nganjëherë kalojnë si të mos ishin, e nganjëherë duken sa shekujt...

Për herë të parë zuri të mendonte për kohën si kuptim dhe për shtrirjen e saj brenda dhe jashtë njeriut. Ç'ishte në të vërtetë koha? Pjesë e njeriut (pra edhe e tij) apo njeriu ishte pjesë e kohës (pra ai t'i takonte një hapësire më të gjerë)? Në një çast përfundoi se mund të ishte edhe e para e edhe e dyta. Pra, mund të thuhej se koha ishte vetë njeriu dhe në të njëjtën kohë njeriu është pjesë e kohës...

Megjithatë, ky farë pajtimi iu duk i mangët, i përdhunshëm dhe shumë konvencional. Edhe pse në të vërtetë ndonjëherë mund të merrej si i pranueshëm... Koha si kuptim, mendoi, vlen dhe qëndron vetëm si pjesë e njeriut, në njeriun dhe për njeriun... Asesi ndryshe... Asesi ndryshe... Brenda-përbrenda këtij përkufizimi po e kërkonte veten. Ku jam unë? — tha. Ku jam?... Nëpër kokë zuri t'i lëkundej lavjerësi i kohës duke matur çastet, orët, ditët, javët deri sa u ndal te dyzetëditëshi. Aty mbeti dhe nuk lëvizi më. Ajo ngecje i erdhi si kërcënim trishtues. Iu duk aq e rëndë sa aty për aty deshi t'i shporrte këto mendime dhe t'i jepej plogështisë shpirtërore si të vetmit ilaç për kotësi. Mbase do t'i jepej plogështisë, por ndjeu një si thirrje të brendshme që po i thoshte se koha megjithatë nuk ndalet... Ajo është në njeriun dhe për njeriun... Njëmend? Njëmend? pështëriti gjithë dëshpërim, nuk bën të pranohet ngecja e lavjerësit të kohës në një numër, pa marrë parasysh se në cilin ndalet... Dhe aty për aty u bë se lavjerësi ecte. Orët, ditët, javët dhe vjetët rridhnin... Në të vërtetë, në atë rrjedhë ai kuptoi se po ecte koha e tij dhe duke ecur e kërkonte të tërin... Por si do ta bënte këtë kur ishte tjetërsuar? Kur duhej të hiqte dorë nga qenia e vet? Si? Si... Iu duk se ashtu pajtohej me përkufizimin tjetër «se njeriu ishte pjesë e kohës...» Pra, që i takonte një shtrirje më të gjerë, e cila mund të zbërthehej pastaj më hollësisht si kohecje apo kohë-kohë... Sipas kësaj ai duhej që brendapërbrenda asaj kohë-kohe të caktuar të nxirrte atë që ishte e mundur ta nxirrte për t'u kënaqur me bindjen se megjithatë kishte bërë diçka... Ky iu duk mashtrim i pashembullt, ngase së pari hiqte dorë nga individualiteti e, së dyti, e pranonte vulën e kohës si të patjetërsueshme... Me këtë e pranonte nënshtrimin shpirtëror dhe fizik... Kjo e rrëqethi. U dëshpërua aq shumë sa i erdhi keq pse u mor me atë mendim. Tekefundit, — pështëriti pasi theu gishtat gjatë, — tekefundit ç'kuptim ka ta vrasësh kokën me gjithfarë gjërash kur nuk të mbetet tjetër pos të pranosh urdhrin e tjetrit...

Kur doli nga Saraji i praruar, pa se dita ishte në të sosur. Këtë e mori vesh prej hijes së vet e cila po i rritej

e po i rritej përpara dhe ai po e ndiqte atë pa ditur se pse po e bënte këtë. Eci e eci ashtu pas hijes së vet (e cila disa herë iu ngatërrua me të tjerat sa në një çast pa se ajo po thyhej nëpër disa shkallë të njohura, se pas pak po i zvogëlohej e po i zvogëlohej sikur të dëshironte të lirohej nga përmasat e rreme e t'i kthehej njëmendësisë. Hija u ndal përpara një dere që u hap ngadalë dhe ai pa se gjendej para Dhomës së kronikës.

Një copë herë mbeti aty si i ngrirë. Pse vallë hija e solli pikërisht në atë vend ku gjithnjë e pritnin shikimet e ngrira të portreteve në mur? Që të mendonte më shtruar për ca gjëra para se të sillte çfarëdo vendimi, apo, ndonjë pjesë i ishte hamendur dhe mendonte se ballafaqimi me sojin e vet do ta kthente nga fillimi i njëmendët? A mos kishte vallë në atë dhomë të ftohtë diçka që do t'i ndihmonte t'ia lidhte shkëputjen jetës së tij midis njëzet e tri vjetëve të shkuara (që i bëheshin si të huaja) dhe asaj që do të vinte pas dyzetëditëshit (që s'i përkiste atij)?

Jo, jo, pëshpëriti, jo, jo... Edhe dyzet e dy vjet, edhe dyqind e dyzet e dy vjet apo dymijë e dyzet e dy vjet të tjera nuk mjaftonin që pjesë të tilla të lidheshin... Jo. Jo. Ishte i bindur se pushteti nuk ishte gjë tjetër pos një imponim i dhunshëm, që pakica ia bën shumicës. Pushteti është dhunë... Dhunë... Dhunë dhe asgjë tjetër... Këtë mendim e kishte pasur gjithmonë... Më kot ishte munduar Hajredini plak, njëri prej këshilltarëve më të mirë të t'et ta bindte se ajo që thoshte për pushtetin në të vërtetë ishte vetëm një ikje në vetvete. Ikja në vetvete, i thoshte plaku, nuk është kurrfarë ilaçi që gjërat të ndryshohen për të mirë... Përkundrazi, plaku i kishte thënë se mendimet e të pakënaqurve mund të bëhen të dobishme po qe se prej tyre nxirren mësime të mira... Pushteti njëmend mund të bëhet, siç e përshkruajnë dhe e shohin mendimtarët e skajshëm, nëse nuk i ndihmojmë që t'i shprehë synimet e shumicës... Pushteti do ndihmuar pareshtur që të mos marrë nën udhë... Këtë duhet ta bëjnë të dijshmit... Do gjetur gjuhë të përbashkët me të... Po të bëhet kjo, atëherë pushteti i afrohet masës, në të kundërtën ai tjetërsohet në atë masë sa bëhet i

padurueshëm... Është gjë e tmerrshme kur pushteti mbrohet nga njerëzit dhe njerëzit mbrohen nga pushteti... Kjo nuk duhet të lejohet...

Pastaj plaku i thoshte: pushtetin mund të mos e duash, por, mos pandeh se ai është i panevojshëm, biro. Gabon rëndë. Mendime të tilla të sjellin huti dhe një ditë mund të humbësh në ndonjë mjegullim të pafund nga i cili nuk mund të lirohesh kurrë... Pushteti është si demi i egër... Zbute aq sa është e mundur të zbutet... Mos e lejo që të egërsohet... Prandaj, a nuk është më mirë që botën të mos e lësh në brirët e demit të egër?... Çfarë do të bëhej po qe se ky dem prore do të mbetej i tillë? Ta shikosh me egërsi edhe ai të shikon me egërsi. Madje, të sulmon... Më mirë përkëdhele dhe zbute... Ndryshe nuk bën... Nuk bën...

Sa herë që plaku i fliste kështu, i kthehej poezisë dhe mendimit i cili do t'i ndihmonte për të krijuar një mburojë të fuqishme kundër brirëve të demit të egërsuar. Kishte thurur një mori vargjesh në të cilat tërhiqej paralelja figurative, në formë të metaforës, midis bririt në njërën anë dhe demit të egër në anën tjetër... Bota në brirët e demit... Bota në brirë... Demi... Demi i egërsuar... Ç'metaforë e bukur? Ç'llahtari e madhërishme? Bota dhe brirët... Pastaj demi i egërsuar që bie ndesh me gjithë botën... Po mburoja e tij çfarë duhej të ishte? Do t'u bënte ballë, vallë brirëve të fuqishëm?... Ç'forcë mund të kenë metaforat, figurat, vargjet, strofat dhe mendimi i ndërlidhur në to?... Mburoja po rritej e po rritej e po kthehej në një mur të madh, i cili po e ndante nga pjesa tjetër e botës. Ai mur tash shihej dhe u bënte në sy të gjithëve, madje edhe demit të egër, i cili përgjonte se çfarë bënin të tjerët... Mbyllja prapa murit të tij i ra në sy edhe të ei, i cili kërkoi që ai të dilte sa më parë prej fortesës së çuditshme që i kishte ngritur vetes për t'u mbrojtur nga të tjerët. Në fillim solli mjekë, e më vonë gjithfarë këshilltarësh bashkë me shpjegues të shenjave, me qëllim që t'i ndihmonin. Ca prej tyre bisedonin me të shtruar për të gjitha, duke e dëgjuar me vëmendje dhe duke mos dhënë kurrfarë shkasesh që ai të mendonte se ata vinin me qëllime të këqija. Ca të tjerë i përcillnin

jo vetëm ato që thoshte, por edhe ato që shkruante. Kur i kaloi të shtatëmbëdhjetat moria e përcjellësve dhe e atyre që e përgjonin nga secili kënd, e lanë paksa të qetë. Kjo e gëzoi, edhe pse ishte i bindur se të tillët asnjëherë nuk do t'i hiqen qafe... Vetëm pyetjet marroçe i kam zët, thoshte. Vetëm ato të mos m'i thonë orë e çast...

I vetmi njeri me të cilin bisedonte me dëshirë ishte Hajredini plak, të cilin zuri ta donte. Edhe pse i fliste për gjërat me të cilat nuk pajtohej, ndjente dëshirë që ndonjëherë ta kishte pranë, t'i fliste me maturinë që e shquante e ai t'ia recitonte vargjet që i shkruante vetë dhe ato që i pëlqenin nga poetët e mëdhenj... Ja pse e dua poezinë, i thoshte plakut, kur zhytej në të... Pa të do të ndjehesha i paqenë dhe i varfër... Pa të nuk më bëhet të jetoj... Pa të bota është e zbrazët dhe e tmerrshme... Plaku e dëgjonte me vëmendje. Jo rrallë ia përmirësonte theksin, për të cilin i thoshte se duhej të tregonte më shumë kujdes. Pajtohem se theksi më qet telashe, i kishte thënë Plakut, por vërejtjet që më bën janë formale dhe mund të merren si manira të pushtetit, pra të pushtetmbajtësve. Theksi ka të bëjë me përkufizimin e lirisë së shprehjes... Plaku i pat kundërshtuar me shpoti dhe i pati thënë se nuk është fjala për kurrfarë deformimi profesional dhe formalizëm pushtetmbajtës, por për çështjen e një prirjeje të qëndrueshme kah rregullsia, e cila është e domosdoshme për secilin krijues... Plaku i pat zënë ngojë punën e rimave, të cilat, po qe se shpjegohen nga ana formale, nuk janë gjë tjetër pos përkufizim i theksuar në shërbim të një rregullsie të domosdoshme. Çfarë anarkie do të mbretëronte në poezi, po qe se rimat nuk do të ekzistonin? Apo sikur rimat të viheshin aty ku nuk e kanë vendin? A mund të ketë poezi të mirë pa rima? Dhe, po qe se për poezinë thuhet pareshtur se i duhen rimat, mos do të thotë se kjo është rregullsi e pushtetshme?... Kjo është tjetër, i pati kundërshtuar plakut. Rimat njëmend duken në të parë si mbërthime të domosdoshme, e ndonjëherë edhe të dhunshme, që vihen në shërbim të një tingëllimi të bukur dhe të natyrshëm, por pikërisht pse janë të tilla, ato shprehin të kundërtën, pra atë harmoninë që i takon lirisë...

Biseda të tilla rëndom përfundonin me çështjen e demit dhe me zbutjen e tij. Plaku nuk harronte që bisedën ta mbyllte me fjalët: demin bëje për vete, se bota mund të mbetet pastaj në brirët e tij të ashpër...

Dikur filloi të mendonte shtruar për refrenin e plakut që e dëgjonte çdo ditë pas bisedave të gjata që bënin për artin. Ç'ishte, vallë ajo që po e ngashnjente kah një mendimi të tillë? Logjika tjetër apo zbutja e tij (që do të merrej si meritë e plakut)? Jo. Jo. Nuk ishte as e para e as e dyta. Fjala ishte për hamendje të vogla të cilat i takojnë mendimit të lirë. Të hamendesh, i kishte thënë plakut, nuk do të thotë se heq dorë nga mendimi yt. Përkundrazi, hamendja është veçori e gjerësisë dhe e thellësisë... Kjo po më pëlqen, i kishte thënë plaku dhe prapë ia kishte përsëritur refrenin për demin e egër dhe botën në brirët e tij. Në të vërtetë, i kishte thënë plaku gjithë urtësi, tash po bindem se ne të dy kemi një mendim, pra të njëjtin mendim, por që rrugët tona deri te ai mendim shkojnë anëve të ndryshme.

Këto qenë fjalët e fundit të plakut. Pas ca ditësh mori vesh se ai kishte vdekur. E gjetën pa jetë me një libër në dorë. Më vonë mori vesh se ai qe libri gjysmë i ndaluar i Lutfi Pashës, me mendimet e të cilit u mor një kohë të gjatë dhe mbase ishte i vetmi burrë shteti te i cili e kishte hetuar thellësinë e mendimit, tolerancën dhe prirjen e jashtëzakonshme për art. Për mendimet e Lutfi Pashës disa herë kishte biseduar me plakun. I erdhi mirë që ai nga kjo botë ishte ndarë me diçka të vlefshme. Froni i lartë nuk mund të bëhet pengesë për t'u bërë mendimtar dhe poet i mirë, i thoshte plaku dhe e zinte ngojë Lutfi Pashën dhe veprën e tij... E qartë, i thoshte plakut, e qartë. Por Lutfi Pashai mbeti as andej as këndej. Pikërisht pushteti e shkatërroi atë dhe veprën e tij. Ai e pa fare mirë se janë ca gjëra që nuk pajtohen kurrsesi, siç janë bindja dhe veprimi jashtë bindjes. A nuk na bën me dije pikërisht vepra e tij e ndritur se persiatja dhe prirja e vazhdueshme kah mendimi i ndritshëm dhe i pafund duhet ta fisnikërojë njeriun në atë masë që ai gjithnjë të ketë një mendim dhe jo dy apo më shumë sosh, të cilët do t'i ndërronte sipas situatave të caktuara?

Lutfi Pashai thoshte se nuk ka gjë më të rëndë, më të dhimbshme dhe më të kobshme se morali i dyfishtë... Bashkëjetesa e dy apo më shumë moraleve brenda për brenda një individi, është plaga dhe fatkeqësia më e madhe e individit dhe e shoqërisë. Ngase edhe individi, e edhe shoqëria, luftojnë pareshtur kundër njëri-tjetrit, por që këtë luftë mundohen ta fshehin. Mundohen ta lustrojnë me fraza përderisa gjenden sy më sy me njëri-tjetrin. Pastaj, individi prapë mendon ndryshe për pushtetin, e pushteti po ashtu mendon ndryshe për individin... Morali i dyfishtë është shëmtim. Shoqëria që jeton me moral të dyfishtë është më e degjeneruar dhe në esencë më e pabarabarta... Nuk do mend se qenë këto mendime që Lutfi Pashain e radhitën ndër burrështetasit e rëndësishëm të perandorisë, emri i të cilit zihet ngojë si me zor, apo shpesh kalohet nëpër të. ndërsa vepra e tij mbeti thuajse e ndaluar (edhe pse kundër saj nuk u lëshua kurrfarë fermani i ndalesës). Fakti se nuk ribotohen, se gjenden të mbyllura dhe nuk komunikojnë me të tjerët, tregon se ato qenë dhe mbetën të papranueshme... Edhe unë them se ajo vepër ishte e madhe, por e pakryer dhe, ç'është më keq, tash e padëshirueshme... Pushteti nuk do të lejojë t'i përsëriten Lutfi Pashatë. Jo, jo... Nuk do të lejojë, i tha plakut, që mendime të tilla të thuhen prej njeriut të parë të pushtetit, prej vetë pushtetudhëheqësit, i cili e pa aq thellë konfliktin midis moralit të rremë dhe moralit të njëmend... Plaku megjithatë nuk hiqte dorë. Ia përsëriste refrenet për demin dhe botën në brirët e tij. Lutfi Pashai, megjithatë, deshi t'ia shkurtonte brirët demit... Pashai i ndritur ishte shumë afër që demit brirët e mprehtë t'ia bënte të butë për të ardhur pastaj një tjetër i cili mund ta linte fare pa brirë... A nuk mund ta vazhdosh ti ku mbeti ai...?

Me vdekjen e plakut iu bë se humbi lidhjen e vetme dhe të fundit me botën që e rrethonte. Sa më shumë që kalonte koha, ndjente se afërsia e tyre njëmend kishte qenë e madhe, më e madhe sesa mendonte. Ajo kishte plotësuar shumëçka të jetës së tij, mbase pjesën më të rëndësishme, atë të lidhjes shpirtërore me pjesët që po i bëheshin gjithnjë më të huaja... Tash kur gjendej i vetmuar, në prakun

e Dhomës së kronikës, ndjeu dëshirë të ofshme ta kishte pranë plakun. Ndoshta plaku i urtë do t'i thoshte diçka që do ta ngushëllonte (sado që ngushëllimin nuk e pranonte)? Mbase do t'i fliste për demin me brirë të mprehtë dhe do të ndryshonte diçka nga refreni i tij i dashur? Ajo dëshirë po i kthehej në etje, në një etje të flakët... Në një çast, bile, iu bë se po dëgjonte zërin e plakut dhe ai zë po shkëputej diku nga brendia e vet... Ç'ishte ajo përzjerje e qenies së tij me një tjetër? A thua po i shembej ajo për të cilën kishte menduar se ishte e parrënueshme? Zëri, që herë i dukej si i plakut, e herë i vinte si i veti, tash po i shfaqej si i papërcaktuar mirë, e të papërcaktuara ishin edhe ato që po ndjente. O zot, ofshau, ç'është ajo shthurje? Mos filloi koha e dyzet ditëve, koha për t'u shkëputur nga vetvetja?... Iu bë se ai zëri tjetër, që s'e dinte a ishte i tij, i plakut apo i dikujt tjetër, po i vinte si qeshje e përzier me ca fjalë të shkëputura që nuk i kuptonte... Fjalët e shkëputura e të përziera me pjesët e të qeshurave, krijonin një thekamë. Patjetër se po zbrazem, tha... Po bëhem i paqenë... Po ndahem nga vetvetja... Po shkëputem nga ajo që më ushqeu aq gjatë.. Po futem në kohën e dyzetditëshit... Në kohën e harresës... Në kohën e të tjerëve... Në kohën e pakohë... Medet!

Fjala kohë pa kohë po i sillej vërdallë dhe po i përplasej herë si kokë e herë si kohë... Një çast ishte i bindur se dëgjonte një përsëritje të thekshme në të cilën spikatej vetëm fjala «kokëëë... kokëëëë...»

Kokat! Kokat! — po çirrej. Ku i kemi kokat? Ku? Ajo kuku e ngjizur po i kthehej në një kukamë. Kukuja po e sulmonte. Dhe ai mendoi se po ikte, se po ikte në një rreth të njëjtë, ku prapë shihte njerëz pa koka, ku çdo gjë i shfaqej e pakokë... Dikur iu bë se u rrëzua, se sharroi në një errësirë, se ajo errësirë e mori me vete, se u bë pjesë e një katrahure të tmerrshme...

Kur u zgjua pa se gjendej në Dhomën e kronikës. Ndjeu rraskapitje të paparë. Koka i vinte si bjeshkë. Dhe aty për aty deshi t'i jepej prapë harrimit. Deshi të futej në atë katrahurën, i bindur se duhej të pastrohej përmes sprovave të rë-

nda. Kur deshi t'i mbyllte sytë për të mos i hapur më, ndjeu një zë që po i thoshte:

«Do të jetosh me vetminë tonë...»

E ngriti kokën përtueshëm për të parë se kush ia tha atë fjalë, por pa se ishte vetëm, fillikat vetëm, i rrethuar nga portretet në mur. Jehona e atyre fjalëve ende po i vinte si dridhërimë. Prapë shikoi portretet, duke e kaluar vështrimin prej njërit në tjetrin. Por kryevezirët rrinin të heshtur si mumje. E ftohtë iu duk edhe pamja e të et, i cili tashmë rrinte në pjesën e skajshme, pas shtatëshes së pandashme. Të gjithë janë të njëjtë, mendoi, të gjithë... Duken si të përsëritshëm, si një qenie që shkapërderdhet nëpër shumë vende... Mos vallë jam edhe unë i tillë? Ky mendim e ligështoi aq sa hoqi dorë nga çfarëdo përsiatjeje. Deshi të zhytej në plogështinë e vet, por ja sërish zëri i pakmëparshëm po i thoshte:

«Do të jetosh me vetminë tonë të madhe...»

Pak më vonë, po ai zë i tha edhe këto:

«Këtu nuk ka mezokohë... Nuk ka mezokohë... Është vetëm koha e vetmisë së amshueshme...»

Fjala mezokohë i tingëlloi butë. Nuk e kuptoi pse ajo fjalë iu duk e afërt? Nuk paska kohë të mesit, apo mesokohë, mendoi... Nuk ekzistuaka koha që lidh pakohësinë... Ajo nuk do t'i rrijë mbi kokë si lavjerësi për t'ia matur çastet, orët, ditët... Përfundimisht shlyhej kufiri i kohësisë së quajtur kohëpakohë dhe fillon përsiatja e pafund ku gjithçka mbetet e njëjtë dhe e amshueshme... Sa mirë... Sa mirë, mendoi... Sa mirë... Do t'i jepem poezisë... Do të bëhem varg... Do të kthehem në metaforë... Do të kthehem në mendim që mbetet midis mendimeve... Do të merrem me të madhërishmen... Sa mirë... Sa mirë...

Fjalën «sa mirë» tash po ia thoshte jo vetëm goja, por po ia thoshte edhe fytyra, po ia thoshin edhe sytë, po ia thoshin edhe veshët po ia thoshte i gjithë trupi, po ia thoshte e gjithë qenia, ajo qenie për të cilën pak më parë mendonte se e kishte lënë...

I ngashnjyer si fëmija që mashtrohet me ndonjë lodër, të cilën kaherë e ka pritur, u ul në fotelen e madhe dhe zuri

të sillte në kokë sërish vargjet e poetit Jahja Dukagjin Zadës për fisnikërimin e shpirtit:

«Ndiqe dritën e qiririt,
flakën e tij shndërro në parafytyrim të përhershëm...»

Një copë herë i përsëriti këto vargje derisa ndjeu se u qetësua fare... Kur po binte terri, zëri që i pati folur për vetminë, tash po i fliste në vargje:

«Një vetmi,
shumë vetmi...
vetmia,
Vetmia e përbashkët...»

Ç'ishte vallë ajo vetmia e përbashkët që i vinte si refren? A nuk ishte ajo një si përzierje nga vetmitë personale? Këtë deshi ta thoshte zëshëm, por zëri që ishte më i shkathët i tha:

«Çdo gjë është e përbashkët... Të veçantat e krijojnë të përbashktën... E veçanta jashtë të përbashktës është e pavlefshme... Është e pavlefshme...»

E veçanta?.. Një kohë të gjatë ato fjalë ia përsëriti brendia e vet, ajo brendi që mund t'i shpalonte edhe thellësitë që vështirë njihen... Mos do të thotë zhytje në shumëqenësinë e ndërsjellë në të cilën vetjekja e humb ngjyrën e vet për ta marrë pastaj atë shumëngjyrësinë e përgjithshme, e cila atij gjithnjë i është shfaqur si e pangjyrë? Këtë dilemë deshi ta thoshte zëshëm, por hetoi se kishte sharruar në një shurdhim të thellë. Goja i qe marrë e mendimet po i ngriheshin...

Një copë herë u mundua të fliste, por nuk mundi t'i thoshte fare ato që ia thurte mendja.

Dikur pa se kornizat po lëviznin. Portretet në mur po largoheshin nga vendet e tyre dhe po i uleshin përpara. E rrethuan dhe po e shikonin butësisht. Përpara mbanin librat e trashë dhe i shfletonin me përtesë. Hetoi se fletët e atyre librave ishin të vrugta dhe me gjithfarë shkronjash lakadredhe. Pas atij shfletimi, i pari Mehmeti la librin mënjanë dhe tha:

«... malli djeg më shumë se zjarri... Nuk ka gjë që përvëlon si ai... Malli është si zjarri... Malli përvëlon...

Mua më përvëloi shumë kohë... Më përvëloi edhe kur ecja, më përvëloi edhe kur luftoja, më përvëloi edhe kur kaluroja nëpër vendet e largëta, e ai përvëlim më shfaqej edhe në gjumë, si ëndërr e përsëritshme... Vendin tim nuk e harroja fare... Sa më larg tij, aq më afër më rrinte. I përfytyroja një mijë dritaret. Nga ato shpërthenin pareshtur një mijë lule shumëngjyrëshe... Ai mall përvëlues ma forconte besimin se duhej t'i përballoja që të gjitha pengesat në mënyrë që një ditë t'i kthehesha vendlindjes sime si i fuqishëm... Kur më shfaqeshin një mijë dritaret, atëherë gjunjëzoja çfarëdo armiku, sado i madh që ishte. Fuqia ime bëhej e jashtëzakonshme kur më shkonte mendja te dritaret e vendlindjes... Edhe më vonë, kur zura të fitoja nishane, gjithnjë i përshpërisja vetes se ato u takonin njëmijë dritareve të mija... Për to hyja në luftë dhe për to derdhja gjak... Ç'kuptim do të kishte jeta ime pa atë përfytyrim të madhërishëm. Dhe kur u bëra vezir, pas njëzet vjet bredhjesh e luftimesh, vendosa t'u kthehesha një mijë dritareve të vendlindjes sime, t'i falënderoja për fuqinë që më kishin dhënë ato. Atëbotë më kaploi një dridhërimë e çuditshme. Do të jenë, vallë, po ato dritare që ishin në përfytyrimet e mia? Në gjysmë të rrugës pashë një ëndërr të jashtëzakonshme: vendlindja m'u shfaq pa dritare... Në vend të tyre kisha gjithfarë therrash në të cilat pushonin zogjtë e zez... Perëndi, thashë, kur u zgjova nga gjumi, po c'ankth i rëndë që më paska mundur? Me ngut e pyeta shpjeguesin e ëndrrave se ç'domethënie kishte ajo ëndërr? Ai më shikoi ftohtë, bëri ca lëvizje kah dielli dhe më tha se duhej të kthehesim sa më parë... E shikova vëngër atë fytyrë të verdhë me sy të futur në gropat e thella dhe më shkoi mendja t'ia merrja aty për aty kokën. Sado që puna e donte të përmbahesha, nuk pata fuqi ta ndrydhja tërbimin që më shpërtheu si vullkan. Pse? Pse të kthehemi? zura të çirresha. Nuk ka gjë që ma kthen rrugën time! Nuk ka gjë! Këtë rrugë e kam bartur në shpirt me vite të tëra! Kjo është rruga ime më e rëndësishme... Me të nuk maten të tjerat, madje as ato fitimtaret... A e ke të qartë?

E ai, si mumja që ishte (bile m'u bë se prej tij po fliste

një shpirt kaherë i ikur) më tha: atje Madhëri ka sëmundje..

— Ç'sëmundje është ajo që mund të ma kthejë rrugën? Nuk ka të tillë, i thashë.

— Është sëmundje e tmerrshme, Madhëri... Nuk është sëmundje si çdo sëmundje tjetër...

— Cfarë? Çfarë? Pa më thuaj se plasa?

— Është murtajë. Shenjat më thonë se mund të jetë murtajë. Këtë do ta marrim vesh së shpejti... Unë merrem me shenja, Madhëri, dhe më ndje po qe se shenjat i shpjegoj si duhet... Këtë e kam për detyrë...

Tjetër gjë nuk tha.

E unë atë natë përfytyrova lule të vyshkura, shumë lule të vyshkura nëpër një mijë dritaret e vendlindjes sime... Lulet dukeshin të zeza. Hapnin gonxhe të zeza. Nga ato gonxhe hapeshin ca miza që shumoheshin shpejt dhe kthehesin në re të zeza, të cilat pastaj e mbulonin qiellin...

Në mëngjes, laimëtarët më thanë se murtaja e kishte kapluar Tokën e lashtë tash disa javë. Vdekja ka zënë vend. Madhëri, në atë vend, më thanë ata gjithë shqetësim... Shumë shtëpi janë shuar, e po shuhen fshatra dhe vendbanime të tëra... Morti i vdekjes bredh në ato anë ditë e natë dhe dhashtë zoti të mbetet vetëm atje... Janë marrë të gjitha masat që vendi të shkëputet përfundimisht nga bota, përderisa sëmundja të largohet...

Atë cast preka shpatën dhe po bëhesha gati që tehun e saj të hollë ta futja në zemër. Cfarë më duhej jeta pa një mijë dritaret e vendit tim? A thua kot më kishte përvëluar ai malli për të aq gjatë?... Mbase do ta gjykoja veten rëndë, po të mos kisha dëgjuar një zë që më tha: ndal! Ke edhe për të bërë... Kujtimin e vendit tënd mund ta nderosh po qe se ngjitesh lart e më lart... Vetëm ashtu ia lan hakun... vetëm ashtu: : :

Gjatë më foli ai zë dhe unë nuk e dija se nga më erdhi: nga thellësia ime apo nga jashtë?

Desha t'i flisja për murtajën. Desha t'i thosha se një mijë dritaret e mia nuk ishin më. Desha t'i tregoja se në vend të tyre kishte therra, por zëri që po më ngushëllonte më tha: Jeta do të ringjallet... ka pasur edhe më parë mur-

tajë... Nuk është as e para, as e fundit... Megjithatë jeni përtëritur shpejt... Kjo është pjesë e ekzistencës suaj...

O zot, thashë, sëmundja pjesë e ekzistencës? Vdekja e tmerrshme pjesë e ekzistencës? Po ç'është jeta? Koka po më ushtonte nga dilema të tilla. Në fund dëgjova urdhrin që më shpërthente nga brenda. Ai më tha: kthim nuk ka... Të pret froni më i lartë... Prapë u dëshpërova. Prej nga, vallë, kjo shtytje kaq e rreptë që po më udhëheq prej shumë kohësh? Nuk paska rrugë tjetër pos të përpjetëzës së domosdoshme?...

Këtë pyetje ia shtrova vetes shumë herë. Madje edhe kur u bëra Kryevezir dhe gjendesha në majë të majës së perandorisë së pafund...»

«Unë e di se ç'ishte ajo që të urdhëroi... E di... Gjatë u mora me të...»

Nimani ndjeu një zë të qetë, përkundër tjetrit që ishte i fortë dhe hove-hove i rrëmbyeshëm. Ishte Ahmet Pashai, që po i fërkonte sytë, sikur të kërkonte të shihte më mirë atë që e pandehu.

«Folë, Ahmet, — i tha Mehmeti. — Mbase ylli yt ishte më i qartë?...

Pas një heshtjeje të shkurtër Ahmet Pashai tha:

«Si thashë, giatë mendova për fatin tonë dhe për atë dyqindvietëshin që ishte si lidhje e diçkahes, por që unë nuk isha në gjendje ta kuptoja se ç'ishte ajo në të vërtetë? Dhe, për ta hequr mjegullimin që e bartnim me vete, i dhashë detyrë kronistit Selajdin që të giurmojë nëpër të giitha defteret, i thashë t'i shfletonte të giitha, regjistrat e mundshëm të perandorisë, i thashë të futej nëpër të giitha bibliotekat, i thashë të punonte në të giitha arkivat e të shkonte nëpër botë për të lidhur fillet e kronikës së familjes sonë. I thashë se nuk duhej t'i linte dy gurë bashkë nëpër t'i parë sa më mirë dhe sa më dreit giithë ato që kanë të bëinë me ne dhe që lidhen me të kaluarën tonë... Ke për detyrë, i thashë, që ta heqësh vellon e mjegullimit që na ka mbërthyer dhe po na i fsheh giurmët tash shumë kohë.

A nuk ishte kështu, Selajdin?»

«Fjala juaj, madhëri», tha ai që Nimanit iu bë se e kishte parë kohë më parë me ca libra të mbërthyer në shpinë,

e për të cilët ai i pati thënë se ishin kronika qindravjeçare. Fjalët e para ai i tha me aso sigurie sa ajo mjaftoi që ai aty për aty të lirohej i tëri prej tisit të mjegullës bashkë me librat që mbante në shpinë.

«Ky i uruar, vazhdoi Ahmet Pashai, — trembëdhjetë vjet rresht, ditë e natë, nuk e hoqi kokën nga librat, nga regjistrat, nga defterët, nga pergamenët, nga emblemat dhe nga gjithfarë shkrimesh të shpërndara në të katër anët e botës... Pas trembëdhjetë vjetësh, një ditë prej ditësh më tha se e kishte kryer urdhrin tim. Gjatë nuk e kisha parë dhe mbase e kisha harruar, atë fytyrë e cila m'u duk e dërrmuar. E shikova një copë herë dhe mezi lidha atë që koha ia kishte marrë me vete. Folë, — i thashë gjithë respekt, — folë. Kam shumë për të thënë, madhëri, shumë... Aq më mirë, i thashë, aq më mirë. Do të thotë se ke gjetur shumëçka? Ai pohoi me kokë dhe vetëm pasi i thashë prapë të fliste, nisi e tha:

... me urdhrin tuaj, madhëri, i mora në shqyrtim të gjitha dokumentet e perandorisë së re e të fuqishme, por shumë kohë u solla edhe në ato të perandorisë që e mundëm dhe të tjerave që nuk janë më. Sidomos m'u desh të sillem nëpër Bizant, ngase dera juaj si dhe gjithë Toka e Lashtë ishte shumë kohë në përbërjen e tij... Me ndihmën e të dhënave, madhëri, vërtetova se dera juaj gjithnjë kishte qenë e fortë, veçmas para dyqind e sa vjetësh... Dyqindvjetëshi që erdhi më pas, nuk ishte gjë tjetër pos një fashë e pakuptueshme, por edhe e mundimshme, kur nga bujarët, fisnikët dhe princat e dikurshëm, dalngadalë ratë, sa një ditë mbetët ushtarakë mesatarë ose qatipë të thieshtë... Dhe, po të mos ishte vendosmëria e pashembullt e Mehmet Pashë Qyprillisë, shumë shpejt do të humbnit në morinë e mijëra e mijëra qatipëve të tjerë të perandorisë, që nuk mund të shënohen me asgjë, as për të mirë e as për të keq... Të dhënat tregojnë se ju ishit nga një derë e fortë e Tokës së Lashtë, e cila gjatë gati shtatëqind vjetësh dha shumë bujarë, fisnikë madje edhe princa të fuqishëm. I pari që e hasa në kronikat e mocme ishte Princ Dhimitri. e i fundit princ Gjoni. Të parin e ngriti perandori i Bizantit Justini rreth vitit 520, ndërsa i fundit, Gjoni, pas vdekjes

së Kryeprincit, për trembëdhjetë vjet luftoi pareshtur në kështjellën e fundit. Perandori Kostandin, i cili po ashtu ishte nga Toka e lashtë, Dhimitrin e pati dorë të djathtë. Kur kishte nevojë, nga princi nxirrte ushtarë të përgatitur dhe i dërgonte në betejat vendimtare. Si shpërblim për këtë, Dhimitri ruajti mëvetësinë e derës princore, e cila kishte një themel të fortë edhe më parë, por që Roma e kishte rrënuar, ngase kishte frikë prej princave vendës. Te shekujt e Romës nuk shkova, pasi për këtë më duhej edhe shumë kohë që shumëçka të qartësohej, edhe pse kjo duhet bërë patjetër në mënyrë që hallkat tuaja të lidhen si duhet që nga kohët më të lashta...

Pra, unë u ndala te shtatë shekujt e fundit, te ajo kohë kur ndesha si të qartësuar fillet e derës suaj. Ma thotë mendja, madhëri, se duke filluar nga Kostandini i Dytë, Justini, Justiniani, Luani, Konstantini i katërt e deri te Komnenët, dera juaj princore qe e fuqishme. Kështu duket nga jashtë. Por në kohën e Luanit u dukën ca ngatërresa midis perandorit dhe princ Tanushit, që do të vazhdojnë edhe më tutje, por gjithnjë si të fshehura.

Tanushi, kuptova, në kështjellë kishte një poet që i thoshin Gropan. Ai, pos të tjerash, kishte zënë të hartonte në vargje histo:inë e derës suaj. Vargjet i shkruante me shkronja të tjera nga ato që lejonte perandoria e madhe. Ai thoshte se poema duhej të shkruhej në gjuhën e popullit. Nuk do lënë që gjuha të tëkurret e të tëkurret, por do përdorur sa më tepër... Gjuha perandorake ka për qëllim ta shfarosë gjuhën tonë, thoshte poeti. Nuk mjafton, thoshte ai, që kujtesën ta ushqejmë vetëm me këngë dhe tregime popullore. Ajo ka nevojë për shkronjat e veta, të cilat i pati dikur, por që perandoritë pushtuese ia mallkuan... Poeti pareshtur kishte folur për gjuhën dhe kishte thënë se herët a vonë do të themelonte një shkollë poetike, në të cilën do të mbizotëronte metrika e mirëfillët dhe do të shprehej gjithë ajo që krijoi shpirti gjatë shekujve... Për t'u bërë kjo, thoshte ai, duhet të hartohet edhe alfabeti vetjak...

Njerëzit e Luanit, të cilët gjendeshin kudo, madje edhe në qarqet më të besueshme të Princit vendës, me të shpejtë

e njoftuan Konstantinopojën dhe vetë Perandorin. I thanë se në Tokën e Lashtë kishte filluar të përhapej një herezi e rrezikshme, e cila po qe se do të merrte hov, do ta rrezikonte perandorinë në atë masë sa shumëçka e saj do të shembej furishëm... Lartmadhëri, i kishin thënë fanatikët e mësimeve perandorake, nëse bima e ligë nuk hiqet me rrënjë, vaj për ne. Do të fillojnë të çarat e para. Gjithçka mund të lejojmë, por që dikush në perandorinë tonë të thërrasë në ndihmë merimangat e veta, të cilat bien ndesh me shkronjat tona nuk do të lejojmë fare. Fare! Fare! Kulla jonë do të rrënohet dalëngadalë nga shkronjat e mallkuara kundër të cilave luftuam aq gjatë. Me shumë gjuhë, me shumë shkrime, me shumë alfabete, ne nuk do t'ia dalim që ta mbajmë të fortë vetëdijen perandorake për të cilën harxhuam aq shumë kohë. Shumëgjuhësia, shumëshkrimësia, shumëshprehësia dhe shumëkulturësia mund të kthehet në një sëmundje të pashërueshme, e cila perandorinë e fuqishme mund ta bëjë që të bjerë... Kjo nuk duhet të lejohet... Helmi i herezive të tillë është i madh... Shumë i madh... Shumë i madh.:. Andaj, lartmadhëri, shpallni sa më parë fushatën e shenjtë. Shpallni, po e deshi puna edhe kryqëzatën shpëtimtare. Nuk do të kursejmë gjë që herezinë ta çrrënjosim njëherë e mirë. Po e kërkoi puna, le të derdhet gjak. Për gjëra të tilla as gjaku nuk kursehet...

Dhe vetë Perandori u nis me ngut për në principatën e skajshme për të parë dhe për t'u bindur se në ç'masë ishte përhapur herezia e tmerrshme për të cilën i folën me aq frikë dhe shqetësim. Mori me vete ushtarakët më të zgjedhur dhe, mbi të gjitha, mori me vete një ushtri të madhe, të pajisur me armatimet më të reja. Hapi fjalë se po nisej të bënte një luftë të shenjtë, një luftë që nuk do të ishte si çdo luftë tjetër, por që prej saj varej fati i mëtutjeshëm i Perandorisë. Kronistëve u tha se ditën dhe datën e nisjes duhej ta shënonin si luftë për mbrojtjen e shpirtit dhe të frymës perandorake...

Princ Tanushi, i cili e dinte fare mirë se nuk kishte kaçik t'i shtinte brirët me perandorinë më të fortë të botës, bëri çka bëri dhe gjithë çështjen e rrudhi në njëfarë sha-

kaje të pakripë të një të çmenduri, të cilën armiqtë e Perandorisë e shfrytëzuan shumë për nevojat e veta. Bile, me rastin e pritjes madhështore që i bëri Perandorit, tha se falë asaj thashetheme, principatën e tij kishte nderin ta vizitonte perandori më i fuqishëm i botës. Po ta dinim se do të na vizitonte, atëherë do të shpifnim diçka edhe më të rëndë vetëm e vetëm të na nderosh.

Perandori kishte buzëqeshur thartë dhe mbase mbeti i kënaqur që Princi po i fliste në atë mënyrë. Gjatë gostisë së paparë që shtroi për Perandorin dhe për përcjellësit e tij, disa herë Tanushi i tha se dera e tij e respektonte pa masë perandorinë. Zuri ngojë viktimat e shumta që kishte bërë për të mbrojtur perandorinë dhe shprehu gatishmërinë që në krye të njësive të asaj elite të gjendeshin trimat e tij sa herë që këtë ta kërkonte puna. Pastaj, ia solli para të gjitha dokumentet dhe regjistrat, në të cilat shihej fare mirë se në Principatën e tij respektoheshin të dy shkrimet zyrtare që përdorte perandoria. Tutje kësaj norme nuk shkojmë, tha Princi...

Bile, për të hequr çdo dyshim, e për ta shpëtuar Principatën nga egërsia e fanatikëve perandorakë, princi solli në aheng vetë Gropanin dhe i tha të demonstronte ca pelivanllëqe dhe t'i thoshte ca hoka (natyrisht në gjuhën perandorake), që i bënë të shqvheshin nga gazi që të gjithë. Vetë Perandorit i shkuan lotët. Ja, Lartmadhëri, kush po e shqetësuaka perandorinë! Ja kush bëri që i madh e i vogël të ngrihej në këmbë. Ja kush bëri që ushtria më e madhe e botës të nisej kah ne... A mund ta rrezikojë, apo ta rrëzojë perandorinë tonë të fuqishme një palaço si ky? C'Perandori mund të jetë ajo që frikësohet nga palaçot? Nuk ma thotë mendja se iu e patët me giithë mendje... Jo, io, ishte kio vetëm një shaka. — i tha Princi Perandorit, dhe një copë herë qeshi me sa zë kishte.

Zyrtarisht giithçka mori fund mirë. Perandori i perandorisë më të madhe të botës ndenji disa ditë në Tokën e Lashtë. Kërkoi të vizitonte Urën e Shenjtë, shkoi deri rrëzë Pashtrikut për të parë ca burime të bardha dhe pastaj u kthye në Kryeqytet. Mori me vete ushtrinë e pafund dhe

hapi fjalë se fushata e shenjtë kishte qenë e suksesshme dhe e dobishme, në mos për tjetër, atëherë se i madh e i vogël, jo vetëm në Tokën e Lashtë, por tutje deri në Kryeqytet, e kishin parë forcën e perandorisë dhe ishin bindur se sa e gatshme ishte ajo të vepronte pa ngurrim ndaj secilës çështje, qoftë ajo edhe ndonjë shaka e pakripë, siç ishte ajo e fundit...

Por, madhëri, unë hasa të dhëna të tjera që flasin se puna e Gropanit dhe e poezisë së tij, sado që Princi bëri përpjekje ta paraqiste si një shaka të pakripë, e kishte tronditur perandorinë. Çështja e gjuhës popullore dhe e shkronjave vetjake kishte qenë gjithnjë plagë e hapur midis perandorisë dhe Tokës së Lashtë. Luani i tretë dhe perandorët e tjerë pas tij kishin nxjerrë dekrete të rrepta, herë zyrtare e herë gjysmëzyrtare, herë të maskuara me formulime të tjera e herë të drejtpërdrejta që mallkonin shkronjat dhe gjuhën e Tokës së lashtë. Kisha, e cila qysh në kohën e perandorit Justinian (i cili vinte po ashtu nga Toka e lashtë) u bë religjion shtetëror dhe mori mbi vete gjithë çështjet e shpirtit dhe të edukimit të njeriut të ri perandorak, pa marrë parasysh se në cilën anë të botës gjendej, nuk prajti duke e shprehur punën e poezisë së Gropanit. Jo zyrtarisht, merret vesh se me t'u kthyer Perandori në Konstantinopojë, shumë shpejt u mblodh Sinodi i madh dhe pas një shqyrtimi të fshehtë, mallkoi çdo përpjekje që shpinte kah përdorimi i shkronjave të tjera pos atyre perandorake. Po ashtu Sinodi i madh kishte urdhëruar hetuesit e vet (natyrisht atyre që maskoheshin me rrobat kishtare), që të përgjonin ditë e natë se mos po hapte kush herezinë e shkrimeve antibizantine. Klerikët kishin marrë aso urdhërash të prera që besimtarëve t'u flitnin për mëkatin e pashembëllt që shfaqej sa herë që dikush harronte shkronjat dhe mësimet kishtare... Ortodoksia është e shenjtë, thoshin klerikët e Konstantinopojës. Kush mendon ndryshe është heretik! Ortodoksia është shpëtimtarja e shpirtit... Ai që mendon ndryshe duhet të digjet në këtë botë dhe në atë botë... Flakini mësimet e tjera! Flakini shkronjat e djallit! Flakini ato që mund t'ju

mjegullojnë mendjet! Kthehuni vetëm kishës! Kisha është e gjithëfuqishme!

Klerikët futeshin nëpër kulla, nëpër kështjella dhe shkonin edhe në katundet e thella malore, të cilët jo vetëm që nuk merreshin më me punët e fesë, por u përziheshin drejtpërsëdrejti Princit dhe bujarëve në çështjet e brendshme, gjithnjë me pretekste të njohura «se ekzistonte rreziku nga herezia e re shpirtërore».

Me arsyetime të tilla, pos klerikëve, në Principatë erdhën edhe ekspeditat e shumta perandorake si dhe komisione të ndërduarta që futeshin ngado dhe nuk lenin dy gurë bashkë. Atbotë, qenë bërë arrestime të shumta, qenë mbyllur shumë veta nëpër kështjella të errëta, qenë zhdukur shumë e shumë veta, e çështë më keq, qenë djegur të gjitha librat që nuk ishin bizantine...

Hetuesit e shumtë, bashkë me klerikët fanatikë, e të përcjellë gjithnjë nga komisionet, nënkomisionet e mbikomisionet e pafund, futeshin nëpër të gjitha skutat dhe kërkonin dokumente. Kërkonin shkrime. Kërkonin pergamene. Kërkonin stema. Kërkonin emblemat e vjetra. Kërkonin piktura. Çmos kërkonin... I duam, thoshin, ato që po helmojnë shpirtin tuaj. I duam ato që po ju ushqejnë herezinë... I duam ato që po ju mjegullojnë kokën... I duam të gjitha ato që janë të rrezikshme për perandorinë...

Ato që i gjenin i merrnin dhe i futnin në arka të metalta dhe i dërgonin me ngut në kryeqytet.

Princ Tanushi me bujarë dhe fisnikë i shikonin gjithë helm sorollatjet e hetuesve, të kryehetuesve, mbihetuesve, të komisioneve, nënkomisioneve, mbikomisioneve dhe të tjerëve që hynin e dilnin në tokën e tij si t'u tekej. Ardhësit nga kryeqyteti nuk kërkonin leje për asgjë. Hynin nëpër të gjitha skutat dhe kurdisnin gjithfarë kurthesh në mënyrë që «herezinë shpirtërore» ta bënin sa më bindëse dhe ta tregonin sa më të përhapur... «Për ta marrë nëpër këmbë Princin dhe për të nxitur ndonjë revoltë të popullit, të cilën e dëshironin aq shumë që ta përdornin pastaj ushtrinë, hetuesit dhe klerikët burgosnin kë të donin. Ua bënin gjyqet pa pyetur autoritetet e principatës dhe të dënuarit i dërgo-

nin në pjesët e skajshme të perandorisë, ku miza brente hekur...

E ç'ishte më fyese për Princin dhe për bujarët e tij, ai, hetuesit dhe klerikët e panumërt nga kryeqyteti duhej t'i shoqëronte, t'u fliste fjalë të mira, t'i falënderonte jo rrallë dhe botërisht e t'u shtronte darka e dreka madhështore, në të cilat ai patjetër duhej të ngrinte dolli, ku thoshte të njëjtat fjalë kundër «herezisë vetjake» dhe të lëvdëronte perandorin dhe perandorinë, «që nuk kursenin gjë për ta mundur të ligën e madhe...» Në atë dolli ai duhej të zotohej se u mbetej besnik mësimeve të shenjta perandorake dhe duhej të shprehte gatishmërinë se do të vdiste për të në çdo kohë...

Në të vërtetë Princi i shkretë e dinte fare mirë sa i pafuqishëm ishte dhe sa po e merrnin nëpër këmbë. E dinte se kishte mbetur vetëm një hije. E dinte se e vetmja gjë që mund të bënte ishte që të luftonte kundër vetvetes... Ai e dinte se çfarë thoshin klerikët nëpër kisha. E dinte si ia mallkonin gjuhën. E dinte si ia mallkonin shpirtin. E dinte sesi treteshin dokumentet më të rëndësishme dhe shkonin atje prej nga do të zhdukeshin apo do të dallashoheshin sipas nevojës së perandorisë... E dinte se çfarë bënin komisionet, nënkomisionet, mbikomisionet, kryekomisionet, shqyrtuesit, zhvleftësuesit e kontratave dhe të tjerët që shkonin me këtë mori të pafund të nënpunësve... Të gjitha i dinte, e megjithatë duhej të shtirej se gjithçka që ndërmerrej bëhej për të mirën e tij dhe të Principatës! Nga dëshpërimi kërcëllinte dhëmbët dhe kafshonte gjuhën sa i kullonte gjak. Sillej si hije dhe mundohej të mos u jepte kurrfarë shkasesh fanatikëve të tërbuar, të cilët kërkonin ta derdhnin tërbimin e tyre njëherë e mirë mbi Tokën e lashtë, me qëllim që, siç thuhet në një dokument të asaj kohe «... të bëhej pastrimi i përgjithshëm... Një pastrim i domosdoshëm për të hequr herezinë e mallkuar e cila gjithnjë është e gatshme të ngrehë krye kundër perandorisë, sapo të hetojë çastin...» Kësaj i dronte Princi dhe gëlltiste helm kur duhej të ngrinte dolli për perandorin dhe perandorinë, të cilën me dëshirë do ta bënte vezë për ta thyer.Megjithatë Princi mendonte se po

qe se atëbotë principata i shpëtonte ndonjë fushate të tmerrshme (pa marrë parasysh viktimat e shumta dhe nënçmimin që i bëhej err e terr), do të ruhej bërthama e mëvetësimit? Ai sa nuk u thoshte bujarëve të vet kur i ankoheshin për ato që ngjanin: heshtni! Gropanët tanë ngjallen shpejt...

Mendja ma thotë se këtë e kishte të qartë edhe kleri fanatik kur kërkonte fushatë të domosdoshme. Ata ishin të bindur se Gropani rronte, se Princi e kishte mashtruar Perandorin dhe koha megjithatë, pa marrë parasysh viktimat që pësonte, punonte për Tokën e lashtë. Prandaj, jo pa arsye ata gjithnjë thoshin se poeti ishte gjallë dhe duhej të gjendej gjithsesi... Madje, ata, kur bënin shqyrtime, thoshin se nuk ishte fjala për një poet, por për shumë syresh, pra, për një mendim të formuar poetik, i cili paraqiste herezinë e organizuar...

Në të vërtetë, e liga për të cilën fliste perandoria dhe e preokuponte aq shumë edhe Sinodin e madh, ekzistonte. Përkrye masave shumëkohore, poeti Gropan u kthye në një shpirt të përshpirtshëm që hasej kudo. Madje, thuhej se e gjithë ajo që ndodhi me rastin e ceremonialit të pritjes së Perandorit kishte qenë vetëm një mashtrim perfid i Princit, ngase poeti Gropan me kohë kishte ikur; se ai që e argëtoi Perandorin nuk ishte Gropani, por një tjetër; se Gropani i vërtetë kishte shkuar dikah dhe më vonë e pati kaluar kohën duke bredhur nëpër skutat më të thella, ku rreth vetes i shkonin disa poetë të rinj, të cilët i mësonte, që një ditë ata ta vazhdojnë punën e tij... Thuhej se i kishte shtruar vetes si detyrë që poetët t'i bënte popullorë, në mënyrë që askush të mos ishte më në gjëndje t'i zbulonte... Çmos thuhej për të...

Klerikët dhe hetuesit perandorakë i dinin këto. Dhe, sa më shumë që kalonte koha, atyre u shfaqeshin telashe gjithnjë më të mëdha sa në një çast ata ishin të bindur se nuk po luftonin më me të gjallët, por me një frymë, e cila hapej ngado duke lënë vjersha dhe shkronja, që ata i quanin heretike dhe të mallkuara. Ngjante ndonjëherë që ndonjë vjershë e tij apo e nxënësve të tij (kjo ishte krejt një) t'u binte në duar. Bëheshin rituale të parapara të shfrenimit,

ku vjersha kallej para të gjithëve. Klerikët silleshin rreth zjarrit, lexonin gjithfare psalmesh e lutjesh, lexonin pjesë të librave të shenjtë, silleshin me kryqe te rënda në duar dhe çirreshin... Një ritual i tillë zgjaste një kohë të gjatë. Klerikët gërricnin fytyrat, shkulnin flokët dhe mallkonin herezinë shpirtërore... Luftë! Luftë! — thoshin ata, — Luftë! Të gjithë në luftën e shenjtë! Të gjithë! Ta shpëtojmë mendimin dhe shpirtin perandorak... Luftë! Luftë!...

Pasi u lodhej goja e u sosej fryma nga çirrjet, atëherë i gjuanin në zjarr fletët heretike dhe luteshin edhe më tutje.

Nga të dhënat mund të merret vesh se sa herë gjendeshin vjersha të tilla, bëhej hataja. Pas ritualeve të mallkimit, hetuesit fillonin arrestimet e panumërta. Hynin nëpër të gjitha anët dhe burgosnin kë të takonin. Armikun, armikun e perandorisë po e kërkojmë, — thoshin... Armiku është kudo... Armikun do ta gjunjëzojmë një ditë...

Me ato fjalë ngojë ata silleshin ditë e natë dhe nuk kishte se kush ua vinte dorën përpara. Për ta i madh e i vogël në Tokën e Lashtë ishte armik... Ata lindnin si të tillë, andaj kundër tyre duhej të merreshin masa më të rrepta. Kjo ndjekje e pashembullt u saksionua me norma ligjore, administrative, morale dhe praktike... Por, edhe përkundër kodifikimit të tmerrshëm të ndjekjes, gjurmët e Gropanit, çuditërisht shfaqeshin pareshtur dhe ai, mbi katërqind vjet i qëndroi si fantazmë mbi kokë perandorisë, duke e shqetësuar në atë masë se ajo shumë herë e humbte torruan sa të ndëshkonte edhe fëmijët.

Tevona, jam i bindur se poeti Gropan u shfaq si shpirt me emra të ndryshëm...

E sa për heshtjen dyqindvjeçare mund të them sa vijon:

— Shpirti që del si i formuar, patjetër se ruhet edhe në rrethana tejet të vështira. Për t'u stërkequr pjesërisht mund të stërkeqet, por për t'u zhdukur nuk zhduket... Të tillë ju pashë juve. Ishit në prag të rrënimit, por pikërisht ajo qënia shumëshekullore mbase pa vetëdijen tuaj, ju ngriti. Rrënjët tuaja të forta sërish nxorën pipa të rinj mu atëherë kur dukej se do të mbeteshin përgjithmonë të kalbur në tokë...»

Kronisti heshti për pak. Nimani hetoi një mjegullim

para tij. Mendoi se ai do të largohej pa i thënë të gjitha. Por nuk vonoi dhe plaku, pas pushimit të shkurtër, tha:

«... puna e poetit Gropan ende më ka mbetur e shkapërderdhur. Ca gjëra duan thellim të mëtutjeshëm. Fadil Pashai nuk ma vuri veshin kur nga ai kërkova edhe dhjetë vjet të tjera leje dhe disa ndihmës për të hulumtuar në arkivat e Romës dhe të Raguzës. Kemi punë të tjera, më tha. Desha t'ia shpjegoja rëndësinë e hulumtimit tim; desha t'i thosha se fjala ishte për ca hallka të rëndësishme të shpirtit tuaj të vjetër, desha t'i thosha se nga ndriçimi i drejtë i saj varet shumëçka e asaj shkapërderdhjeje të pashembullt që ju përcolli dhe po ju përcjell tash shumë kohë, por pashai nuk e çoi më gjatë... Mbase nuk kishte dëshirë të merrej me vetveten. Mendja ma tha se Pashai nuk e shikonte me sy të mirë punën time...»

«Nuk kisha kohë për kronika të vdekura. Lartmadhëria më thirri dhe më tha: Fadil Pasha, Evropën e kemi përpara. Duhet të shkojmë thellë e më thellë kah veriu i saj... Para kemi mbretërinë e hungarezëve që po na pengon. Ajo rrafshinë duhet të bëhet jona në mënyrë që bota osmane të bëhet e pafund... Ytë gjysh, Mehmeti, qe i fortë dhe i guximshëm. Ai zgjeroi kufijtë tanë nga lindja e nga perëndimi. Kaloi Kaukazin dhe e shtriu pushtetin tonë nga na shkonin vetëm ëndrrat... Andaj, ty të takon që t'ia kalosh...

Një kohë të gjatë bëra plane si të shkonim tutje kufijve që na i la Fatihu. Mblodha rreth vetes gjithfarë këshilltarësh, analitikësh, ushtarakësh, mjekësh, myderrizësh... Dëgjova shumë mendime dhe më në fund dhashë urdhër për themelimin e kalorësisë së re, e cila nuk do të hynte në luftë si deri më tash, por do të futej nga prapavija me sulme të befasishme. E çështë më e rëndësishme, themelova njësitë speciale për të vepruar në thellësi të armikut. E hetova se kishte ardhur çasti i organizimit të ushtrisë. Neve na duhej lufta e re dhe mënyra e re e veprimit... Isha i bindur se me reforma të lehta, por të domosdoshme, do të shkonim atje ku duhej të shkonim patjetër...

Ditën e përvjetorit të dytë të uljes në fronin e kryevezirit, kërkova nga Lartmadhëria që t'ia nisja luftës kah

veriu. Ishte syri i pranverës. Kundërmimi i jargovanëve ma mbushi kraharorin me gjallëri të paparë. Isha i bindur se do të kthehesha fitimtar dhe do të më pritnin kurorat e lavdisë si askënd deri më atëherë... Këtë e parandjeva edhe nga shikimi i Lartmadhërisë kur ma dha bekimin. Ardhsh faqebardhë, më tha dhe ma ledhatoi butësisht supin. Dora e tij një copë herë mbeti mbi supin tim dhe unë përjetova drithërima ngashryese si asnjëherë më parë. Ajo prekje magjike ma hapi jeshillëkun e gjithë botës, një jeshillëk të paparë, që nuk m'u hoq sysh edhe kur e kalova Azinë dhe u futa në Evropë. Jeshillëk shihja ngado, edhe kur më dolën para malet e thepisura me borë, edhe kur m'u shfaqën akullnajet e pafund... Ditë e natë shihja jeshillëk. Allah, thashë, nga ky udhëtim do të kthehem i stërlumtur. Shpjeguesi i ëndrrave dëgjonte e dëgjonte me vëmendje ato që i tregoja dhe nunuriste: xhehneti, xhehneti do të jetë i pafund... Po shoh një xhehnet... Të lumët ju për të... Xhehneti i dynjasë...

Por, sa më shumë që ecnim, xhehneti për të cilin më fliste shpjeguesi i ëndrrave, po më zvetënohej sa një ditë sytë e mi shihnin ferr të njëmendët. Pas luftrave të para, ku patëm fitime të dukshme, erdhi një kohë e shurdhër, në të cilën thuajse asgjë nuk ndodhte... Të zënë në një mjegull të dendur ushtarët tanë dukeshin si të përgjumur, e të përgjumura më dukej se ishin edhe ushtritë armike, të cilat sa s'i preknim me dorë. Mjegulla e çuditshme na kishte bërë troç dhe gati po na i humbte ndjenjat armiqësore që kishim për njëri-tjetrin! Midis nesh e tyre ishte një heshtje e ftohtë (që bëhej edhe më e trishtueshme nga një shi i imët që nuk kishte të ndalur) dhe mjegulla e dendur, e cila nuk lëvizte dot. Në atë kohë të shurdhër gjithçka dukej e neveritshme dhe me padurim prisja të ndodhte diçka, të ndodhte çkado që do të më këndellte paksa mua dhe taborret e mia. Por ja sesi për inat mjegulla vazhdonte të bënte gjumin e saj të gjatë (më thanë se ajo nganjëherë rrinte ashtu me muaj), e shiu i imët po bëhej gjithnjë më i akullt sa një ditë i mbuloi tendat tona (bashkë me armët që kishim dhe kuajt që hingëllinin dëshpërueshëm). Nuk vonoi dhe ne ndjemë stuhinë. Në

fillim erdhi një erë e ftohtë që të thante, që ua lëshoi vendin ca të tjerave më të forta, të cilat gjëmonin ditë e natë. Nuk vonoi e mjegulla u bë bashkë me një borë të imët. Koha e shurdhër u bë edhe më e padurueshme. Ishte dimri i parë që po kaloja i futur thellë në një hapësirë të bezdisshme, ku kishte vetëm borë dhe vetmi. Ç'vend i mallkuar ishte ai që zhytet pareshtur në mjegullina dhe në akullnaja? Kështilltarët më thanë se fjala ishte për një stinë të ngatërruar keq, që përsëritet në fillim të çdo shekulli. Në këtë pjesë të botës, më thanë ata, qindvjetëshët gjithnjë ndërrohen kështu, pra me kohë të pakohë. Gati plasa nga tërbimi. Pse nuk ma thatë këtë më parë? Ç'na u desh që të zhytemi në këtë kalburinë?... Ata ma kthyen se pikërisht një kohë e tillë është më e përshtatshmja për befasi të mëdha. Derra, u thashë, menduat se lufta e madhe mund të bëhet në kohë të pakohë? Vetëm qyqarët përgjojnë hutime të tilla për të përfituar... Unë desha një luftë të madhe... Desha një luftë të lavdishme, e jo luftë kënetash...

Por ç'e do që isha futur në një luftë të tillë! Vetëm zëri i klarinetës më ngushëllonte paksa. Klarinetisti plak, ditë e natë rrinte me instrumentin e vet në dorë, e unë mendoja për stinën e re, që do të vinte së shpejti. Çfarë do të sillte vallë ajo? Jeshillëk apo mjegullim? Më së shumti i droja asaj heshtjeje të shurdhër dhe sorollatjeve të pafund nëpër këneta...

Një ditë prej ditësh pashë se bora po ia lëshonte vendin një behari të lehtë, i cili i qiti në shesh konturat e ushtrive të lodhura që i kishim përpara. Ushtria kundërshtare, e molisur nga të ftohtit e dimrit të gjatë, nuk pati kurrfarë vullneti të na kundërvihej. Madje ajo na u dorëzua pa iu sulur fare. Thuajse kishte pritur që këtë ta bënte sa më parë. Ushtarakët e ngazëllyer erdhën te unë gjithë gëzim dhe më thanë se shënuam fitore të madhe. E dinim, flitnin ata, se kjo kohë është kohë e fitoreve të mëdha. I shikova vëngër dhe u thashë se nuk shënuam kurrfarë fitoreje, bile prej tashit do të kemi telashe me ushtrinë e huaj, të cilën duhet ta bartim zvarrazi, si të dorëzuar. Atë ushtri të mërdhirë e të sëmurë duhet ta ushqejmë. A nuk është ky telash për ne?

Ushtarakët më shikuan me habi. E panë se edhe ca suksese nuk mund të jenë të suksesshme. T'i lëmë të shkojnë nga të duan, më tha njëri. Ç'punë kemi me ta? Do t'ua falim jetën dhe le të kthehen nga kanë ardhur... Sërish do të na i qesin përpara, u thashë, sërish do të na dorëzohen dhe ne do të sillemi kot në një rreth të mbyllur që i thonë luftë e luftë nuk bëhet. Përherë do të kemi të bëjmë me të njëjtët shkretanë. A nuk do të bezdisemi edhe ne me ta?

Megjithatë, pas asaj ngecjeje, ecëm pak. Morëm ca kështjella (ah ç'kështjella të mjera që dukeshin ato të rrasura në baltë) dhe sërish m'u bë se gjendeshim në të njëjtën hapësirë. M'u bë se shihja të njëjtat moçale, të njëjtat çufrrina, të njëjtat barëra të liga, të njëjtat përroska plot myshqe të kalbura, të njëjtat fusha të shkreta... M'u bë se përsëriteshin edhe betejat bashkë me ushtarët e vrarë, kufomat e të cilëve nuk bëheshin kërma. Dhe në fund vinte ajo mjegulla e dëndur bashkë me heshtjen e shurdhër, e cila ngrinte. Ne e kuptonim se hynim prapë në atë mezokohën në të cilën nuk ndodhte gjë, por që bora mbulonte çdo shteg, frynte veriu i akullt dhe ne pritnim që ajo të hiqej dhe t'ia fillonim sërish në të njëjtën mënyrë... Zot, thashë, ç'luftë monotone po bëjmë? Ndoshta nuk luftojmë fare pos që sillemi rreth vetes dhe imitojmë betejat e mëdha? Kjo marramendje më gllabëroi shpirtin aq shumë sa një ditë i thashë kronistit: a mos kemi humbur në mjegull? Mos na kanë zënë kallakonxhat? Nuk kemi humbur, ma ktheu ai, por po luftojmë. Ka katër vjet që bëjmë një luftë të madhe dhe po aq vjet po fitojmë... Në atë çast sec mu qep një e qeshur e thartë në fytyrë. Ne po sillemi kot së koti, i thashë. Sorollatemi si të marrë dhe përfytyrojmë beteja, përfytyrojmë luftëra, përfytyrojmë fitore të shkëlqyeshme, e në të vërtetë nuk bëjmë gjë, pos që sharrojmë ditë për ditë në ligatinën më të madhe të botës... Prej saj nuk do të dalim kurrë. Këmbët na u kanë futur në të dhe po na sharrojnë thellë e më thellë... Kronisti heshti. Heshtja e tij ma bënte me dije se kisha të drejtë. Më vonë i thashë: shëno, or kronist, se Fadil Pashai po sillet në një cirk të madh, po sillet në një cirk të pafund, ku ai është aktor dhe shikues, ku ai qesh dhe qan në të njëj-

tën kohë... Shëno se kësaj nuk i thonë as luftë, e nuk i thonë as paqe veç boshësi ku gjërat përsëriten në mënyrë të mërzitshme... E kronisti më tha: madhëri ju ka molisur koha e ligë. Në këtë rrafshinë ajri kundërmon rëndë dhe sjell shqetësim. I tillë është ky vend dhe kështu shpesh mbrohet nga ata që janë të vrullshëm... Është ferri, i thashë. Është tokë e nëmur që s'i duhet as djallit... Mjerë ai që ngatërrohet në të...

Kronisti heshti dhe nuk di se si m'u kujtuan ca fjalë të tij që m'i kishte thënë moti për një leje dhjetëvjetëshe për të gjurmuar diçka nëpër botë. Më pate kërkuar leje të punosh diçka, i thashë? E ai ma ktheu plot urtësi: vonë është, madhëri, vonë. Jam plakur. Syri im s'i zë më shkronjat e fshehta; mendja ime s'i heton më dokumentet e ngatërruara dhe të përziera me ato të huajat... Jam plakur që të merrem me punë të ngatërruara... Shko, i thashë dhe kryeje atë që duhet ta bësh. Por mos trego se Fadil Pashai është ngujuar në këtë mjegull të mallkuar, se do të tallen me mua. A nuk është kështu, kronist?»

«Ashtu është, — foli kronisti. — Isha i vetëdijshëm se me gojën tuaj po fliste një shpirt i sublimuar që kaherë ishte i pakënaqur me gjendjen në të cilën ndodhej. Kur u nisa për në Kryesheher (me urdhrin tuaj), isha i bindur se lajmi i kobshëm do të shkonte atje para meje. Dhe, njëmend, në të hyrë e hetova të ligën. Tellallët po shqyenin gurmazët me fjalët: Fadil Pashai ra heroikisht në luftën e shenjtë në Srem! Ushtria jonë korri sukses të jashtëzakonshëm! Pashai shpallet shehit! A nuk ishte kjo një gënjeshtër e pashoqe, Pasha?

«Nuk e di. Nuk e di, — tha Fadil Pashai me një zë të butë, në të cilin Nimani hetoi një mëdyshje të thellë. — Nuk e di me tamam se çfarë ngjau...»

«Ishte ky një mashtrim i madh, Pasha», — tha Kronisti gjithë ngulm.

«Kur shkove, m'u bë se gjithnjë më shumë po sharroja në atë mjegullim të bezdisshëm, sa m'u err bota:... Koha e shurdhër ishte e pamëshirshme... Kohe e shurdhër nuk kishte të ndalur... Humba në kohën e shurdhër...»

«Ju nuk ratë heroikisht në luftën e shenjtë, sado që luftuat me gjithë fuqi dhe korrët fitore të shkëlqyeshme, — shtoi kronisti. — Ju bëtë vetëvrasje. Po. Po. Bëtë vetëvrasje! E bëtë, ngase ai shpirti i sublimuar që e hetova moti te ju, nuk ju la të qetë. Ju ia futët vetes thikën kur mbetët vetëm. Rojet tuaja (gjithsesi me urdhrin e ndonjë ushtaraku të lartë) hapën fjalë se njëfarë armiku u fut në tendë i maskuar, për të marrë hak për disfatat e njëpasnjëshme që i përjetoi në fushëbetejë! Zyrtarisht gjithçka ishte e saktë. Por vlerësimi im për këtë është ky:

— Është e vërtetë se ju përcolli një mjegullim i dendur që nuk ju hiqej syve dhe mendimeve. Është e vërtetë se ju mendonit se silleshit në një arenë ku gjërat përsëriteshin dhe shfaqej ajo kotësia e rëndë gjithë zymti. Është e vërtetë se ju bezdiseshit pa masë kur futeshit në mezokohën e shurdhër, pra të kalimit nga stina në stinë, kohë kjo që nuk ishte as për luftë e as për paqe. Është e vërtetë se ju mundonin gjithfarë përfytyrimesh të ngatërruara në të cilat ju shpirtërisht shkallmoheshit dhe moliseshit... Molisja juaj i kundërshtonte gjendjes në të cilën ndodheshit dhe ndodhte kështu pse në të vërtetë te ju vërtitej pareshtur shpirti i njëmendët, i cili luftonte kundër zbrazëtisë...»

«Ç'ishte ai shpirt, kronist»?

«Shpirti i poetit. Shpirti i atij poetit, i cili ishte i përsëritshëm dhe gjithkohor... Ai shpirt që kërkonte pareshtur folenë e vet te ju...»

«Ah, — tha Fadil Pashai, — për perëndi mos më ngatërro me poetët! Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja te poezia. Ata që merreshin me të i kam parë pak si ndryshe...»

«Këtë e besoj, Pasha. Por mos harro se Gropani me kohë u bë pjesë e qenies suaj kolektive, e asaj të vetëdijshmes dhe të pavetëdijshmes...

Në fillim e donit luftën... E donit shpatën, i donit betejat. Pa to as që mund të rrinit. Mendja juaj përpëlitej pareshtur me luftëra, merrej me armë dhe me strategji ushtarake... Në atë mënyrë ajo ushqehej dhe përjashtonte gjithçka tjetër. Tekefundit a nuk jua solli famën pikërisht një përkushtim i tillë? A nuk u bëtë ushtaraku më i fuqishëm i

perandorisë falë kësaj? Dhe kur arritët në majë, në atë majën që e ëndërruat pareshtur, ndodhi ajo që ju e hetuat si boshllëk apo si fashë... Tash sukseset nuk iu sillnin kënaqësi si dikur. Përkundrazi, fitoret tuaja të mëdha, të cilat perandoria i priste me ngazëllim, ju i përjetonit si hiçgjë, i merrnit si një përsëritje të njëfarë kotësie. Pikërisht kjo kotësi jua merrte qetësinë, dhe kërkonit me të drejtë disi shpëtim prej saj... Dhe ja ai mjegullimi, ai shqetësimi, ajo koha e shurdhër në të cilën gjithçka dukej e papërcaktuar dhe e kotë, e përsëritshme, monotone, e njëtrajtshme dhe e padenjë për asgjë... Ju ndjenit njëfarë ngrirjeje të çuditshme, e cila ju mbërthente dhe ua merrte vullnetin... A nuk ishte kjo shenjë e dëshpërimit të tmerrshëm që ju e përjetuat si zbrazëti? Jam i bindur se te ju luftonin dy pjesët e një qenie që kundërshtoheshin mes vete pareshtur, edhe pse ju dukeshit njeri i vendosur, i pathyeshëm dhe tejet i fuqishëm. Me një fjalë te ju u ndesh, më në fund, uni individual me qenësinë e njëmendët... Kjo e dyta nuk ishte aq e fuqishme sa t'ju bënte për vete si duhet, andaj ju mbetët në atë gjendje amullie pa shpëtim... Tekefundit ky ishte hap i rëndësishëm drejt vetëdijësimit, që gjithsesi duhej të shprehej me shenjat e hetimit të qenësisë së lashtë, e cila me kalimin e kohës kthehet në një ngacmim të përhershëm... Proçese të tilla nganjëherë zgjasin shumë dhe lënë pasoja te disa gjenerata...

«Mjaft! Mjaft! Ende jam në mjegull! Ende... Ende iam në mjegull... Mjegulla nuk po më hiqet nga sytë... Mos më ngatërro me gjëra që do të më shqetësojnë edhe më...»

«Koha është t'i ndriçojmë ca gjëra... S'është e thënë që të mbeteni gjithnjë në atë mjegull...»

«Ah, mjegulla... Mjegulla... Mjegullim po shoh gjithnjë... Edhe tash që të gjithë po më dukeni të mjegulluar... Mbase mjegullimi është më i përshtatshëm që ca gjëra të mos kuptohen kurrë?... Tekefundit pse duhet doemos të kuptohen?... Unë nuk i kam besuar asnjëherë shumëqenësisë për të cilën flet ti. Shumëqenësia është mungesë e qenësisë. Unë isha ushtarak dhe kisha qëndrimin tim...» — fliste Fadili si përçart.

«Mendoje se kishe qëndrim, por në të vërtetë nuk pate qëndrim, nuk pate mundësi ta kishe asnjëherë «ngase te ju bashkëjetonin dy pjesët e një qenie: ajo aktualja, që ishte në shërbim të plotë të perandorisë dhe ajo e vjetra, pra, kolektivja, e cila kërkonte me çdo kusht që ju t'i ktheheshit vetvetes... Atë ndeshje e provove, sado që si të heshtur dhe të papërcaktuar... Qenia e lashtë po e bënte të vetën... Shpirti i njëmendtë të ngacmonte...»

«Bah! Pse flet si i marrë? Çfarë shpirti i huaj?...»

«Nuk ishte i huaj, por juaji... Ai shpirt sillej e sillej pareshtur nëpër kohë dhe të sulej... Ju nuk e dinit se fjala është për një segment të rëndësishëm të vetëdijësimit që duhej të shpinte kah krijimi i vetëdijes së vetëdijshme...»

«Mjaft! Mjaft! Tash m'i ngatërrove të gjitha shtigjet... Mjegullimi m'u bë edhe më i dendur... Si t'ia bëj? Si t'ia bëj që të dal nga ky mjegullim? Pse sorrollatem kështu dhe nuk gjej derman?...»

Fadil Pashai po dëneste. Kishte zënë sytë me duar dhe nuk dëshironte të shihte njeri.

«Ndoshta kronisti ka të drejtë? — tha një tjetër që i rrinte pranë Fadil Pashait. — Pse të mos mendojmë shtruar për të gjitha? Kohë kemi. Nga shoshitja e mendimeve nuk mund të ketë dëm, pos dobi...»

Nimani pa t'i shfaqej një mesoburrë me sy të mufatur, në të cilët hetohej një shikim i lodhur. Ai i prekte ata herë pas here, si të kërkonte prej tyre të hiqte perden e errët që e pengonte të shihte.

«Kur më emëroi Kryevezir, Lartmadhëria më tha: nga ti, Sami Pasha, kërkoj forcën e tyt et, Fadilit dhe mendjen e gjysh Ahmetit.

Ç'është e drejta, unë isha një farë gjysmëgjyse, një trup që bante dy pjesë të kundërta. Pareshtur e hetoja praninë e dy vetave: të njërit që ishte i butë, i heshtur, i qetë dhe gjithë prirje për meditim e poezi, dhe tjetrit që ishte i ashpër, i vrullshëm dhe gjithnjë me plot shqetësim... Si t'i pajtoja vallë këto dy skajshmëri? Si? A bënte të jetohej me kundërthënie të tilla? Ishte punë që nuk bëhej, ngase ishte e pamundur. Sepse, te unë zhvillohej një betejë e për-

hershme midis dy vetave. Një kohë të gjatë u përpoqa t'i zbutja, që kundërthëniet e tyre t'i sillja në kufijtë e një shqetësimi normal, që i duhet secilit për ta njohur veten sa më mirë. Por kjo luftë me vetveten, te unë shfaqej si luftë midis dy njerëzve të kundërt që jetonin në të njëjtin kulm, në të njëjtën hapësirë dhe në të njëjtat rrethana... Lufta e tyre ishte e përhershme dhe thuajse nuk kishte të sosur. Shpesh mendoja se sa fatlum do të isha po qe se më në fund njëri do të fitonte, cilidoqoftë. Mbase pastaj jeta ime do të kishte rrjedhë të njëtrajtshme dhe të qetë? Por, ç'e do që të dy anët ishin njësoj të forta dhe nuk lëshonin pe asnjëherë. Grindeshin e grindeshin deri sa shkallmohesha i tëri. Atëherë te unë flitnin dy zëra që thoshin:

I pari: e dua poezinë...

I dyti: i dua armët...

I pari: poezia është e amshueshme... Poezia është vetëdije... Poezia është ushqim shpirtëror... Poezia është përcaktim gjithkohor...

I dyti: arma është e fortë... Forca është siguri... Siguria është liri... Liria është pavarësi...

I pari: Liria e amshueshme gjendet vetëm në mbretërinë e muzave... Aty gjithçka është harmonike, e thellë dhe e bukur... Bukuria aty nuk ka fund...

I dyti: Baraspesha e forcës është kushti i parë i lirisë... Pa të nuk ka zhvillim të lirë e as mendim të lirë... Baraspesha është e domosdoshme...

I pari: kush është më fatlum se poeti? Kush është më fatlum se mendimtari? Kush është më fatlum se ai që sheh rritën e strofave dhe dëgjon tingëllimën e amshueshme të rimave? Kush është më fatlum se krijuesi?

I dyti: kush është më fatkeq se poeti? Kush është më fatkeq nga mendimtari? Kush është më fatkeq nga ai që sheh se strofat paraqesin fundin e frymëzimit?

Kjo kushkush nuk ' ë hiqei. Herë njëra anë e herë tjetra anë ma shtronte të njëjtën pyetje... Herë njëra anë e herë ana tjetër më ngacmonte, më sulmonte, më thirrte në ndihmë kundër tjetrit dhe kërkonte t'i mbaja krahun. Unë, megjithatë, dëshiroja ta mbaja asnjanësinë dhe pikë-

risht kjo më moliste. Ah, sa vështirë ishte që të mbahej asnjanësia e domosdoshme në rrethana të tilla! Shembesha poshtë dhe mallkoja fatin e zi që u bëra log i betejave të pafund. Dëshiroja të rrija ashtu si i paqenë, por shpejt dëgjoja që dikush më thoshte:

jepju poezisë, ki besim në poezinë...
forcohu, vetëm forca të ndihmon...
poezia...
forca...
poezia...
mos lejo...
mos...
poezinë...
forcën...
mos...
mo...
m...

Mosmosi nuk më la të qetë asnjëherë, siç nuk më la të qetë as perandoria e cila kërkonte që të bëhej pajtimi i mendjes me forcën. Lartmadhërisë desha t'i thosha se kjo ishte çështje e vështirë, shumë e vështirë, por ai më tha se koha nuk priste, kishte rrezik që të bëhej vonë... Nisja, më tha, nisja... Dalsh faqebardhë!

Kur u ula në fron vendosa të bëja kompromis: t'u lë veprim të lirë mendjes dhe forcës. Le të zhvillohen njësoj. Mbase një ditë mund ta arrijmë pushtetin ideal, në të cilin do të mbizotëronte baraspesha e natyrshme e të dyjave! Por nuk vonoi dhe hetova se mendimi i lirë (bashkë me poezinë dhe artin në përgjithësi) nuk shkonte barabar me forcën dhe me pushtetin. Forca eci shumë më shpejt dhe shkoi shumë më larg, ndërsa mendimi ngeci...

Pjesa ime, ajo që e mbronte artin dhe mendimin e lirë një ditë më tha gjithë dëshpërim:

— E ke tash të qartë se ç'ngjet kur mbizotëron forca? Bëre gabim të madh kur ia lëshove frenat forcës. Ajo nuk është pjesë e vetëdijshme. Përkundrazi, sa herë që gjen hapësirë të lirë të veprimit bëhet e papërmbajtshme...

— Nuk mendova keq, i thashë pjesës sime të qetë... Desha që gjërat të zhvilloheshin lirisht...

— Ky është gabim i pafalshëm, më tha pjesa që foli pak më parë. Lirinë e kupton drejt dhe si duhet vetëm pjesa e vetëdijshme. Të tjerët nuk e kuptojnë si duhet. Pjesa e pavetëdijshme, sapo gjen hapësirë të lirë, bëhet shkatërruese, ia zë kokën mendimit të lirë dhe gjithë asaj që është pjellë e vetëdijes së gjatë... Injoranca mendon se gjithçka duhet t'i takojë asaj, madje edhe hapësira për çështjet e shpirtit. Injoranca nuk nguron që të ngrerë kokë edhe kundër mendimit të lirë dhe artit duke e shpallur si të rrezikshëm dhe të padëshirueshëm. Madje, bën çmos që në mungesë të gjerësisë të veprojë me dhunë kundër saj... A nuk po sheh kah po shkojnë punët? Injoranca është bërë e papërmbajtshme. Po i rri në pritë mendimit të lirë dhe po e gjykon rëndë... Mëkat. Po mbyllen të gjitha çepat e frymëmarrjes së lirë... Ka rrezik që nesër a pasnesër ta ndrydhim përfundimisht mendimin e lirë dhe shoqëria të bëhet autokratike... Shpirti do të stërkeqet e do të stërkeqet sa një ditë të rrudhet... Ka rrezik që një ditë të mos mendojmë më me kokën tonë fare... Çfarë do të bëhet me ne po qe se do të zëmë të frikësohemi nga mendimet tona?... Kjo është gjëja më e rrezikshme... Na mori lumi çastin që do të zëmë t'i herrim mendimet tona ende pa i thënë...

Pjesa që më fliste kështu kishte të drejtë. Keqardhja ime ishte edhe më e madhe kur pashë se ishte tepër vonë të ndryshoja gjë. Rashë në shtrat dhe nuk u çova më...

Për habi, në çastet e fundit m'u qepën ca vargje të vjetra... M'u lidhën ca mendime të shkëputura, të gjitha të rimuara... Ato nuk po më ndaheshin, edhe pse shumë prej tyre nuk i kuptoja, e nuk e kuptoja edhe gjuhën e tyre... Megjithatë, ato po më ngashrenin çuditërisht... Më bëhej se shërohesha nga ndjenja e fajit për militarizimin e vrullshëm të perandorisë sa isha në krye të saj... Dalngadalë po kthehesha në një poet. Më bëhej se gjithë jetën kisha qenë i tillë... Se pareshtur isha marrë me një poemë të moçme që kishte bredhur e kishte bredhur brez pas brezi, herë duke u plotësuar, e herë duke u rrudhur dhe në njëfarë mënyre edhe unë merrja pjesë në ripërtëritjen e saj... Të takon edhe ty, po më thoshte një zë i thellë... Të takon edhe ty... Poe-

ma është edhe jotja... Duhet ta plotësosh... Gjymtyrët e saj kërkojnë shpirtin tuaj...

Ç'ishte vallë, ajo që m'u qep ashtu dhe më shpëtoi nga vuajtja e amshueshme? Mos ishte ndonjë përfitim mashtrues? Kjo po më mundon edhe tash...»

«Nuk ishte kurrfarë mashtrimi, por ishte shpirti juaj, foli kronisti nxitueshëm. — Ishte ndjenja kolektive që u shkatërrua, sado që soji i juaj, herë me dashje e herë pa dashje hoqi dorë prej saj. Por ajo nuk hoqi dorë prej jush dhe nuk do të heqë edhe po qe se ju kundër saj do të luftonit ditë e natë...

Nëpër kronika të ndryshme pashë se qysh në kohën e Princ Dhimitrit, e edhe më vonë, pati nga tuajt që me mish e me shpirt i kundërshtuan një ndjenje së tillë. Nuk nguruan të luftonin haptazi kundër saj... Madje hasa edhe të tillë që shkuan aq larg sa pjesën e shpirtit të vet, atë që i shqetësonte pareshtur, e shpallën heretike, mëkatnore, të padëshirueshme, të rrezikshme e tjera e tjera... Jo rrallë hoqën dorë prej saj botërisht dhe u betuan para perandorëve të ndryshëm dhe perandorive që shkonin e vinin, se do të luftonin kundër atij shqetësimi me gjithë zemër, siç e lufton njeriu gjakun e prishtë, nga i cili jo vetëm që do hequr dorë, por duhet therur vetja herë pas here, që ai gjak të kullojë dhe duke kulluar të pastrohet!

«Gjaku i prishtë» jo rrallë u pastrua me heqjen e kokave më të mira, që u prenë në pabesi dhe iu dhuruan pastaj perandorëve të huaj. E ata, të kënaqur se jepnit dëshmi të tilla besnikërie, ju jepnin dekorata, ju mbushnin gjoksin me to dhe ju nderonin me ndonjë bijë të tyre.

Por, mu pse ngjiste kështu, ajo ndjenjë kundërvepronte pareshtur dhe ju qepej edhe atëherë kur nuk pritej fare në formë të ndonjë shqetësimi, si ëndërr, apo si prirje e fuqishme për t'u marrë me krijimtari... Ky farë shqetësimi ju shfaqej pavetëdijshëm, aq vrullshëm sa kthesat ishin të fuqishme dhe të kohshme madje. Ngjiste që ushtarakëve të betuar në normat perandorake dhe me njëmijë e një dëshmi të bëra kundër vetvetes, kjo ndjenjë ua turbullonte mendjen befas, sa ata në mënyrë të pavetëdijshme vepronin të ku-

ndërtën. Saora, nga të besueshëm që ishin, ktheheshin në të rrezikshëm; nga të urtë dhe të dëgjueshëm, ktheheshin në plangprishës të pashembullt; nga të përkulshëm që ishin dhe sahanlëpirës, ktheheshin në kryeneçë! Çmos ngjiste. Fillonin grindjet me perandorinë pa ditur fare se ç'ishte ajo që i drejtonte kundër saj dhe kundër bindjes së tyre të dëshmuar? Rëndom në raste të tilla, gjithçka merrte fund tragjikisht... Kryeneçët dënoheshin rreptë dhe gjithçka pastaj shpjegohej me ambiciet e tyre të sëmura për pushtet të pakufishëm... Ca të tjerë shpalleshin komplotistë, e të tjera e të tjera, pa ua zënë ngojë asnjëherë shtytjet e vërteta, gjë që ma thotë mendja se perandorët e dinin se për çfarë ishte fjala...

Megjithatë, perandorët e ndryshëm, që shkonin e vinin nuk hoqën dorë nga ju. Kështu ngjau në kohën e Romës, kështu ngjau në kohën e Bizantit e kështu po ngjet edhe tash, e kështu do të ngjajë edhe në të ardhmen, derisa forcën tuaj të brendshme ta drejtonin për të mirën tuaj e jo kundër vetvetes. Të tjerët e kuptuan drejt atë për të cilën ju kahmot nuk jeni të vetëdijshëm... Por, ja se edhe në fronin më të lartë qenia juaj ju gjeti. Ajo ju shqetësoi dhe do t'ju shqetësojë edhe më shumë, derisa një ditë ta kuptoni atë që do kuptuar patjetër...»

«Nuk pajtohem me këto që thotë kronisti. Nuk pajtohem... Ky po na sjell mjegullim të panevojshëm me atë farë poetin dhe me fosilet që na qenkëshin shpërndarë nëpër kohë... Ky po mundohet të na nënçmojë gjoja se ne nuk e ditkemi se cila qenka pjesa jonë e vetëdijshme dhe ajo e pavetëdijshme, që sipas tij po na kërkuaka tash sa shekuj... Të gjitha këto janë thashetheme.

Sa për vete mund të them se pata bindjen e pathyeshme perandorake. Punova ditë e natë për të mirën e saj dhe gjithnjë do të punoja ashtu.

E tash po del se ne paskemi pasë qenë gënjeshtarë! Se na paskan pasë udhëhequr ca instikte e veprime të pakontrolluara! Se një ndjenjë tjetër, si e huaj, paska qenë më e fortë se ne... Pastaj flet për ca grindje të brendshme me të cilat ne gjoja u morëm aq gjatë... Po ç'paskemi qenë ne? Djaj?

Mjaft më me marrëzira të tilla! Askush nuk do të na e besonte fronin më të lartë për dofarë ndjenjash të pavetëdijshme që po e frikësuekan dikë...»

«Ai që foli ishte një burrë i gjatë me shpatulla të gjera. Kishte një fytyrë të përhektë, në të cilën shikimi i mëvrenjtur dukej si i ngrirë. Nimani vërejti se atij i fliste i gjithë trupi.

«Nuk të thotë kush, or Mustafa Pashë Qyprilliu, ta ndërrosh bindjen tënde. Ne po bisedojmë. Tekefundit, çfarë mund të bëjmë tjetër?» — foli qetë kronisti.

«Dua të them se punova me mish e me shpirt për të mirën e perandorisë», — foli Mustafa Pasha, po me atë zë si më parë.

«Këtë s'e luan as topi. Bëre sa dhjetë të tjerë. Të gjitha këto dihen...»

«E pse më flet, pra, për ato farë dokrrash që lidhen me vetëdijen e fshehur? Vetëdija ime ishte perandoria dhe rritja e saj, apo jo? Ajo për mua ishte mbi gjithë botën dhe për të e dhashë jetën diku në Ballkan, kur isha gati t'i afrohesha Vjenës...»

«Ju i shërbyet asaj si asnjë tjetër. Shuat shtatë kryengritje të mëdha. Shkuat tutje në Krime. I dogjët tatarët. U futën edhe në rërën e Afrikës e, ç'është më e rëndësishme, bëtë një luftë të madhe kundër gjeneralit të Vjenës në vendlindjen tënde. Në atë luftë soji juaj u nda në dysh dhe luftoi në anën e dy mbretërive të mëdha. Një pjesë, (mbi dhjetë mijë), qenë me ty si ushtarë të rregullt dhe, një pjesë (afër tetë mijë), nën udhëheqjen e Priftit, qenë me Pikolomenin. A nuk ishte kështu? Gjaku juaj u derdh në të njëjtën kohë për të mbrojtur dy perandori, për të mbrojtur dy botëra, për të mbrojtur dy bindje të kundërta që me shekuj luftojnë njëra me tjetrën. Nga Shkupi, Prishtina e deri në Nish a nuk ndodhte që vëllezërit e një nëne e të një babai të vriteshin me njëri-tjetrin nën flamuj të ndryshëm? A nuk të thanë se në grykë të Kaçanikut, gjatë pushimeve, ushtarët kundërshtarë linin armët mënjanë, ndiznin ndonjë duhan dhe ia thoshin ndonjë kënge të përbashkët para se t'i suleshin prapë njeri-tjetrit deri në vdekje?... A nuk ishte kështu?...»

«Mjaft, mjaft se po më pëlcet zemra! Pse m'i zë ngojë këto gjëra? Pse?»

«Ngase janë pjesë e tragjikes suaj...»

«Gati pëlcas kur më kujtohet ajo luftë e mallkuar..»

«Ishte edhe luftë me vetveten... Nuk ishte si çdo luftë tjetër...»

«Mjaft! Mjaft!» — po çirrej Mustafa Pasha.

«Pse shqetësohesh? — ndërhyri Sami Pasha. — Këtu nuk flasim më si kryevezirë të fuqishëm e as si ushtarakë. Koha jonë perëndoi që moti. Tash jemi të barabartë dhe të lirë të merremi me gjithfarë rishqyrtimesh. Tekefundit a nuk po e bëjmë këtë tash sa kohë? A nuk ia përsërisim njëri-tjetrit të njëjtat fjalë pareshtur? Kronisti është asnjanës. Ka punuar shumë dhe ka të drejtë që gjërat t'i shtrojë ashtu si i sheh. Tekefundit, biro, ne i takojmë historisë me të bëmat dhe me të pabëmat tona... Ajo e jep gjykimin e vet për ne...»

«Patjetër se do të shqetësohemi kur t'i marrim vesh ca gjëra. Mund të mos na pëlqejnë, por koha nuk kthehet prapa. Ne zbritëm nga froni që e mbajtëm aq kohë. Shekulli ynë perëndoi. Tash filloi shekulli i kronistit dhe i kronistëve të tjerë që do të merren me ne. Kjo nuk bën të na shqetësojë. Kronikat, dokumentet e fermanet ruhen. Ne jemi të pafuqishëm t'u shtojmë apo t'u heqim gjë. Andaj, kronist, fol dhe mos e çaj kokën për mospajtimet tona. Ne jemi rralluar ngapak. Nuk jemi mësuar të ballafaqohemi me shumanshmërinë. Mbase froni na ka çoroditur?» — tha Mehmeti.

«Po këtë e them edhe unë, pasha i nderuar. Jam vetëm njëfarë ndërmjetësuesi midis jush dhe kohës së quajtur histori. Imja është t'i qes në shesh dëshmitë. Tekefundit, ju kërkuat që unë të merrem me ju...»

«Nga e vërteta nuk kemi dëm. Është koha që ca gjëra t'i shohim edhe ashtu si nuk na pëlqejnë...» — foli njëri ndër ata.

«Desha të them, — vazhdoi kronisti duke e shikuar Mustafa Pashën, — ju luftuat pareshtur dhe bëtë luftëra të mëdha. Por, luftuat edhe kundër vetvetes. Kjo ishte pjesë e ekzistencës suaj. Dëshmitë janë. Ato dihen. Flasin qartë

dhe po e deshi puna mund t'ua hedh përpara një nga një...»

«Nuk ka nevojë. Nuk ka nevojë», — tha Qypriliu plak.

«Nuk i mbaj kot këta libra në shpinë. Të gjitha i kam shënuar me kujdes... Andaj, pashallarë të nderuar, unë prapë duhet ta përsëris atë që e thashë pak më parë se te ju u shfaq pareshtur, ku më shumë e ku më pak, vetëdija kolektive që ju ngacmoi si shqetësim i brendshëm. Ca prej jush, vetëm me anën e ashpërsisë dhe me vringëllimën e armëve u munduat ta bëni zap dhe ta fshihni këtë shqetësim. Megjithatë, ai shqetësim nuk ju la të qetë, sado që shumë prej jush këtë gjë nuk e kuptuat mirë dhe drejt. Thirrja e saj ishte e pareshtur, por ende e paqartësuar. Ajo priste çastin që të formësohej si duhet. A nuk ju ka rënë, Mustafa Pasha, të ndjeni gulçime të papërmbajtshme në kraharor?»

«Unë?... Asnjëherë! Asnjëherë!... Nuk më shqetësoi gjë. Ju betohem se sa isha në fron nuk më shkoi mendja për të keq. Zot ruajna! Për perandorinë e dhashë edhe kokën. Dhe po t'i kisha njëmijë sosh ngjashër do t'i jepja...»

«Për këtë nuk dyshoj...»

«Pse më mundon pra?»

«Që ta kuptosh vetveten...»

«Vetveten?»

«Vetveten.»

«Do të thotë se unë nuk e paskam kuptuar asnjëherë?... A nuk është kjo për t'u zemëruar?»

«Nuk them kështu...»

«E si pra?»

«Se nuk e pate të qartë një gjë...»

«E ç'ishte ajo që nuk e pata të qartë?»

«Se në ndërdije qenia jote shprehte mospajtim të haptë; se ajo të kundërshtonte dhe sa më shumë që të kundërshtonte ti bëheshe më i ashpër, bëheshe më i egër, bëheshe më i padurueshëm... Këtë ngacmim të papërshkrueshëm mundoheshe ta fshehje disi përmes vringëllimës së shpatës. Ajo të qetësonte paksa, por sërish ishe i pakënaqur, sërish ndjeheshe i shqetësuar... Ashpërsia jote në të vërtetë ishte përpjekje e pareshtur që t'i zihej fryma asaj që ti e ndjeje

si ngacmim, nga i cili kishe frikë... Po, po. Kishe frikë të papërmbajtshme prej saj...»

«Dokrra. Flet dokrra. Paskam pasur frikë nga ajo ndjenjë dhe këtë e paskam pasë shprehur përmes ashpërsisë? Dokrra!...»

«Nuk janë dokrra, por të vërteta. Është koha t'i heqim maskat...»

«Tash po e tepron...»

«Maskat e shpirtit, pasha. Maskat e shpirtit duhen hequr. Duhen hequr ato që vështirë të hiqen, ose që shpesh herë nuk hiqen dot... Për këto e kam fjalën. Njëherë provove t'i heqësh, por u dëshpërove si shumë. Kjo ishte rënia jote përfundimtare...»

«Boll se plasa! Boll! Deri kur do t'i duroj intriga të tilla?»

Mustafa Pasha u shemb përtokë. Të tjerët po e shikonin si të ngrirë. Nimani hetoi një heshtje të shurdhër. Iu bë se ata që kishte përpara do të ktheheshin në kornizat e veta në mur. Bile, iu duk se ata po i shihte të tejdukshëm, më tepër hije se qenie të njëmendta që biseduan një kohë të gjatë para tij. Por mjaftoi një ndërhyrje e Mehmetit plak që ata të mbeteshin ku ishin kohë më parë.

«Nuk po largohemi pa i marrë vesh të gjitha, — tha Pashai plak. — Nuk do të largohemi. Koha është t'i kuptojmë të gjitha një nga një. Mjegullimi nuk na ndihmon. Pse të mbesim me bindje të rreme? Pse? Shumë nga ne nuk do t'i dëgjonim më me dëshirë ca gjëra, por a nuk është ky një mashtrim i madh nga i cili nuk ka dobi? Pse të fshehemi në lëvozhgë? Ta njohësh vetveten është guxim i madh... Nuk bën të ikim nga ajo që nuk do ikur...»

«Këtë e them edhe unë, pasha i nderuar... Vetja do njohur gjithsesi. Ky është kushti i parë që të pastrohet ndërgjegjja. Nganjëherë kjo është punë e vështirë dhe përcillet me shumë pengesa. Ja, për shembull, t'ia nisim nga Mustafa Pasha. E nderoi guximin dhe trimërinë e tij...

Si thashë, Mustafa Pasha po e ndjente kundërshtimin e qenies së vet. I shfaqej si ndjenjë që ky nuk e përcaktonte dhe nuk e qartësonte dot. Ngacmimi një çast iu bë shumë i madh, sa i erdhi si shungullimë e papërmbajtshme. Sado

vonë, Pashai e kuptoi më në fund se kishte luftuar kundër një pjese të vet, kundër asaj që ai nuk e kishte të qartë se ishte qenësia e tij e njëmendët që kërkonte të shpërthente me çdo kusht...

Nëse Sami Pashai kishte hetuar ngacmimin kundërthënës dhe së fundit i ishin sjellë ca vargje që e munduan në formë të një gulçimi të rëndë, e Fadil Pashai kishte vërejtur një shqetësim të vazhdueshëm, që nuk dinte ta shpjegonte se çfarë ishte në të vërtetë, Mustafa Pasha ishte shumë afër t'i nënshtrohej urdhrit të shpirtit, atij shpirti kolektiv, që bridhte brez pas brezi dhe mëtonte që një ditë t'i lidhte fillet tuaja të shkapërderdhura... Me ashpërsi të jashtëzakonshme, pra me mund të madh, ky i kundërshtoi kësaj ndjenje. E kam të qartë se ç'çaste të vështira përjetoi Pashai i nderuar... Të gjitha këto janë të kuptueshme. Dhe në fund zëri i njëmendësisë të tha: deri kur kështu?... Deri kur?... T'u shfaqen viktimat e shumta... gjaku... T'u shfaqen vëllezërit që hiqnin flamujt e të dy perandorive dhe e vritnin njëri-tjetrin në vatan të vetin... T'u shfaq katrahura e jashtëzakonshme që ngjau më pas... T'u shfaq Prifti që të ndoqi si hije... Pastaj, t'u shfaq një mjegullim dhe nga andej buroi një thirrje që ta mori fuqinë... Ishte zëri i Gropanit... A nuk është kështu, Pasha?»

Mustafa Pasha po shikonte me sy të ulur poshtë. Ca djersë të ftohta po i shkonin ballit çurg.

«A nuk ishte kështu, Pasha?»

«Ai megjithatë heshtte. Dukej se do të shkrihej i tëri nga djersët dhe avulli që i shkonte mbi kokë.

«A nuk ishte kështu?» — i tha prapë?

Zuri të murmuriste diçka, por shpejt heshti. Goja nuk ia hiqte ato që i kishin ardhur deri te gjuha.

«Është koha të flasësh! Është koha të flasësh! Duhet ta thuash atë që po të mundon. Do ta kesh më të lehtë...»

«Më muuuuuundooooooiii... Më muuuuuundooooiii», — po belbëzonte ai.

«Thuaje! Thuaje! Gati e ke! Thuaje!»

«Më muuuundoiii njëëë shtrëëngim i pashoq... Më mundoi një shtrëngim i cili nuk dija se çka ishte... Vërtitesha

andej këndej dhe nuk e kuptoja fare se ç'ishte ai shtrëngim që më kapej për kraharor dhe kërkonte të shpërthente... Pyeta mjekë, pyeta mendimtarë, pyeta shpjegues të shenjave të veçanta, pyeta shpjeguesit e ëndrrave... Të gjithë rrudhnin krahët... Keni shqetësimin e njerëzve të mëdhenj më thoshin... Është shqetësim i madhështisë, që nxit para... Por sa më shumë që arrija, ai shqetësim rritej dhe bëhej më i padurueshëm, sa ma zinte frymën. Kot mundohesha ta mashtroja disi duke e çuar mendjen gjetiu. Së fundi, gjithçka m'u shndërrua në një shungullimë të paparë. Ndihmo, zot, thashë. Por shungullima u bë katrahurë, ku kishte zogj të zez dhe gjithfarë qeniesh të tjera të shthurura... Aty mbeta dhe nga andej nuk u ktheva më. Mbeta me atë lëmshin që po e baj pa pra... Së voni m'u shfaq Prifti... Nuk e di se kush më tha se ishte Prifti... Ishte ai prifti i cili kishte disa mijëra veta pas dhe luftonte kundër meje... Në të vërtetë, ai mbronte perandorinë danubiane dhe Gjeneralin e Vjenës... Në atë katrahurë e pashë si hije, e si hije m'u bënë edhe ata që i shkonin pas... Deri kur do të luftojmë njëri me tjetrin, më thotë ai? Deri kur?... Unë mundohem t'i ik asaj hijeje. E ai sërish më thotë të njëjtat gjëra... Pse ma prishe varrin, më thotë? Pse m'i bëre eshtrat copë e grimë?... Pastaj më thotë: eja t'ia themi bashkë! Pse shtiresh që s'më kupton?... Pse?... Unë ik... E marr ikën, por zëri i tij më ndjek... Ai mullani që po më mundon më bëhet edhe më i madh... Nuk e di se çfarë po më mundon në të vërtetë? Nuk e di...»

Pashai nuk po dëneste më. Djersët ende i kullonin, por fytyra që deri pak më parë i dukej shumë e ngrysur, i mori një pamje të butë. Nimani pa se ajo fytyrë ishte liruar nga moria e rrudhave të ngatërruara.

«Është qenia juaj... Është qenia e juaj që t'u ka qepur dhe nuk po të ndahet... Pjesëzat e saj janë kthyer në zërin e Poetit, në të Priftit dhe të tjerëve që po të ndjekin dhe nuk po të lënë të qetë...»

«Shumë kohë mendova se ç'ishte ajo që e çoi tim atë në çmendi, — foli Mahmuti mendueshëm. — Tash i kam të qarta disa gjëra...»

«Shpirti juaj po formësohej mundimshëm, pasha i nderuar, tha kronisti. — Po vinte koha kur po lidheshin hallkat e tij... Këtë e ndjenit si shqetësim, si ngacmim apo si shungullimë të pashpjegueshme. Mustafa Pasha qe i fundit që kësaj ndjenje i bëri ballë me shpatë në dorë. Pashai që erdhi më pas (me Mahmutin dhe Hysniun) paralajmëronte shfaqjen e mirëfilltë të Poetit...»

Pas fjalëve të fundit të kronistit, pashallarët po e shikonin njëri-tjetrin si të kërkonin diçka të panjohur që ishte fshehur kaherë midis tyre.

«Poeti erdhi», — tha kronisti. — «erdhi poeti...»

«Cili poet?», — pyeti Mehmeti plak.

«Ai që ishte te ju dhe, te kush më shumë e te kush më pak, pasqyrohej si shqetësim... Ja ku e keni. Po ju dëgjon dhe po ju shikon gjithë kohës. Me të merr fund shekulli i pushtetit tuaj të fuqishëm. Tash e tutje Qyprillinjtë do të merren me botën e mendimit, me poezi dhe me krijimtari. Nimani nuk do të ulet në fron, edhe pse i ka dyzet ditë kohë për t'u përgatitur për të... Do të merret me poezi e filozofi...»

Pashallarët prapë heshtnin. Mehmeti plak po mërmëriste diçka, por fjalët e tij mbeteshin si të shurdhëra.

Niman Qyprilliu është poet. Është mendimtar. Është pikërisht ai shpirt i qartësuar, i cili kaloi nga brezi në brez duke marrë e duke lënë diçka... Te ky janë sublimuar shqetësimet tuaja shekullore që ju munduan. Nimani është qenia juaj më e përhapur në shumë pjesë... Prej tashit kjo qenie nuk do të frikësohet më nga vetvetja... Ajo nuk do të bredhë kot për ta kërkuar formësimin...»

Fjalët e fundit kronisti i tha me një zë të ngritur. Pashallarët ishin mbledhur kokë më kokë dhe nunuritnin diçka...

«Dhe tash, të nderuar pashallarë, kthehuni në vendet tuaja. Shfaqja mori fund...», tha kronisti.

Fjalët e fundit të kronistit, Nimanit i tingëlluan ftohtë. Mbylli sytë dhe një copë herë u shoqërua me terrin që i krijoi vetes. Kur u kthjellua, pa portretet në mur që po rrinin si të ngrira. Përreth heshtja e shurdhër ishte po ajo

që hasi kur hyri në të. Seç ju kujtua ta pyeste kronistin për atë kohën dyqindvjeçare, që ai e quajti kohë të ngecjes, por hetoi se ishte vetëm, se gjendej fillikat vetëm, se kronisti nuk ishte kund... Aty ku mendja ia thoshte se pak më parë ai rrinte dhe fliste, gjendej tavolina e drunjtë me plot e përplot kronika përmbi. Fërkoi sytë disa herë si të kërkonte të hiqte mjegullimin që iu duk se i qe shfaqur para, por më kot. Shihte vetëm librat e trashë dhe portretet në mur. Asnjë gjurmë dhe asnjë shenjë e skenës së pakmëparshme. Ç'përfitime ishin ato vallë, po i thoshte vetes dhe koka e tij sërish zuri t'i rikthente pjesëzat e Sarajit të praruar. Kështu ngatërrueshëm po i shfaqej një pamje e çuditshme ku kishte nga të gjitha nga pak. Mozaiku që po i krijohej ishte plot e përplot qenie të deformuara. Dëshironi që kjo pamje t'i shqiste sa më parë nga mendja. Për ta larguar, zuri sytë me duar dhe ndolli një terr të thellë, në të cilin do të mbyteshin njëherë e mirë konturet e realitetit. Dëshiroi që në atë terr koha të mbetej e paqenë. Dëshiroi që koha ta humbte rëndësinë që kishte. Ishte i bindur se e dëshironte një kohë të pakohë, nga e cila nuk do të shkëputej kurrë... Një copë herë mendoi për kohën e paqenë dhe sa më shumë që mendoi, hetoi se po i formësohej një si libër i trashë, që po i hapej para ngadalë. Për habi, ai libër i trashë shkronjat i kishte të shndëritshme dhe shquheshin qartazi nga larg. Shkronjat po i afroheshin sa i ranë në gjunjë. Madje iu bë se librin po e prekte dhe po e mbante në duar që të mos i ikte...

(Koha e dyqindvjetorit dhe libri shtesë i kronist Selajdinit)

Sanxhakbej Ali Evernozi rrinte në tendën mavi dhe pinte shurupin e freskët. Nga mendja nuk po i shqiteshin relievet e ashpra ku ndërroheshin pareshtur malet, bjeshkët, grykat e zeza e lumenjtë që herë gumëzhonin e herë treteshin si t'i kishte përbirë toka. I bëhej se lundronte në atë reliev të shtrembër. Vend ugurzi, vend ugurzi, oshëtiu dhe iu duk se oshëtima përpak ia hoq pamjet që dëshironte t'i

shlyente nga kujtesa. Vend ugurzi, tha Ali Bej Evernozi dhe për të tretën herë dhe thirri Kadiasqerin që t'i raportonte...

Kadiasqeri erdhi me nxitim. I veshur me veladonin e zi, dukej si hije. Sanxhakbeu një kohë të gjatë nuk ia ndau shikimin fytyrës së zverdhur që i vinte si kufomë. Një çast iu bë se përpara kishte një të vdekur, i cili po i rrinte balla-ballës si kufomë për ta trishtuar. Ç'është e vërteta qysh çastin kur e emëruan sanxhakbej të Tokës së Lashtë i shkoi mendja se vendit ugurzi medoemos i duhej një surrat i tillë që kall datën në shikim të parë. Por tash që po i rrinte përpara dhe prisie urdhrin për të folur, iu duk si vetë kobi, që po e ndiqte kushedi sa kohë, e nga i cili nuk kishte shpëtim... Duart e tij të zbehta padashtas prekën fytyrën e ftohtë, pastaj sytë e lodhur që iu mbyllën; kështu që midis tij e Kadiasqerit u shfaq një terr i mistershëm, në të cilin sharruan që të dy. Në atë terr po sharronin ngadalë, si në ndonjë kënetë edhe taborret e ushtrisë, po sharronin edhe topat e rëndë që kishte me vete dhe në fund po sharronin edhe tendat e panumërta, të cilave u shiheshin shtizat me flamujt e lodhur. Dhe ata flamuj të molisur kullonin gjak, kullonin gjak të zi, që ngjitej ngado... Kjo e trishtoi aq shumë Sanxhakbeun sa me nxitim hoqi duart nga fytyra, e përkoi atë disa herë, pastaj kërciti gishtat, u ngrit rrëmishëm dhe u soll nëpër tendë pa ditur se çfarë kërkonte. Të gjitha këto i vërejti Kadiasqeri, i cili hetoi çastin se duhej të fliste mbase edhe për t'i ndihmuar Sanxhakbeut që ai ta hiqte ankthin që po ia shfaqte fytyra sheshazi.

— Rrethimi u krye, tha Kadiasqeri. — Të njëjtat gjëra përsëriti edhe një herë, ngase iu bë se ato që i tha, humbën ende pa e prekur veshin e Sanxhakbeut.

Sanxhakbeu një copë herë u soll pa cak e pastaj, si t'i kujtohej diçka, u kthye në shilte dhe tha:

— A patët telashe?

— Jo, madhëri, tha ai duke u përkulur thellë. — Ushtria jonë iu afrua kështjellës nga ana e lumit dhe nga ana e kodrinës. Kur u bashkuam te pjesa ballore, për ta krijuar

gjysmërrethin e nevojshëm, m'u bë se zogu i zi në shtizën e lartë në majë të pirgut dukej i përgjumur. Gjatë ia shikova valëvitjet dëshpëruese dhe më shkoi mendja te dita e nesërme kur vendin e tij do ta zinte gjysmëhëna jonë për të mos u larguar kurrë më nga ajo kaltëri. Allah, ç'dëshpërim do të ndiejnë ata? mendova. Krenaria jonë do të bëhet edhe më e madhe kur Princi-vasal do të ulë flamurin e vet e do të ngrejë tonin... Akte të tilla i pres me padurim dhe më bëhet zemra mal kur shoh sesi, një nga një, stemat, emblemat, flamujt dhe shenjat e tjera të princave të mundur përgjithmonë ua lëshojnë vendin shenjave tona...

— Mirë, — tha Sanxhakbeu, — le të veprohet sipas marrëveshjes. Kur dielli ta marrë tatëpjetën, takohemi para Kështjellës. Mos i harro dhuratat për Princin.

— I kam marrë të gjitha masat që Princit vasal t'i shkëlqejnë sytë nga flakërimi i dhuratave tona. Atë flakërim duhet ta përjetojë e gjithë principata që nuk do të jetë më... I madh e i vogël në këtë vend duhet ta shohë shkëlqimin tonë dhe të mësohet të jetojë me të...

Pas një heshtjeje të shkurtër Kadiasqeri zuri të fliste edhe për masat e tjera që kishte ndërmarrë. Sidomos u ndal te çallgitë, të cilat do ta shqyenin qiellin me tingujt e tyre.

— Duhet ta dinë se tash e tutje në këto anë do të dëgjohet vetëm kënga jonë, kënga perandorake, e cila do të bëjë që të vdesin këngët e tyre harbute...

Sanxhakbeu nuk e la të fliste më. Ia bëri me dorë dhe i dha shenjë se biseda kishte marrë fund. I tha se nevojitej pushimi dhe uli kokën që të mos e shihte më në fytyrë Kadiasqerin, ngase kishte frikë prej përftimit të pakmëparshëm, kur ai hyri në tendë dhe iu duk si kufomë. Por, sado që nuk e pa kur doli (veç ia dëgjoi hapat, ata hapa me të cilët ishte mësuar tash sa kohë), mendja e tij aty për aty krijoi konturet e një kufome të mistershme që fluturonte e mbështjellë me veladonin e zi. Duke fluturuar, kufoma kapte yjet, i shuante dhe ashtu të shkrumbuar i ngarkonte mbi krahët e zez. Dikur kufoma që ishte rritur e zmadhuar së tepërmi, iu sul tendave që shtriheshin afër kështjellës. Mos! Mos! klithi Sanxhakbeu. Klithi aq shumë sa roja që

rrinte në paradhomë nxitoi brenda. Shikimi kureshtar i rojës që i rrinte pranë dhe i përkulej, e nxori nga ankthi. E pati të qartë se prapë e kishte munduar përftimi i lig, të cilit ia pati frikën.

Për t'i ikur shfaqjes së sërishme të përftimit urdhëroi që t'ia sillnin klarinetistin plak.

Kur hyri plaku me klarinetë, Sanxhakbeu po rrinte i kërrusur dhe po mendonte për ligështimin që kohëve të fundit nuk po i hiqej. Plaku e dinte se çfarë duhej të bënte dhe, atypëraty ia mori një melodie nga ato që i pëlqenin Sanxhakbeut kur ishte në gjendje të tillë. Tingujt e klarinetës filluan të mbushnin tendën me ngrohtësi dhe ai ngadalë po lirohej nga mërdhitja që e kishte pushtuar të tërin. Pas pak u ul këmbë kryq dhe po i luante tespihet e qëlibarit. I luante plogësht, thuajse gjithë forcën ia kishte thithur heshtja përreth që thyhej nga melodia e klarinetës. Ishte hera e parë që koha njëditëshe para marrjes së kështjellës i ishte kthyer në një pritje të ethshme. Ç'është e vërteta ai, gjatë njëmbëdhjetë vjetëve të fundit, kishte marrë në dorëzim gjashtë kështjella të ngjashme (tri në Bullgari, një në Serbi e një në Greqi) si dhe po aq princa ia dorëzuan sovranitetin duke u bërë vasalë, por nuk i kishte ndodhur që para apo pas ceremonialeve të ngjashme të shqetësohej apo të ligështohej në atë masë sa të kërkonte shpëtim nga klarineta që e donte aq shumë... Përkundrazi, në raste të tilla ndjehej i fortë, krenar dhe mbi gjithë botën. Çastet kur princat e mundur ndër beteja, ose ata që e lutnin për paqe, ia dorëzonin flamurin dhe hiqnin stemat e tyre të vjetra nga kështjellat për t'i zëvendësuar me ato perandoraket, i priste me padurim.

Të tillë e paramendoi edhe çastin e marrjes në dorëzim të kështjellës së tashme. Bile, kur e njoftuan se emërohej sanxhakbej i Tokës së Lashtë (me sqarime plotësuese se një pas një do t'i kishte në mbikëqyrje edhe tri kështjella të tjera që shtriheshin deri aty ku puqej kufiri i devotshëm midis dy botërave, i Lindjes dhe i Perëndimit), u ngazëllye aq shumë, sepse e dinte se tutje-tëhu shtrihej bota për të cilën flitej tash sa kohë, se «pa atë botë pera-

ndoria ishte e gjymtë...» Të jesh sanxhakbej i sanxhaqeve të mesme, që kufizohen me njëri tjetrin, ishte njësoj si të rrije kot në një fron të përgjumur. Andaj, lajmi se do të qeveriste sanxhakun e skajshëm, aty ku kishte arritur pushteti perandorak me aq mund, ia regëtiu shpresën se nuk do të zhytej në ndonjë gjumë të thellë shumëvjeçar (siç ngjau gjatë njëmbëdhjetëve të fundit), që doemos do të ndodhej në ankthin e pritjeve dhe përgjimit që të shkonte më tutje nga bota që duhej t'u përkiste. E kjo do të thoshte shumë, ngase në Kryesheher, e mbase në të gjithë perandorinë, do të flitej për të me nderim, si për njeriun që ndodhej në krye të pjesës më të rëndësishme të perandorisë, aty ku shekuj e shekuj me radhë u bënë copë e grimë besimet e ndryshme dhe u ndeshën perandoritë e shumta, ku filluan kryqëzatat e panumërta, e ku u zhvilluan betejat më trishtuese dhe gjithnjë vendimtare qoftë për Lindjen qoftë për Perëndimin...

Sado që aty tashmë nuk kishte luftë dhe gjithçka i ishte nënshtruar një heshtjeje të shurdhër, Sanxhakbeu e dinte se nyjet e ambicjeve të ndryshme aty gjithmonë qenë mpleksur keq e nuk do të çplekseshin kurrë qoftë edhe me mashtrime, dorëzime të kështjellave apo me pranimin e vasalitetit, siç ishte rasti i fundit. Në atë vend, i kishte thënë një njohës i rrethanave të përgjithshme të asaj bote, asnjëherë nuk ka pasur paqe e nuk do të ketë kurrë. Aty edhe paqja është luftë e edhe lufta është si paqe! Ngjau kështu ngase e gjithë bota i pati sytë aty dhe i ka ende. Çuditërisht në atë hapësirë gjithmonë dikush i fut gishtat fshehtas, kështu që edhe kur duket se nuk ndodh gjë, patjetër se zhvillohet një garë e jashtëzakonshme mu në thellësitë e saj. Prandaj, nuk është për t'u habitur pse atje tronditjet shfaqen papritmas dhe sherret midis të mëdhenjve gjithnjë kanë nisur aty... Aty është nyja e botës... Kush e ka atë nyje mund ta ketë në shuplakë të dorës dhe Lindjen e edhe Perëndimin... Ai i kishte thënë pastaj sesi sanxhakbej i atij vendi, kurrë nuk e kishte pasur më afër famën, por edhe kobin. Në çdo çast, i kishte thënë mund të ngjitesh në qiell, e po ashtu në çdo çast mund të sharrosh shtatë pashë thellë në tokë...

Ky mendim, në vend që t'i sillte të dridhura, e ngushëlloi ca dhe i erdhi mirë që iu kujtua mu në çastin kur u mbërthye keqas nga ligështimi i pakmëparshëm. Nyja e botës, pështpëriti. Nyja e botës... Mund të shembesh e mund të ngrihesh... Shtatë pashë lart e shtatë pashë thellë në tokë?... A nuk është kjo e madhërishme? Atje edhe fitorja është e jashtëzakonshme, por edhe vdekja është e madhërishme?... Këto fjalë ia tha vetes disa herë dhe heshtja e natës që thyhej nga melodia e klarinetës iu bë më e gjallë, aq e gjallërueshme saqë uroi që koha të ecte sa më shpejt, që drita ta zëvendësonte aty për aty natën, në mënyrë që të vinte çasti ku do ta merrte në dorëzim Kështjellën, atë Kështjellë për të cilën tashmë ishte i bindur se ishte më e rëndësishmja e perandorisë së pafund, prej ku do të fillonte një faqe e re, ajo faqja e re, ajo faqja e mbushur fund e krye me emrin e Ali Bej Evernozit...

Nga përfytyrimi nuk po i shqiste ajo faqe e madhe e historisë. I shfaqej e madhe, disi si përrallore, në të cilën shkronjat e panumërta ngatërroheshin e ngatërroheshin shthurshëm duke thirrur nga të gjitha anët lavdinë e tij, atë lavdinë e madhe e cila do të shndriste në të gjithë vendin. Iu bë se emrit të tij po i përkuleshin të gjithë me radhë nga aty e deri te Saraji i praruar dhe pa një qilim të kuq të shtruar për të që po e shpinte deri në majën më të lartë ku të tjerët nuk do të ngjiteshin kurrë... Përreth turma e pafund po ia thoshte emrin. Ia thoshte dhe duartrokiste. Gëzohej. Çirrej... Në atë zhurmë ai dëgjonte emrin e tij që po i vinte si Allll, Aallll, Allahh...

Nga ecejakja e gëzueshme doli vetëm atëherë kur hetoi se po agonte. Fërkoi sytë dhe pa klarinetistin plak si po kotej me instrumentin e lagur pranë...

Hetoi se dita hynte e gjymtë dhe kjo i solli të dridhura të panumërta...

Jehona e daulleve hyri në tendë me rrezen e parë. Sanxhakbeu ende po merrej me fijet e mendimeve të shkapërderdhura, kur veshët ia kapën ca tamtame që i jehuan si ogur i lig. Në fillim mendoi se edhe ato qenë pjesë e mendimeve që e rënduan gjatë natës por shpejt kuptoi se oguri

po shtohej sa çdo pjesë e tendës, që tash i dukej e ngushtë, po mbërthehej nga jehona shurdhuese. Një çast deshi të ikte nga tenda dhe gati po nisej kah dalja, kur para i doli fytyra e zverdhur e Kadiasqerit.

— Ç'është kjo gjëmë, — pyeti Sanxhakbeu?

— Po bien daullet e tyre, — foli ai duke bërë me dorë kah Kështjella...

— Domethënë, — foli Sanxhakbeu duke murmuritur, — domethënë, ata e shkelën marrëveshjen?

— E shkelën dhe kjo nuk është shenjë e mirë që dita e sotme fillon në këtë mënyrë. Në marrëveshje shkruan qartë se me rastin e dorëzimit, pra të marrjes së kështjellës, nuk guxojnë t'i prekin armët apo daullet.

— Do të thotë se ata mendojnë ndryshe?

— Mbase mendojnë, kur veprojnë kështu, por...

— Ç'është ajo «por»?

— Thonë se i kanë ca zakone që nuk u nënshtrohen marrëveshjeve... Ndër to bien edhe daullet. I mbajnë gjithnjë pranë, në gëzime dhe në shqetësime, kur humbin dhe kur fitojnë... Po të jetë kështu, atëherë nuk kemi pse të shqetësohemi... Çastin kur e marrim kështjellën, të parën gjë që mund ta bëjmë nisim luftën kundër adeteve të tilla deri sa të bëjmë që të heqin dorë prej tyre... Për këtë kemi kohë...

— Kohën e kemi për të luftuar me botën tjetër që e kemi përtej, e jo me dokrrat e tyre... Vaj për ne po qe se do të na ngjajë të merremi me perandoritë e tjera që na rrinë ndesh... Nënçmuese është për ne çdo luftë që mund të bëjmë me ta... Elefantit nuk i ka hije të kacafytet me miun...

— E qartë, madhëri... Nuk duhet t'ua vëmë veshin fare...

— E tash, foli Sanxhakbeu, — kalli çallgitë tona. Edhepse ende nuk është koha, le ta shqyejnë qiellin. A kuptove? Le ta shqyejnë qiellin. Vetëm kështu madhështia jonë do ta bëjë të paqenë fodullëkun e tyre...

— Peqej, madhëri...

Kadiasqeri nxitoi me sa i hanin këmbët, ndërsa Sa-

nxhakbeun u përpoq ta qetësonte zemrën e sfilitur nga jehona e daulleve, të cilat ia çuan peshë si asnjëherë. Pas pak çallgitë filluan të binin nga të gjitha anët. Për habi, sado që fuqia e tyre ishte shumë e madhe, atij i bëhej se ato ishin të pafuqishme që ta mbulonin jehonën e daulleve! I dëshpëruar, urdhëroi që çallgixhinjtë t'u binin edhe më shumë çallgive. T'i kallni, t'i kallni, tha me një zë dëshpërues dhe zuri kokën me duar që të mbrohej nga tamtamet e daulleve, të cilat nuk i dëgjonte kush pos tij. Bile, Kadiasqeri i tha se kishte kohë që tamtamet e mallkuara nuk dëgjoheshin më në atë afërsi. Me të filluar çallgitë ato u bënë të paqena... Por, Sanxhakbeu shfreu gjithë tërbim dhe tha se tamtamet po shungullonin, se ato nuk kishin prajtur dhe nuk do të pranin përderisa dikush t'i bënte copë e grimë, një nga një, bashkë me ata që u binin... Kadiasqeri, me gjysmë zëri dhe gjithë frikë, i tha se një gjë të tillë tash për tash nuk mund ta bënin (së paku derisa të merrnin Kështjellën), sepse punët mund të ngatërroheshin aq shumë e aq keqas sa të kishte pasoja të padëshirueshme. Nga Kryeshehri na bëjnë me dije se aty-këtu mund të lëshojmë pe, po qe se gjërat mund të marrin kahe të padëshirueshme. Perandoria e synon nënshtrimin e plotë në etapa, i tha Kadiasqeri, i bindur se do t'i ndihmonte t'i pakësohej hidhërimi. Pandehja se gjendje të tilla do të kishte në këtë vend edhe herëve të tjera, e bëri të dridhej me dëshpërim. Dëshpërimi iu ngjit në fyt dhe po e shtrëngonte gjithnjë e më shumë kur iu kujtuan ato që i patën thënë në Kryesheher «se në atë vend mund të ngjitesh shtatë pashë lart dhe mund të biesh shtatë pashë poshtë...» Nuk është aty kot kufiri i të dy botëve... Nuk është kot... Po të ishte ndryshe as që do ta kishte zënë ngojë...

«Kufiri i dy botëve... Kufiri i dy botëve...» Këto fjalë iu sollën në kokë dhe çuditërisht e ngushëlluan, saqë aty për aty nuk i ndjeu më tamtamet e daulleve, e as jehonën e çallgive që kishte mbushur gjithë hapësirën përreth me zhurmë të papërmbajtshme... Iu bë se u zhyt në një hapësirë të mbushur me një heshtje thithëse, ku ai notonte prajshëm mbi një jeshillëk të harlisur, ku kishte lule, ku

kishte gjithfarë drunjsh të butë me degë të kacavarura kah toka... Aty pa zogj shumëngjyrësh që fluturonin prajshëm dhe cicëronin gëzueshëm... Aty pa çmos, dhe me dëshirë do të mbetej në atë vend po të mos i thoshin se kishte ardhur koha e marrjes së kështjellës. Një copë herë fërkoi sytë, sikur të dëshironte me çdo kusht të mbante sa më gjatë përfytyrimin e pakmëparshëm. Por s'qe e mundur më, ngase fjalët për kohën e marrjes së kështjellës po i vinin të përsëritura dhe gjithnjë më të fuqishme sa që prej tyre jeshillëku po i thyhej e po i thyhej gjithnjë më shumë dhe në ato të çara, që vinin e zgjeroheshin, shfaqeshin konturet e një fytyre të ashpër që nuk e pati vështirë ta njihte. Për t'i ikur formësimit të saj të plotë (së cilës i dronte frikshëm) tha gjithë murmuritje se shpejt do të merrte rrugën e kështjellës...

Kur doli jashtë, dielli i vrau sytë. Pastaj një perde e errët që iu shfaq ia shndërroi aty për aty gjësendet dhe njerëzit në konture të mjegulluara, kështu që ato si të ngjizura, po i shqitnin para si silueta të dala nga njëmendësia. Në vend të atyre që po i përkuleshin nga të dy anët (që në të vërtetë ishin ushtarët e rreshtuar), ai po shihte hije të mjegulluara, dhe e mjegulluar dhe pa kurrfarë përmbajtjeje po i shfaqej edhe kështjella, e cila si e tillë i gjasonte një grumbulli të thyer vijash, të cilat ngjizeshin njëra mbi tjetrën, herë nga lart, herë nga poshtë, e herë anash, pa ndonjë kuptim të caktuar... Një kohë të gjatë gjërat i pa të përdala nga njëmendësia e tyre, derisa dikur, pak nga pak, zunë t'i formësoheshin. Megjithatë, derisa u bë formësimi i tyre i plotë kaluan edhe ca kohë, kështu që shumëçka iu duk e çoroditur dhe ndjellakeqe... E mbi të gjitha ndjellakeqe iu duk ajo heshtja e shurdhër që e ndjeu kur po i afrohej shkallores së kështjellës, mu aty ku qe paraparë që Princi t'ia dorëzonte kështjellën, e ai Princit t'ia jepte kartën e perandorisë, që për Princin do të thoshte hyrje me dëshirë në vasalitet të plotë, ku principata e tij i humbte kufijtë që kishte dhe përfundimisht shkrihej në hapësirën e madhe perandorake, bashkë me shumë e shumë principata që nuk ishin më, emrat e të cilave defterët perandorakë nuk do t'i shënonin më...

Sytë e tij, tashmë të liruar nga mjegullimi i pakmëparshëm, më kot po i kërkonin kështjellarët me rroba solemne dhe me lule në duar, duke i dëshiruar mirëseardhje nga të dy anët e shkallores. Ai po shihte një zbrazëti të frikshme që kufizohej anash me mure të shkreta, të cilat iu dukën shumë të ftohta. Befas, mendja i shkoi te ndonjë e papritur e këndshme, që po ia pregatitnin ata që nga ajo ditë bëheshin vasalë të përjetshëm. Kur e pati marrë kështjellën e dytë me radhë (diku në Rumeli), pati përjetuar çaste shqetësimi të përkohshëm, ngase ata që duhej t'i dilnin përpara në kohën dhe në vendin e paraparë nuk po i shihte. U desh të bënte edhe njëmbëdhjetë hapa të tjerë (jashtë marrëveshjes) dhe që gati të pyeste se çfarë po ndodhte, kur nga pjesët e fshehura të mureve dolën ca vasha të veshura me të bardha dhe me lule shumëngjyrëshe në duar. Nga lulet, ato gjithë shkathtësi formuan një kurorë të madhe që ia vunë mbi kokë. Pastaj u shfaqën edhe të tjerët, të cilët rrugën deri në vendin e dorëzimit të kështjellës, ia shtruan me lule dhe i thanë fjalë të panumërta mirëseardhjeje... Mbase edhe këtu do të stolisem me kurorë të tillë, mendoi. Mbase ajo do të jetë kurorë mbi kurorë. Mbase do të jetë më e madhja, më e bukura, më e madhërishmja... Iu bë se i madh e i vogël po rrinin nëpër biruca dhe po prisnin çastin që të dilnin... Nuk kanë se nga t'ia mbajnë, po i thoshte vetes... Nuk kanë... Do të dalin i madh e i vogël dhe unë do të qesh me ta... Do t'i shikoj gjithë nënçmim... Tekefundit a s'e meritojnë këtë vasalët? Por, kur po merrej me nënçmimin, nuk e dinte as vetë se pse iu shfaq surrati i Kadiasqerit dhe përftimi i tij prej kufome? Nuk kaloi shumë (pasi iu afrua pjesës ku zgjerohej shkallorja dhe fillonte ngushtica që shpinte kah porta e Kështjellës), njëmend iu shfaq Kadiasqeri me atë pamjen e ftohtë... Shikimi i tij i ngrirë ia bëri edhe më të akullt atmosferën sa ndjeu të dridhura.

— Pse më rri ashtu i ngrirë, — i tha për ta mundur disi gjendjen e padishirueshme.

Kadiasqeri po matej të fliste, por fjalët po i silleshin nëpër gojë. Pas një mundimi të madh ai foli e tha:

— Madhëri, na kanë mashtruar...
— The se na kanë mashtruar?
— Na kanë mashtruar.
— Kush është ai që mund të mashtrojë perandorinë më të madhe të botës? Pa më thuaj? A ka të tillë?

Kadiasqeri u bë dyllë. Një copë herë ju kyç goja. Sanxhakbeut seç i pëlqeu ta shihte në atë gjendje, e shikonte dhe nuk shfaqte shenja të një shqetësimi. Dikur tha:

— Princi... Princi... Na mashtroi Princi...

Kadiasqeri deshi të thoshte diçka për ta bërë edhe më të plotë mendimin, por Sanxhakbeu i dha shenjë të mos fliste tjetër. U nis me të shpejtë kah porta e madhe e kështjellës, pa çarë kokën për ato që deshi t'i thoshte oficeri i sigurimit për rrezikun që të ecte vetëm, para të tjerëve. Edhe atij, si pak më parë Kadiasqerit, ia bëri me shenjë të heshtte, pa u përzier në veprimet e tij, të cilat tashmë ishin instiktive. Megjithatë, oficeri i sigurimit dhe truprojet e tjera, që e dinin mirë detyrën e vet, morën turr para duke ua bërë me dorë rojeve që të nxitonin nga të dy anët e skajshme, në mënyrë që të pengonin ndonjë të papritur që ishte e mundshme në rrethana të tilla. Pas tyre po ecte Sanxhakbeu sikur të çante nëpër ndonjë fërfëllizë. I rrethuar nga muret e zbrazëta, të cilat sa më shumë që i afroheshin portës ballore bëheshin më të thepishme, ai dukej si një i ikur, i cili nxiton dikah pa ditur se kah... Këtë ia tregonte ecja me frikë dhe shikimi i tij i trembur, që i përplasej herë në të majtë e herë në të djathtë pa zënë kund vend. Vetëm kur iu afrua portës së madhe, sa s'e preku me hundë, u ndal dhe mori frymë thellë. Një copë herë ndenji aty i shtangur dhe e para gjë që iu kujtua ishte ajo se sa i pakuptimtë mund të ishte ceremoniali i marrjes së kështjellave, po që se zhvillohej nga gjoja marrëveshja midis fitimtarit që fiton dhe të mundurit që e pranon vasalitetin. Gjatë marrjes së kështjellës së mëparshme (e kjo ngjau një vit më parë), një çast i kishte shkuar mendja se çfarë do të bëhej po që se në ceremoniale të tilla diç do të çalonte. Mendimin ndjellakeq e kishte flakur shpejt, ngase ishte i bindur se kjo nuk mund të ndodhte kurrën e kurrës përderisa të ki-

shte ngadhënjimtarë dhe të mundur, perandorë dhe vasalë... Por ja se ajo që dikur i dukej e pamundur tash po i njëmendësohej dhe ai, Sanxhakbeu i rendit të parë të perandorisë më të fuqishme të botës, i ngarkuar me detyrën e shenjtë që të merrte përsipër kështjellën e parafundit të Tokës së Lashtë, mu aty ku pareshtur kishte kaluar kufiri midis Lindjes dhe Perëndimit, pra i dy botëve, të cilat nuk kishin pajtim, u poshtërua nga një princ i vogël, shumë i vogël, të cilit nuk ia dinte mirë as emrin. Allah, shfreu vetmevete në këtë vend ugurzi çmos mund të ndodhë dhe mendja i shkoi te kronikat e gjata që kishte lexuar para se të emërohej sanxhakbej i këtij vendi. Në njërën sosh, të cilën kur e lexoi e quajti ndjellakeqe, flitej për shpirtërat e shqetësuar që bredhin dhe duke bredhur kthehen në trajta të ndryshme dhe njëmendësohen, herë si ura, herë si kështjella, herë si murana në të cilat ngatërrohet jeta me vdekjen... Makabre i që dukur një legjendë për të cilën thuhej se ishte shumë e përhapur dhe që bënte jetë variantesh të ndryshme. Sipas asaj legjende, në të njëjtin kalë ecnin bashkarisht jeta dhe vdekja! A nuk ishte rrëqethës përfytyrimi ku jeta në të njëjtën kohë ishte vdekje dhe vdekja në të njëjtën kohë ishte e jetshme dhe se kufiri midis njërës gjendje në tjetrën jo vetëm që nuk ekzistonte, por shlyhej përfundimisht...

Atëherë i qe turbulluar mendja keqas, e e njëjta gjë i ndodhi edhe tash kur po rrinte si i ngrirë para portës së madhe dhe po e priste që të ndodhte diçka, diçka çkadoqoftë, që do ta nxirrte nga mendimet rrëqethëse për atë farë makabriteti ku njeriu mund t'i shfaqej në të njëjtën kohë në të dy gjendjet. Pra, si i gjallë apo si i vdekur, pa ditur se me kë ka punë: me të gjallë apo me të vdekur. Vetë djalli është njësuar me ta, mendoi, dhe pikërisht pse mendoi se mund të ishte kështu, iu shfaq një shpresë flakëruese se Princin do ta takonte shumë shpejt, se mbase gjatë gjithë kohës ai ishte në vendin e duhur, se mund ta kishte shoqëruar sipas marrëveshjes, e të tjera e të tjera... Por që ai, nga ngutia, nuk e kishte hetuar ndoshta mu për shkak të makabritetit, pra të shtrirjes së jetës në vdekje dhe të vdekjes në jetë...

Sytë e tij të shqyer po kërkonin para dhe anash dicka që duhej të ishte aty pranë, fare pranë tij, ndoshta ngjita-ngjit tij. Kjo e shqetësoi sa zuri të dridhej. Të dridhurat i kishte aq të furishme sa ia hetuan edhe ata që po i rrinin pranë dhe pritnin që të kalonte portën. Bile, Kadiasqeri, njëherë u mat t'i thoshte se duhej të hynte atje për ku ishte nisur dhe, me Princin apo pa të, duhej ta merrte kështjellën, ngase koha e paraparë sipas marrëveshjes kishte kaluar moti. Megjithatë, Sanxhakbeu e kaloi portën e madhe vetëm atëherë kur u bind se, sado që nuk e shihte Princin, ai ishte me të dhe po e shoqëronte... Kjo shkaktoi njëfarë hutie te ata që po e përcillnin, saqë zunë të frikësohen. Atij që pak më parë i dridhej trupi dhe fytyra i qe ngrirë, tash i ishte kthyer njëfarë hareje jo e rëndomtë. Ecte krenar, thuajse ceremoniali i marrjes së kështjellës ishte kryer sipas parashikimeve dhe, si edhe në raste të tjera, pranë kishte princin vasal që po i përkulej... Gjendja e mpirjes së Sanxhakbeut (siç e cilësoi më vonë Kadiasqeri) zgjati gjithë pasditen, kështu që për habinë e të gjithëve, ai kërkoi të fliste në shesh (edhe pse përpara kishte vetëm ca pleq dhe disa fëmijë që i sollën aty me dhunë), pastaj foli (sikur t'i kishte në gjunjë të gjithë vasalët), bëri një shëti nëpër pjesën më të rrezikshme të kështjellës (andej nga kalonte lumi dha shkëmbinjtë thyheshin rrëpishëm në një humnerë), e çishte më e rëndë për ata që e përcillnin, qe imitimi i marrjes së stemës dhe të emblemës së Princit. Sanxhakbeu, siç kishte vepruar edhe në dy kështjellat e tjera, së pari qëndroi gatitu, pastaj shikoi djathtas e majtas (sikurse t'i kishte vasalët përpara) dhe me hap të rëndë u nis drejt pjesës ballore të sheshit, aty ku kulla e Princit dukej e shkretë, pa stemë, pa emblemë, e pa flamur... Fliste vetmevete, herë duke ngritur zërin (në formë të urdhrit, e herë duke shtruar ndonjë pyetje, të cilën e vazhdonte sërish pas ndonjë pushimi, që tregonte se bashkëbiseduesin ai e përfytyronte pranë si bashkëveprues...

Sorollatjet e Sanxhakbeut dhe stepjet e atyre që i rrinin pranë vazhduan derisa dielli iu afrua majës së malit dhe rrezet e tij e humbën dritën që kishte pak më parë. Atë

çast Sanxhakbeu kërkoi t'ia sillnin flamurin e Princit që ta përdhoste sipas zakonit perandorak, e në vend të tij të ngrinte atë të perandorisë. Kadiasqeri, që deri atëherë kishte heshtur i brengosur, pa pasur guxim t'i thoshte gjë, u zu ngushtë. Si t'i thoshte Sanxhakbeut se Princi e kishte marrë me vete flamurin bashkë me stemat dhe me emblemën? Si t'ia bënte me dije se shtiza ishte e shkretë që nga mëngjesi i asaj dite ugurzezë? Si t'ia tregonte gjithë këto atij që ishte mpirë dhe nuk shihte gjë pos që bartej zvarrë tash sa kohë nga përfytyrimet? T'i thoshte të vërtetën, dronte se ai sërish do të bënte sikur e shihte flamurin dhe do të kërkonte me këmbëngulje ta përdhoste. Ta mashtronte disi, po ashtu i vinte keq nga ata pak vendës të cilëve po ashtu ua hetonte nënçmimin dhe gazin, sado që nuk kishin guxim që këtë ta shprehnin. Çfarë të bënte, pra? Për herë të parë e mallkoi fatin e zi që ishte ngritur në atë post për të përcjellë titullarë të lartë, ambiciet e të cilëve për të arritur domosdo sa më shumë, kthehen në ankthe të papara... Si? Si? Të fliste çkado apo të shtirej se nuk shihte apo nuk dëgjonte? Pas një hamendjeje foli e tha:

— Princi nuk është këtu. As flamurin nuk e ka këtu, — tha me një zë të ulët që iu bë se nuk e dëgjoi as vetë atë që e tha.

— Princin e kam pranë, — ia ktheu Sanxhakbeu. — Princi po më shoqëron. A nuk e di se Princi është i dëgjueshëm? Princi nuk bën hap pa më pyetur mua... Erdhi koha që t'ia heq flamurin... Marrëveshja është marrëveshje... Apo jo, Princ?

— Madhëri, — foli prapë Kadiasqeri, — e di se nuk e keni të lehtë por...

— Flamurin, flamurin e dua, — zuri të çirrej Sanxhakbeu. — E dua flamurin e tyre... Koha është ta përdhos sipas rregullave tona... Mjaft na i shkallmoi sytë nga ajo shtizë... Nuk do të valëvitet më krenar...

— E ku ta gjejmë, madhëri?

— Atje në shtizë... Në shtizë... Po e shoh në shtizë... Është i madh... Zogu i tij është ogurzi... Do t'ia shkurtoj krahët... Hiqeni sa më parë!

Kadiasqeri heshti ndërkohë që Sanxhakbeu po çirrej dhe po e rrihte fytyrën. Kadiasqeri e dinte se vetëm kështu ai po e hiqte ankthin që iu shfaq nga tronditja e rëndë pas nënçmimit që i kishte bërë Princi, i cili nuk deshi t'ia dorëzonte solemnisht kështjellën bashkë me flamurin, me stemat dhe me emblemën...

Ata që ishin pranë tij (qenë vetëm ca përcjellës nga më kryesorët, ngase Kadiasqeri kishte urdhëruar që ushtria të priste jashtë) panë diçka që do t'u mbetej gjatë në kujtesë për të keq... Sanxhakbeu, pas asaj çirrjeje për flamurin, që e kërkonte domosdo, u kaplua nga ca diersë të forta, sa ato po i shkonin çurg. Pastaj u ul e u bë këmbë e krye. Prapë u ngrit. Shkuli flokët dhe pasi disa herë rresht u ngrit dhe u ul, së fundi u plandos përtokë dhe mbeti si i pajetë... Kadiasqeri vrapoi t'i ndihmonte. E dinte se tashme ishte liruar nga ankthi dhe gjendja e ethshme që e mundoi aq gjatë. Urdhëroi ta bartnin deri në tendë dhe për këtë të mos flitej fare...

Sanxhakbeu doli nga ankthi diku në mëngjes. Kur drita e gjymtueshme preku fytyrën e tij, ai kërkoi ujë. Më pas kadiasqeri, si t'i fliste një të huaji, i tregoi gjerë e gjatë sesi Princi kishte thyer marrëveshjen duke marrë me vete stemat, emblemën dhe flamurin... Pastaj i tregoi për repartin ndëshkues që e kishte nisur me të vetmin qëllim që ta zinte sa më parë Princin dhe ta sillte të lidhur përmes principatës, por që, mjerisht, ata nuk kishin patur sukses, ngase askush nuk ua kishte thënë asnjë fjalë për ecejakën e tij, pos që dikush nga ata të niësisë së giurmimit, si në mjegull u kishte thënë se mbase Princi bashkë me kapedanët, me buiarët dhe me flamurtarët më besnikë ishte nisur kah kështjella e skajshme për t'u bërë gati për një luftë të re... I tregoi më tutje për hyrjen në Kështjellë, i foli për ata pak veta që i kishin gjetur aty (kryesisht pleq, pak fëmijë dhe disa plaka kërcuna). I tregoi për kontrollin e kullës së Princit në të cilën, për habi, kishin gjetur një kërthi që po qante.

— Madhëri, kërthiu bënte një vaj të thekshëm sa na u rrëqeth misht, — i tha ai. — Fëmija qau gjithë natën e

ndoshta edhe tash po i bezdis rojet me zërin e tij si thikë.

Fjalët e fundit për fëmijën e gjetur me zë thike, Sanxhakbeun e nxorën nga gjendja e plogështisë së rëndë. Ktheu kokën nga Kadiasqeri dhe pasi e shikoi një copë herë, tha:

— The se gjetët një fëmijë?

— Ishte alamet fëmije, madhëri...

— Sanxhakbeu prapë heshti. Iu bë se po dëgjonte vajin e thekshëm që po i vinte nga një thellësi e mistershme.

— The se qante kur e gjetën?

— Qante madhëri, me sa zë kishte.

— E kuptuat se i kujt ishte ai fëmijë?

— Këtë nuk e kuptuam dot. Pyetëm ata pak pleq që gjetëm, pyetëm edhe plakat, por askush nuk bëri gjë me gojë... Të gjithë na shikonin të frikësuar dhe rrudhnin krahët.

— Çudi, — tha Sanxhakbeu me gjysmë zëri. — Cudi... Fëmija qan në kullën e Princit dhe askush nuk e di se i kujt është ai?

Kadiasqeri heshti. Nuk dinte se çfarë të thoshte më. ndërsa Sanxhakbeu luante kokën dhe herë pas here i thoshte fjalët «çudi, çudi...» Dikur, pasi preku kokën, si të kishte gjetur diçka që moti e kishte kërkuar, tha:

— Tash po e di...

Kadiasqeri pa një zbardhëllimë në fytyrën e Sanxhakbeut.

— Tash po e di... Fëmija duhet të jetë nga dera e Princit... Fëmija mund të jetë i gjakut të Princit...

Tha këto dhe zuri të sillej mendueshëm. Pas pak u ul ku ishte më parë dhe tha:

— Tash e di edhe pse e lanë...

Kadiasqeri prapë heshti. Fjalët e Sanxhakbeut e bënë kurreshtar të dinte diçka më tepër se pse fëmija mund të ishte nga dera e Princit dhe pse e kishin lënë qëllimisht? Njëherë mendja ia tha se Sanxhakbeu, kur fliste ashtu, ende nuk ishte liruar nga ankthi i gjatë. Madje dyshoi se Sanxhakbeu njëmend pjesërisht ishte në gjendje ankthi, ngase sytë i kishte të mjegulluar dhe gjithë lodhje.

— Fëmijën e lanë qëllimisht, — foli prapë Sanxhak-

beu. — Fëmijën e lanë... Të gjitha i kam të qarta... Të gjitha...

Kadiasqerit ato fjalë po i hynin në kokë të ngjizura me një pjesë të mjegullimit që Sanxhakbeut ia hetonte nga jashtë..

— Mendon se do të na e hedhë?... Princit ia ha mendja se ne jemi të marrë?... Mendon se mund të ma hedhë mua, perandorisë dhe gjithë neve me anën e një kërthiu?... Mendon se ne nuk dimë se ai e la fëmijën qëllimisht që ne të mendojmë se është si çdo fëmijë tjetër i lënë, që ne ta rrisim, në mënyrë që kur të rritet të na sulmojë nga brenda... Vë bast se ai fëmijë ka ndonjë shenjë të posaçme në trup që më vonë t'ia bëjë me dije se nuk është si të tjerët... Por kjo nuk do të bëhet... Fëmijën do ta mësojmë si duam ne:... Ky do t'i sulet së pari sojit të vet... Do t'i sulet së pari vendit ugurzi... Të tillë do ta bëimë ne... Të tillë na duhen... Luftën me ta mund ta fitoimë në këtë mënyrë...

— Pra, madhëri, — foli Kadiasqeri gjithë kuides, nga frika se mos do të bënte ndonjë gabim, — si po shoh, fëmijën do ta mbajmë? Do të thotë, nuk do ta hedhim në humnerë?

— Jo, jo. Ai na duhet. Një fëmijë të tillë e kemi pritur. Kjo është dhuratë e madhe për ne... Ai i duhet luftës sonë të shenjtë... Mendja ma thotë se të tillë e bëri engjëlli mirtor...

Fjalët e fundit Sanxhakbeu i tha gjithë hare. Dukej se ishte njeri tjetër.

— Këto që m'i thatë, madhëri, niëmend janë të rëndësishme dhe kuptimplote, — foli kadiasqeri më shumë për t'ia bërë qejfin.

E Sanxhakbeu i foli edhe më për luftën e shenjtë dhe për larjen e kuitesës. I foli për njëfarë stërkeqieje të domosdoshme të shpirtit, e cila ishte shumë e rëndësishme, e me të cilën mund të arrihej shumë më shumë se me anën e shpatës. I foli për luftën e re, e cila sado që nuk dukej, duhej të bëhej në shumë mënyrë...

Para s'e t'i jepte leje pyeti:

— Cili qe ai që e gjeti kërthiun?

— Njëfarë ushtari i thjeshtë që i thoshin Qyprilli...

— Fëmija le të marrë emrin tënd, Mehmet, e llagapin e atij që e gjeti, pra Qyprilli...

— Peqej, tha Kadiasqeri dhe doli jashtë pa e shikuar më Sanxhakbeun, i cili po fliste si përçart: kot e ke, o Princ... Kot... Ta ndërrova emrin... Ta ndërrova... Kërthiut do t'i humbë nami e nishani ndër mijëra e mijëra të tjerë, të cilët do të bëhen gati të bartin barrën e luftës së shenjtë... Do të shohësh se ç'vdekje e tmerrshme është ajo kur të vjen nga dora jote...»

(Shënimet plotësuese të kronistit)

Fëmija që i lanë emrin Mehmet (sipas Kadiasqerit më të tmerrshëm) dhe llagapin Qyprilli e mori, (sipas ushtarit që i pari e gjeti në Kështjellë), u bë kryejeniçer dhe erdhi të luftonte bashkë me Padishahun, Fatihun e Dytë në kështjellën e skajshme të Tokës së Lashtë... Nuk e dinte as vetë sesi në kokë i ishte futur një urdhër i prerë se duhej t'ia ngulte thikën Princit të kështjellës së Tokës së lashtë, i cili para njëzet vjetësh kishte ikur bashkë me flamurin, me stemat dhe me emblemën e vet në kështjellën e skajshme dhe prej aty i ndihmonte Kryeprincit të zhvillonte njërën ndër luftërat më të mëdha që kishte parë ndonjëherë bota... Fati i luftës deshi që kryejeniçeri Mehmet Qyprilliu i ri u vra nga kështjellarët kur po bëhej gati të hynte në kullën në të cilën rrinte Princi i kështjellës së Tokës së Lashtë dhe po mendonte si t'i ndalej turri disi ushtrisë më të madhe të botës, e cila kishte nxirë fushën që nga deti e deri rrezë mureve të kështjellës. Princi po sillte ndër mend ngjarjet e para njëzet vjetësh dhe zemra po i çante e i kullonte helm për kërthiun që i kishte mbetur në kullë i sapolindur... Fëmijën e kishte lënë e shoqja, e cila ishte e bindur se do të ktheheshin po atë natë... Kur i thanë se e vranë ushtarin e huaj mu në prag të kullës dhe ia bënë me dije se do ta futnin në hu për ta parë të vetët se ç'fat e gjente atë që merrte guximin të futej në Kështjellë, Princi

nuk diti as vetë pse e la mënjanë atë kokë, e shikoi një copë herë, sikur të njihte diçka në të dhe, së fundit, urdhëroi ta varrosnin me të tjerët e sojit të vet në Kështjellë.
Fatihu, sado që i dëshpëruar me ngjarjet në fushbetejë, Kryejeniçerin Mehmet Qyprilliun e shpalli shehit, sepse qe i pari ushtar perandorak ndër ata njëqind e pesëdhjetë mijë që kishte me vete, i cili ia doli të futej në kështiellë. Edhe pse e la kokën, Fatihu urdhëroi që fëmijët e tij (Myslymi, Shahini e Hysniu) të merreshin nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Portës.
I pari, Myslimi u bë jeniçer dhe tregoi vullnet të fortë për pushtime të reja kah Krimeja.
I dyti, Shahini, u ngjit deri në shkallën më të lartë të kadiut.
Ndërsa i treti, Hysniu, u bë kadiasqer. E urdhëruan të kthehej në vendlindjen e t'et (sado që këtë nuk e dinte) dhe vdiq i dëshpëruar që shërbeu shumë vjet në një vend të shkrumbuar e të bërë hi e pluhur nga luftërat e giata që nuk përfunduan rreth pesëdhjetë vjet... Ai pati dy diem: Mehmetin e Qerimin, që të dy ushtarakë të lartë. Mehmeti e Qerimi, pastaj patën nëmbëdhjetë fëmijë të tjerë (shtatë djem e katër vajza). Kështu Qyprillinitë zunë të hapnin rrënjë në giithë perandorinë si ushtarakë dhe nëpunës të vveshëm. Në secilën kore të tyre patjetër se përtëritej emri Mehmet, me të cilin mburreshin që të giithë, e që prore u shërbeu për t'u ngjitur lart e më lart. Kuitesa e tyre nuk shkonte tutje Mehmet shehitit... Dhe, pas dyqind vjetësh bezdisieje në hieraxhinë e rangut të mesëm të ushtarakëve dhe të qatipëve, njëri prej Mehmetëve, që përsëdyteshin shpesh e më shpesh, u nis pas vllit të vet, pas atij vllit të vet, pas atij vllit që Qyprillinitë i nxori nga mpiria e gjatë...»

Fjalët «mpiria e gjatë» i përsëriti disa herë të shkënputura nga të tjerat, sa një cast nuk ishte i bindur se a i lexoi diku apo ia tha një zë i huaj. Hamendia iu bë edhe më e madhe kur hetoi se librin që pak më parë e kishte pranë, nuk e pa më. Sytë i shkuan te rafti i drunjtë dhe ia zunë librin që e kërkonte. I rrasur me librat e tjerë, ai libër du-

kej se një kohë të gjatë nuk kishte lëvizur nga ai vend. Kjo mund të dëshmohej me pluhurin që i kishte rënë përsipër...

Çfarë po ngjet me mua? Çfarë? — tha Nimani dëshpërueshëm! Ajo pyetje po i sillej nëpër kokë dhe po i kthehej në një shushurimë të shurdhër, e cila iu bë se pak nga pak po e zbrazte nga njëmendësia. Hetoi se po shndërrohej në një hije, që herë zgjatej, herë ngushtohej pa mundur që të shkëputej nga pika në të cilën i bëhej se ishte ngulitur përgjithmonë... Asaj hijeje po i kërcënoheshin shpata të shumta, shumë e shumë sosh që vezullonin nga të gjitha anët, e që mendja ia thoshte se ishin të shkëputura nga ca duar të ngrira (të gjyshërve dhe të stërgjyshërve të tij ushtarakë). Nuk ke nga ia mban... Nuk ke... Nuk ke nga ia mban... po i thoshin armët si me fërshëllimë...: Nuk të lëmë... Ne qemë shumë... Shumë... Shumë... Shpatat po i afroheshin e po i afroheshin gjithnjë e më shumë. Nuk të lëmë... Nuk të lëmë, po i thoshin... Ktheju frontit... Ktheju fronit... Pse të na humbë emri përgjithmonë?... Përgjithmonë... Përgjithmonë... A e kuptove, përgjithmonë? Më kot provoi të dilte nga ajo skëterrë ku shihte vetëm shpata dhe dëgjonte kërcënime. Kjo e trishtoi aq shumë, sa filloi të çirrej me sa fuqi kishte. Por, në hapësirën e shurdhër, ku pamëshirshëm mbytej çdo tingull tjetër, e kotë ishte çirrja. I dëshpëruar, mbylli sytë me duar dhe dëshiroi që disi të mos i shihte shpatat që po i afroheshin gjithnjë më shumë. Dëshiroi që të bëhej i paqenë dhe si i tillë t'i bashkohej hiçit të përgjithshëm. Bile uroi që hiçësia të mbretëronte kudo dhe ngado. Ngadalë po i jepej hiçësisë... Dikur hetoi se po i afroheshin ca konture të mjegulluara, të cilat sa vinin e formësoheshin. Nuk vonoi e nga ai tis nuk e pati të vështirë ta dallonte kronistin e ngarkuar me shumë libra...

«Po ndodhin gjëra të jashtëzakonshme», — tha Nimani gjithë shqetësim.

Kronisti zbarkoi librat dhe u ul në to. Fytyrën e kishte të thyer nga rrudhat e shumta, të cilat i degëzoheshin dhe i bashkoheshin diku nën mollëza, duke i krijuar një si vrragë

të thellë. Sytë e imët dhe mjegullimi që nuk i ishte hequr plotësisht, e bënin edhe më të mistershme pamjen e tij.

«Po ndodhin gjëra të jashtëzakonshme», — tha Nimani për të dytën herë, por tash foli me një zë më të fortë, thuajse dëshironte t'ia bënte me dije se në ç'gjëndje ishte.

«E çfarë po ngjet», — pyeti kronisti?

«Kohë më parë... Kohë më parë... Nuk e di se a lexova një libër apo më rrëfeu dikush diçka, kjo tashmë nuk është e rëndësishme, por dua të them se më pas filloi një ngarendje shpatash... Shumë shpata m'u sulën... M'u sulën dhe jam i bindur se më sulmuan... Dikush po ma kërkon kokën. Nuk e di pse, por ma kërkon kokën?...»

Kronisti një copë herë nuk foli. Vuri gishtin në tëmth. Dikur tha:

«Kundër e ke perandorinë dhe sojin tënd...»

«Kujt s'i kam hak, pos që kërkova t'i kushtohem poezisë dhe të merrem me filozofi...»

«Pikërisht këtu qëndron kobi yt, — i tha Kronisti. — I hidhërove në të njëjtën masë miqtë dhe armiqtë...»

«Ç'të keqe ka të merresh me poezi?... Kujt mund t'i pengojnë metaforat dhe rimat?...»

«Njerëzit shpesh janë si guri. Nuk çajnë kokën për çështjet e shpirtit...»

«E pabesueshme! I pengojnë çështjet e shpirtit? E pabesueshme!»

«Mos harro se je Qyprilli dhe si i tillë duhet të kesh pushtet të lartë ose shpatë në dorë. Ndryshe nuk bën...»

Nimani heshti. Tash po i kthjellohej pak nga pak ajo që i kishte lexuar apo kishte dëgjuar nga dikush (krejt një) për gjyshërit dhe stërgjyshërit e tij gjatë dyqind vjetëve të para të perandorisë. Po e shihte kërthiun e vogël duke qarë. E pa si të rritur dhe së fundi me thikën e fshehur përtej mureve të kështjellës, duke ia kërkuar kokën Princit, që në të vërtetë kërkonte kokën e të et... Iu bë se ajo thikë tash po ia kërkonte kokën edhe atij. Mbase thika do t'i futej në fyt po të mos e kishte para kronistin që po i afrohej me një libër në dorë (nga ato që kishte me vete).

«Këtë duhet ta lexosh medoemos sa më parë», — i tha Kronisti.

Nimani pa një libër të trashë me kopertina të vrukta të lëkurës, i cili dukej se kishte kaluar nëpër shumë d·ar.

«Mos i harro ato që dëgjove nga gjyshërit dhe stërgjyshërit që i ke këtu dhe të vështrojnë si të ngrirë, — i tha Kronisti. — Këta, — tha duke bërë me dorë nga muri ku rrinin të varura portretet e kryevezirëve, — nuk flasin kurdo dhe çfarëdo. Ca prej tyre mbase njëherë, të vetmen herë bëjnë gëk me gojë. Të tillë janë Qyprillinjtë. Ua njoh të mirat dhe huqet. Ka njëmijë vjet që merrem me ta pareshtur. Shumë prej tyre janë si guaca. Futen në të dhe s'ka gjë që i nxjerr prej andej. Bëra përpjekje të pareshtura t'i nxisja të thoshin çkado që do t'i shërbente kronikës, por kot. A flet guri, ashtu flasin ata. Duke i shikuar të dhënat e plota, erdha te përfundimi se gjatë qeverisjes, Hysni Pasha asnjëherë nuk kishte shprehur ndonjë mendim të plotë. E gjithë ajo që kishte thënë ishte rrudhur në vetëm tetë fjalë të shkruara, tejet të shkurtëra, si: po, jo, bën, nuk bën, merre, nisu dhe luftë... Në shumë mbledhje të rëndësishme të qeverisë e takova të thoshte vetëm një po apo një jo. Hasa mbledhje ku ai dëgjonte e dëgjonte me orë ushtarakët e lartë, adjutantët, mjekët dhe përcjellësit e shenjave dhe në fund thoshte vetëm fjalën luftë. Pati edhe aso mbledhjesh që zgjatnin me ditë në të cilat ai fare nuk kishte folur, pos që kishte bërë me kokë herë duke e ngritur lart, herë duke e ulur poshtë, e ndonjëherë edhe duke e sjellë anash. Proçesmbajtësi, i mësuar me lëvizje të tilla dhe me domethëniet e tyre, jepte shënime plotësuese për lëvizjet e kokës së Kryevezirit: uli kokën, pra u pajtua; lëvizi kokën majtas e djathtas — do të thotë se nuk u pajtua; ngriti kokën përpjetë — do të thotë se kërkon ende sqarim... Kishte edhe ca shenja të tjera, si për shembull — bënte me dorë, rrudhte fytyrën, zinte sytë me duar, mbyllte njërin sy, hapte gojën më shumë se rëndom... Andaj, jo pa arsye, Hysni Pasha pati nofkën Kryeveziri i pagojë...

Të pagojë dhe memecë nga soji juaj pati shumë. Kam takuar afro dymbëdhjetë ushtarakë të lartë që me të vërtetë ishin memecë. Ndër ta më i fuqishmi ishte njëfarë Sami Beu, që ishte serasqeri më i shkathët që e pati Pe-

randoria. Bile njëri prej sulltanëve, me gjasë Sulejmani, kishte thënë se do të ishte fat i madh për perandorinë po qe se të gjithë ushtarakët e lartë do të ishin të pagojë si Sami Bej Qyprilliu, nipi i Ahmet Pashës. Sami Beu, si i pagojë, bëri atë që fjalamanët më të mëdhenj nuk do ta bënin. Ai futi rregull e shkathtësi të jashtëzakonshme në armatë dhe, ç'është më e rëndësishme, ai në praktikë zhvilloi në përmasa të mëdha doktrinën e sulmit të befasishëm me njësi të vogla, të cilat deri më atëherë nuk kishin qenë fare në strategjinë e luftës.

Ç'është më e habitshme, nga kronikat e shumta mësova se nga fisi juaj, në hierarkinë e pushtetit pati edhe të tillë që ishin të verbër. Njëfarë Bilall Beu, që jetoi në kohën e Mustafa Pashës, u bë i famshëm në sajë të aftësisë së jashtëzakonshme për të shpjeguar shenjat e luftës. Bilall Qorri, siç i thoshin i madh e i vogël, me përpikëri të paparë shpjegonte fatet e njerëzve dhe të luftrave që do të bëheshin. I mjaftonte ndonjë shenjë e thjeshtë që ai të jepte mendime me meritore, të cilave u nënshtroheshin që të gjithë. Për shembull, kur i thoshin se ditën e kismetit, pra, para se të nisej ndonjë fushatë apo luftë, flamuri u gjend në shtizë paksa i fashitur, ai thoshte se punët do të shkonin keq, kur i thoshin se filan pashait i është kruar tri ditë vetulla e majtë dhe i ka lëvizur syri i djathtë, thoshte se ai njeri do ta lërë kokën në fushë të betejës, por që lufta do të fitohet... Ata që nuk i përfillnin shenjat e Balall Qorrit, nuk kalonin mirë. Ka shumë dëshmi që ndonjë pasha kokëfortë apo sadriazem madje e kishte lënë kokën kotnasikoti në ndonjë fushatë vetëm e vetëm pse nuk i kishte përfillur shpjegimet e shenjave të tij. Së voni, Bilall Qorri ishte kthyer në një urdhëdhënës, fjalën e të cilit nuk e bënin dysh as sulltanët. Shumë herë, ajo që planifikohej gjatë nga ushtarakët ambiciozë nuk vlente një pare, po qe se nuk puqej me këshillat e Bilall Qorrit. Kështu, ky njeri që nuk e pa botën asnjëherë dhe nuk e dinte se çfarë ishte dukja e njeriut, u bë njeriu më i rëndësishëm i kohës, këshillat e të cilit vlenin më shumë se të atyre që shihnin mbi tokë e nën tokë. Është e çuditshme, madje e pabesueshme, sesi i din-

te të gjitha gjërat. Mendohej se ai njeri, në vend të syve shihte me ndonjë pjesë tjetër. Pati edhe nga ata që u betuan me kokë se Sami Qorri shihte patjetër më shumë se e gjithë bota, por që mbetej fshehtësi e pashpjegueshme se ku i kishte sytë. Thuhej se ai kishte dhjetë sy që i mbante në majë të gishtave me të cilët njerëzve u lexonte edhe mendimet në kokë dhe shihte atë që bëhej gati të vinte si fat apo si fatkeqësi... Çmos ishte thënë për Sami Qorrin... Kjo më shtyri që ta përforcoj edhe më bindjen time për sojin tuaj, se bartej nga një shtytje e brendshme, tejet e fuqishme, të cilën më tepër e kuptuan të tjerët se ju... Ajo fuqi e jashtëzakonshme shpirtërore në qindvjetëshat e fundit u derdh së jashtmi (pra për qëllime të të tjerëve). Ndërsa mbeti e shkapërderdhur brendapërbrenda qenies suaj, gjithnjë si ngacmim i përdijshëm, që ju solli shqetësime herë të mëdha, herë të vogla, të cilat erdhën duke u formësuar nga Mehmet Pashai e deri te yt atë Hysniu, në mënyrë që të emërtohet qartazi te ti, si shpirt i cili më në fund iu kthye vetvetes... Dhe, shi për këtë, djalo, perandoria është e shqetësuar pse nuk do të ketë më kryevezirë të tillë të fuqishëm, të drejtë dhe tejet besnikë, por edhe për faktin se tash e tutje, nuk do ta ketë më në mbikëqyrje gjithë atë energji shpirtërore, që kohë më parë e vinte në shërbim të fronit të lartë, pra për nevojat e veta të domosdoshme... Ajo energji shpirtërore do të shkapërderdhet, qoftë si mendim, qoftë si poezi, po qoftë si filozofi dhe do të shkëndijojë në mënyra të ndryshme. Mendimi, biro, është i rrezikshëm, shumë i rrezikshëm. Atij i frikësohen miqtë dhe armiqtë. Andaj, ja pse kundër teje tash janë të gjithë. Ç'është e vërteta, sulltanët e dinin se njëherë do të vijë çasti kur forca e shpirtit tuaj nuk do të derdhet më ashtu siç u derdh me shekuj, vetëm për fronin e lartë. Ata e parandjenin këtë dhe njëri ndër ta, Sulltan Sulemani i Dytë, nuk e tha kot se «Perandoria nuk do t'i ketë punët mirë çastin që ndonjëri prej Qyprillinjve do të thotë se nuk e do fronin e lartë...»

Lartmadhëria, si i dijshëm që ishte, patjetër se kur tha kështu e pati parasysh vetëdijësimin tuaj të domosdoshëm, që do të pasonte një ditë doemos nga shtytjet e brendshme,

nga ato shtytje që u shfaqën në kohën e Luanit të Tretë, kur Princ Tanushi u detyrua të hiqte dorë nga poeti Gropan, sa për sy e faqe, që të mos shkaktonte ndonjë acarim me Bizantin. Mbase mëkati i bëri ndaj poetit qe mëkat i pafalshëm ndaj vetvetes, ngase më vonë, gjatë, shumë gjatë jetuat si vasalë, pa vulën e botës suaj shpirtërore, pa shkronjat tuaja, pa vjershat tuaja, pa mendimin tuaj... Në vend të tyre ju përdorët shkronjat e huaja bashkë me gjuhën administrative perandorake, e cila bëri që kujtesa juaj të rrudhet në atë masë, sa edhe pjesërisht të mjegullohej. Dhe jo vetëm kaq. Gjuhën tuaj nuk e futët as në kisha e as në kuvende shtetërore. E përdornit heshtazi nëpër oda për t'ua treguar fëmijve ndonjë përrallë para se t'i zinte gjumi...

Dhe nuk është për t'u habitur pse pas shkatërrimit të perandorisë së vjetër, nga ajo ngritje shumëshekullore, dolët gati të pavrejtshëm dhe pa qenësinë që duhej ta kishit si shpirt i vjetër. Përkundrazi, nami si luftarakë që e kishit dhe si besnikë ndaj fronit, qe i pafuqishëm që t'jua lidhte shkëputjet shekullore, është fare e kuptueshme pse pas shkatërrimit të Perandorisë së Bizantit ju zutë të silleshit si fëmija që më shumë rrëzohet sesa ecën, andaj mëkëmbjen e patët shumë të vështirë e rënien të pashmangshme (edhe përkundër forcës suaj të jashtëzakonshme fizike). Në hartat e reja, që atëbotë hartoheshin midis mbretërive, ju ndaheshit sipas kishave dhe shkronjave të huaja, e jo sipas fuqisë shpirtërore... Mbase tash e tutje do të bëhet ndryshe...»

Nimani rrinte si i shtanguar dhe koka po ia kapte pareshtur atë «mbase, mbase» që Kronisti e tha me aq ftohtësi. Dhe ishte pikërisht ajo dilemë që atij ia ngacmoi një mendim tjetër dhe e bëri t'ia shtronte vetes pyetjen se çfarë do të ishte fati i Qyprillinjve dhe i tij personalisht po qe se fëmija në kështjellë të mos gjendej fare, apo të vdiste pa u rënë në dorë ushtarëve perandorakë? Mendja ia tha se çdo gjë do të kishte rrjedhë tjetër: soji i tij do të largohej përfundimisht nga faqja e dheut me të rënë Kështjella e rufundit (duke lënë pas ca stema dhe emblemën që do të rueheshin si suvenire në ndonjë muze të Evropës), ndërsa pe-

randoria do të mbetej pa shumë jeniçerë të ashpër, do të mbetej pa shumë ushtarakë dhe qatipë tejet besnikë, e mbi të gjitha do të mbetej pa shtatë kryevezirë që njëri pas tjetrit, me ndonjë ndërprerje të shkurtër, e mbajtën fronin më të lartë të pushtetit perandorak njëqind vjet.

Fjala njëqind vjet iu duk aq e rëndë, sa iu bë se përmbi kishte gjithë kështjellat e perandorisë së pafund, bashkë me të vdekurit që ranë për marrjen e tyre. Sado që u mundua ta merrte me mend perandorinë pa Qyprillinjtë, një gjë e tillë nuk i shkoi përdore. Qyprillinjtë qenë mpleksur në të dhe asnjë mendim sado i fuqishëm të ishte nuk krijonte dot përfytyrim të qartë të dukjes së saj pa ta... Jo. Jo. i tha vetes. Perandoria pa Qyprillinjtë është e paqenë... Qyprillinjtë dhe perandoria janë një... Janë një... Nuk ndahen dhe nuk del kush që mund t'i shikojë të ndarë...

Këto deshi t'ia thoshte Kronistit, por hetoi se ai nuk ishte më ku ndenji kohë më parë. Tash përpara kishte një libër me mbështjellëse të trasha e të brejtura. Iu bë se ishte po ai libri për të cilin kronisti i pati thënë se duhej ta lexonte medoemos...

(Endrra që pa kryejeniçeri Mehmet Qyprilliu para se të vritej në Kështjellën e Mallkuar...)

Gjumi më treti çastin që më thanë se isha ngarkuar me detyrën e shenjtë. Koka m'u kthye në një log betejash të pashembullta që nuk i kuptoja... Ç'ishte ky vallë: shqetësim i tmerrshëm apo frikë nga vetvetja?... Megjithatë, unë nuk dëshiroja të merresha më me vetveten. Qenia ime nuk ekzistonte më për mua, por për veprën që më ishte ngarkuar. Gjithçka e imja i nënshtrohej këtij qëllimi të lartë. Pra, duhej ta kaloja murin e mallkuar të kështjellës pa u dikruar nga kështjellarët dhe t'ia merrja Princit kokën. Këtë duhet ta bëja medoemos, ngase, siç më thoshte serasqeri, dikujt duhej t'i takonte nderi të futej në atë kështjellë për t'ua bërë me dije kështjellarëve se nuk ishin të pathyeshëm, siç mendonin... Kur të futesh atje, më thoshte serasqeri me zë të butë, njëherë e përgjithmonë do të marrin fund ato pë-

rralla për gjoja pamundësinë që brenda mureve të shkelë këmba e huaj... Ata këtë e kanë shndërruar në besim. Kur të shohin se perandoria mund ta bëjë këtë, atëherë do t'u shembet besimi... Do t'u shembet besimi... Kjo është e tmerrshme për ta dhe do ta përjetojnë si disfatë morale, e ne do t'u bëjmë me dije ushtarëve tanë se mund të shkohet tutje atyre mureve që na rrinë përpara ditë e natë dhe duket se na tallin... Fjalët e serasqerit ma morën qetësinë. Këtë ma shfaqte zëri që më dridhej, këtë ma tregonte shikimi që më binte përdhe, këtë ma pasqyronte njëfarë nuri i mejitit që zuri vend në fytyrën time... I brengosur për mua, Haruni plak më rrinte pranë dhe pareshtur më rrëfente tregime nga jeta dhe vepra e shenjtorëve. Kjo më frikësonte edhe më. A thua ai te unë shihte një krijesë që fati po e ngrinte fuqishëm mbi të tjerat. I lumi ti, i lumi, më thoshte plaku. Shpejt do të shkosh atje ku të prekin vetëm mendimet tona... Paçim fatin tënd! Ai më fliste për domosdonë e njësimit shpirtëror me të madhërishmen dhe të lartësueshmen... Ai që e arrin këtë, thoshte, patjetër se m ind çdo vështirësi dhe ia del të bëjë vepra të shenjta. Fakti se je i shqetësuar dhe ndjehesh si qenie që rri as në tokë e as në qiell, tregon se ti po vetëdijësohesh për vepra të mëdha...

Dikur m'u bë se u mpiva. Kjo qenka vallë ajo gjendje kur njeriu lirohet nga vetvetja për të cilën më fliste Haruni plak? Hetova se m'u hoq sikleti i madh. Ngadalë po futesha në pushtetin e gjumit. Po i jepesha një ëndrre e cila më mbajti gjatë... Ëndrra ishte kjo: përpara me doli një fushë e gjerë, si e paanë, në të cilën vërtiteshin kuaj të bardhë, që hingëllonin zëthekshëm... Kuajt e bardhë shkonin nga njëra anë në tjetrën dhe sa herë ktheheshin linin pas një trokëllimë të shurdhër... Nuk e di sa zgjati vërtitja e kuajve të bardhë me jele të zeza, por më kujtohet se në një çast kuajt e bardhë me jele të zeza nuk u kthyen më. Megjithatë, hingëllima e tyre më vinte e thyer në shumë pjesë dhe si e tillë, herë-herë i gjasonte fërshëllimës së erës. Më vonë, nga ajo fërshëllimë u liruan gjithfarë fluturash, të cilat shkonin grumbuj-grumbuj. Nga ajo mori e fluturave

u formësua një e madhe, e cila nganjëherë më dukej se merrte pamjen e një kali të bardhë, që kishte krahë laroshë. Kali i bardhë apo flutura u soll e u soll në atë hapësirë derisa u kthye në një zog të zi, e dikur u bë lis. Lisi u rrit e u rrit sa hapi degë të mëdha. Degët hapën gjethe, e gjethet shpejt u thanë dhe lisi mbeti pa degë, i tëri i gërmuqur... Lisin fillikat zunë ta rrahin ca stuhi të cilat u shfaqën befas nga qielli. E rrahën e e rrahën po lisi fillikat mbeti aty ku ishte. Dikur zuri të binte një shi i imët, i cili nuk kishte të ndalë. Ra e ra ai shi pareshtur, sa nga zgafellat e lisit zuri të rridhte një vadë uji. Uji pastaj u bë përroskë, përroska u bë përrua, përroi u bë lumë, lumi u bë det, u bë një det që e mbuloi gjithë hapësirën e paanë, në të cilën dikur shihja jeshillëk dhe kuajt e bardhë me jela të zeza, që shkonin tufa-tufa dhe kalëronin lazdrueshëm... Edhe pse uji i turbullt nuk kishte fund, maja e lisit fillikat shihej dhe rrinte e fuqishme mu në mesin e mesit të detit të turbullt... Dikur u shfaq një zog i kuq në majë të asaj maje të lisit fillikat dhe po shikonte mendueshëm ujin e turbullt. Zogu i kuq për një çast mbylli sytë e zi dhe sapo i mbylli sytë, hapësira e paanë m'u duk po ajo që ishte, në të cilën kalëronin kuajt e bardhë me jele të zeza. Uji shkoi dikah dhe unë sërish pashë jeshillëk dhe lojën e kuajve të harlisur... Dhe kur po kënaqesha me atë jeshillëk, se nga u shfaq një shpatë e madhe e cila përhapej furishëm në erë. Shpata vezullonte dhe unë ndjeva një zë që më tha se duhej ta kapja shpatën dhe t'i sulesha zogut të kuq me sy të zez që po rrinte krenar në majën e lisit të gërmuqur. Duhet t'ia marrësh kokën zogut të kuq sa më parë, po më thoshte ai zë i cili ishte gjithë kërcënim. E mora shpatën. U nisa hajtmorehajt drejt lisit të gërmuqur që t'ia merrja kokën zogut të zi, i cili dukej se rrinte i fjetur dhe ëndërronte. Por më bëhej se vendnumëroja. Largësia midis nesh ishte prore e njëjtë. Eca gjatë, shumë gjatë (në të vërtetë vendnumërova), e zogu i kuq në majën e lisit të gërmuqur fjeti. Dhe kur më bëhej se mendimi im nuk do të kishte të sosur, zogu i kuq hapi sytë dhe sapo i hapi ata sy të zez, shpërtheu një vetëtimë e cila më dha saora forcë sa m'u bë se mora

krahë dhe fluturova drejt qiellit. Kur u ngjita atje prej nga zogu i kuq dukej si pikë e vogël, e lëshova shpatën pingul dhe ajo gjithë flakë u sul mbi zogun e kuq. Zogu i kuq saora mbeti pa kokë... Unë, i lumtur që ia dola t'ia marr kokën, fjeta. Por, sapo u zgjova sërish pashë zogun e kuq, që e kishte kokën në vend. Bile tash e kishte më të madhe. Prapë u ngrita përpjetë, prapë shpata ime u lëshua pingul mbi zogun e kuq me sy të zez. Dhe, prapë pashë kokën e zogut si u nda nga trupi i tij dhe prapë fjeta... Më zuri një gjumë i thellë... Fjeta e fjeta aq gjatë, sa, kur u zgjova, pashë se gjelbërimi ishte vyshkur, se lulet ishin tharë, se therrat anembanë kishin qitur krye, e megjithatë zogu i kuq me sy të zez rrinte ende i fjetur në majë të lisit të gërmuqur. E sheh, më tha një zë, zogu i kuq me sy të zez ende rri në atë majë dhe kotet. Desha të thosha se dy herë ia kisha prerë kokën, por hetova se nuk kisha zë. Tekefundit, ç'vlerë do të kishte tregimi im për dy kokat e prera dhe për gjumin tim, kur zogu i kuq me sy të zez njëmend rrinte në majën e lisit të gërmuqur dhe kotej si të mos kishte ndodhur gjë. Dhe, hajtmorehajt prapë u ngrita lart. Prapa shpata vringëlloi dhe prapë pashë sesi koka e zogut të kuq me sy të zez u nda nga trupi i tij... Nuk do ta shoh më atë kokë që po më shqetëson, i thashë vetes, ngase shpresoja se më vonë do të shihja jeshillëkun, i cili ishte vyshkur. Kur po bëhesha gati të kotesha, ia hodha një shikim zogut të kuq me sy të zez për ta tallur, por shih moj mrekulli, zogu i kuq me sy të zez sërish m'u shfaq me kokë! Bile tash kokën e kishte më të madhe. Bah, oshëtina, e teproi! Unë hiqja, e ai nxirrte tjetrën edhe më të madhe. Do ta ndaj përgjysmë që të mos ketë më as trup as kokë. Tekefundit a s'e meritoi një gjë të tillë me kryeneçësinë e tij që me cdo kusht të nxjerrë kokë të re, madje edhe më të madhe? Dhe hajtmorehajt iu sula sërish zogut të kuq me sy të zez. Shpata flakëronte dhe unë po e shihja të madh e më të madh. Për habi, kur iu afrova, pashë se zogu i kuq me sy të zez kishte kokë njeriu! Bah, thashë prapë. Ky, herë zog e herë njeri. Qoftëlargu këtu mund t'i ketë futur thonjtë? Koka më shikonte nënçmueshëm. Kjo ma shtoi edhe më dë-

shirën që atë kokë ta merrja sa më parë. Dhe pa një pa dy, shpata ime e preu kokën. Koka u rrokullis, por edhe si e prerë e ruante shikimin nënçmues... Nuk e di pse m'u tek që atë kokë, për të cilën tashmë isha i bindur se ishte e njeriut (këtë ma vërtetonte edhe shikimi i saj që vazhdonte të mbetej nënçmues), e mora me vete dhe po e zvarritja nëpër hapësirën e paanë... Kështu, hajtmorehajt, ec unë e ec koka pas meje. Ecëm e ecëm sa sërish pashë se po shfaqej behari dhe luleshqerrat po merrnin jetë. Por, mu atëherë kur sytë po më mbusheshin me jeshillëk, koka e hequr që më shkonte zvarrë, foli e tha:

— po e bart kokën tënde... tënden...

— Bah, thashë, t'i prapë po më shqetëson?

Por ajo qeshte dhe më thoshte të njëjtat fjalë. E qeshura u bë aq e fuqishme sa hetova se gjethet e luleshqerrave po binin. Të njëjtat fjalë tash po m'i thoshte edhe puhiza që përhapej lehtë-lehtë, e të njëjtat po m'i thoshin edhe ca flutura që shkonin tufa-tufa prapa një kali të bardhë...

Dhe përnjëmend hetova se nuk kisha kokë! Ku më mbeti koka? Ku? Po çirresha... Ku më mbeti koka?

E ajo që e bartja zvarrë po më thoshte: e ke në dorë... po e bart zvarrë... moti e ke këputur... moti... ka kohë që ia more kokën vetes... Kur më doli gjumi, isha djersitur... Allah, thashë, diçka e tmerrshme do të ndodhë...»

(E shënoi nëpunësi i Tabir sarajit, Irfan Allajbeu)

(Dëshmia e kryerojës për heshtjen e thellë të Sami Pashë Qyprilliut...)

... Unë e njoha tjetër për tjetër... Sado që i madh e i vogël thoshte se ai fliste pak, ngase kishte pushtet të pakufishëm dhe dëshironte ta ruante autoritetin e vet e të perandorisë, unë them edhe këtë e mbroj po të jetë nevoja edhe me kokën time, se ai fliste me heshtjen e vet. Dikush mund të thotë se heshtja është heshtje dhe njeriu futet në të si guaca për t'u mbrojtur nga të tjerët. Heshtja e tij nuk ishte e heshtur, përkundrazi në të ai futej gjithë shqetësim dhe

largohej i qetë, mbase edhe i shkallmuar. Betohem në të gjithëfuqishmin se ai mezi priste çastin që t'i kthehej kësaj prehjeje të mundimshme. Unë që e përgjova shumë e shumë vjet nga e njëjta pikë e vrojtimit dhe pata për detyrë t'ia ruaja gjumin dhe qetësinë, e dija se ai nuk fuste gjumë në sy (sado që dukej se flinte) e as që ndonjëherë ishte i qetë. Shtirej se flinte, e në të vërtetë pareshtur mejtonte dhe merrej me të madhërishmen. Në ato çaste ai ishte jashtë qenies së tij fizike dhe njësoj me të lartësishmen... Se ishte kështu, fliste më së miri njëfarë ngrirjeje që i shfaqej shumë kohë edhe pasi ngrihej nga shtrati. Madje, jashtë vetes ishte shpesh herë edhe kur bënte punë të rëndësishme perandorake. Mos më keqkuptoni, ju lutem. Kur flas kështu nuk them se ai ishte i paaftë që të merrej me punët e pushtetit. Jo. Jo. Ai edhe symbylltas dhe i tëri i ngrirë (pra pa u liruar nga gjendja e mpirjes meditative), dinte më shumë se gjithë njerëzit e botës. Ai dinte pa hesap dhe pikërisht pse dinte aq shumë dhe shihte aq larg kërkonte me cdo kusht që të lirohej ashtu nga pjesa e mëkatshme që e bart njeriu me vete shpesh herë pa ditur se ç'barrë është ajo. Dikush mund të thotë se nga i di unë këto që i them për madhërinë? E kam dëshmitar perëndinë e këtë mund ta them nën benë më të madhe se një herë, të vetmen herë, të vetmën herë, pata rastin t'i lexoj ca nga shtytjet e heshtjes së heshtme, të cilat madhëria i pat shkruar, e të cilat i kalli ende pa i përfunduar mirë... Kush e di se pse mori letrën dhe zuri të shkruante. Këtë e bëri diku nga mëngjesi dhe unë që po e veneroja e dija se shkruante diçka të rëndësishme. Shkroi e shkroi deri në iqindi dhe befas e zuri një gjumë i thellë. La letrat manash dhe u përplas në minder. Kur iu afrova ai dukej si i pashpirt. Kureshtja e madhe më shtyri që t'u lëshoja shpejt e shpejt një sy atyre që kishte shkruar... Aty kishte gjithfarë mendimesh të shkapërderdhura, të shumtën e herës të këputura e të papërfunduara... Ca nga fjalitë duket se nuk kishin as fillim e as mbarim. Vende-vende shihej ndonjë fjalë e vetme si të kishte ikur nga moria e të tjerave qëllimisht, mbase pse kunërshtonte. Çfarë nuk pashë në ato letra, por çuditërisht më

mbetën në kujtesë fjalët «e lartësishmja... e madhërishmja... e gjithfuqishmja... tjetërsim... shfrim i mendokushtshëm...» që ishin të nënvizuara dhe herë-herë të shkruara me shkronja më të mëdha nga të tjerat... Leura përfundonte me fjalinë:
Nga gjumi u zgjua i frikësuar. Kapi ato që kishte shkruar dhe pasi i pushpurisi në duar, si të kërkonte diçka të jashtëzakonshme në to, u vuri zjarrin. Nga tymi që lëshuan ato një copë herë nuk ia pashë fytyrën, e edhe kur më doli i tëri, m'u bë se para kisha një tjetër, sikurse flaka e pakmëparshme t'ia kishte kallur qetësinë. «Punë që s'bëhet... Punë që s'bëhet...» po belbëzonte. Një kohë të gjatë belbëzoi dhe murmuriti duke i shtrënguar duart kërcënueshëm. Mbase gjatë do të mendohej ashtu po të mos futesha brenda për t'i sjellë shurupin të cilin e pinte gjithnjë në të njëjtën kohë. Kur më pa, u mëvrejt edhe më. Fytyra i dukej si një det i ngrysur në të cilin çdo çast priten të shpërthejnë stuhitë. Piu shurupin nxitueshëm dhe më dha shenjë se mund të largohesha. Më pastaj nuk e pashë dot t'i kishte mbyllur sytë. Pareshtur vështronte një pikë (aty ku gjendej stema e madhe perandorake) dhe rrinte si i ngrirë. Herë pas here thyente gishtat dhe nxirrte ndonjë ofshamë të lehtë. Duke e parë ashtu si mundohej me vetveten, e dija se ai shkëputej prej botës gënjeshtare në të cilën ne jemi zhytur dhe shkonte te ajo e njëmendta, të cilën mund ta kenë hak vetëm ata që përpiqen pareshtur t'i afrohen dhe ta bëjnë për vete... Kur thanë se ndërroi jetë, e pata të qartë se shpirti i tij i ndritur ishte liruar nga barra e rëndë dhe e pakuptimësisë së kësaj bote...»

(Çfarë tha Bilall Bej Qyprilliu për errësirën dhe pakuptimësinë e kësaj bote?)

1. Errësira ua heq gjërave tejdukshmërinë...
2. Errësira humb hijen...
3. Në errësirë shlyhet kufiri i përcaktimeve dhe i përkufizimeve..

4. Në errësirë njëmendësia merr kuptim të thellë dhe zhvishet nga kufizimet e realitetit...
5. Errësira e pafundshme u jep mundësi perceptimeve të reja dhe të amshueshme...
6. Errësira e bën të paqenë ndjenjën e kohës dhe të hapësirës...
7. Në errësirë nuk ekziston rreziku i përsëritjeve...
8. Errësira nuk e pranon të djeshmen, të sotmen e as të nesërmen...
9. Në errësirë edhe pesha bëhet e papeshë...
10. Errësira u hap krahë mejtimeve të pafund...

P r a n d a j

1. Mos i besoni asaj që shihni,
2. Dyshoni dhe vetëm dyshoni,
3. Hiquni ngazëllimit,
4. Shporreni kënaqësinë,
5. Qasjuni thellimit,
6. Mos iu gëzoni lëvdatës,
7. Mendoni se dikë gjithnjë e keni pranë,
8. Dhjetë herë mate, e një herë qite,
9. Dije se nga asgjëja del asgjë, dhe,
10. Mos u bëj mendjefjetur...

(Poetika e mesjetës apo tridhjetë e gjashtë shënimet e çuditshme të poetit Gropan)

A.

...Unë, Gropani, i biri i Bardh Shpendziut, nga derë e Princit, i shkishëruar, i mallkuar, i shpallur heretik dhe, së fundi, armik i rrezikshëm i perandorisë, duke parë se mjegullira perandorake zuri të bëhej gjithnjë e më e dendur dhe se shpirti ynë do të shkrihet njëherë e përgjithmonë në atë katrahurë të pafund, siç shkrihet qiriu në altarin e madh të kungimit, u vura në mbrojtje të tij...

E di se kjo është punë e rrezikshme, jo vetëm për mua, por edhe për breza të tjerë. Po a nuk është edhe rreziku, edhe sakrifica, edhe vuajtja ushqim shpirtëror? E dihet se shpirti ka nevojë për ushqim të tillë të pareshtur siç i duhet edhe bimës lagështia që ajo të mos thahet.
Për mallkimin që ma bënë anembanë kishave të Perandorisë nuk çaj kokën, ngase unë nuk ngrita krye kundër të Gjithëfuqishmit, siç thonë, veç se dëgjova zërin e qenies sime që më tha gjithë shqetësim:
po përgjumeni,
po mpiheni,
po mjegulloheni...
andaj, or të dashur, kthehuni kah persiatjet dhe mendoni me kokën tuaj; kthehuni poezisë dhe artit tuaj të moçëm... Ju nuk mund ta merrni me mend se ç'tempuj të madhërishëm ndërtuan stërgjyshërit tuaj të lashtë... U fola për Dodonën, Apollóninë, Ulpianën dhe shumë e shumë gjëra të tjera...
Ata më dëgjuan dhe derdhën lot...

B.

Orakulli i Dodonës rrinte i qetë. I mbërthyer midis dy shkrepave të lartësuar përgjonte amshimin që i shtrihej tutje deri në det... Para tij faleshin stërgjyshërit tuaj dhe ai u fliste për mirësinë, u fliste për të madhërishmen dhe të amshueshmen... Kur largoheshin, ndiheshin edhe më të pasur dhe ishin të gatshëm që të krijonin vepra edhe më të mëdha... Dodona priste dhe përcillte pareshtur... Njerëzit po bëheshin një me hyjnitë e urta. Erdhi një kohë kur nuk dihej më se ishin hyjnitë njerëz, apo njerëzit ishin shndërruar në hyjni...
Por Nemezisi smirëzi, që përgjonte nga Olimpi Dodonën dhe hyjnitë e tjera, e thirri në ndihmë Eolin shkatërrimtar. Këta, i tha Nemezisi Eolit gjithë shqetësim, e kaluan çdo masë. Njerëzit i fisnikëruan aq shumë saqë ata një ditë mund ta pushtojnë edhe Olimpin e shenjtë! Kjo nuk duhet të lejohet. T'u sulemi sa nuk bëhet vonë!

Dhe, o të dashurit e mi, fjala e Nemezisit shkoi në vend. Tempujt e madhërishëm saora u bënë copë e grimë. Polifemi u përkujdes që të shembeshin malet e të rrafshoheshin kodrinat dhe shumëçka e asaj madhështie u varros në tokën e zezë... Dodona e trishtuar me forcën e fundit ia doli ta mbajë të ruajtur një pjesë të amfiteatrit të madh. Nga ky vend, ofshani ajo, herët a vonë gjëmimi im do të shpërndahet dhe do të shkojë atje ku e ka vendin. Thirravajen time nuk ka ç'e ndal...

C.

Pranë lumit dëgjohej gurgullima e hareshme e lumit. Ca rreze na i përlanin fytyrat butësisht.
Thirravaja e Dodonës, vazhdova, u përhap në të gjitha anët, por vetëm lumi e fshehu në gurgullimën e vet. Nemezisit smirëzi nuk i shkoi mendja se ajo do të strukej në ujë... Dhe kështu, o të dashurit e mi, kaluan vite, kaluan dhjetëvjetësh, kaluan edhe shekuj dhe thirravaja e Dodonës mbetë aty ku ishte — në gurgullimën e lumit...
Ndodhi seç ndodhi dhe një ditë ajo nga andej gjeti veshin e Glaukut të ndritur. Seç i tha ajo gurgullimë nuk dihet, por Glauka që po merrej me ca murana e rrethoja të larta, iu kthye persiatjeve të thella. Pareshtur fliste për artin, filizofinë dhe bukurinë, që duhet të vihen në shërbim të së madhërishmes. Të fuqishëm bëhemi, thoshte ai, vetëm po qe se e kuptojmë vetveten dhe fisnikërohemi me ndjenja të larta... Mblodhi vjershëtarë, thirri artistë të ndryshëm dhe shpalli konkurse të shumta krijuese. Do ta ngrejmë lart ngrehinën e shpirtit, thoshte. Atë nuk ka gjë që e rrëzon. Në amfiteatrin e ri vargjet nuk kishin të mbaruar. Mbi të gjitha kërkoi që secili të përsiaste së paku gjysmë dite. Përsiatja, thoshte ai, është themeli i kështjellës së shpirtit...
Por ç'e do që Glaukun nuk e lanë të qetë. Smirëzia, e cila rrodhi nga Nemezisi, vërshoi ngado dhe te kush më shumë e te kush më pak, u bë pjesë e jetës së tyre... Kafsha e zezë zuri pritë...
Sapo e zura ngojë kafshën e zezë, masa që po më dëgjonte me aq vëmendje shpërtheu në vaj...

Ç

Nxënësit më pyetën gjithë kurreshtje:

— Ç'ishte k ë s h t j e l l a e s h p i r t i t me të cilën u mor aq shumë Glauku?

Unë ua ktheva:

— I ndrituri Glauk thoshte: jetë të jetshme mund të bëjnë vetëm ata që ndërtojnë k ë s h t j e l l ë n e s h p i r t i t. I biri i Mounit zemërgjerë fliste edhe kështu: bota e gjësendeve është si fluska e sapunit. ... Laryshia e saj është mashtrimtare dhe e përkohshme. Mjerë ata që ngashërehen pas saj. Një ditë mund të dëshpërohen...

Kur perëndonte dielli, Glauku i thoshte edhe këto fjalë: peshku i madh e ha të voglin... Nga ky rregull nuk ka përjashtim, edhe pse ngjet që i madhi të bëhet i vogël e i vogli të bëhet i madh... Shpirti i formësuar e përjashton logjikën e gjësendeve. Shi për këtë ai iu qas ndërtimit të k ë s h t j e l l ë s s ë s h p i r t i t, i bindur se ajo nuk do të shembej kurrë. Për këtë kështjellë ai thoshte se kishte themelet në vetëdije dhe përbëhej nga shtatë kulla. Këto ishin:

1. *Kulla e mendimit,*
2. *Kulla e kujtesës,*
3. *Kulla e letërsisë,*
4. *Kulla e muzikës,*
5. *Kulla e valleve,*
6. *Kulla e pikturës dhe*
7. *Kulla e moralit.*

Për këtë të fundit Glauku thoshte se shembet fare lehtë po qe se gjashtë të tjera nuk ndërlidhen si duhet...

D.

Të mendosh drejt dhe urtë është vështirë, thoshte Glauku, — por edhe më vështirë është që mendimin tënd ta shuash gjithnjë si duhet dhe ku duhet...

Demezisi iu sul Dodonës pse pati frikë se ajo me çiltërsinë e mendimit të saj po ua merrte anën hyjnive të tjera. Dodona nuk do të ishte e madhërishme pa forcën e mendimit të vet,

edhe pse për këtë e pagoi shtrenjt... Pa mendimin e vet jehona e fjalëve të Dodonës (e fshehur në gurgullimën e ujit) nuk do ta gjente veshin dhe shpirtin e Glaukut e as që do të vinte deri te ne. Tempujt e rrëzuar po, por fjala e saj jo. A nuk na bën me dije se kullën e mendimit e bartim me vete secili, por si të mbyllur. Vetëm persiatja e thellë na i hap dyert e saj dhe na shpie nëpër labirintët e saj që nuk kanë të sosur...
Prandaj, o të dashurit e mi, bëni përpjekje të pareshtura që të futeni në të. Në të mund të hyni dhe të mbeteni vetëm po qe se e ushqeni me forcën e mendimit tuaj. Për mendjefjeturit nuk ka vend aty...

DH.

Pika pika bëhet përroska, e gur gur bëhet mur... Kështu u thoshte Glauku njëqind nxënësve që merreshin ditë e natë me persiatje dhe krye çdo jave i tregonin se çfarë kishin mësuar. Me t'u kthyer nëpër qelitë e tyre, Glauku merrej gjatë me mendimet e tyre të shkëputura dhe mundohej t'ua gjente fillin e përbashkët. I rendiste pranë e pranë dhe si fundit i njësonte. Në këtë mënyrë e ndërtoi kullën e kujtesës për të cilën mëndjendrituri thoshte:
— Që të mos e kemi fatin e gjësendeve duhet t'i kthehemi kujtesës... Kujtesa është gjerdan i pafund i mendimeve me gjithfarë rruazash. Shkëlqimi i tyre është i amshueshëm dhe ç'është më e rëndësishme rruazat e këtij gjerdani përhapin në gjithësi ca rreze të pakëputshme, të cilat herët a vonë i drejtohen qenësisë në çastet më të rënda (gjatë robërive të gjata shekullore, pas shthurjeve të papritura apo kur ajo zë ta harrojë vetveten...)
Ja, pra, pse kullën e kujtesës Glauku e çmonte shumë...

E.

Djaloshi i tha Glaukut gjithë shqetësim:
— Imzot, do të thur një gënjeshtër të vërtetë... Ata që ishin me të u zverdhën, por djaloshi edhe për të dytën herë

tha po të njëjtat fjalë për gënjeshtrën e vërtetë. Tash nisi të jepte ca shpjegime.

— Mjaft, mjaft, — i tha Glauku djaloshit. — Nuk ka nevojë për fjalë të tepërta. Nis punën dhe bisedojmë sapo të mendosh se i ke thënë të gjitha që gënjeshtra të duket e vërtetë...

Një kohë të gjatë djaloshin s'e panë të dilte nga qilari. Shpejt kaloi pranvera, e pastaj erdhi vera, ia behu edhe vjeshta me lagështi e kaloi edhe dimri i acarshëm. Kur çeli lulepjeshka, djaloshi ia behu dhe u ul para Glaukut. Dukej i zverdhur. Leshrat e gjata i shkonin kreshpërueshëm.

— Hë. — i tha Glauku, — Ç'kemi?

Ai shikoi përreth dhe, pasi uli shikimin përtokë, foli me një zë të çjerrë:

— Asgjë imzot...

Ata që rrinin anash tash ia panë duart si i dridheshin dhe sytë e mbërthyer nga një tis i zi.

— Imzot, tha ai prapë, — mbase humba kohë kotnasikoti? Pastaj djaloshi tregoi se si ditë e natë kishte menduar si t'ia niste, por nuk arrinte ta gjente nismën që do ta kënaqte. Droj se nuk do t'ia dal fare, tha gjithë dëshpërim. Humba kohë kot... kot... Glauku i shkoi pranë dhe i fërkoi ballin e ngrysur.

— Nuk humbe kohë kotnasikoti. Ti mendove. Gjatë u more me diçka që të mundoi. Ky është mundim i fisnikëruar. Vepra t krijohen me mund dhe durim të madh...

— Do të thotë, Imzot, se unë bëra diçka?

— Fakti se mendove aq shumë është me rëndësi... Vazhdo punën e filluar dhe mos ia vë veshin kohës...

Dhe, o të dashur, djaloshi prapë u kthye në qilar. Vjet e vjet nuk doli. Kur u shfaq për të dytën herë para Glaukut, doli një njeri i pjekur. Ai prapë e uli shikimin. Një kohë të gjatë u mundua të thoshte diçka. Aty nga mbrëmja nxori një letër të vogël dhe ia la përpara Glaukut.

— Të lumtë! — tha Glauku. — Të lumtë! Bëre shumë.

Djaloshi u shemb përdhe. Dukej si i pajetë. Kur erdhi në vete, po belbëzonte:

— E dija se do të më tallni... E dija...

— *Nuk po të tallim, — i tha Glauku — por po të përgëzojmë.*
— *Shkarravita... Asgjë tjetër nuk bëra, tha ai...*
— *Bëre hapat e parë në letërsi, foli Glauku...*

Ë.

Në shkalloren e sheshit lira dukej si një monument i përkryer. Era që frynte nga perëndimi i përqafonte telat e saj, e ata lironin tinguj të butë. Gjithë vendi zhytej në një melodi të ëmbël me të cilën u mësuan i madh e i vogël...
Por, ç'e do, një ditë prej ditësh tingujt e lirës nuk u dëgjuan më. Pranë shkallores kurreshtarët pritnin që sërish të derdhej melodia me të cilën ishin mësuar. Dikur, të dëshpëruar i thanë Glaukut:
— *Pse u shurdhua lira?*
Glauku i shikoi një copë herë dhe në fytyrën e secilit dalloi brengën e thellë.
— *Nuk po frynë erë, — u tha Glauku. — Era u dha jetë telave të saj e ata nxorën tinguj të ëmbël...*
— *Si t'ia bëjmë? Pyeti masa. — Pa ata tinguj po ndihemi si të paqenë.*
— *Duhet t'i krijoni vetë, — u tha Glauku.*
— *E si mund t'i krijojmë ne tingujt që i kushtëzon era?*
— *Ka mundësi, — u tha ai.*
— *Si? Si?*
— *Me një kusht, — foli Glauku me sa zë kishte...*
— *Tregona...*
— *Të bëni atë që do t'u them unë.*
— *Do ta bëjmë! Do ta bëjmë!*
Pastaj Glauku foli e tha:
— *Secili ta mbarojë nga një lirë të vogël, pra lirën e vet...*
— *Këtë mund ta bëjmë, tha njëri, — por si t'ia bëjmë me melodinë? Ajo është dhunti e hyjnive...*
— *Nga diçka të hyjnueshme bartim me vete. Ajo duhet të zgjohet... Dhe, o të dashur, nuk vonoi e në të gjithë vendin lirat u shfaqën si kërpudhat pas shiut... Një ditë u tubuan në shkalloren e madhe për t'ia treguar Glaukut. E ai, kur i pa të gjitha ato, tha:*

Tash e tutje do të prehemi në mijëra e mijëra melodi. Secili do të krijojë të vetën...;

F.

Ngujt gjetën veshin, veshi ia përcolli mendjes, mendja ia fali zemrës dhe, së fundi, nga ndjeshmëria e jashtëzakonshme emocionale, rrodhën ca lëvizje të lehta të duarve e të këmbëve... Pastaj u lidhën shumë duar, u përplasën shumë këmbë... Dikush tha: obobo, ç'valle e rëndë burrërishte që na doli!

G.

I ndrituri Glauk një ditë tha:
— Keni për detyrë të pikturoni qiellin.
Mijëra e mijëra veta morën ngjyrat, brushën dhe pëlhurën. Kush më herët e kush më vonë shkuan para Glaukut me punimet e kryera. Nga kaltëria e pikturave po i ndritnin sytë.
I fundit u shfaq një mesoburrë me një pëlhurë të madhe që e barte gati zvarrë.
Me të parë punimin e mesoburrit, Glaukut iu çel fytyra.
— I kuq na qenka qielli? — i tha.
— Unë të tillë e shoh.
— E sheh vetëm të kuq?
— Të shumtën po, por nganjëherë e shoh edhe të zi apo tjetërfare... Për mua pikturë nuk është ajo që diçka kopjohet, por ajo që ndjehet. E di se do të më marrin për të marrë, por nuk çaj kokën për të tillë.
— Ti je piktor i njëmendtë, — i tha Glauku. — Të paçim!

GJ.

Të menduarit,
krijimtaria,
letërsia.
muzika,

vallet,
piktura
e përcaktojnë bashkarisht moralin e një shoqërie...
Kështu tha Glauku para një mijë vjetësh...

I.

Njëherë pate folur për kafshën e zezë. Zure ngojë njëfarë lufte të jashtëzakonshme që e pati zhvilluar — më pyetën nxënësit?
E unë ua ktheva:
— Breuku, që ishte i biri i Glaukut të madh, një kohë të gjatë qe log betejash. Kur po thellohej në çështjet e shpirtit, hetoi se me vete po barte dy pjesë të kundërta, të cilat ia morën qetësinë keqas... Pjesën e parë e cilësoi SI KAFSHË TË ZEZË, ndërsa pjesën e dytë, SI KAFSHË TË BARDHË. Kafsha e zezë ulërinte pareshtur, e kafsha e bardhë mundohej ta qetësonte tjetrën...
Një ditë prej ditësh, kur po lexonte ca libra të vjetra, që ishin plot e përplot fjalë të urta dhe mendime të arta, kafsha e zezë mori krye tmerrësisht. Iu sul megjithë fuqinë që kishte dhe përnjëherë e nënshtroi. Breuku ndjeu se duart po i ktheheshin në shputa e gishtat në kthetra të fuqishme. Hetoi se ishte kthyer në një bishë të egër, e cila kërkonte t'i griste dhe t'i shkatërronte librat që kishte pranë. Dhe kështu u bë...
Iu sul librave. Fletët, e më pas kopertinat e trasha nuk i qëndronin dot egërsisë. I bëri grima-grima që të gjitha. Më vonë i prishi dollapet dhe derdhi ngjyrën e shkrimit. Kur nuk kishte më se çfarë të shkatërronte, zuri të ulërinte. Uluriu e uluriu me sa zë kishte derisa befas u shfaq kafsha e bardhë. Pa një pa dy, filloi një përleshje e paparë midis tyre. E zeza sulmo, e bardha mbroju... Beteja zgjati shumë kohë. Dikur kafshët u tërhoqën secila në anën e vet...
Atë çast Breuku i shkallmuar pa përreth librat e grisura dhe zuri të qante. Qau e qau derisa iu terën lotët. Ç'e ligë më gjeti, thoshte. Herë kafshë e herë jokafshë... Çfarë po ngjet me mua? Medet, ç'sëmundje qenka kjo?

— Nuk je i sëmurë, — i tha një zë që i erdhi nga dikah. — Nuk je sëmurë. Të sëmurë janë ata që nuk e hetojnë kafshën e zezë në vetvete. Ti përmes mejtimit dhe thellimit të vazhdueshëm ia prishe folenë kafshës së zezë, e cila shumë e shumë kohë rrinte te ti e qetë. Po të rrije mendjefjetur, ajo nuk do të egërsohej kurrë. Prandaj ajo nuk pati rrugëdalje tjetër pos të sulej. Në një çast të mori të tërin. Të pushtoi, por nuk të mbajti përgjithmonë, ngase ti ia prishe folenë, atë fole të padukshme që fatkeqësisht e bartim në vete e të shumtën nuk e vërejmë... Kafsha e zezë të sulmon prapë. Ajo nuk jepet lehtë. Sa më shumë të thellohesh në libra dhe sa më tepër që vepron me arsye, ajo do të shqetësohet. Për t'u munduar do të mundohesh, për t'u sprovuar rëndë e më rëndë do të sprovohesh, por sa më shumë të kacafytesh me të, aq më shumë ligështohesh... E liga nuk shporret lehtë. Mjerisht, nganjëherë është më e fuqishme se ne...

J.

Nxënësit më thanë me një gojë:
— Sa më shumë po mendojmë, aq më shumë po shqetësohemi...
Njëri prej tyre më tha edhe këto:
— Mbase ajo kafsha e zezë që e pati sulmuar Breukun atëbotë, tash po më sulmon edhe mua.
— Unë po mjegullohem, — më tha një tjetër.
— Mua po më mbërthen një ankth...
— Mua m'u shfaq një hije që më tha gjithë shqetësim: po bëhemi heretikë...
— Mua m'u bë se dikush më tha: pse i harroni mësimet e shenjta? Pse ngarkoheni me mëkate?
— Mua dikush m'u kërcënua: pse helmohesh?
Shumë e shumë gjëra m'i thanë nxënësit dhe secili dukej më i shqetësuar se tjetri.
E unë u thashë:
— Enkeleu nuk thoshte kot se shpirti që s'i kthehet vetes, është si bima që nuk qet gjethe. Ai shpirt duhet të përsëritet pareshtur...

Në të kundërtën mjegullohet... E kur shpirti mjegullohet, atëherë duhet kohë e kohë që ta njohë vetveten. Ngjet që disa mbesin amshueshëm në atë mjegullim...
Andaj, o të dashur, luftoni me vetveten pareshtur... Në këtë mënyrë do ta ushqeni shpirtin, e qenien tuaj do ta formësoni...

K.

Para se të perëndonte dielli, u fola nxënësve për Mark Pakuvin... Ishte një poet i madh, u thashë. Mbase ishte më i madhi që kishte Roma. Shkroi tragjedi. Shkroi poezi dhe proza poetike. La shumë e shumë mendime të arta. Ishte nga Mesapët. Pati shqetësime të jashtëzakonshme krijuese. Ca kronikanë thonë se ai nuk i përfillte perandorët e fuqishëm të perandorisë së pafund. Mesapi, — thoshte ai, — nuk çan kokën për kurrfarë pushteti. Ai ka botën e vet shpirtërore plot e përplot vlime, që i jep fuqi të ngrihet mbi pushtuesit... Para se të vdiste shkroi këto vargje:

«Këshilla e Dodonës
Vlen sa e gjithë bota...
Porosia e saj
ngjall edhe të vdekurin...

Në fund ua recitova edhe këto vargje të këtij autori:

Vesa e gjeti trëndafilin
Lulja e përhapi purpurin
e purpuri ia mori sytë ilires së bukur...

L.

Justinit i thanë gjithë shqetësim:
— Madhëri, ka ndodhur një hata!
— Po ç'hata na qenka ajo, pyeti ai?
— Një piktor i krisur, madhëri, çoi krye kundër jush. Perandori i fuqishëm i Bizantit buzëqeshi.
— Me atë piktor nuk është shaka, — i thanë. — Do ta përmbys perandorinë!
Nuk vonoi e para i sollën një burrë të lidhur. Perandori njohu shokun e fëmijërisë, Gurëbardhin.

— Po thonë se ke çuar krye kundër meje! — i tha Justini duke ia hequr litarin.
Piktori heshti. Dikur foli e tha:
— Unë kam botën time dhe nuk çaj kokën se çfarë thonë të tjerët...
Nuk shoh tjetër pos ngjyrave dhe brushave që s'i heq nga dora ditë e natë...
— Ky njeri bëri shkelje të rëndë, — ndërhyri kështilltari. — Kjo mund të dëshmohet.
— E si mund të dëshmohet fajësia e tij? — pyeti Perandori?
— Me një ikonë që nuk është ikonë, — tha Kështilltari.
— Ç'është ikona që nuk është ikonë? — ia bëri Perandori.
— Mëkat. Mëkat... Piktori pikturoi shenjtoren si të ishte ndonjë bareshë.
Kështu u ngrit kundër urdhrit Tuaj për pacënueshmërinë e dukjes së shenjtorëve në ikonat e freskat. U ngrit kundër urdhërit Bizantin... A nuk është kjo shkelje e mëkatshme?
— Dua ta shoh ikonën, tha Perandori.
Kështilltari e hapi me të shpejtë ikonën mbështjellë shumëfish.
— Sa thellë është zhytur ky i shkretë në mëkate... sa thellë është zhytur, — fliste kështilltari.
Perandori një copë herë e shikoi ikonën dhe urdhëroi që ta linin vetëm me piktorin.
— Po kjo qenka Bardha, — tha Perandori me një zë të butë.
— Vetë Bardha. Si e paske mbajtur në mend? Ah, sa e desha. Mëkat që vdiq e re... Mëkat... Sa e desha... Buzëqeshja e saj nuk m'u hoq nga përfytyrimi... Po më duket se po e shoh të tillë... Të lumtë!
Piktor Gurëbardhi deshi të fliste diçka, por Perandori s'e hiqte nga goja fjalën Bardha, Bardha ime... Nuk e dija se do të shihemi prapë... Nuk e dija se do të takoja në këtë mënyrë... Tash e tutje do të rrish me mua...
Unë e ti... Unë e ti të pandashëm...
Dikur Perandori Justin i tha piktor Gurëbardhit, shokut të tij të fëmijërisë:
— Këtë madhështi do ta mbaj për vete, ndërsa ty për mëkatin e bërë kundër dogmës bizantine, të shkurtohen duart...

LL.

Pas dimrit vjen pranvera u thashë nxënësve, sapo filloi moti i lig...

M.

Qielli po ngrysej kur njëri nga nxënësit më tha:
— E nesërmja... E nesërmja...
Këto fjalë ishin ngjizur dhe mendimin nuk mundi ta çonte tutje fare. — Vazhdo, — i thashë. — Vazhdoje mendimin që po sillet nëpër kokë. E di se e ke të vështirë ta thuash, por bëj përpjekje... Përpiqu pareshtur ta thuash atë që të mori qetësinë...
Pas shumë e shumë përpëlitjesh tha:
— ...një lëmsh, një lëmsh i madh më është mbështjellë në kraharor dhe po ma zë frymën... Nuk e di se çfarë po ngjet me mua? Ka kohë që ky lëmsh më sillet e më pështillet dhe nuk ia gjej dot fillin. Sa do të zgjasë kjo, vallë?
— Derisa të thuash atë që po të mundon, — i thashë. — Nga kjo barrë do të lirohesh patjetër, por mos pandeh se pastaj do ta kesh lehtë. Jo. Jo. Shqetësimet nuk kanë të sosur. Vijnë palë-palë dhe nuk marrin fund fare...
— Por si ta them? Si? ...
Kur më tha këto, hetova se po dridhej. U kërrus dhe zuri të ulërinte me sa zë kishte... Uluriu e ulëriu, derisa u shtri përdhe dhe mbeti si i pafrymë.
Shokët e tij po qanin e mua më kapën ca dridhërima e-thesh... Po e kuptojmë vetveten, pështërita...

N.

Duhet trazuar uji, që të shohësh se ç'ka brenda, — u thashë nxënësve. Ata më shikuan si të ngrirë. Ndërsa njeri prej tyre më pyeti:
— A ngjet që të mos shihet gjë prej gjëje në të?
— Ngjet, — i thashë, — por nuk do të thotë se atje nuk ka

gjë. Përkundrazi, problemi mund të jetë te ai i cili nuk është në gjendje ta shohë atë që duhet të shohë...
Biseda jonë për ujin që do trazuar, zgjati shumë. Në fund nxënësve u dhashë detyrë që të hartojnë fjalë të urta dhe t'i mbajnë të shënuara në fletore të veçanta.
— Sa më shumë sosh, — u thashë, aq më mirë...

NJ.

— Piktor Davidi, — u thashë nxënësve, — s'e kishte shoqin në shtatë perandoritë. Ato që pikturonte, dukeshin të përkryera. Megjithatë, ai ishte i pakënaqur. Sa më shumë që ia lavdëronin veprat, i bëhej se nuk e kishte thënë atë që duhej të thoshte... Dhe kështu, o të dashur. Davidi u kthye në vendlindje. Ishte i moshuar dhe kur fliste shpesh, i ngatërroheshin emrat e vendeve të shumta nga kishte kaluar siç i ngatërroheshin edhe gjuhët e shumta që fliste.
Vendësit e pritën me nderime të mëdha dhe u erdhi mirë që ai ditët e prehjes do t'i kalonte me ta. Por piktori nuk gjeti prehje. Kërkoi t'i ndërtonin një kishëz.
— A nuk u ngope me to? — i thanë bashkëfshatarët.
— Ato që krijove nëpër botën e pafund, janë hiçgjë krahasuar me këtë që do të pikturoj këtu.
Bashkëfshatarët u gëzuan pa masë që kishëza e tyre do të bëhej e njohur në botë.
Kur u krye kishëza, piktori kërkoi që askush të mos hynte në të pa i dhënë fund veprës.
Gjithë verës së lume piktor Davidi nuk doli nga kisha. Një ditë, ndaj buzëmbrëmjes, piktori i dha fund veprës. Bashkëfshatarët e panë të lodhur, por më të lumtur se kurrë.
— Nesër do ta shihni pikturën...
Por me të gdhirë u hap lajmi i zi. Piktor Davidi u gjend i vdekur në kishëz. Edhe freska në murin ballor, në të cilën punoi shumë kohë, ishte gërvishtur pamëshirshëm...
I madh e i vogël qau...

O.

— Po ndjej shqetësim të madh, — më tha një nxënës...

— *Seç po më zë frymën, — më tha tjetri...*
— *Mbase kafsha e zezë po më sulmon?*
— *Më ka ikur gjumi...*
— *Mendja m'u ka kreshpëruar keqas...*
— *Më bëhet se një tjetër flet në mua?*
— *Nuk e di flas apo ulërij?*
— *Hija nuk po më shkëputet...*
— *Ç'janë këto përgjime?*
— *Sa shumë hije... Sa shumë!*
— *Nata është me barrë...*
Të gjithë thanë nga një ankesë, e unë ua ktheva:
— *Shkruajini ato që ju mundojnë...*

P.

— *Pse e pësoi aq rëndë piktor Davidi dhe piktura e tij, — më pyetën nxënësit gjithë shqetësim?*
E unë u thashë:
— *Si vdiq piktor Davidi dhe kush e shkatërroi freskën në murin e kishëzës së vendlindjes së tij, asnjëherë nuk u kuptua. Megjithatë, u hapën gjithfarë thashethemesh. Disa thanë se piktorin e përcolli një hije e fshehtë që nga malet e Iberisë, ku ai, sipas disa fjalëve, paska pasë pikturuar ca ikona, të cilat në njëfarë mase binin ndesh me mësimet kishtare... Hija duhej të merrte hak... Ca të tjerë thanë se fjala ishte për një zënkë të çuditshme midis piktorit dhe një adhuruesi të flaktë të veprës së tij që na paskësh shpërthyer mu çastin kur ai i kishte dhënë fund veprës... Adhuruesi i kishte thënë piktorit se ajo freskë nuk duhej të mbetej e fundit, e piktori ishte betuar se nuk do ta merrte më brushën në dorë... Adhuruesi i kishte thënë se kjo nuk duhej të ndodhte... Dhe, fjalë pas fjalë, adhuruesi i hakërryer e kishte gërvishtur veprën pa të keq. Piktori nga hidhërimi kishte vdekur sapo pa veprën e vet të gjymtuar...*
U thanë edhe fjalë të tjera, por fakti se freska ishte shkatërruar dhe piktori u gjend i vdekur para veprës që e punoi me aq përkushtim, flet qartë se fjala ishte për një atentat kundër artit, i cili kishte zënë t'i thyente kanonet shumëshekullore...

Krijuesit fat të tillë kanë...

Q.

Sheh rrushi rrushin e piqet...

R.

Lexoni të gjitha librat e vjetër, — u thashë nxënësve. — Gjithëçka është e vlefshme. Të kaluarën duhet ta njohim për ta kuptuar më mirë dhe më drejtë të sotmen dhe të nesërmen...

RR.

Ujku e ndërron qimen, por hujin jo...

S.

Po shoh vetëm një copë qiell dhe një peizash të ngrirë — më tha një nxënës, — si ta mund këtë zymti?
Unë ia ktheva:
— Lehtë, fare lehtë, biro...
Ai më shikoi me kureshtje.
— Po pse e kemi mendjen? — i thashë. — Me të duhet të shohim më larg se me syrin më të madh të botës... Bëj përpjekje që gjërat t'i shohësh ndryshe nga ç'janë... Mos lejo që të mashtrojë tejdukshmëria... Dysho dhe hesht... Mbi të gjitha, mësohu që fundin gjithnjë ta zësh para fillimit... Atëherë do ta kesh më lehtë...

SH.

Ngado të sillesh hijen e ke prapa...

T.

Vjershën e lind frymëzimi i thellë, — u thashë nxënësve. — Mbase patët mjaft kohë që ta ndillni atë. Përse? Që t'ia ji-

lloni vjershërimit... Mos nguroni fare! Shumëçka do t'u duket e pabesueshme, e luhatshme dhe e pakapshme, por dijeni se gurë-gurë bëhet mur...
Kjo është kohë shkrimesh... Kohë e kujtesës... Nxënësit më shikonin sy e veshë. Më bëhej se ua ndjeja dridhërimat në kraharorë...

TH.

Shumë herë mendo, një herë fol...

U.

Fërfëlliza kuiste si kafshë e plagosur...
Nxënësit silleshin me libra të vjetër ndër duar dhe pështëritnin vargjet e para që po i hartonin me aq mund.
— Mos rrini në gjysmë të rrugës, — u thashë.
— E dini se çfarë thoshte Glauku për kullat e shpirtit. Tash ju jeni muratorët e saj...
Diku vonë u ngjita në qilarin tim të ftohtë. Për herë të parë m'u bë se me mua hynë edhe ndjekësit e shumtë, të cilët na përgjonin nga të gjitha anët. Më bëhej se më rrinin para dhe më shikonin gjithë mllef. «As këtu nuk po më lini të qetë», u thashë. Por ndjekësit nuk çanin kokën për ato që u thashë.
«E di, — fola si i trullosur, — e di. Është shkrimi... Koha e shkrimit i shqetëson të tillët...»
«Kohë shkrumbi», — më thanë ata. — «Kohë shkrumbi...»
M'u bë se tash po më flisnin korbat, një kor i tërë korbash që më kishte mbërthyer brenda një rrethi të çuditshëm të futës.
«Kohë shkrimi», — u thashë.
«Kohë shkrumbi», — ma kthyen.
Kështu, unë «shkrim», e ata «shkrumb». «Shkrim», «shkrumb», «shkrim», «shkrumb...»
Qilari jehonte nga fjalët:
shkrim-shkrumb, shkrim-shkrumb, shkrim-shkrumb...
Më vonë, m'u bë se korbat kërkonin koka.

«Koka... koka... koka... Koka... koka... Të gjitha kokat...»

Kur zbardhi e lumja dritë, isha lodhur, aq i lodhur sa më bëhej se të gjitha gjymtyrët i kisha të thyera...

X.

Ngrica nuk po soste. Stina e akullnajave dukej si e pafund... Nxënësit ndiqnin frymëzimet dhe shkruanin.
Aty për aty m'u kujtua Batoni dhe rrethimi i tij i gjatë. Desha t'u flisja nxënësve për atë rrethim të pashembullt dhe për sakrificat e mëdha të fisit të tij për t'u bërë ballë shtrëngesave që u vinin nga ushtria e përtejdetit, por heshta. Ata ishin të vetëdijshëm për fërfëllizën dhe për acarin që i rrethonte... Rrathëve të tillë mund t'u bëjnë ballë vetëm krijimet shpirtërore, që nuk u nënshtrohen as kohës e as hapësirës...

XH.

Një nxënës po thoshte si përçart:
e amshueshmja,
e madhërishmja,
e lartësishmja,
e përsëritshmja...
Një kohë të gjatë i tha këto dhe dukej i verdhë si dyllë. Dikur heshti. Shokët e tij po qanin...
Kur u ktheva në qilar, sërish ndjeva praninë e korbave. Më bëhej se ata silleshin e silleshin dhe kërkonin vargjet e njoma... Shkrumb... Shkrumb... thoshin. Kthetrat i kishin plot shkronja... Kohë tmerri, thashë dhe i mbylla sytë. Por ç'e do që përfytyrimet e tilla ishin më të forta se dëshira ime që të rrija vetëm...

Y.

— Po e parandjej pranverën, — më tha një nxënës.
— Nga e di këtë, — e pyeta gjithë kërshëri?

Ai belbëzoi një copë herë dhe tha:
— Sepse... sepse... e kam hartuar vjershën...
E lexova vjershën që më dha dhe nga ngashërimi më shkuan lotët. Më bëhej se fluturoja mbi një hapësirë me lule të llojllojshme ku nuk kishte as korba e as ndjekës... Kur më kaloi ngashërimi, po dridhesha. Erdhi çasti i pritur, i thashë vetes... Tash nuk kanë më se çfarë të bëjnë korbat e botës...

Z.

— Paçit frymëzim të amshueshëm, kopshtarë të pavdekshëm, — u thashë nxënësve në ndarje.
Ata u nisën në të katër anët. Shpejt më humbën nga sytë. I përfytyroja si vargje, si vjersha që shkojnë gojë më gojë dhe bashkëjetojnë me kuptimet e reja...
Shpirti e mund edhe katrahurën, thashë...

ZH.

«Nga na dole, m o j m e s j e t ë
që nuk po ke të sosur?»

Fjala «mesjetë» i erdhi e ftohtë. Ftohtësia e saj iu bë se e tërhoqi kah një akullnajë e pafund, në të cilën kishin mbërthyer të ngrirë, një nga një, Qyprillinjtë... Të ngrirë pastaj po i shihte edhe nxënësit bashkë me vjershat e tyre të shkapërderdhura, e të ngrira po i dukeshin edhe shpatat edhe heshtat... Të ngrirë i shihte edhe ndjekësit e shumtë që nuk kishin fund... Çuditërisht, asaj ngrirjeje i kishte shpëtuar vetëm njëri, i cili sillej andej-këndej duke u pështëritur diçka të ngrirëve...

Nimani e mori me mend se ai që sillej ashtu ishte Poeti, poet Gropani dhe me të as që do të mund të takohej ndryshe pos në një ftohtësi të tillë ku edhe koha rrinte e ngrirë...

«Gjithçka është ngrirë... Gjithçka është ngrirë...» — po fliste Poeti.

Nimani pa një fytyrë të akullt në të cilën dy sy të mëdhenj dukeshin të mjegulluar.

«Shekujt e ngrirë... Mendimet e ngrira... Gjurmët e ngrira... Pergamenët e ngrirë... shkronjat e ngrira...»

(Koha pas dyzetditëshit)

Sapo i sollën plikon e kaltër, Sulltan Mustafai urdhëroi që të mos e trazonin. Një copë herë e shikoi letrën dhe iu bë se në të ishte vetë Niman Pashë Qyprilliu, i zvogëluar në përmasa qesharake. Në përmasa komike po i shihte edhe Qyprillinjtë e tjerë. Do të mjaftonte fare pak mund (madje vetëm një grisje e plikos), që gjithçka e tyre të shkatërrohej si të mos ishte. Kjo ndjenjë e trimëroi aq sa plikon e kapi sikur në dorë të kishte të gjithë Qyprillinjtë... Por, cuditërisht mjaftoi një e prekur e lehtë e letrës që t'i kthehej saora zemërimi i pakmëparshëm që po e mundonte nga çasti kur Niman Pashai nuk e pranoi postin e Kryevezirit. Qafiri! — shfreu. Edhe kështu nuk po më lë të qetë. Dhe, aty për aty, në kokë iu ndez një mendim që ta kallte letrën pa lexuar fare. Tekefundit, ç'rëndësi kishin hollësitë që nuk i duheshin për asgjë? Letra edhe ashtu duhej të asgjesohej medoemos. Prandaj, pse të mos e bënte këtë pa e hapur fare?
Dhe, kur ishte gati ta kallte në shandanin e madh, iu bë se dëgjoi një zë të njohur që po i thoshte:

«Ke frikë nga unë? Këtë e dija, o Babaxhan».

Sulltani u rrënqeth. Flaka e qiriut iu duk e zbehtë dhe e pafuqishme...

«...Ke frikë?... Ende frikësohesh nga unë?... Kjo nuk do të hehet kurrë... Kurrë...»

«Ti... Tiiii... Tiiii u frikësove nga vetvetja... Kërkoje të fshiheshe midis librave të vjetër dhe pergameneve... Ti... Tiiii», foli Sulltani gjithë djersë.

«Aty e kisha vendin... Aty... Po e kërkoja vendin që më takonte...»

«Mjaft! Mjaft!», — u kërcënua Sulltani. — «Tash e tutje je i paqenë... A të mjafton kjo?...
Zëri qeshi.

«Përkundrazi, iu bashkova thirrjes së shpirtit tim... U bëra një me atë thirje, që për shumë shekuj brodhi e shkapërderdhur dhe na kërkoi...»

«Mjaft! Mjaft!»

Zëri prapë qeshi. Iu bë se e qeshura u përhap shpejt

në të gjitha anët dhe u kthye në një thekamë të tmerrshme, që po e sulmonte nga të gjitha drejtimet. Mbase do ta kallte aty për aty letrën, por hetoi se flaka e qiriut ishte e pazonja ta bënte një gjë të tillë. Deshi të kërkonte flakë, një flakë të fuqishme, por kishte frikë se do t'ia hetonin shqetësimin. Grise! Grise! — po thoshte një zë i brendshëm. Sa më parë grise!

Duart që po i dridheshin mezi e hoqën dyllin dhe fjongon e kuqe në pliko. Iu bë se fjongoja lëshoi një klithmë të shurdhër e cila ia ngjeshi edhe më mishin. Hetoi se nuk kishte fuqi ta griste letrën, e cila po i rrinte e hapur para, sikur dëshironte t'ia thoshte se të kesh pushtet mbi gjithë botën, nuk do të thotë se njëherësh mund të kesh epërsi shpirtërore mbi të tjerët... Ky mendim e ligështoi aq saqë pa dashur kërkoi të ngushëllohej me ato që i shkruante ysqedari.

«...dyzet ditë isha hija e tij... E ai, si i matufosur, zuri të futej nëpër libra. Ditë e natë fliste me ta. Herë qeshte, herë ngrinte zërin e ndonjëherë shkulte flokët sikur ta kishte në kraharor sikletin e botës! Jo rrallë recitonte vargje. Kur zbrazej nga ato, atëherë shtrihej si i pajetë dhe mua më dhimbsej, pse shpirti i tij nuk gjente qetësi...

Një ditë prej ditësh nga muri ballor hoqi portretet e farefisit, i rreshtoi përpara dhe i qortoi gjatë. Çmos u tha. Kisha frikë se do t'i dëmtonte. Por, për habi, prapë i ktheu. U lexoi një vjershë dhe u tha se deri në amshim do të dëgjonin poezi. Këtë e keni si dënim...

Kur ia lashë gotën pranë dhe pritja që më në fund ta pinte, në mënyrë që të merrnin fund vuajtjet e tij dhe tonat, ishte i shkallmuar. Thoshte përçart ca vargje që s'i kuptoja. Së fundi, në gojë iu qepën fjalët: ngrirje... shkrirje... ngrirje... shkrirje... ngrirje shekullore! Për habinë më të madhe, po atë mbrëmje, kur u nisa bashkë me trupin e tij të ngrirë dhe shpalla lajmin se Pashai vdiq nga pika në zemër, mu në çastin më të rëndësishëm, kur po bëhej gati të merrte postin e kryevezirit, trupi i tij i pajetë herë pas here nxirrte fjalët «ngrirje».

Kjo më frikësoi pa masë, kështu që nxitova ta varrosja

sa më parë. Bile edhe pasi e mbulova me dheun e zi, m'u bë se nga varri i fshehur në kështjellën e harruar të Krimesë, dilte ajo fjalë, e po atë fjalë të mallkuar po e thoshte pastaj edhe tabuti i rremë që e nisa me nderime të mëdha drejt Kryeshehrit...»

Sulltan Mustafai nuk e lexoi letrën deri në fund. E bëri shuk dhe e gjuajti në shandanin e madh, ku qiriu lëshonte një flakë të dobët. Në një çast iu duk se flaka e qiriut do t'i nënshtrohej letrës, por nuk vonoi dhe ajo u rrit befas dhe ai ndjeu kundërmimin e dyllit dhe të ngjyrës.

«Qafiri», shfreu Pashai. «Qafiri. Mendon se mund t'i bëjë ballë edhe zjarrit!»

Një buzëqeshje e thartë ishte gati të zinte vend në fytyrën e tij të zymtë, por shpejt i iku ngase iu bë se Nimanin e kishte pranë, bashkë me Qyprillinjtë e tjerë.

«Qafiri», tha gjithë tërbim dhe me të shpejtë shkroi fermanin me të cilin urdhërohej që tabuti (i rremë) i Niman Pashë Qyprilliut, i cili ishte në rrugë për në Kryesheher, të përcillej me shumë hoxhallarë e dervishë... Urdhëroi poashtu që ditën e varrimit, që duhej të ishte madhështor, tabutit t'i rrethoheshin gjithë hoxhallarët e Kryeshehrit dhe të luteshin për shpirtin e tij më sa zë kishin...

Ashtu edhe u bë...

Çastin kur tabuti (i rremë) i Niman Pashë Qyprilliut kaloi pranë Gjylsarajt e nga lutjet e hoxhallarëve po dridhej sarai i madh, Sulltan Mustafajt iu bë se pranë kishte Nimanin. Aty për aty urdhëroi të kalleshin të gjitha librat e Qyprilliut të fundit. Kadiasqerit më të besueshëm i tha t'i asgjësonte të gjitha dokumentat e tjera të mundshme që lidheshin me sojin e tij. Po atë ditë dha dhe një urdhër të fshehtë që menjëherë të vritej ysqedar Halim Ozali dhe të varrosej në Krime...

Prishtinë, 1986-1988

Buxhovi, Jusuf
Libri i të mallkuarve: Roman / Jusuf Buxhovi: Red.: J. Bulo. — T.: Naim Frashëri, 1991. — 384 f.; 18 cm.
891.983(=919.83:497.115)-31
B 98

U dorëzua për shtyp më 7 janar 1991

Doli nga shtypi Prill 1991

Tirazhi 15000 kopje Formati 60x88/16 Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1991